REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI
I PRAKTIKËS GJYQËSORE
2012

Vëllimi I

Botues:
Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Prof.Dr. Enver Hasani, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Prof.Dr. Ivan Čukalović, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese
Almiro Rodrigues, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese
Prof.Dr. Snezhana Botusharova, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese
Mr.Sc. Arbëresha Raça-Shala, Sekretare e Përgjithshme e Gjykatës Kushtetuese

Përgatitur nga:
Prof. Dr. Bengt Beutler, Ekspert Ligjor
Z. Volkmar Theobald, Menaxher i Projektit, GIZ
Dr. Avni Mazrreku, Ekspert Ligjor
Znj. Pranvera Ejupi- Hajzeraj, Kordinatore e projektit, GIZ

© 2013 Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) , përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësisë:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhja e vendimeve dhe aktgjykimeve është përpiluar nga "Projekti për Reformë Juridike" implementuar nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ), dhe si i tillë, nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqësojnë formulimin e vërtetë të vendimeve/aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

BULETINI
I PRAKTIKËS GJYQËSORE
2012

I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ky Buletin është përgatitur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammendarbeit (GIZ) GmbH, Projekti „ Reforma Juridike“ në Kosovë, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Përmbatja

Parathënie..... 12

Nr.1 KI 35/10 datë 17 janar 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Prizren KP Nr. 3/2010, të datës 29 janar 2010..... 14

Nr.2 KI 08/10, KI 16/10, KI 22/10, KI 24/10, KI 27/10, KI 36/10, KI 41/10, KI 42/10, KI 45/10, KI 53/10, KI 54/10, KI 56/10, KI 57/10, KI 58/10, KI 59/10, KI 60/10, KI 61/10, KI 63/10, KI 64/10, KI 65/10, KI 66/10, KI 67/10, KI 68/10 KI 71/10, KI 74/10, KI 76/10 datë 27 janar 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së 26 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës..... 24

Nr.3 KI 09/11 datë 06 mars 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Ac. nr. 1326/2008, të datës 27.02.2009 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale CI. nr 1176/07, të datës 12.06.2008..... 51

Nr.4 KI 02/11 datë 19 janar 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajit C. nr. 409/06, të 7 shkurtit 2008..... 62

Nr.5 KO 117/10 datë 12 janar 2012- Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, lidhur me emrin e Komunës së Hanit të Elezit, në gjuhën serbe e njohur si Gjeneral Jankoviq 71

Nr.6 KI 101/11 datë 17 janar 2012- Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PPA nr. 4/2009 të datës 27.4.2011 79

Nr.7 KI 10/11 datë janar 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.Nr.142/04, të 19 majit 2005 dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, Ap.Kz.Nr.179/2007, të 23 qershorit 2009 dhe Nr PKL-KZZ 131/09, të 5 qershorit 2010 90

Nr.8 KI 23/11 datë 21 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Gllogoc, C. Nr. 150/04, të 29 janarit 2009, dhe të Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 90/04, të 14 tetorit 2004..... 100

Nr.9 KI 94/11 datë 24 janar 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Komisionit të Kërkesave Banesore dhe Pronësore HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004 108

Nr.10 KI 62/11 datë 10 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pn. nr. 181/2011, të datës 31 mars 2011..... 116

Nr.11 KI 126/10 datë 21 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit Nr. 140, të 25 janarit 2010..... 125

Nr.12 KI 14/11 datë 10 shkurt 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme Pzd.nr. 135/2010, të 21 janarit 2011..... 135

Nr.13 KI 54/11 datë 10 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 11/2002, të 6 shkurtit 2002 143

Nr.14 KI 06/11 datë 10 shkurt 2012- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit të Senatit të Universitetit të Prishtinës, ref. nr 4/449, të datës 03.12.2010..... 151

Nr.15 KI 90,91,92,93,94 dhe 95/10 datë 10 shkurt 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për privatizimin e Ndërmarrjes së re Jatex kompleksi industrial sh,p.k, në valën e 45 A të privatizimit..... 161

Nr.16 KI 19/09 datë 10 shkurt 2012- Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. 120/2008, të 1 janarit 2009..... 173

Nr.17 KI 14/10 dhe KI 15/10 datë 10 shkurt 2012- Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë 181

Nr.18 KI 30/09 datë 15 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. Nr. 1360/08, të 19 qershorit 2009 189

Nr.19 KI 03/11 datë 06 mars 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Marrëveshjes për Bashkëpunim midis Zyrës së Prokurorit të Shtetit dhe Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit..... 198

Nr.20 KI 43/09 datë 10 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Protokollit për Bashkëpunim Policor në mes të Misionit Evropian për Drejtësi dhe Sundim të Ligjit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë, të datës 11 shtator 2009..... 207

Nr.21 KI 107/11 datë 06 mars 2012- Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr 293/ 2010 të datës 23.03.2011..... 215

Nr.22 KI 64/11 datë 15 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 184/2008, të 27 janarit 2009..... 230

Nr.23 KI 128/11 datë 15 shkurt 2012- Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Rev. Nr. 225/2007), të 25 shtatorit 2007..... 238

Nr.24 KI 26/10 datë 15 mars 2012- Vendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 14/2008, të 10 tetorit 2008, dhe Vendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 260/2008, të 2 korrikut 2008..... 244

Nr.25 KO 04/11 datë 06 mars 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Nr. 03/L-139..... 264

Nr.26 KI 37/11 datë 06 mars 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.5/2008, të 9 korrikut 2010..... 290

Nr.27 KI 59/11 datë 22 mars 2012- Në lidhje me kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës, SCA 15/07, të 26 dhjetorit 2007..... 300

Nr.28 KI 51/10 datë 26 mars 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Goran Zdravkovićit anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si përfaqësues të komunitetit serb 311

Nr.29 KI 109/10 datë 29 mars 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. Nr. 317/07, të 12 nëntorit 2008..... 320

Nr.30 KI 122/11 datë 22 mars 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, SSC-11-0148, të 15 qershorit 2011..... 328

Nr.31 KI 20/11 dhe KI 96/11 datë 05 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan P. nr. 550/08, të 9 korrikut 2009, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan AP. nr. 182/2009, të 29 prillit 2010..... 336

Nr.32 KO 05/12 datë 19 mars 2012- Lidhur me kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-279, të 20 janarit 2012..... 347

Nr.33 KI 132/11 datë 05 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 601/02, të 15 shtatorit 2004..... 359

Nr.34 KI 131/11 datë 21 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 197/2010, të datës 22 gusht 2011..... 366

Nr.35 KI 139/11 datë 21 prill 2012 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për riemërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Nr. 01/118-658, të 27 28 tetorit 2010..... 381

Nr.36 KI 147/11 datë 21 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL. nr. 1288/2011, të 28 tetorit 2011..... 389

Nr.37 KI 106/11, KI 110/11, KI 115/11 dhe KI 116/11 datë 24 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Gjykatës së Qarkut në Pejë, PN. Nr. 81/11 dhe PN. Nr. 83/11, të 1 korrikut 2011..... 403

Nr.38 KI 46/11 datë 29 mars 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë të mosekzekutimit të Aktgjykimit CI.nr.33/2006 të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 5 korrikut 2006..... 415

Nr.39 KI 98/10 datë 17 prill 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve 01 nr. 06/837, të datës 16 prill 2009, dhe Npi-01/132, të datës 30 prill 2009, të Kuvendit Komunal të Shtimes..... 427

Nr.40 KI 112/10 datë 17 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të dekreteve të Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, të datës 22 tetor 2010..... 439

Nr.41 KI 86/11 datë 17 prill 2012- Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës rev.nr 20/09 të datës 1.3.2011..... 448

Nr.42 KI 103/10 datë 19 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 406/2008, të 3 shtatorit 2010..... 461

Nr.43 KI 77/11 datë 24 prill 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.330/2008, të datës 06.01.2011..... 477

Nr.44 KI 01/10 datë 10 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1224/09, të 12 nëntorit 2009..... 489

Nr.45 KI 32/11 datë 18 maj 2012- Kërkesë për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së..... 497

Nr.46 KI 104/10 datë 10 maj 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan GŽ Nr. 78/2010, të 7 qershorit 2010..... 503

Nr.47 KI 08/11 datë 10 maj 2012- Malush Sopa, Sedat Kuqi, Fazli Morina, Rrahman Kabashi dhe Liman Gashi kundër Autoritetit të panjohur publik..... 530

Nr.48 KI 56/11 datë 10 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ae. nr. 104/2009, të 21 shtatorit 2010..... 552

Nr.49 KI 161/11 datë 22 maj 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. Nr. 2/2011 të 10 qershorit 2011..... 562

Nr.50 KI 160/11 datë 10 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ASC-09-0106, të datës 7 tetor 2011..... 571

Nr.51 KI 153/11 datë 22 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 564/2011, të 5 gushtit 2011..... 583

Nr.52 KI 05/11 datë 28 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Deklaratës së Përbashkët, Nr. 122/08, të 14 tetorit 2008..... 590

Nr.53 KI 125/11 datë 28 maj 2012- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 217/2008, të datës 10.06.2011..... 602

Nr.54 KI 155/11 datë 18 maj 2012- Kërkesë për vlerësimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Viti nr. 22/2004, të 28 majit 2007, Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan nr. 323/2007, të 26 tetorit 2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 52/2008, të 10 qershorit 2011..... 612

Nr.55 KI 27/11 datë 18 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 820/2010, të 25 janarit 2010..... 621

Nr.56 KI 87/11 datë 11 qershor 2012- Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.Nr.247/2007, të 12 janarit 2011..... 632

Nr.57 KI 150/11 datë 28 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 396/11, të 7 qershorit 2011..... 643

Nr.58 KI 17/12 datë 04 qershor 2012- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 12/59, të datës 1 shkurt 2012..... 651

Nr.59 KI 129/10 datë 28 maj 2012 - Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 15/2003 të 30 qershorit 2004..... 665

Nr.60 KO 38/12 datë 05 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012..... 672

Nr.61 KI 26/11 datë 15 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl-Kzz-93/09, të 1 marsit 2010..... 707

Nr.62 KI 146/11 datë 15 qershor 2012- Kërkesë për zbatimin e dy rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2001/35 dhe 2005/20 715

Nr.63 KO 123/10 datë 11 qershor 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë Nr. C. nr. 183/2009 të 17 qershorit 2009 725

Nr.64 KI 110/10 datë 15 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës, të 3 shkurtit 2010..... 734

Nr.65 KI 66/11 datë 15 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pn-Kr 56/2006, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap. nr. 52/2004 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtine P. nr. 94/01..... 742

Nr.66 KI 114/11 datë 15 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc. nr. 2/2009, të 5 prillit 2011 749

Nr.67 KI 130/11 datë 15 qershor 2012- Kërkesë për rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KI18/10, të 12 prillit 2011..... 760

Nr.68 KI 18/12 datë 25 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 1285/2011, të 30 dhjetorit 2011 767

Nr.69 KI 108/11 datë 10 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme PN. Nr. 372/2011, të 13 korrikut 2011..... 775

Nr.70 KI 16/12 datë 25 qershor 2012- Vlerësim kushtetues i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. nr. 1415/2011, të datës 30 dhjetor 2011..... 784

Nr.71 KI 127/11 datë 1 1 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 219/2009, të 10 qershorit 2011..... 793

Nr.72 KI 90/11 datë 18 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 368/2008, të 8 prillit 2011..... 806

Nr.73 KI 95/11 datë 27 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 1230/2010, të 15 shkurtit 2011..... 816

Nr.74 KI 30/10 datë 10 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 852/2009, të 24 marsit 2010..... 825

Nr.75 KI 46/10 datë 19 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit P. nr. 162/03, të 7 prillit 2005, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan; Aktgjykimit P.nr.628/04, të 8 marsit 2007, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë; Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap. nr. 393/2006, të 21 majit 2008; Aktgjykimit API. Nr. 04/2009, të 16 shtatorit 2009, të Kolegjit të Veçantë Penal të Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap. nr. 84/09, të 3 dhjetorit 2009..... 833

Nr.76 KI 52/10 datë 19 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P. nr. 162/2003, të 7 prillit 2005, dhe të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. nr. 393/2006, të 20 majit 2008, Nr. 4/09, të 16 shtatorit 2009, dhe PKL-KZI nr. 30/2010, të 1 shkurtit 2011..... 846

Indeksi i termave..... 860

Indeksi i nenëve të kushtetutës..... 864

Parathënie

Buletini i praktikës gjyqësore 2012 i Gjykatës Kushtetuese është publikimi i tretë i këtij lloji që nga themelimi i Gjykatës, në shtator të vitit 2009. Kam kënaqësinë që Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese ka arritur të përgatisë këtë buletin, duke përdorur të njëjtën metodologji, siç është zhvilluar nga Iniciativa Kushtetuese e Drejtësisë për publikimin e buletineve të mëparshme të praktikës gjyqësore për vitet 2009, 2010 dhe 2011. Publikimi i Buletinit të tanishëm është bërë i mundur nëpërmjet një donacioni nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për të cilin Gjykata është jashtëzakonisht mirënjohëse.

Ashtu sikur edhe në buletinet e mëparshme, vendimet e përfshira në Buletinin e praktikës gjyqësore për vitin 2012, merren me një numër çështjesh të rëndësishme të të drejtave të njeriut, të parashtruara nga persona fizikë dhe nga persona juridikë, si dhe me çështje po aq të rëndësishme, të ngritura në bazë të Kushtetutës nga institucionet e Kosovës. Në këtë drejtim, nuk mund të theksoj mjaftueshëm se sa e rëndësishme është për ata që synojnë të parashtrojnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese që, së pari, të shikojnë rastet e ngjashme të gjykuara tashmë nga Gjykata, në mënyrë që të kenë një ide nëse rasti i tyre do të kishte ose jo ndonjë perspektivë suksesi në Gjykatën Kushtetuese.Prandaj, në mënyrë që të lehtësojnë kërkimet e tyre, rekomandohet që parashtruesit e mundshëm, ose përfaqësuesit e tyre, të përdorin buletinet e praktikës gjyqësore, ku janë përmbledhur vendimet më përfaqësuese që i ka marrë Gjykata ndërmjet viteve 2009-2012.Këto dhe publikime të tjera të Gjykatës kanë për qëllim t'i tregojnë popullit të Kosovës se puna e Gjykatës Kushtetuese është plotësisht transparente dhe se, në përpjekje që të mbështesë sundimin e ligjit, Gjykata, si autoriteti më i lartë për interpretimin e Kushtetutës dhe të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, përmbush standardet më të larta të profesionalizmit dhe të objektivitetit.

Prof. Dr. Enver Hasani

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

KI 35/10 datë 17 janar 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Prizren KP Nr. 3/2010, të datës 29 janar 2010

Lënda KI 35/10, vendimi i 21 nëntorit 2012
Fjalët kyçe; kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren

Parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës së 15 janarit 2009.

Me 11 shkurt 2010, Gjykata pranoi kërkesën nga parashtruesi i kërkesës, cili pretendon shkeljen e të drejtave të tij individuale njerëzore.

Me 30 gusht 2010 Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar Raportues dhe Kolegjin Shqyrtues te përbërë nga Gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesues), Ivan Cukalovic dhe Iliriana Islami.
Me 30 mars 2010, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës qe të sqarojë kërkesën e tij dhe të dorëzojë Vendimin e kontestuar KP nr. 3/2010, të datës 29 janar 2010, i cili i ishte dorëzuar atij me 3 shkurt 2010, si dhe një kopje te ankesës ndaj atij vendimi qe parashtruesi i kërkesës pretendohet ta ketë paraqitur me 5 shkurt 2010.
Me 18 korrik 2008, parashtruesi i kërkesës ngriti padi private penale kundër gjyqtarit M.A., të Gjykatës Komunale ne Prizren për *inter alia*, vepër te supozuar penale kundër nderit dhe reputacionit, të paraparë me nenin 190 te Kodit te Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK, UNMIK/REG/2003/25) dhe vepër penale për lëshimin e vendimeve gjyqësore të paligjshme, paraparë me nenin 346 te KPPK-së.
Me 11 janar 2010, Gjykata Komunale ne Prizren nxori Vendimin PKA Nr 163/09 dhe hodhi poshtë padinë private penale të parashtruesit të kërkesës si jo të rregullt dhe të pabazuar si dhe ndërpreu procedurat penale ndaj të padituri.

Parashtruesi i kërkesës ushtori ankesë.
Me 29 janar 2010, Gjykata Komunale ne Prizren lëshoi Vendimin Nr.3/2010 dhe refuzoi si të pabazë ankesën e parashtruesit të

kërkesës ndaj Vendimit të 11 janarit 2010. Ne atë Vendim ishte cekur se *inter alia*, parashtruesi i kërkesës nuk është sjellë në pajtueshmëri me nenin 361(1) te KPPK-së dhe se nuk e ka sqaruar padinë e tij private penale. Me tej u theksua se padia private penale ishte e parashkruar.
Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, edhe pse Gjykata Kushtetuese i kishte kërkuar të sqarojë kërkesën e tij dhe të dorëzojë *inter alia* një kopje te ankesës ndaj vendimit të datës 29 janar 2010, ai kurrë nuk e bëri këtë. Pavarësisht se, siç; u cek me lart, duket se procedurat kundër vendimit te Gjykatës Komunale në Prizren ende janë në pritje.

Gjykata Kushtetuese rikujton se kjo gjykatë nuk duhet të veprojë si Gjykatë e Apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese.

Lidhur me këtë, Gjykata konsideron se nga autoritetet publike të Republikës së Kosovës mund vetëm të kërkohet përgjigje për faktet dhe aktet të cilat ndodhën pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, me 15 qershor 2008. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të merret me kërkesën lidhur me ngjarjet qe ndodhën para se të hyjë në fuqi Kushtetuta.
Përfundimisht, kushtet për pranueshmërinë e kësaj kërkese nuk janë plotësuar.
Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kësaj kërkese, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullave 36. (1a) dhe 36. (3c) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 19 prill 2012, njëzëri vendosi ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

Prishtinë, më 10 janar 2012

Nr. ref.: RK172/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 35/10

Parashtruesi

Skender Zenuni

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Prizren

KP Nr. 3/2010, të datës 29 janar 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Skender Zenuni, nga Gjilani.

2. Parashtruesi i kërkesës pretendon, pa specifikuar ndonjë dispozitë të caktuar të Kushtetutës, se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë, për shkak të korruptimit, të pretenduar, të gjyqtarit të Gjykatës Komunale në Gjilan.

3. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Vendimi i kontestuar

4. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës Komunale në Prizren KP Nr. 3/2010, të datës 29 janar 2010, i cili i ishte dorëzuar atij më 3 shkurt 2010.

Procedura në Gjykatë

5. Më 25 janar 2010, parashtruesi i kërkesës i shkroi letër Gjykatës (në tekstin mëtejmë: Gjykata) duke pretenduar korruptimin e gjyqtarit të Gjykatës Komunale në Gjilan.

6. Më 28 janar 2010, Sekretariati i Gjykatës i shkroi letër parashtruesit të kërkesës duke i propozuar atij që t'i drejtohet Zyrës së Prokurorit Disiplinor në Prishtinë.

7. Më 11 shkurt 2010, Gjykata pranoi kërkesën nga parashtruesi i kërkesës, i cili pretendon shkeljen e të drejtave të tij individuale njerëzore.

8. Më 30 mars 2010, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të sqarojë kërkesën e tij dhe të dorëzojë Vendimin e kontestuar KP Nr. 3/2010, të datës 29 janar 2010, i cili i ishte dorëzuar atij më 3 shkurt 2010, si dhe një kopje të ankesës ndaj atij vendimi që parashtruesi i kërkesës pretendohet ta ketë paraqitur më 5 shkurt 2010.

9. Më 12 prill 2010, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj letrës së Gjykatës të 30 marsit 2010, dhe paraqiti vetëm Vendimin e Gjykatës Komunale në Prizren KP Nr. 3/2010, të datës 29 janar 2010.

10. Më 24 gusht 2010, Gjykata njoftoi Gjykatën Komunale në Prizren lidhur me kërkesën.

11. Më 30 gusht 2010 Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar Raportues dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga Gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesues), Ivan Čukalović

dhe Iliriana Islami. Më 28 nëntor 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe dokumenteve në dosjen e rastit, faktet e rastit mund të përmblidhen si vijon:

13. Më 18 korrik 2008, parashtruesi i kërkesës ngriti padi private penale kundër gjyqtarit M.A., të Gjykatës Komunale në Prizren për *inter alia*, vepër të supozuar penale kundër nderit dhe reputacionit, paraparë me nenin 190 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK, UNMIK/REG/2003/25) dhe vepër penale për lëshimin e vendimeve gjyqësore të paligjshme, paraparë me nenin 346 të KPPK-së.

14. Më 11 janar 2010, Gjykata Komunale në Prizren nxori Vendimin PKA Nr 163/09 dhe hodhi poshtë padinë private penale të parashtruesit të kërkesës, si dhe ndërpreu procedurat penale ndaj të padituri. Gjykata Komunale në Prizren, në arsyetimin e Vendimit PKA Nr 163/09, thekson se padia private penale e parashtruesit të kërkesës është e parregullt dhe e parashkruar.

15. Sipas këshillës juridike, dhënë në vendimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Prizren, parashtruesi i kërkesës pati mundësinë të parashtrojë ankesë kundër atij vendimi brenda afatit prej 3 ditësh.

16. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ai ka paraqitur ankesë ndaj Vendimit të Gjykatës komunale në Prizren të lëshuar më 11 janar 2010.

17. Më 29 janar 2010, Gjykata Komunale në Prizren lëshoi Vendimin Nr.3/2010 dhe refuzoi si të pabazë ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj Vendimit të 11 janarit 2010. Në atë Vendim ishte cekur se *inter alia,* parashtruesi i kërkesës nuk është sjellë në pajtueshmëri me neni 361(1) të KPPK-së dhe se

nuk e ka sqaruar padinë e tij private penale. Më tej u theksua se padia private penale ishte e parashkruar.

18. Sipas kërkesës, duket se parashtruesi i kërkesës e pranoi Vendimin e Gjykatës Komunale në Prizren Nr.3/2010, më 3 shkurt 2010, dhe se ai u ankua më 5 shkurt 2010. Duket se procedura kundër vendimit të Gjykatës Komunale nuk ka përfunduar ende. Për më tepër, në bazë të dokumenteve në dosjen e rastit duket se, më 2 shkurt 2010, Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) e informoi parashtruesin e kërkesës se ka shqyrtuar parashtresën e parashtruesit të kërkesës, të datës 10 korrik 2008 dhe të datës 13 mars 2009, përmes së cilës parashtruesi i kërkesës pretendon parregullsi të ndryshme në procedurat e rastit Nr. 51/200 nga ana e gjyqtarit M.A., dhe kërkoi shkarkimin e tij nga rasti i parashtruesit të kërkesës.

19. Në parashtresën e ZPD-së u theksua se *inter alia,* "ZPD-ja ka siguruar dosje gjyqësore dhe intervistuar dëshmitarë të rëndësishëm, dhe ka gjetur se Gjykata ka proceduar rastin sipas kërkesës së paditësit R.H. kundër M.Z. për vlefshmërinë e pronës... Gjykata Supreme me vendimin e vet Rev Nr. 71/02, të datës 26 qershor 2003, ktheu dy aktgjykimet dhe rasti u rihap për procedim. Rasti mori një numër të ri, C.Nr. 361/03, procedurat e të cilit u ndërprenë më 6 shkurt 2004, me rastin e vdekjes së paditësit. Asnjëra nga palët nuk kërkoi vazhdimin e procedurave të ndërprera më 6 shkurt 2004". ZPD-ja më tej deklaroi se, "Skender Zenuni (përkatësisht parashtruesi i kërkesës) më 14 maj 2008, ka iniciuar procedurat gjyqësore C.Nr.212/08 për pengim të posedimit... procedurat janë në zhvillim." Në bazë të kësaj që u tha më lart, ZPD-ja ka deklaruar se për momentin nuk do të merret me hetime disiplinore. Në rast të deklarimit shtesë, parashtruesi i kërkesës kështillohet të kontaktojë me ZPD-në.

20. Historiku i padisë private penale të parashtruesit të kërkesës dhe parashtresa në ZPD daton qysh nga 1980, kur Gjykata Komunale në Gjilan nxori Aktgjykimin C.Nr. 30/80, lidhur me kontestin mes dy vëllezërve (njëri prej të cilëve është babai i parashtruesit të kërkesës), në lidhje me pronën e paluajtshme që ua kishte lënë babai i tyre i ndjerë. Më 10 qershor 1986, Gjykata Komunale në Gjilan miratoi vendimin për ndarjen e pronës së paluajtshme në fjalë. Në vitin 1988, Gjykata e Qarkut

hodhi poshtë ankesën e një personi tjetër, X.H., i cili pretendoi se prona ishte e tij. Me Vendimin e Gjykatës Komunale në Gjilan C. Nr. 256/90, të datës 16 maj 1991, procedurat e iniciuara nga X.H. kanë pushuar. Megjithatë, më 21 janar 2001, Gjykata Komunale në Gjilan me Vendimin C.Nr. 51/2000, i dha R.H. (djalit të X.H.) pronësinë e vetme mbi pronën. Kjo ishte konfirmuar nga Gjykata e Qarkut në Gjilan me Vendimin Ac.Nr. 9/2002, të datës 20 mars 2002. Sidoqoftë, Gjykata Supreme me Vendimin Rev.Nr. 71/2002, të 26 qershorit 2003, anuloi aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës së Qarkut dhe asaj Komunale. Rasti u kthye në gjykatën e shkallës së parë.

21. Pas vdekjes së M.S., parashtruesi i kërkesës trashëgoi pronën sipas Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan T. 63/2003. Më 14 maj 2008, parashtruesi i kërkesës inicioi procedurat gjyqësore C.Nr. 212/08 për pengim të posedimit kundër R.H. Seanca e parë u mbajt më 19 qershor 2008, kur paditësi kërkoi shkarkimin e gjyqtarit M.A. nga rasti. Gjykata e Apelit me vendimin e vet CN.Nr. 5/08, më 27 qershor 2008, hodhi poshtë kërkesën për shkarkim. Më vonë, kërkesa për rihapjen e procedurës, sipas konfirmimit nga Gjykata e Apelit, po ashtu u hodh poshtë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë, specifikohen me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe nenin 36 të Rregullores së punës.

23. Neni 113.7 i Kushtetutës dhe neni 47(2) i Ligjit, parashohin se individët që ngrenë kërkesë në Gjykatë duhet të dëshmojnë se i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

24. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi mbi kërkesën për shterim është që t'u ofrohet autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet

në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive ligjore për shkeljet e të drejtave kushtetuese (mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendim i datës 28 korrik 1999). Kjo gjykatë aplikoi të njëjtin arsyetim kur lëshoi Aktvendimin për papranueshmëri në rastin e Universitetit AAB-RIINVEST kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti KI 41/09 i janarit 2010.

25. Siç i është prezantuar Gjykatës, duket se parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Vendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, të lëshuar më 29 janar 2010.

26. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, edhepse Gjykata Kushtetuese i kishte kërkuar të sqarojë kërkesën e tij dhe të dorëzojë *inter alia* një kopje të ankesës ndaj vendimit të datës 29 janar 2010, ai kurrë nuk e bëri këtë. Pavarësisht se, siç u cek më lart, duket se procedurat kundër vendimit të Gjykatës Komunale në Prizren ende janë në pritje.

27. Gjykata Kushtetuese rikujton se kjo gjykatë nuk duhet të veprojë si Gjykatë e Apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Gjykatat e rregullta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

28. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).

29. Gjykata rikujton se Gjykata Komunale në Prizren gjeti se padia private penale e parashtruesit të kërkesës është e parregullt dhe e parashkruar. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata Kushtetuese nuk gjeti që në çfarëdo mënyre procedurat relevante të kenë qenë të padrejta ose arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër. Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

30. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me kontestin pronësor, Gjykata duhet që së pari të vërtetojë nëse çështjet e ngritura në kërkesë "bien nën juridiksionin e saj". Lidhur me këtë, Gjykata konsideron se nga autoritetet publike të Republikës së Kosovës mund vetëm të kërkohet përgjigje për faktet dhe aktet të cilat ndodhën pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, më 15 qershor 2008. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të merret me kërkesën lidhur me ngjarjet që ndodhën para se të hyjë në fuqi Kushtetuta (shih, Aktvendimin e Gjykatës për Papranueshmëri në rastin Nr.18/10, Denić *et al,* të datës 17 gusht 2011*).*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, me shumicë votash

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 08/10, KI 16/10, KI 22/10, KI 24/10, KI 27/10, KI 36/10, KI 41/10, KI 42/10, KI 45/10, KI 53/10, KI 54/10, KI 56/10, KI 57/10, KI 58/10, KI 59/10, KI 60/10, KI 61/10, KI 63/10, KI 64/10, KI 65/10, KI 66/10, KI 67/10, KI 68/10 KI 71/10, KI 74/10, KI 76/10 datë 27 janar 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së 26 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

Rastet KI 08/10, KI 16/10, KI 22/10, KI 24/10, KI 27/10, KI 36/10, KI 41/10, KI 42/10, KI 45/10, KI 53/10, KI 54/10, KI 56/10, KI 57/10, KI 58/10, KI 59/10, KI 60/10, KI 61/10, KI 63/10, KI 64/10, KI 65/10, KI 66/10, KI 67/10, KI 68/10, KI 71/10, KI 74/10, KI 76/10 vendimi i datës 10 mars 2011

Fjalët kyçe: shkelje e vazhdueshme, kontesti për kontratë, pension i aftësisë së kufizuar, kërkesë individuale/ grupore, pension invalidor, pritje legjitime, pensionet, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm

Parashtruesit, 26 ish-punëtorë të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), i kishin dorëzuar Kërkesat sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se me 26 aktgjykimet e nxjerra nga Gjykata Supreme ishin shkelur të drejtat e tyre në pronë dhe në gjykim të drejtë, të cilat Gjykata i interpretoj si referenca në nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesit argumentuan se ata padrejtësisht ishin privuar nga interesat e fitimit dhe se nuk ishin në gjendje të korrigjonin shkeljen me mjete juridike, përmes gjykatave të rregullta. Gjykata Supreme i anuloi vendimet e gjykatave më të ulëta dhe e aprovoi anulimin e njëanshëm nga KEK-u të marrëveshjeve për kompensim ("Marrëveshjeve") pas përfundimit të parakohshëm të kontratave të punës të Parashtruesve, të cilat u kishin dhënë atyre të drejtën në kompensim derisa të krijohej dhe të funksionojë Fondi i Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor. Në

njërën anë, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se KEK-u kishte përmbushur obligimet e veta sipas marrëveshjes për kompensim, sepse ishte krijuar Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor (FSPI), duke nxitur kështu ndërprerjen e marrëveshjes. Në anën tjetër, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) i kontestoi gjetjet e Gjykatës Supreme, duke pranuar se pensionet u takojnë personave me aftësi të kufizuara të përhershme dhe individëve mbi moshën 65 vjeçare, por duke shtuar se ende nuk ishte miratuar Ligji për Pensionet përmes të cilit krijohet FSPI.

Sa i përket pranueshmërisë, Gjykata konstatoi se 26 Parashtrues ishin palë të autorizuara në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, se ata e kishin plotësuar kushtin për shterjen mjeteve juridike sipas nenit 113.7 dhe nenit 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese ("Ligji") dhe se në këtë rast nuk zbatohej rregulli për afatin prej katër muajsh, të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit, pasi që shkelja e pretenduar e Kushtetutës kishte karakter vazhdues. Gjykata vendosi se 21 Kërkesat korresponduese ishin të pranueshme dhe se 5 Kërkesat e mbetura ishin vetëm pjesërisht të pranueshme, duke përjashtuar kërkesat për kompensim, pas ditëlindjes së 65-të të Parashtruesve, e duke përfshirë kërkesat për kompensim për periudhën deri në ditëlindjen e tyre të 65-të.

Sa i përket meritave, Gjykata nënvizoi të drejtat në pronë të përfshira në nenin 46 dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ). Gjykata arsyetoi se pritja e Parashtruesve për kompensim të përkohshëm sipas Marrëveshjeve, derisa të fillon të funksionontе FSPI ishte legjitime dhe një e drejtë kjo që mbrohej me nenin 1 të Protokollit Nr. 1, duke cituar rastin *Ibrahimi*, *Prokshi* dhe rastin *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke*. Gjykata konstatoi se ndërprerja e njëanshme e Marrëveshjeve nga KEK-u para zbatimit të FSPI cenonte interesat e tyre të fitimit nga prona dhe ishte shkelje e nenit 46 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Duke theksuar të drejtat për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31.1 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së,

Gjykata tërhoqi vërejtjen se gjykatat e rregullta duhet të zgjidhin kontestet faktike, ato procedurale si dhe ato të së drejtës materiale, duke cituar rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, ndërsa fokusi i saj është në atë se a ka pasur Parashtruesi gjykim të drejtë, duke cituar rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Gjykata theksoi se gjykatat janë të obliguara që të paraqesin arsyet për aktgjykimet e tyre, ndonëse niveli i detajeve të domosdoshme mund të ndryshojë, duke cituar nenin 6.1 të KEDNJ-së, rastin *Ibrahimi* e *Prokshi*. Çka është me rëndësi, Gjykata theksoi se Parashtruesit kishin argumentuar se Ligji për Pensionet me të cilin themelohet FSPI akoma nuk ishte miratuar, pohim ky që ishte konfirmuar edhe nga MPMS. Gjykata konkludoi se Gjykata Supreme nuk kishte bërë përpjekje që të zgjidhur argumentin e Parashtruesve, duke sugjeruar se neni 74.3 i Ligjit për Kontratat dhe Detyrimet në lidhje me nenin 18 të Ligjit të vitit 1983 për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, mund të kenë mbështetur ketë argument. Rrjedhimisht, Gjykata erdhi në përfundim se Gjykata Supreme kishte shkelur nenin 31 dhe nenin 6 të (KEDNJ) kur kishte dështuar që të adresojë argumentet specifike, përkatëse dhe të rëndësishme të paraqitura nga Parashtruesit, duke cituar rastin *Ibrahimi*, *Prokshi* dhe *Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut, i 18 korrikut 2006, në rastin Pronina kundër Ukrainës, kërkesa Nr. 63566/00*.

Për arsyet e cekura më lartë, Gjykata nxori Aktgjykimin për vendimet e saj për pranueshmëri, për shkeljet e nenit 46 në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së dhe nenit 31 në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Aktgjykimi po ashtu i shfuqizoi vendimet e Gjykatës Supreme, i kthej rastet në rishqyrtim në pajtim me vendimet dhe deklaroi se vazhdon të mbetet kompetente në ketë çështje, në pritje të zbatimit të këtij aktgjykimi.

Prishtinë, më 10 shkurt 2010

Nr. ref.: RK /10

AKTGJYKIM

në
Rastin Nr.
KI 08/10, KI 16/10, KI 22/10, KI 24/10, KI 27/10, KI 36/10, KI 41/10, KI 42/10, KI 45/10, KI 53/10, KI 54/10, KI 56/10, KI 57/10, KI 58/10, KI 59/10, KI 60/10, KI 61/10, KI 63/10, KI 64/10, KI 65/10, KI 66/10, KI 67/10, KI 68/10 KI 71/10, KI 74/10, KI 76/10

Parashtrues të kërkesës
Isuf Mërlaku dhe 25 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së 26 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

HYRJE

1. Ky aktgjykim ka të bëjë me kërkesat e paraqitura nga parashtruesit, të shënuar më poshtë, të parashtruara në Gjykatën Kushtetuese nga njëzet e gjashtë (26) ish-punëtorë të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) ndërmjet janarit dhe gushtit 2010.

2. Rastet në fjalë janë të ngjashme me rastin KI Nr. 40/09, "Imer Ibrahimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës" dhe "Gani Prokshi dhe 15 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 16 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës". Gjykata Kushtetuese gjeti në të dy aktgjykimet se ka pasur shkelje të nenit 46 (Mbrojtja e Pronës) në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe që, po ashtu, ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për disa prej parashtruesve. Si rrjedhojë, është marr vendim për t'i shpallur të pavlefshme aktgjykimet e nxjerra nga Gjykata Supreme në disa prej atyre rasteve dhe për t'ia kthyer këto raste Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate (shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të 23 qershorit 2010 dhe 18 tetorit 2010).

Parashtrues të kërkesës së rastit në fjalë janë:

1. KI 08/10 Isuf Mërlaku,
2. KI 16/10 Ragip Berisha,
3. KI 22/10 Bedri Berisha,
4. KI 24/10 Ajvaz Krasniqi,
5. KI 27/10 Rasim Klinaku,
6. KI 36/10 Ali Tahiri,
7. KI 41/10 Smajl Grajqevci,
8. KI 42/10 Sherfi Pllana,

9. KI 45/10 Hasan Shala,
10. KI 53/10 Azem Fetahu,
11. KI 54/10 Zenel Bajgora,
12. KI 56/10 Vjollca Shala,
13. KI 57/10 Agim Visoka,
14. KI 58/10 Amit Krasniqi,
15. KI 59/10 Shaban Igrishta,
16. KI 60/10 Havë Islami,
17. KI 61/10 Ramush Shala,
18. KI 63/10Halil Vrella,
19. KI 64/10 Hamdi Haxha,
20. KI 65/10 Gani Sahiti,
21. KI 66/10 Zoja Sollova,
22. KI 67/10 Isa Hajdari,
23. KI 68/10 Hajrije Sadiku,
24. KI 71/10 Blerim Hatipi,
25. KI 74/10 Time Bekaj, dhe
26. KI 76/10 Ilaz Halili.

3. Në këtë aktgjykim, për referim më të lehtë, parashtruesit mund të referohen kolektivisht si njëzetegjashtë (26) ish-punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK).

Parashtruesit i kontestojnë këto aktgjykime të Gjykatës Supreme të Kosovës, të nxjerra në këto raste:

1. Isuf Mërlaku, Rev.nr. 338/2008, datë 11.02.2009,
2. Ragip Berisha, Rev.nr. 63/2009, datë 11.02.2009,
3. Bedri Berisha, Rev.nr. 145/2008, datë 13.04.2009,
4. Ajvaz Krasniqi, Rev.nr. 549/2008, datë 10.03.2008,
5. Rasim Klinaku, Rev.nr. 470/2008, datë 23.02.2009,
6. Ali Tahiri, Rev.nr. 271/2009, datë 15.07.2009,
7. Smajl Grajqevci, Rev.nr. 41/10, datë 23.02.2009,
8. Sherfi Pllana, Rev.nr. 207/2009, datë 29.06.2009,

9. Hasan Shala, Rev.nr. 45/2010, datë 23.02.2009,
10. Azem Fetahu, Rev.nr. 38/2010, datë 09.06.2010,
11. Zenel Bajgora, Rev.nr. 152/2009, datë 13.04.2010,
12. Vjollca Shala, Rev.nr. 452/2008, datë 23.02.2009,
13. Agim Visoka, Rev.nr. 57/2010, datë 23.06.2009,
14. Amit Krasniqi, Rev.nr. 67/2008, datë 10.02.2009,
15. Shaban Igrishta, Rev.nr. 442/2008, datë 11.02.2009,
16. Havë Islami, Rev.nr. 154/2009, datë 27.04.2009,
17. Ramush Shala, Rev.nr. 223/2008, datë 27.01.2009,
18. Halil Vrella, Rev nr. 252/2008, datë 10.02.2009,
19. Hamdi Haxha, Rev.nr. 66/2009, datë 11.02.2009,
20. Gani Sahiti, Rev. nr 65/2009, datë 16.03.2010,
21. Zoja Sollova, Rev.nr. 103/2009, datë 17.03.2009,
22. Isa Hajdari, Rev.nr. 469/09, datë 10/03/2010,
23. Hajrije Sadiku, Rev.nr 137/2008, datë 27.01.2009,
24. Blerim Hatipi, Rev.nr. 542/2008, datë 23.02.2009,
25. Time Bekaj, Rev.nr. 42/2009, datë 11.02.2009, dhe
26. Ilaz Halili, Rev.nr. 432/2008, datë 10.02.2009

Çështja e lëndës

4. Çështja e lëndës së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve individuale të nxjerra nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës në njëzet e gjashtë (26) rastet individuale të parashtruesve kundër KEK-ut, siç është cekur më lart.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe nenin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e Punës).

Përmbledhje e fakteve siç pretendohen nga palët

6. Faktet e këtyre kërkesave janë të ngjashme me ato në rastin "Imer Ibrahimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të

Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës" dhe "Gani Prokshi dhe 15 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 16 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës", shih aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: rasti "Ibrahimi dhe të tjerët", i 23 qershorit 2010, dhe rasti "Prokshi dhe të tjerët", i 18 tetorit 2010).

7. Gjatë vitit 2001 dhe 2002, secili parashtrues në këtë kërkesë, si parashtruesit në aktgjykimin e lartcekur, të 23 qershorit 2010, nënshkruan marrëveshje për kompensim të përkohshëm të pagesës për shkëputje të kontratës së punës me punëdhënësin e tyre, KEK-un. Këto marrëveshje ishin, në thelb, të njëjta.

8. Neni 1 i kësaj Marrëveshjeje përcakton se, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë (Gazeta Zyrtare e ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nr. *26/83, 26/86* dhe *11/88)* dhe konstatimit të Komisionit Invalidor të KEK-ut, përfituesi (d.m.th. secili parashtrues) ka të drejtë për kompensim të përkohshëm për ndërprerje të marrëdhënies së punës, deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor.

9. Neni 2 i kësaj Marrëveshjeje përcaktoi se shuma mujore që duhet t'i paguhet secilit parashtrues ishte 206 marka gjermane.

10. Neni 3 përcaktoi që "pagesa do të përfundojë në ditën e funksionimit të Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor. Prej asaj dite e tutje, shfrytëzuesi mund t'i realizojë të drejtat e veta në Fondin e Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor (Fondi Pensional Invalidor i Kosovës), dhe KEK-ut do t'i hiqen obligimet ndaj shfrytëzuesit sipas kësaj marrëveshjeje".

11. Më 1 nëntor 2002, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut miratoi një vendim për themelimin e Fondit Pensional, në përputhje me kriteret e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/30 për Pensionet në Kosovë. Neni 3 i këtij vendimi thotë: "Fondi Pensional do të vazhdojë të

ekzistojë për një periudhë të pacaktuar kohore, në pajtim me kriteret dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligjet për pensione, të miratuara nga Bordi i Fondit Pensional dhe KEK-u, në përputhje me këtë vendim, apo derisa kushtet ligjore për ekzistimin dhe funksionimin e Fondit të jenë në përputhje me rregulloret për pension ose rregullat për pension të miratuara nga ABPK-ja".

12. Më 25 korrik 2006, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut e anuloi vendimin në fjalë për themelimin e Fondit Pensional Suplementar dhe ndërpreu financimin dhe punën e Fondit Pensional Suplementar, që nga 31 korriku 2006. Sipas vendimit të 25 korrikut 2006, të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plotë në përputhje me Statutin e Fondit. Për më tepër, obligimi i përgjithshëm ndaj përfituesve ishte 2.395.487 euro, depozitat bankare ishin 3.677.383 euro, dhe suficiti nga përgjegjësia ishte 1.281.896 euro. Vendimi thotë se punëtorët e KEK-ut të cilët Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i pranon si persona me aftësi të kufizuar për punë do t'i gëzojnë të drejtat e parapara nga Ministria. Më 14 nëntor 2006, KEK-u e informoi Autoritetin Qendror Bankar se "vendimi për revokimin e Fondit Pensional të KEK-ut bazohet në vendimin e Bordit Ekzekutiv të KEK-ut dhe në vendimin e Bordit Menaxhues për Pensione ... <u>për shkak të rrezikut financiar që kjo skemë paraqet për KEK-un në të ardhmen</u>".

13. Sipas parashtruesve, KEK-u ndërpreu pagesën e paraparë me marrëveshjet e verës së vitit 2006 pa asnjë njoftim. Parashtruesit pohojnë që një veprim i tillë është në kundërshtim me marrëveshjet e nënshkruara.

14. Parashtruesit, gjithashtu, pohojnë që dihet mirë se Fondi Pensional dhe Invalidor i Kosovës nuk është themeluar ende.

15. Në anën tjetër, KEK-u fillimisht kundërshtoi pohimet e parashtruesve duke thënë se dihej që Fondi Pensional dhe Invalidor funksiononte që nga 1 janari 2004.

16. Sipas KEK-ut, parashtruesit ishin mbuluar automatikisht nga skema kombëtare invalidore në përputhje me Rregulloren e

UNMIK-ut Nr. 2003/40 për shpalljen e Ligjit për Pensionet Invalidore në Kosovë (Ligji Nr. 2003/23).

17. KEK-u më tutje pohoi që më 31 gusht 2006 lëshoi një njoftim sipas të cilit të gjithë përfituesit e Fondit Suplementar të KEK-ut ishin njoftuar se Fondi ishte mbyllur. I njëjti njoftim konfirmonte se të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plotë në përputhje me Statutin e FPS-së, që do të thotë 60 muaj pagesë ose derisa përfituesit ta arrijnë moshën 65-vjeçare, në përputhje me Vendimin e Bordit Menaxhues të Fondit Pensional të 29 gushtit 2006.

18. KEK-u më tutje tha që parashtruesit nuk i kishin kontestuar udhëzimet për pension invalidor dhe nënshkrimin për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në përputhje me konkluzionet e Komisionit Invalidor.

19. Parashtruesit ngritën padi kundër KEK-ut në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me të cilën kërkonin që Gjykata ta urdhëronte KEK-un t'ua paguante pagesat e papaguara dhe të vazhdonte t'ua paguante nga 105 euro (që është e barabartë me 206 marka gjermane) deri në përmbushjen e kushteve për ndërprerjen e pagesës.

20. Gjykata Komunale në Prishtinë i miratoi kërkesëpaditë e parashtruesve dhe urdhëroi kompensim monetar. Gjykata Komunale në Prishtinë gjeti (p.sh. Aktgjykimi C. Nr. 445/2006, i 19 qershorit 2007, në rastin e parashtruesit të parë Isuf Mërlaku) se kushtet e parapara në nenin 3 të Marrëveshjes nuk ishin përmbushur. Neni 3 i Marrëveshjes parashikon kompensimin e pagës deri në realizimin e të drejtës së parashtruesve, "që do të thotë të drejtën për skemë të pensioneve, që nuk është e mundur për paditësin sepse nuk e ka arritur moshën 65-vjeçare".

21. Gjykata Komunale theksoi më tej në aktgjykimin e sipërpërmendur se pagesa e kompensimit nuk duhet të lidhet me dispozitat e Statutit Suplementar Pensional, pasi marrëveshjet

ishin nënshkruar më herët dhe Statuti nuk ka paraparë që marrëveshjet e lidhura në rastet e mëhershme do të pushojnë së qeni të vlefshme. Gjykata, gjithashtu, sqaroi se sipas nenit 262 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, kreditori (d.m.th. një parashtrues) kishte të drejtë të kërkonte përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori (d.m.th. KEK-u) është i detyruar ta përmbushë detyrimin e tillë.

22. KEK-u paraqiti ankesë kundër aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut, duke thënë, ndër të tjera, se aktgjykimi i Gjykatës Komunale nuk ishte i drejtë sepse marrëveshjet ishin nënshkruar me parashtruesit për shkak të invaliditetit të tyre dhe se nuk mund të kërkojnë vazhdimin e marrëdhënies së tyre të punës për shkak të invaliditetit të tyre.

23. KEK-u ritheksoi se Gjykata ishte e detyruar të vendoste duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/40 për shpalljen e Ligjit për Pensionet Invalidore, sipas të cilës parashtruesit kishin të drejtë për pension invalidor.

24. Gjykata e Qarkut në Prishtinë i hodhi poshtë ankesat e KEK-ut dhe i gjeti parashtresat e tyre të pabazuara.

25. KEK-u parashtroi një revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve të pretenduara thelbësore të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale (Revizioni nga KEK-u, i 27 janarit 2009, në rastin e parashtruesit të parë, Isuf Mërlaku). Aty përsëritej që parashtruesit kishin të drejtë për pension sipas Ligjit 2003/40 dhe që, për shkak të arsyeve humanitare, KEK-u kishte vazhduar të paguante kompensimet mujore edhe pas hyrjes në fuqi të Ligjit. KEK-u pohonte që nuk ishte në pyetje mosha e parashtruesit, por invaliditeti i tij.

26. Gjykata Supreme i miratoi revizionet e KEK-ut, i anuloi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Komunale në

Prishtinë, dhe i hodhi poshtë paditë e parashtruesve si të pabazuara.

27. Gjykata Supreme theksoi që mënyra e ndërprerjes së punësimit konsiderohej e ligjshme sipas nenit 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë.

28. Në aktgjykimin e vet në rastin e parashtruesit të parë, Isuf Mërlaku, Rev. Nr. 338/2008, të 11 shkurtit 2009, Gjykata Supreme theksoi: "Duke marrë parasysh faktin e pakontestueshëm që pala e paditur e ka përmbushur obligimin ndaj paditësit, që është pagesa e kompensimit të pagave sipas periudhës së specifikuar, që është deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit për Sigurim Invalidor dhe Pensional në Kosovë, në fuqi prej 1 janarit 2004, Gjykata gjeti që pala e paditur e ka kryer obligimin sipas marrëveshjes. Kështu, pohimet e paditësit që pala e paditur ka për obligim t'ia paguajë atij kompensimin e përkohshëm të pagave pas themelimit të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë konsiderohen nga kjo Gjykatë si të pabazuara për shkak se palët kontraktuese, deri në shfaqjen e kushtit zgjidhës – themelimin e fondit të lartpërmendur, i kanë kryer obligimet e tyre kontraktuese...".

29. Më 15 maj 2009, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës lëshoi këtë njoftim: "Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, në arsyetimin e vet të p.sh. Aktgjykimit Rev. Nr 338/2008, që në Republikën e Kosovës ekziston Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor që është funksional që nga 1 janari 2004, nuk është i saktë dhe është i pabazuar. Në dhënien e kësaj deklarate, ne kemi parasysh faktin që Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/40 shpall Ligjin Nr. 2003/213 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i cili i rregullon rastet e personave me paaftësi të përhershme, të cilët mund ta gëzojnë këtë skemë në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj. Prandaj, më lejoni të theksoj që dispozitat e këtij Ligji nuk parashikojnë themelimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të vendit. Themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin për Sigurim Pensional dhe Invalidor i cili

është në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës". Në të njëjtin njoftim shpjegohej që në kohën e shkrimit të atij njoftimi, pensioni *inter alia* ekzistonte "pensioni invalidor në shumë prej 45 eurove, siç rregullohet me Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar (përfitues të tyre janë të gjithë personat me aftësi të kufizuara të plotë dhe të përhershme)", si dhe "pensionet e kontributdhënësve prej 82 eurove, që rregullohen me vendim të Qeverisë (përfitues të të cilit janë gjithë pensionistët që e kanë arritur moshën e pensionimit prej 65-vjetësh, si dhe të cilët kanë së paku 15 vjet përvojë pune)".

Ankesat

30. Parashtruesit ankohen që të drejtat e tyre janë shkelur për shkak se KEK-u (në mënyrë të njëanshme i ka anuluar marrëveshjet e tyre, përkundër faktit se kushti i përcaktuar me nenin 3, themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor, nuk është përmbushur. Parashtruesit theksojnë më tutje se nuk kanë pasur mundësi ta kundërshtojnë një shkelje të tillë në gjykatat e rregullta. Ndërsa parashtruesit nuk ankohen shprehimisht për shkeljen e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), nga parashtresat e parashtruesve duket se lëndë e ankesave të tyre janë të drejtat e tyre pronësore (siç garantohet me nenin 1, Protokollin 1 të KEDNJ-së), si dhe e drejta e tyre për gjykim të drejtë (siç garantohet me nenin 6 të KEDNJ-se).

Përmbledhje e procedurave para Gjykatës

31. Ndërmjet janarit dhe gushtit 2010, parashtruesit individualisht i kanë dorëzuar kërkesat në Gjykatën Kushtetuese. Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu si Gjyqtar raportues dhe e caktoi Kolegjin shqyrtues të Gjykatës, të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.

32. Më 17 gusht 2010, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën Supreme, në pajtim me nenin 26 të Ligjit, që këta parashtrues i kanë kontestuar aktgjykimet individuale të miratuara nga Gjykata Supreme.

33. Më 18 gusht 2010, Gjykata Kushtetuese e njoftoi KEK-un, si palë e interesuar, në lidhje me parashtrimin e kërkesave të lartcekura.

34. KEK-u u përgjigj me shkrim më 1 tetor 2010, duke thënë se të gjitha rastet e lartpërmendura janë identike me rastin KI 40/09 dhe prandaj i kanë ofruar komentet e tyre në seancën publike për rastin KI 40/09, të mbajtur më 30 prill 2010. Përveç kësaj, KEK-u e kontestoi substancën e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të nxjerrë në rastin "Ibrahimi dhe të tjerët" dhe "Prokshi dhe të tjerët", duke thënë që nuk ka pasur shkelje të Kushtetutës.

35. Gjykata Kushtetuese nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Gjykata Supreme.

36. Më 13 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga Altay Suroy, Enver Hasani dhe Iliriana Islami, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për pranueshmëri të kërkesës.

Pranueshmëria

37. Siç është vendosur në rastin *"Ibrahimi dhe të tjerët"* dhe *"Prokshi dhe të tjerët"*, të përmendur më lart, për të qenë në gjendje për të gjykuar për kërkesat e parashtruesve, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret e përcaktuara me Kushtetutë.

38. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

> "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*".

dhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili thotë:

> "*Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*".

39. Gjykata, gjithashtu, duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë parashtruar kërkesat e tyre brenda afatit prej katër muajve, siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili thotë:

> "*Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...*".

40. Gjykata rikujton që në rastin në fjalë, ngjashëm si në rastin *"Ibrahimi dhe të tjerët"* dhe *"Prokshi dhe të tjerët"*, parashtruesit ende vuajnë nga ndërprerja e njëanshme e marrëveshjeve të tyre të nënshkruara nga KEK-u. Ata kanë ngritur të njëjtin argument ashtu si parashtruesit e mëhershëm, në kuptimin se është vërtetuar që Fondi Pensional dhe Invalidor nuk është themeluar deri më sot. Pra, ekziston një situatë vazhduese. Meqenëse rrethanat në bazë të të cilave parashtruesit kanë paraqitur ankesat e tyre kanë vazhduar, atëherë afati prej katër muajve siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit nuk është i zbatueshëm për këto raste.

41. Gjykata Kushtetuese është e njoftuar që disa prej parashtruesve ishin më të vjetër se 65 vjeç në kohën e parashtrimit të kërkesës së tyre në këtë Gjykate.

42. Këta parashtrues janë: Ajvaz Krasniqi (1945), Rasim Klinaku (1944), Sherif Pllana (1945), Halil Vrella (1945), dhe Ilaz Haliti (1945).

43. Gjykata Kushtetuese rikujton se sipas njoftimit të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale më 15 maj 2009, personave që e kanë arritur moshën e pensionimit prej 65-vjetësh dhe që i kanë së paku 15 vjet përvojë pune u takon pensioni në shumë mujore prej 82 eurove. Thelbi i këtij njoftimi u konfirmua nga përfaqësuesi i Ministrisë në seancën publike që Gjykata Kushtetuese e mbajti më 30 prill 2010 në rastin "Ibrahimi dhe të tjerët".

44. Rrjedhimisht, duket që parashtruesit e lartpërmendur kanë të drejtë për pension që nga momenti kur i kanë mbushur 65 vjet.

45. Megjithatë, ankesa e tyre lidhur me kompensimin e papaguar për periudhën deri në atë moment, në kuptimin e situatës së vazhdueshme, mbetet në shqyrtim.

46. Prandaj, kërkesat e parashtruesve: Ajvaz Krasniqi, Rasim Klinaku, Sherif Pllana, Halil Vrella dhe Ilaz Haliri janë pjesërisht të pranueshme.

47. Sa u përket parashtruesve të tjerë, Gjykata Kushtetuese nuk gjen ndonjë arsye për papranueshmëri të kërkesës.

48. Gjykata më tej konsideron se është e përshtatshme të bëhet bashkimi i kërkesave në përputhje me rregullin 36 të Rregullores së punës.

Meritat e rastit

49. Gjykata rikujton aktgjykimet e veta të 23 qershorit 2010 dhe 18 tetorit, të miratuara në rastet e mëparshme të KEK-ut, në të cilat konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Mbrojtja e Pronës) në lidhje me nenin 1 të

Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe se po ashtu ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të njëjtit parashtrues. Rrjedhimisht, ishte marrë vendim për t'i shpallur të pavlefshme aktgjykimet e nxjerra nga Gjykata Supreme në rastet e parashtruesve dhe për t'ia kthyer ato aktgjykime Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

i. Sa i përket mbrojtjes së pronës

50. Parashtruesit ankohen se të drejtat e tyre janë shkelur për shkak se KEK-u i ka anuluar marrëveshjet e tyre në mënyrë të njëanshme, edhe pse kushti i përcaktuar me nenin 3 (pra themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor) nuk është përmbushur. Në thelb, parashtruesit ankohen se ka pasur shkelje të të drejtave të tyre pronësore.

51. Që në fillim, duhet rikujtuar këto dispozita ligjore:

Neni 53 i Kushtetutës

"*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*".

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës thotë me sa vijon:

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj shpronësimin e pronës nëse ky shpronësim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve shpronësohet.

Neni 1 i Protokollit nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton:

"*Secili person fizik apo juridik ka të drejtë të gëzojë posedimet e tij në mënyrë të qetë. Askush nuk mund të privohet nga posedimet e tij/saj përveç për interes publik si dhe duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara me ligj, si dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*

Megjithatë, dispozitat paravajtëse nuk do të pengojnë në asnjë mënyrë të drejtën e Shtetit që të zbatojë ligje që i konsideron të domosdoshme për kontrollimin e shfrytëzimit të pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, apo për të siguruar pagesën e tatimeve apo kontributeve e dënimeve tjera".

52. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një parashtrues mund të pretendojë shkeljen e nenit 1 të Protokollit Nr. 1, vetëm deri në përmasën që vendimet e kundërshtuara kanë të bëjnë me "posedimet" e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite.

53. Për më tepër, "posedimet" mund të jenë ose "posedime ekzistuese" ose asete, duke përfshirë pohimet, në kuptimin e të

cilave parashtruesi mund të argumentojë që ai apo ajo ka "pritje legjitime" të fitimit dhe gëzimit efektiv të një të drejte pronësore. Në kundërshtim me këtë, shpresa e njohjes së një të drejte pronësore e cila ka qenë e pamundur të ushtrohet në mënyrë efektive nuk mund të konsiderohet "posedim" sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit Nr. 1, ashtu siç nuk mund të konsiderohet posedim as kërkesa me kusht, e cila mbaron si rezultat i mospërmbushjes së kushtit" (shih rastin *"Ibrahimi dhe të tjerët"* dhe "*Prokshi dhe të tjerët"*, shih po ashtu Prince Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë, nr. *42527/98,* paragrafët 82-83, GJEDNJ 2001-VIII; dhe Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës së Çekisë (vendim) [GC] nr. *39794/98,* para. 69, GJEDNJ 2002-VII).

54. Çështja që duhet shqyrtuar në secilin rast është nëse rrethanat e rastit, të marra si tërësi, i japin parashtruesit pronësi ndaj një interesi thelbësor të garantuar me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së (shih rasti *"Ibrahimi dhe të tjerët"* dhe "*Prokshi dhe të tjerët"*).
55. Gjykata Kushtetuese vëren që në kohën e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërmjet parashtruesve dhe KEK-ut, ky lloj i marrëveshjeve është rregulluar me Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore (Ligji për Obligimet), të shpallur në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së 29/1978 dhe të ndryshuar në 39/1985, 45/1989, 57/1989.

    Neni 74(3) i Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore thotë me sa vijon:

    "Pas lidhjes sipas kushtit shfuqizues, kontrata pushon të jetë e vlefshme pasi ai kusht është i vlefshëm".
56. Prandaj, thelbi i çështjes është nëse është përmbushur kushti shfuqizues sipas të cilit marrëveshjet janë nënshkruar. Përgjigja në këtë pyetje do t'i mundësojë Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse rrethanat e kësaj kërkese, të shqyrtuara si tërësi, u japin parashtruesve të drejtën ndaj interesit thelbësor të mbrojtur nga neni 1, Protokolli Nr. 1 i KEDNJ-së.

57. Gjykata Kushtetuese vëren se është e qartë nga dokumentet dhe se është e pakontestueshme që ndërmjet palëve "kushti shfuqizues", sipas të cilit janë nënshkruar marrëveshjet, është

themelimi dhe funksionimi i Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor.

58. Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese vëren që sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor do të duhej të parashikohej me Ligjin për Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor. Ky i fundit ka qenë në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës.

59. Gjykata Kushtetuese konsideron se parashtruesit, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve me KEK-un, kanë pasur pritje legjitime që do të gëzonin dëmshpërblim mujor në shumë prej 105 eurove, deri në themelimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor.

60. Një pritje e tillë legjitime garantohet me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës. Natyra e saj është konkrete, dhe jo vetëm shpresë e thjeshtë, dhe bazohet në një dispozitë ligjore apo akt ligjor, d.m.th. marrëveshjen me KEK-un (rasti *"Ibrahimi dhe të tjerët" dhe "Prokshi dhe të tjerët"),* po ashtu *mutatis mutandis* Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës së Çekisë (vendim), nr. 39794/98, paragrafi 73, ECHR 2002-VII).

61. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konsideron se parashtruesit kanë "pritje legjitime" që kërkesa e tyre do të trajtohet në pajtim me ligjet në fuqi, në veçanti në përputhje me dispozitat e lartpërmendura të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, si dhe të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë, dhe që rrjedhimisht do të njiheshin si të tilla (shih rastin *"Ibrahimi dhe të tjerët"* dhe "*Prokshi dhe të tjerët"*).

62. Megjithatë, anulimi i njëanshëm i marrëveshjeve, para përmbushjes së kushtit shfuqizues, i ka shkelur interesat materiale të parashtrueseve që ishin të njohura sipas ligjit dhe të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (shih rastin *"Ibrahimi dhe të tjerët"* dhe "*Prokshi dhe të tjerët").*

63. Si rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese konstaton se ka shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

ii. Sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë

64. Më tutje, parashtruesit ankohen se nuk kanë qenë në gjendje të zhdëmtohen për shkeljen e të drejtave të tyre pronësore në gjykatat e rregullta.

> ***Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës thotë me sa vijon:***
>
> 1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike*.
>
> ***Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut:***
>
> *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet ... nga [një] gjykatë ... e cila do të vendosë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile ..."*.

65. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë apeli, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme. Në përgjithësi, "Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit" (neni 102 i Kushtetutës). Më saktësisht, roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [GC]. nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

66. Në anën tjetër, "Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën" (neni 112.1 i Kushtetutës). Kështu, Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë paraqitur në mënyrë të duhur, dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesi ka pasur gjykim të drejtë

(shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

67. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së i obligon gjykatat që të japin arsyetime për aktgjykimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për përgjigje të hollësishme për secilin argument. Përmasa në të cilën zbatohet detyra e ofrimit të arsyetimeve mund të dallojë varësisht nga natyra e vendimit. Për më tepër, është e domosdoshme të merret parasysh, ndër të tjera, shumëllojshmëria e parashtresave që një palë mund të dorëzojë në gjykata, si dhe dallimet që ekzistojnë në shtetet kontraktuese lidhur me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, mendimet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimeve. Prandaj, çështja nëse gjykatat kanë dështuar në përmbushjen e obligimit të parashtrimit të arsyeve, që burojnë nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në bazë të rrethanave të rastit (shih rastin "*Ibrahimi dhe të tjerët", "Prokshi dhe të tjerët"*, dhe *Ruiz Torija kundër Spanjës*, aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, Seria A nr. 303-A, paragrafi 29).

68. Në rastin në fjalë, parashtruesit kanë kërkuar nga gjykatat e rregullta të vendosin për mosmarrëveshjen e tyre pronësore me KEK-un. Parashtruesit iu kanë referuar në veçanti dispozitës së nenit 3 të marrëveshjeve, duke theksuar se Ligji për Pensionet, që themelon Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor, nuk është miratuar ende. Ky fakt është vërtetuar nga përfaqësuesi i Ministrisë kompetente të Punës dhe Mirëqenies Sociale.

69. Megjithatë, Gjykata Supreme nuk ka bërë asnjë përpjekje për t'i analizuar kërkesëpaditë e parashtrueseve nga ky këndvështrim përkundër referencës së qartë para çdo instance tjetër gjyqësore. Në vend të kësaj, pikëpamja e Gjykatës Supreme ka qenë se është fakt i pamohueshëm që pala kundërshtare (KEK) i ka përmbushur obligimet e veta ndaj paditësit, që ka qenë pagesa e kompensimit të pagave sipas afatit të përcaktuar deri në themelimin dhe funksionalizimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë, në fuqi nga 1 janari 2004.

70. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të vendosë se cila do të ishte mënyra më e mirë që gjykatat e rregullta t'i trajtojnë

argumentet e parashtrueseve, d.m.th., përmbushjen e kushtit shfuqizues të nenit 3 të marrëveshjeve, përmbushje kjo që përcaktohet po ashtu me nenin 74 (3) të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore i marrë në lidhje me nenin 18 të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të vitit 1983.

71. Megjithatë, sipas mendimit të kësaj Gjykate, Gjykata Supreme duke shpërfillur vlerësimin e kësaj pike në tërësi, edhe pse ishte specifike, përkatëse dhe e rëndësishme, ka dështuar në obligimin e saj sipas nenit 6 të paragrafit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih rastin "*Ibrahimi dhe të tjerët", "Prokshi dhe të tjerët"* dhe Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i 18 korrikut 2006, në rastin *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa Nr. 63566/00).
72. Nga sa u tha më lart, Gjykata Kushtetuese konkludon se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI VENDOS ME SA VIJON:

I. T'I BASHKOJË KËRKESAT

II. T'I SHPALLË SI:

a) Të pranueshme: kërkesat në lidhje me parashtruesit në vijim:

KI 08/10 Isuf Mërlaku,

KI 16/10 Ragip Berisha,

KI 22/10 Bedri Berisha,

KI 36/10 Ali Tahiri,

KI 41/10 Smajl Grajqevci

KI 45/10 Hasan Shala,

KI 53/10 Azem Fetahu,

KI 54/10 Zenel Bajgora,

KI 56/10 Vjollca Shala,

KI 57/10 Agim Visoka,

KI 58/10 Amit Krasniqi,

KI 59/10 Shaban Igrishta,

KI 60/10 Havë Islami,

KI 61/10 Ramush Shala,

KI 64/10 Hamdi Haxha,

KI 65/10 Gani Sahiti,

KI 66/10 Zoja Sollova,

KI 67/10 Isa Hajdari,

KI 68/10 Hajrije Sadiku,

KI 71/10 Blerim Hatipi, dhe

KI 74/10 Time Bekaj.

***b) Pjesërisht të pranueshme: k*ërkesat në lidhje me parashtruesit në vijim:**

KI 24/10 Ajvaz Krasniqi,

KI 27/10 Rasim Klinaku,

KI 42/10 Sherif Pllana,

KI 63/10 Halil Vrella, dhe

KI 76/10 Ilaz Haliti.

III. *TË KONSTATOJË QË:*

a) ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet e parashtruesve: Isuf Mërlaku, Ragip, Berisha, Bedri Berisha, Ajvaz Krasniqi, Rasim Klinaku, Ali Tahiri, Smajl Grajqevci, Sherfi Pllana, Hasan Shala, Azem Fetahu, Zenel Bajgora, Vjollca Shala, Agim Visoka, Amit Krasniqi, Shaban Igrishta, Havë Islami, Ramush Shala, Halil Vrella, Hamdi Haxha, Gani Sahiti, Zoja Sollova, Isa Hajdari, Hajrije Sadiku, Blerim Hatipi, Time Bekaj dhe Ilaz Halili.

b) ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sa u përket parashtruesve të njëjtë, që kanë pësuar shkelje të nenit 46 të Kushtetutës.

IV. ***T'i shpallë të pavlefshme aktgjykimet e Gjykatës Supreme*** në këto raste:

KI 08/10 Isuf Mërlaku, Rev.nr. 338/2008, datë 11.02.2009,

KI 16/10 Ragip Berisha, Rev.nr. 63/2009, datë 11.02.2009,

KI 22/10 Bedri Berisha, Rev.nr. 145/2008, datë 13.04.2009,

KI 24/10 Ajvaz Krasniqi, Rev.nr. 549/2008, datë 10.03.2008,

KI 27/10 Rasim Klinaku, Rev.nr. 470/2008, datë 23.02.2009,

KI 36/10 Ali Tahiri, Rev.nr. 271/2009, datë 15.07.2009,

KI 41/10 Smajl Grajqevci, Rev.nr. 41/10, datë 23.02.2009,

KI 42/10 Sherfi Pllana, Rev.nr. 207/2009, datë 29.06.2009,

KI 45/10 Hasan Shala, Rev.nr. 45/2010, datë 23.02.2009,

KI 53/10 Azem Fetahu, Rev.nr. 38/2010, datë 09.06.2010,

KI 54/10 Zenel Bajgora, Rev.nr. 152/2009, datë 13.04.2010,

KI 56/10 Vjollca Shala, Rev.nr. 452/2008, datë 23.02.2009,

KI 57/10 Agim Visoka, Rev.nr. 57/2010, datë 23.06.2009,

KI 58/10 Amit Krasniqi, Rev.nr. 67/2008, datë 10.02.2009,

KI 59/10 Shaban Igrishta, Rev.nr. 442/2008, datë 11.02.2009,

KI 60/10 Havë Islami, Rev.nr. 154/2009 dated27.04.2009,

KI 61/10 Ramush Shala, Rev.nr. 223/2008 dated27.01.2009,

KI 63/10 Halil Vrella, Rev nr. 252/2008, datë 10.02.2009,

KI 64/10 Hamdi Haxha, Rev.nr. 66/2009, datë 11.02.2009,

KI 65/10 Gani Sahiti, Rev. nr 65/2009, datë 16.03.2010,

KI 66/10 Zoja Sollova, Rev.nr. 103/2009, datë 17.03.2009,

KI 67/10 Isa Hajdari, Rev.nr. 469/09, datë 10/03/2010,

KI 68/10 Hajrije Sadiku, Rev.nr 137/2008, datë 27.01.2009,

KI 71/10 Blerim Hatipi, Rev.nr. 542/2008, datë 23.02.2009,

KI 74/10 Time Bekaj, Rev.nr. 42/2009, datë 11.02.2009, dhe

KI 76/10 Ilaz Halili, Rev.nr. 432/2008, datë 10.02.2009.

V. T'IA KTHEJË këto aktgjykime Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate.

VI. MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me atë Urdhër.

Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë pasi t'u dorëzohet palëve.

Gjyqtari Raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 09/11 datë 06 mars 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Ac. nr. 1326/2008, të datës 27.02.2009 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale CI. nr 1176/07, të datës 12.06.2008

Rasti KI 09/11, vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë CI. nr 1176/07, i datës 12.06.2008; dhe vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i datës 27.02.2009

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, qartazi e pabazuar , Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi i kërkesës vlerësimin e kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Ac. nr. 1326/2008, të datës 27.02.2009 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale CI. nr 1176/07, të datës 12.06.2008.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur edhe pse në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës ai ka theksuar se pretendon se janë shkelur neni 21.22,23 dhe neni 113 i Kushtetutës (të drejtat e njeriut-parimet e përgjithshme, zbatimi i drejtpërdrejt i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, dinjiteti i njeriut dhe juridiksioni, dhe palët e autorizuara për ngritje).

Gjykata konstaton që kërkesa është e papranueshme dhe qartazi e pabazuar.

Prishtinë, më 11 nëntor 2011

Nr. ref.:RK157/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUSHMËRI

në

Rastin Nr. KI 09/11

Parashtruesi

Mustafë Aliu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Ac. nr. 1326/2008, të datës 27.02.2009 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale CI. nr 1176/07, të datës 12.06.2008

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Njëzëri miraton Aktvendimin mbi papranueshmërinë, që ka të bëjë me kërkesën.

> Kryetari i Gjykatës, Prof. Dr. Enver Hasani, në përputhje me nenin 18, par. 1, pika 1.3 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 03/L -121) ka deklaruar konfliktin e interesit pasi që rasti që shqyrtohet nga Gjykata ka të bëjë me institucionin ku kishte punuar paraprakisht, dhe

ka kërkuar përjashtimin e tij përgjatë tërë procedurës së shqyrtimit të këtij rasti. Pasi që kërkesa e tij është aprovuar nga gjyqtarët, Kryetari nuk mori pjesë në asnjë nga fazat e shqyrtimit dhe të procesit të vendimmarrjes për këtë lëndë.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Mustafë Aliu, mësimdhënës në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës.

Vendimet e sfiduara

2. Vendimet e sfiduara në Gjykatën Kushtetuese janë:

Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë CI. nr 1176/07, i datës 12.06.2008; dhe

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1326/2008, i datës 27.02.2009.

Çështja e lëndës

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 24 janar 2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1326/2008, të datës 27.02.2009, me anë të cilit është refuzuar ankesa e Universitetit të Prishtinës, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë Ci. nr. 1176/07, i datës 12.06.2008, me anë të të cilit z. Mustafë Aliu i është aprovuar kërkesëpadia, dhe Universiteti Prishtinës është detyruar që z. Mustafë Aliu t'ia mundësojë kryerjen e detyrave të Dekanit të Fakultetit të

Kulturës Fizike dhe Sportit sipas vendimit Ref. Nr. 1/38, të datës 12.06.2006.

Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara kushtetuese

4. Edhe pse me nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar, z. Mustafë Aliu në kërkesën e tij nuk ka qartësuar se cilat të drejta pretendon se i janë shkelur, edhe pse në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës ai ka theksuar se pretendon se janë shkelur neni 21.22,23 dhe neni 113 i Kushtetutës (të drejtat e njeriut-parimet e përgjithshme, zbatimi i drejtpërdrejt i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, dinjiteti i njeriut dhe jurisdikcioni, dhe palët e autorizuara për ngritje).

Baza juridike

5. Neni 113.7 lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullit 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Përmbledhje e procedurës në Gjykatë

6. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese më 24 janar 2011.

7. Më 26 janar 2011, Gjykata Kushtetuese me shkresën zyrtare Ref: DRLSA- 168/11/sk, kishte njoftuar Gjykatën Komunale në Prishtinë lidhur me kërkesën që e ka në shqyrtim dhe nga kjo gjykatë ka kërkuar zyrtarisht aktvendimet e saja lidhur me kërkesëpadinë e z. Aliu, e që mungojnë në dosjen e lëndës që e ka në shqyrtim Gjykata Kushtetuese.

8. Po të njëjtën ditë, në përgjigjeje të shkresës së Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Komunale ia ka dërguar aktvendimet e kërkuara.

9. Më 1 shkurt 2011, me shkresën Ref. nr.: DRLSA-244 /11/sk, Gjykata ka njoftuar Universitetin e Prishtinës për kërkesën e parashtruar nga z. Aliu dhe ka kërkuar komentet eventuale të UP-së lidhur me këtë kërkesë.

10. Më 14 shkurt 2011, Universiteti i Prishtinës ka dërguar përgjigje me shkrim lidhur me këtë kërkesë, në të cilën ka theksuar se UP nuk mund të bëjë asnjë lloj kompensimi për z. Mustafë Aliu pasi që ai realisht nuk e ka kryer punën e Dekanit të Fakultetit të Kulturës Fizike.

11. Më 12 prill 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Altay Suroy, Kolegji shqyrtues i përbëre nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami, anëtarë, brenda të njëjtës ditë i paraqiti rekomandimet e veta për të refuzuar lëndën si të palejueshme para përbërjes së plotë të Gjykatës.

Ankesa e parashtruesit

12. Parashtruesi i kërkesës ankohet se Universiteti i Prishtinës, pa ndonjë justifikim ligjor, nuk e ka ekzekutuar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Nr. 1326/2008, me të cilin kjo Gjykatë ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Universitetit të Prishtinës dhe kishte vetëtuar Aktgjykimin e

Gjykatës Komunale në Prishtinë Ci. nr. 1176/07, të datës 12.06.2008, e që me atë Aktgjykim ishte aprovuar kërkesëpadia e z. Mustafë Aliu, dhe Universiteti i Prishtinës ishte detyruar që paditësin ta kthejë në vendin e punës - Dekan i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në Prishtinë, post ky nga i cili ishte shkarkuar me vendimin e Rektoratit.

Faktet

13. Më 12 qershor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin Ci .nr. 1176/07 ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e z. Mustafë Aliu, ish-Dekan i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit dhe ka anuluar vendimin e të paditurës-UP-së për shkarkimin e tij nga pozita e Dekanit (Vendimi-ref. nr 1/38 i datës 12.06.2006.) dhe ka obliguar të paditurën që paditësin– z. Mustafë Aliu ta kthejë në vendin e punës- Dekan i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në kuadër të UP-së.

14. Më 27 janar 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin Ac. nr. 1326/2008 kishte refuzuar ankesën e Universitetit të Prishtinës dhe ka vërtetuar Aktgjykimin Gjykatës Komunale Ci. nr 1176/07.

15. Më 30 qershor 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktvendimin E 530/09 kishte aprovuar propozimin për përmbarim të z. Mustafë Aliu dhe kishte caktuar ekzekutimin e propozuar.

16. Më 25 gusht 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktvendimin E. nr 530/09 kishte refuzuar kundërshtimin e debitorit – Universitetit të Prishtinës kundër aktvendimit për lejimin e ekzekutimit të aktgjykimeve të Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut në Prishtinë, të cilat ishin të favorshme për kreditorin z. Mustafë Aliu.

17. Më 2 shtator 2009, z. Mustafë Aliu i kishte dërguar një shkresë Universitetit të Prishtinës duke kërkuar kthimin e tij në vendin e punës – Dekan i FKFS-së duke u thirrur në aktgjykime të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme të gjykatave të rregullta.

18. Më 29 mars 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktvendimin Ac. nr. 1079/ 2009, përfundimisht kishte APROVUAR si të bazuar ankesën e debitorit-Universiteti i Prishtinës dhe kishte shfuqizuar Aktvendimin për përmbarim E 530/09 të Gjykatës Komunale të Prishtinës, duke e deklaruar këtë çështje përmbarimore si të përfunduar.

19. Z. Mustafë Aliu, në kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese, ka pretenduar edhe për shkelje tjera kushtuese dhe ligjore të drejtuara ndaj kolegëve të tij, dhe në emër të këtyre parregullsive të supozuara ka prezantuar kontrata pune të z. Rexhep Murati, z. Azem Hajdari, vendime të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, procesverbale të Senatit të UP-së dhe kopjen e Statutit të UP-së.

Vlerësimi i pranueshmërisë

20. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata paraprakisht i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës ku thuhet:

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

Nenet 47 e 49 të Ligjit për Gjykatë Kushtetuese që përcaktojnë se:

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale, të garantuara me Kushtetutë, janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

Neni 49 (Afatet):

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".

21. Duke shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur në kërkesën e parashtruesit, por edhe atë të siguruar sipas detyrës zyrtare nga Gjykata Komunale e Prishtinës lidhur me procedurën përmbaruese e që është në lidhmëri të drejtpërdrejt me çështjen që e shqyrton, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi në mënyrë të padiskutueshme se vendimin e fundit, z. Mustafë Aliu e ka pranuar më 20.04.2010 (Aktgjykimi Ac. nr 1079/ 2009) dhe ky fakt u konstatua nga kopja e fletëdërgesës për dorëzim personal të nënshkruar personalisht nga vetë z. Aliu, ndërsa kërkesën në Gjykatën Kushtetuese e kishte dorëzuar më 24 .01.2011, pra rreth 8 muaj përtej afatit prej katër muajsh të paraparë me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës për të parashtruar një kërkesë individuale para saj.

22. Në këto kushte, kërkesa duhet të refuzohet si e paafatshme (shih mutatis mutandis. Blecic v. Kroacisë, kërkesa Nr. 59532100, Vendim i GJEDNJ-se i datës 29 korrik 2004). Një arsyetim të tillë Gjykata Kushtetuese e kishte përdorur në Rastin Nr. KI 33/09 - Fillim Musa Guga kundër vendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, SCEL-

08-0001 i datës 17 qershor 2008 dhe SCEL -08-0001 i datës 10 shtator 2008.

23. Gjykata më tej vëren se, edhe sikur kërkesa e parashtruesit të ishte paraqitur brenda afatit kohor prej katër muajve, të paraparë me nenin 49 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ajo prapë se prapë do të duhej të refuzohej si haptazi e pabazuar, sepse parashtruesi i saj nuk ka paraqitur prova të cilat prima facie do të tregonin se atij i janë shkelur të drejta të garantuara me Kushtetutë.

24. Në fakt, edhe pse Gjykata Komunale dhe ajo e Qarkut në Prishtinë, gjatë shqyrtimit të kontestit të punës, kishin aprovuar kërkesëpadinë e tij dhe kishin urdhëruar kthimin e z, Aliu në pozitën e Dekanit në FKFS të UP-së, Gjykata e Qarkut në Prishtinë në procedurën përmbarimore me Aktvendimin Ac. nr. 1079/ 2009, kishte ”refuzuar” ekzekutimin e saj duke e cilësuar si të papërmbarueshëm dhe duke marrë parasysh Ligjin për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 03 /L-008) i cili me nenin 14.1 ka paraparë që - “Kundër aktvendimit të nxjerrë në formë të prerë në procedurën përmbarimore dhe të sigurimit nuk lejohet revizioni as përsëritja e procedurës”, kësaj çështje juridike i ka dhënë fund ligjor.

25. Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "Gjykate e shkallës së katërt", (shih mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

26. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën, shihet se parashtruesi i saj nuk e ka përmbushur obligimin ligjor të saktësimit të kërkesës, sepse ai nuk ka specifikuar qartë se cila e drejtë e garantuar me Kushtetutë i është cenuar nga aktet e

autoriteteve publike. Për me tepër, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se Gjykatës, gjate dëgjimit te rastit, i mungonte paanshmëria ose që procedura ishte e padrejtë. Fakti i thjesht se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih mutatis mutandis Aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005)

27. Për sa i përket shkeljeve të tjera kushtetuese, që parashtruesi i kërkesës i thekson në kërkesë dhe për të cilat pretendon se i janë cenuar, Gjykata rithekson se në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese theksohet se për të pasur të drejtë të paraqitjes së një kërkese individuale në Gjykatën Kushtetuese, pala duhet të dëshmojë se të "drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik", pra, në fakt duhet ta dëshmojë cenimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë ndaj tij dhe jo personave të tjerë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk njeh një "actio popullaris", apo të drejtën e ngritjes së çështjeve kushtetuese nga secili individ, a person juridik, pa pasur paraprakisht interesin direkt në atë çështje.

28. Në këto rrethana, kërkesa është e paafatshme, qartazi e pabazuar, andaj parashtruesi nuk i ka plotësuar kërkesat për pranueshmërinë e kërkesës, dhe

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 36.3 (h) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e datës 12 prill 2011, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHE POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Vendimi do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare,

në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetues**

Altay Suroy Mr. Sc. Kadri Kryeziu

KI 02/11 datë 19 janar 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajit C. nr. 409/06, të 7 shkurtit 2008.

Rasti KI 02/11, Vendimi për papranueshmëri i 23 nëntorit 2011

Fjalë kyçe: mos-shterimi, ratione temporis, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, shkelje të të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi ka parashtruar një Kërkesë në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar Aktvendimin C. nr. 409/06 të Gjykatës Komunale në Ferizaj, të datës 7 shkurt 2008, si dhe duke pretenduar që e drejta e punës së Parashtruesit, e garantuar me Kushtetutë, ishte shkelur.

Sa i përket pranueshmërisë së Kërkesës, Gjykata theksoi që Kërkesa ishte e papranueshme, sepse Parashtruesi ishte ankuar ndaj aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e cila, me Aktvendimin Ac. Nr. 215/08, të datës 27 mars 2009, vërtetoi atë vendim, por Parashtruesi nuk ka demonstruar që ka parashtruar ankesë në shkallën e fundit, në Gjykatën Supreme, ku ai duhej të kishte bërë të njëjtat ankesa kushtetuese ndaj vendimeve të Gjykatës Komunale dhe Gjykatës së Qarkut. Vetëm nëse këto mjete juridike do të ishin të pasuksesshme, atëherë do të mund të kishte një Kërkesë në këtë Gjykatë. Sa i përket aktvendimit të kontestuar C. nr. 409/06 të Gjykatës Komunale në Ferizaj, të 7 shkurtit 2008, Gjykata theksoi që kjo nuk ishte ratione temporis në pajtim me Kushtetutën.

Prishtinë, më 16 dhjetor 2011

Nr. ref.: RK179/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 02/11

Parashtrues

Esat Kurtaliqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajit

C. nr. 409/06, të 7 shkurtit 2008.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtruesi është z. Esat Kurtaliqi, me vendbanim në fshatin Pleshinë, Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston në mënyrë eksplicite Vendimin e Gjykatës Komunale të Ferizajit C. nr. 409/06, të 7 shkurtit 2008, i cili i është dërguar parashtruesit në të njëjtën datë.

3. Për më shumë, parashtruesi në kërkesën e tij po ashtu i referohet vendimit Ac.nr. 215/08 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të 27 marsit 2009, i cili i është dërguar më 28 maj 2009.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesi pretendon se është shkelur e drejta e tij e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 49 [e Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit].

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56(2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 10 janar 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 12 janar 2011, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

8. Më 14 shkurt 2011, Kryetari, me Urdhrin nr. GJR. 02/11 caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Urdhrin nr. KSH. 02/11 caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Almiro Rodriguez.

9. Më 4 maj 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, Ndërmarrjes Shoqërore IMK Fabrika e prodhimit të gypave në Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: IMK) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

10. Më 12 maj 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Gjykatës Komunale të Ferizajit.

11. Më 23 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 27 nëntor 1989, organi i përkohshëm mbikëqyrës i IMK-së, me Vendimin nr. 5616, ka suspenduar përkohësisht parashtruesin nga puna në IMK për shkak të shkeljeve të rënda të kontratës së punës.

13. Më 12 tetor 1990, organi i përkohshëm mbikëqyrës i IMK-së ndërpreu kontratën e punës me parashtruesin me arsyetimin se ai kishte bërë shkelje të rëndë të kontratës së punës.

14. Më 26 nëntor 1990, parashtruesi u ankua në organin e përkohshëm mbikëqyrës të IMK-së lidhur me vendimin e 12 tetorit 1990.

15. Në vitin 1999, parashtruesi dhe të punësuarit tjerë të fabrikës u kthyen në punë.

16. Më 4 janar 2006, parashtruesi paraqiti ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme) duke kërkuar të konfirmohet marrëdhënia e tij e punës me IMK-në, t'i jepej kompensimi i të ardhurave personale dhe t'i ndaheshin aksionet që i ishin caktuar. Në të njëjtën ditë, dhe pas kësaj, më 14 mars 2006, parashtruesi njoftoi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM) lidhur me ankesën.

17. Më 18 maj 2006, Dhoma e Posaçme vendosi që t'ia referojë çështjen Gjykatës Komunale në Ferizaj, si gjykatë kompetente, në pajtim me nenin 17 të Urdhëresës Administrative 2003/13 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të

Kosovës, për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.

18. Më 21 nëntor 2007, AKM i dërgoi letër parashtruesit duke e njoftuar se kontrata e tij e punës me IMK ishte ndërprerë me efekt të menjëhershëm pas privatizimit të IMK-së.

19. Me vendimin C.nr. 186/05, të 7 shkurtit 2008, Gjykata Komunale e Ferizajit ndërpreu procedurën për shkak të likuidimit (apo privatizimit?) të "IMK".

20. Më 27 mars 2009, Gjykata e Qarkut të Prishtinës refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi vendimin e Gjykatës së Qarkut në Ferizaj, të 7 shkurtit 2008. Gjykata e Qarkut u shpreh se në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12), neni 9.3, "çfarëdo padie gjyqësore kundër një ndërmarrje në pronësi shoqërore që i nënshtrohet likuidimit sipas këtij neni do të pezullohet me rastin e paraqitjes së kërkesës nga Agjencia në gjykatën e vendit ku është paraqitur padia".

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi pretendon se Gjykata Komunale dhe e Qarkut kanë shkelur të drejtat e tij duke mos ia miratuar ankesën e tij për konfirmimin e marrëdhënies së tij të punës me IMK-në, duke mos ia kompensuar humbjen e të ardhurave personale dhe duke mos ia ndarë aksionet që i takonin.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Sipas pretendimeve të parashtruesit, e drejta e tij e garantuar me nenin 49 [e Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës është shkelur. Për të qenë kërkesa e pranueshme,

Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

23. Në lidhje me Vendimin e kontestuar C. nr. 409/06 të Gjykatës Komunale të Ferizajit, të 7 shkurtit 2008, që iu dërgua parashtruesit në datën e njëjtë, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (h) që thotë si në vijim:

"Një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:

(h)Kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën".

24. Në mënyrë që të vihet juridiksioni i përkohshëm i Gjykatës, është esenciale që të identifikohet, në çdo rast specifik, koha e saktë e ndërhyrjes së pretenduar. Duke vepruar kështu, Gjykata duhet të marrë parasysh të dy faktet për të cilat ankohet parashtruesi dhe fushën e të drejtës Kushtetuese që pretendohet se është shkelur (shih *mutatis mutandis* , Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe në rastin Blečić kundër Kroacisë, Parashtresa nr. 59532/0, e datës 8 mars 2006 paragrafi 82).

25. Gjykata vëren se parashtruesi ankohet që e drejta e tij për punë, e garantuar me Kushtetutë, është shkelur. Në këtë drejtim parashtruesi shprehimisht konteston vendimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj, të 7 shkurtit 2008, që iu dërgua parashtruesit në të njëjtën datë.

26. Sidoqoftë, Gjykata vëren se parashtruesi u ankua në mënyrë efektive kundër vendimit të Gjykatës Komunale, në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, e cila, me Vendimin Ac. nr. 215/08, të 27 marsit 2009, vërtetoi atë vendim, por parashtruesi nuk ka treguar se ai ka dërguar një ankesë në shkallën e fundit të Gjykatës Supreme, ku ai duhet të ketë ngritur të njëjtat ankesa kushtetuese kundër vendimeve të Gjykatës Komunale dhe Gjykatës së Qarkut. Vetëm nëse ai mjet nuk do të ishte i suksesshëm, ai do të mund të parashtronte një kërkesë në këtë Gjykatë.

27. Gjykata duhet të konkludojë se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i ka në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 (2) të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës. Arsyetimi për kërkesën e shterimit është që t'iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike për shkeljet e të drejtave kushtetuese (shih Aktvendim për papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtina kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 27 janarit 2010 dhe mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803194, vendimi i datës 28 korrik 1999).

28. Për arsyet e sipërpërmendura kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 47 (2) të Ligjit, dhe rregullin 36 (1) (a) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 nëntor 2011, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË poshtë kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KO 117/10 datë 12 janar 2012- Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, lidhur me emrin e Komunës së Hanit të Elezit, në gjuhën serbe e njohur si Gjeneral Jankoviq

Lënda KO 117/10, nga data 1 dhjetor 2011.
Fjalët kyçe; Kryetari i Komunës, barazia para ligjit.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur parashtresë në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës dhe nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr.03/L-121 për Kushtetutën e Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009.
Më 29 nëntor 2011, paraqitësi i kërkesës i ka paraqitur kërkesë Gjykatës Kushtetuese.
Kryetari, më 29 nëntor 2010 e ka emëruar gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin për shqyrtim në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.
Paraqitësi i kërkesës pohon se ka pasur një numër të ankesave nga ana e qytetarëve, të shoqatave të ndryshme, ndërmarrjeve kundër emërtimit të komunës në gjuhën serbe të njohur si Gjeneral Jankoviq.
Paraqitësi i kërkesës definitivisht pohon se qytetarët kanë tërhequr vërejtjen se, nëse vazhdohet tu dërgohen llogaritë për tatim në pronë me emërtimin Gjeneral Jankoviq, ata do ti bojkotojnë dhe do ta ndërpresin pagesën.

Paraqitësi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese të konstatoj se ka pasur shkelje të Kushtetutës lidhur me emërtimit e komunës në gjuhën serbe.

Gjykata vëren se kërkesa është bërë me 26 nëntor 2010 që do të thotë më shumë së dy vjet nga hyrja në fuqi e dispozitës së kontestuar të Ligjit për Kufijtë Administrativë të Komunave, i cili ka hyrë në fuqi, më 16 qershor 2008.
Del se kërkesa nuk i është bërë Gjykatës në afatin e paraparë me nenin 41. të Ligjit.
Rrjedhimisht, kërkesa e paraqitësit duhet të refuzohet si e papranueshme sepse e njëjta është e vjetruar.

Prandaj Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. paragrafin 4. të Kushtetutës, nenin 41. të Ligjit, me shumicë votash ka vendosur ta refuzojë ankesën si të papranueshme.

Prishtinë, më 27 dhjetor 2011

Nr. ref.: RK182/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KO 117/10

Parashtrues

Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma,

lidhur me emrin e Komunës së Hanit të Elezit, në gjuhën serbe e njohur si Gjeneral Jankoviq

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, i përfaqësuar nga Bajrush Laçi, përfaqësues juridik i Komunës.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 3 [Barazia para ligjit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se është shkelur dëshira e lirë e qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit.

Baza juridike

3. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.4 të Kushtetutës, nenin 41 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Ligji i kontestuar

4. Në këtë kërkesë parashtruesi i kërkesës konteston emrin e Komunës së Hanit të Elezit në gjuhën serbe si Gjeneral Jankoviq, i cili është paraparë me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave, në versionin serbisht të atij Ligji (2008/03-L041). Ligji i cekur ishte miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 20 shkurt 2008 dhe hyri në fuqi më 16 qershor 2008.

Procedura në Gjykatë

5. Më 26 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës e paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 29 nëntor 2010, Kryetari e emëroi gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.

7. Më 18 maj 2011, pas shqyrtimit të raportit paraprak të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës së plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesi i kërkesës deklaron se kishte ankesa të numërta nga qytetarët, shoqatat e ndryshme dhe bizneset kundër emrit të Komunës në gjuhën serbe të njohur si Gjeneral Jankoviq.

9. Kështu që, parashtruesi i kërkesës, duke pasur parasysh Rregulloren e UNMIK-ut 2000/43 për Numrat, Emrat dhe Kufijtë e Komunave, në emër të qytetarëve ua ka drejtuar një mori letrash institucioneve qendrore. Parashtruesi i kërkesës pohon se asnjë nga institucionet e adresuara nuk iu përgjigj kërkesave të tij për ndërrimin emrit.

10. Parashtruesi i kërkesës përfundimisht deklaron se qytetarët kanë paralajmëruar se nëse vazhdohet t'u dërgohen faturat e taksave në pronë me emrin Gjeneral Jankoviq, ata do të bojkotojnë dhe do të ndërpresin pagesat e taksave.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

11. Siç është cekur më parë, parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 3 [Barazia para ligjit] të Kushtetutës, sepse emri i Komunës në gjuhën serbe është Gjeneral Jankoviq, e që sipas parashtruesit të kërkesës, është emër i dhunshëm i imponuar nga regjimi komunist.

12. Parashtruesi i kërkesës ankohet se përkundër kërkesave të numërta për amendamentimin e Rregullores së UNMNIK-ut 2000/45 përkitazi me emrin e Komunës në gjuhën serbe, Ligji për Kufijtë Administrativ të Komunave mbajti këtë emër.

13. Kështu që, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata Kushtetuese të gjejë shkeljet e Kushtetutës përkitazi me emrin e Komunës në gjuhën serbe.

Vlerësimi i pranueshmërisë

14. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë,

specifikuar me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.

15. Lidhur me këtë Gjykata rikujton se neni 113.4 i Kushtetutës thotë si vijon:

"Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt."

16. Gjykata më tutje vëren se neni 41 i Ligjit parasheh afatet për procedurat e rastit të definuara me nenin 113. 4 të Kushtetutës si vijon:

Neni 41

Afatet

"Kërkesa duhet të dorëzohet brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të dispozitës ligjore apo aktit të qeverisë që kontestohet nga ana e komunës".

17. Në Republikën e Kosovës, Ligji për Kufijtë Administrativ të Komunave "rregullon organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale, themelon komunat e reja, përcakton territorin e komunës si njësi e vetëqeverisjes lokale, definon kufijtë administrativ komunal, emrat dhe selitë e komunave të reja, vendosen rregullimet kalimtare në mes të komunave ekzistuese dhe komunave të reja të themeluara me këtë ligj, si dhe definohen procedurat për ndryshimin e kufijve administrativ të komunave" (shih nenin 1 të Ligjit 2008/03-L041).

18. Neni 5.5 i Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave në pjesën përkatëse thotë si vijon:

"*Komunat në vijim do të themelohen me zonat kadastrale të renditura në këtë ligj dhe selitë të përcaktuara më poshtë:*

33. Komuna e Hani i Elezit me seli Hani i Elezit;"

19. Në gjuhën serbe fjalia e cituar më lartë është: "Komuna e Gjeneral Jankoviqit me seli në Gjeneral Jankoviq."

20. Gjykata vëren se kërkesa ishte dorëzuar më 26 nëntor 2010, çka është më shumë se dy vite nga hyrja në fuqi e dispozitave të kontestuara të Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave, i cili ka hyrë në fuqi më 16 qershor 2008.

21. Rezulton se kërkesa nuk i ishte paraqitur Gjykatës brenda afatit të paraparë me nenin 41 të Ligjit.

22. Nga kjo rrjedh se kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhej refuzuar si e papranueshme ngase ishte e parashkruar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.4 të Kushtetutës dhe nenin 41 të Ligjit, me shumicë votash:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Prof. Dr. Enver Hasani

KI 101/11 datë 17 janar 2012- Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PPA nr. 4/2009 të datës 27.4.2011

Rastin KI 101/11**,** Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 27.4.2011.

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, Aktvendim për papranueshmëri.

Parashtruesi i kërkesës nuk ka përcaktuar saktësisht se cila e drejtë e garantuar me kushtetutë i është cenuar por ka theksuar se me vendimet e sfiduara asaj i janë cenuar të drejtat "sipas ligjeve në fuqi, Kushtetutës dhe Konventave ndërkombëtare".

Gjykata konsideron se në kërkesë nuk ka asgjë që tregon se Gjykatës, dhe në këtë rast edhe komisioneve të MPMS-së gjatë ekzaminimit të rastit, i mungonte paanshmëria ose që procedura ishte e padrejtë. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë që të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës.

Gjykata konstaton që kërkesa është e papranueshme dhe qartazi e pabazuar.

Prishtinë, më.12 janar 2012

Nr. ref.: RK180/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 101/11

Parashtruesi

Isma Bunjaku

Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PPA nr. 4/2009 të datës 27.4.2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është znj. Isma Bunjaku nga fshati Vinarc komuna e Mitrovicës me vendbanim të përhershëm në fshatin Samadrexhë komuna e Vushtrrisë

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutën e Kosovës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, PPA.nr. 4/2009 të datës 27.4.2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së lëndës së parashtruar më 28 korrik 2011 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PPA. nr. 4/2009 të datës 27.4.2011 për të cilin parashtruesi i kërkesës nuk kishte specifikuar se në cilën datë e ka pranuar.

Shkeljet e pretenduara të drejtave të garantuara Kushtetuese

4. Parashtruesi i kërkesës nuk ka përcaktuar saktësisht se cila e drejtë e garantuar me kushtetutë i është cenuar por ka theksuar se me vendimet e sfiduara asaj i janë cenuar të drejtat "sipas ligjeve në fuqi, Kushtetutës dhe Konventave ndërkombëtare".

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i dt. 16 dhjetor 2009 i hyrë në fuqi më 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejmë referuar si Ligji), dhe Neni 29 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë i referuar si rregullorja).

Ankesa e parashtruesit

6. Parashtruesja e ankesës ka pohuar se Komisionet mjekësore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë MPMS) ia kanë refuzuar në mënyrë joligjore të "drejtën për pension me aftësi të kufizuara" edhe pse ajo i ka

plotësuar kushtet për një pension të tillë, ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës duke refuzuar padinë e saj lidhur me këtë çështje dhe duke refuzuar edhe kërkesën për Përsëritjen e Procedurës, gjithashtu ka bërë të njëjtën shkelje, sepse sipas parashtrueses së ankesës ajo ka paaftësi të përhershme për punë dhe atë e ka provuar edhe me dokumentacion mjekësor.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 28 korrik 2011 Gjykata Kushtuese pranoi kërkesën e znj. Isma Bunjaku dhe e regjistroi atë me nr. KI 101/11.

8. Më 17 gusht 2011 me vendimin GJR 101/11 Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtar raportues, gjyqtaren Dr. Iliriana Islami.

9. Të njëjtën ditë Kryetrari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje: Robert Carolan (kryesues) dhe gjyqtarët Ivan Čukalović e Mr. sc. Kadri Kryeziu në cilësi të anëtarëve të kolegjit.

10. Më 17 tetor 2011 Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar Gjykatën Supreme të Kosovës dhe përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e lëndës por nuk kishte marrë asnjë koment nga asnjëra palë. Gjykata po ashtu me këtë datë ka njoftuar edhe Departamentin e Administratës Pensionale të MPMS lidhur me kërkesën, duke kërkuar dokumentacionin relevant nga ky departament.

11. Më 1 nëntor 2011 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka pranuar nga Departamenti i Administratë Pensionale të MPMS dokumentacionin e kërkuar.

12. Me 30 nëntor 2011 Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 27 dhjetor 204 znj. Isma Bunjaku nga fshati Samadrexhë i kishte parashtruar kërkesë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës me të cilën nga ky Institucion ka kërkuar njohjen e të drejtës për Pension të Personave me Aftësi të Kufizuara.

14. Me 16 gusht 2005 Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës kishte nxjerrë Vendimin me nr. të dosjes 5057358, me të cilin kishte refuzuar kërkesën e znj.Bunjaku me arsyetimin se nga komisioni mjekësor tek ajo është konstatuar **"aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme" nuk ekziston.**

15. Më 30.11.2005 Këshilli i Ankesave për pensionet e personave me Aftësi të Kufizuara i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka refuzuar si të pabazuar ankesën e znj. Isma Bunjaku, dhe me Aktvendimin me nr. të dosjes 5057358 ka konstatuar se vendimi i shkallës së parë ka qenë i bazuar në ligj dhe i drejtë.

16. Më 5.4.2006 Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar sipas padisë së znj. Isma Bunjaku në procedurën e Konfliktit Administrativ ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.223/2006 me anë të cilit ka pranuar padinë dhe ka anuluar Aktvendimin e Këshillit të Ankesave të MPMS me nr të dosjes 5057358 të datës 30.11.2005 për shkak të mungesës së pjesës arsyetuese gjatë marrjes së atij vendimi.

17. Nga shkresat e lëndës të dërguara zyrtarisht nga MPMS-Departamenti i Administratës Pensionale, konstatohet se, Këshilli i Ankesave përherë të dytë kishte vendosur për ankesën e znj. Isma Bunjaku më 31 maj 2006 duke nxjerrë përsëri Aktvendim Refuzues dhe duke e lënë në fuqi vendimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë të datës 16 gusht 2005 ku kërkonte përshpejtimin e procedurës në Gjykatën Komunale. Këtë Aktgjykim znj.Bunjaku e kishte pranuar më 8. 4.2011.

18. Më 26.09 2007 Gjykata Supreme e Kosovës përsëri duke vendosur sipas padisë së re për Konflikt Administrativ ndaj Aktvendimit të Këshillit të Ankesave të MPMS tash të datës 31 maj 2006, ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr.1558/2006 me të cilin për herë të dytë është miratuar Padia e paditëses znj. Isma Bunjaku dhe është anuluar Aktvendimi i Këshillit të Ankesave të MPMS i datës 31 maj 2006 i cili mbante nr. e njëjtë të dosjes 5057358.

19. Më 7 nëntor 2007, Këshilli i ankesave i MPMS duke vepruar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A.nr.1558/2006 të datës 26.9.2007 për herë të tretë ka vendosur lidhur me Ankesën e znj. Isma Bunjaku dhe me këtë rast ka nxjerrë Aktvendimin me nr. të njëjtë të dosjes 5057358, përsëri duke REFUZUAR ankesën e parashtruar nga znj. Bunjaku, por kësaj here duke dhënë edhe arsyetimin e duhur për marrjen këtij Aktvendimi.

20. Znj. Bunjaku edhe ndaj këtij Aktvendimi prapë ka parashtruar padi për Konflikt administrativ e Gjykata Supreme me Aktgjykimin nr. A.956/2008 të datës 17 nëntor 2008 ka refuzuar padinë e paraqitur.

21. Kundër këtij Aktgjykimi z. Bunjaku përmes avokates znj. Fatmire Braha më 3 mars 2009 ka paraqitur në Gjykatën Supreme të Kosovës "Kërkesën për Përsëritjen e Procedurës Administrative".

22. Më 27 prill 2011, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktvendimin PPA. nr. 4/2009 me të cilin HODHI poshtë Kërkesën për Përsëritjen e Procedurës me arsyetimin se pala kërkuese nuk kishte ofruar prova të reja që do të justifikonin përsëritjen e procedurës.

23. Më 28 korrik 2011, përfundimisht e pakënaqur me vendimet e lartcekura z. Isma Bunjaku paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Për të qenë në gjendje për të gjykuar për Kërkesën e Parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen në Kushtetutë.

25. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

*"Individët janë të autorizuar të ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë**, mirëpo **vetëm** pasi të **kenë shteruar te gjitha mjetet juridike** të përcaktuara me ligj."*

24. Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) kërkesa është qartazi e bazuar."

25. Në fakt duke iu referuar shkeljes së supozuar të së drejtës për pension Gjykata, konstaton se Kushtetuta e Kosovës të drejtës së pensionit i referohet vetëm në nenin 105 dhe 109 të saj, edhe atë duke iu referuar procesit të mandatit dhe riemërimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve për të cilët përdoret formulimi kushtetues "**deri në pensionim sipas ligjit"**

26. Në Nenin 51 të Kushtetutës **[Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale]** paragrafi 2 është qartazi e paraparë: "Sigurimi social

themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj."

27. Nga përkufizimi juridik i Nenit 51 të Kushtetutës shihet qartë se sigurimi social për "aftësi të kufizuara, papunësi dhe moshë të shtyrë" rregullohet me LIGJ, në rastin konkret çështja e pensionit me aftësi të kufizuara është e rregulluar me Ligjin NR.2003/23 PËR PENSIONET E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË KOSOVË të aprovuar në Kuvendin e Kosovës më 6 nëntor 2003.

28. Procedurat e aplikimit, dhe të plotësimit të kushteve për gëzimin e kësaj të drejtë janë të parapara me këtë Ligj sikur edhe e drejta e apelimit të vendimeve kur palët nuk janë të kënaqura me vendimet lidhur me kërkesën e tyre.

29. Komisionet Administrative të MPMS-së kishin vepruar pikërisht në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj përfundimtar

A. 956/2008 të datës 17 nëntor 2008 kishte konstatuar se këto vendime ishin Ligjore.

30. Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e verifikimit të fakteve dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe të plotë është juridiksion i plotë i Gjykatave të rregullta dhe në këtë rast edhe i organeve administrative dhe se roli i saj është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt", (shih *mutatis mutandis,* i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

31. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën shihet se parashtruesi i saj nuk ka përmbushur obligimin ligjor të saktësimit të kërkesës sepse ai nuk ka specifikuar qartë se cila e drejtë e garantuar me Kushtetutë i është cenuar nga aktet e autoriteteve publike. Për më tepër, Gjykata konsideron se në kërkesë nuk ka asgjë që tregon se Gjykatës, dhe në këtë rast edhe komisioneve të MPMS-së gjatë ekzaminimit të rastit, i mungonte paanshmëria ose që procedura ishte e padrejtë. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë që të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. *5503/02,* Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005.

32. Në këto rrethana parashtruesi ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij" andaj, kolegjit shqyrtues i propozoj që në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika c dhe d kërkesën ta refuzojë si qartazi të pabazuar, dhe

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese më 30 nëntor, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Dr.Iliriana Islami	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 10/11 datë janar 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.Nr.142/04, të 19 majit 2005 dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, Ap.Kz.Nr.179/2007, të 23 qershorit 2009 dhe Nr PKL-KZZ 131/09, të 5 qershorit 2010

Lënda Kl 10/11 e 29 nëntorit 2011

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm

Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009.

Më 5 dhjetor 2010, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi një letër Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) duke pretenduar shkeljet e të drejtave individuale te njeriut.
Me 14 shkurt 2011, Kryetari emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova për Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Gjyljeta Mushkolaj.

Më 19 maj 2005, Gjykata e Qarkut ne Gjilan me Aktgjykimin e vet te datës 19 maj 2005, dënoi parashtruesin e kërkesës me 16 vjet burgim për vepër penale vrasje e rëndë, sipas neneve 146 dhe 147 pika 5 në lidhje me nenin 25 të Kodit të Përkohshëm Penal te Kosovës (UNMIK/REG/2003/25, në tekstin e mëtejmë: KPPK) si dhe për pjesëmarrjen në kryerjen e veprës penale në grup, të paraparë me nenin 200 paragrafi 1 të KPPK-së.
Parashtruesi i kërkesës u ankua ne Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, duke pohuar shkelje te procedurave esenciale penale.

Me 23 qershor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin e vet Ap.Kz Nr 179/2007, aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit te

kërkesës lidhur me kundërvajtjen për ndihmë në vrasjen e rëndë. Gjykata Supreme konstatoi se ligji i vjetër (neni 30 paragrafi 2 pika 5 LPK) është ligj i aplikueshëm sepse ligji i ri (nenet 146 dhe 147 pika 5 në lidhje me nenin 25 KPPK) nuk ishte më i favorshëm për të pandehurit.
Me 25 nëntor 2009, qe të dy, parashtruesi i kërkesës dhe avokati i tij mbrojtës, paraqiten kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës se Qarkut.
Me 15 qershor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Nr PKL-KZZ 131/09 dhe refuzoi që të dy kërkesat, atë te parashtruesit të kërkesës dhe të avokatit të tij mbrojtës për mbrojtje te ligjshmërisë, si të pabazuara.
Parashtruesi i kërkesës pohon shkeljen e nenit 23 [Dinjiteti i njeriut], nenit 24 [Barazia para ligjit] dhe nenit 31 [E drejta për gjykim të ndershëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (ne tekstin e mëtejmë: Kushtetuta). Parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë *prima facie* dëshmi që do të tregonte shkelje të të drejtave të tij kushtetuese (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ për pranueshmerinë e kërkesës, Nr 53363/99, i 31 majit 2005).
Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kësaj kërkese, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullave 36. (1a) dhe 36. (3c) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 17 janar 2012, njëzëri vendosi ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

Prishtinë, më 17 janar 2012

Nr. ref.: RK 183/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 10/11

Parashtrues

Nexhat Ramadani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.Nr.142/04, të 19 majit 2005 dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, Ap.Kz.Nr.179/2007, të 23 qershorit 2009 dhe

Nr PKL-KZZ 131/09, të 5 qershorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Nexhat Ramadani, nga Gjilani, momentalisht në vuajtje të dënimit me burgim në Dubravë.

Baza juridike

2. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Vendimi i kontestuar

3. Në kërkesën e vet parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.Nr.142/04, të datës 19 maj 2005. Ai po ashtu përmend dhe dorëzon kopjet e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap.Kz.Nr179/2007, të datës 23 qershor 2009 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. PKL-KZZ 131/09, të datës 5 qershor 2010, që iu dorëzua avokatit të tij mbrojtës më 5 gusht 2010.

Procedura në Gjykatë

4. Më 5 dhjetor 2010, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi letër Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) duke pretenduar shkeljet e të drejtave individuale të njeriut.

5. Më 27 janar 2011, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) bashkë me dokumentacionin e nevojshëm.

6. Më 14 shkurt 2011, Kryetari emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova për Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Gjyljeta Mushkolaj.

7. Më 15 shkurt 2011, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me kërkesën.

8. Më 31 gusht 2011, Gjykata e Qarkut në Gjilan i siguroi Gjykatës kopjen e Aktgjykimit të vet P.Nr.142/04, të datës 19 maj 2005, si dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme Ap.Kz.No179/2007, të datës 23 qershor 2009, dhe Aktgjykimin Nr PKL-KZZ 131/09, të datës 5 qershor 2010.

9. Më 29 nëntor 2011, pas shqyrtimit të raportit paraprak të Gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës së plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 19 maj 2005, Gjykata e Qarkut në Gjilan me Aktgjykimin e vet të datës 19 maj 2005, dënoi parashtruesin e kërkesës me 16 vjet burgim për vepër penale vrasje e rëndë, sipas neneve 146 dhe 147 pika 5 në lidhje me nenin 25 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (UNMIK/REG/2003/25, në tekstin e mëtejmë: KPPK) si dhe për pjesëmarrjen në kryerjen e veprës penale në grup, të paraparë me nenin 200 paragrafi 1 të KPPK-së.

11. Sipas këtij aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës u shpall fajtor sepse ndër të tjera, më 17 mars 2004 ai "privoi nga jeta S.P., kur në bashkëpunim me bashkëfajtorët e tjerë duke ndjekur S.P., me rastin e sulmit në pronën e tij nga një turmë e zemëruar, ai kërceu sipër trupit të S.P. duke e qëlluar dy herë me shkop, njëherë në krahë dhe njëherë në kokë, përderisa pjesëtarët e tjerë të turmës sulmuan S.P. me shkopinj dhe gurë."

12. Parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, duke pohuar shkelje të procedurave esenciale penale, veçanërisht (nenit 403 paragrafi 1 pika 12 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (UNMIK/REG/2003/26, në tekstin e mëtejmë: KPPPK), shkelje të Kodit Penal (neni 404 i KPPPK), vlerësim të gabueshëm dhe jo të plotë të situatës faktike (neni 405 KPPPK) dhe dështimit të gjykatës për të përcaktuar dënimin e tij në mënyrë korrekte (neni 406 të KPPPK).

13. Më 23 qershor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin e vet Ap.Kz Nr 179/2007, aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës lidhur me kundërvajtjen për ndihmë në vrasjen e rëndë. Gjykata Supreme konstatoi se ligji i vjetër (neni 30 paragrafi 2 pika 5 LPK) është ligj i aplikueshëm sepse ligji i ri (nenet 146 dhe 147 pika 5 në lidhje me nenin 25 KPPK) nuk ishte më i favorshëm për të pandehurit. Ky rikualifikim i veprës nuk pati efekt në dënimin i cili mbeti 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim. Pjesa tjetër e ankesës është refuzuar.

14. Më 25 nëntor 2009, që të dy, parashtruesi i kërkesës dhe avokati i tij mbrojtës, paraqitën kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut P. Nr 142/04, të datës 19 maj 2005, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap.Kz.Nr.179/2007, të datës 23 qershor 2009. Mbrojtja e parashtruesit të kërkesës paraqiti kërkesë për shkak të, siç pretendohet, shkeljeve të procedurave esenciale të përkohshme penale (neni 403 par. 1 pika 12 e KPPPK) si dhe shkeljeve të Ligjit Penal (neni 404 i KPPPK) me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Po ashtu, mbrojtja e parashtruesit të kërkesës paraqiti edhe kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme për shkeljet e pretenduara të Ligjit Penal të Kosovës. Ishte argumentuar, ndër të tjera se, "Arsyet janë tërësisht të paqarta dhe deri në një masë në kundërshtim me faktet kritike dhe dëshmitë nga dëshmitarët e dëgjuar si dhe dëshmitë e përpunuara në shqyrtimin kryesor dhe përmbajtja e dokumenteve dhe procesverbalit nga këndvështrimi kryesor". Parashtruesi i kërkesës po ashtu paraqiti kërkesë të bazuar në shkeljen e ligjit penal dhe

shkeljeve të Procedurës Penale në dy aktgjykimet e lartpërmendura.

15. Më 15 qershor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Nr PKL-KZZ 131/09 dhe refuzoi që të dy kërkesat, atë të parashtruesit të kërkesës dhe të avokatit të tij mbrojtës për mbrojtje të ligjshmërisë, si të pabazuara. Është theksuar, ndër të tjera se, "Gjykata Supreme plotësisht pajtohet me atë çfarë ka theksuar gjykata e shkallës së dytë, çka është në pajtim me standardet ligjore ndërkombëtare dhe Evropiane".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pohon shkeljen e nenit 23 [Dinjiteti i njeriut], nenit 24 [Barazia para ligjit] dhe nenit 31 [E drejta për gjykim të ndershëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ka pasur shkelje të të drejtës së tij për dinjitet njerëzor siç garantohet me nenin 23 të Kushtetutës, nga momenti kur Prokurori Publik në Qarkun e Gjilanit parashtroi padi kundër tij me dyshimin për vrasjen e S.P., si dhe nëpër të gjitha vendimet e ndryshme gjyqësore sepse ato të gjitha rezultonin me etiketimin e tij si "vrasës, kriminel, shovinist, dhe vrasës mizor".

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kishte shkelje të të drejtës së barazisë para ligjit siç garantohet me nenin 24 të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës pohon se ai ishte vendosur në një pozitë të pabarabartë para ligjit, sepse ai ishte akuzuar vetëm ngase ishte shqiptar, shumëllojshmëria e akuzave ndaj tij ishte e "paparë", Prokurori Ndërkombëtar Publik (në tekstin e mëtejmë: PNP) në asnjë moment nuk ka arritur të bëjë dallimin mes nenit 146 dhe nenit 147, ai u akuzua nga PNP vazhdimisht për kryerje të kundërvajtjeve në pajtim me ligjin e vjetër në aplikim dhe me ligjin e ri, dhe si rezultat, parashtruesi i kërkesës nuk dinte se me çfarë po akuzohej dhe se si do të dënohej,. Ai po ashtu pohoi se Gjykata Supreme duke parë gabimet dhe dobësitë e prokurorit dhe gjykatës së shkallës së parë, vetëm ndërroi kualifikimin e krimit sepse edhe ajo

udhëhiqej nga i njëjti motiv politik si të tjerët, dhe përfundimisht, ai argumentoi se akuzat për vrasje të rëndë u tërhoqën nga të tjerët duke e lënë atë si të vetmin kryerës të akuzuar.

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtës ës tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të mbrojtur me nenin 31, sepse ai është trajtuar ashpër gjatë hetimeve, ai është dashur që detyrimisht të ketë avokat mbrojtës në kohën e hetimeve sepse ai ka vetëm shkollim katërvjeçar, dhe se për shkak të paragjykimeve kundër tij gjatë hetimeve atë e kanë paraqitur si kryesin e vetëm të vrasjes së S.P., dhe se kishte paragjykime se komunitetit ndërkombëtar donte të gjente dikë përgjegjës për trazirat e 17 marsit 2004.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë, specifikuar me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe nenin 36 të Rregullores së punës.

21. Gjykata rikujton se, në kërkesën e tij parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.Nr.142/04, të datës 19 maj 2005. Nga kjo rrjedh se ndërhyrja e pretenduar në të drejtat e parashtruesit të kërkesës qëndron në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, Aktgjykimi i datës 19 maj 2005.

22. Gjykata rikujton se nga autoritetet publike të Republikës së Kosovës mund vetëm të kërkohet përgjigje për faktet dhe aktet të cilat ndodhën pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës.

23. Sidoqoftë, siç është cekur më herët, Gjykata vëren se në kërkesën e vetë parashtruesi i kërkesës po ashtu përmend dhe dorëzon kopjet e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap.Kz.Nr.179/2007, të datës 23 qershor 2009, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr PKL-KZZ 131/09, të datës 5

qershor 2010, i cili i ishte dorëzuar avokatit të tij mbrojtës më 5 gusht 2010.

24. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendime e marra nga ana e gjykatave rregullta. Roli i gjykatave më të ulëta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e duhura të procedurës dhe të drejtës materiale (shih *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

25. Parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë *prima facie dëshmi* që do të tregonte shkelje të të drejtave të tij kushtetuese (shih Vanek kundër Republikës së Slovakisë, Vendimi i GJEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës, Nr 53363/99, i majit 2005).

26. Gjykata vëren që Gjykata Supreme ka trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap.Kz.Nr.179/2007, të datës 23 qershor 2009, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. PKL-KZZ 131/09, të datës 5 qershor 2010. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata Kushtetuese nuk vëren se procedurat përkatës ishin në çfarëdo mënyre të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis* Shub kundër Lituanisë, Vendimi GJEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i datës 30 qershor 2009).

27. Nga kjo rrjedh se, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit të kërkesës duhet refuzuar si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 23/11 datë 21 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Gllogoc, C. Nr. 150/04, të 29 janarit 2009, dhe të Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 90/04, të 14 tetorit 2004.

Rasti KI 23/11, Vendimi për papranueshmëri i datës 23 nëntor 2011
Fjalë kyçe: mbrojtja e pronës, mos-shterimi, shkelja e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi ka parashtruar Kërkesë në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke kontestuar Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gllogoc, C. nr. 150/04, të datës 29 janar 2009, si dhe Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 90/04, të datës 14 tetor 2004, për shkak se e drejta e Parashtruesit për shfrytëzim të banesës, e garantuar sipas nenit 46 [Mbrojtja e pronës] të Kushtetutës, është shkelur, si dhe Gjykata Supreme ishte e anshme.

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së Kërkesës, Gjykata theksoi që Kërkesa është e papranueshme, pasi që Parashtruesi nuk ka ngritur shkeljet e pretenduara të të drejtës së tij të shfrytëzimit të banesës tek Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, e cila sipas aktvendimit të Gjykatës Komunale, është gjykata kompetente për t'u marrë me këtë çështje.

Prishtinë, më 17 janar 2012

Nr. ref.: RK 184/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 23/11

Parashtrues

Pajazit Mulaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Gllogoc, C. Nr. 150/04, të 29 janarit 2009, dhe të Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 90/04, të 14 tetorit 2004.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Pajazit Mulaj, me vendbanim në Gllogoc.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Komunale në Gllogoc, C. Nr. 150/04, të 29 janarit 2009, dhe Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 90/04, të 14 tetorit 2004.

Objekti i çështjes

3. Kërkesa ka të bëjë me shkeljen e supozuar të parashtruesit të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (Nr.

03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 21 shkurt 2011.

6. Më 2 mars 2011, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 23/11, e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 23/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Iliriana Islami.

7. Më 9 mars 2011, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Gjykatën Komunale në Gllogoc dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për këtë kërkesë.

8. Më 23 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 6 maj 1985, Kompania Ndërtimore “Ndërtimtari”, me Vendimin nr. 628, ia kishte ndarë parashtruesit një banesë shoqërore. Banesa i ishte ndarë gjersa ishte në ndërtim e sipër, si rrjedhojë e të cilës parashtruesi nuk kishte mundësi të banonte në të. Pas përfundimit të ndërtimit, banesën e kishte uzurpuar z. I. D.

10. Më 12 qershor 2002, Gjykata Komunale në Gllogoc e miratoi ankesën e parashtruesit për ta poseduar banesën dhe e obligoi z. I. D. ta lironte banesën e parashtruesit (Aktgjykimi C. Nr. 22/201). Z. I. D. ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

11. Më 17 dhjetor 2003, Gjykata e Qarkut e refuzoi ankesën e z. I. D. dhe e miratoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale (Aktgjykimi AC. Nr. 502/2002). Z. I. D. ushtroi revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij aktgjykimi, me të cilin kërkonte që Gjykata Supreme t'i anulonte vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta.

12. Më 14 tetor 2004, Gjykata Supreme e Kosovës i anuloi vendimet e Gjykatës së Qarkut (AC. Nr. 502/2002, të 17 dhjetorit 2003) dhe të Gjykatës Komunale (C. Nr. 22/2001, të 12 qershorit 2002), dhe ia ktheu rastin për gjykim gjykatës së shkallës së parë (Rev. Nr. 90/2004). Gjykata Supreme konkludoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk i kishin konfirmuar, në përputhje me nenin 11 të Ligjit për marrëdhëniet banesore, kushtet sipas të cilave ishte fituar e drejta për posedim të banesës. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konkludoi që gjykatat e shkallëve më të ulëta duhej të konfirmonin nëse banesa shoqërore ishte bartur në pronësi private apo ende ishte në pronësi të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

13. Më 24 nëntor 2004, Gjykata Komunale në Gllogoc e refuzoi ankesën e z. I. D. për konfirmimin e të drejtës së tij për shfrytëzim të banesës. Gjykata Komunale konkludoi se kjo çështje ishte gjykuar me vendimet e Gjykatës Komunale (Aktgjykimi C. Nr. 22/2001, i 12 qershorit 2002) dhe të Gjykatës së Qarkut (Aktgjykimi AC. Nr. 502/2002, i 17 dhjetorit 2003).

14. Më 29 janar 2009, pasi Gjykata Supreme ia kishte kthyer rastin, Gjykata Komunale në Gllogoc e shpalli veten jokompetente sepse kjo çështje ishte në kompetencë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për shkak se banesa e kontestuar ishte në pronësi të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Procedura e përmbarimit

15. Më 15 shtator 2004, Gjykata Komunale lejoi përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Qarkut (E. Nr. 24/04). Z. I. D. parashtroi ankesë kundër këtij vendimi pranë Gjykatës Komunale.

16. Më 11 nëntor 2004, Gjykata Komunale e refuzoi si të pabazë ankesën e z. I. D.

17. Më 8 dhjetor 2004, Gjykata Komunale në Gllogoc e pezulloi procedurën përmbarimore pasi e drejta e përmbarimit ishte anuluar me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 90/04, të 14 tetorit 2004, me ç'rast të gjitha veprimet lidhur me këtë çështje gjyqësore ishin abroguar.

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi pohon që i është shkelur e drejta e tij për ta shfrytëzuar banesën, siç garantohet me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

19. Parashtruesi gjithashtu pohon që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i 14 tetorit 2004 ishte i pjesshëm. Përveç kësaj, parashtruesi pohon që edhe vendimi i Gjykatës Komunale në Gllogoc për ta shpallur veten jokompetente është i dyshimtë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Sa u përket pretendimeve të parashtruesit se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ai i ka

përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës të Gjykatës Kushtetuese.

21. Sa i përket Vendimit të kontestuar, C. Nr. 150/04, të Gjykatës Komunale në Gllogoc, të 29 janarit 2009, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47 (2) të Ligjit, sipas të cilëve individët që parashtrojnë kërkesë në Gjykatë duhet të tregojnë se i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.

22. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është t'ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803194, vendimi i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të ceken në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Nëse çështja ishte ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, *mutatis mutandis,* GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, vendimi i 28 prillit 2004).

23. Kjo Gjykatë e zbatoi të njëjtin arsyetim kur nxori Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti KI 41/09, i 27 janarit 2010, dhe Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rasti Nr. 73/09, i 23 marsit 2010.

24. Sa i përket këtij rasti, nga parashtresat e parashtruesit shihet qartë se, deri më tani, ai nuk e ka ngritur shkeljen e supozuar të së drejtës së tij për ta poseduar banesën pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, e cila, sipas vendimit të Gjykatës Komunale të 29 janarit 2009, është gjykata kompetente për t'u marrë me këtë çështje. Parashtruesi është dashur të ketë pasur dijeni për këtë informatë kur, me vendimin e 14 tetorit 2004,

Gjykata Supreme i anuloi vendimet e gjykatave më të ulëta dhe të gjitha veprimet e ndërmarra nga gjykatat më të ulëta lidhur me këtë çështje.

25. Prandaj, rezulton që parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 (2) të Ligjit.

26. Për shkak të arsyeve të sipërpërmendura, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të rregullit 36 (3) (h) të Rregullores së punës, nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47 (2) të Ligjit dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese më 23 nëntor 2011, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Dr.Gjyljeta Mushkolaj	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 94/11 datë 24 janar 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Komisionit të Kërkesave Banesore dhe Pronësore HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004

Rasti KI 94/11, vendimi i datës 21 nëntor 2011.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta në pronë, ratione temporis, jashtë afatshme, mbrojtja e pronës.

Parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke kontestuar vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore (në tekstin e mëtejmë: KKP) HPCC/D/144/2004/C të 27 gushtit 2004, me të cilën është refuzuar kërkesa e parashtruesit që ti lejohet posedimi i pronës që gjendet në "Bregu i Diellit II".

Parashtruesi i kërkesës konteston vendimin e HPCC /D/144/2004/C të 27 gushtit 2004. Gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesa ka të bëjë me ndodhitë para 15 qershorit 2008, përkatësisht para datës kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në bazë të kësaj, kërkesa është parashtruar jashtë afatit dhe me këtë nuk është në pajtim *ratione temporis* me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit. Për këtë arsye, Gjykata ka vendosur që kërkesa është e papranueshme sipas rregullit 36 (3h) të Rregullores së Punës.

Prishtinë, më 18 janar 2012

Nr. ref.: RK185/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 94/11

Parashtruesi

Lumnije Krasniqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Komisionit të Kërkesave Banesore dhe Pronësore HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Lumnije Krasniqi, rr. Hasan Remniku, Komuna e Prishtinës.

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet Vendimi i Komisionit të Kërkesave Banesore dhe Pronësore (në tekstin e mëtejmë: KKBP) HPCC/D/144/2004/C, i datës 27 gusht 2004, me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës që t'i lejohet posedimi i patundshmërisë e cila gjendet në „Bregu i Diellit II".

Çështja e lëndës

3. Parashtruesja e kërkesës konteston Vendimin HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, pa cekur nen konkret të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, por pretendon si në vazhdim: „Se *ka vërtetim nga Komuna dhe bashkësia lokale se është banor i banesës në fjalë që nga viti 1999 deri në 30 mars 2007, se në cilindo vend tjetër dikush që është shtetas i atij vendi ka përparësi që pas 3 vitesh, apo më shumë, t'i jepet banesa me tapi, në përputhje me ligjin çka është më lehtë dhe ekonomikisht më e drejtë për popullin e tij..."*

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën

Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 paragrafi 2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 20 janar 2011, parashtruesja e kërkesës nëpërmjet postës ka paraqitur një pjesë të dokumentacionit si kërkesë për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë : Gjykata).

6. Më 21 janar 2011, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar parashtruesen e kërkesës përmes një njoftimi se çfarë duhet të përmbajë një kërkesë, në mënyrë që të konsiderohet si kërkesë para Gjykatës Kushtetuese, dhe ka regjistruar lëndën si të përkohshme.

7. Më 11 korrik 2011, parashtruesja e kërkesës ka plotësuar kërkesën e vet me dokumentacionin e nevojshëm dhe kërkesa është regjistruar në e evidencën e Gjykatës KI.

8. Më 21 korrik 2011, parashtruesja e kërkesës në adresimin e saj të tretë Gjykatës, ka kërkuar që në procedurat në Gjykatë t'i mbrohet identiteti me arsyetimin;

„Se familja e saj ka armiq të trefishtë."

„Se familjen e sajna gjenerata në gjeneratë e përcjellin agjentët serb, sepse janë patriotë dhe luftëtarë."

„Se dëshiron që të drejtat e saj të realizohen në emër të Kosovës."

9. Më 26 korrik 2011, Gjykata Kushtetuese e ka njoftuar parashtruesen e kërkesës dhe Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejmë: AKP), e cila është pasardhëse ligjore e KKBP, së kanë filluar procedurat e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimeve për lëndën Nr. KI-94-11.

10. Më 5 gusht 2011, AKP në përgjigjen e vet e ka njoftuar detalisht Gjykatën për procedurën lidhur me Vendimin HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, dhe njëkohësisht dorëzoi edhe kopjen e vendimit dhe përgjigjeve për palën e cila kërkon rishqyrtim.

11. Më 21 nëntor 2011, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Prof. dr Ivan Čukalović dhe Prof. Dr. Gjyljeta Mushkolaj, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë të refuzojë kërkesën si të papranueshme. Njëkohësisht, Gjykata vlerësoi se kërkesa për mbrojtjen e identitetit është e pabazuar.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesja e kërkesës gjatë kohës së luftës ka ikur nga vendi, me përfundimin e luftës është kthyer në Kosovë dhe pasi që nuk kishte kurrfarë strehimi KFOR-i i vendosi në një objekt në lagjen Bregu i Diellit II, *„pasiqë ishin gjendur nën qiellin e hapur“*.

13. Më 29 gusht 2001, KKBP ka pranuar kërkesën me nr. DS001936 të parashtruar nga M.K. i autorizuar nga Z.P., përmes të cilës kërkonte kthimin në posedim të banesës në lagjen Bregu i Diellit II. Si palë kundërshtare në këtë rast ishte F.K., bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës (në tekstin e mëtejmë: F.K.).

14. KKBP pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar edhe të njërës edhe të palës tjetër në kërkesën nr. DS001936, me

Vendimin HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, vendosi që t'i kthejë Z.P. të drejtën e posedimit të banesës në fjalë.

15. Vendimi HPCC/D/144/2004/C, i datës 27 gusht 2004, i është dorëzuar banorit të atëhershëm të patundshmërisë në fjalë, zotëriut F.K., më 13 tetor 2005.

16. Më 19 dhjetor 2005, KKBP ka pranuar kërkesën për rishqyrtimin e Vendimit KKBP/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, paraqitur nga F.K.

17. Kërkesa për rishqyrtim është refuzuar nga KKBP, ngase nuk është paraqitur në afatin kohor prej 30 ditësh të paraparë me ligj, siç edhe parashihet në nenin 14.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

18. Njëkohësisht, pala e cila ka kërkuar rishqyrtimin, F.K., nuk ka sjellë as edhe një dëshmi të re që nuk ishte shqyrtuar më parë, gjegjësisht asnjë dëshmi që do të dëshmonte çfarëdo të drejte të F.K. ndaj banesës në fjalë.

19. Njoftimi zyrtar për refuzimin e kërkesës për rishqyrtimin e Vendimit HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, i është dorëzuar F.K.

20. Pas fuqizimit të Vendimit HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, dhe kërkesës së P.Z. si palë e suksesshme në këtë kontest që t'i kthehet banesa në fjalë, AKP më 14 shkurt 2006 ka zhvendosur nga banesa familjen e parashtruesit të kërkesës dhe më 15 shkurt 2006 i ka dorëzuar në posedim palës së suksesshme në kontest, z. Z.P., me çka edhe u përfundua rasti në AKP.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesja e kërkesës konteston Vendimin HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, pa cekur nenin konkret të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, por nga Gjykata Kushtetuese kërkon:

„Që shteti t'i ndaj asaj banesën e përmendur në kërkesën e saj me tapi dhe me çmim të arsyeshëm dhe pagesë afatgjate sipas Ligjit i cili mbështet ekonominë që kemi. Çmimi të jetë i caktuar sipas vjetërsisë së banesës dhe ekonomisë që i takon këtij popull të përvuajtur prej padrejtësive që ka, dhe i cili ka vuajtur para dhe gjatë luftës, si edhe në ditët e sotme kur armiku ka përparësi në Kosovën e lirë...".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.

23. Lidhur me këtë kërkesë, Gjykata Kushtetuese konstaton se parashtruesja e kërkesës ankohet në Vendimin HPCC/D/144/2004/C, të datës 27 gusht 2004, i cili i është dorëzuar më 13 gusht 2005. Kjo do të thotë se kërkesa ka të bëjë me ngjarjet para 15 qershorit 2008, gjegjësisht datës kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në bazë të kësaj, kërkesa është paraqitur jashtë afatit, andaj nuk është *"ratione temporis"* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit (shih *mutatis mutandis Jasiūnienė kundër Lituanisë, kërkesa nr.. 41510/98, aktgjykimi i GJEDNJ i datës 6 mars dhe 6 qershor 2003).*

24. Nga kjo rrjedhë se kërkesa duhet të hidhet poshtë në bazë të rregullit 36 (3h) të Rregullores së punës i cili parasheh: „Kërkesa mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në

rastet vijuese kur: h) kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.“

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhje me nenin 113.7 paragrafi 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (3h) të Rregullore së punës të 25 nëntorit 2011, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Dr.Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 62/11 datë 10 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pn. nr. 181/2011, të datës 31 mars 2011

Rasti KI 62/11, Vendimi për papranueshmëri i datës 25 nëntor 2011
Fjalë kyçe: dinjiteti njerëzor, kërkesa individuale, masa e përkohshme, qartazi e pabazuar, e drejta për liri dhe siguri, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi, Z. Çlirim Grezda, ka parashtruar Kërkesë në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke kontestuar Aktvendimin e Gjykatës Supreme Pn. nr. 181/2011, të datës 31 mars 2011, si të marrë me shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e përgjithshme], nenin 23 [Dinjiteti njerëzor], 29 [E drejta për liri dhe siguri] si dhe nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për proces të rregullt] të KEDNJ-së, sepse "nuk ka pasur dyshim të bazuar për kryerjen e veprës penale, si dhe rrjedhimisht, nuk ka pasur arsye ligjore që Gjykata e Qarkut të vendosë masën e paraburgimit; vendimi për fillimin e hetimeve nuk i është dorëzuar menjëherë dhe pa vonesë Parashtruesit, ashtu që nuk është informuar për akuzat e sakta ndaj tij; si dhe nderi, prestigji, autoriteti dhe dinjiteti i tij janë cenuar nga deklarata e shtypit e nxjerrë nga Policia e Kosovës dhe publikimi i asaj informate në faqen e internetit të Policisë së Kosovës."

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së Kërkesës, Gjykata theksoi që Kërkesa është e papranueshme, sepse Parashtruesi nuk kishte arritur të dorëzojë prova që procedurat përkatëse kishin qenë në çfarëdo mënyre të padrejta apo të njollosura me arbitraritet. Kështu, Gjykata vërejti që Kërkesa ishte qartazi e pabazuar, në bazë të Rregullit 36 (1.c) të Rregullores së Punës. Për më tepër, sa i përket kërkesës për masë të përkohshme, theksoi Gjykata, duke marrë parasysh që Kërkesa u hudh poshtë si e papranueshme, Parashtruesi

nuk ka të drejtë të kërkojë masa të përkohshme, sipas Rregullit 54 (1) të Rregullores së Punës.

Prishtinë, më 19 janar 2012

Nr. ref.: RK187/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 62/11

Parashtruesi

Çlirim Grezda

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pn. nr. 181/2011, të datës 31 mars 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Çlirim Grezda, me vendbanim në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, Pn. nr. 181/2011, të 31 marsit 2011, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 4 prill 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i Gjykatës Supreme është në kundërshtim me nenet 21 [Parimet e përgjithshme], 23 [Dinjiteti i njeriut], 29 [E drejta e lirisë dhe sigurisë] dhe 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Më tej, ai pretendon se është shkelur neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së *"sepse për shkak të pamundësisë për të punuar kam mbetur pa të ardhura personale."*

5. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme duke urdhëruar policinë që ta tërheqë nga ueb faqja e saj njoftimin për medie në lidhje me të.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 dhe 27 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 15 janar 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: "Ligji") dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 5 maj 2011, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

8. Më 4 korrik 2011, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 62/11, e emëroi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Urdhrin Nr. KSH. 62/11, Kryetari e emëroi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Ivan Čukalović.

9. Më 9 gusht 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Gjykatës Supreme dhe Prokurorit Publik të Qarkut në Pejë.

10. Më 25 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 16 shkurt 2011, Prokurori Publik i Qarkut në Pejë mori vendim për inicimin e procedurës hetimore ndaj parashtruesit të kërkesës dhe bashkëkryerësve të tij, me dyshimin se kishin kryer vjedhje të rëndë grabitqare nga neni 256.1 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK) (Vendimi PP-nr. 60/11 dhe PPM – nr. 12/11).

12. Më 16 shkurt 2011, Prokurori Publik paraqiti kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës, pasi që ekzistonte dyshimi bazuar se ai kishte kryer veprën penale nga neni 256 (1) në lidhje me nenin 23 të KPK-së.

13. Më 16 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë ia caktoi parashtruesit të kërkesës masën e paraburgimit prej një muaj, në bazë të nenit 281 (1) të KPK-së (Vendimi PPQ. Nr. 29/11 dhe PPMQ. Nr. 10/11). Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij vendimi pranë Trupit Gjykues të Gjykatës së Qarkut në Pejë.

14. Më 9 mars 2011, parashtruesi i kërkesës kërkoi që menjëherë të lirohej nga paraburgimi.

15. Më 11 mars 2011, Prokurori Publik i paraqiti kërkesë Trupit Gjykues të Gjykatës së Qarkut në Pejë që t'ia vazhdonte paraburgimin parashtruesit të kërkesës, pasi që hetimet paraprake nuk ishin përmbyllur dhe se ende kishte arsye ligjore për mbajtjen e parashtruesit të kërkesës në paraburgim.

16. Më 14 mars 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë e hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të datës 9 mars 2011 dhe e miratoi kërkesën e Prokurorit Publik duke ia vazhduar paraburgimin edhe për dy muaj në bazë të nenit 281 (1) të KPK (Vendimi KP. nr. 36/11). Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.

17. Më 31 mars 2011, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se "*në rastin konkret ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit, po ashtu gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete përkitazi me bazat ligjore për të cilat iu është vazhduar paraburgimi*" (Vendimi Pn. Nr. 181/2011).

18. Më 13 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë, me kërkesë të Prokurorit Publik ia ndërpreu parashtruesit të kërkesës masën e paraburgimit dhe urdhëroi lirimin e tij të menjëhershëm, pasi që hetimet paraprake ishin ndërprerë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se:

a. Nuk ekzistonte dyshimi i bazuar se ishte kryer vepra penale dhe rrjedhimisht nuk kishte arsye ligjore që Gjykata e Qarkut t'ia caktonte atij masën e paraburgimit;

b. Vendimi për inicimin e hetimeve nuk i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës menjëherë dhe pa vonesë, pra ai nuk ishte njoftuar për akuzat konkrete ndaj tij; dhe

c. I është cenuar nderi, prestigji, autoriteti dhe dinjiteti me njoftimin për shtyp të lëshuar nga Policia e Kosovës dhe me shpalljen a atij informacioni në ueb faqen e Policisë së Kosovës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenet 21 [Parimet e përgjithshme], 23 [Dinjiteti i njeriut], 29 [E drejta e lirisë dhe sigurisë] dhe 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së pasi që Gjykata Supreme, me vendimin e saj të datës 31 mars 2011, e refuzoi ankesën e tij me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë kishte dhënë arsye të qarta në lidhje me bazën ligjore për vazhdimin e paraburgimit të parashtruesit të kërkesës.

21. Gjykata vëren se, për të gjykuar për ankesën e parashtruesit, së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk mund të ankohet se gjykatat e rregullta kanë bërë gabime të fakteve apo të ligjit përderisa nuk i kanë cenuar të drejtat dhe liritë e tij të mbrojtura me Kushtetutë.

23. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është gjykatë e shkallës së katërt kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës

procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

24. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat, dhe në përgjithësi procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre, janë paraqitur, respektivisht mbajtur në mënyrë të tillë ashtu që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih *mutatis mutandis*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa Nr. 13071/87, e datës 10 korrik 1991).

25. Sa i përket këtij rasti, Gjykata vëren se Vendimi i Gjykatës Supreme, Pn. nr. 181/2011, i datës 31 mars 2011, konkludonte se *"në rastin konkret ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit, po ashtu gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete përkitazi me bazat ligjore për të cilat iu është vazhduar paraburgimi"*.

26. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka provuar se në çfarë mënyre vendimi i Gjykatës Supreme kanë qenë i padrejtë apo i njollosur nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr_ 17064/06, të 30 qershorit 2009 dhe Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005), dhe se kishte paraqitur cenim të të drejtave kushtetuese në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës.

27. Në këto rrethana, kërkesa është qartazi e pabazuar në bazë të rregullit 36 (1.c) të Rregullores së punës, i cili parashikon që: *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar"*.

28. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

Vlerësimi i kërkesës për masa të përkohshme

29. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për masa të përkohshme, Gjykata i referohet nenit 27 të Ligjit dhe, më konkretisht, rregullit 54 (1) të Rregullores së punës i cili parashikon që në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme. Sidoqoftë, duke marrë parasysh që kërkesa u gjet si e papranueshme, parashtruesi i kërkesës në bazë të rregullit 54 (1) të Rregullores së punës nuk ka të drejtë të kërkojë masa të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullat 36 (1.c), 54 (1) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 25 nëntor 2011, njëzëri

VENDOSI

I. TA REFUZOJË kërkesën për masa të përkohshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Dr.Kadri Kryeziu	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 126/10 datë 21 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit Nr. 140, të 25 janarit 2010

Rasti KI 126/10, Vendimi për papranueshmëri i datës 29 nëntor 2011
Fjalë kyçe: barazia para ligjit, mos-shterimi, qartazi e pabazuar, shkelje të të drejtave e lirive individuale

Parashtruesi ka parashtruar Kërkesë në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke kontestuar Aktvendimin e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 140, të datës 25 janar 2010, derisa Parashtruesi ankohet edhe për dy procedura të tjera, procedura kundër Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, si dhe procedura kundër Postës dhe Telekomit në Pejë, duke mos specifikuar se për çka janë ankesat e tij. Në këtë kuptim, Parashtruesi pretendon që PTK-ja, MTPT-ja, Zyra e PTK-së në Pejë, duhet t'i paguajnë atij kompensimin e dëmeve që pretendohen t'i jenë shkaktuar atij, si dhe që punëtorët e PTK-së të mbahen përgjegjës për sjellje të pahijshme në ushtrimin e detyrave të tyre zyrtare.

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së Kërkesës, Gjykata theksoi që Kërkesa është e papranueshme, pasi që procedura kundër Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, si dhe procedura kundër Postës dhe Telekomit në Pejë janë ende në pritje të vendimit të Gjykatës Supreme. Për më tepër, Parashtruesi nuk ka arritur të ofrojë prova që procedurat përkatëse kishin qenë në çfarëdo mënyre të padrejta apo të njollosura me arbitraritet. Kështu, Gjykata vërejti që Kërkesa ishte qartazi e pabazuar, në bazë të Rregullit 36 (1.c) të Rregullores së Punës.

Prishtinë, më 19 janar 2012

Nr. ref.: RK186/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 126/10

Parashtruesi

Lulzim Ramaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit Nr. 140, të 25 janarit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Lulzim Ramaj, me vendbanim në Pejë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës, në mënyrë eksplicite, e konteston Vendimin e Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (në tekstin e mëtejmë: MTPT) me Nr. 140, të 25 janarit 2010.

3. Mirëpo, në kërkesë parashtruesi i kërkesës po ashtu ankohet edhe ndaj dy procedurave, procedurës ndaj Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit dhe procedurës ndaj Postës dhe Telekomunikacionit në Pejë, pa specifikuar se në lidhje me çka janë ankesat e tij.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 24 [Barazia para Ligjit].

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 28 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata). Të njëjtën ditë Sekretariati i Gjykatës e njoftoi parashtruesin e kërkesës se ai duhej të plotësonte formularin e kërkesës.

7. Më 9 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi formularin e kërkesës në Gjykatë.

8. Më 27 janar 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën MTPT-së, e cila deri më tani nuk ka dorëzuar asnjë dokument.

9. Më 4 shkurt 2011, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë.

10. Më 14 shkurt 2011, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 126/10, e emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 126/10, e

emëroi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

11. Më 28 prill 2011, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të specifikonte se në çfarë mënyre vendimet e kontestuara ia cenonin të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

12. Më 12 maj 2011, parashtruesi i kërkesës u përgjigj, mirëpo përgjigja e tij nuk kishte të bënte me kërkesën fillestare.

13. Më 29 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe ia paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 10 janar 2008, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Shërbimin Postar të Kosovës lidhur me vonesën e pranimit të letrave.

15. Më 21 dhjetor 2009, parashtruesi i kërkesës përsëri i shkroi Shërbimit Postar të Kosovës duke u ankuar rreth vonesave në shërbimin postar dhe rreth kontrollit të pretenduar të letrave nga ana stafit të Shërbimit Postar.

16. Më 5 janar 2010, parashtruesi i kërkesës u ankua në MTPT ndaj vendimit të Shërbimit Postar të Kosovës, të 24 dhjetorit 2009, me të cilin ishin hedhur poshtë pretendimet e tij.

17. Më 25 shkurt 2010, parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën Supreme ndaj vendimit të MTPT-së të 25 janarit 2010. Parashtruesi i kërkesës konsideronte se MTPT nuk i kishte marrë parasysh vërejtjet dhe ankesat e tij.

18. Më 27 korrik 2010, parashtruesi i kërkesës e parashtroi një ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ndaj Gjykatës Supreme për mosshqyrtimin e ankesës së tij të 25 shkurtit 2010 dhe për stërzgjatje të rastit.

19. Më 13 gusht 2010, Këshilli Gjyqësor i Kosovës lëshoi një vendim në lidhje me ankesën e parashtruesit të kërkesës të 27 korrikut 2010.

20. Më 25 gusht 2010, parashtruesi i kërkesës u ankua ndaj vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të 13 gushtit 2010 për mosndërmarrje të masave ligjore ndaj Gjykatës Supreme.

21. Sa i përket procedurave ndaj Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit dhe procedurave ndaj Postës dhe Telekomunikacionit në Pejë, faktet paraqiten si në vijim:

a) Faktet në lidhje me procedurat ndaj Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit

22. Më 31 mars 2009, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në MTPT në lidhje me vonesat e shërbimit postar, vjedhje dhe për mospastrim të vulës, gjë që e vështirëson leximin e datës në vulë.

23. Më 13 maj 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi edhe një ankesë në MTPT në lidhje me vonesën e marrjes së postës.

24. Më 20 maj 2010, MTPT lëshoi një vendim të cilin parashtruesi i kërkesës nuk e ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese.

25. Parashtruesi i kërkesës pastaj parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme ndaj vendimit të MTPT-së, të 20 majit 2010.

26. Më 8 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi parashtresë në Gjykatën Supreme duke e ndryshuar ankesën ndaj vendimit të MTPT-së, të 20 majit 2010.

27. Më 11 qershor 2010, Gjykata Supreme i dërgoi njoftim parashtruesit të kërkesës për pagesën e një takse gjyqësore në lidhje me ankesën e tij në Gjykatën Supreme.

28. Më 19 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi përgjigjen në njoftimin e Gjykatës Supreme të 11 qershorit 2010.

29. Më 17 korrik 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti parashtresë në Gjykatën Supreme me të cilën e ndryshoi ankesën e tij.

b) Faktet në lidhje me procedurat ndaj Postës dhe Telekomunikacionit në Pejë

30. Më 29 prill 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Postën e Pejës ndaj zyrtarëve të Shërbimit Postar të Kosovës për mosdërgimin në kohë të faturës së telefonit.

31. Më 7 korrik 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti edhe një ankesë në PTK-në e Pejës ndaj punëtorëve të PTK-së për pasurim të padrejtë dhe shpërdorim gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

32. Më 2 shtator 2010, parashtroi edhe një ankesë në PTK-në e Pejës në lidhje me pretendimin për shpërdorim nga ana e punëtorëve të PTK-së, duke pohuar se për pullat postare që i kishte blerë i ishte dashur të paguajë më shumë se duhej paguar zakonisht dhe se punëtorët e tjerë të PTK-së nuk e kishin pastruar vulën para përdorimit.

33. Më 7 shtator 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme ndaj vendimit të Degës së PTK-së në Pejë, të 3 shtator 2010.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i është cenuar e drejta e garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

35. Parashtruesi i kërkesës thekson se, me këtë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duhet t'i realizohen të drejtat e tij ashtu që, autoritetet: PTK, MTPT dhe dega e PTK-së në Pejë duhet t'i paguajnë kompensim monetar për dëmet që pretendon se ia kanë shkaktuar dhe se punëtorët e PTK-së duhet të mbahen përgjegjës për shpërdorim gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

36. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se i është cenuar e drejta e garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, Gjykata vëren se për të qenë në gjendje të gjykojë për ankesën e parashtruesit, së pari duhet të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

37. Në lidhje me këtë, duhet përmendur nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 (2) të Ligjit, sipas të cilëve, individët që parashtrojnë kërkesë në Gjykatë duhet të tregojnë se i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike që i kanë në dispozicion në bazë të ligjit të aplikueshëm.

38. Gjykata e thekson se arsyetimi për kërkesën e shterimit është që t'iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat,

mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ Selmouni kundër Francës, nr. 25803194, vendimi i 28 korrikut 1999). Sidoqoftë, nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese të ngrihen në mënyrë eksplicite gjatë procedurave në fjalë. Derisa kjo çështje është ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, kërkesa për shterimin e mjeteve është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, nr. 56679/00, Vendimi i 28 prillit 2004).

39. Kjo Gjykatë e ka përdorur të njëjtin arsyetim kur e ka nxjerrë Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Universiteti AAB – RIINVEST SH. P. K. kundër Qeverisës së Republikës së Kosovës, rasti KI 41/09 i 27 janarit 2010, si dhe në Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Mimoza Kusari – Lila kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rasti nr. 73/09 i 23 marsit 2010.

40. Sa i përket këtij rasti, nga parashtresat e parashtruesit të kërkesës është e qartë se procedurat ndaj Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe procedurat ndaj Postës dhe Telekomunikacionit në Pejë, ende nuk kanë përfunduar në Gjykatën Supreme.

41. Rezulton që parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i ka në dispozicion në bazë të ligjit të aplikueshëm, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 (2) të Ligjit.

42. Sa i përket procedurave ndaj Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit dhe procedurave ndaj Postës dhe Telekomunikacionit në Pejë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka dështuar të provojë se cilat të drejta dhe në çfarë mënyrë vendimet përkatëse të këtyre organeve publike i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

43. Rrjedhimisht, rezulton që kërkesa në tërësi është qartazi e pabazuar në bazë të rregullit 36 (1.c) të Rregullores së punës që parasheh: *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar."*

44. Për arsyet e lartpërmendura kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 (2) të Ligjit si dhe rregullat 36 (1.c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 29 nëntor 2011, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 14/11 datë 10 shkurt 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme Pzd.nr. 135/2010, të 21 janarit 2011

Rasti KI 14/11, Vendimi për papranueshmëri, i datës 23 nëntor 2011
Fjalë kyçe: barazia para ligjit, kërkesa individuale, qartazi e pabazuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi, Z. Baki Musa, ka parashtruar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar aktvendimin e Gjykatës Supreme Pzd. nr. 135/2010, i datës 21 janar, si të marrë me shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para ligjit] dhe nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës, sepse "[...] Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut kanë nxjerrë aktgjykime me mangësi procedurale, derisa ankesa e prokurorit publik nuk i është komunikuar atij."

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së Kërkesës, Gjykata theksoi që Kërkesa është e papranueshme, se ose Parashtruesi nuk kishte arritur të dorëzojë prova që procedurat përkatëse kishin qenë në çfarëdo mënyre të padrejta apo të njollosura me arbitraritet. Kështu, Gjykata vërejti që Kërkesa ishte qartazi e pabazuar, në bazë të Rregullit 36 (1.c) të Rregullores së Punës.

Prishtinë, më 23 janar 2012

Nr. ref.: RK188/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 14/11

Parashtruesi

Baki Musa

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme Pzd.nr. 135/2010, të 21 janarit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi është z. Baki Musa me banim në Bërnicë të Epërme, Komuna e Prishtinës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Vendimin e Gjykatës Supreme Pzd. nr. 135/2010, të 21 janarit 2011, i cili iu dorëzua parashtruesit më 1 shkurt 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se vendimi i Gjykatës Supreme shkel nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009 (nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli nr. 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 8 mars 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 2 mars 2011, Kryetari, me Urdhrin nr. GJR. 14/11 caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu si Gjyqtar raportues. Në të njëjtën ditë, Kryetari, me Urdhrin nr. KSH. 14/11 caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Ivan Čukalovič.

7. Më 4 maj 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Gjykatës Supreme.

8. Më 8 korrik, Gjykata kërkoi dokumentacion shtesë nga parashtruesi, i cili u përgjigj më 1 gusht 2011 dhe dorëzoi dokumentet e kërkuara.

9. Më 23 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 24 korrik 2001, Prokurori publik paraqiti akuzë në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër parashtruesit për kryerjen e veprës penale duke shkaktuar lëndime të rënda e të lehta trupore ndaj një pale të tretë.

11. Më 18 shkurt 2003, Gjykata Komunale e Prishtinës lëshoi një aktgjykim duke gjetur parashtruesin fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën ishte akuzuar dhe e dënoi atë me tetë

muaj burgim (Aktgjykimi P. nr. 1643/2002). Parashtruesi u ankua për këtë aktgjykim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

12. Më 20 maj 2005, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe dënoi parashtruesin me gjashtë muaj burgim (Aktgjykimi Ap. nr. 438/2003). Parashtruesi u ankua për këtë aktgjykim në Gjykatën Supreme.

13. Më 2 nëntor 2005, Gjykata Supreme e Kosovës anuloi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe e ktheu në Gjykatën e Qarkut për rigjykim (Aktgjykimi Pkl. nr. 34/2005). Gjykata Supreme konkludoi se vendimi i Gjykatës së Qarkut kishte shkelur nenin 403 (2) (1) të Kodit të Procedurës Penale pasi që ankesa e Prokurorit publik nuk i ishte komunikuar parashtruesit.

14. Më 20 mars 2006, Gjykata e Qarkut rigjykoi rastin dhe lëshoi një aktgjykim duke dënuar parashtruesin me gjashtë muaj burgim (Aktgjykimi Ap. nr. 83?2006). Parashtruesi prapë u ankua për aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjykatën Supreme.

15. Më 15 janar 2009, Gjykata Supreme anuloi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe e ktheu për rigjykim (Aktgjykimi Pkl. nr. 1/2009). Gjykata Supreme prapë konkludoi se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut ishte duke shkelur nenin 403 (2)(1) të Kodit të Procedurës Penale, pasi ankesa e Prokurorit publik nuk i ishte komunikuar parashtruesit.

16. Si rezultat i kësaj, Gjykata e Qarkut ia përcjelli ankesën parashtruesit për komente. Më 2 dhjetor 2009, Gjykata e Qarkut vendosi të ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe të dënojë parashtruesin me gjashtë muaj burgim (Aktgjykimi Ap. nr. 68/2009). Përsëri parashtruesi u ankua kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme duke kërkuar zvogëlimin e dënimit.

17. Më 21 janar 2011, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për të zvogëluar dënimin. Gjykata Supreme konkludoi se nuk kishte rrethana te reja që arsyetojnë zvogëlimin e dënimit dhe që aktgjykimi i shqiptuar i Gjykatës së Qarkut ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj (Vendimi Pzd.nr. 135/2010).

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi pretendon se kishte shkelje të nenit 24 [Barazia Para Ligjit] dhe nenit 31 [e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, me arsyetimin se, meqenëse Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut kanë lëshuar një aktgjykim me gabime procedurale, ankesa e Prokurorit publik nuk i është komunikuar atij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Parashtruesi pretendon shkeljen e nenit 24 [Barazia Para Ligjit] dhe nenit 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, me arsyetimin se, meqenëse Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut kanë lëshuar një aktgjykim me gabime procedurale, ankesa e Prokurorit publik nuk i është komunikuar atij.

20. Megjithatë, në mënyrë që të gjykohet kërkesa e parashtruesit, është e nevojshme që së pari të shqyrtohet nëse parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë ashtu siç është specifikuar me Ligj dhe me Rregulloren e punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk mund të ankohet se gjykatat e rregullta kanë kryer gabime të fakteve ose ligjeve, përveç nëse ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë.

22. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e shkallës së katërt, kur merren parasysh vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjeve si procedurale edhe ato materiale (shih *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, par. 28, Gjykata Evropiane për të drejtat e Njeriut [ECHR] 1999-I).
23. Gjykata mund vetëm të shqyrtojë nëse prova është paraqitur në mënyrë të tillë, dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar nga tërësia e tyre, janë kryer në mënyrë të atillë që parashtruesi ka pasur një gjykim të drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. nr. 13071/87 e aprovuar më 10 korrik 1991).

24. Sa i përket çështjes në fjalë, Gjykata vëren se Gjykata e Qarkut me Aktgjykimin Ap. nr. 68/2009, të 2 dhjetorit 2009, ka zbatuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme duke ia përcjellë ankesën e Prokurorit publik parashtruesit për komente. Për më tepër, Gjykata Supreme me vendimin Pzd. Nr. 135/2010, të 21 janarit 2011, përfundoi se nuk ka pasur rrethana të reja që arsyetojnë zvogëlimin e dënimit dhe se vendimi i shqiptuar nga Gjykata e Qarkut ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj.

25. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka treguar se në çfarë mënyre vendimi i Gjykatës Supreme ka qenë i padrejtë dhe i njollosur nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i KEDNJ sa i përket pranueshmërisë së kërkesës nr_17064/06, të 30 qershorit 2009 dhe Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i KEDNJ sa i përket pranueshmërisë së kërkesës nr. 53363/99 të 31 majit 2005) dhe si erdhi deri te shkelja e të drejtave kushtetuese të përmendura nga parashtruesi.

26. Në këto rrethana, kërkesa është qartazi e pabazuar sipas rregullit 36 (1. c) të Rregullores së punës që përcakton: "*Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) Kërkesa është qartazi e bazuar*".

27. Prandaj, kërkesa e parashtruesit duhet të refuzohet si e papranueshme

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhje me rregullin 36 (1. c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 nëntor 2011 njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË poshtë kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 54/11 datë 10 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 11/2002, të 6 shkurtit 2002

Lënda KI 54/11, vendimi i 29 nëntorit 2011.
Fjalët kyçe; kërkesë individuale, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

Parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesës në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese së Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009.
Më 21 prill 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.
Më 21 prill 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova, prof. Dr. Enver Hasani dhe Dr. Gjyljeta Mushkolaj.
Më 25 korrik 2001, Gjykata Komunale në Viti, me Aktgjykimin C. nr. 53/2001, e konfirmoi të drejtën paraprake të parashtruesit për ta blerë ngastrën kadastrale nr. 3089/1
Gjykata Komunale e urdhëroi N. A. të pajtohej me bartjen e të drejtës pronësore për ngastrën e kontestuar kadastrale.
Më 23 tetor 2001, Gjykata Komunale me Vendimin AC. nr. 128/01, e refuzoi ankesën e J. S. dhe N. A. dhe e konfirmoi Aktgjykimin C. nr. 53/2001.
Më 6 shkurt 2002, Gjykata Supreme, me aktgjykimin rev. nr. 11/2002, e miratoi revizionin e J. S. dhe N. A. dhe e anuloi Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 128/2001.
Gjykata Supreme pas shqyrtimit të Aktgjykimit të kontestuar ka vërtetuar që revizioni është i bazuar për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale në këtë rast.
Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. nr. 11/2002 të 6 shkurtit 2002, me aplikimin e gabuar të LBPP ka shkelur disa nga të drejtat e tij kushtetuese: të drejtën e tij në [Barazi para Ligjit] garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në bazë të nenit 31 të Kushtetutës, të drejtën e tij për mbrojtje gjyqësorë të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës dhe drejtën e tij nga neni 22 i Kushtetutës, pasi që nuk është respektuar e drejta e tij për një

gjykim të drejtë sipas nenit 6 paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
Gjykata pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur konstaton se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ac. nr. 128/2001, ishte miratuar më 6 shkurt 2002, pra para hyrjes së Kushtetutës në fuqi. (dmth. 15 qershor 2008).

Gjykata nuk mund ta shqyrtojë një kërkesë që ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës (shih Aktvendimin e Gjykatës për Papranueshmëri në Rastin nr. KI 18/10, Denic dhe të tjerët, të 17 gushtit 2011).

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së dorëzuar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 ë Kushtetutës, nenet 46, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullave 36. (1a) dhe 36. (3c) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 29 nëntor 2011 njëzëri ka vendosur ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

Prishtinë, më 24 janar 2012

Nr. ref.: RK189/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 54/11

Parashtruesi

Adem Qamili

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 11/2002, të 6 shkurtit 2002

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Adem Qamili, nga Komuna e Vitisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 11/2002, të 6 shkurtit 2002.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon se ka pasur shkelje të nenit 22, paragrafit 2 [i cili parashikon zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kryesisht paragrafin 1 të nenit 6], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 21 prill 2011.

6. Më 21 prill 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga

gjyqtarët Snezhana Botusharova, prof. Dr. Enver Hasani dhe Dr. Gjyljeta Mushkolaj.

7. Më 29 nëntor 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

8. Më 25 korrik 2001, Gjykata Komunale në Viti, nëpërmjet Aktgjykimit C. Nr. 53/2001, e konfirmoi të drejtën paraprake të parashtruesit për ta blerë ngastrën kadastrale nr. 3089/1 në vendin e quajtur "Sello-Oborr", një shtëpi dhe oborr me sipërfaqe prej 0.02,20 ha. Gjatë marrjes së këtij vendimi, gjykata anuloi një kontratë formale të pavërtetuar, të 30 prillit 2001, me anë të së cilës J.S., përfaqësues i autorizuar dhe kujdestar i pronës për trashëgimtarët e tjerë, ia shiti N.A.-së këtë pronë kadastrale.

9. Gjykata Komunale e urdhëroi, ndër të tjera, J.S.-në që ta lidhte kontratën për shitje të pronës kadastrale me parashtruesin dhe ta vërtetonte atë në Gjykatën Komunale brenda 15 ditëve, përndryshe do të ishte objekt i përmbarimit të detyrueshëm. Gjykata Komunale tha se sikur J.S.-ja të mos e kishte respektuar afatin e caktuar, ky aktgjykim do të kishte shërbyer si bazë për ta regjistruar parashtruesin si pronar të pronës në regjistrin pronësor.

10. Gjykata Komunale e urdhëroi N.A.-në të pajtohej me bartjen e të drejtës pronësore për ngastrën e kontestuar kadastrale.

11. Më 23 tetor 2001, Gjykata e Qarkut në Gjilan, me Vendimin AC. Nr. 128/01, e refuzoi ankesën e J.S.-së dhe N.A.-së, dhe e konfirmoi Aktgjykimin C. Nr. 53/2001.

12. Më 6 shkurt 2002, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. Nr. 11/2002 e miratoi revizionin e J.S.-së dhe N.A.-së dhe e anuloi Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, AC. Nr. 128/2001, dhe Vendimin e Gjykatës Komunale në Viti C. Nr. 53/2001. Gjykata Supreme tërësisht e refuzoi si të pabazë

kërkesëpadinë e parashtruesit lidhur me konfirmimin e të drejtës paraprake për blerjen e pronës së paluajtshme, të regjistruar si ngastra kadastrale Nr. 3089/1, në vendin e quajtur "Sello-Oborr" dhe e anuloi kontratën e pavërtetuar të 30 prillit 2001.

13. Pas shqyrtimit të aktgjykimit të ankimuar, Gjykata Supreme, në përputhje me dispozitën e nenit 386 të Ligjit për procedurën kontestimore, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së Nr. 4/1977 (në tekstin e mëtejmë: LPK), konstatoi që revizioni ishte i bazuar për shkak të zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale në këtë rast.

14. Gjykata Supreme vendosi që sipas nenit 4, paragrafit 2, të Ligjit për bartjen e pronës së paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Serbisë Nr. 43/81, 24/89, 30/89 dhe 40/89 (në tekstin e mëtejmë: LBPP), kontrata që nuk është hartuar në përputhje me nenin 4, paragrafin 1, të LBPP-së nuk do të ketë efekt ligjor. Në këtë rast, kontrata ndërmjet palëve nuk ishte vërtetuar nga gjykata, prandaj nuk ka efekt ligjor, kështu që konsiderohet pa fuqi ligjore, dhe konkluzioni i saj nuk e parashikonte as të drejtën paraprake për blerje të pronës. Në përputhje me nenin 26, paragrafin 2, të LBPP-së, padia mund të ushtrohet brenda një viti nga data e lidhjes së kontratës, por në këtë rast nuk kishte kontratë të vlefshme. Prandaj, Gjykata Supreme konstatoi që gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë e kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale.

15. Gjykata Supreme gjithashtu konstatoi që e nxori këtë vendim sepse, siç shihet në shkresat e lëndës, paditësi nuk e kishte depozituar çmimin e pronës së paluajtshme në kohën e parashtrimit të padisë dhe nuk e bëri këtë as gjatë kohës që procedura ishte në shqyrtim e sipër në gjykatën e shkallës së dytë, e kjo ishte në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 26 të LBPP-së.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi pohon se kur Gjykata Supreme e Kosovës në Aktgjykimin e vet Rev. Nr. 11/2002, të 6 shkurtit 2002, padrejtësisht e zbatoi LBPP-në, ajo ia shkeli disa të drejta kushtetuese: të drejtën për barazi para ligjit, të garantuar me

nenin 24 të Kushtetutës; të drejtën për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës; të drejtën për mbrojtje gjyqësore, të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës; dhe të drejtat e tij të garantuara me nenin 22 të Kushtetutës sepse nuk ishte respektuar e drejta e tij për gjykim të drejtë sipas nenit 6, paragrafit 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vlerësimi për pranueshmëri

17. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregullore të punës.

18. Nga dokumentet në kërkesë shihet se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. Nr. 128/2001, ishte miratuar më 6 shkurt 2002, pra para hyrjes së Kushtetutës në fuqi (Kushtetuta hyri në fuqi më 15 qershor 2008). Në faqen 6 të kërkesës së vet, parashtruesi thotë se Gjykata nuk funksiononte në kohën kur e kishte marrë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

19. Gjykata konsideron se nga organet publike të Republikës së Kosovës mund të kërkohet të përgjigjen vetëm për faktet dhe aktet që kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Si rrjedhojë, Gjykata nuk mund ta shqyrtojë një kërkesë që ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës (shih Aktvendimin e Gjykatës për Papranueshmëri në Rastin Nr. 18/10, Denić dhe të tjerët, të 17 gushtit 2011).

20. Prandaj, rezulton që kërkesa është e papranueshme në përputhje me rregullin 36.3 (h) të Rregullores së punës, i cili thotë që kërkesa po ashtu mund të konsiderohet e papranueshme nëse "kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën".

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 36.3 (h) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu, Prof. Dr. Enver Hasani

KI 06/11 datë 10 shkurt 2012- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit të Senatit të Universitetit të Prishtinës, ref. nr 4/449, të datës 03.12.2010

Rasti KI 06/11, vendimi i datës 27 janar 2012
Fjalët kyçe; kërkesë individuale, e drejta në pune, mos shterje e mjeteve juridike, Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pretenduar se me Njoftimin e Senatit të Universitetit të Prishtinës, ref. nr 4/449, të datës 03. 12. 2010, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë neni 49 i Kushtetutës (e drejta në punë dhe zgjedhja e profesionit) dhe neni 25 (E drejta për jetën).
Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e Kushtetutshmërisë së njoftimit ref. nr. 4/449, të datës 03.12.2010, i nënshkruar nga Rektori i UP-së, z. Mujë Rugova, me anë të të cilit Fakulteti i Mjekësisë (shërbimi financiar), zyrtari ligjor i UP-së, Zyra akademike dhe profesorët z. Shaban Hasi e z. Lutfi Dervishi njoftohen se çështja e zgjedhjes së këtyre dy profesorëve refuzohet sepse të përmendurit janë në procedurë gjyqësore dhe njëkohësisht obligohet shërbimi financiar i UP-së që të përmendurit t'i largojë nga lista e pagave.

Duke shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur në kërkesë, Gjykata konstaton se parashtruesi i saj nuk ka përmbushur kushtin e shterjes së mjeteve të parapara juridike, sepse nuk ka ofruar dëshmi që përpos një ankese në Senatin e UP-së të ketë ushtruar ndonjë mjet tjetër juridik apo të ketë marrë ndonjë vendim meritor nga ndonjë organ administrativ, apo gjykatë e rregullt, para se t'i drejtohej me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.
Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.1(a) të Rregullores së punës, hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

Prishtinë, më.27 janar 2012

Nr. ref.: RK192 /12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 06/11

Parashtruesi

Prof. Dr. Shaban Hasi

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit të Senatit të Universitetit të Prishtinës, ref. nr 4/449, të datës 03.12.2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Prof. Dr. Shaban Hasi, nga Gllogovci, me banim në Gllogovc, Rr. e "Jasharajve" p.n.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Njoftimi i Senatit të Universitetit të Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: UP), ref. nr. 4/449, i datës 03.12.2010.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 21.11.2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Njoftimit ref. nr. 4/449, të datës 03.12.2010, i nënshkruar nga Rektori i UP-së, z. Mujë Rugova, me anë të të cilit Fakulteti i Mjekësisë (shërbimi financiar), zyrtari ligjor i UP-së, Zyra akademike dhe profesorët z. Shaban

Hasi e z. Lutfi Dervishi njoftohen se **çështja e zgjedhjes së këtyre dy profesorëve refuzohet** sepse të përmendurit janë në procedurë gjyqësore dhe njëkohësisht obligohet shërbimi financiar i UP-së që të përmendurit t'i largojë nga lista e pagave.

Baza ligjore

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 21.01.2011, prof. Dr. Shaban Hasi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës me të cilën kërkonte vlerësimin e kushtetutshmërisë së Njoftimit të Senatit të Universitetit të Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: UP) ref. nr. 4/449, të datës 03.12.2010.

6. Më 14 shkurt 2011, Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović e Gjyljeta Mushkolaj, anëtarë.

7. Më 03 mars 2011, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar parashtruesin e kërkesës dhe Universitetin e Prishtinës lidhur me regjistrimin e kërkesës së parashtruar në këtë Gjykatë, duke kërkuar nga UP përgjigje me shkrim lidhur me kërkesën dhe komentet eventuale.

8. Në aftin ligjor prej 45 ditësh Gjykata nuk mori asnjë përgjigje nga UP.

9. Më 9 qershor 2011, pas raportimit të Gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues në përbërje nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović e Gjyljeta Mushkolaj, anëtarë, i rekomandoi përbërjes së plotë të Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Prof. Shaban Hasi, sipas pohimit të tij në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ka punuar në Fakultetin e Mjekësisë që nga viti 1987.

11. Universiteti i Prishtinës, më datë të papërcaktuar të muajit dhjetor 2010, kishte dërguar Njoftimin Ref. nr 4/449 në Fakultetin e Mjekësisë dhe një kopje të tij edhe: arkivit të UP-së, zyrës për çështje akademike, fakultetit, zyrtarit ligjor të UP-së, të përmendurve (prof. Dr. Shaban Hasit dhe prof. Lutfi Dervishit) dhe shërbimit financiar të UP-së, të cilin e kishin nënshkruar Rektori i UP-së, prof. Dr. Mujë Rugova dhe zyrtari ligjor i UP-së, në të cilin njoftim ishte theksuar se UP në mbledhjen e Senatit të mbajtur më 8.11.2010 kishte vendosur që, "çështja e zgjedhjes së prof. Shaban Hasit dhe prof. Lutfi Dervishit të refuzohet për shkak se të përmendurit janë në procedurë gjyqësore".

12. Përmes këtij njoftimi gjithashtu është obliguar shërbimi financiar i UP-së që të përmendurit t'i heqë nga lista e pagave nga data e mbajtjes së mbledhjes së Senatit (8.11.2010).

13. Nëpërmjet avokatit Shaqir Behrami, prof. Dr. Shaban Hasi është ankuar në Senatin e UP-së për shkak të ndërprerjes së njëanshme të kontratës në Fakultetin e Mjekësisë, dhe atë pa vendim të Senatit, me propozimin që Senati të marrë vendim

për ANULIMIN e Njoftimit ref. 4/449 dhe që t'i vazhdohet marrëdhënia e punës në pozitën që kishte para këtij njoftimi.

14. Lidhur me këtë ankesë, prof. Shaban Hasi nuk mori asnjë përgjigje nga Senati i UP-së.

15. Më 07 dhjetor 2010, sipas kërkesës së prof. Dr. Shaban Hasi, Gjykata Komunale në Gllogovc ka lëshuar një certifikatë me të cilën vërtetohet se ndaj z. Shaban Hasi nuk është ushtruar aktakuzë e plotfuqishme e as nuk është gjykuar me aktgjykim për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burg në kohëzgjatje prej 3(tre) vjetësh, ose dënimi me gjobë.

16. Më 14.12.2010, Fakulteti i Mjekësisë me shkresën ref. nr. 4333, të nënshkruar nga Dekani i fakultetit, i ka dërguar përgjigje në kërkesën e tij në të cilën ka konfirmuar se ky fakultet nuk ka të dhëna se prof. Shaban Hasi është dënuar ndonjë herë apo që në të kaluarën e deri më sot të ketë marrë ndonjë vërejtje në punën e tij nga dekanati i këtij fakulteti.

17. Më 20.12.2010, dekanati i Fakultetit të Mjekësisë me shkresën zyrtare ref. nr. 4421 i ka dërguar prof. Shaban Hasit një tjetër përgjigje, me të cilën konfirmohet se Rektorati i UP-së nuk ka kërkuar ndonjë sqarim apo informatë me shkrim nga Dekanati i Fakultetit të Mjekësisë lidhur çështjen e ngritur ndaj tij (procedura eventuale gjyqësore), dhe se Dekani i Fakultetit të Mjekësisë nuk është në dijeni për këtë çështje.

18. Përfundimisht, më 21.01.2011 prof. Dr. Shaban Hasi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar shkeljet e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, të cekura në kërkesë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës ka theksuar se konsideron që me njoftimin të cilin e sfidon para Gjykatës atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë për jetë dhe punë.

20. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu në Gjykatën Kushtetuese ka theksuar se me Njoftimin ref. nr. 4/449, të nënshkruar nga Rektori i UP-së, i cili nuk e ka as formën e vendimit, atij në mënyrë të kundërligjshme i është mohuar e drejta për të ushtruar detyrën e profesorit të lëndës së Kirurgjisë në Fakultetin e Mjekësisë, nga shkaku se gjoja ai gjendet në procedurë gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës pohon se ai asnjëherë nuk ka qenë në procedurë gjyqësore, dhe se për këtë posedon edhe dokumentacionin përkatës që ia vërteton këto pohime. Njoftimin e Rektorit e quan arbitrar dhe pretendon se me këtë akt i janë shkelur të drejtat kushtetuese për punë dhe jetë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen në Kushtetutë.

22. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

*"Individët janë të autorizuar të ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale**, **të garantuara me Kushtetutë**, mirëpo **vetëm** pasi të **kenë shteruar të gjitha mjetet juridike** të përcaktuara me ligj."*

Gjykata gjithashtu merr parasysh: nenin 46 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës që i referohet kërkesave individuale dhe në të cilin përcaktohet:

"Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore."

23. Duke shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur në kërkesë, Gjykata konstaton se parashtruesi i saj nuk ka përmbushur kushtin e shterjes së mjeteve të parapara juridike, sepse nuk ka ofruar dëshmi që përpos një ankese në Senatin e UP-së të ketë ushtruar ndonjë mjet tjetër juridik apo të ketë marrë ndonjë vendim meritor nga ndonjë organ administrativ, apo gjykatë e rregullt, para se t'i drejtohej me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

24. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se kriteri juridik i shterjes së "të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj" është absolutisht i domosdoshëm si kusht esencial për të paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, dhe përpos që është një kusht juridik i paraparë me Kushtetutë dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, si kusht esencial juridik parashihet edhe me rregullin 36 par.(a) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.

25. Gjithnjë duke iu referuar këtij kriteri të pranueshmërisë, Gjykata vë në pah se me Ligjin nr. 2002/03 mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, të shpallur më 12 maj 2003 nga Michael Steiner, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm, përkatësisht me nenin 25.5, është qartë e përcaktuar se:

" Personeli akademik e joakademik i bartësit të arsimit të lartë gëzon të drejtën për të apeluar ndaj

një vendimi apo veprimi të institucionit të arsimit të lartë lidhur me to te Ministria dhe pastaj tek një gjykatë e juridiksionit kompetent."

26. Nga sa u tha në paragrafët e mësipërme, është e qartë se këtë mundësi ligjore për përdorimin e këtij mjeti juridik parashtruesi i kërkesës nuk e ka shfrytëzuar.

27. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të sigurojë mjet efikas ligjor për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni v. Francë nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999).

28. Një arsyetim të tillë Gjykata e kishte aplikuar gjatë shqyrtimit të mëparshëm të kërkesave në rastet: KI 55/10 - Hamide Osaj në kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 43/2010, të datës 4 qershor 2010; Rastin nr. KI 20/10 - Muhamet Bucaliu kundër Vendimit të Prokurorit të Shtetit KMLC. nr. 09/10, të 24 shkurtit 2010 (vendimi i GJ. Kushtetuese i datës 15 tetor 2010).

29. Në këto rrethana, kërkesa është e papranueshme sepse parashtruesi i saj nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike para se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.1(a) të

Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 14 qershorit 2011, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20-4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 90,91,92,93,94 dhe 95/10 datë 10 shkurt 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për privatizimin e Ndërmarrjes së re Jatex kompleksi industrial sh,p.k, në valën e 45 A të privatizimit

Rastin KI 90,91,92,93,94 dhe 95/10**,** vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për privatizimin e Ndërmarrjes së re Jatex kompleksi industrial sh,p.k, në valën e 45 A të privatizimit

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, mos shterje e mjeteve juridike, Aktvendim për papranueshmëri,

Përfaqësuesit kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për privatizimin e Ndërmarrjes së re Jatex kompleksi industrial sh,p.k, në valën e 45 A të privatizimit.

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se atyre, në cilësinë e aksionarëve të ndërmarrjes, me vendimet e AKP-së u janë cenuar e drejta e pronës e garantuar me Kushtetutën e Republikës Kosovës, më saktësisht, sipas tyre janë shkelur neni 46 pika 1 dhe 3 e Kushtetutës.Parashtruesit e ankesës, gjithashtu, kanë theksuar se ata edhe pse kanë dërguar kërkesë për masë të përkohshme në Gjykatën Supreme-Dhoma e Veçantë, ata nuk e njohin juridiksionin e kësaj Gjykate andaj kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese që ajo ta vendos kërkesën në mënyrë meritore.Gjykata hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme sepse parashtruesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj para se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese;

Prishtinë, më 27 janar 2012

Nr. ref.: 190/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 90,91,92,93,94 dhe 95/10,

të bashkuara me vendimin UR 90-10-bk/10, të datës 8 tetor 2010

Parashtrues

Të gjithë aksionarët e Holding ”Jatex-Conitex” sh.a, Holding “Jatex-Modatex” sh.a, Holding “Jatex-Jatex Commerce” sh.a, Holding Corporacy ”Jatex” sh.a, Holding “Jatex-Junitex” sh.a dhe Holding”Jatex-Tricotex” sh.a

Të përfaqësuar nga avokatët: z. Gazmend Nushi dhe z. Ahmet Hasolli

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për privatizimin e Ndërmarrjes së re Jatex kompleksi industrial sh,p.k, në valën e 45 A të privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë aksionarët e Ndërmarrjes Holding Corporacy "Jatex" me njësitë Holding "Jatex-Conitex" sh.a; Holding "Jatex-Modatex" sh.a; Holding "Jatex-jatex Commerce" sh.a; Holding "Jatex-Junitex" sh.a; Holding "Jatex-Tricotex" sh.a, me seli në Gjakovë dhe Junik, të cilët me autorizim i përfaqësojnë avokatët z. Gazmend Zhushi dhe z. Ahmet Hasolli.

Vendimet e kontestuara

2. Vendime të kontestuara në Gjykatën Kushtetuese janë:

Vendimi i AKP-së për aprovimin e rekomandimeve për trajtimin e ndërmarrjeve ”Emin Duraku”, “Jatex” dhe “Deva” si ndërmarrje shoqërore, i datës 29 prill 2010; dhe

Vendimi i AKP-së për shpalljen e valës së 45 A të privatizimit për privatizimin e Ndërmarrjes së re Jatex kompleksi industrial sh,p.k.

Objekti i çështjes

3. Vendimi i AKP-së për shpalljen e valës së 45 A të Privatizimit për privatizimin e Ndërmarrjes së re Jatex kompleksi industrial sh,p.k, të cilat sipas përfaqësuesve të aksionarëve të kësaj ndërmarrje janë bërë pa pasur bazë ligjore dhe se me këtë veprim AKP-ja ka bërë shkelje të nenit 46.1 dhe 46.3 të Kushtetutës së Kosovës (e drejta e pronës) të ndërlidhur me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Baza juridike

4. Neni 113.7 lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i datës 16 dhjetor 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 29 shtator 2010, përfaqësuesit ligjorë të parashtruesve të kërkesës, avokatët: z. Gazmend Nushi dhe z. Ahmet Hasolli, parashtruan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duke cilësuar si jo ligjore vendimet e AKP-së për aprovimin e rekomandimeve për trajtimin e ndërmarrjeve "Emin Duraku", "Jatex" dhe "Deva" si ndërmarrje shoqërore, të datës 29 prill 2010, dhe vendimin e AKP-së për shpalljen e valës së 45 A të privatizimit për privatizimin e Ndërmarrjes së re Jatex kompleksi industrial sh,p.k.

6. Më 9 nëntor 2010, Gjykata Kushtetuese njoftoi palët për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi komentet eventuale lidhur me kërkesën.

7. Më 23 nëntor 2010 dhe me 10 mars 2011, Gjykata Kushtetuese ka marrë përgjigje me shkrim dhe komentet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me kërkesën.

8. Më 12.05.2011, pas raportimit të Gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues në përbërje të Snezhana Botusharova (kryesuese) dhe Robert Carolan e Altay Suroy, anëtarë, i rekomandoi përbërjes së plotë të Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Sipas parashtruesve të kërkesës, të gjashtë ish OTHPB-të, tani parashtruesit e kërkesës, në vitin 1990, sipas legjislacionit në fuqi të asaj kohe, janë ndarë nga Kombinati Industrial ”Emin Duraku” dhe janë transformuar në Shoqëri Aksionare. Ky transformim sipas tyre ishte bërë në përputhje me Ligjin mbi Ndërmarrjet (Gaz. zyr. e RSFJ nr 77/88,40/89,46/90 dhe 61/90).

10. Më 16 gusht 1991, duke marrë parasysh faktin se shumë faza të prodhimit të tyre ishin të ndërlidhura në mes vete, si dhe faktin se të gjitha kompanitë, përpos ‘Junitex”, e kishin selinë në të njëjtin kompleks në Gjakovë, këto kompani morën VENDIM për themelimin e HOLDING CORPORACY “JATEX” sh.a.

11. Me këtë vendim kompanitë vendosën që në ‘HOLDING CORPORACY’ të bartin 51% të aksioneve, ndërsa 49 % të tyre t’i mbajnë për vete.

12. Më 22.11.1991, Holding Corporacy ’Jatex” u regjistrua në Gjykatën e Ekonomike të Qarkut në Gjakovë dhe mori Vendimin nr Fi.2917/91. Gjithashtu në Gjykatën Ekonomike të Qarkut u regjistruan edhe ndërmarrjet që ishin të bashkuara në të, e që tani kanë paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

13. Më 24.12.1992, Holding-u mori Vendimin 06-194/2 për emetimin e aksioneve interne në APOENA dhe secili prej aksionarëve u pajis me këto fletëaksione.

14. Në një formë të tillë të strukturimit Holding Corporacy “Jatex” dhe ndërmarrjet e bashkuara në të kanë funksionuar deri në vitin 1999.

15. Duke vepruar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë VII.C 29/06, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Zyra e Regjistrimit të Ndërmarrjeve Biznesore dhe Emrave Tregtar në Kosovë, ka regjistruar Holding “Jatex” dhe

të gjitha Kompanitë tjera që tani kanë paraqitur kërkesë në Gjykatë Kushtetuese duke i cilësuar si "**Ndërmarrje tjera nën juridiksionin e AKM–së".**

16. Më 22 prill 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit lëshoj një komunikatë për medie në të cilën njofton publikun për vendimin e Bordit të AKP-së që ndërmarrjet "Emin Duraku", "Jatex" dhe "Deva", nga Gjakova, t'i trajtojë si ndërmarrje shoqërore.

17. Më 20 maj 2010, AKP i kishte dërguar njoftim të veçantë me shkrim Ndërmarrjes 'Jatex" lidhur me Vendimin e Bordit të AKP –së për cilësimin e Kompanisë "Emin Duraku", në Gjakovë, pjesë e së cilës para ndarjes ishte e dhe 'Jatex" si 100% ndërmarrje shoqërore duke e venë nën administrim të AKP-së dhe njëkohësisht e njoftoi edhe me bazën ligjore për marrjen e një vendimi të tillë.

18. Më 30 gusht 2010, AKP kishte dërguar njoftimin për refuzimin e ankesës së "Holding Corporacy Jatex", duke e njoftuar se AKP edhe më tej do të vazhdojë ta administrojë Kompaninë Jatex" si ndërmarrje shoqërore dhe duke e udhëzuar atë se lidhur me këtë vendim, kjo kompani, mund të ankohet në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

19. Më 07.09.2010, AKP ka shpallur Valën e 45 A të privatizimit dhe në të ishin publikuar për privatizim edhe ndërmarrja e re "Jatex fabrika e re" sh.p.k dhe ndërmarrja e re "Jatex Kompleksi Industrial", pjesë e të cilave, sipas shpjegimit plotësues të AKP-së, janë edhe Holding Corporacy "Jatex", Holding "Jatex-Conitex"sh.a, Holding 'Jatex-Modatex"sh.a, Holding "Jatex-jatex Commerce" sh.a, Holding "Jatex-Junitex"sh.a dhe Holding "Jatex-Tricotex" sh.a.

20. Më 21 tetor 2010, AKP ka nxjerrë Aktvendimin **SCC- 10 - 0215,** me të cilën ka aprovuar ankesën e paditësit dhe ka APLIKUAR **masën e përkohshme** duke NDALUAR shitjen e

aseteve të shpallura për privatizim të ndërmarrjes së re ”Jatex Fabrika e Re” sh.p.k dhe Fabrika e re “Jatex Kompleksi Industrial” sh.p.k, deri në vendimin përfundimtar për zgjedhjen e padisë nga kjo Gjykatë.

21. Nga dokumentacioni i paraqitur në lëndë, si dhe nga përgjigjet e palëve të involvuara në këtë lëndë, konstatohet se ky proces në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme nuk ka përfunduar ende.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se atyre, në cilësinë e aksionarëve të ndërmarrjes, me vendimet e AKP-së u janë cenuar e drejta e pronës e garantuar me Kushtetutën e Republikës Kosovës, më saktësisht, sipas tyre janë shkelur neni 46 pika 1 dhe 3 e Kushtetutës.

23. Ata gjithashtu ankohen se Agjencia Kosovare e Privatizimit duke mos marrë parasysh statusin juridik të ndërmarrjes Holding “Jatex-Corporacy ‘sh.a dhe të gjitha njësitë e lartcekura, të përcaktuar me legjislacionin në fuqi të vitit 1991 dhe veprimin e vazhdueshëm të këtyre ndërmarrjeve me këtë status juridik deri në vitin 1999, në mënyrë arbitrare, me vendimin e datës 29 prill 2010, ka përcaktuar një status të ri juridik për këto ndërmarrje duke i cilësuar si 100% shoqërore me të gjitha asetet e tyre dhe padrejtësisht i ka venë në menaxhim të AKP-së. Me këtë vendim, sipas tyre, ata në mënyre kundërkushtetuese janë privuar nga e drejta e pronësisë të fituar nëpërmes aksioneve që i kanë poseduar në ndërmarrje dhe që, sipas tyre, i kanë realizuar në mënyrë tërësisht ligjore.

24. Parashtruesit e ankesës, gjithashtu, kanë theksuar se ata edhe pse kanë dërguar kërkesë për masë të përkohshme në Gjykatën Supreme-Dhoma e Veçantë, ata nuk e njohin juridiksionin e

kësaj Gjykate andaj kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese që ajo ta vendos kërkesën në mënyrë meritore.

Komentet e Autoritetit publik

25. Më 23 nëntor 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka dërguar përgjigjeje me shkrim për lëndën KI 95/10 në të cilën ka theksuar se "parashtruesit e kërkesës kanë paraqitur kërkesë edhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, lënda nr.SCC-10 -0215 dhe se kjo dhomë më 21.10.2010 ka aprovuar masën e përkohshme me Aktvendimin nr SCC- 10-0215, me anë të cilit AKM-së i ndalohet shitja e aseteve të shpallura për privatizim deri në vendosjen përfundimtare të padisë".

26. Duke vepruar sipas kërkesës për sqarim plotësues të Gjykatës Kushtetuese, AKP, më 10 mars 2011, ka dërguar përgjigjeje shtesë në kërkesë në të cilën ka sqaruar se: të gjitha shoqëritë aksionare të cilat kanë parashtruar kërkesa në Gjykatën Kushtetuese janë asete të Ndërmarrjes së re "Jatex Fabrika e re" sh,p,k dhe të Ndërmarrjes së re "Jatex Kompleksi Industrial" sh.p.k, e të cilat janë tenderuar në valën e 45 A të privatizimit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë dhe lidhur me këtë i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës ku thuhet:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës i cili përcakton se:

‘Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.

28. Duke shqyrtuar gjithë dokumentacionin e paraqitur në lëndë nga palët, Gjykata në mënyrë të pakontestueshme konstaton se palët që kanë parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese kanë parashtruar gjithashtu edhe padi në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme dhe se në atë Gjykatë, lidhur me këtë padi, akoma nuk është nxjerrë një vendim përfundimtar dhe se lënda është akoma në procedurë, që rrjedhimisht, nënkupton faktin se palët nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, dhe në këto kushte nuk kanë përmbushur kriteret për pranueshmërinë e kërkesës.

29. Gjykata nuk mund të pranojë si të arsyeshme kërkesën e parashtruesve për mos njohjen e juridiksionit të Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme kur me Rregulloren **2002/13 (UNMIK,** të datës13 qershor 2002 **),** në nenin 1.1, qartazi përcaktohet: me anë të kësaj themelohet një **Dhomë e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës** për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë e Mirëbesimit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Veçantë).

30. Gjykata Kushtetuese gjithashtu çmon faktin se është pikërisht “vendimi juridik” i kësaj Dhome të Veçantë të Gjykatës Supreme (Aktvendimi për masë të përkohshme nr. SCC- 10-0215) i cili ka pezulluar privatizimin e ndërmarrjeve në të cilat parashtruesit e kërkesës kanë interesa, dhe ky aktvendim është

marrë mbi bazën e kërkesës së përfaqësuesve ligjorë të tyre, andaj është e qartë se Gjykata Kushtetuese nuk mund të marrë një vendim deri sa Gjykata Supreme nuk e përfundon këtë proces.

31. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës, do të sigurojë mjet efikas ligjor për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis,* GJEDNJ, Selmouni v. France nr. *25803/94,* Vendim i 28 korrikut 1999).

32. Gjykata, një arsyetim të tillë e kishte aplikuar gjatë shqyrtimit të mëparshëm të kërkesave e në rastet: KI 55/10 Hamide Osaj , në kërkesën për Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykates Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 43/2010, i datës 4 qershor 2010, Rastin nr. KI *20/10* Muhamet Bucaliu kundër Vendimit të Prokurorit të shtetit KMLC.nr. *09/10,* të 24 shkurtit 2010 (vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i datës 15 tetor 2010**).**

33. Në këto rrethana, kërkesa është **e paparanuseshme,** sepse palët **nuk i kanë shteruar** të gjitha mjetet juridike para se t'i drejtoheshin Gjykatës **Kushtetuese** dhe parashtruesit nuk i kanë plotësuar kriteret për pranueshmërinë e kërkesës, prandaj

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36. paragrafi 1(a) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e datës 12.05.2011, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme sepse parashtruesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj para se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20-4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 19/09 datë 10 shkurt 2012- Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. 120/2008, të 1 janarit 2009

Rasti KI 19/09, vendim i 30 janarit 2012

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, komisioni diciplinor i KEK-ut, e drejta në punë, shkelje e lirive dhe të drejtave individuale.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nein 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese ishin cenuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me ç'rast miratoi ankesën e KEK-ut dhe anuloi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, duke mbështetur në atë rast largimin e parashtruesit nga punësimi me KEK-un. Parashtruesi pohoi se Gjykata Supreme ka cenuar të drejtën e tij në punë, si dhe të drejtat kushtetuese të garantuara me nenet 49 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës.Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 56.2 të Rregullores së Punës për shkak se parashtruesi nuk kishte dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave kushtetuese. Gjykata vendimin e saj e arsyetoi duke përsëritur se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Duke cituar vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Shub kundër Lituanisë,* Gjykata më tutje arsyetoi se pas shqyrtimit të procedurave në gjykatat e rregullta si tërësi, nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekuara nga arbitrariteti, dhe se Gjykata Supreme kishte dhënë arsye të mjaftueshme se përse ankesat e parashtruesve ishin të pabazuara. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

Prishtinë, më.30 janar 2012

Nr. ref.: RK196/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 19/09

Parashtrues

Mehmet Llapashtica

kundër

Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. 120/2008, të 1 janarit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Mehmet Llapashtica, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. 120/2008, i 1 janarit 2009.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi e dorëzoi një kërkesë në Sekretariatin e Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), në të cilën pohonte që Korporata Energjetike e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK) ia kishte shkelur të drejtën e tij të punës, të garantuar me Kushtetutë, veçanërisht me nenin 49.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 22.7 dhe 22.8 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Sekretariatin e Gjykatës më 19 shtator 2009.

6. Kryetari e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Gjyljeta Mushkolaj. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për këtë kërkesë.

7. Në përgjigje ndaj njoftimit për kërkesë që i ishte dërguar KEK-ut, Zyra Ligjore e KEK-ut iu përgjigj Gjykatës Kushtetuese dhe dërgoi, ndër të tjera, ankesën disiplinore dhe procesverbalin e një shqyrtimi verbal të mbajtur nga KEK-u për këtë çështje më 28 prill 2004.

8. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues më 16 qershor 2010, dhe i rekomandoi Gjykatës se kërkesa ishte e papranueshme.

Përmbledhje e fakteve

9. Parashtruesi ishte i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) si elektromontues në Prishtinë. KEK-u ndërmori masa disiplinore kundër tij për shkak se ai kishte marrë pa leje një transformator elektrik, që ishte pronë e KEK-ut. Gjatë një shqyrtimi verbal, parashtruesi mohoi ta kishte marrë transformatorin pa leje, por pranoi se, me të tjerët, ai kishte marrë 800 euro për punën e kryer privatisht jashtë orarit të punës.

10. Më 28 prill 2004, komisioni disiplinor i KEK-u konstatoi që parashtruesi i kishte shkelur detyrat e punës dhe ia shkëputi kontratën e punës.

11. Parashtruesi parashtroi ankesë kundër këtij vendimi në komisionin disiplinor të shkallës së dytë. Ai pohoi se nuk e kishte transferuar transformatorin sipas kërkesës së të tjerëve, por kishte leje nga shefi i distriktit të KEK-ut. Komisioni disiplinor i shkallës së dytë e refuzoi ankesën e tij me vendimin e 2 qershorit 2006.

12. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër largimit të tij nga puna, e cila e mbështeti padinë e tij dhe Gjykata, në Aktgjykimin e vet Cl. Br. 167/2006, të 28 shtatorit 2006, urdhëroi që parashtruesi të kthehej në punë. KEK-u ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e cila, përmes Aktgjykimit të vet AC. nr. 1016/2006, të 31 korrikut 2007, e hodhi poshtë ankesën e KEK-ut dhe e miratoi vendimin e gjykatës komunale.

13. KEK-u u ankua kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila, përmes Aktgjykimit të vet Rev. nr. 120/2008, të 1 janarit 2009, e miratoi ankesën e KEK-ut dhe e anuloi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, duke mbështetur me këtë rast largimin e parashtruesit nga punësimi me KEK-un. Gjykata Supreme konstatoi që Gjykata Komunale gabimisht e kishte zbatuar të drejtën materiale kur kishte konstatuar që padia e parashtruesit ishte e bazuar.

14. Gjykata Supreme theksoi se Ligji themelor i punës në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/27, që hyri në fuqi më 8 dhjetor 2001, parashikonte shkëputjen e kontratës së punës. Gjykata vuri në pah se Ligji parashikonte shkëputjen e kontratës së punës në raste të sjelljes së keqe, duke përfshirë vjedhjen, shkatërrimin e pronës, dëmtimin ose shfrytëzimin e paautorizuar të pasurisë së punëdhënësit. Për këto arsye, Gjykata Supreme konstatoi që ankesa e KEK-ut ishte e bazuar dhe i anuloi aktgjykimet e Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Qarkut dhe e hodhi poshtë padinë e parashtruesit.

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi pohon, pa shtjellim të mëtejmë, se i është shkelur e drejta e tij për punë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Neni 49 i Kushtetutës përcakton që:

E drejta e punës garantohet.

17. Neni 54 i Kushtetutës përcakton që:

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

18. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta.

Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], *nr. 30544/96*, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

19. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kërkesës ka pasur gjykim të drejtë (Shih *Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të 23 qershorit 2010, në rastin KI 40/09, Imer Ibrahimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, para. 66 dhe 67).*

20. Parashtruesi thjesht konteston nëse Gjykata Supreme e ka zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin e zbatueshëm dhe thjesht nuk pajtohet me gjetjet faktike të vendimit të Gjykatës Supreme lidhur me statusin e punësimit të kandidatëve të suksesshëm për pozitën e kontestuar. Duket që padia e parashtruesit është e papranueshme.

21. Pas shqyrtimit të procedurave në këto gjykata të rregullta si tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

22. Përveç kësaj, parashtruesi nuk kishte dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (*shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005*).

23. Prandaj, rezulton që kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe rregullit 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KI 14/10 dhe KI 15/10 datë 10 shkurt 2012- Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë

Rastet KI 14/10 dhe KI 15/10.

Fjalët kyçe; kërkesë individuale,

Parashtruesit ankohen se u është shkelur e drejta e tyre për liri te lëvizjes e garantuar me nenin 35 (2) te Kushtetutës. Ata pohojnë qe Gjykata Komunale ne Prishtine ne mënyre te padrejte dhe te gabueshme i ka interpretuar dispozitat e zbatueshme ligjore pasi ka dështuar t'ua lëshonte certifikatën, e cila, siç pohohet, është dokument i domosdoshëm për Ministrinë e Punëve te Brendshme për te lëshuar pasaporte te Republikës se Kosovës.

Parashtruesit kërkuan caktimin e masës se përkohshme "për ta shmangur diskriminimin e mëtejme dhe shkeljen e te drejtës se qytetareve për liri te lëvizjes me kushtëzimin e cilësdo procedure penale ne vazhdim e sipër".

Për shkak te arsyeve te sipërpërmendura, shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës ndërpritet dhe Gjykata konstaton qe nuk ka rrethana te posaçme lidhur me respektimin e te drejtave te njeriut te cilat do te kërkonin shqyrtim te mëtejshëm te kërkesës.

Gjykata Kushtetuese merr vendim për heqjen e kërkesës nga lista.

Prishtinë, më 30 janar 2012
Ref. No.: 194/12

VENDIM PËR HEQJEN E KËRKESËS NGA LISTA

në

Rastin Nr. KI 14/10 dhe KI 15/10

Besnik Musa dhe Hekuran Muhaxhiri

kundër

Ministrisë së Punëve të Brendshme,

Këshillit Gjyqësor të Kosovës

dhe

Ministrisë së Drejtësisë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit

1. Parashtrues janë z. Besnik Musa dhe z. Hekuran Muhaxhiri me banim në Gjakovë. Në procedurën në Gjykatën Kushtetuese ata përfaqësohen nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

2. Rastet në fjalë janë të ngjashme me Rastin KI 06/10 "Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë". Në këtë rast, Gjykata vendosi që ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit për liri të lëvizjes, të garantuar me nenin 35 (2) të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të Protokollit Nr. 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

   Përveç kësaj, Gjykata ka vendosur që praktika e bazuar në memorandumin e mirëkuptimit, të 21 gushtit 2008, e zbatuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Gjykata Komunale, e pengoi parashtruesin që ta gëzonte të drejtën e tij për mjet efektiv juridik në kundërshtim me nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

   Gjykata Kushtetuese konstatoi që Ministria e Punëve të Brendshme duhej të vendoste lidhur me kërkesën e parashtruesit për pasaportë, të 27 prillit 2009, në pajtim me Ligjin për Dokumentet e Udhëtimit brenda 30 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi (*Shih Aktgjykimin KI 06/10, të 30 tetorit 2010).*

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së shkeljes së supozuar të lirisë së lëvizjes së parashtruesve, të garantuar me nenin 35 (2) të Kushtetutës së

Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta). Sipas parashtruesve të kërkesës, atyre u është shkelur e drejta për t'u larguar nga vendi pasi u është refuzuar lëshimi i pasaportës, e cila kërkohet për të udhëtuar jashtë vendit. Parashtruesit më tej pohuan që në sistemin ligjor të Kosovës nuk ka mjete efektive juridike për ta ushtruar të drejtën e tyre për t'u larguar nga vendi.

4. Parashtruesit kanë paraqitur kërkesë për masa të përkohshme, përmes përfaqësuesit të tyre, për ta shmangur "diskriminimin e mëtejmë dhe shkeljen e të drejtës së qytetarëve për liri të lëvizjes me kushtëzimin e cilësdo procedurë penale në vazhdim e sipër."

Baza juridike

5. Këto kërkesa janë të bazuara në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullin 32 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Përmbledhja e fakteve

6. Parashtruesit i mbështesin kërkesat e tyre vetëm duke iu referuar dokumenteve të përmendura në kërkesën e parashtruar në Gjykatë.

Ankesat e parashtruesve të kërkesës

7. Parashtruesit ankohen se u është shkelur e drejta e tyre për liri të lëvizjes e garantuar me nenin 35 (2) të Kushtetutës. Ata pohojnë që Gjykata Komunale në Prishtinë në mënyrë të padrejtë dhe të gabueshme i ka interpretuar dispozitat e zbatueshme ligjore pasi

ka dështuar t'ua lëshonte certifikatën, e cila, siç pohohet, është dokument i domosdoshëm për Ministrinë e Punëve të Brendshme për të lëshuar pasaportë të Republikës së Kosovës.

8. Parashtruesit, gjithashtu ankohen se në Kosovë nuk ka mjete juridike që mund të përdoren për ta zgjidhur situatën e tyre. Prandaj, sipas tyre, ekziston nevoja për krijimin e një mekanizmi brenda shtetit për qytetarët e Kosovës që janë në të njëjtën situatë si ata për ta parandaluar shkeljen e mëtejme të së drejtës për lëshim të pasaportës.
9. Parashtruesit pohojnë që u është shkelur e drejta për liri të lëvizjes për shkak të zbatimit të gabuar të nenit 271(2) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), nenit 27.1, pika A, dhe nenit 28.2 të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit. Sipas parashtruesve, të dy ligjet parashikojnë që kufizimi i të drejtës për liri të lëvizjes, i shkaktuar nga refuzimi për lëshim të pasaportës, mund të vendoset vetëm për rastet në të cilat gjykata kompetente ka lëshuar vendim paraprak.

10. Parashtruesit, gjithashtu pohojnë që Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka kurrfarë baze juridike për t'ua privuar të drejtën e tyre kushtetuese në bazë të mungesës së certifikatës së lëshuar nga gjykata që një person nuk është nën hetime. Në parim, sipas tyre, kufizimi i vendosur në të drejtën e tyre për liri të lëvizjes nuk është i bazuar në ligj, por është çështje e interpretimit të gabuar të ligjeve dhe e praktikës, përfshirë këtu keqinterpretimin e një memorandumi të mirëkuptimit, të 21 gushtit 2008, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë.

11. Në fund, parashtruesit kërkuan caktimin e masës së përkohshme "për ta shmangur diskriminimin e mëtejmë dhe shkeljen e të drejtës së qytetarëve për liri të lëvizjes me kushtëzimin e cilësdo procedurë penale në vazhdim e sipër".

Përmbledhja e procedurës në Gjykatë

12. Parashtruesit i parashtruan kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese më 5 shkurt 2010.

13. Më 19 shkurt 2010, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 06/10, e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 06/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.

14. Më 25 mars 2011, në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI 06/10, të 30 tetorit 2010, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesit që ta njoftonin Gjykatën Kushtetuese nëse i kanë marrë pasaportat.

15. Më 6 prill 2011, përfaqësuesi ligjor i parashtruesve e njoftoi Gjykatën Kushtetuese se pas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, KI 06/10, parashtruesve u ishin lëshuar pasaportat.

16. Parashtruesit e njoftuan Gjykatën Kushtetuese se kërkesa e tyre ishte realizuar.

17. Më 16 maj 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për heqje të kërkesës nga lista.

Vlerësimi i Gjykatës

18. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara në rregullin 32 të Rregullores së punës.

19. Rregulli 32 i Rregullores së punës, në pjesën përkatëse, thotë me sa vijon:

1) Pala mund të tërheqë kërkesën ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.

(2) Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë në lidhje me të.

(3) Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në kërkesë, përgjigjet e parashtruara dhe çfarëdo dokumentesh të bashkëngjitura asaj.

(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme ose që nuk përfaqësojnë një rast ose kontest.

20. Për shkak të arsyeve të sipërpërmendura, shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës ndërpritet dhe Gjykata konstaton që nuk ka rrethana të posaçme lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut të cilat do të kërkonin shqyrtim të mëtejshëm të kërkesës (shih *mutatis mutandis*, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në Rastin Rafet Hoxha KI 24/09, të 24 marsit 2010).

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 32 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOS

I. TA HEQË kërkesën nga lista.

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu, Prof. Dr. Enver Hasani

KI 30/09 datë 15 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. Nr. 1360/08, të 19 qershorit 2009.

Rasti KI 30/09, vendim i 30 janarit 2012

Fjalët kyçe:drejtoria për ekonomi dhe financa, drejtoria për çështje pronësore juridike, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, shkelje e lirive dhe të drejtave individuale, shpronësimi i tokës.

Parashtruesit paraqitën kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tyre kushtetuese janë cenuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me ç'rast miratoi Vendimin e Drejtorisë për çështje pronësore juridike të komunës së Gjakovës lidhur me kërkesën e parashtruesve për kthim të pronës. Parashtruesit pohuan se Gjykata Supreme ka cenuar të drejtat e tyre të garantuara me nenet 24 dhe 29 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe nenin 1 të protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut.Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesve ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 56 të Rregullores së Punës për shkak se parashtruesit nuk kishin paraqitur fakte që në ndonjë mënyrë arsyetonin pohimet për shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese. Gjykata vendimin e saj e arsyetoi duke përsëritur se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Duke cituar vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë,* Gjykata më tutje arsyetoi se pas shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesit nuk vëren ndonjë indikacion se procedurat në tërësi kanë qenë të padrejta apo të prekuara nga arbitrariteti, dhe se Gjykata Supreme kishte dhënë arsye të mjaftueshme se përse ankesat e parashtruesve ishin të pabazuara. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesve si të papranueshme.

Prishtinë, më 10 janar 2012

Nr. ref.: RK 193/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 30/09

Parashtrues

Agim Iliaz Dyla dhe të tjerët

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. Nr. 1360/08, të 19 qershorit 2009.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues janë Agim Ilaz Dyla, Njazi Iliaz Dyla dhe Myrteza Iliaz Dyla, dy vëllezër e një motër, të cilët jetojnë në Gjakovë dhe e përfaqësojnë vetveten.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, A. Nr. 1360/08, i 19 qershorit 2009.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me kërkesën e parashtruesve për ta anuluar vendimin për shpronësim të pronës, që fillimisht ishte shpronësuar nga Komuna e Gjakovës në vitin 1969.

Baza juridike

4. Neni 113 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe neni 56 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesit e dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatë më 14 korrik 2009.

6. Më 29 janar 2010, në përputhje me nenin 22.2 të Ligjit dhe nenin 33.2 të Rregullores së punës, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës për përgjigje. Gjykata Supreme e Kosovës nuk ofroi përgjigje zyrtare për këtë kërkesë.

7. Më 15 qershor 2010, Gjyqtarja raportuese, Gjyljeta Mushkolaj, ia paraqiti raportin e vet Kolegjit shqyrtues, i cili përbëhej nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

Përmbledhje e fakteve

8. Më 11 qershor 1969, Komuna e Gjakovës, me Vendimin numër 03-477-1-1069 të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, ia shpronësoi babait të parashtruesve ngastrat kadastrale Nr. 4350/1 dhe 4350/2. Ngastrat ishin shpronësuar në përputhje me nevojat e ndërmarrjes shoqërore "Sektori për shërbime dhe meremetime "Kompresor" - Gjakova".

9. Më 9 prill 2003, parashtruesit dorëzuan një kërkesë në qeverinë komunale të Gjakovës, me të cilën kërkonin anulimin e Vendimit 03-477-1-1069, të 11 qershorit 1969.

10. Pasi nuk e kishin marrë vendimin e Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, më 5 korrik 2005, parashtruesit dorëzuan edhe një kërkesë tjetër në Drejtori për vazhdimin e procedurës.

11. Në një datë të paraportuar, Drejtoria e shpalli veten jokompetente për t'u marrë me këtë çështje dhe ia dërgoi lëndën Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. Megjithatë, pretendohet që Dhoma e Posaçme kurrë nuk e ka marrë lëndën.

12. Parashtruesit dorëzuan edhe një ankesë tjetër për heshtjen administrative të Drejtorisë. Si rrjedhojë, Agjencia Kadastrale e Kosovës nxori Konkluzionin Nr. 421/07, të 17 korrikut 2007, me të cilin e urdhëroi Drejtorinë që ta shqyrtonte këtë çështje brenda 15 ditëve nga Konkluzioni.

13. Më 11 shtator 2008, Drejtoria për çështje pronësore juridike e Komunës së Gjakovës nxori Vendimin Nr. 11-465-6/03-08, me të cilin e refuzoi kërkesën e parashtruesve për kthim të pronës.

14. Parashtruesit u ankuan kundër këtij vendimi në qeverinë komunale të Gjakovës dhe, më 5 nëntor 2008, kryetari i Komunës së Gjakovës nxori Vendimin Nr. 11-465-06/08-08, me të cilin e refuzoi kërkesën për ankesë.

15. Parashtruesit më pas paraqitën ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Më 19 qershor 2009, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin A. Nr. 1360/08, me të cilin e miratoi Vendimin e Drejtorisë për çështje pronësore juridike të Komunës së Gjakovës, Nr. 11-465-6/03-08, të 11 shtatorit 2009.

Pretendimet e parashtruesve

16. Parashtruesit ankohen se Vendimi Nr. 03-477/1-1969 i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa të Komunës së Gjakovës, e cila e shpronësoi tokën e kontestuar, ishte nxjerrë për interes afarist, e jo për interes publik. Parashtruesit pohojnë që interesi publik parashihej me ligj.

17. Parashtruesit gjithashtu pohojnë që Drejtoria për çështje pronësore juridike e Komunës së Gjakovës padrejtësisht e vonoi marrjen e vendimit për këtë çështje. Parashtruesit theksojnë se kjo vonesë përfshinte injorimin e afateve kohore të përcaktuara me ligj dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

18. Parashtruesit më tej pohojnë që qeveria komunale e Gjakovës dhe Gjykata Supreme e Kosovës gabimisht e kishin përcaktuar ligjin në fuqi lidhur me shpronësimet. Qeveria dhe Gjykata Supreme zbatuan Ligjin e Kosovës për shpronësim (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78), të ndryshuar me Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për shpronësim (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 46/86). Megjithatë, parashtruesit pohojnë që ligji në fuqi ishte Ligji i Serbisë për shpronësim.

19. Për këto arsye, parashtruesit pohojnë që Vendimi A. Nr. 1360/08, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i shkeli nenet 24 dhe 29 të Kushtetutës, dhe nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, që është i përfshirë në Kushtetutë përmes nenit 22.2.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme

20. Në Aktgjykimin e vet A. Nr. 1360/08, të 19 qershorit 2009, Gjykata Supreme e Kosovës i konsideroi pohimet e parashtruesve si të pabazuara. Gjykata Supreme konstatoi që dosja e lëndës qartazi tregonte se shpronësimi ishte bërë për nevoja të ndërmarrjes shoqërore, e jo për nevoja të afarizmit privat. Gjykata Supreme më tej theksoi se parashtruesit dështuan t'i verifikonin pretendimet e tyre.

21. Gjykata Supreme gjithashtu theksoi në Aktgjykimin e vet se kërkesa e parashtruesve për kthim të pronës ishte e parashkruar, sepse sipas Ligjit për shpronësim (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 21/78), Vendimi për shpronësim Nr. 03-477/1-1969 u bë përfundimtar në vitin 1969. Neni 21.4 i ligjit të sipërpërmendur thotë që vendimi përfundimtar për

shpronësim mund të anulohet nëse pala shpronësuese nuk e ka kryer ndërtimin/zhvillimin e objektit të parapërcaktuar, nëse pronari i mëparshëm i pronës së shpronësuar paraqet kërkesë përkatëse brenda tri vjetëve nga momenti kur vendimi për shpronësim është bërë përfundimtar.

22. Neni 21.5 më tej përcakton që asnjë kërkesë për anulim të një vendimi të tillë nuk mund të paraqitet pasi të kenë kaluar 10 vjet nga data kur vendimi për shpronësim të jetë bërë përfundimtar.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

24. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87*,* e miratuar më 10 korrik 1991).

25. Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesit, Gjykata Kushtetuese nuk gjen ndonjë indikacion që procedurat kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Kërkesa Nr. 53363/99, Vendim i GJEDNJ-së, i 31 majit 2005). Gjykata Supreme dha

arsye të mjaftueshme se përse ankesat e parashtruesit ishin të pabazuara dhe të parashkruara. Prandaj, rezulton që kjo kërkesë është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë.

26. Përfundimisht, sa i përket çështjes së kthimit të pronës, Gjykata Kushtetuese i referohet Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Aneksi XII i Marrëveshjes, në nenin 2 (Legjislacioni që zyrtarisht duhet të miratohet gjatë ose pas periudhës së tranzicionit), kërkon që Kuvendi ta miratojë "si çështje parësore pas përfundimit të periudhës së tranzicionit..." ndër të tjera, një "Ligj për kthimin e pronës" (neni 12.3).

27. Gjykata gjithashtu dëshiron të theksojë se vetë Kushtetuta e Kosovës, në nenin 143.3, përcakton se *"Kushtetuta ... do të interpretohet në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës..."* Prandaj, edhe mbrojtja e pronës, e garantuar me nenin 46, gjithashtu duhet të interpretohet nga Gjykata në pajtueshmëri me Marrëveshjen.

28. Përveç kësaj, neni 143.1 i Kushtetutës përcakton që *"Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës..."*

29. Sa i përket çështjes së kthimit të pronës, këto dispozita nënkuptojnë, ndër të tjera, që Kuvendi i Kosovës ka për obligim, si çështje parësore pas përfundimit të periudhës së tranzicionit (d.m.th. menjëherë pas 26 korrikut 2007), ta miratojë një "Ligj për kthim të pronës". Megjithatë, Gjykata vëren që Kuvendi i Kosovës nuk ka miratuar një ligj të tillë deri më tani.

30. Gjykata gjithashtu vëren që në Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin e trashëgimtarëve Ymer Loxha dhe Sehit Loxha, KI 14/09, të 15 tetorit 2010, ajo ua rikujtoi autoriteteve të Republikës së Kosovës obligimin e tyre *"për ta themeluar një mekanizëm të pavarur për ta formuluar kornizën politike, ligjore dhe institucionale për shqyrtimin e çështjeve të kthimit të pronës, siç kërkohet me Aneksin VII, nenin 6.1 të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e*

Statusit të Kosovës, dhe Kuvendit për ta miratuar një ligj për kthim të pronës, në pajtim me nenin 143 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 2.13 të Aneksit XII të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës".

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe nenit 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, me shumicë votash

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t"u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Dr. Gjyljeta Mushkolaj Prof. Dr. Enver Hasani

KI 03/11 datë 6 mars 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Marrëveshjes për Bashkëpunim midis Zyrës së Prokurorit të Shtetit dhe Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit.

Rasti KI 03/11, Marrëveshja për Bashkëpunim midis Zyrës së Prokurorit të Shtetit dhe Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit.

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, palë e paautorizuar , Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi pretendon se me vendimin e kontestuar në Gjykatën Kushtetuese është shkelur neni 109, pika 2 dhe 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
Gjykata konstaton që kërkesa është e papranueshme.

Prishtinë, më 30 Janar 2012

Nr.ref.:RK195/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 03/11

Parashtruesi

Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet "ÇOHU" e

përfaqësuar nga z. Arton Demhasaj me autorizim të organizatës.

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Marrëveshjes për Bashkëpunim midis Zyrës së Prokurorit të Shtetit dhe Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet **"ÇOHU"**, të cilën e përfaqëson z. Arton Demhasaj.

Objekti i çështjes

2. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës me 11 janar 2011, siç është cekur në kërkesë, është : "Vlerësimi i Konfliktit" që përmban Marrëveshja për Bashkëpunim midis Zyrës së Prokurorit të Shtetit dhe Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

4. Më 11 janar 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

5. Më 4 mars 2011, Gjykata Kushtetuese informoi Prokurorin e Shtetit dhe Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit për dorëzimin e kërkesës dhe kërkoi nëse ata kanë ndonjë koment që do të konsiderohej interesante për t'u shqyrtuar nga Gjykata sa i përket çështjes.

6. Më 23 mars 2011, Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit i dërgoi përgjigje me shkrim Gjykatës Kushtetuese duke sqaruar qëndrimin e saj lidhur me kërkesën.

7. Më 19 mars 2011, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Kadri Kryeziu (kryesues), Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, Robert Carolan, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 4 qershor 2010, Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit dhe Zyra e Prokurorit të Shtetit e Kosovës kanë nënshkruar **Marrëveshjen për Bashkëpunim** me anë të së cilës krijojnë raporte të partneritetit në luftimin e korrupsionit përmes:

   a. Shkëmbimit të informacioneve lidhur me korrupsionin;

   b. Bashkëpunimit në hetimin e rasteve që rezultojnë me veprime kriminale të korrupsionit;

   c. Ndihmës së ndërsjellë dhe asistencës teknike në proceset hetimore; dhe

   d. Ofrimit të këshillave të ndërsjella në zgjidhjen e problemeve të ndryshme që kanë të bëjnë me luftimin e korrupsionit.

9. Më 5 tetor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës me shkresën Agj. nr. 646/2010 ka njoftuar Agjencinë Kosovare Kundër Korrupsionit se kjo Gjykatë nuk është kompetente të japë mendime juridike lidhur me marrëveshjen e nënshkruar në mes të këtyre dy institucioneve, dhe se për këtë çështje, Organizata "ÇOHU" eventualisht mund t`i drejtohet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

10. Më 11 janar 2011, Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet **"ÇOHU",** përmes parashtruesit ka paraqitur ankesë në Gjykatën Kushtetuese duke kontestuar këtë marrëveshje si jokushtetuese dhe në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale në Kosovë.

Shkeljet e pretenduara të drejtave të garantuara kushtetuese

11. Parashtruesi pretendon se me vendimin e kontestuar në Gjykatën Kushtetuese është shkelur neni 109, pika 2 dhe 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

12. Parashtruesi i ankesës ka pohuar se Zyra e Prokurorit të Shtetit dhe Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit, më 4 qershor 2010, kanë nënshkruar një "**Marrëveshje bashkëpunimi"** dhe se pikat 5 dhe 6 të kësaj marrëveshjeje bien në kundërshtim direkt me nenet 220, 221, 256 dhe 258 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Komentet e Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit

13. Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit në përgjigjen e vet me shkrim ka theksuar se asnjë nga pikat e marrëveshjes së Zyrës së Prokurorit të Shtetit nuk cenon dispozitat kushtetuese të

institucioneve të pavarura, si dhe janë brenda kornizave të ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Vlerësimi i papranueshmërisë

14. Për të qenë në gjendje për të gjykuar lidhur me kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala parashtruese i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë dhe lidhur me këtë i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, ku thuhet:

"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."

Dhe nenit 113.7 lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës, ku thuhet:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Përkatësisht:

'Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".

15. Gjatë shqyrtimit të kësaj kërkese, Gjykata gjithashtu ka parasysh nenin 46 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të

Republikës së Kosovës, i cili lidhur me kërkesat individuale përcakton:

*"Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar **të gjitha** kushtet e përcaktuara ligjore".*

16. Duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lëndë nga ana e parashtruesit të kërkesës duket se ai **nuk ka përmbushur** kërkesat themelore të nenit 113.1 të Kushtetutës sa i përket shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga "**pala e autorizuar".**

17. Sikur që u theksua edhe ne paragrafin 10 të këtij raporti, në përputhje me nenin 117.7 të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet kundër autoriteteve publike kur ato shkelin të drejtat dhe liritë e tyre individuale të garantuara me Kushtetutë, por nuk janë të autorizuar të ngrenë shkeljet eventuale të shkaktuara me akt të ndonjë autoriteti publik në emër të personave të tjerë, dhe gjithashtu nuk janë të autorizuar të kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, sepse Kushtetuta e Kosovës këtë të drejtë ua ka përcaktuar vetëm personave të autorizuar dhe nuk njeh institutin juridik të ***Actio Popularis*.**

18. Për pasojë, parashtruesit të kërkesës duket se i ka munguar legjitimiteti aktiv për të ngritur këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese, përkatësisht ka pasur mungesë të *locus standi* që për pasojë Gjykata do të duhej ta deklarojë si të papranueshme (*shih mutatis mutandis* Konventa (Municipal Section of Antilly v. France (dec.), nr. 45129/98, KEDLNJ 1999-VIII*).*

19. Për më tepër, Gjykata vëren se edhe sikur kërkesa e parashtruesit të trajtohej si kërkesë "individuale" sipas nenit 113.7 lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtruesi i saj nuk ka qenë në gjendje të argumentojë "**statusin e viktimës të shkaktuar me aktin e autoritetit publik"** sikur është

paraparë me nenin 34 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (shih *mutatis mutandis* *Lindsay kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 31699/96, Vendimi i Komisionit të 17 janarit 1997, 23 E.H.R.R. *Agrotexim dhe të tjerët v. Greqisë*, Aktgjykimi i 24 tetorit 1995, Seria A nr. 330-A, pp. 22-26, §§ 59-72; *Terem Ltd, Chechetkin dhe Olius v. Ukraine*, nr. 70297/01, § 28, 18 tetor 2005; *Veselá dhe Loyka v. Slovakisë*(dec.), nr. 54811/00, 13 dhjetor 2005);

20. Duke marrë parasysh faktin se kërkesa është dorëzuar nga një palë e autorizuar, duke pasur në mendje se parashtruesi, veçanërisht, thekson mospërputhshmërinë e memorandumit të mirëkuptimit në mes të dy palëve nënshkruese me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, pra kërkon vlerësimin e përputhshmërisë së një akti juridik me Ligjin dhe jo me Kushtetutën, e duke marrë parasysh nenin 112.1 të Kushtetutës ku saktësisht thuhet: ***"Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën",*** është e qartë se kërkesa e organizatës 'Çohu", në formën si është parashtruar, nuk përbën një çështje kushtetuese të përshtatshme për t'u shqyrtuar nga kjo Gjykatë, prandaj duke u bazuar në këtë duhet të refuzohet.

21. Të njëjtin argument Gjykata Kushtetuese e ka përdorur në Rastin 44/10 (Gafurr Podvorica kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Aktvendimi për papranueshmëri i datës 18 mars 2001).

22. Bazuar në faktet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se kjo kërkesë është paraqitur nga një palë e paautorizuar dhe nuk i ka përmbushur kriteret e domosdoshme, prandaj:

PËR KËTË ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe rregullin 36 paragrafi 3 (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 19 maj 2011, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË poshtë kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Prof. Dr. Enver Hasani

KI 43/09 datë 10 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Protokollit për Bashkëpunim Policor në mes të Misionit Evropian për Drejtësi dhe Sundim të Ligjit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë, të datës 11 shtator 2009

Lënda Kl 43/09 e 11 majit 2011,
Fjalët kyçe; kërkesë individuale, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Protokollit për Bashkëpunim Policor

Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese së Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009.
Kryetari i Gjykatës e emëroi gjyqtarin Čukalović Gjyqtar raportues si dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Iliriana Islami.

Më 25 shtator 2009, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën Kushtetuese.
Parashtruesi i kërkesës vlerëson se Protokolli për Bashkëpunim Policor është në kundërshtim me nenet 18 (1), 63, 65 (12) dhe 93 (1) të Kushtetutës.
Në kërkesën e tij, parashtruesi i ka ngritur disa shqetësime në lidhje me respektimin dhe ushtrimin e sovranitetit nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe konsideron se një interpretim nga ana e Gjykatës Kushtetuese do të ishte i nevojshëm në lidhje me Protokollin për Bashkëpunim Policor.
Gjykata shqyrtoi kërkesën e parashtruesi dhe në të njëjtën kohë ceku se Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh *actio popularis*. Me fjalë të tjera, parashtruesi i kërkesës nuk mund të ankohet në mënyrë abstrakte për masat e autoriteteve publike që nuk janë zbatuar personalisht ndaj tij, siç është ky rast para kësaj Gjykate.
Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur aktualisht drejtpërdrejt nga një autoritet publik (shih: Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99 të datës 31 maj 2005).

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të

Kushtetutës, nenin 46, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullave 36. (1a) dhe 36. (3c) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 11 maj 2011 njëzëri vendosi ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

Prishtinë, më 01. shkurt 2012

Nr. ref: RK.197/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 43/09

Parashtruesi

Lëvizja FOL

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Protokollit për Bashkëpunim Policor në mes të Misionit Evropian për Drejtësi dhe Sundim të Ligjit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë, të datës 11 shtator 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Lëvizja Fol, një OJQ e pavarur me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson Ramadan Ilazi (drejtor ekzekutiv).

Akti i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Protokollit për Bashkëpunim Policor të nënshkruar midis Misionit Evropian për Drejtësi dhe Sundim të Ligjit (në tekstin e

mëtejmë: EULEX) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë, më 11 shtator 2009.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese të bëjë interpretimin e nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili parashikon se "Kuvendi është institucioni ligjvënës i Republikës së Kosovës...", kundrejt nënshkrimit të njëanshëm të Protokollit të lartpërmendur nga ana e EULEX-it.

4. Parashtruesi i kërkesës konsideron se nënshkrimi i njëanshëm i protokollit të lartpërmendur nga EULEX-i paraqet shkelje të neneve 18.1, 65.12 dhe nenit 93.1 të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës; neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 36 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

6. Më 25 shtator 2009, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

7. Më 2 tetor 2009, Gjykata i dërgoi parashtruesit të kërkesës një njoftim dhe i sugjeroi që të dorëzonte formularin e kërkesës.

8. Rrjedhimisht, sekretariati e regjistroi kërkesën e parashtruesit me nr. KI 43/09.

9. Më 31 maj 2010, parashtruesi i kërkesës e dërgoi përgjigjen e tij në shkresën e datës 2 tetor 2009 në të cilën theksonte se kërkesa e tyre nuk do të thoshte se "Lëvizja FOL do të jetë palë dhe se do të plotësonte procedurat administrative në mënyrë që kërkesa të shqyrtohej si një rast i rregullt". Në të njëjtën kohë, parashtruesi i kërkesës e ritheksoi interesimin e tij që Gjykata Kushtetuese të japë mendimin e saj në lidhje me nënshkrimin e protokollit të lartpërmendur.

10. Kryetari i Gjykatës e emëroi gjyqtarin Čukalović Gjyqtar raportues si dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), dhe gjyqtarët Kadri Kryeziu dhe Iliriana Islami.

11. Më 16 maj 2011, pasi e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 11 shtator 2009, u nënshkrua Protokolli për Bashkëpunim Policor në mes të EULEX-it dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës vlerëson se Protokolli për Bashkëpunim Policor është në kundërshtim me nenet 18.1, 63, 65.12 dhe 93.1 të Kushtetutës.

14. Në kërkesën e tij, parashtruesi i ka ngritur disa shqetësime në lidhje me respektimin dhe ushtrimin e sovranitetit nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe konsideron se një interpretim nga ana e Gjykatës Kushtetuese do të ishte i nevojshëm në lidhje me Protokollin për Bashkëpunim Policor.

15. Parashtruesi bën me dije se implementimi i Protokollit për Bashkëpunim Policor është i pamundur pa përfshirjen e institucioneve të Kosovës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

17. Në kërkesën e tij parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 113.7 dhe nenit 32 të Kushtetutës.
Neni 113.7 i Kushtetutës parashikon si në vijim:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

18. Për më tepër, neni 32 i Kushtetutës thotë:

"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj."

19. Në bazë të parashtresave të parashtruesit të kërkesës duket se, përderisa nuk e konsiderojnë vetveten palë në procedurat para Gjykatës Kushtetuese, ata me kohë kanë theksuar interesimin e tyre që Gjykata Kushtetuese të japë mendimin e saj në lidhje me nënshkrimin e protokollit të lartpërmendur.

20. Në këtë drejtim, duhet të sillet ndër mend neni 48 i Ligjit, i cili përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."

21. Për qëllimet e Kushtetutës, viktimë konsiderohet personi fizik ose juridik (shih rastin Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K, Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, rasti Nr. KI. 41 /09) të drejtat kushtetuese të të cilit janë prekur personalisht apo drejtpërdrejtë nga një masë apo akt i autoriteteve publike.

22. Një person i cili nuk preket në këtë mënyrë nuk e ka statusin e viktimës pasi që Kushtetuta nuk parasheh *actio popularis*. Me fjalë të tjera, një parashtrues kërkese nuk mund të ankohet në mënyrë abstrakte për masat e autoriteteve publike që nuk janë zbatuar personalisht ndaj tij, siç është ky rast para kësaj Gjykate.

23. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur apo janë duke u shkelur aktualisht drejtpërdrejt nga një autoritet publik (shih Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të datës 31 maj 2005).

24. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar dhe kërkesa duhet hedhur poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së Punës,

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

II. Vendimi do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. Dr. Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KI 107/11 datë 06 mars 2012- Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr 293/ 2010 të datës 23.03.2011

Rasti KI 107/11, vendimi i datës 7 shkurt 2012

Fjalët kyçe; e drejta në punë, kërkesë individuale, shpërblim i drejtë, qartazi e pabazuar

Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pretenduar se me vendimin e Gjykatës se Qarkut ne Prizren Ac. nr 293/2010, datë 23 mars 2011, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë neni 49 i Kushtetutës (e drejta në punë dhe zgjedhja e profesionit) dhe neni 41 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (shpërblim i drejtë).

Parashtruesi kërkon vlerësim të Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr 293/ 2010 të datës 23.03.2011, me të cilin kjo gjykatë kishte refuzuar propozimin e përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës drejtuar kësaj Gjykate për përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.423/2004 të datës 23.11.2004, e të ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës rev.nr.31/2007 të datës 14.06.2007.

Duke vendosur për kërkesën e parashtruesit, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk gjeti elemente të arbitraritetit dhe as shkelje të supozuar të drejtave të njeriut sikur që parashtruesit e kërkesës kishin pretenduar.

Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se në perputhje me Rregullin 36 paragrafi 2 pika (c dhe d) të Rregullorës së Punës kërkesa është qartazi e pabazuar.

Prishtinë, më 7 shkurt 2012

Nr. ref.: RK 200/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMERI

në

Rastin nr. KI 107/11

Parashtruesi

Hamzi Bylykbashi

e të tjerët

Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr 293/ 2010 të datës 23.03.2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e Kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Hamzi Bylykbashi, Ferat Kuqi, Nasibe Llapatinca, Sadri Abazi, Abaz Demiri, Shaban Basha, Tahir Gashi, Asbije Gashi, Sali Bytyqi, Hajrije Sallani,Gani Musliu, Xhemali Jahaj, Halil Durmishi, Igballe Koigeci, Hamdi Palushi, Baftijar Hoxha, Shaban Tahiri, Mahmut Kadolli, Hysen Muqaj, Haki Baraliu, Hazir Bytyqi, Sinan Hajdari, Ramadan Sallahu, Ibrahim Berisha, Sahit Basha, Ismet Vranovci, Shefka Avdija, Sali Morina, Mexhit Baraliu, Xhemajl Kuqi, Mahmut Alijaj, Zenel Krasniqi, dhe Aziz Bukoshi, te gjithë ish punetore te K.K. Suhareke te cilët me autorizim i përfaqëson Ethem Rogova, avokat . nga Prizreni

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutën e Kosovës është Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, **Ac.nr 293/**

2010 të datës 23.03.2011 të cilin përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës sipas kopjes së nënshkruar të fletëkthesës së Gjykatës Komunale në Suharekë e cila ka bërë dorëzimin e tij ,**e ka pranuar më 01.04,2011.**

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së regjistruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës me date 08. Gusht 2011 është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr 293/ 2010 të datës 23.03.2011
Me të cilin kjo gjykatë kishte refuzuar propozimin e përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës drejtuar kësaj Gjykate për përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.423/2004 të datës 23.11.2004 e të ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës rev.nr.31/2007 të datës 14.06.2007.

Baza juridike

4. Neni 113.7 Kushtetutës së Republikës së Kosovës(në te tekstin e mëtejmë Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i dt. 16 Dhjetor 2009 i hyrë në fuqi me 15 janar 2010(në tekstin e mëtejmë referuar si Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë i referuar si rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtuese

5. Më 15. korrik 2011 Gjykata Kushtuese pranoj nëpërmes postës një shkresë të cilës i ishin bashkangjitur edhe vendimet a autoriteteve publike që kontestoheshin ,e me anë të së cilës kërkohej që Gjykata Kushtetuese të vlerësoj kushtetutshmërinë e Aktgjykimit Ac.nr 293/ 2010 të datës 23.03.2011 të Gjykatës së Qarkut në Prizren

6. Më 22 korrik Gjykata Kushtetuese i dërgoj një njoftim përfaqësuesit të autorizuar të parashtruesve të kërkesës avokatit z. Ethem Rugova me anë të cilit Gjykata kërkoj që në aftin e dhënë në njoftim të plotësoj kërkesën duke plotësuar edhe formularin zyrtar për dorëzimin e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese.

7. Më 28 korrik 2011 ,brenda afatit të dhënë nga Gjykata,zRugova i dërgoj përgjigjeje Gjykatës Kushtetuese lidhur me kërkesën e bërë dhe kërkoj sqarime shtesë se ku mund ta marrë formularin zyrtar.

8. Më 4 gusht 2011 Gjykata Kushtetuese kishte pranuar nëpërmes postës kërkesën e përsëritur nga Avokati Ethem Rugova kësaj radhe edhe me formularin zyrtar të plotësuar dhe të gjitha kopjet e vendimeve të autoriteteve publike të cilat kanë të bëjnë me rastin.

9. Më 8 gusht 2011 kërkesa e z. Parashtruesve i u regjistrua në Departamentin përkatës të Gjykatës Kushtetuese dhe mori numrin KI 107/11

10. Më 8 gusht 2011 pra të njëjtën ditë Gjykata Kushtetuese dërgoj njoftimin për regjistrimin e kërkesës palëve të përfshira në

lëndë dhe njëkohësisht nga përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës kërkoj që kërkesën ta plotësoj me autorizimin me shkrim për përfaqësim dhe kopjet e lejeve të njoftimit për personat që përfaqësohen.

11. Më 22 gusht 2011 Gjykata Kushtetuese pranoi nga avokati Rugova dokumentacionin plotësues të kërkuar.

12. Më 23 gusht Kryetari i Gjykatës me vendimin Gjr,KI 107/11 caktoj gjyqtarin Robert Carolan i cili do të përpiloj raportin paraprak lidhur me kërkesën.

13. Të njëjtën ditë Kryetrari i Gjykatës me vendimin KSH-KI 107/11, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje Ivan Cukalovic(kryesues) dhe gjyqtarët Mr.sc.Kadri Kryeziu e Prof.Dr.Enver Hasani, në cilësi të anëtarëve të kolegjit

14. Më 17 nëntor Gjykata Kushtetuese kishte pranuar nëpërmes faksit zyrtar nga Gjykata Komunale në Suharekë kopjen e fletëdorzimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr 293/ 2010 të datës 23.03.2011 nga i cili vërtetohej se z.Hamzi Bylykbashi i pari nga lista e ankuesve i cili ka edhe autorizim për përfaqësim nga kolegët e tij ,këtë vendim e ka pranuar më 01.042011.

Përmbledhja e fakteve

15. Në vitin 2001(data e pa specifikuar) Kryeshefi Ekzekutiv i Komunës së Suharekës ka bërë publike qarkoren të cilën ua ka drejtuar të gjithë të punësuarve në shërbimin civil komunal(administrata komunale)në formë të ofertës për pensionim vullnetar të gjithë atyre që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me qarkore e që janë mosha së paku 45 vjeçare dhe

së paku 15 vjet shërbimi (përvojë pune).Pensioni vullnetar do të kompensohej me mjete materiale në shumën prej një rroge mujore për secilin vit shërbimi dhe nuk do të kalonte shumën e përgjithshme prej 8000 DM.

16. Në qarkore specifikohej se kjo ofertë bëhet me qëllim të ofrimit të një pako ndihme materiale për ata që do të largohen nga puna në Komunë,sepse në bazë të rekomandimit të Komisionit për reformën e administratës publike si dhe vendimit të Asamblesë Komunale të Suharekës "numri i punëtorëve në Administratën Komunale duhet të zvogëlohet".Ndërsa aplikimi për pensionin e ofruar është në baza vullnetare.

17. Pas afatit të lënë sipas qarkores ,kësaj ofertë të Kryeshefit ekzekutiv i janë përgjigjur një numër i madh i të punësuarve që i plotësonin kushtet e kërkuara ndërsa komuna iu ka zgjedhur zyrtarisht " për pensionin vullnetar" 33 aplikuesit më të denjë e që tani janë parashtrues të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

18. Sipas dokumentacionit të paraqitur në lëndë të gjithë punëtorët të cilëve u është njohur e drejta për pension vullnetar kanë **marrë Aktvendimet me shkrim për shkëputjen e marrëdhënies së punës me marrëveshj**e në të cilat janë specifikuar edhe data e shkëputjes së marrëdhënies së Punës edhe Kompensimi material që ju takon. Të gjithë të punësuarit i kishin pranuar këtë aktvendime dhe i kishin nënshkruar ato,ndërsa në cilësi të provës së bashku me kërkesën në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur edhe Aktvendimi(si në kopje që i kishin edhe të tjerët) 02.nr 334 i dt.30.07.2001 për punëtorin z.Sadri Abazi në të cilin ishte dhënë edhe dhe këshilla juridike që pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

19. Më 22.12.2003 Gjykata Komunale në Suharekë duke vepruar sipas ankesës së 33 ish punëtorëve të administratës Komunale të Komunës së Suharekës ka nxjerrë Aktgjykimin C.nr.159/03 me të cilin ka Refuzuar kërkesëpadinë e paditësve në tërësi **si**

të pabazuar ,dhe në arsyetimin e këtij Aktgjykimi thuhet se jo bazushmëria e tij mbështetet në faktin se të gjithë punëtorët kanë nënshkruar Aktvendimet për shkëputjen e marrëdhënies së punës me marrëveshje ,se kanë marrë kompensimin sipas aktvendimeve dhe se edhe pse kanë pasur në dispozicion mjetin juridik të ankesës atë nuk e kanë shfrytëzuar andaj këto aktvendime janë të plotfuqishme.

20. Kundër këtij Aktgjykimi në afat ligjor i autorizuari i paditësve ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

21. Më 23.06.2004 Gjykata e Qarkut në Prizren ka nxjerrë Aktgjykimin Ac.42/2004 me anë të së cilit është **Aprovuar** ankesa e të autorizuarit të paditësve (Hamzi Bylykbashi dhe 32 të tjerë),është prishur Aktgjykimi C.nr.159/03 i datës 22.12.2003 dhe lënda i është kthyer Gjykatës Komunale në Suharekë për rivendosje. Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet se Gjykata e shkallës së parë Aktgjykimin e vet e ka bazuar në përcaktimin e gjendjes faktike të gabuar dhe jo të plotë si dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale andaj domosdo është dashur të prishet nga gjykata e shkallës së dytë

22. Më 23 11.2004 Gjykata Komunale në Suharekë ,duke marrë parasysh Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në procedurën e përsëritur ka nxjerrë Aktgjykimin C. nr.423/04 dhe ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve njëkohësisht ka anuluar të gjitha aktvendimet për shkëputjen e marrëdhënies së punës sipas marrëveshjes ,duke obliguar të padituren Komunën e Suharekës që paditësit në afat prej 15 ditësh ti kthejë në vendet e tyre të punës apo në një vend të punës sipas kualifikimeve që posedojnë.

23. Kundër këtij Aktgjykimi Komuna e Suharekës ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

24. Më 10.11.2006 Gjykata e Qarkut në Prizren ka nxjerrë Aktgjykimin Ac.nr 30/2005 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të padituresë –Komuna e Prizrenit dhe ka **Vërtetuar** A aktgjykimin C.nr.423/2004 të datës 23.11.2004,të Gjykatës Komunale në Suharekë duke konstatuar

se Aktgjykimi i Shkallës së parë ka vërtetuar plotësisht drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe ka aplikuar drejt dispozitat materiale.

25. Kundër këtij Aktgjykimi ,Komuna e Suharekës ka paraqitur kërkesë për Revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

26. Më 14.06.2007 ,Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Aktgjykimin rev.nr 31/2007 me të cilin ka PRANUAR revizionin e të Padituërs –Komuna e Suharekës dhe ka **ndryshuar ,**Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.30/2005 ,dt.10.11.2006 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.423/2004 .dt.23.11.2004 në mënyrë që padia e paditësve në këtë çështje juridike HIDHET POSHTË si e **pakohshme.**

27. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi Gjykata Supreme ka theksuar se gjykatat e instancave më të ulëta "Mbi gjendjen faktike të konstatuar drejt dhe në mënyrë të plotë ,gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale kurë kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar për të cilën arsye u desh që të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që padia e paditësve të hidhet si e pakohshme"

28. Gjykata Supreme më tej në arsyetimin e Aktgjykimit rev.nr 31/2007 përcakton se Aktgjykimi i saj bazohet në faktin se në ligjin e aplikueshëm në kohën kurë ka ndodhur kontesti(ligji mbi Administratën Shtetërore i Kosovës gaz,zyr 30/80)kishte paraparë me nenin 213 se afati për ankim në organin e shkallës së dytë është 15 ditë nga dita e marrjes së Aktvendimit dhe se pas marrjes së vendimit nga shkalla e dytë pala edhe më tej e pakënaqur në afat prej 30 ditësh ka të drejtë të i drejtohet gjykatës kompetente,ndërsa gjykata Supreme citon gjithashtu edhe Ligjin themelor për Marrëdhëniet te punës ,gjithashtu ligj i aplikueshëm në Kosovë i cili në nenin 83.par.2 kishte paraparë se "mbrojtja gjyqësore para gjykatës nuk mund të kërkohet nëqofëtse punëtori paraprakisht nuk ka kërkuar mbrojtje para organit kompetent të punëdhënësit" andaj duke marrë parasysh fatin se punëtorët e Komunës s Suharekës nuk e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë edhe padia e tyre është e pakohshme.

29. Gjykata supreme gjithashtu ka theksuar se"objekt shqyrtimi në këtë kontest është ligjshmëria e aktvendimeve të së padituresë me të cilat paditësve iu është ndërprerë marrëdhënia e punës ,kundër të cilave paditësit nuk kanë kërkuar mbrojtje juridike sipas dispozitave ligjore të sipërpërmendura ,andaj gjykatat e shkallëve më të ulëta gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale kur kanë aprovuar padinë duke konstatuar se paditësi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë çështjet e pensionimit e në fakt aktvendimet e të padituresë nuk kanë të bëjnë me e pensionimin e paditësve por me shkëputjen e marrëdhënies së punës sipas marrëveshjes"(shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme rev . nr 31/2007 të datës 14 06 2007 faqe 3).

30. Ta pakënaqur me këtë Aktgjykim parashtruesit e kërkesës nëpërmes të autorizuarit të tyre avokatit Ethem Rugova kanë paraqitur **Kërkesë për përsëritjen e procedurës** në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

31. Më 21.03.2011 Gjykata e Qarkut në Prizren ka nxjerrë Aktvendimin Ac.nr.293/2010 me të cilin ka refuzuar kërkesën për përsëritjen e procedurës të përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.423/2004 të datës 23.11.2004 i ndryshuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.nr.31/2007 të datës 14.06.2007,duke konstatuar se nuk ekzistojnë fakte që do t ë justifikonin përsëritjen e procedurës .

Shkeljet e pretenduara të drejtave të garantuara Kushtetuese

32. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si në vijim:neni 49(e drejta e punës dhe zgjedhja e profesionit)neni 41 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. (shpërblimi i drejtë)

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Për te qene ne gjendje për te gjykuar mbi Kërkesën e Parashtruesit te kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht te vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë te cilat përcaktohen ne Kushtetute,ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës

34. Ne lidhje me ketë, Gjykata i referohet nenit 113.7 te Kushtetutës qe përcakton se:

*"Individët janë te autorizuar te ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike te drejtave dhe lirive te tyre individuale**, **te garantuara me Kushtetute**, mirëpo **vetëm** pasi te **kenë shteruar te gjitha mjetet juridike** te përcaktuara me ligj."*

Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese ku shprehimisht përcaktohet se:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën

kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi."

dhe

Rregullin 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartas e bazuar:

35. Duke iu referuar shkeljes së supozuar të së drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të Konventave e instrumenteve tjera Ndërkombëtare nga ana e parashtruesit të Kërkesës Gjykata Kushtetuese konstaton:

36. I autorizuari i parashtruesve të kërkesës nëpërmes postës, Gjykatës Kushtetuese i kishte dërguar me postë më 15.07.2011 një kërkesë të shkruar të cilës i kishte bashkangjitur edhe të gjitha Aktgjykimet dhe Aktvendimet e nevojshme ,ndërsa pas kërkesës së Gjykatës në afatin e dhënë nga Gjykata kishte plotësuar edhe lëndën me formën standarde të kërkesës ,andaj Gjykata konsideron se data e komunizmit të parë me Gjykatën 15.07.2011 e bënë kërkesën të pranueshme sa i përket afatit edhe pse ajo në Gjykatë si e plotë është regjistruar me 08 gusht 2011.

37. Në lidhje me këtë Gjykata Kushtetuese i referohet edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ ku në rastin Kemevuako v. Holandë (Aplikacioni Nr.65938/09 1 qershor 2010) kishte theksuar se" duhet si rregull i përgjithshëm të konsiderohet që të jetë datë e paraqitjes së një kërkese data e parë e komunikimit me Gjykatën nga aplikuesi-

madje edhe atëherë kur objekti i çështjes është shpjeguar shkurtimisht , me kusht që një formë krejtësisht e plotësuar aplikimi është paraqitur brenda afatit të caktuar nga Gjykata .

38. Gjykata gjithmonë ka parasysh faktin se qëllimi i rregullit katër-mujor është për të promovuar sigurinë juridike,të sigurojë që rastet e ngritura për e çështjet Kushtetuese do të ë shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme dhe për të mbrojtur autoritetet dhe personat e tjerë të interesuar nga të qenit në një situatë të pasigurisë për një periudhë të gjatë kohore (shih mutais mutandis PM v Mbretëria e Bashkuar Applikcioni no. 6638/03 , 19 korrik 2005)

39. Parashtruesit e kërkesës kishin pretenduar se atyre iu është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë sipas nenit 49 të Kushtetutës ,për punë dhe zgjedhje të profesionit.

40. Lidhur me këtë pretendim Gjykata Kushtetuese thekson se e drejta për punë dhe

zgjedhje të profesionit është e drejtë e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 49) që para së gjithash nënkupton se secili individ ka të drejtë për punë dhe zgjedhje të profesionit në liri të plotë dhe nën kushtet e njëjta me të gjithë qytetarët e tjerë dhe vëren se e drejta për punë rregullohet me ligjet përkatëse të lëmisë së punës,

41 Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e verifikimit të fakteve ,dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe e të plotë është juridiksion i plotë i Gjykatave të rregullta si në rastin konkret i Gjykatës Supreme duke Aprovuar revizionin e e të paditurës apo të Gjykatës së Qarkut duke refuzuar kërkesën për përsëritje të procedurës nga

ana e paditësve, dhe se roli i sajë (i GJ.Kushtuese)është vetëm qe ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat qe garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veproje si "gjykate e shkalës se katërt", (shih, *mutatis mutandis,* i.a., Akdivar kunder Turqise, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65

42. Fakti i thjeshte se parashtruesit janë te pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund tu shërbejë atyre si e drejtë te ngrenë një kërkesë te argumentueshme për shkelje te Nenit 31 te Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. *5503/02,* Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kunder Hungarise, Aktgjykim i 26 korrikut 2005 ose , Tengerakis v. Qipro, nr. 35698/03, vendim i datës 9 nëntor 2006, § 74).

43. Në këtë rast, parashtruesit e kërkesës dështuan në kohën e duhur për të shter të gjitha mjetet e tyre ligjore, siç përshkruhet në paragrafin 28 të këtij aktvendimi . Për këtë kjo Gjykatë që tani të veprojë në lidhje me kërkesën e tyre, do të duhet të injorojë faktin se parashtruesit e kërkesës kanë dështuar për të vepruar në një kohë të caktuar dhe për të shter të gjitha mjetet e tyre ligjore. Kjo gjykatë nuk ka atë autoritet. Kjo gjykatë nuk mund të veprojë si një gjykatë e shkallës së katërt duke zëvendësuar vendimin e Gjykatave sa i përket fakteve (ose të ligjit në fuqi për atë janë gjykatat e rregullta.)

44. Për të deklaruar një Aktgjykim apo Aktvendim të një autoriteti publik si jo kushtetues parashtruesi i kërkesës do të duhej prima facie të tregojë se" Vendimi i autoritetit publik, si e tillë, do të jetë tregues i një shkeljeje të kërkesës gjykim të drejtë, dhe nëse, pa arsyeshmëria e atij vendimi është aq e dukshme sa që vendimi mund të konsiderohet si vendim ***tej mase arbitrar*** (shih GjEDNj, *Khamidov kundër Rusisë,* nr. 72118/01, aktgjykimi i datës 15 nëntor 2007, § 175.

45. Gjykata Kushtetuese nga në Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut Ac.nr.293/2010 të datës 21.3.2011 nuk gjeti elemente të arbitraritetit dhe as shkelje të supozuar të drejtave të njeriut sikur që parashtruesit e kërkesës kishin pretenduar.

46. Në këto rrethana parashtruesi ankesës nuk ka “argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij” dhe nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar andaj,Gjykata në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika c dhe d , gjen se kërkesën duhet ta refuzoj si qartas të pabazuar.,dhe rrjedhimisht

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 20.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 5 tetorit 2011, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës**
KushtetueseRobert Carolan Prof. Dr. Enver Hasani

KI 64/11 datë 15 shkurt 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 184/2008, të 27 janarit 2009

Rasti Nr.KI 64/11, datë 14 shkurt 2012

Fjalët kyçe; e drejta në punë, e paafatshme, kërkesë individuale

Parashtruesi paraqiti kërkesën në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pretenduar se me vendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Rev.Nr.184/2008 datë 27 janar 2009, i është shkelur e drejta në punë në bazë të nenit 49.1 të Kushtetutës.Parashtruesi i Kërkesës , e kishte dorëzuar një Kërkesë tjetër në Gjykatën Kushtetuese më 19 dhjetor 2009 për të njëjten cështje, e cila ka qenë e regjistruar me Nr. KI 74/09. Parashtruesi kishte kontratë pune me KEK-un e cila u ndërpre më 24 prill 2006.Parashtruesi inicioi procedurë gjyqësore në Gjykatën Komunale në Lipjan, duke vazhduar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme (Rev. Nr. 184/2008) i anuloi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Komunale duke e mbështetur largimin e parashtruesit nga punësimi ne KEK.Gjykata Kushtetuese , konkludon që kërkesa e regjistruar me Nr.KI 64/11, në përputhje me Rregullin 36 (3) (e) të Rregullorës së Punës , nuk ofron bazë të mjaftueshme për vendim te ri.Gjykata vendosi ta hedhë poshtë kërkesën, duke mbrojtur konkluzionin për papranueshmëri të arritur ne Aktvendimin e nxjerrë në lidhje me kërkesën 74/09 , sepse në përputhje me nenin 49 të Ligjit, kërkesa ishte dhe ende është e paafatshme.

Prishtinë, më 14 shkurt 2012

Nr. ref.: RK191/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 64/11

Parashtruesi

Feti Gashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,

Rev. Nr. 184/2008, të 27 janarit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Feti Gashi nga fshati Mramor, Hajvali.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 184/2008, të 27 janarit 2009, duke pohuar që i është cenuar e drejta e punës sipas nenit 49 të Kushtetutës.

3. Më 19 dhjetor 2009, parashtruesi kishte dorëzuar një kërkesë tjetër në Gjykatë për të njëjtën çështje. Kjo kërkesë ishte regjistruar me Nr. KI 74/09.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së

Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 15 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues dhe propozimit të Kolegjit shqyrtues për kërkesën e regjistruar me Nr. KI 74/09, Gjykata konstatoi që kërkesa ishte e papranueshme për shkak se nuk ishte parashtruar brenda afatit katër mujor në përputhje me nenin 49 të Ligjit.

6. Më 12 maj 2011, parashtruesi dorëzoi një kërkesë të re në Gjykatë, tani të regjistruar me Nr. KI 64/11.

7. Më 17 gusht 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj.

8. Më 18 janar 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës kishte kontratë pune me KEK-un, e cila u ndërpre më 24 prill 2006. Në të vërtetë, Komisioni Disiplinor i KEK-ut nxori një vendim me të cilin konstatoi që parashtruesi i kishte shkelur detyrat e tij të punës.

10. Në qershor të vitit 2006, parashtruesi, në përpjekje të mbrojtjes së interesave dhe të drejtave të tij, të cilat pohonte se i ishin cenuar, inicioi procedurë gjyqësore në Gjykatën Komunale në Lipjan, duke vazhduar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe në Gjykatën Supreme.

11. Në të vërtetë, më 27 janar 2009, Gjykata Supreme (Rev. Nr. 184/2008) i anuloi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Komunale duke e mbështetur largimin e parashtruesit nga punësimi në KEK. Gjykata Supreme konstatoi që gjykatat gabimisht e kishin zbatuar të drejtën materiale kur kishin konsideruar se padia e parashtruesit ishte e bazuar.

12. Më 16 mars 2009, parashtruesi i shkroi letër kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, me të cilën kërkonte ndryshimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Parashtruesi thotë që kurrë nuk ka marrë përgjigje nga EULEX-i.

Vlerësimi i pranueshmërisë

13. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën 74/09 në Gjykatë më 19 dhjetor 2009. Si u përmend më lart, më 16 mars 2009, ai i shkroi letër kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it. Pra, letra drejtuar kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it ishte dorëzuar para parashtrimit të kërkesës 74/09 në Gjykatë.

14. Edhe pse ajo letër nuk ishte përmendur në kërkesën e mëhershme 74/09, kërkesa e re 64/11 bazohet vetëm në letrën e paraqitur nga parashtruesi si fakt i ri i parashtruar për këtë rast.

15. Parashtruesi konsideron që kërkesa e tij e mëparshme, e regjistruar me Nr. 74/09, ishte parashtruar me kohë duke pasur parasysh faktin që letrën e tij ia dërgoi kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it më 16 mars 2009 dhe pasi që ende është në pritje të përgjigjes nga EULEX-i.

16. Sa u përket kritereve për pranueshmëri, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (e) të Rregullores së punës, i cili thotë që kërkesa mund të konsiderohet e papranueshme nëse *"gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri"*.

17. Gjatë zbatimit të këtij rregulli për këtë rast, është me vend të shqyrtohet nëse kërkesa e parashtruesit ofron *"bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri"*.

18. Gjykata rikujton se parashtruesi pretendon që letra e tij drejtuar kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it është fakt i ri për qëllimet e një vendimi të ri, pasi ajo gjoja tregon se rasti ende nuk ka përfunduar.

19. Gjykata vëren që parashtruesi e bazoi kërkesën e tij drejtuar kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it në nenin 6, në lidhje me nenin 5 (6) të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

20. Neni 6 (Dispozitat lidhur me Koordinatorin e EULEX-it për të Drejtat Pronësore në Kosovë) i ligjit të sipërpërmendur përcakton:

"6.1 Koordinatori i EULEX-it për të Drejtat Pronësore do të ndihmojë në koordinimin e çështjeve lidhur me të drejtat pronësore, si dhe zgjidhjen e kërkesave ndërmjet palëve të përfshira në këtë çështje, duke përfshirë por jo kufizuar në Agjencinë Kosovare të Pronës, Komisionin Kosovar për Kërkesa Pronësore, Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, gjykatat e rregullta, apo Shërbimin Policor të Kosovës.

6.2 Të gjitha palët që merren me çështjet e të drejtave pronësore, përfshirë këtu zgjidhjen e kërkesave në Kosovë, janë të obliguar që t'i ofrojnë falas Koordinatorit të EULEX-it për të Drejtat Pronësore çdo informatë të kërkuar nga ta dhe t'i lejojnë qasje në të gjitha elementet e nevojshme për zbatimin e mandatit të vet".

21. Neni 5 (6) i të njëjtit ligj thotë:

"5.6 Në ushtrimin e funksionit të tyre të monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, gjyqtarët e EULEX-it do të kenë kompetencë që

të kërkojnë me shkrim informata lidhur me statusin e çdo lënde civile në procedurë apo të përfunduar që është në juridiksionin ose kompetencën e cilësdo gjykatë në Kosovë. Gjyqtarët e EULEX-it do të kenë të drejtë që t'i marrin kopjet e duhura të dokumenteve që kanë të bëjnë me çdo kontest apo procedurë civile që janë në juridiksionin ose kompetencën e cilësdo gjykatë në Kosovë".

22. Parashtruesi nuk ka marrë përgjigje në kërkesën e tij drejtuar EULEX-it dhe nuk është i sigurt nëse kërkesa e tij është regjistruar si rast në pritje për t'u zgjidhur pranë EULEX-it.

23. Në anën tjetër, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës, i cili përcakton që *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*. Duket që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (Rev. Nr. 184/2008), i 27 janarit 2009, është i formës së prerë dhe detyrues (*res judicata*). Prandaj, përveç përmbarimit të tij, asnjë mjet tjetër juridik nuk është efektiv dhe në dispozicion kundër vlefshmërisë së tij.

24. Përveç kësaj, letra që parashtruesi ia ka dërguar kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it nuk është mjet juridik i paraparë me ligj dhe nuk e ka fuqinë të ndikojë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

25. Gjithashtu, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane, parashtruesit janë vetëm të obliguar t'i shterojnë mjetet juridike që janë në dispozicion në teori dhe në praktikë në kohën përkatëse, pra, mjetet që janë të qasshme, që sigurojnë kompensim lidhur me ankesat e tyre dhe që ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses (Aktgjykim i Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Sejdović kundër Italisë, Kërkesa nr. 56581/00 e 1 marsit 2006, paragrafi 46).

26. Letra që parashtruesi ia ka dërguar kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, rrjedhimisht nuk është në gjendje të

sigurojë kompensimin që e kërkon parashtruesi i kërkesës dhe nuk ofron asnjë mundësi për sukses për të marrë një aktgjykim të favorshëm të Gjykatës Supreme.

27. Gjykata konkludon që kërkesa e regjistruar me Nr. 64/11, në përputhje me rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës, nuk ofron bazë të mjaftueshme për vendim të ri.

28. Prandaj, Gjykata mbron konkluzionin për papranueshmëri të arritur në aktvendimin e nxjerrë në lidhje me kërkesën 74/09, sepse, në përputhje me nenin 49 të Ligjit, kërkesa ishte dhe ende është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (3) (e) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 128/11 datë 15 shkurt 2012- Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Rev. Nr. 225/2007), të 25 shtatorit 2007

Rastin KI 128/11, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 25.9.2007.

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, ratione temporis, Aktvendim për papranueshmëri.

Parashtruesi pohon që "i është shkelur e drejta e tij themelore e punës, e garantuar me nenin 49.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".
Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që "ta anulojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 225/2007, të 25 shtatorit 2007", dhe "ta miratojë" kërkesën [e tij] për ta kthyer në vendin e punës".
Gjykata konsideron se nga organet publike të Republikës së Kosovës mund të kërkohet të përgjigjen vetëm për faktet dhe aktet që kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, pra pas 15 qershorit 2008. Si rrjedhojë, Gjykata nuk mund ta shqyrtojë një kërkesë që ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes së Kushtetutës në fuqi.Gjykata konstaton që kërkesa është e papranueshme dhe e cila kërkesë është e parashkruar "*ratione temporis*".

Prishtinë, më.14 shkurt 2012

Nr.Ref.:RK198/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti Nr. KI 128/11

Parashtrues

Ismet Boshnjaku

Vlerësim i

Aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Rev. Nr. 225/2007), të 25 shtatorit 2007

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Ismet Boshnjaku nga Batllava, Podujevë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme (Rev. Nr. 225/2007), të 25 shtatorit 2007, që i ishte dorëzuar më 15 janar 2008.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon që "i është shkelur e drejta e tij themelore e punës, e garantuar me nenin 49.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".

4. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që "ta anulojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 225/2007, të 25 shtatorit 2007", dhe "ta miratojë" kërkesën [e tij] për ta kthyer në vendin e punës".

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 7 tetor 2011.

7. Më 16 janar 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj.

8. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues më 18 janar 2012, dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Parashtruesi kishte marrëdhënie pune me NSH "Llapi", e cila u ndërpre diku në vitin 1991, pas pothuaj 13 vjetësh.

10. Për t'i mbrojtur interesat dhe të drejtat e tij për të cilat pretendonte se i ishin shkelur, parashtruesi filloi procedurë gjyqësore në Gjykatën Komunale në Podujevë, pastaj në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe në fund në Gjykatën Supreme.

11. Në të vërtetë, më 25 shtator 2007, Gjykata Supreme (Rev. Nr. 225/2007) e refuzoi ankesën e parashtruesit kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut (Ac. Nr. 1043/2006, të 10 majit 2007).

Vlerësimi i pranueshmërisë

12. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në rregullin 36 të Rregullores së punës.

13. Gjykata konsideron se nga organet publike të Republikës së Kosovës mund të kërkohet të përgjigjen vetëm për faktet dhe aktet që kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, pra pas 15 qershorit 2008. Si rrjedhojë, Gjykata nuk mund ta shqyrtojë një kërkesë që ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes së Kushtetutës në fuqi (shih Aktvendimin e Gjykatës për Papranueshmëri në Rastin Nr. 18/10, Denić dhe të tjerët, të 17 gushtit 2011).

14. Kjo çështje nuk bie nën juridiksionin kohor të Gjykatës Kushtetuese pasi Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (Rev. Nr. 225/2007), i 25 shtatorit 2007, i ishte dorëzuar parashtruesit më 15 janar 2008, pra para 15 qershorit 2008, data e hyrjes së Kushtetutës në fuqi.

15. Përveç kësaj, rregulli 36.3 (h) parashikon që *"Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme"* nëse *"kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën"*. Prandaj, Gjykata konsideron që kërkesa është e parashkruar "*ratione temporis*".

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullit 36.3 (h) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Prof. Dr. Enver Hasani

KI 26/10 datë 15 mars 2012- Vendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 14/2008, të 10 tetorit 2008, dhe Vendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 260/2008, të 2 korrikut 2008

Rasti KI 26/10, vendimi i 27 shkurtit 2012

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pronës, barazia para ligjit, e drejta për një gjykim të drejtë dhe të pavarur, e drejta për mjete juridike.

Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në gjykatë, duke pretenduar shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese në lidhje me dy çështje të ndërlidhura: (1) çështja e të drejtës së pronës në lidhje me ngastrën e caktuar kadastrale dhe shtëpinë e ndërtuar në të; dhe (2) çështja e të drejtës së pronës në lidhje çezmën e cila gjendet në ngastrën e kontestuar kadastrale. Ai pretendoi shkeljen e nenit 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 36 [E Drejta e Privatësisë], 46 [Mbrojtja e Pronës], 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.

Lidhur me ngastrën kadastrale dhe shtëpisë së ndërtuar në të, ai ankohet, në veçanti, në lidhje me kohëzgjatjen e padisë, që e përfshinte atë dhe anëtarët e familjes së tij, që pretendohet të jetë iniciuar në gusht 1992. Ai më tutje pretendon se Gjykata Komunale në Vushtrri, i ka injoruar të gjitha provat relevante ligjore se ai është pronari i vetëm i ngastrës kadastrale dhe shtëpisë së ndërtuar në të. Për më tepër, Gjykata Komunale gjithashtu kishte injoruar udhëzimet detyruese të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës së Qarkut, të cilat i kishin anuluar aktgjykimet në bazë të asaj se ato kanë shkelur dispozitat substanciale të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe e kishin udhëzuar Gjykatën Komunale ta rigjykojë rastin. Sa i përket çështjes së çezmës, parashtruesi u ankua se Gjykata Komunale në Vushtrri e kishte shkelur Ligjin e Procedurës Kontestimore me aktvendimin, me të cilin parashtruesi e kishte

humbur të drejtën e përdorimit të çezmës, pasi që ai nuk kishte ushtruar posedim faktik që nga viti 2004.

Gjykata Kushtetuese vendosi ta refuzojë padinë e parashtruesit lidhur me ngastrën kadastrale dhe shtëpinë e ndërtuar në të, në bazë të asaj se procedura e rigjykimit në Gjykatën Komunale në Vushtrri, ishte ende në pritje e sipër dhe se parashtruesi, deri më tani, nuk kishte provuar se ai kishte ngritur ankesa kushtetuese, që tani ai i ngritë në gjykatë, në procedurën e rigjykimit në Gjykatën Komunale, dhe lere më, nëse padia e tij do të refuzohej nga gjykata, në procedurën ankimore në Gjykatën e Qarkut, dhe, nëse prapë do të ishte e pasuksesshme, në instancën e fundit në Gjykatën Supreme.

Sa i përket çështjes së çezmës, Gjykata njoftoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte asnjë qëllim ti paraqet shkeljet e pretenduara të së drejtave të tij kushtetuese, të cilat i kishte ngritur në kërkesën e tij, në Gjykatën Supreme, si një gjykatë e instancës së fundit. Në këto rrethana, Gjykata konkludoi se kërkesa ishte e papranueshme, pasi që parashtruesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.

Prishtinë, më 27 shkurt 2012

Ref.Nr.:RK201/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 26/10

Parashtrues

Emin Behrami

VLERËSIM I KUSHTETUTSHMËRISË

së

Vendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 14/2008,

të 10 tetorit 2008,

dhe

Vendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 260/2008,

të 2 korrikut 2008

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Emin Behrami nga komuna e Vushtrrisë.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i konteston Aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 14/4008, të 10 tetorit 2008, dhe C. nr. 260/2008, të 2 korrikut 2008, të cilat iu dorëzuan më 4 korrik 2008.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të

Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 27 prill 2010.

6. Më 27 prill 2010, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. 26/10, e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 26/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.

7. Më 24 gusht 2010, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën Komunale në Vushtrri për këtë kërkesë, ajo u përgjigj më 13 shtator 2010.

8. Më 21 dhjetor 2010, Gjykata Kushtetuese kërkoi dokumente shtesë nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë lidhur me këtë rast, dhe ajo u përgjigj më 28 dhjetor 2010.

9. Më 3 maj 2011, një njoftim iu dërgua Gjykatës Komunale në Vushtrri lidhur me statusin e lëndës Ac. Nr. 14/2008.

Përmbledhje e fakteve

10. Parashtruesi pohoi për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese në lidhje me dy çështje të ndërlidhura: (1) çështja e të drejtës së pronës lidhur me ngastrën kadastrale dhe shtëpinë e ndërtuar në të; dhe (2) çështja e të drejtës së pronës lidhur me çezmën që gjendet në ngastrën e kontestuar kadastrale.

Çështja e pronës lidhur me ngastrën kadastrale dhe shtëpinë e ndërtuar në të

11. Më 22 dhjetor 1977, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin C. nr. 357/77, vendosi t'ia akordonte parashtruesit të drejtën për gjysmën e ngastrës kadastrale nr. 3001/12, që gjendet tek vendi i quajtur "Selishte" në Vushtrri.

12. Më 31 mars 1978, Sekretariati për Ekonomi dhe Çështje Komunale në Vushtrri, me Vendimin 03-nr. 353-19, i dha parashtruesit leje ndërtimore për atë ngastër kadastrale.

13. Më 24 janar 1979, parashtruesi u pajtua me babanë e vet për ta ndarë pronën familjare. Parashtruesi mori ngastrën kadastrale nr. 3001/14, që përmbante një shtëpi dhe një kopsht.

14. Më 15 dhjetor 1980, Kryetari i Bashkësisë Islame në Prishtinë i dha parashtruesit një hua në shumë prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) dinarëve për ta përfunduar ndërtimin e shtëpisë së tij në ngastrën e sipërpërmendur kadastrale.

15. Më 5 dhjetor 1994, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin P. br. 110/94, ia akordoi të drejtën babait të parashtruesit dhe familjes së tij për të shfrytëzuar pjesë të shtëpisë që posedoheshin nga parashtruesi.

16. Më 6 prill 1995, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Aktgjykimin GZH-br. 132/95, e miratoi Aktgjykimin P. br. 110/94, të Gjykatës Komunale në Vushtrri.

17. Më 12 maj 1995, babai i parashtruesit kërkoi nga Gjykata Komunale në Vushtrri që t'ia caktonte të drejtën në pronën e përbashkët për shtëpinë që zotërohej nga parashtruesi.

18. Më 8 nëntor 1995, Gjykata Komunale, me Vendimin P. br. 35/95, e miratoi kërkesën kundër të cilës parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

19. Më 17 maj 1996, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Vendimin GZH. br. 43/96, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar.

20. Më 28 maj 1996, babai i parashtruesit dhe familja e tij paraqitën kërkesë në Gjykatën Komunale në Vushtrri për inicimin e procedurës përmbarimore lidhur me Vendimin P. br. 35/95, të 8 nëntorit 1995, dhe Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, GZH. br. 43/96, të 5 qershorit 1996.

21. Më 7 tetor 1996, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Vendimin I-164/96, e hodhi poshtë si të pabazuar kundërshtimin e parashtruesit kundër urdhrit për përmbarim.

22. Më 23 shkurt 1997, Gjykata Supreme e Serbisë, me Vendimin Rev. 3277/96, i abrogoi këto vendime: P. br. 110/94, të 5 dhjetorit 1994; GZH-br. 132/95, të 6 prillit 1995; P. br. 35/95, të 8 nëntorit 1995; GZH. br. 43/96, të 17 majit 1996; dhe I. br.

164/96, të 7 tetorit 1996, dhe ia ktheu vendimet e sipërpërmendura Gjykatës Komunale në Vushtrri për rigjykim.

23. Më 17 prill 1997, parashtruesi kërkoi nga Gjykata Komunale në Vushtrri pezullimin e procedurës përmbarimore në rastin P. br. 164/96.

24. Më 13 maj 1997, Gjykata Komunale, me Vendimin I. br. 142/97, e anuloi procedurën përmbarimore kundër parashtruesit.

25. Si rrjedhojë, babai i parashtruesit dhe familja e tij i zënë pjesë të shtëpisë së parashtruesit.

26. Më 17 qershor 1997, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën Komunale në Vushtrri, me të cilën kërkonte vënien e masave të përkohshme kundër zënies së shtëpisë nga babai i tij dhe familja e tij. Gjykata në fjalë gjoja nuk e mori parasysh këtë ankesë.

27. Më 17 korrik 1997, babai i parashtruesit dhe familja e tij parashtruan ankesë në Gjykatën Komunale në Vushtrri, me të cilën kërkonin vënien e masave të përkohshme kundër parashtruesit.

28. Më 29 korrik 1997, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Vendimin P. br. 138/97, caktoi masën e përkohshme kundër parashtruesit, duke e lejuar babain e parashtruesit dhe familjen e tij të kyçeshin në rrjet elektrik dhe ujësjellës në pjesën e shtëpisë të banuar nga ata, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

29. Më 20 gusht 1997, parashtruesi parashtroi ankesë në gjykatën e njëjtë, me të cilën kërkonte që ajo ta shqyrtonte Vendimin P. br. 138/97.

30. Më 7 dhjetor 1998, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Vendimin P. br. 119/97, e legalizoi zënien e 2/3 së shtëpisë së parashtruesit nga babai i parashtruesit dhe familja e tij dhe caktoi gjobë ose paraburgim kundër parashtruesit dhe djemve të tij.

31. Pas padisë së ngritur nga babai i parashtruesit më 17 dhjetor 1998, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Vendimin P. br. 220/97, vendosi që ngastra e kontestuar kadastrale ishte pronë e përbashkët e familjes dhe se parashtruesi duhet ta njohë dhe lejojë regjistrimin e ngastrës kadastrale në fjalë në Zyrën Kadastrore në Vushtrri. Ky vendim i është dorëzuar parashtruesit më 21 janar 1999.

32. Më 1 janar 1999, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë kundër Vendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, P. br. 119/97, por procedura u ndërpre për shkak të ndodhive që ishin duke u zhvilluar në Kosovë në atë kohë.

33. Më 7 prill 2000, parashtruesi ndërmori masa ligjore në Gjykatën Komunale në Vushtrri kundër babait të tij dhe familjes së tij, duke kërkuar që atij t'i kthehej prona e paluajtshme.

34. Me Aktgjykimin K-nr. 20/2000, të 29 qershorit 2000, Gjykata Komunale në Vushtrri e miratoi padinë e parashtruesit dhe i urdhëroi babait të parashtruesit dhe familjes së tij ta lironin pjesën nën kulm në katin e dytë të shtëpisë.

35. Pas ankesës së babait të parashtruesit, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Vendimin Ac. Nr. 26/2001, të 9 janarit 2001, e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, K-nr. 20/2000, të 29 qershorit 2000, dhe ia ktheu lëndën të njëjtës gjykatë për rigjykim.

36. Pasi verifikoi që ngastra e kontestuar kadastrale bashkë me shtëpinë e ndërtuar në të kishin qenë pronë e përbashkët gjatë bashkësisë familjare të ndërgjyqësve, më 4 shtator 2001, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin K. nr. 63/2001, e miratoi padinë e babait të parashtruesit dhe të familjes së tij, dhe e refuzoi padinë e parashtruesit se ai ishte pronari i vetëm i ngastrës kadastrale dhe i shtëpisë të kontestuar.

37. Më 10 tetor 2002, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Aktgjykimin, Ac. nr. 28/2002, e miratoi Aktgjykimin K. nr. 63/2001 dhe e refuzoi ankesën e parashtruesit se është pronari i vetëm i ngastrës kadastrale dhe i shtëpisë së kontestuar.

38. Më 24 prill 2003, Gjykata Supreme, me Vendimin Rev. nr. 19/2003, e pranoi revizionin e parashtruesit dhe e anuloi Aktgjykimin Ac. Nr. 28/2002, të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, dhe Aktgjykimin C. nr. 63/2001, të Gjykatës Komunale në Vushtrri, dhe ia ktheu lëndën gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

39. Më 16 dhjetor 2003, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin K. nr. 92/03, e miratoi padinë e babait të parashtruesit dhe të familjes së tij dhe konfirmoi se ngastra kadastrale dhe shtëpia e kontestuar janë pronë e përbashkët e bashkësisë familjare, dhe se parashtruesi ishte i obliguar ta pranonte këtë aktgjykim dhe ta lejonte regjistrimin e pronës së kontestuar në Zyrën Kadastrale në emër të babait të parashtruesit dhe familjes së tij.

40. Më 4 janar 2005, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Vendimin Ac. nr. 49/04, e miratoi ankesën e parashtruesit, e anuloi Aktgjykimin K. nr. 92/03, të Gjykatës Komunale në Vushtrri, dhe ia ktheu lëndën të njëjtës gjykatë për rigjykim.

41. Më 22 dhjetor 2005, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin C. nr. 447/05, e miratoi padinë e babait të parashtruesit dhe familjes së tij, dhe konfirmoi se ngastra

kadastrale dhe shtëpia e kontestuar ishin pronë e përbashkët e bashkësisë familjare të babait të parashtruesit dhe parashtruesit.

42. Më 27 dhjetor 2007, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Vendimin Ac. nr. 61/2006, e anuloi Aktgjykimin C. nr. 447/05, të Gjykatës Komunale në Vushtrri dhe ia ktheu lëndën gjykatës në fjalë për rigjykim.

43. Më 10 tetor 2008, Gjykata Komunale në Vushtrri e ftoi babain e parashtruesit në një seancë dëgjimore për këtë rast, me ç'rast ai dha një deklaratë, e cila u evidentua në regjistrin e gjykatës nën C. nr. 14/2008, dhe iu dërgua Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, e cila procedoi këtë lëndë nën numrin e ri Ac. nr. 91/08.

44. Më 7 prill 2009, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, në të cilën theksonte se Gjykata Komunale në Vushtrri, në seancën publike të 10 tetorit 2008, e cila përfundoi me Aktgjykimin C. nr. 14/2008 (shënim: procesverbali i asaj seance publike përmban vetëm deklaratat e babait të parashtruesit), nuk e ftoi as atë, as përfaqësuesin e tij ligjor si palë kundërshtare, dhe nuk iu dërgua kopja e aktgjykimit në fjalë.

45. Më 8 qershor 2009, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, përmes të cilës kërkonte t'i dorëzohej Vendimi Ac. nr. 91/08, dhe ia tërhoqi vërejtjen gjykatës në fjalë se ai do të priste më së largu deri më 26 qershor 2009 që t'i dorëzohej vendimi.

46. Më 31 janar 2011, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ia dërgoi parashtruesit një njoftim lidhur me rastin Ac. nr. 91/08, i cili i ishte dërguar edhe Gjykatës Komunale në Vushtrri, në të cilin thuhej:

"*Me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë Ac. nr. 61/2006 të datës 27.12.2007 është prishur në tërësi aktgjykimi C. nr. 447/05 i datës 22.12.2005 i Gjykatës Komunale në Vushtrri dhe lënda i është kthyer të njëjtës për rigjykim dhe vendosje.*

Nga dokumentet e lëndës shihet që Gjykata Komunale në Vushtrri (procesverbali i 10 tetorit 2008), pa seancë gjyqësore e ka thirrur vetëm Halil Qerimin (babanë e parashtruesit) dhe pa marrë masa përkatëse për rigjykim në përputhje me rekomandimet e dhëna në vendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë Ac. nr. 61/2006; lënda iu kthye përsëri Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.

"Gjykata Komunale në Vushtrri ishte e obliguar t'i thërriste ndërgjyqësit në seancën e rigjykimit në mënyrë që ata t'i parashtronin pretendimet e tyre dhe më pas të merrte vendim të mirëfilltë si rezultat i fakteve të vërtetuara në mënyrë të drejtë e të hollësishme në proces të rregullt gjyqësor. Vendimet është dashur t'u dërgoheshin palëve bashkë me këshillën juridike lidhur me ankesat në përputhje me kriteret juridike, vetëm atëherë lënda duhet t'i dërgohet Gjykatës së Qarkut për shqyrtim në shkallë të dytë".

Bashkëngjitur me këtë parashtresë ua përcjellim dokumentacionin komplet të lëndës Ac. nr. 14/2008 për rigjykim".

Çështja e çezmës

47. Më 16 qershor 2008, parashtruesi ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Vushtrri kundër të padituri (babait të parashtruesit dhe familjes së tij) mbi bazën se i padituri ka kryer pengim të posedimit në dëm të parashtruesit duke mos i lejuar djemtë e tij që ta vënin në funksion çezmën që gjendet në pjesën e ngastrës që i takon të padituri.

48. Më 2 korrik 2008, Gjykata Komunale në Vushtrri, përmes Vendimit C. nr. 260/2008, e refuzoi padinë e parashtruesit si të pabazuar. Në pjesën e arsyetimit, Gjykata Komunale në Vushtrri theksoi se parashtruesi e ka humbur posedimin e çezmës së sipërpërmendur sepse që nga viti 2004 ai nuk ka ushtruar pushtet faktik mbi objektin e sipërpërmendur. Gjykata Komunale në Vushtrri nxori vendimin e vet në bazë të nenit 74 të Ligjit mbi marrëdhëniet pronësore juridike, Gazeta Zyrtare e ish-RSFJ-së, në të cilin thuhet që:

"*Posedimi humbet kur mbajtësi pushon të ushtrojë zotërimin faktik të sendit*".

49. Më 7 korrik 2008, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Vendimit C. nr. 260/2008, me ç'rast u ankua se Gjykata Komunale në Vushtrri, përmes vendimit të sipërpërmendur, ka kryer shkelje të rëndë të dispozitave të Ligjit për procedurën kontestimore, vërtetim të gabueshëm të gjendjes faktike dhe zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

Pretendimet e parashtruesit

Lidhur me ngastrën kadastrale dhe shtëpinë e ndërtuar në të

50. Parashtruesi pohon që Gjykata Komunale në Vushtrri, përmes Aktgjykimit C. nr. 14/2008, të 10 tetorit 2008, ia shkeli të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, sepse ai nuk ishte ftuar nga gjykata e sipërpërmendur edhe pse ishte palë në procedurë.

51. Parashtruesi pohon që Gjykata Komunale në Vushtrri i ka injoruar të gjitha provat përkatëse ligjore që ai është pronar i vetëm i ngastrës kadastrale të kontestuar dhe i shtëpisë së ndërtuar në të, sepse gjykata e sipërpërmendur gjoja lejoi uzurpimin me dhunë të 2/3 së shtëpisë së parashtruesit.

52. Për më tepër, parashtruesi pohon që Gjykata Komunale në Vushtrri me qëllim i ka injoruar udhëzimet detyruese të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, me ç'rast Gjykata e Qarkut në Mitrovicë disa herë i ka anuluar aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Vushtrri për shkak të shkeljeve thelbësore të Ligjit për procedurën kontestimore, dhe ia ka kthyer lëndën për rigjykim gjykatës së sipërpërmendur.

53. Parashtruesi pohon që lënda e tij është në procedurë e sipër në gjykatat e rregullta që nga viti 1992, dhe ende nuk është zgjidhur për shkak të vonesave të qëllimshme nga Gjykata Komunale në Vushtrri.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

Çështja e të drejtës së pronës

54. Në rastin në fjalë, parashtruesi ankohet për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete

Juridike], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemi Gjyqësor], të Kushtetutës. Parashtruesi ankohet në veçanti për kohëzgjatjen e procedurave lidhur me padinë në të cilën përfshiheshin ai dhe anëtarët e familjes së tij, që gjoja filloi më 4 gusht 1992.

55. Megjithatë, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë dhe Ligj lidhur me ankesat e tij sipas Kushtetutës.

56. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që periudha që duhet të merret parasysh për të vendosur për kërkesën e parashtruesit nuk filloi të ecën më 4 gusht 1992, kur ishte parashtruar padia në të cilën përfshiheshin parashtruesi dhe babai i tij, por më 15 qershor 2008, kur Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyri në fuqi dhe përcaktoi juridiksionin e kësaj Gjykate për të vendosur për kërkesa sipas nenit 113 [Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

57. Sa i përket nenit 113, Gjykata i referohet paragrafit 7, i cili thotë që "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*" Kjo do të thotë që, para se ta paraqiste kërkesën në këtë Gjykatë, parashtruesi është dashur së pari të ketë provuar ta marrë një vendim për objektin e çështjes së ankesave të tij nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë ankesat në gjykatën më të lartë, e cila ka juridiksion për këtë lëndë..

58. Gjykata thekson se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme

që të drejtat kushtetuese të ceken në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Nëse çështja ishte ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, *mutatis mutandis,* GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, Vendim i 28 prillit 2004).

59. Kjo Gjykatë përdori të njëjtin arsyetim kur nxori Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti KI-41/09, i 27 janarit 2010, dhe në Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor, Rasti Nr. 73/09, i 23 marsit 2010.

60. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesve të kërkesës u kërkohet t'i shterin vetëm mjetet juridike të cilat janë në dispozicion dhe efektive. Mjetet diskrecionale ose të jashtëzakonshme nuk duhet të shteren, për shembull, të kërkosh nga gjykata ta rishqyrtojë vendimin e vet (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Cinar kundër Turqisë, nr. 28602/95, Vendim i 13 nëntorit 2003).

61. Prandaj, sa i përket këtij rasti, Gjykata duhet të shqyrtojë së pari nëse, që nga 15 qershori 2008, kur u përcaktua juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për të vendosur për kërkesa, parashtruesi ka ngritur ankesa kushtetuese, të cilën është duke e parashtruar në këtë Gjykatë, në gjykatat e tjera që merren me rastin e tij, dhe, nëse nuk ka pasur sukses, në Gjykatën Supreme, si instancë e fundit, apo nëse i ka shfrytëzuar mjetet e tjera juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.

62. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që më 20 qershor 2008, kur me sa duket rasti priste të zgjidhej në Gjykatën Komunale në Vushtrri, parashtruesi iu ankua Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë për sjelljen e gjyqtarëve të Gjykatës Komunale, në veçanti të Kryetarit të saj, duke i quajtur të korruptuar dhe shkelës të ligjit.

63. Më 1 gusht 2008, parashtruesi i shkroi letër Kryetarit të Gjykatës Komunale, në të cilën theksonte se nuk ishte e qartë se mbi bazën e cilës padi vepronte Gjykata dhe se padia e palës tjetër duhet të refuzohet si e pabazuar dhe e pambështetur me prova.

64. Më 10 tetor 2008, Gjykata Komunale e ftoi vetëm babain e parashtruesit në seancë, por jo edhe parashtruesin. Si rrjedhojë, parashtruesi iu ankua Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë se Kryetari i Gjykatës Komunale, duke vepruar në atë mënyrë, me qëllim kishte kryer shkelje thelbësore dhe absolute të Ligjit për procedurën kontestimore, për të cilat ai duhet të dënohet kurse rasti duhet të anulohet menjëherë.

65. Më 14 prill 2009, Gjykata e Qarkut e njoftoi parashtruesin se seanca për ankesë do të mbahej diku në maj 2009.

66. Më 8 qershor 2009, parashtruesi dorëzoi edhe një ankesë tjetër në Gjykatën e Qarkut, me të cilën kërkonte anulimin e aktgjykimit të paligjshëm të Gjykatës Komunale si joligjor dhe të pabazuar mbi bazën e "një prove ligjore për 17 vjet rresht". Ai shtoi se "nëse nuk e miratoni padinë time si të ligjshme dhe të bazuar sipas të gjitha provave të nevojshme ligjore për më tepër se 30 vjet, që janë në pajtim me Vendimin Rev. nr. 19/03, të Gjykatës Supreme, të 24 prillit 2003, do të besoj që ju po u ndihmoni shkelësve të ligjit nga gjykata e shkallës së parë në Vushtrri".

67. Më 12 qershor 2009, Kryetari i Gjykatës së Qarkut e njoftoi parashtruesin se do të thirrej të merrte pjesë në seancën kryesore në atë gjykatë. Data e seancës dhe vendimi pasues i gjykatës nuk i janë komunikuar Gjykatës Kushtetuese.

68. Më 31 janar 2011, parashtruesi mori një njoftim nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, në të cilin thuhej se ajo ia kishte kthyer lëndën Gjykatës Komunale në Vushtrri për rigjykim. Sipas mendimit të Gjykatës së Qarkut, *"Gjykata Komunale në*

Vushtrri ishte e obliguar t'i thërriste ndërgjyqësit në seancën e rigjykimit në mënyrë që ata t'i parashtronin pretendimet e tyre dhe më pas të merrte vendim të mirëfilltë si rezultat i fakteve të vërtetuara në mënyrë të drejtë e të hollësishme në proces të rregullt gjyqësor".

69. Duke pasur parasysh këto fakte, Gjykata thekson se ankesa e parashtruesit drejtuar Gjykatës së Qarkut kundër mënyrës në të cilën Gjykata Komunale e kishte zhvilluar procedurën, vërtetë ka qenë e suksesshme.

70. Sa i përket procedurës së rigjykimit në Gjykatën Komunale në Vushtrri, Gjykata Kushtetuese vëren që më 25 gusht 2011, Gjykata Komunale mori një njoftim nga Gjykata e Qarkut në të cilin thuhej se rasti gjyqësor nuk kishte përfunduar ende për shkak të mungesës së gjyqtarëve, dhe se vetëm Kryetari ishte emëruar gjatë fazës së tretë të emërimit të gjyqtarëve, i cili, më 27 maj 2011, kishte kërkuar nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ta delegonte një gjyqtar për t'i mundësuar Gjykatës Komunale që të vendoste për lëndën në rigjykim. Në mungesë të informacioneve të tjera nga Gjykata Komunale apo parashtruesi, Gjykata mendon që rasti është në procedurë në atë gjykatë.

71. Sa u përket këtyre procedurave në shqyrtim në Gjykatën Komunale në Vushtrri, Gjykata Kushtetuese vëren që parashtruesi nuk ka treguar deri më tani se ai ka ngritur ankesë kushtetuese, të cilën e ngrit tani në këtë Gjykatë, në këto procedura, e lëre më nëse ankesa e tij do të ishte refuzuar nga ajo Gjykatë Komunale, në procedurën e ankesës në Gjykatën e Qarkut, dhe, po të mos ishte e suksesshme, në Gjykatën Supreme, si instancë e fundit.

72. Në këto rrethana, Gjykata gjen që parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit.

73. Gjykata konkludon që ankesa e parashtruesit është e parakohshme dhe se kjo pjesë e kërkesës është e papranueshme.

Çështja e çezmës

74. Sa i përket pretendimit në fjalë, Gjykata vëren që më 7 korrik 2008, parashtruesi ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë kundër Vendimit C. nr. 260/2008, të nxjerrë nga Gjykata Komunale në Vushtrri.

75. Në ndërkohë, më 3 maj 2011, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Vendimin AC. nr. 21/11, e refuzoi ankesën si të pabazë. Më 22 qershor 2011, parashtruesi e njoftoi Gjykatën Kushtetuese se nuk do të ushtronte ankesë kundër këtij vendimi.

76. Prandaj, Gjykata vëren që parashtruesi nuk ka ndërmend t'i ngrejë në Gjykatën Supreme, si gjykatë e shkallës së fundit, shkeljet e supozuara të të drejtave të tij kushtetuese lidhur me çështjen e çezmës, të cilat i ka ngritur në këtë kërkesë.

77. Në këto rrethana, Gjykata duhet të konkludojë që, sa i përket kësaj pjese të kërkesës, parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.

78. Prandaj, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, neneve 22.7, 22.8 dhe 47 të Ligjit, dhe rregullat 34 dhe 35 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese me shumicë

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Prof. Dr. Enver Hasani

KO 04/11 datë 06 mars 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Nr. 03/L-139

Rasti KO 04/11, vendim i 1 marsit 2012.

Fjalët kyçe: barazia para ligjit, kërkesë e gjykatës supreme, kompensimi i dëmit, ligji për shpronësim, ndarja e pushteteve, prezumimi i kushtetushmërisë së ligjit.

Parashtruesja paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.8 të Kushtetutës, duke pohuar se Nenet 35, 36,37 dhe 38 të Ligjit për shpronësim janë në kundërshtim me 102 (5)të Kushtetutës. Parashtruesja theksoi se nenet e kontestuara kërkojnë që palët në procedurë të paraqesin ankesa në gjykatë komunale, nëse vendimi është nxjerrë nga organi komunal, dhe në Gjykatën Supreme, nëse vendimi për shpronësim është nxjerrë nga Qeveria. Parashtruesja më tej theksoi se ankesa mund të paraqitet kundër vendimeve të Gjykatës Supreme, edhe pse nuk ka dispozita për ankesë kundër një vendimi të Gjykatës Supreme të lejuar me Kushtetutë. Parashtruesja pohoi se palët në procedurë janë vënë në pozitë të pabarabartë; kur gjykata komunale merr një vendim, palët kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë të gjitha mjetet juridike, duke përfshirë mjetet juridike në Gjykatën Supreme, por kur vendimi i shkallës së parë merret nga Gjykata Supreme, nuk është e qartë cila është gjykata e juridiksionit të apelit. Si rrjedhojë, sipas parashtrueses, nenet 35,36,37 dhe 38 të Ligjit për shpronësim janë në kundërshtim me nenin 24 (1) të Kushtetutës, i cili përcakton se të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Se fundi, parashtruesja pohoi se zbatimi i dispozitave të kontestuara të Ligjit për shpronësim do të kishte ndikim negativ në numrin e madh të lëndëve të grumbulluara në Gjykatën Supreme. Parashtruesja tha se në kohën e përpilimit të kësaj kërkese kishte pasur rreth 200 lëndë për shpronësim.

Gjykata konstatoi se kërkesa ishte ishte e pranueshme sepse Gjykata Supreme bazuar në nenin 113.8 të Kushtetutës ishte palë e autorizuar

dhe se kishte përmbushur tri kushte procedurale: (1) ligji i kontestuar duhej të zbatohej drejtpërsëdrejti nga parashtruesja në lëndën në shqyrtim e sipër; (2) ligjshmëria e ligjit të kontestuar ishte parakusht për marrjen e vendimit për lëndën në shqyrtim e sipër nga parashtruesja; (3) parashtruesja kishte saktësuar se cilat dispozita të ligjit konsideroheshin në kundërshtim me Kushtetutën.

Lidhur me meritat e kërkesës, Gjykata shqyrtoi nenin 4 të Ligjit për shpronësim dhe numëroi kushtet e veçanta që zbatohen për komuna kur ato dëshirojnë ta shpronësojnë tokën për funksione të tyre. Gjykata më tutje arsyetoi se neni 4 i Ligjit për shpronësim ka të bëj me mandatin e komunës që lidhet me planifikimin, ndërtimin e rrugëve komunale, objekteve publike dhe të ngjashme. Gjykata po ashtu vërejti se bazuar në nenin 4 të Ligjit për shpronësim, nëse organ shpronësues është Qeveria, funksionet lidhen me rrugët ndërkomunale, hekurudhat, prodhimin dhe transmisionni e energjisë, stabilimentet dhe linjat e telekomunikacionit, pendët, rezervarët publikë të ujit, dhe të tjera.

Gjykata më tutje shtjelloi natyrën dhe dallimet e shpronësimit të kryer nga komunat në njërën anë dhe nga Qeveria në anën tjetër, dhe se palët në rastin e parë mund të ankoheshin në gjykatat komunale përkatëse, ndërsa në rastin e fundit palët mund të ankoheshin në Gjykatën Supreme. Për më tepër, Gjykata arsyetoi se neni 102 i Kushtetutës, lejon që rastet të referohen drejtpëdrejtë në Gjykatën Supreme pa të drejtë ankese, dhe se Gjykata ishte e kënaqur që nuk ka shkelje kushtetuese në përcaktimin se ankesat kundër vendimeve të komunave shqyrtohen në gjykatat komunale përkatëse dhe se ankesat kundër vendimeve të Qeverisë të shqyrtohen në Gjykatën Supreme.

Duke cituar praktikën e saj gjyqësore në rastin KO 98/11, të 20 shtatorit 2011, lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Gjykata arsyetoi se Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit mes tyre. Gjykata bazuar në parimin e ndarjes

së pushteteve, theksoi se çështja e numrit të madh të lëndëve dhe mënyrat e kompensimit të shpronësimeve është çështje plotësisht brenda juridiksionit të gjyqësorit, legjislaturës dhe Qeverisë për diskutim. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata konstatoi se kërkesa është e pranueshme nga aspekti procedural – formal; që nenet 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësim Nr. 03/L-139, janë në përputhje me Kushtetutën; Aktgjykimi do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe se Aktgjykimi hyn menjëherë në fuqi.

Prishtinë, më 01 mars 2012

Nr. ref.:AGJ203/12

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KO 04/11

Parashtruesi

Gjykata Supreme e Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Nr. 03/L-139

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Baza juridike

2. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.8 të Kushtetutës, në nenet 51, 52, 53 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 75 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është kërkesa e Gjykatës Supreme për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësim, Nr. 03/L-139.

Parashtresa e parashtrueses

4. Parashtruesja pohon, së pari, që nenet 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit të vitit 2009 janë në kundërshtim me nenin 102 (5) të Kushtetutës, i cili në pjesën përkatëse thotë:

> *"... Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese."*

5. Parashtruesja thekson që nenet e kontestuara kërkojnë që palët në procedurë të paraqesin ankesa në gjykatë komunale, nëse vendimi është nxjerrë nga organi komunal, dhe në Gjykatën Supreme, nëse vendimi për shpronësim është nxjerrë nga Qeveria.

6. Parashtruesja më tej thekson se *"Ankesa mund të paraqitet kundër këtyre vendimeve ..."* dhe kjo do të thotë se ankesa mund të paraqitet kundër vendimeve të Gjykatës Supreme, edhe pse

nuk ka dispozita për ankesë kundër një vendimi të Gjykatës Supreme të lejuar me Kushtetutë.

7. Parashtruesja pohon që palët në procedurë janë vënë në pozitë të pabarabartë; kur gjykata komunale merr një vendim, palët kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë të gjitha mjetet juridike, duke përfshirë mjetet juridike në Gjykatën Supreme, por kur vendimi i shkallës së parë merret nga Gjykata Supreme, nuk është e qartë cila është gjykata e juridiksionit të apelit. Si rrjedhojë, sipas parashtrueses, nenet në fjalë të Ligjit për shpronësim të vitit 2009 janë në kundërshtim me nenin 24 (1) të Kushtetutës, i cili thotë: *"1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim"*.

8. Parashtruesja më tej thekson se nenet e sipërpërmendura janë në kundërshtim me nenin 32 të Kushtetutës [E Drejta për Mjete Juridike], i cili thotë: *"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj"*. Në këtë drejtim, parashtruesja pohon që edhe pse nenet e sipërpërmendura të Ligjit për shpronësim të vitit 2009 formalisht lejojnë të drejtën për ankesë, në të vërtetë, nuk ka gjykatë tjetër që do të vendoste për një ankesë të tillë përveç Gjykatës Supreme.

9. Parashtruesja më tej pohon që nenet e sipërpërmendura të Ligjit për shpronësim të vitit 2009 bien ndesh me Ligjin për procedurën jokontestimore dhe me Ligjin për gjykatat e rregullta.

10. Së fundi, parashtruesja pohon që zbatimi i dispozitave të kontestuara të Ligjit të vitit 2009 do të kishte ndikim negativ në numrin e madh të lëndëve të grumbulluara në Gjykatën Supreme. Parashtruesja tha që në kohën e përpilimit të kësaj kërkese kishte pasur rreth 200 lëndë për shpronësim në Prizren. Parashtruesja më tej thotë që *"shumë më shumë të tjera do të vijnë me rastin e shpronësimeve deri në Merdarë, sigurisht mijëra lëndë të tilla do të ketë. Në këso situatash do të ishte thjesht një utopi respektimi i afateve që i ka vendosur ligji, madje edhe sikur t'i kishim edhe 30 gjyqtarë shtesë, që do të merreshin vetëm me këto lëndë"*.

Procedura në Gjykatë

11. Parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Sekretariatin e Gjykatës Kushtetuese më 17 janar 2011.

12. Më 14 shkurt 2011, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan, kryesues, Altay Suroy dhe Iliriana Islami.

13. Më 11 maj 2011, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Kryetarin e Gjykatës Supreme dhe Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për pranimin e kërkesës.

14. Më 17 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesja, në përputhje me nenin 113 (8) të Kushtetutës, t'i referohej procedurës së posaçme gjyqësore, pra lëndës në të cilin parashtruesja nuk ishte e sigurt sa i përket përputhshmërisë së ligjit të kontestuar me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese gjithashtu kërkoi nga parashtruesja të sqaronte nëse kërkesa e tyre ka të bëjë me Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme me ndryshime dhe plotësime (2010/03-L-205, në tekstin e mëtejmë: Ndryshimet e vitit 2010 për Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme të vitit 2009 (2009/03-L-139).

15. Më 12 korrik 2011, parashtruesja iu përgjigj Gjykatës Kushtetuese duke sqaruar se kërkesa është parashtruar në lidhje me kushtetutshmërinë e Ligjit për shpronësim të vitit 2009. Në të njëjtën letër, parashtruesja përsëriti se dispozita të kontestuara të Ligjit të sipërpërmendur të vitit 2009 janë nenet 35, 36, 37 dhe 38.

16. Më 20 tetor 2011, Gjykata Supreme ia dërgoi Gjykatës Kushtetuese dy lëndë prej rreth dyqind e pesëdhjetë ankesave të paraqitura nga pronarët e tokës të cilët e kontestojnë vendimin përfundimtar të Qeverisë së Kosovës për vlerësimin e shumës për

kompensim për pronën e shpronësuar për ndërtimin e autostradës kombëtare Vermicë-Merdarë.

17. Më 24 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Qeverinë e Kosovës për parashtrimin e kërkesës.

18. Më 3 nëntor 2011, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Supreme që t'i pezullonte të gjitha procedurat lidhur me lëndët në procedurë para saj që kanë të bëjnë me zbatimin e neneve të kontestuara të Ligjit për shpronësim, në pajtim me nenin 53 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Komentet e palëve

19. Gjykata Kushtetuese nuk ka marrë asnjë përgjigje në këtë kërkesë as nga Kuvendi i Kosovës as nga Qeveria e Kosovës.

Dispozitat e kontestuara të Ligjit për shpronësim të vitit 2009 dhe raporti i tyre me ndryshimet e vitit 2010 për Ligjin për shpronësim të vitit 2009

20. Ligji për shpronësim i vitit 2009 ishte ndryshuar në vitin 2010 me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Ligji Nr. 03/L-205. Ndër të tjera, këto ndryshime i prekën, pjesërisht, të gjitha nenet e kontestuara të Ligjit për shpronësim, pra nenet 35, 36, 37 dhe 38. Megjithatë, këto ndryshime nuk e prekën substancën e kërkesës që kishte të bënte me inicimin e procedurës në gjykatë me rastin e kontestimit të një vendimi të një organi shpronësues. Prandaj, nëse organi shpronësues në të cilin ndodhet toka është komuna, atëherë gjykata komunale është vendi i duhur për shqyrtimin e lëndës, dhe nëse organi shpronësues është Qeveria, atëherë vendi i duhur për shqyrtimin e lëndës është Gjykata Supreme.

Dispozitat e kontestuara të Ligjit për shpronësim të vitit 2009

21. Prandaj, për hir të plotësisë dhe me qëllim të kuptimit të çështjeve të ngritura në këtë kërkesë në kontekstin e tyre aktual, teksti përkatës i dispozitave të kontestuara, të ndryshuara me Ligjin e vitit 2010, thotë me sa vijon:

KREU XI

MJETET JURIDIKE

Neni 35

Ankesa Kundër Vendimit Preliminar mbi Ligjshmërinë e Shpronësimit të Propozuar

1. Nëse një Person është Pronar ose Zotërues i një Interesi në pronën e paluajtshme e cila është objekt i procedurës së shpronësimit dhe ky person me arsye mendon se Vendimi Preliminar (ose cilado pjesë e tij) është në kundërshtim me një ose më shumë kushte të përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 4 të këtij ligji, ky person ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e Vendimit Preliminar, pjesërisht ose plotësisht.

2. Nëse Organi Shpronësues është Organi Shpronësues i një Komune, ankesa paraqitet pranë gjykatës përkatëse komunale. Nëse Organi Shpronësues është Qeveria, ankesa paraqitet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës...

Neni 36

Ankesat mbi shumën e kompensimit

1. Nëse në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, një Organ Shpronësues nxjerr një Vendim Përfundimtar, çdo Pronar ose Zotërues i Interesit në pronën dhe/ose të drejtat të cilat janë objekt i këtij vendimi mund të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e shumës së kompensimit

dhe/ose dëmeve të cilat janë përcaktuar në vendim se do t'i paguhen atij Pronari dhe/ose Zotëruesi të Interesit.

2. Nëse Organ Shpronësues është Organi Shpronësues i një Komune, ankesa duhet të paraqitet pranë gjykatës përkatëse komunale. Nëse Organi Shpronësues është Qeveria, ankesa duhet të paraqitet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës...

Neni 37

Ankesa për Kompensimin e Dëmeve të Pësuara nga Shpronësimi i Pjesshëm

1. Nëse në përputhje me paragrafin 3. të nenit 18 të këtij ligji, Vendimi Përfundimtar autorizon shpronësimin e një pjese të parcelës së pronës së paluajtshme dhe kjo rezulton, ose me arsye pritet se do të rezultojë, në humbjen e vlerës së pjesës së pa shpronësuar, Pronari i pjesës së pa shpronësuar ka të drejtë të paraqesë ankesë sipas këtij neni dhe të kërkojë nga gjykata kompetente nxjerrjen e një aktgjykimi i cili e urdhëron Organin Shpronësues që të kompensojë humbjen e vlerës, nëse – dhe vetëm për aq sa – ky kompensim nuk është paraparë në Vendimin Përfundimtar.

2. Nëse Organ Shpronësues është Organi Shpronësues i një Komune, ankesa duhet të paraqitet pranë gjykatës përkatëse komunale. Nëse Organi Shpronësues është Qeveria, ankesa duhet të paraqitet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës...

Neni 38

Ankesa kundër ligjshmërisë së vendimit për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës

1. Nëse një Person i cili është Pronar ose Zotërues i një Interesi në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimi të Qeverisë për shfrytëzimin e përkohshëm të saj, dhe ky person me arsye mendon se vendimi nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 29 të këtij ligji, ky person ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës për kundërshtimin e vendimit...

22. Këtu duhet të citohet edhe një nen tjetër i rëndësishëm i Ligjit të ndryshuar për shpronësim, e ai është neni 39. Ky nen mbeti i paprekur nga ndryshimet e bëra me Ligjin e vitit 2010 dhe është i njëjti në origjinal si në Ligjin e konsoliduar. Ai përcakton që me rastin e shqyrtimit të kontesteve brenda fushëveprimit të neneve të kontestuara, nëse ka ndeshje ndërmjet dispozitave të neneve të kontestuara dhe dispozitave të Ligjit për procedurën administrative apo ndonjë ligj tjetër procedural, këto nene kanë përparësi. Ai përcakton, në tërësi, me sa vijon:

Neni 39

Kontestet tjera

1. Ankesat dhe kontestet tjera juridike nga nenet 35, 36, 37 ose 38 të këtij ligji do të zhvillohen në përputhje me ato nene. Në rast të konfliktit ndërmjet këtyre neneve dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative ose cilitdo ligj tjetër procedural, këto nene kanë përparësi.

2 Të gjitha kontestet tjera juridike që rezultojnë nga një veprim ose vendim i një Autoriteti Publik sipas këtij ligji i nënshtrohen e do të rregullohen në përputhje me dispozitat aplikueshme të Ligjit për Procedurën Administrative. Megjithatë, nëse një dispozitë e Ligjit për Procedurën Administrative eliminon ose e kufizon në mënyrë të paarsyeshme të drejtën e Personi të ndikuar (Person i cili është ndikuar në mënyrë specifike nga një veprim ose vendim i lartpërmendur) për të paraqitur ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtim e këtij veprimi ose vendimi nuk do të zbatohet.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata Kushtetuese së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.

24. Parashtruesja e ka parashtruar kërkesën në këtë Gjykatë në pajtim me nenin 113 (8) të Kushtetutës, i cili thotë:

> *Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.*

25. Ligji për Gjykatën Kushtetuese më tej specifikon procedurën për kërkesat e parashtruara sipas nenit 113 (8), të Kushtetutës. Veçanërisht neni 51 thotë:

Neni 51

Saktësimi i kërkesës

> *1. Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.*

2. Kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën."

26. Së fundi, Rregullorja e punës e Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera parashikon:

Rregulli 75

"Parashtrimi i kërkesës

(1) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, ex officio, ose me kërkesë të njërës palë të përfshirë në lëndë.

(2) Kërkesa duhet të theksojë përse vendimi i Gjykatës varet nga çështja e përputhshmërisë së ligjit me Kushtetutë. Dosja e cila shqyrtohet nga Gjykata duhet t'i bashkëngjitet kërkesës.

(3) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë për të iniciuar procedurën në pajtim me dispozitat e nenit 113.8 të Kushtetutës, pavarësisht nëse një palë e përfshirë në lëndë ka kontestuar kushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse ligjore."

27. Shkurtimisht, tërësia e këtyre dispozitave do të thotë që kur gjykata që merret me një lëndë në procedurë e sipër dhe nuk është e sigurt nëse ligji që duhet të zbatohet është në përputhje me Kushtetutën, atëherë ajo gjykatë mund t'ia referojë Gjykatës Kushtetuese çështjen e përputhshmërisë së ligjit me Kushtetutën. Natyrisht, duhet të ketë procedura në të cilat çështja e

parashtruar ka të bëjë me vendimin që do të merret nga gjykata referuese.

28. Nenet e posaçme të Ligjit që ngrenë dyshimin në mendjen e gjykatës duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë dhe detajet e lëndës në shqyrtim e sipër duhet t'i bashkëngjiten kërkesës. Procedura në gjykatën e rregullt duhet të pezullohet në mënyrë automatike kur kërkesa parashtrohet në pritje të vendimit të kësaj Gjykate.

29. Prandaj, për ta vlerësuar pranueshmërinë, kjo Gjykatë duhet së pari të shqyrtojë nëse ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti nga parashtruesja në lëndën në shqyrtim e sipër dhe, së dyti, nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit për lëndën në shqyrtim e sipër nga parashtruesja. Së treti, është me rëndësi të shihet nëse parashtruesja ka specifikuar cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.

30. Nga parashtresat e parashtrueses, si dhe nga teksti i dispozitave të kontestuara të Ligjit për shpronësim të vitit 2009, shihet qartë që parashtruesja duhet t'i zbatojë nenet e kontestuara të atij Ligji.

31. Sa i përket kushtit të dytë, Gjykata vëren që parashtruesja i ka dorëzuar dy ankesa që asaj i janë parashtruar nga pronarët e tokës së shpronësuar në përputhje me dispozitat e kontestuara të Ligjit për shpronësim të vitit 2009. Që të dy ankesat kishin të bënin me vendimet e Qeverisë për shpronësimin e pronës së paluajtshme në Suharekë. Gjykata Supreme ende nuk ka marrë vendime për ato raste. Gjykata Supreme ka dyshime lidhur me kushtetutshmërinë e neneve të kontestuara dhe nuk është e sigurt sa i përket përputhshmërisë së neneve me Kushtetutën. Kjo Gjykatë është e kënaqur që vendimi i parashtrueses varet nga kushtetutshmëria e neneve në fjalë.

32. Së fundi, Gjykata vëren që parashtruesja ka specifikuar cilat dispozita të ligjit të kontestuar konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën, nenet 35, 36, 37 dhe 38.

33. Nuk ka arsye të tjera që kjo Gjykatë të konstatojë që kërkesa është e papranueshme dhe, si rrjedhojë, Gjykata konstaton që kërkesa është e pranueshme dhe do t'i trajtojë meritat e kërkesës.

34. Kjo kërkesë është rasti parë i dorëzuar nga ndonjë gjykatë në Kosovë ku gjykata e tillë nuk ka qenë e sigurt për përputhshmërinë e ligjit me Kushtetutën dhe ku, sipas nenit 113 (8) të Kushtetutës, pushteti është ushtruar. Neni 113 (8) i Kushtetutës është mjet i fuqishëm në administrimin e drejtësisë pasi u lejon të gjitha gjykatave në Kosovë të referojnë çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese. Nëse ka rast të pazgjidhur dhe nëse rasti varet nga pyetja, atëherë nuk ka pengesë për kërkesë.

35. Mund të paraqiten rrethana në të cilat gjykatat e rregullta kanë dyshime apo pasiguri nëse zbatimi i një ligji mund t'i shkelë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë, si Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj. Kjo Gjykatë është e pozicionuar brenda kornizës kushtetuese për t'iu përgjigjur pyetjeve të tilla dhe gjykatat janë të autorizuara të parashtrojnë pyetje të tilla.

Vlerësimi i meritave

36. Në esencë, Gjykata Supreme i ngrit dy çështje kryesore lidhur me dispozitat e kontestuara të Ligjit për shpronësim të vitit 2009. E para është, nga që ekzistojnë dy procedura të ndryshme gjyqësore që personat të cilëve u shpronësohet prona mund të jenë të obliguar t'i përdorin, se ka shkelje të Kushtetutës. Njëra procedurë është kur organi publik, e jo Qeveria, dëshiron ta marrë tokën. Në një rast të tillë, procedura është që ankesa të paraqitet në gjykatën përkatëse komunale ku gjendet toka. Megjithatë, nëse toka merret nga Qeveria, atëherë procedura është që ankesa të paraqitet në Gjykatën Supreme. I njëjti rregull vlen nëse ankesa ka të bëjë me vendimin preliminar mbi ligjshmërinë e shpronësimit të propozuar, shumën e kompensimit, dëmet që pësohen nga shpronësimi i pjesshëm apo ligjshmërinë e vendimit për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës.

37. Çështja e dytë që parashtruesja ngrit është se ekziston një numër i madh i lëndëve të parashtruara në Gjykatën Supreme që kanë ardhur si rrjedhojë e shpronësimit në komunën e Prizrenit dhe shumë të tjera pritet të vijnë nga shpronësimet që do të ndodhin vetëm përgjatë autostradës Vërmicë – Merdarë. Kjo Gjykatë vëren që Qeveria e Kosovës është duke ndërtuar autostradën kombëtare Vërmicë – Merdarë.

38. Sa i përket çështjes së parë, a mund të thuhet që pasi ka dy rrugë për mjete juridike për shpronësim nga dy organe të ndryshme, *ipso facto*, ka shkelje të Kushtetutës, që shfaqet qoftë nga diskriminimi apo në ndonjë mënyrë tjetër? Kur i shikojmë personat që mund të shpronësojnë tokë në Republikën e Kosovës, përkufizimet në Ligj përkufizojnë se ""Organi Shpronësues" nënkupton *"një Komunë ose Qeverinë që është e autorizuar për kryerjen e shpronësimit sipas nenit 4 të këtij ligji"*. Prandaj, është e qartë që edhe komuna edhe Qeveria janë organe që mund ta kryejnë shpronësimin.

39. Me rastin e shqyrtimit të nenit 4 të Ligjit për shpronësim, ekzistojnë kushte të përgjithshme që duhet të përmbushen nëse një organ shpronësues dëshiron ta shpronësojë pronën e paluajtshme. Këto kushte të përgjithshme janë:

1. Organi Shpronësues është i autorizuar të bëjë shpronësimin e pronës së paluajtshme vetëm pas përmbushjes së të gjitha kushteve në vijim:

1.1. shpronësimi bëhet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë për arritjen e një qëllimi të ligjshëm publik brenda kompetencave të tij të përcaktuara në paragrafët 2. dhe 3. të këtij neni;

1.2. qëllimi i ligjshëm publik nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e Shpronësimit;

1.3. përfitimi publik nga shpronësimi është më i madh se interesat të cilat do të ndikohen negativisht nga Shpronësimi; dhe

1.4. prona e paluajtshme e cila është objekt i shpronësimit nuk është zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues; dhe

1.5. Organi Shpronësues i ka përmbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij ligji.

40. Neni 4 vazhdon të thotë çfarë kushtesh të veçanta zbatohen për komuna kur ato dëshirojnë ta shpronësojnë tokën për funksione të tyre. Këto funksione, jo çuditërisht, kanë të bëjnë me mandatin e komunës që lidhen me planifikimin, ndërtimin e rrugëve komunale, objekteve publike dhe të ngjashme. Ato përkufizohen me sa vijon:

"...Organi Shpronësues i Komunës mund bëjë shpronësimin e pronës se paluajtshme vetëm nëse:

2.1. kushtet e përcaktuara në paragrafit 1. të këtij neni;

2.2. shpronësimi i prek shprehimisht të drejtat private në fushëveprimin e paragrafit 3. të nenit 3 të këtij ligji;

2.3. prona e paluajtshme përkatëse gjendet plotësisht brenda kufijve të Komunës; dhe

2.4. shpronësimi ndërlidhet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë me arritjen e njërit nga qëllimet publike në vijim:

2.4.1. zbatimin e një plani urbanistik dhe/ose hapësinor i cili është miratuar dhe shpallur nga një Autoritet Publik Komunal në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;

2.4.2. ndërtimin ose zgjerimin e një ndërtese ose objekti i cili i do të shfrytëzohet nga një Autoritet Publik Komunal për ushtrimin e funksionit të tij publik; ose

2.4.3. ndërtimin, zgjerimin, themelimin ose vendosjen e infrastrukturës dhe/ose stabilimenteve në vijim, nëse kjo është e nevojshme për avancimin e mirëqenies së përgjithshme ekonomike dhe/ose shoqërore të komunës ose ka një përfitim tjetër të qartë publik për banorët e komunës dhe është në përputhje me kushtet e aplikueshme ligjore:

2.4.3.1. rrugët komunale (rrugët të cilat shtrihen tërësisht brenda Komunës) të cilat ofrojnë shërbime të transportit për publikun;

2.4.3.2. objektet publike të cilat i nevojiten një Autoriteti Publik Komunal për sigurimin e shërbimeve arsimore, shëndetësore dhe/ose të mirëqenies sociale brenda Komunës;

2.4.3.3. gypat që përdoren për sigurimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për vendbanimet brenda Komunës;

2.4.3.4. deponitë komunale dhe vendet për deponimin e mbeturinave publike;

2.4.3.5. varrezat publike komunale; ose

2.4.3.6. parqet publike komunale dhe objektet publike komunale të sportit; ose

2.4.4. përvetësimin e të drejtave sipërfaqësore të cilat i nevojiten një Autoriteti Publik Komunal për zbatimin e një licence të shfrytëzimit zejtar të mineraleve e cila i është dhënë Komunës nga KPMM në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale.

41. Kushte të ndryshme zbatohen nëse organi shpronësues është Qeveria. Këtu, funksionet kanë të bëjnë me gjëra të tilla, si rrugët ndërkomunale, hekurudhat, prodhimi dhe transmisioni i energjisë, stabilimentet dhe linjat *e* telekomunikacionit, pendët, rezervarët publikë të ujit, dhe të tjera. Këto përcaktohen me sa vijon:

3. Qeveria është e autorizuar ta bëjë shpronësimin e pronës për çfarëdo qëllimi tjetër të ligjshëm publik i cili nuk është përcaktuar në pikat e nën-paragrafit 2.4.1 deri më 2.4.4 të paragrafit 2 të këtij neni, nëse i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni. Për këto Shpronësime, Organi përgjegjës Shpronësues është Qeveria. Qëllime të ligjshme publike në kuptim të këtij paragrafi janë, por pa u kufizuar vetëm në këto:

3.1. zbatimi i një plani urbanistik dhe/ose hapësinor i cili është miratuar dhe shpallur nga një Autoritet Publik Qendror në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse ligjore;

3.2. ndërtimi ose zgjerimi i një ndërtese ose objekti i cili do të shfrytëzohet nga një Autoritet Publik Qendror për ushtrimin e funksionit të tij publik;

3.3. ndërtimin, zgjerimin ose vendosjen e infrastrukturës dhe/ose stabilimenteve të nevojshme për avancimin e mirëqenies së përgjithshme ekonomike dhe/ose shoqërore të Kosovës ose që ka një përfitim tjetër të qartë publik duke përfshirë, përveç tjerash, ndërtimin, zgjerimin ose vendosjen e:

3.3.1. rrugëve shtetërore ose ndër-komunale të cilat ofrojnë shërbime të transportimit për publikun, duke përfshirë rrugët me pagesë;

3.3.2. hekurudhave të cilat ofrojnë shërbime të transportimit për publikun;

3.3.3. punimeve, objekteve, zonave të sigurisë ose zonave për ruajtjen e karburantit ose zonave për hedhjen e mbetjeve që ndërlidhen me prodhimin, furnizimin, transmisionin ose distribuimin e energjisë;

3.3.4. minierave dhe punimeve tjera, zonave të sigurisë dhe objekteve për shfrytëzimin e resurseve minerare;

3.3.5. stabilimenteve dhe linjave të telekomunikacionit, duke përfshirë linjat telegrafike dhe telefonike, dhe të rrjetit të radios dhe televizionit;

3.3.6. objekteve publike të nevojshme për qëllime të arsimit, shëndetësisë dhe/ose shërbimeve të mirëqenies sociale nga një autoritet qendror publik;

3.3.7. gypat kryesor që përdoren nga një NP për sigurimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për publikun;

3.3.8. deponive dhe vendeve për deponimin e mbeturinave publike;

3.3.9. pendave;

3.3.10. rezervuarëve publik të ujit;

3.3.11. varrezave shtetërore për veteranë të dalluar dhe shërbyes publik të dalluar;

3.3.12. aeroportet publike, duke përfshirë zonat e sigurisë rreth aeroporteve publike;

3.3.13. parqet shtetërore publike dhe objektet shtetërore publike të sportit;

3.3.14. rezervatet mjedisore ose natyrore, duke përfshirë ato me qasje të kufizuar për publikun; ose

3.3.15. punimeve, infrastrukturës, objekteve, zonave ose vendeve të cilat janë paraparë në një Kontratë të

Infrastrukturës të dhënë nga një Organ Tenderues, ose që nevojiten me arsye për zbatimin e kësaj kontrate.

3.4. mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe vendeve me rëndësi arkeologjike, historike ose shkencore, por vetëm nëse vendi është përcaktuar si i tillë në mënyrë të ligjshme me një rezolutë të Kuvendit dhe, ose:

3.4.1. pronari i pronës së paluajtshme në të cilin ndodhet monumenti ose vendi refuzon ta mbrojë atë ose për shkak të pamundësisë objektive nuk mundet ta mbrojë monumentin ose vendin; ose

3.4.2. pronari pranon ose kërkon shpronësimin e pronës përkatëse.

42. Gjykatës i duket që, me rastin e miratimit të këtij Ligji, ligjvënësit ishin të vetëdijshëm për dallimin ndërmjet shpronësimit nga komunat dhe shpronësimit nga Qeveria. Në nenet e kontestuara, Kuvendi parashikoi se do të ketë mekanizma të ndryshëm për ankesë për shpronësime nga komunat dhe për shpronësime nga Qeveria. Mund të kuptohet pse kjo është kështu. Komunat janë të kufizuara për shpronësime brenda juridiksionit të vet dhe për funksione të tyre të posaçme statutore. Ato janë të kufizuara vetëm brenda territorit të komunës.

43. Shpronësimet nga Qeveria kanë natyrë tjetër. Në përgjithësi, këto shpronësime janë më të përqendruara në dobi të infrastrukturës kombëtare. Ka dobi të qartë për ta pasur një organ të përgjithshëm përgjegjës për zhvillimin kombëtar dhe Kuvendi ka përcaktuar që kjo kompetencë do t'i takojë Qeverisë.

44. Prandaj, Gjykata e ka vështirë të konstatojë që ka diskriminim kundër ndokujt në lidhje me mekanizmat për "ankesë" që janë

miratuar në Ligjin për shpronësim. Askujt nuk i mohohet e drejta për mjete juridike ndaj një vendimi gjyqësor për shkaqet e tyre të ankesës që shfaqen nga vendimet për ta shpronësuar pronën e paluajtshme apo për shumën e kompensimit. Për shpronësimet nga komuna, organi i shkallës së parë është gjykata komunale në të cilën gjendet prona. Për shpronësimet nga Qeveria, shkalla e parë dhe e vetme është Gjykata Supreme.

45. Gjykata Kushtetuese ka parasysh lejimin e posaçëm të përfshirë në nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], i cili lejon që rasti të referohet drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme pa të drejtë ankese, në të cilin posaçërisht përcaktohet që:

> *"...Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese."*

46. Prandaj, kjo Gjykatë është e kënaqur që nuk ka shkelje kushtetuese në përcaktimin që ankesat kundër vendimeve të komunave shqyrtohen në gjykatat përkatëse komunale dhe në përcaktimin që ankesat kundër vendimeve të Qeverisë shqyrtohen në Gjykatën Supreme.

47. Përgjigja për argumentet lidhur me atë se si palët e prekura nga vendimi për shpronësim mund të jenë në konfuzion sa i përket procedurës që duhet të zbatohet me rastin e paraqitjes së ankesës gjendet në referencën e nenit 39 të Ligjit për shpronësim, i cili përcakton që dispozitat e neneve 35, 36, 37 dhe 38 kanë përparësi: *"1. Ankesat dhe kontestet tjera juridike nga nenet 35, 36, 37 ose 38 të këtij ligji do të zhvillohen në përputhje me ato nene. Në rast të konfliktit ndërmjet këtyre neneve dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative ose cilitdo ligj tjetër procedural, këto nene kanë përparësi."*

48. Argumenti i dytë i parashtrueses ka të bëjë me numrin e lëndëve që mund të parashtrohen pranë saj, që shfaqen nga ndërtimi i autostradës kombëtare dhe i një sërë shpronësimeve që mund të pasojnë. Mund të ndodhë që shumë persona do të jenë të

pakënaqur me vendimet për shpronësim të tokës përgjatë rrugës së propozuar. Mund të parashtrohet një numër i madh i çështjeve që e kontestojnë një vendim paraprak për ligjshmërinë e një shpronësimi të propozuar. Megjithatë, parimet që shfaqen nga këto vendime gjithashtu mund të zgjidhen mirë në rastet e para të vendosura mbi meritat. Ankesat që e kontestojnë shumën e kompensimit duhet ta përcjellin parimin e përgjithshëm të vlerës së tregut për pronën e shpronësuar, siç parashihet në nenin 15 të Ligjit për shpronësim.

Neni 15

Rregullat themelore për përcaktimin e shumës së kompensimit

1. Kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës, e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6. të këtij neni.

49. Gjykatat e Kosovës, duke përfshirë Gjykatën Supreme, kanë mundësi ta zbatojnë këtë parim themelor të përcaktuar mirë. Ka të ngjarë që një numër i madh i rasteve nuk do t'i referohen Gjykatës Supreme, siç parasheh ajo.

50. Kjo Gjykatë ka theksuar më herët se Kushtetuta bazohet në doktrinën e ndarjes së pushteteve. Në Aktgjykimin e vet në Kërkesën KO 98/11, të 20 shtatorit 2011, lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Gjykata tha në paragrafin 44, *"Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Ndarja e pushteteve është njëra prej bazave që garanton funksionim demokratik të shtetit. Esenca e funksionimit të pavarur dhe efektiv të këtyre degëve është imuniteti që u është dhënë njerëzve që i mishërojnë këto pushtete"*.

51. Gjykata Kushtetuese nuk do të duhej të ndërhynte lehtë në sferën e vendimmarrjes së Kuvendit kur ai vendosi për këto dispozita të kontestuara, për më tepër kur mjeti juridik për çështjen e shqyrtimit të një numri të madh të lëndëve është brenda kompetencave të parashtrueses dhe Kuvendit, qoftë në ndarjen e burimeve shtesë për Gjykatën Supreme për t'i mundësuar asaj që të merret me ngarkesën e parashikuar të punës sipas Ligjit të ri për shpronësim apo në dhënien me kohë të kompensimit të plotë për pronën e shpronësuar. Këto janë çështje plotësisht brenda juridiksionit të gjyqësorit, legjislaturës dhe Qeverisë dhe për diskutim, po qe nevoja, ndërmjet tyre. Përgjegjësia parësore për administrimin e mirëfilltë të drejtësisë i takon Qeverisë.

52. Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjejë se ka shkelje të Kushtetutës së Kosovës as mbi atë bazë.

PËR KËTO ARSYE

Në përputhje me nenin 113.8 të Kushtetutës, nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit, dhe rregullin 75 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese me shumicë

VENDOSI

I. Që kërkesa është e pranueshme;

II. Që nenet 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësim Nr. 03/L-139, janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës;

III. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. Dr. Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KI 37/11 datë 06 mars 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.5/2008, të 9 korrikut 2010

Rasti KI 37/11, vendimi i Gjykatës të Gjykatës Supreme të Kosovës

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, jashtë afatit kohor , Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesja e kërkesës ka theksuar se me vendimin e kontestuar asaj i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë të parapara me nenet 23 (Dinjiteti Njerëzor), 24 (Barazia para Ligjit), 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit)

Parashtruesja e kërkesës, gjithashtu, ka theksuar se Gjykata Supreme e Kosovës duke refuzuar revizionin e paditëses me Aktgjykimin i Rev. nr. 5/2008, të 9 korrikut 2010, ia ka pamundësuar realizimin e të drejtës së saj për kompensimin e pagave të papaguara për kohën që ajo në mënyrë të kundërligjshme ishte e larguar nga puna, prandaj kërkon nga Gjykata Kushtetuese që t'ia njohë këtë të drejtë.

Gjykata konstaton se parashtruesja nuk e ka përmbushur kushtin e pranueshmërisë së kërkesës, për shkak se nuk e ka parashtruar kërkesën brenda afatit prej 4 (katër) muajsh .

Prishtinë, më 01 mars 2012

Nr. ref.: RK204/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMERI

në

Rastin Nr. KI 37/11

Parashtruesi

Jalldyze Kastrati

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.5/2008, të 9 korrikut 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Jalldyze Kastrati, nga Gjakova, me banim në rr. Nëna Terezë banesa nr. 7 , e përfaqësuar nga avokati, z. Hasan Shala, nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev.nr.5/2008, i datës 09. 07. 2010, me anë të cilit është refuzuar Revizioni i të padituës, znj. Jalldyze Kastrati, nga Gjakova, i paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 318/2004, i datës 08.05.2007, të cilin pala e ka pranuar më 17 shtator 2010.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës më 16 mars 2011, është kontesti i punës që parashtruesja e kësaj kërkese e ka me ish- punëdhënësin e saj, SH.A 'Virgjinia" nga Gjakova, e që ka të bëjë me mospagesën e të ardhurave personale për periudhën kohore 14.11.1994 deri me 28.08.1997, sa ka qenë në mënyrë të kundërligjshme e larguar nga puna. Parashtruesja e kërkesës ka iniciuar procedurë gjyqësore për këtë rast dhe duke qenë e pakënaqur me vendimin e Gjykatës

së Qarkut në Pejë, ajo ka ushtruar Revizion në Gjykatën Supreme, dhe pikërisht Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev.nr.5/2008, i 09 korrikut 2010, është akti i autoritetit publik të cilin e konteston parashtruesja, ndaj të cilit kërkon vlerësim të kushtetutshmërisë.

Baza Juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 16 mars 2011, znj. Jalldyze Kastrati parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës me të cilën kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 5/2008, të 9 korrikut 2010.

6. Më 23 mars 2011, Gjykata Kushtetuese ka kërkuar nga përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës që kësaj Gjykate t'ia paraqesë të gjithë dokumentacionin për ecurinë e lëndës, në të gjitha instancat gjyqësore, duke përfshirë edhe vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta.

7. Më 4 prill 2011, Gjykata Kushtetuese ka pranuar nga përfaqësuesi ligjor i parashtrueses së kërkesës plotësimin e kërkesës me dokumentacionin e kërkuar.

8. Më 18 prill 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët

Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu anëtar dhe Gjyljeta Mushkolaj, anëtare.

9. Më 14 qershor 2011, pas raportimit të Gjyqtarit raportues Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues i përbëre nga Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu (anëtar) dhe Gjyljeta Mushkolaj (anëtare), i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Znj. Jalldyze Kastrati ishte në marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar në KBI "Virxhinia" SH.A. në Gjakovë.

11. Më 15 nëntor 1994, Komisioni disiplinor i punëdhënësit, KBI SH.A "Virxhinia", në Gjakovë, me Vendim nr. 105 ia ka shqiptuar znj. Kastrati masën disiplinore "ndërprerje të marrëdhënies së punës", ndërsa Komisioni i ankesave i të njëjtit punëdhënës me vendim nr. 138, të 23 dhjetorit 1994, ka vërtetuar vendimin e Komisionit disiplinor lidhur me shqiptimin e kësaj mase disiplinore.

12. Më 24 dhjetor 1996, Gjykata Komunale në Gjakovë me Aktgjykimin P. nr. 9/95 ka aprovuar kërkesë-padinë e znj. Kastrati dhe ka anuluar vendimet e punëdhënësit, KBI SH.A" Virxhinia", dhe ka obliguar të padituren që ta kthejë në punë znj. Kastrati me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

13. Më 23 janar 1998, me Aktgjykimin P. nr. 60B/96, Gjykata Komunale në Gjakovë ka aprovuar kërkesëpadinë tjetër të paditëses, znj. Kastrati, dhe ka obliguar KBI Sh.A. "Virxhinia" që t'ia kompensojë të ardhurat personale të pa paguara në emër të largimit ë paligjshëm nga puna për periudhën kohore 14 nëntor 1994 deri më 28 gusht 1997, në shumën prej 13.332.00 dinarëve të atëhershëm, së bashku me kamatën ligjore të llogaritur nga 1 janari 1997.

14. Më 27 nëntor 1998, duke vepruar sipas ankesës së të paditurës Sh.A. "Virxhinia" në Gjakove, Gjykata e Qarkut në Pejë me Aktvendimin Ac. nr. 673/98 e kishte prishë aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Gjakovës C. nr. 608/96, të 23 janarit 1998 dhe lënda i është kthyer Gjykatës së shkallës së parë, në rivendosje, me vërejtjen nëse ka qenë i plotfuqishëm Aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë C. nr. 9/1995. Kjo lëndë ka ngelë e papërfunduar para luftës në Kosovë, ashtu që paditësja me parashtresën e 12 shkurtit 2002, ka kërkuar vazhdimin e procedurës.

15. Më 25 mars 2004, me Aktgjykimin e saj C. nr. 84/02, Gjykata Komunale në Gjakovë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe e ka aprovuar kërkesë-padinë e paditëses për kompensimin e pagave mujore të papaguara në shumën prej 2.238,00 € si dhe pagesën e shpenzimeve procedurale në shumën prej 700,00 €.

16. Më 8 maj 2008, Gjykata e Qarkut në Pejë me Aktgjykimin A. C nr. 318/04, ka ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë C. nr. 84/02, të 25 marsit 2004, dhe ka hedhur poshtë si të pabazuar kërkesë-padinë e paditëses, znj. Jalldyze Kastrati, për kompensimin e pagave të pa paguara duke theksuar se SH.A. ”Virxhinia” e tanishme nuk është pasardhëse e i ish-KBI SH.A ”Virxhinia” dhe paditësja nuk është në ”raport juridik-civil a të punës” me punëdhënësin e tashëm SH.A. “Virxhinia”, prandaj ky punëdhënës nuk ka asnjë obligim ndaj paditëses.

17. Më 09 korrik 2010, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 5/2008, ka hedhur poshtë si të pabazuar Revizionin e paraqitur nga paditësja, znj. Jalldyze Kastrati, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 318/2004, të 8 majit 2007.

18. Sipas deklarimit personal të shkruar në kërkesën e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, znj. Jalldyze Kastrati, ka pohuar se Aktgjykimin e Gjykatës Supreme e ka marrë më 17 shtator 2010.

19. Më 16 mars 2011, znj. Jalldyze Kastrati, përmes përfaqësuesit të saj, avokatit z. Hasan Shala, parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtuese duke pretenduar për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, të cekura në kërkesë.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

20. Parashtruesja e kërkesës ka theksuar se me vendimin e kontestuar asaj i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë të parapara me nenet 23 (Dinjiteti Njerëzor), 24 (Barazia para Ligjit), 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe 49 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit).

21. Parashtruesja e kërkesës, gjithashtu, ka theksuar se Gjykata Supreme e Kosovës duke refuzuar REVIZIONIN e paditëses me Aktgjykimin i Rev. nr. 5/2008, të 9 korrikut 2010, ia ka pamundësuar realizimin e të drejtës së saj për kompensimin e pagave të papaguara për kohën që ajo në mënyrë të kundërligjshme ishte e larguar nga puna, prandaj kërkon nga Gjykata Kushtetuese që t'ia njohë këtë të drejtë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Në mënyre që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë në tërësi kërkesën e parashtrueses, duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë.

23. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton se:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetute, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Gjykata, gjithashtu merr parasysh:

Nenin 49 të Ligjit për Gjykatë Kushtetuese të Republikës së Kosovës që i referohet kërkesave individuale dhe në të cilin përcaktohet;

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.

24. Në Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në rregullin 36, paragrafi 1, është thënë qartazi se: Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

"b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi ".

25. Duke shqyrtuar faktet relevante të paraqitura në kërkesë, Gjykata konstaton se parashtruesja nuk e ka përmbushur kushtin e

pranueshmërisë së kërkesës, për shkak se nuk e ka parashtruar kërkesën brenda afatit prej 4 (katër) muajsh, të kërkuar me dispozitat juridike të cekura në paragrafët paraprakë të këtij raporti, sepse Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 5/2008 e kishte pranuar më 17 shtator 2010, ndërsa kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës e kishte dorëzuar më 16 mars 2011, pra pas kalimit të fatit prej 4 (katër) muajsh brenda të cilit e kishte obligim ligjor ta paraqiste atë.

26. Në rastin konkret, Gjykata thekson se kriteri juridik i pajtueshmërisë me afatin 4 mujor për paraqitjen e një kërkese ka për qëllim që të promovojë parimin e sigurisë juridike dhe të sigurojë palët se lëndët që janë nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese ekzaminohen brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që të mbrojë autoritetet dhe palët e tjera të interesuara nga situatat e të qenkëshit në "paqartësi" për një periudhë të gjatë kohore (shih (*ECHR P.M. v. the United Kingdom* Aplikacioni nr. 6638/03, i datës 24 gusht 2004 *)*

27. Prandaj, nga rrethana e cekur më lartë, del se parashtruesi i kërkesës nuk i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë për shkak të paraqitjes së kërkesës pas kalimit të aftit 4 (katër) mujor, siç është paraparë me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese, dhe:

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.1(b) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 14 qershorit 2011, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KI 59/11 datë 22 mars 2012- Në lidhje me kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës, SCA 15/07, të 26 dhjetorit 2007

Rasti KI 59/11, vendim i 9 marsit 2012

Fjalët kyçe: e drejtat në gjykim të drejtë, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, kodi penal, vrasje e rëndë.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me ç'rast u vërtetua aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ku parashtruesi u dënua për vrasje me paramendim dhe posedim të paligjshëm të armës. Parashtruesi pohoi se Gjykata Supreme ka cenuar të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 paragrafi 2 të Kushtetutës së Kosovës.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së Punës për shkak se parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pohimin e tij për të sqaruar si dhe pse janë cenuar të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Kosovës. Gjykata më tutje arsyetoi se kërkesa nuk tregon se Gjykata Supreme kishte vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë.Për shkak të arsyeve të përmendura, Gykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

Prishtinë, më 09 mars 2012

Nr. ref.: RK202/12

Aktvendim për papranueshmëri

në

Rastin Nr. KI 59/11

Parashtrues

Zyfer Sahitolli

Në lidhje me kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës, SCA 15/07, të 26 dhjetorit 2007

Gjykata Kushtetuese, e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Zyfer Sahitolli, me vendbanim në Qendrën Korrektuese në Lipjan, Kosovë.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Nr. 15/07, të 26 dhjetorit 2007, me të cilin konfirmohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Nr. 297/2004, i 15 shtatorit 2006, për krim të vrasjes së rëndë në kundërshtim me nenin 147, paragrafin 1, nënparagrafin 11, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe për përdorim të paautorizuar të armës në kundërshtim me nenin 328, paragrafin 2, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Ai u dënua me 12 vjet burgim prej 2 marsit 2004.

3. Parashtruesi dëshiron që Gjykata Kushtetuese të gjejë shkelje të të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe t'i mundësohet gjykim i ri dhe/apo që dënimi i tij për vrasje me paramendim të zvogëlohet në vrasje me gjendje të çrregulluar mendore.

Baza juridike

4. Neni 113.1 dhe 7 i Kushtetutës, neni 20 i Ligjit dhe rregulli 36 i Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 29 prill 2011.

6. Më 3 maj 2011, Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 27 korrik 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe Gjykatën Supreme për parashtrimin e kërkesës nga parashtruesi. Gjykata Kushtetuese gjithashtu kërkoi nga Gjykata Supreme të paraqiste prova që atij ia kishte dorëzuar Aktgjykimin e vet.

8. Më 29 qershor 2011, Gjykata i shkroi parashtruesit dhe kërkoi datën kur Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar atij.

9. Gjykata nuk ka marrë asnjë përgjigje për këtë korrespondencë.

Përmbledhje e fakteve

10. Gjykata e Qarkut në Prishtinë e dënoi parashtruesin për vrasje me paramendim dhe posedim të paligjshëm të armës më 15 shtator 2006.

11. Më 26 dhjetor 2007, Gjykata Supreme e Kosovës e konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me të cilin e dënoi

parashtruesin për vrasje me paramendim dhe posedim të paligjshëm të armës. Megjithatë, Gjykata Supreme e modifikoi dënimin që ia kishte shqiptuar parashtruesit duke e ngritur atë në 17 vjet që nga 2 marsi 2004.

12. Më 2 mars 2004, parashtruesi dhe i ndjeri, Kadri Krasniqi, dhe vëllai i tij, Sabri Krasniqi, u takuan në ndërtesën e postës në fshatin Lipjan. Gjatë këtij takimi filloi një përleshje ndërmjet parashtruesit dhe vëllezërve Krasniqi për shkak se ata mendonin që parashtruesi i kishte thirrur disa herë në telefon dhe i kishte fyer. Gjatë kësaj përleshjeje, Kadri Krasniqi e kishte qëlluar disa herë me grusht parashtruesin.

13. Më vonë, më 2 mars 2004, parashtruesi u kthye në rrugën Adem Jashari në Lipjan dhe, gjatë një konfrontimi me Kadri Krasniqin, shkrepi dy plumba në trupin e Kadriut, i cili vdiq nga humbja e gjakut.

14. Pasi parashtruesi e qëlloi Kadri Krasniqin, ai më pas e ndoqi Sabri Krasniqin, i cili ishte duke ikur në drejtim të stacionit të policisë, dhe shtiu disa herë në drejtim të tij, por nuk e qëlloi me asnjërin nga plumbat e shkrepur.

15. Parashtruesi nuk kishte leje për përdorim ose posedim të armës, një revole Helvan 9mm, me numër të serisë 1052235, që e përdori për ta vrarë Kadri Krasniqin dhe që e përdori për të shtënë në drejtim të Sabri Krasniqit.

16. Parashtruesi i njihte edhe më parë të ndjerin dhe vëllanë e tij. Në të vërtetë, parashtruesi kishte dalë më parë me bashkëshorten e Sabri Krasniqit para se ajo të martohej me Sabriun.

17. Disa dëshmitarë të vrasjes, si dhe psikiatri Dr. Nazmije Musliu, dëshmuan gjatë gjykimit. Dr. Musliu dëshmoi në lidhje me gjendjen mendore të parashtruesit në kohën e vrasjes.

18. Gjykata e Qarkut me kujdes i shqyrtoi të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve dhe më pas konkludoi se provat tregonin që parashtruesi e kishte vrarë të ndjerin Kadri Krasniqi. Ajo konkludoi që vrasja nuk ishte bërë në vetëmbrojtje dhe se nuk ishte produkt i gjendjes psikologjikisht të çrregulluar mendore. Ajo gjeti që parashtruesi ishte në gjendje të largohej nga vendi i konfrontimit dhe më tej konkludoi që parashtruesi kishte ndërmend ta vriste jo vetëm të ndjerin, por edhe vëllanë e tij duke e ndjekur atë dhe duke shkrepur plumba në drejtim të tij kur ai ishte duke ikur në drejtim të stacionit policor.

19. Gjykata Supreme me kujdes i shqyrtoi gjetjet dhe aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Ajo konkludoi që parashtruesi dhe viktimat e këtij krimi njiheshin që më parë dhe se kishte pasur grindje të vazhdueshme ndërmjet tyre, se në ditën e vrasjes kishte pasur konfrontim fizik ndërmjet parashtruesit dhe viktimës dhe se, më vonë gjatë asaj dite, parashtruesi përsëri ishte konfrontuar me viktimat, por kësaj radhe ishte i pajisur me armë pa leje.

20. Gjykata Supreme më tej konkludoi që, si çështje e ligjit, mbrojtja lehtësuese e "gjendjes së çrregulluar mendore" është mbrojtje e jashtëzakonshme që zbatohet vetëm në ato situata në të cilat trupi i kryesit të veprës është në rrezik apo i lënduar dhe në të cilat kryesi i veprës nuk e provokon sulmin ndaj trupit të tij. Gjykata Supreme gjeti që parashtruesi në këtë rast e kishte shqetësuar palën e dëmtuar dhe e kishte krijuar konfrontimin që rezultoi në vdekjen e Kadri Krasniqit dhe në përpjekjen për ta vrarë Sabri Krasniqin. Gjykata Supreme konkludoi që ky nuk është veprim që do të lejonte që parashtruesi të pohonte se ishte duke vuajtur nga një gjendje e çrregulluar psikologjike në kohën e vrasjes.

Faktet e kontestuara dhe të pakontestuara

21. Nuk ka fakte të pakontestuara. Megjithatë, konkluzionet që duhet të nxirren nga faktet janë të kontestuara.

Argumentet juridike të paraqitura nga parashtruesi

22. Parashtruesi pohoi që nuk ka pasur gjykim të drejtë, duke aluduar në shkelje të nenit 31, paragrafit 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ai veçanërisht pohon që gjykatat nuk kanë pasur prova të mjaftueshme për ta shpallur atë fajtor për vrasje me paramendim.

23. Parashtruesi gjithashtu pohoi që bashkëshortja e viktimës, Sabri Krasniqit, nuk u lejua të dëshmonte apo që kunati i tij të dëshmonte që fëmijët e tij ishin në shtëpinë e vjehrrit të tij. Ai gjithashtu pohoi që as bashkëshortja e tij nuk u lejua të dëshmonte lidhur me planin e veprimtarive të tij për t'i regjistruar fëmijët e tij në ditën e vrasjes së Kadri Krasniqit.

24. Parashtruesi gjithashtu pohoi që aktakuza e ngritur nga prokurori dhe e miratuar nga gjykata ishte e pavend sepse ai fillimisht nuk ishte marrë në pyetje nga prokurori.

25. Parashtruesi gjithashtu u ankua që nuk i ishte lejuar t'i bënte pyetje babait të viktimës dhe ishte ndërprerë disa herë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit Sabri Krasniqi.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

26. Neni 31, paragrafi 2, i Kushtetutës përcakton:

"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose

për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."

27. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton:

1. *Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

2. *Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.*

3. *Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*

a. *të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;*

b. *t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;*

c. *të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;*

d. *të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;*

e. *të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq*.

28. Sa u përket dëshmitarëve që parashtruesi dëshironte të thirreshin apo të merreshin në pyetje më gjerësisht gjatë gjykimit, parashtruesi nuk ofron fakte lidhur me atë se çfarë provash do të mund të nxirreshin nga ata dëshmitarë e që do të ishin relevante për ndonjë çështje apo për mbrojtjen që parashtruesi do të mund ta parashtronte ndaj aktakuzës. Natyrisht, gjykata mund dhe duhet ta trajtojë atë që është dhe atë që nuk është relevante në një rast. Parashtruesi nuk ka treguar para kësaj Gjykate apo para Gjykatës Supreme se ato prova do të ishin relevante.

29. Nuk kishte prova për ta mbështetur pretendimin që të drejtat e parashtruesit në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës apo me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë shkelur.

30. Rregulli 36.2 kërkon që Gjykata ta refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse kërkesa nuk arsyetohet *prima facie*, ose kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

31. Gjykata i referohet:

a. Rregullit 36 (1) (a) dhe (c) të Rregullores së punës: *Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj dhe kërkesa është qartazi e bazuar*.

b. Rregullit 36 (2) (b) dhe (d): *Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se faktet e paraqitura nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

32. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pohimin e tij për të sqaruar si dhe pse është bërë shkelja, dhe nuk ka ofruar prova për të dëshmuar se është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë.

33. Përveç kësaj, kërkesa nuk tregon që Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të Kushtetutës. Në këto rrethana, nuk mund të konsiderohet që parashtruesi i ka përmbushur kriteret e përcaktuara për pranueshmëri të përmendura më sipër.

34. Nuk ka prova për ta mbështetur pretendimin e parashtruesit.

PËR KËTO ARSYE

Pas shqyrtimit të mbajtur më 29 nëntor 2011, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit, dhe rregullit 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'i komunikohet parashtruesit; dhe

III. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 51/10 datë 26 mars 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Goran Zdravkovićit anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si përfaqësues të komunitetit serb

Rasti KI 51/10, vendim i 9 marsit 2012

Fjalët kyçe: actio popularis, cenim i lirive dhe të drejtave kushtetuese, komisioni qendror i zgjedhjeve, kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, presidenti i republikës së Kosovës.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Goran Zdravkovićit anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si përfaqësues i komunitetit serb. Parashtruesi pohoi se Presidenti i Republikës së Kosovës kishte cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me kushtetutë pa saktësuar ndonjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme bazuar në nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës për shkak se parashtruesi nuk kishte paraqitur kërkesën në pajtim me afatet kohore të parapara me dispozitën në fjalë. Duke cituar praktikën e saj gjyqësore në rastin KI 41/09 *Universiteti AAB-RIINVEST SH. P. K, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës,* Gjykata më tutje arsyetoi se parashtruesi nuk kishte saktësuar kërkesën në pajtim me Nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe se nuk kishte provuar se në çfarë mënyre ishin cenuar të drejtat e tij kushtetuese nga akti i autoritetit publik pasi që Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh mjetin *actio popularis*. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

Prishtinë, më. 09 mars.2012

Nr. ref.: RK199/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 51/10

Parashtrues

Ljubiša Živić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Goran Zdravkovićit anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si përfaqësues të komunitetit serb

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Ljubiša Živić, nga Graçanica, Kryetar i Lidhjes së Socialdemokratëve të Pavarur.

Pala kundërshtare

2. Pala kundërshtare është Presidenti i Republikës së Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Goran Zdravković anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si përfaqësues i komunitetit serb.

Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë

4. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka specifikuar se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë pretendohet t'i jenë cenuar.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Ankesa e parashtruesit të kërkesës

6. Më 29 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me të cilën pretendon se Presidenti i Republikës së Kosovës e ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës me emërimin e z. Goran Zdravkovićit anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si përfaqësues të komunitetit serb.

7. Më 28 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi një kërkesë tjetër në Gjykatën Kushtetuese, me të cilën kërkon anulimin e Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Goran Zdravkoviç dhe kthimin e z. Sinisha Zhiviç në pozitën e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si përfaqësues të komunitetit serb.

Procedura në Gjykatë

8. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 29 qershor 2010.

9. Me urdhër të Kryetarit të datës 9 korrik 2010, gjyqtarja Gjyljeta Mushkolaj u emërua Gjyqtar Raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari e emëroi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Kadri Kryeziu.

10. Gjykata mbajti këshillime dhe e shqyrtoi kërkesën më 21 shkurt 2011.

Komentet e palës kundërshtare

11. Më 5 korrik 2010, Presidentit të Republikës së Kosovës i është dërguar njoftimi për regjistrimin e lëndës dhe kërkesa për përgjigje. Më 2 gusht 2010, Presidenti i Republikës së Kosovës, përmes juristëve të tij të caktuar në mënyrën e duhur, i dërgoi përgjigje Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 4 korrik 2008, Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu, kërkoi nga përfaqësuesit e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare dhe nga përfaqësuesit e komuniteteve pakicë t'i dërgonin propozimet e tyre për përfaqësues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Më 4 korrik 2008, Presidenti i Republikës së Kosovës, po ashtu, kërkoi nga Partia Liberale Serbe, partia më e madhe politike që përfaqëson komunitetin serb në Kuvendin e Kosovës, që të dërgonte propozimin e saj për emërim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

13. Më 14 korrik 2008, z. Bojan Stojanoviç, kryetar i grupit parlamentar të Partisë Liberale Serbe, i dërgoi letër Presidentit të Republikës së Kosovës me të cilën propozonte z. Goran Zdravkoviç për anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
14. Presidenti i Republikës së Kosovës, më 15 korrik 2008, e emëroi z. Goran Zdravkoviç anëtar të KQZ-së si përfaqësues të

komunitetit serb. Vendimi i Presidentit hyri në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

15. Më 19 korrik 2008, z. Goran Zdravkoviç e dha betimin para Presidentit dhe u bë zyrtarisht anëtar i KQZ-së.

16. Parashtruesi i kërkesës ankohet se Presidenti i Republikës së Kosovës ka bërë shkelje të Kushtetutës dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës duke emëruar z. Goran Zdravkoviç anëtar të Komisionit Qendror Zgjedhor. Sipas parashtruesit të kërkesës, z. Goran Zdravkoviç nuk i plotëson kushtet e parapara me ligj për atë pozitë, sa i përket kualifikimit.

17. Në kërkesën e tij të dytë drejtuar Gjykatës Kushtetuese më 28 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të anulojë Vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe të zëvendësojë z. Goran Zdravkoviç me z. Sinisha Zhiviç, i cili e kishte mbajtur më herët pozitën e anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me vendimin e z. Joachim Rücker, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/25, të datës 29 gusht 2008. Sipas parashtruesit të kërkesës, z. Sinisha Zhiviç i janë cenuar të drejtat me Vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Goran Zdravkoviç anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pa e njoftuar z. Sinisha Zhiviç për zëvendësimin e tij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligjin dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës.

19. Gjykata vëren se neni 49 i Ligjit parasheh se kërkesa është dashur të dorëzohet brenda afatit prej katër (4) muajsh nga vendimi i fundit në këtë rast. Neni 49 përcakton si në vijim:

"Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".

20. Kur ky afat prej katër muajsh ka të bëjë me periudhën para hyrjes në fuqi të Ligjit. Neni 56 i Ligjit parashikon që "afati fillon të llogaritet në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji". Ligji ka hyrë në fuqi më 15 janar 2009, në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

21. Vendimi i kontestuar i Presidentit të Republikës së Kosovës ishte nënshkruar më 15 korrik 2008, dhe ishte bërë publik në të njëjtën ditë. Anëtari i emëruar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me të njëjtin Vendim të Presidentit, e dha betimin para Presidentit të Republikës më 19 gusht 2008. Prandaj, afati për dorëzimin e kërkesës në Gjykatë ka kaluar më 15 maj 2009, ndërsa parashtruesi e ka parashtruar kërkesën më 29 qershor 2010. Rrjedhimisht, kërkesa është e paafatshme, në bazë të nenit të lartpërmendur të Ligjit.

22. Edhe sikur kërkesa të ishte dorëzuar brenda afatit, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar",* ndërsa neni 113.7 i Kushtetutës parasheh që, *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

23. Është e vërtetë se vendimet e Presidentit të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me emërimin e individëve janë vendime të autoriteteve publike. Ato kanë të bëjnë me një ose më shumë të adresuar specifikë, dhe duhet të konsiderohen si vendime që prekin të drejtat dhe liritë individuale të individëve të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, ato mund të jenë objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë, pra, ndaj tyre mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën Kushtetuese.

24. Sidoqoftë, ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit, parashtruesi nuk ka paraqitur prova dhe nuk ka argumentuar pohimin se atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë individuale me vendimin e Kuvendit. Në bazë të Kushtetutës, viktimë konsiderohet personi fizik ose juridik (shih rastin Universiteti AAB-RIINVEST SH. P. K, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti nr. KI. 41/09) të drejtat kushtetuese të të cilit preken personalisht ose drejtpërdrejt nga masat apo aktet e autoriteteve publike. Personi i cili nuk është prekur në këtë mënyrë, nuk e ka statusin e viktimës pasi që Kushtetuta nuk parasheh *actio popularis*. Me fjalë të tjera, një parashtrues i kërkesës nuk mund të ankohet në abstrakt ndaj masave të autoriteteve publike të cilat nuk janë zbatuar personalisht ndaj tij, siç është ky rast në këtë Gjykatë. Rrjedhimisht, kërkesa hedhet poshtë, po ashtu, si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në bazë të nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Sekretariati do t'ua komunikojë vendimin palëve dhe të njëjtin do ta publikojë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Dr.Gjyljeta Mushkolaj Prof. Dr. Enver Hasani

KI 109/10 datë 29 mars 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. Nr. 317/07, të 12 nëntorit 2008

Rasti KI 109/10, datë 9 mars 2012

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, jashtë afatit kohor.

Parashtruesi paraqiti kërkesën në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke pretenduar që me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac.Nr 317/07 te datës 12 nëntor 2008 i janë shkelur të drejtat e tij pasiqë rasti është zgjatur për katër vjet në Gjykatën Komunale në Deqan.Parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese ta urdhërojë kompensimin e dëmit që gjoja i është shkaktuar atij për shkak se ka më tepër se 40 vjet që trafostacioni i energjisë elektrike është vendosur në pronën e tij të paluajtshme. Gjykata ka konstatuar qe Kërkesa e parashtruesit është jashtë afatit kohor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dh rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.Gjykata Kushtetuese ka konkluduar që kërkesa është e papranueshme

Prishtinë, 09 mars 2012

Nr. ref.: RK205/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 109/10

Parashtrues

Ismet Hebibi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë,

Ac. Nr. 317/07, të 12 nëntorit 2008

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Ismet Hebibi, me vendbanim në Junik, Kosovë.

Vendimi i kontestuar gjyqësor

2. Vendimi i kontestuar gjyqësor është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Ac. Nr. 317/07, i 12 nëntorit 2008, që parashtruesit të kërkesës iu dorëzua më 26 dhjetor 2008.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon që i është shkelur e drejta e tij pasi rasti i tij është zgjatur katër vjet në Gjykatën Komunale në Deçan sepse një gjyqtar, "për shkaqe personale, u përpoq ta minimizonte rastin e tij dhe të nxirrte vendim të paligjshëm".

4. Parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese ta urdhërojë kompensimin e dëmit që gjoja i është shkaktuar atij për shkak se ka më tepër se 40 vjet që trafostacioni i energjisë elektrike është vendosur në pronën e tij të paluajtshme. Parashtruesi, gjithashtu kërkon që Gjykata ta urdhërojë largimin e kabllos së tensionit të lartë dhe të trafostacionit të prishur të energjisë elektrike, i cili paraqet rrezik të madh për familjen e tij.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 20, 22 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe rregulli 36 (1) (b) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 29 tetor 2010. Parashtruesi kërkoi në kërkesë që identiteti i tij të mos zbulohej në vendimin e Gjykatës.

7. Më 23 nëntor 2010, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 109/10, e caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 109/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami.

8. Më 18 maj 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve dhe pretendimeve siç janë paraqitur nga parashtruesi

9. Parashtruesi është pronar i paluajtshmërisë Nr. 1342, lista poseduese 109, komuna e Junikut.

10. Sipas tij, prej vitit 1968 e deri më sot familja e tij dhe shumë familje të tjera janë rrezikuar për shkak se trafostacioni i

energjisë elektrike ishte vendosur kundër dëshirës së familjes së tij në pronën e tyre të paluajtshme të përmendur më lart. Ky trafostacion ishte prishur shumë herë dhe prandaj paraqet rrezik për familjen e tij. Me një rast, tensioni i lartë ia mbyti një lopë në oborr.

11. Përveç dëmit material, frikës dhe shqetësimit psikologjik që ai dhe familja e tij kanë pësuar, më 18 prill 2008, trafostacioni i KEK-ut ishte shkatërruar nga stuhia dhe kablloja e tensionit të lartë ishte këputur dhe kishte rënë në dy shtëpi dhe në oborret e tyre.

12. Kjo situatë ka vazhduar për 42 vjet me radhë.

13. Si rrjedhojë, parashtruesi ngriti padi kundër KEK-ut në Pejë në Gjykatën Komunale në Deçan, duke kërkuar kompensimin e dëmit në shumë prej 17,230 eurove.

14. Më 19 qershor 2007, Gjykata Komunale në Deçan nxori Aktgjykimin C. Nr. 484/04 dhe e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit si të pabazë, siç u cek më lart.

15. I pakënaqur me atë aktgjykim, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

16. Më 12 nëntor 2008, Gjykata e Qarkut nxori Aktgjykimin Ac. Nr. 317/07 dhe e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit si të pabazë.

17. Sipas dëftesës së Gjykatës Komunale, që u gjet në dosjen e lëndës së parashtruesit, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut, i 12 nëntorit 2008, i ishte dorëzuar parashtruesit më 26 dhjetor 2008.

18. Parashtruesi kërkoi së paku pesë herë përjashtimin e kryetarit të trupit gjykues nga rasti i tij në Gjykatën Komunale në Deçan, C. Nr. 448/04, për shkak të mungesës së kredibilitetit të gjyqtarit. Për më tepër, parashtruesi kërkoi që rasti i tij të kalohej në Gjykatën Komunale në Pejë apo në Gjakovë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili në pjesën përkatëse thotë me sa vijon:

Afatet

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...."

21. Gjykata vëren që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Qarkut të Pejës, Ac. Nr. 317/07, i 12 nëntorit 2008, i është dorëzuar parashtruesit më 26 dhjetor 2008. Gjykata, gjithashtu vëren që parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 29 tetor 2010.

22. Përveç kësaj, edhe po të supozohej që parashtruesi e ka parashtruar kërkesën brenda afatit ligjor, ai nuk ka treguar se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës. (*shih mutatis mutandis, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679100, Vendim i 28 prillit 2004, shih gjithashtu mutatis mutandis, Vendimi i 24 marsit 2010 në*

rastin Nr. KI 73/09, Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor).

23. Prandaj, rezulton që kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 49, 56 dhe 58 të Ligjit dhe nenin 36 1 (b) të Rregullores së punës, më 18 maj 2001, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA HEDHË POSHTË si të pabazë kërkesën për moszbulim të identitetit të tij;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Prof. Dr. Enver Hasani

KI 122/11 datë 22 mars 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, SSC-11-0148, të 15 qershorit 2011.

Rasti KI 122/11, vendim i 15 marsit 2012.

Fjalët kyçe: cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese, dëm i paripareshëm, kërkesë individuale, heqje e kërkesës nga lista, lis pendens, masë e përkohshme, procesi i privatizimit.

Parashtruesi ka paraqitur kërkesën bazuar në Nenin 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë kushtetuese janë cenuar për shkak se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme nuk kishte dhënë vendim brenda një afati të arsyeshëm. Parashtruesi poashtu kishte kërkuar nga Gjykata heqjen e kërkesën nga lista sepse çështja e tij tanimë ishte pa objekt shqyrtimi. Prashtruesi pohoi se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka cenuar të drejtat e tij të garantuara me nenet 32 dhe 46 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe nein 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Gjykata pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruesit bazuar në nenet 20 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Rregullin 32 të Rregullores së Punës vendosi që ta hedhë poshtë kërkesën për masë të përkohshme, ta hedhë poshtë kërkesën për lejimin e një *lis pendens,* si dhe ta heqë kërkesën nga lista dhe të mos ndërmarrë masa tjera lidhur me të.

Prishtinë, 11 mars 2011

Nr. ref.: KI122-11

VENDIM PËR REFUZIMIN E MASËS SË PËRKOHSHME DHE

HEQJEN E KËRKESËS NGA LISTA

në

Rastin Nr. KI 122/11

Parashtrues

Bujar Reka, pronar i INTER STEEL LLC

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, SSC-11-0148, të 15 qershorit 2011.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Bujar Reka nga Prishtina, pronar i INTER STEEL LLC, i përfaqësuar nga Interlex Associates l.l.c.

Vendimi i kontestuar

2. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, SSC-11-0148, i 15 qershorit 2011.

Objekti i çështjes

3. Kërkesa ka të bëjë me vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) për të vazhduar me shitjen e pasurive të NewCo Llamkos Steel Assets (në tekstin e mëtejmë: Llamkos) përmes tenderit një ofertuesi tjetër në procesin e privatizimit.

4. Parashtruesi kërkoi që Gjykata Kushtetuese të caktonte masë të përkohshme për ta ndaluar AKP-në nga konkludimi i shitjes së Llamkosit pasi kjo do t'i shkaktonte dëm të pariparueshëm dhe të pakthyeshëm parashtruesit. Si alternativë, ai kërkon që Gjykata ta obligojë Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë ta regjistrojë një shënim *lis pendens* në aksionet e Llamkosit.

Baza juridike

5. Nenet 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 20 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullat 32, 55 dhe 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Sekretariatin e Gjykatës Kushtetuese më 14 shtator 2011.

7. Me urdhrin e Kryetarit, të 19 shtatorit 2011, gjyqtarja Snezhana Botusharova u caktua Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Iliriana Islami.

8. Me anë të letrës së 7 dhjetorit 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Odën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për parashtrimin e kërkesës dhe, ndër të tjera, kërkoi përgjigje.

9. Kërkesa për masë të përkohshme dhe kërkesa për regjistrimin e një *lis pendens* u shqyrtuan nga Gjykata në përbërje të plotë më 12 dhjetor 2011.

10. Oda e Posaçme më pas u përgjigj në korrespondencën e Gjykatës Kushtetuese më 14 dhjetor 2011.

Përmbledhje e fakteve

11. Llamkos ishte ndërmarrje shoqërore e shitur nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, por shitja e planifikuar dështoi. Më 3 shkurt 2011, AKP vendosi t'i shiste asetet sërish. Kompania e parashtruesit ofroi 5.345.000 euro dhe ishte ofertuesi i dytë më i lartë. Ofertuesi i parë nuk e kompletoi shitjen. Parashtruesi u informua për këtë dhe se do të mund të kualifikohej si ofertues i suksesshëm pas bisedave me një përfaqësues të AKP-së.

12. Megjithatë, pas një komunikimi të shkurtër ndërmjet parashtruesit dhe AKP-së, parashtruesi u informua me letrën e 27 prillit 2011 se AKP-ja vendosi të mos ia kompletonte parashtruesit shitjen e Llamkosit. Më pas, ofertuesi i tretë deklaroi publikisht se e kishte fituar tenderin. Më vonë, më 3 gusht 2011, AKP bëri të ditur se ndërmarrjen ia kishte shitur një pale të tretë.

13. Më 17 maj 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë për një vendim gjyqësor në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe gjithashtu e kontestoi vendimin e AKP-së për të mos ia kompletuar shitjen parashtruesit. Me vendimin e vet të 15 qershorit 2011, i cili parashtruesit iu dorëzua më 16 qershor 2011, Trupi Gjykues i Dhomës së Posaçme e refuzoi kërkesën për vendim gjyqësor.

14. Para vendimit të Dhomës së Posaçme, AKP i shkroi parashtruesit më 1 qershor 2011, duke theksuar se *"Komisioni i likuidimit ka komunikuar me bankën [e parashtruesit] dhe ka*

fituar besimin se Inter Steel sh.p.k. në të vërtetë nuk posedon fonde të mjaftueshme të depozituara apo fonde të tjera për ta paguar çmimin e ofertës dhe për t'i përmbushur zotimet për investim".

15. Parashtruesi e mohon këtë dhe thekson se banka Raiffeisen askujt nuk i ofroi informata specifike lidhur me shumën e fondeve të depozituara në bankë. Parashtruesi pohon që banka Raiffeisen ofroi një formular standard të garancionit që e kishte përdorur më parë për qindra tenderë të AKM-së dhe AKP-së.

16. Më 29 qershor 2011, parashtruesi paraqiti ankesë në Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme, me të cilën kërkonte anulimin e vendimit të Dhomës së Posaçme.

17. Më 11 janar 2012, avokatët e parashtruesit i shkruan Gjykatës Kushtetuese dhe e njoftuan se pasi Kolegji i Apelit i Odës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës tashmë kishte nxjerrë një vendim, çështja ishte tani pa objekt shqyrtimi.

Pretendimet e parashtruesit

18. Pretendimet e parashtruesit janë siç janë cekur në faktet më sipër, domethënë që:

    1. Procesi i privatizimit për Llamkosin ishte zhvilluar në mënyrë të padrejtë;

    2. Vendimi ishte bazuar në fakte të gabuara; dhe

    3. Ka pasur shkelje të neneve 32 [E DREJTA PËR MJETE JURIDIKE] dhe 46 [MBROJTJA E PRONËS] të Kushtetutës në lidhje me nenin i të Protokollit dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore për shkak se Dhoma e Posaçme ia kishte mohuar

parashtruesit të drejtën për ta marrë vendimin brenda një afati të arsyeshëm.

Vlerësimi i kërkesës për masa të përkohshme

19. Parashtruesi kërkoi që Gjykata Kushtetuese të caktonte masë të përkohshme për ta ndaluar AKP-në nga konkludimi i shitjes së Llamkosit pasi kjo parashtruesit do t'i shkaktonte dëm të paripareshëm dhe të pakthyeshëm.

20. Njëri prej kritereve për caktimin e masës së përkohshme është nëse do të shkaktohen dëme të pakthyeshme dhe të paripareshme.

21. Neni 116.2 i Kushtetutës përcakton:

Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të paripareshme.

22. Neni 27 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton:

1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të paripareshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.

23. Nëse ndodh të gjendet shkelja e një të drejte kushtetuese, atëherë ai mund të jetë rasti që veprimi në dëme të mund të jetë mjet i mundshëm.

24. Megjithatë, pasi ankesa ende ishte në procedurë e sipër në Kolegjin për Apele të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ekzistonte mundësia që kontesti do të mund të zgjidhej në favor të parashtruesit. Përveç kësaj, është praktikë e themeluar që Gjykata Kushtetuese duhet të jetë e kujdesshme për të ndërhyrë në çështjet që janë në vazhdim e sipër ndërmjet palëve, posaçërisht në lidhje me supozimin se gjykatat e rëndomta në Kosovë janë vendi i duhur për shqyrtimin e këtyre rasteve.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të neneve 20 dhe 27 të Ligjit dhe rregullave 32, 55 dhe 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për lejimin e një *lis pendens;*

III. TA HEQË kërkesën nga lista dhe të mos ndërmarrë masa të tjera lidhur me të;

IV. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit; dhe

V. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 20/11 dhe KI 96/11 datë 05 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan P. nr. 550/08, të 9 korrikut 2009, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan AP. nr. 182/2009, të 29 prillit 2010.

Rasti KI 20/11 & 96/11, vendim i 7 marsit 2012

Fjalët kyçe: ekzekutimi i vendimit, kërkesë individuale, bashkimi i kërkesave, i paafatshëm, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm,

Parashtruesi parashtroi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pohuar se aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës së Qarkut nuk ishte zbatuar nga autoritetet kompetente, as nga aspekti penal dhe as civil, dhe si i tillë mbetet një dokument pavlerë . Mos-ekzekutimi i aktgjykimit të formës së prerë i Gjykatës së Qarkut përbën pretendimin e shkeljes, së nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje ne nenin 6.1 të KEDNJ.

Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesit ishte e paafatshme, sipas nenit 49 të Ligjit, sepse Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, AP. nr. 182/2009, të 29 prillit 2010 iu dorëzua parashtruesit më 26 maj 2010, përderisa parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese më 30 qershor 2011, d.m.th. më shumë se 4 muaj pasi që parashtruesit iu dorëzua Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut. Për këtë arsye, Gjykata vendosi ta refuzojë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

Prishtinë, 15 mars 2012

Nr. ref.: RK207/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastet Nr. KI 20/11 dhe KI 96/11

Parashtrues

Kushtrim Kqiku

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan P. nr. 550/08, të 9 korrikut 2009,

dhe

Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan AP. nr. 182/2009, të 29 prillit 2010.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Kushtrim Kqiku, me vendbanim në Gjilan.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi qartazi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan P. nr. 550/08, të 9 korrikut 2009, i cili iu dorëzua më 10 korrik 2009.

3. Përveç kësaj, parashtruesi gjithashtu e përmend në kërkesë edhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan AP. nr. 182/2009, të 29 prillit 2010, i cili iu dorëzua më 26 maj 2010.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesi pohon për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 18 shkurt 2011, gjyshi i parashtruesit, z. Mahmut Kqiku, parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), në emër të nipit të vet, z. Kushtrim Kqiku, e cila u regjistrua si Rasti Nr. KI 20/11.

7. Më 2 mars 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI20/11, e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KI20/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Iliriana Islami

8. Më 30 qershor 2011, parashtruesi (Kushtrim Kqiku) parashtroi kërkesë në Gjykatë për të njëjtin objekt të çështjes dhe të drejtuar kundër organeve të njëjta publike në Republikën e Kosovës, e cila u regjistrua si Rasti Nr. KI 96/11.

9. Më 1 korrik 2011, Gjykata Kushtetuese e pyeti parashtruesin (Kushtrim Kqiku) nëse e autorizon gjyshin e tij për të parashtruar kërkesë në emër të tij.

10. Më 7 korrik 2011, parashtruesi iu përgjigj kërkesës së Gjykatës duke shtuar që ai e autorizon gjyshin e tij *post festum*, por në të njëjtën kohë kërkoi nga Gjykata që prej atij momenti e tutje çdo formë e komunikimit duhet t'i drejtohet atij, e jo gjyshit të tij Mahmut Kqiku.

11. Më 5 shtator 2011, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Gjykatën Komunale në Gjilan, Ministrinë e Drejtësisë (në tekstin e mëtejmë: Ministria), dhe Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: EULEX), për parashtrimin e kërkesës.

12. Më 27 tetor 2011, Kryetari, me Vendimin KI 20/11, KI 96/11, urdhëroi bashkimin e këtyre dy kërkesave sipas rregullit 37 (1) të Rregullores së punës pasi ato kanë të bëjnë me të njëjtat çështje ligjore dhe janë të drejtuara kundër organeve të njëjta publike në Republikën e Kosovës. Të njëjtën datë, Gjykata e njoftoi parashtruesin (Kushtrim Kqiku) për bashkimin e kërkesave KI 20/11 dhe KI 96/11.

13. Më 1 dhjetor 2011, parashtruesi e njoftoi Gjykatën Kushtetuese se nuk e kundërshtonte vendimin për bashkimin e kërkesave.

14. Më 24 janar 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Komunale në Gjilan që t'ia dorëzonte fletëkthesën në të cilën tregohej data në të cilën parashtruesit i ishte dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan AP. nr. 182/2009, i 29 prillit 2010.

15. Më 8 shkurt 2012, Gjykata Komunale në Gjilan iu përgjigj Gjykatës Kushtetuese dhe dorëzoi fletëkthesën në të cilën tregohej data në të cilën parashtruesit i ishte dorëzuar

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan AP. nr. 182/2009, i 29 prillit 2010.

16. Më 7 mars 20012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

17. Më 15 nëntor 2007, parashtruesi lidhi kontratë shitblerjeje me një palë të tretë (në tekstin e mëtejmë: shitësi) për blerjen e një automjeti.

18. Më 9 prill 2008, parashtruesi ushtroi kallëzim penal në Prokurorinë Publike Komunale në Gjilan kundër shitësit për shkak të mashtrimit.

19. Më 30 maj 2008, Prokurori publik komunal ngriti aktakuzë kundër shitësit në Gjykatën Komunale në Gjilan, me ç'rast pretendohej që shitësi kishte kryer vepër penale të mashtrimit nga neni 261 (1) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK), (PP. nr. 684/2008).

20. Më 11 gusht 2008, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjilan për përshpejtim të procedurës (P. nr. 550/08).

21. Më 9 korrik 2009, Gjykata Komunale në Gjilan e shpalli shitësin fajtor për vepër penale të mashtrimit nga neni 261 (1) i KPPK-së dhe vendosi që shitësi detyrohet ta paguajë shumën e cekur në kontratë të shitblerjes (Aktgjykimi P. nr. 550/08). Shitësi ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Gjilan.

22. Më 29 prill 2010, Gjykata e Qarkut në Gjilan e shpalli ankesën e shitësit të pabazuar dhe e miratoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan P. nr. 550/08, të 9 korrikut 2009 (Aktgjykimi AP. nr. 182/09).

23. Më 29 prill 2010, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan P. nr. 550/08, i 9 korrikut 2009, u bë i formës së prerë dhe i detyrueshëm.

24. Sa i përket procedurës përmbarimore lidhur me shumën e cekur në kontratën e shitblerjes dhe në procedurën për ekstradim, faktet janë me sa vijon:

a) Faktet lidhur me procedurën përmbarimore

25. Më 4 shkurt 2009, parashtruesi lidhi marrëveshje gjyqësore me shitësin, me ç'rast u pajtuan që shitësi do t'ia paguante parashtruesit shumën e cekur në kontratën e shitblerjes (E. nr. 236/2008).

26. Më 16 mars 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjilan për përshpejtim të procedurës përmbarimore lidhur me rastin E. nr. 236/2008, të 4 shkurtit 2009.

b) Faktet lidhur me ekstradimin

27. Në ndërkohë, shitësi u largua nga Kosova dhe nuk ishte i arritshëm për përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale dhe të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan.

28. Më 5 mars 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjilan, me ç'rast u propozoi që t'ia bënin një kërkesë zyrtare Ministrisë së Drejtësisë, përkatësisht Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, për ta iniciuar procedurën për transferimin e shitësit në Republikën e Kosovës me qëllim të përmbarimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan (P. nr. 550/08, të 9 korrikut 2009), i cili u bë i formës së prerë dhe i detyrueshëm me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan (AP. nr. 182/09, të 29 prillit 2010).

29. Më 4 qershor 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë në Komponentin Policor të EULEX-it në Kosovë, me ç'rast kërkoi inicimin e procedurës për transferimin e shitësit në Republikën e Kosovës sipas nenit 507 (3) të KPPPK-së.

30. Më 28 qershor 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjilan, me ç'rast kërkoi inicimin e procedurës për transferimin e shitësit në Republikën e Kosovës sipas nenit 507 (3) të KPPPK-së.

Pretendimet e parashtruesit

31. Parashtruesi pretendon që Marrëveshja gjyqësore E. nr. 236/08, sa i përket pjesës substantive, pra kompensimit të palës së dëmtuar, ka stagnuar, edhe pse çështja është aktive që nga 28 marsi 2008.

32. Përveç kësaj, parashtruesi pohon që aktgjykimi i formës së prerë, i 29 prillit 2010, nuk u përmbarua as nga pikëpamja penale as nga pikëpamja civile dhe, si i tillë, mbetet dokument i pavlerë që përbën shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

33. Nga dokumentet e dorëzuara shihet që parashtruesi kërkon nga Gjykata:

a. Të konstatojë që ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së;

b. T'i obligojë Gjykatën Komunale në Gjilan, Ministrinë e Drejtësisë dhe EULEX-in për inicimin e procedurave dhe për të bërë përpjekje për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Gjilan, pra për ta ekstraduar shitësin; dhe

c. Gjykata Komunale në Gjilan, Ministria e Drejtësisë dhe EULEX-i duhet t'i raportojnë Gjykatës dhe parashtruesit në periudha që Gjykata i sheh të arsyeshme, lidhur me përparimin e arritur në këtë drejtim.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

34. Gjykata vëren që parashtruesi ankohet për tri çështje:

a. Aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës Komunale në Gjilan P. nr. 550/08, i 9 korrikut 2009, nuk u përmbarua dhe, si i tillë, përbën shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së;

b. Marrëveshja gjyqësore E. nr. 236/08, lidhur me kompensimin ndaj parashtruesit, nuk është përmbaruar që nga 28 marsi 2008; dhe

c. Organet në Kosovë, pra Gjykata Komunale në Gjilan, Ministria e Drejtësisë dhe EULEX-i, nuk i kanë iniciuar procedurat për ekstradimin e shitësit.

35. Në këtë drejtim, për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

36. Sa i përket Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut AP. nr. 182/2009, të 29 prillit 2010, Gjykata vëren që parashtruesit i ishte dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut AP. nr. 182/2009, i 29 prillit 2010, më 26 maj 2010.

37. Gjykata Kushtetuese gjithashtu vëren që parashtruesi e parashtroi kërkesën më 30 qershor 2011.

38. Në këto rrethana, kërkesa është e parashkruar sipas nenit 49 të Ligjit.

39. Prandaj, rezulton që kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 7 mars 2012, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Prof. Dr. Enver Hasani

KO 05/12 datë 19 mars 2012- Lidhur me kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-279, të 20 janarit 2012.

Rasti KO 05/12, vendim i 19 marsit 2012

Fjalët Kyçe: kërkesë e deputetëve të kuvendit, kontestim i vendimit të kuvendit, marrëveshje ndërkombëtare, ndarja e pushteteve, prezumim i moszbatimit të procedures së ratifikimit, ratione materiae.

Parashtruesit paraqitën kërkesën bazuar në Nenin 113.5 të Kushtetutës duke pohuar se vendimi Nr. 04-V-279, i 20 janarit 2012 i Kuvendit të Republikës së Kosovës ishte në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës. Parashtruesit pohuan se Kuvendi i Republikës së Kosovës me vendimin në fjalë i mirëpriste marrëveshjet e arritura në dialogun ndërmjet qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë në kundërshtim me Kushtetutën. Parashtruesit poashtu theksuan se Kosova dhe Serbia janë dy shtete me subjektivitet juridik në të drejtën ndërkombëtare, dhe si rrjedhojë marrëveshjet ndërmjet tyre janë marrëveshje ndërkombëtare siç përkufizohet në nenin 3.1.5 të Ligjit Nr. 04/L-052 për marrëveshje ndërkombëtare. Parashtruesit e cituan në tërësi nenin 18 të Kushtetutës lidhur me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Ata theksuan se përmes 'mirëpritjes së arritjes së marrëveshjeve' dhe përmes 'mbështetjes për zbatim të tërësishëm' të tyre, Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka njohur dhe i ka ratifikuar këto marrëveshje si dhe ka marr përsipër detyrimet që dalin nga këto marrëveshje. Parashtruesit pohuan që Kuvendi është dashur ta ketë miratuar një procedurë të ratifikimit sipas nenit 18 të Kushtetutës.

Gjykata kërkoi shpjegime shtesë nga Parashtruesit lidhur me thelbin e kërkesës së tyre të ngritur në Gjykatë. Gjykata konstatoi se Parashtruesit ishin palë e autorizuar në pajtim me Nenin 113.5 të Kushtetutës, sepse kërkesa ishte paraqitur brenda afatit ligjor si dhe ishte përmbushur kushti ligjor përsa i përket numrit të deputetëve që

mund të kontestojnë vendimet e kuvendit për nga përmbajtja e tyre dhe procedura e ndjekur.

Gjykata konstatoi se Parashtruesit nuk kishin saktësuar kërkesën në pajtim me Nenin 113.5 të Kushtetutës lidhur me nenin 42 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, gjegjësisht Parashtruesit nuk kishin saktësuar se në çfarë mënyre kontestonin vendimin e kuvendit si për nga përmbajtja ashtu dhe nga procedura e ndjekur. Gjykata, më tutje arsyetoi se Parashtruesit më tepër kontestojnë natyrën e vendimit të kuvendit dhe kërkojnë interpretim sesa përmbajtjen e tij apo procedurën e ndjekur. Duke shqyrtuar kërkesën në tërësinë e saj, Gjykata nënvizoi se është e vetëdijshme për doktrinën e ndarjes së pushteteve siç parashihet në nenin 4 të Kushtetutës dhe për kompetencat e Kuvendit që nënkupton se është detyrë e këtij të fundit të marrë vendime të duhura apo të nevojshme. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata konkludoi që kërkesa është e papranueshme sepse nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

Prishtinë, më 19 mars 2012

Nr. ref.: RK 208/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KO 05/12

Parashtrues

Visar Ymeri dhe dymbëdhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Lidhur me kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-279, të 20 janarit 2012.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtrues

1. Parashtrues të kërkesës janë: Visar Ymeri, Rexhep Selimi, Liburn Aliu, Albin Kurti, Albana Fetoshi, Glauk Konjufca, Albana Gashi, Florin Krasniqi, Alma Lama, Albulena Haxhiu, Afrim Kasolli, Emin Gërbeshi dhe Afrim Hoti, që të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesit e kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-279, të 20 janarit 2012. Ky vendim u publikua të njëjtën ditë në ueb faqen e Kuvendit.

Baza juridike

3. Neni 113.5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 38 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 36 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

4. Parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 26 janar 2012.

5. Më 31 janar 2012, Kryetari e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

6. Më 31 janar 2012, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Kryetarin e Kuvendit dhe Qeverinë për parashtrimin e kësaj kërkese.

7. Më 7 shkurt 2012, Gjykata u shkroi letër parashtruesve me anë të së cilës kërkonte sqarim lidhur me kërkesën.

8. Një kopje e letrës së Gjykatës iu dërgua Kryetarit të Kuvendit dhe Qeverisë.

9. Parashtruesit iu përgjigjën letrës së Gjykatës përmes letrës së 20 shkurtit 2012, të cilën Gjykata e mori më 21 shkurt 2012. Përgjigja e parashtruesve përshkruhet më në detaje në paragrafët 18 deri në 22 më poshtë.

10. Një kopje e kësaj përgjigjeje iu dërgua Kryetarit të Kuvendit dhe Qeverisë më 27 shkurt 2012, dhe u ftuan të përgjigjeshin brenda një jave, po të dëshironin. Gjykata nuk mori asnjë përgjigje brenda kësaj kohe.

11. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e përgatitur nga Gjyqtarja raportuese më 15 mars 2012, i cili i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës. Gjykata në përbërje të plotë e shqyrtoi kërkesën të njëjtën ditë.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 20 janar 2012, Kuvendi e shqyrtoi një mocion të paraqitur nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe nxori një vendim po atë ditë. Vendimi, ndër të tjera, "mirëpriti marrëveshjet" e arritura në dialogun ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, dhe se Kuvendi "e mbështeste zbatimin e tyre të tërësishëm".

13. Prej deputetëve të pranishëm, 59 votuan për mocion, 41 ishin kundër, dhe një abstenoi.

Argumentet e paraqitura nga parashtruesit

14. Parashtruesit theksojnë në kërkesën e tyre se vendimi i Kuvendit u referohet marrëveshjeve të arritura ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, të cilat, siç pohojnë, janë dy shtete me subjektivitet juridik në të drejtën ndërkombëtare.

15. Parashtruesit theksojnë se Ligji për marrëveshjet ndërkombëtare, Nr. 04/L-052, në nenin 3.1.5, e përkufizon marrëveshjen ndërkombëtare si *"- një marrëveshje ndërkombëtare përkatësisht traktat i lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare në formë të shkruar, e rregulluar me të drejtën ndërkombëtare pavarësisht nga emërtimi dhe nga përfshirja në një, dy apo më shumë instrumente të ndërlidhura."* Si rrjedhojë, ata pohojnë se pasi marrëveshjet e përmendura në paragrafin 1 të vendimit të Kuvendit, të 20 janarit 2012, janë lidhur ndërmjet dy shteteve në pajtim me atë ligj, ato janë marrëveshje ndërkombëtare.

16. Parashtruesit e citojnë në tërësi nenin 18 të Kushtetutës lidhur me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Ata theksuan që "Në këtë mënyrë, përmes 'mirëpritjes së arritjes së marrëveshjeve' dhe përmes 'mbështetjes për zbatim të tërësishëm' të tyre, Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka njohur dhe i ka ratifikuar këto marrëveshje si dhe ka marr përsipër detyrimet që dalin nga këto marrëveshje".

17. Ata pohojnë që ky "ratifikim i marrëveshjeve ndërkombëtare" ishte në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës.

18. Më 7 shkurt 2012, Gjykata u shkroi letër parashtruesve me sa vijon:

1) Cili është thelbi i çështjes kushtetuese të ankesës, apo shkeljes së pretenduar, për të cilën ju konsideroni që kërkon

shqyrtimin nga ana e Gjykatës Kushtetuese të substancës apo procedurës së saj.

2) Ju lutem të cekni se mbi çfarë baze konsideroni se objekti i çështjes së kërkesës i nënshtrohet proceseve të ratifikimit të përcaktuara në nenin 18 të Kushtetutës së Kosovës dhe të ofroni prova që do të mbështesnin një bazë të tillë.

19. Në përgjigjen e tyre, parashtruesit përsëritën qëndrimin që kishin marrë në kërkesë dhe përsëri iu referuan "mirëpritjes së arritjes së marrëveshjeve" dhe "mbështetjes së zbatimit të tërësishëm të këtyre marrëveshjeve". Ata theksuan se vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i "ratifikoi" marrëveshjet ndërkombëtare. Ata konsideronin se ratifikimi nënkuptonte që duhej të zbatohej procedura e parashikuar me nenin 18 të Kushtetutës.

20. Ata i përmendën kriteret e ndryshme të ratifikimit sipas nenit 18.1 dhe nenit 18.2; njëri kërkonte dy të tretat e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe tjetri kërkonte ratifikimin nga Presidenti i Republikës së Kosovës, varësisht nga objekti i çështjes së marrëveshjeve.

21. Përveç kësaj, ata e shtjelluan dhe e analizuan karakterin e marrëveshjeve ndërkombëtare në bazë të Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, Nr. 04. L-052, dhe Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve të vitit 1969.

22. Parashtruesit gjithashtu përsëritën që Republika e Kosovës dhe Republika e Serbisë janë dy vende me subjektivitet juridik në të drejtën ndërkombëtare. Prandaj, ata pohojnë që marrëveshjet të cilat përmenden në vendimin e Kuvendit kishin karakter të marrëveshjeve ndërkombëtare, siç parashikohet me Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare dhe Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve të vitit 1969.

23. Në përgjigjen e tyre, parashtruesit kërkuan që *"Presidenti, Kuvendi dhe Kryeministri duhet të udhëzohen për obligimet e*

tyre kushtetuese lidhur me nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare (...)".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Për të përcaktuar nëse kërkesa mund të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, duhet të bëhet vlerësimi nëse ajo është apo nuk është e pranueshme.

25. Parashtruesit e parashtruan kërkesën e tyre në përputhje me nenin 113.5 të Kushtetutës, i cili thotë:

"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur[1]."

26. Kërkesa u parashtrua nga 13 deputetë të Kuvendit të Kosovës, siç përcaktohet në paragrafin 1 më sipër, që është më tepër se minimumi që kërkohet me nenin 113.5 të Kushtetutës, prandaj kriteri për palë të autorizuar është përmbushur.

27. Vendimi i Kuvendit, të cilin parashtruesit e kontestojnë, u mor më 20 janar 2012 dhe kërkesa u parashtrua në Gjykatë më 26 janar 2012, dmth. brenda afatit prej tetë ditësh të përcaktuar me Kushtetutë. Prandaj, kërkesa është parashtruar me kohë.

28. Mirëpo, ka edhe çështje të tjera që Gjykata do të marrë parasysh me rastin e përcaktimit nëse kërkesa është apo nuk është e pranueshme. Në këtë drejtim, duhet t'i kushtohet vëmendje formulimit të nenit 113.5, i cili përcakton që

[1] Versioni në gjuhën serbe dallon nga versioni në gjuhën shqipe dhe angleze.

"kushtetutshmëria e një ligji apo vendimi të miratuar nga Kuvendi si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur", është ajo që do të shqyrtohet nga Gjykata.

29. Gjithashtu është me rëndësi të theksohen dispozitat përkatëse të Ligjit me të cilin rregullohet parashtrimi i kërkesës sipas nenit 113.5 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, neni 42 i Ligjit thotë:

Neni 42

Saktësimi i kërkesës

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6[2] të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë[3]; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.

30. Rikujtojmë, Gjykata veçanërisht kërkoi që parashtruesit ta identifikonin thelbin e çështjes kushtetuese që kërkonte shqyrtim nga Gjykata lidhur me substancën apo procedurën e saj. Nga parashtruesit gjithashtu u kërkua veçanërisht të

[2] Versioni në gjuhën shqipe dhe serbe dallon nga versioni në gjuhën angleze.

[3] Versioni në gjuhën serbe dallon nga versioni në gjuhën shqipe dhe angleze.

ofronin prova që do ta mbështetnin bazën mbi të cilën konsideronin se objekti i çështjes së kërkesës u nënshtrohej proceseve të ratifikimit të përcaktuara në nenin 18 të Kushtetutës. Kërkesa e parashtruesve ishte arsyetuar në veçanti sipas nenit 42.1.3 të Ligjit.

31. Gjykata rikujton që Kuvendi i Kosovës, në vendimin e 20 janarit 2012, *"mirëpret Marrëveshjet e arritura në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, përmes procesit të dialogut dhe mbështetë zbatimin e tyre të tërësishëm"*. Vendimi gjithashtu theksoi se *"Qeveria e Kosovës duhet të vendosë për masat përkatëse reciproke për mbarëvajtjen e procesit të dialogut dhe zbatimin e konkluzioneve të arritura"*, dhe se *"Qeveria obligohet t'i raportojë Kuvendit lidhur me mbarëvajtjen e procesit të dialogut dhe reciprocitetit"*.

32. Sipas nenit 65 (1) të Kushtetutës [Kompetencat e Kuvendit], Kuvendi miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme të nxjerra brenda kompetencave të veta dhe të miratuara me kuorum dhe shumicë të nevojshme, siç kërkohet me nenin 69 (3) dhe nenin 80 (1) të Kushtetutës.

33. Gjykata vëren që Kuvendi i Republikës së Kosovës ka të drejtë ta vendosë formën e akteve që i miraton. Në këtë rast, Kuvendi e kishte miratuar një vendim pas mocionit të propozuar nga anëtarët e një grupi parlamentar. Parashtruesit nuk e ngrenë çështjen nëse ka pasur kuorum, siç parashihet me nenin 69.3, apo shumicë, siç parashihet me nenin 80.1 të Kushtetutës, me rastin e marrjes së vendimit. Nga parashtresat e parashtruesve duket që ata nuk e sulmojnë substancën apo procedurën e vendimit të Kuvendit, por më tepër natyrën e tij. Duket që ata duan të thonë që Gjykata, në këtë rast, do të duhej ta ndryshonte natyrën e vendimit, por nuk ofrojnë argumente, prova, apo arsyetim se si Gjykata mund ta bëjë këtë. Parashtruesit pohojnë që vendimi i Kuvendit përmban marrëveshje ndërkombëtare dhe prandaj ky ishte një ratifikim që kërkonte zbatimin e nenit 18 të Kushtetutës. Në Kuvend nuk u propozua apo diskutua që mocioni që gjendej para tij përmbante marrëveshje

ndërkombëtare apo që vendimi i miratuar duhej të ratifikohej sipas nenit 18.

34. Nuk ka argumente apo prova që ajo që ishte në pyetje në vendimin e nxjerrë nga Kuvendi bie nën fushëveprimin e nenit 18. Për më tepër, parashtruesit nuk i kanë shtjelluar dallimet ndërmjet nenit 18.1 dhe 18.2, dhe cili do të duhej të zbatohej. Vetëm përmendja e nenit 18 në tërësinë e tij nuk shpie në konkluzionin se ai duhej të zbatohej në vendimin e Kuvendit.

35. Gjykata përsërit që kompetencë e saj kushtetuese është ta shqyrtojë kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar lidhur me substancën e tij dhe procedurën zbatuar. Parashtruesit nuk e kontestojnë as substancën as procedurën e vendimit të nxjerrë. Ata pohojnë që Kuvendi është dashur ta ketë miratuar një procedurë të ratifikimit sipas nenit 18 të Kushtetutës.

36. Gjykata duhet ta analizojë tërësinë e kërkesës së parashtruar nga parashtruesit dhe kjo kërkon që të merren parasysh parashtrimi i kërkesës së parë dhe përgjigja që parashtruesit e kishin dorëzuar në Gjykatë më 21 shkurt 2012. Në esencë, duket të parashtruesit dëshirojnë që Gjykata ta interpretojë vendimin e Kuvendit, të 20 janarit 2012, si marrëveshje ndërkombëtare që kërkon ratifikim sipas nenit 18 të Kushtetutës. Gjykata është e vetëdijshme për doktrinën e ndarjes së pushteteve, siç parashihet në nenin 4 të Kushtetutës, dhe për kompetencat e Kuvendit. Prandaj, Gjykata konsideron që është detyrë e Kuvendit të marrë vendime të tilla që i konsideron të duhura apo të nevojshme. Si rrjedhojë, kërkesa e parashtruesve që Gjykata ta konsiderojë vendimin e Kuvendit si marrëveshje ndërkombëtare që kërkon ratifikim është jashtë fushës së juridiksionit të Gjykatës sipas nenit 113.5 të Kushtetutës.

37. Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha këto çështje, Gjykata konkludon që kërkesa është e papranueshme sepse nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese:

VENDOS

I. Njëzëri, ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme;

II. Me shumicë votash, ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme sepse nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet parashtruesve, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

IV. Ky Vendim do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

V. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

KI 132/11 datë 05 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 601/02, të 15 shtatorit 2004

Rasti: KI 132/11, vendimi i 20 marsit 2012

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, e drejta për punë, e jashtë-afatshme, ratione temporis.

Parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC. nr. 601/02 të 15 shtatorit 2004, me të cilën është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 123/2001 të 18 shtatorit 2002, dhe është hedhur poshtë kërkesa e parashtruesit që të kthehet në vendin e përhershëm të punës në Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK) ku parashtruesi ka qenë i punësuar para shpërthimit të konfliktit luftarak në Kosovë. Parashtruesi i kërkesës konsideron se këto aktgjykime kanë shkelur të drejtën e saj për punë dhe marrëdhënie pune.

Parashtruesi i kërkesës konteston aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 601/02 të 15 shtatorit 2004. Gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesa ka të bëjë me ndodhitë e para datës 15 qershor 2008, përkatësisht datës kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në bazë të kësaj, kërkesa është parashtruar jashtë afatit dhe me këtë nuk është "*ratione temporis*" në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit. Për këtë arsye, Gjykata ka vendosur që kërkesa është e papranueshme në pajtim me Rregullin 36 (3h) të Procedurës së Punës.

Prishtinë, më 20 mars 2012

Nr. ref.: RK 214/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 132/11

Parashtrues

Sabile Sopjani

Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë

Ac. nr. 601/02, të 15 shtatorit 2004

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Sabile Sopjani, nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Nr. 601/02, i 15 shtatorit 2004, me të cilin është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 123/2001, i 18 shtatorit 2002, dhe u refuzua kërkesa e parashtruesit të kërkesës që të kthehet në marrëdhënie të përhershme pune në Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KEK) ku, para shpërthimit të luftës në Kosovë, parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar i përhershëm.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Nr 601/02, të 15 shtatorit 2004, pa cekur konkretisht se cilat nene të Kushtetutës janë shkelur, por nga kërkesa mund të shihet se objekti i çështjes është kontesti juridik për marrëdhënie pune mes parashtruesit të kërkesës dhe KEK-ut.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 17 tetor 2011, parashtruesi i kërkesës i parashtroi kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 27 janar 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Komunale në Prishtinë, si dhe Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, se kanë filluar procedurat për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve lidhur me lëndën Nr. KI-132-11.

7. Më 20 mars 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Snezhana Botusharova, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesi i kërkesës ka themeluar marrëdhënie të përhershme pune në KEK, në pozitën e referentit të sigurimit, parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie pune deri më 1 prill 1999 kur së bashku me familjen është dëbuar nga Prishtina dhe si refugjat u deportua në Holandë.

9. Parashtruesi i kërkesës, me familje, është kthyer në Kosovë më 17 janar 2001,ndërsa kërkesën për kthim në vendin e punës e ka parashtruar më 2 shkurt 2001.

10. Me vendimin numër 46 të 29 janarit 2001, Drejtori i KEK-ut refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kthim në vend të punës, si të pabazuar. Me arsyetimin se, sipas rregullave të përkohshme për marrëdhënie pune të KEK-ut, afati i fundit për kthim të punëtorëve të dëbuar nga puna ka qenë më 1 qershor 2001.

11. Vendimi i drejtorit, numër 46 i 29 janarit 2001, është vërtetuar me vendimin numër 835 të Këshillit ekzekutiv të KEK-ut, të 1 marsit 2001.

12. Parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë ndaj këtyre vendimeve të KEK-ut, duke kërkuar anulimin e këtyre vendimeve dhe kthimin e tij në vend të punës, ndërsa mungesën e vet u mundua ta arsyetojë me sëmundje dhe pamundësi për t'u paraqitur në vendin e punës.

13. Gjykata Komunale në Prishtinë, me aktgjykimin C. nr. 123/2001 të 18 shtatorit 2002, refuzoi kërkesat e parashtruesit të kërkesës si të pabaza dhe dëshmitë për sëmundje i vlerësoi si jo bindëse.

14. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 601/2002 të 15 shtatorit 2004, e konfirmoi plotësisht Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr 123/2001, të 18 shtatorit 2002.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr 601/02, të 15 shtatorit 2004, duke theksuar:

„Ju drejtohem përmes kësaj kërkese, pasi që më është shkelur e drejta për punë, si e drejtë themelore e njeriut. Dhe theksoj se jam paraqitur tek e paditura (KEK), por më është thënë se jam vonuar që të kthehem në punë, duke anashkaluar rrethanat që ishin, luftën, e unë si refugjat isha në Holandë, dhe se për shkak të përkeqësimit të gjendjes sime shëndetësore dhe fëmijës tim të vetëm, nuk kam mundur të kthehem sipas dëshirës sime, por vetëm përmes organeve holandeze. Por, është e çuditshme se tek e paditura ka punëtorë që janë kthyer shumë kohë pas meje, dhe e paditura i ka kthyer në punë.“

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

17. Në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata Kushtetuese konstaton se parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Br 601/02, të 15 shtatorit 2008. Kjo do të thotë se kërkesa ka të bëjë me ngjarje para 15 qershorit 2008, respektivisht para datës së hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në bazë të kësaj, kërkesa është dorëzuar pas afatit, dhe kësisoj nuk është në përputhje *“ratione temporis”* me dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit (shih *mutatis mutandis Jasiūnienė kundër Lituanisë, Kërkesa nr.*

41510/98, aktgjykimi i GJEDNJ-së të 6 marsit dhe 6 qershorit 2003).

18. Rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (3h) të Rregullores së punës i cili parashikon që „një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur: h) kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën."

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 36 (3h) të Rregullores së punës, më 20 mars 2012, njëzëri

VENDOSI

I. Ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KI 131/11 datë 21 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 197/2010, të datës 22 gusht 2011

Rasti: KI 131/11, vendimi i 20 marsit 2012

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta në punë, e drejta në pronë, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, mbrojtja gjyqësore e të drejtës , masë të përkohshme. Parashtruesit kanë paraqitur kërkesën në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës rev. Nr. 197//2010 të 22 gushtit 2011, duke pohuar se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme janë shkelur nenet 31, 46 dhe 54 (e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, Mbrojtja e Pronës dhe Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës, gjithashtu edhe nenet 6 dhe 13 të GJEDNJ (e Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm dhe e Drejta në Mjet efektiv ligjor). Në të njëjtën kohë kanë kërkuar lejimin e masës së përkohshme për të mbrojtur të drejtat e tyre. Duke vendosur për kërkesën parashtruesve Qazim Gashi dhe Agim Gashi, Gjykata ka arritur në përfundim se parashtruesit e kërkesës nuk kanë arsyetuar pretendimet e tyre me fakte, e as nuk kanë ofruar dëshmi *prima facie* që tregojnë shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese. Më tutje parashtruesve u janë ofruar mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tyre dhe për të kontestuar interpretimin e ligjit për të cilin konsiderojnë se është i pasaktë para Gjykatës Komunale, Supreme dhe asaj të Qarkut. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta dhe arbitrare, prandaj Gjykata Kushtetuese e ka shpallur kërkesën të papranueshme dhe qartazi të pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së Punës.

Duke vendosur për kërkesën e parashtruesit Ali Kelmendi, Gjykata ka arritur në përfundim se me vendimin e Gjykatës Supreme rasti i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim, kurse procedura për gjykim të ri ende është në pritje. Prandaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike të përcaktuara me ligj. Pra kërkesa është shpallur e papranueshme për shqyrtim në pajtim me nenin 113.7 dhe rregullin 36 (1a).

Prishtinë, më 20 mars 2012

Nr. ref.: RK210/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 131/11

Parashtruesit:

Qazim Gashi, Fadil Gashi, Agim Gashi dhe Ali Kelmendi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev. nr. 197/2010, të datës 22 gusht 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë Qazim Gashi, Fadil Gashi, Agim Gashi nga Ajvalia dhe Ali Kelmendi nga Mramori, që të gjithë nga Komuna e Prishtinës, të cilët para Gjykatës Kushtetuese të Kosovës përfaqësohen nga avokatët Shefki Sylaj dhe Visar Vehapi nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 197/2010, i datës 22 gusht 2011, me të cilin konfirmohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Nr. 1137/2009, i datës 25 maj 2010, dhe iu urdhërohet parashtruesve të kërkesës që të kthejnë patundshmëritë, të cilat momentalisht i mbajnë në posedim, personave të tretë të cilët në procedurat para gjykatës kanë dëshmuar pronësinë ndaj patundshmërive në kontest.

Objekt i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 197/2010, të datës 22 gusht 2011, duke pretenduar se me këtë vendim janë shkelur nenet 31, 46 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Deri në vendimin përfundimtar të këtij kontesti ligjoro-pronësor mes parashtruesve dhe personave të tretë, lidhur me të drejtat e pronësisë mbi paluajtshmëritë, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës si vijon;

> "Kërkojmë masën e sigurisë – masën e përkohshme, mosndryshimin e gjendjes në terren në parcelën kadastrale 528, lista poseduese 933, Zona Kadastrale Çagllavicë."

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafi 2 i Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 13 tetor 2011, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Parashtruesit e kërkesës njëkohësisht kërkuan nga Gjykata Kushtetuese që të vendos masën e përkohshme, në mënyrë që të mos ndryshojë situata në ngastrën kadastrale 528, lista poseduese 933, Zona kadastrale e Çagllavicës.

8. Më 27 janar 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Komunale në Prishtinë, Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, se ka filluar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë se vendimeve lidhur me Rastin nr. KI-131-11.

9. Më 20 mars 2012, pas shqyrtimit të raportit paraprak të gjyqtarit Robert Carolan, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë që të refuzojë kërkesën, në tërësi, si të papranueshme.

10. Njëkohësisht, Kolegji shqyrtues i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë që të refuzojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës për masën e përkohshme, me arsyetimin se të njëjtit nuk kishin ofruar dëshmi që do të arsyetonte vendosjen e masës se përkohshme si të domosdoshme për të shmangur ndonjë dëm të pakompenzueshëm, apo dëshmi se një masë e tillë do të ishte me interes publik.

Përmbledhje e fakteve

11. Më 10 dhjetor 2003, I. Th. dhe N. H. nga Prishtina, parashtruan ankesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për pengim në posedim, kundër parashtruesve të kërkesës dhe disa personave të tretë, që këtu nuk janë parashtrues kërkese, me kërkesën që parashtruesit e kërkesës të lirojnë nga uzurpimi dhe mundësojnë shfrytëzimin e papengueshëm të patundshmërive që janë evidentuar si Ngastra nr. 528, në Zonën kadastrale të Çagllavicës, me kulturë bari të klasit të tretë dhe sipërfaqe prej 6.34,97 ha.

12. Gjykata Komunale në Prishtinë me procedurën C. Nr. 2140/3, të 7 shtatorit 2004, refuzoi kërkesën e paditësve I. Th. dhe N. H. dhe gjykoi në dobi të parashtruesve të kërkesës.

13. Më 27 dhjetor 2004, I. Th. dhe N. H. parashtruan ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur.

14. Më 14 mars 2007, parashtruesit e kërkesës kundër paditësve I. Th. dhe N. H., i propozuan Gjykatës Komunale në Prishtinë që të vendoste masën e përkohshme. Gjykata Komunale e Prishtinës kurrë nuk vendosi lidhur me masën e përkohshme, dhe në këtë mënyrë, sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës *„...u paragjykua zgjidhja e çështjes në dobi të palës kundërshtare...“*.

15. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, sipas ankesës së paditësit, me Aktgjykimin Ac. nr. 119/2005, të 3 prillit 2007, anuloi Aktgjykimin e Gjykatës komunale në Prishtinë C. Nr. 2140/3, të 7 shtatorit 2004, dhe ktheu lëndën për rigjykim.

16. Më 17 tetor 2007, parashtruesit e kërkesës parashtruan kundërpadi kundër paditësve I. Th. dhe N. H., dhe kërkuan që *„të vërtetohet e drejta e pronësisë përmes parashkrimit fitues ngastrën kadastrale nr. 528, fleta poseduese nr. 933, zona kadastrale Çagllavicë, me sipërfaqe prej 6.34.97 ha.“*

17. Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktgjykimit C. nr. 713/07, të 29 prillit 2009, pjesërisht i aprovoi kërkesat e paditësve I. Th.

dhe N. H., që të dy nga Prishtina, dhe i urdhëroi parashtruesit e kërkesës që t'u dorëzojnë paditësve pjesë të patundshmërisë, siç edhe ceket në pjesën operative të aktgjykimit. Njëkohësisht, refuzohet si e palejueshme kundërpadia e parashtruesve të kërkesës, kundër paditësve, në pjesën ku kërkesa ka të bëjë me konfirmimin e të drejtave në pronësi në ngastrën kadastrale nr. 528, vendi i quajtur Ajvali, me kulturë bari të klasës të tretë, Zona kadastrale e Çagllavicës, me sipërfaqe prej 6.34.97 ha.

18. Më 31 korrik 2009, parashtruesit e kërkesës ushtruan ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 713/07, të 29 prillit 2009, me propozimin që Gjykata e Qarkut në Prishtinë të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 713/07, të 29 prillit 2009, dhe ta kthejë çështjen në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, ose ta ndryshojë atë dhe të miratojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës për kundërpadi.

19. Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin Ac. nr. 1137/2009, të 25 majit 2010, refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe pjesërisht ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 713/07, të 29 prillit 2009, dhe urdhëroi parashtruesit e kërkesës që t'u dorëzojnë paditësve pjesë të patundshmërisë, siç edhe ceket në pjesën operative të aktgjykimit. Njëkohësisht, refuzohet si e palejueshme kundërpadia e parashtruesve të kërkesës - kundër paditësve, në pjesën ku kërkesa ka të bëjë me konfirmimin e të drejtave në pronësi në ngastrën kadastrale nr. 528, vendi i quajtur Ajvali, me kulturë bari të klasit të tretë, Zona kadastrale e Çagllavicës, me sipërfaqe prej 6.34.97 ha.

20. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1137/2009, të 25 majit 2010, në afatin e paraparë me ligj, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesën për revizion, njëkohësisht edhe Prokuroria Publike e Kosovës parashtroi kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke kërkuar që Gjykata Supreme e Kosovës të anulonte aktvendimet e përmendura si të kundërligjshme.

21. Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev. nr. 197/2010, të 22 gushtit 2011, refuzoi si të pabazë kërkesën për revizion të parashtruesve të kërkesës - kundër paditësve, si dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Nr. 1137/2009, të 25 majit 2010, në pjesën e operative, **në pjesën I nën 1, 3, dhe 4, pjesën II dhe III**, lidhur me parashtruesit e kërkesës Qazim Gashi, Fadil Gashi dhe Selim Gashi.

22. Pjesërisht u pranua si e bazuar kërkesa për revizion e të paditurve – kundër paditësve, si dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, duke anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1137/2009, të 25 majit 2010, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 713/2007, të 29 prillit 2009, në pjesën operative të aktgjykimit **I nën 2** vetëm lidhur me parashtruesin e kërkesës Ali Kelmendi, si dhe duke ia kthyer këtë pjesë të lëndës gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr. 197/2010, të 22 tetorit 2011, duke deklaruar shkeljet si vijon:

„Të paditurit (parashtruesit e kërkesës) – kundër paditësve kanë propozuar masën e përkohshme më datë 14/03/2007/ dhe nga Gjykata Komunale në Prishtinë asnjëherë nuk është vendosur mbi masën e përkohshme dhe në këtë mënyrë është prejudikuar zgjidhja e çështjes në favor të paditësve dhe janë shkelur në vazhdimësi nenet 31, 46, dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe si pasojë e këtyre shkeljeve janë shkelur edhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së dhe gjithë efekti i tyre i dobishëm.“

„Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin C.nr. 7l3/07 ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore

nga neni 182 par.1 dhe 2 pika n. Al. 2 të LPK, ngase diapozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit dhe shkresat e lëndës.“

„Aktgjykimi i lartcekur përmban shkelje të natyrës së nenit 182.2 pika n., për shkak se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, ngase diapozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit. Aktgjykimi gjithashtu nuk përmban fare arsye për faktet vendimtare, ndërsa arsyet të cilat i përmban janë të paqarta dhe kontradiktore etj.“

„Cenimi esencial i dispozitave të procedurës kontestimore konsiston edhe në faktin se aktgjykimi i lartcekur përmban të meta të tilla për shkak të së cilave juridikisht është i paqëndrueshëm. Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se aktgjykimi i atakuar përkitazi me kundërpadinë e të paditurve kundër paditësve nuk përmban kurrfarë arsyetimi. Kundërpadia e të paditurve në një pjesë në diapozitivin nën III është refuzuar ndërsa në diapozitivin nën IV në një pjesë është hedhur poshtë si e palejuar.”

„Ngase Gjykata kundërpadinë si të palejuar mund ta hedhë vetëm pas shqyrtimit paraprak të Padisë më së largu deri në seancën përgatitore dhe atë poqëse janë plotësuar kushtet nga neni I cituar më sipër, në rastin konkret nuk ka mundur të hidhet me aktgjykim por edhe me aktvendim në procedurën paraprake kundërpadia si e palejuar ngase nuk është plotësuar asnjë kusht i paraparë nga neni 391 i LPK.”

„Të njëjtat shkelje esenciale i ka bërë edhe Gjykata e Qarkut në Prishtinë si gjykatë e shkallës së dytë me Aktgjykimin AC.nr. 1137/2010/ kur e ka refuzuar ankesën e të paditurve – kundër paditësve.”

„Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të Procedurës Kontestimore kur si provë ka pranuar procesverbalin e vendshiqimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë me të cilin është konstatuar se KBI "Kosovo Export" nga Fushë Kosova e ka punuar ngastrën kadastrale kontestuese ngase në atë procedurë të paditurit – kundër paditësit nuk kanë qenë palë në procedurë dhe nuk kanë pasur mundësi që ta kundërshtojnë këtë pronë. Andaj ai procesverbal i ndonjë procedure tjetër nuk mund të merret si provë, nëse palëve në kontest nuk iu është dhënë mundësia ta kontestojnë -kundërshtojnë dhe se përmes dëshmitarëve të dëgjuar para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë është vërtetuar se parcelën kadastrale të cekur si më lartë të paditurit - kundër paditësit me mirëbesim e shfrytëzojnë që nga viti 1956."

"Gjykata e Qarkut në Prishtinë duke vepruar si Gjykatë e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale kur kërkesëpadinë e të padituve – kundër paditësve e ka refuzuar si të pabazuar ngase paditësit të drejtën e pronësisë në parcelën kadastrale nr. 528 e kanë fituar në bazë të Parashkrimit fitues, andaj është aplikuar gabimisht neni 28 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike si ligj në fuqi dhe neni 40 i Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore të Kosovës."

„Të njëjtat shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale të cekura më lartë i ka bërë Gjykata Supreme e Kosovës duke e llogaritur afatin e parashkrimit fitues dhe duke mos marrë parasysh se të paditurit – kundër paditësit prej vitit 1956, në bazë të kontratës interne vijimisht kanë qenë dhe janë në posedim dhe shfrytëzim të patundshmërisë kontestuese sepse në të kanë të ndërtuara shtëpitë e banimit dhe objektet tjera përcjellëse qysh në vitet e 50 –ta."

„ Duke u shkelur në mënyrë drastike dispozitat e lartcekura Procedurale dhe materiale, janë shkelur edhe nenet 31, 46, dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe është shkelur edhe KEDNJ-a."

24. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 197/2010, të 22 tetorit 2011, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës:

"Kërkojmë masën e sigurisë - masën e përkohshme, mosndryshimin e gjendjes në terren në ngastrën kadastrale 528, lista poseduese 933, Zona Kadastrale Çagllavicë."

„Kërkojmë shpalljen e pavlefshme të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 197/2010/ të datës 22/08/2011, anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1137/2009 të datës 25/05/2010/ dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 713/07 të datës 29/04/2009/. Dhe ta kthej çështjen në rishqyrtim."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës në pjesën që ka të bëjë me parashtruesit e kërkesës Qazim Gashi, Fadil Gashi dhe Agim Gashi

25. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se bazë për parashtresën e tyre janë nenet 31, 46 dhe 54 (E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Mbrojtja e pasurisë dhe Mbrojtja gjyqësore e të drejtave) të Kushtetutës dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe e drejta mjete juridike efektive).

26. Kushtet e pranueshmërisë janë paraparë me Kushtetutë, më saktësisht specifikohen me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.

27. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

> *„ Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.“*

28. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

29. Parashtruesit e kërkesës nuk i mbështetën me prova pretendimet e tyre, dhe as nuk paraqitën ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99 të 31 majit 2005). Parashtruesit e kërkesës nuk cekin se si dhe në ç'mënyrë nenet 31, 46 dhe 54 e Kushtetutës, dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ mbështesin kërkesën e tyre, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

30. Parashtruesit e kërkesës deklarojnë se të drejtat e tyre janë shkelur me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe aplikimin e gabueshëm të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, pa qartësuar se në ç'mënyrë ato vendime kanë cenuar të drejtat e tyre kushtetuese.

31. Në këtë rast, parashtruesve të kërkesës u janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesin rastin e tyre dhe të kontestojnë interpretimin e ligjit për të cilin konsiderojnë se është i pasaktë, para Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

32. Nga kjo rrjedh se, kërkesa në pjesën që ka të bëj me parashtruesit e kërkesës Qazim Gashi, Fadil Gashi dhe Agim Gashi është qartazi e pabazë në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, ku parashihet *„Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:*
b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese“.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës në pjesën që ka të bëj me parashtruesin e kërkesës Ali Kelmendi

33. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

„Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të

drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo

vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj“.

34. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi mbi kërkesën e shterimit është që t'ju ofrojnë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se korniza ligjore e Kosovës do të sigurojë mjete efektive për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shihni, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendim i datës 28 korrik 1999). Megjithatë, nuk është

e nevojshme që të drejtat kushtetuese të ceken në mënyrë eksplicite gjatë procedurës në fjalë. Derisa kjo çështje është cekur në mënyrë absolute ose substanciale, kërkesa mbi shterimin e mjeteve është plotësuar (shihni, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros nr. 56679/00, vendimi i datës 28 prill 2004).

Kjo Gjykatë e ka aplikuar këtë arsyetim me rastin e nxjerrjes së vendimit për papranueshmëri, të 27 janarit 2010, në bazë të mosshterimit të mjeteve juridike në rastin Universiteti AAB-RIINVEST sh.p.k., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, rasti nr. KI. 41 /09 dhe vendimit të 23 marsit 2010 në rastin Mimoza Kusari-Lila *kundër* Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rasti nr. KI 73/09.

35. Duke pasur parasysh këtë, dhe në bazë të dokumentacionit të paraqitur Gjykatës Kushtetuese nga parashtruesit e kërkesës, me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 197/2010, të 22 gushtit 2011, pjesërisht është pranuar si e bazuar kërkesa për revizion e të paditurve – kundër paditësit, si dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës. Kështu që, anulohen Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1137/2009, i 25 majit 2010, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 713/2007, i 29 prillit 2009, në pjesën operative të Aktgjykimit **I nën 2** vetëm në lidhje me parashtruesin e kërkesës Ali Kelmendi dhe kjo pjesë e lëndës i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim, përderisa procedura për rigjykim ende nuk ka përfunduar. Prandaj, parashtruesit e kërkesës nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet ligjore të parapara me ligj, në mënyrë që të mund të paraqesin kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

36. Nga kjo rrjedh se, kërkesa në pjesën që ka të bëjë me parashtruesin e kërkesës Ali Kelmendi është e papranueshme për shqyrtim në pajtim me nenin 113.7 dhe rregullin 36. (1a) të Rregullores së punës, i cili parasheh që *„Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

a) janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar...".

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47(2) të Ligjit, dhe rregullin 36 (1a) dhe 36 (2b) të Rregullore së punës, në seancën e mbajtur më 20 mars 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme në tërësi;

II. TA REFUZOJË kërkesën për vënien e masës së përkohshme;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Prof. Dr. Enver Hasani

KI 139/11 datë 21 prill 2012 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për riemërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Nr. 01/118-658, të 27 28 tetorit 2010

Rasti KI 139/11, vendim i 20 marsit 2012

Fjalët kyçe: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kërkesë individuale, mos shterje e mjeteve juridike, e drejta për mjete juridike, emërimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e saj kushtetuese janë cenuar me njoftimin me të cilin nuk iu vazhdua mandati si gjyqtar në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë. Parashtruesi pretendon se me këtë njoftim i janë cenuar të drejtat e mbrojtura me nenet 5 [Gjuhët], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve] dhe 108 [Këshilli Gjyqësore i Kosovës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës në lidhje me nenin 47.2 të Ligjit për shkak se parashtruesi nuk kishte shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Gjykata arsyetoi vendimin e saj duke theksuar se parashtruesi i kërkesës nuk kishte ndërmarrë hapa për të zgjidhur kërkesën e tij siç parashihet me dispozitat përkatëse ligjore. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesve si të papranueshme.

Prishtinë, më 20 mars 2012

Nr.Ref.:RK209/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 139/11

Parashtrues

Ali Latifi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për riemërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Nr. 01/118-658, të 27 28 tetorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Ali Latifi, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Njoftimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KGJK), Nr. 01/118-658, të 27 tetorit 2010, për largimin e tij nga posti i gjyqtarit në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 26 tetor 2011, në të cilën pohonte se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 5 [Gjuhët], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve] dhe 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 i Ligjit dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 26 tetor 2011.

6. Më 23 janar 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës për parashtrimin e kërkesës.

7. Më 12 janar 2012, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. GJR. 139/11, e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. 139/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.

8. Më 28 janar2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi ta dorëzonte vendimin përfundimtar të Gjykatës Supreme lidhur me rastin e tij.

9. Parashtruesi u përgjigj më 31 janar 2012. Megjithatë, ai nuk e dorëzoi vendimin përfundimtar lidhur me rastin e tij.

10. Më 20 mars 20012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Parashtruesi është ish-gjyqtar i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, i cili e mori Njoftimin nga KGJK-ja, Nr. 01/118-658, të 27 tetorit 2010, me të cilin njoftohej se mandati i tij si gjyqtar në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë pushon më 27 tetor 2010.

12. Njoftimi i KGJK-së u referohet rezultateve të procesit të riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve përgjatë fazës së tretë, në bazë të nenit 2.11, nenit 2.16 dhe nenit 14.2 të Urdhëresës Administrative Nr. 2008/02 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe nenit 150 të Kushtetutës.

13. Më 1 nëntor 2010, parashtruesi ushtroi ankesë në KGJK, me anë të së cilës shprehte pakënaqësinë e tij lidhur me Vendimin Nr. 01/118-658.

14. Më 2 shkurt 2011, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër largimit pa vendim, ndërsa më 22 shkurt 2011, ai dorëzoi dokumente me të cilat e plotësonte ankesën e tij.

15. Më 22 shkurt 2011, kryetari i Gjykatës Supreme iu përgjigj mocionit të parashtruesit, me ç'rast parashtruesi u këshillua të fillonte procedurë për konflikt administrativ në Gjykatën Supreme.

16. Më 26 prill 2011, parashtruesi ushtroi padi për konflikt administrativ në Gjykatën Supreme, me ç'rast i përmendi shkeljet e supozuara të bëra nga KGJK-ja gjatë procesit të riemërimit.

17. Më 27 korrik 2011, parashtruesi dorëzoi një mocion në Gjykatën Supreme me anë të të cilit kërkonte trajtim urgjent të padisë së tij të dorëzuar më 26 prill 2011.

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi pretendon që njoftimi i KGJK-së nuk përmban arsye për largimin e tij nga posti i gjyqtarit. Kështu që, gjoja, është shkelur neni 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] i Kushtetutës.

19. Përveç kësaj, parashtruesi ankohet që Gjykata Supreme, gjoja, i ka shkelur nenet 5 [Gjuhët], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve] të Kushtetutës duke mos iu përgjigjur ankesës së tij të 2 shkurtit 2011 dhe të 22 shkurtit 2011.

20. Përveç kësaj, parashtruesi pretendon që KGJK-ja e ka shkelur nenin 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] për shkak se procesi i ekzaminimit nuk është i paraparë me ligj.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

21. Parashtruesi ankohet që KGJK-ja, me anë të Njoftimit Nr. 01/1018-658, të 27 tetorit 2010, për largimin e tij nga posti i gjyqtarit në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

22. Megjithatë, në mënyrë që kërkesa të jetë e pranueshme, parashtruesi së pari duhet të tregojë se i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

23. Sa i përket kësaj kërkese, Gjykata Kushtetuese vëren që më 27 tetor 2010, KGJK-ja e njoftoi parashtruesin, me anë të Njoftimit Nr. 01/1018-658, që mandati i tij si gjyqtar në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë pushoi më 27 tetor 2010.

24. KGJK-ja, me sa duket, e bazoi lëshimin e këtij njoftimi në nenin 150 të Kushtetutës dhe në nenet 2.11, 2.16 dhe 14.2 të Urdhëresës Administrative Nr. 2008/02 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë, pa i përmendur arsyet e tjera për largimin e parashtruesit.

25. Megjithatë, Gjykata thekson që ajo mund të vendosë vetëm për pranueshmëri të kërkesës nëse parashtruesi tregon se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive që i ka në dispozicion sipas ligjit në fuqi.

26. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih Aktvendimin për Papranueshmëri: Badivuku kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KI 114/10, të 18 majit 2011, dhe shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

27. Në këtë rast, Gjykata gjen që parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë provë dhe fakte *prima facie* që tregojnë se i ka shteruar të gjitha mjetet efektive sipas ligjit të Kosovës në mënyrë që Gjykata të procedojë me pretendimin e tij për kushtetutshmërinë e Njoftimit Nr. 01/118-658, të 27 tetorit 2010.

28. Prandaj, rezulton që kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 20 mars 2012, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Prof. Dr. Enver Hasani

KI 147/11 datë 21 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL. nr. 1288/2011, të 28 tetorit 2011

Rasti KI 147/11, vendimi i 20 marsit 2012

Fjalët kyçe: procedurë administrative, diskriminim, barazia para ligjit, kërkesë individuale, e drejta për mjete ligjore, shkelja e të drejtave dhe lirive individuale, qartazi i pabazuar, mos-shterimi

Parashtruesja parashtroi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pohuar se janë shkelur të drejtat e saj nga nenet 24 [Barazia para Ligjit], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] me vendimin e Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje, me të cilin u vërtetua vendimi i Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prizren qe ka të bëjë me gjobën, por e ndryshoi vendimin qe ka të bëjë me kohen gjate të cilës parashtruesja nuk ka të drejtë ri-hyrjeje në një vit.

Gjykata konkludoi se kërkesa ishte e papranueshme sepse parashtruesja nuk ka ofruar prova që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti. Prandaj, Gjykata vendosi se kërkesa ishte e pabazuar sipas rregullit 36 (1.c) të Rregullores së Punës. Për më tepër, sa i përket procedurës administrative Gjykata vëren që parashtruesja ka filluar procedurë administrative në Gjykatën Supreme kundër vendimit të Komisionit për Ankesa te 8 gushtit 2011. Megjithatë, Gjykata Supreme ende nuk ka asnjë vendim lidhur me këtë çështje. Prandaj, rezulton se kërkesa është e papranueshme për shkak të mos-shterimit.

Prishtinë, më 20 mars 2012

Nr. ref.: RK215/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 147/11

Parashtrues

Maria Strugari

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL. nr. 1288/2011, të 28 tetorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Maria Strugari, e përfaqësuar nga z. Armend Krasniqi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e konteston Vendimin e Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL. nr. 1288/2011, të 28 tetorit 2011, i cili iu dorëzua më 10 nëntor 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesja pohon që vendimi i Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje tregon se ajo ishte diskriminuar në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe se kurrë nuk iu ofrua mundësia për ta treguar gjendjen faktike para organeve përkatëse, gjë që përbën shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.

4. Përveç kësaj, parashtruesja kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) vënien e masës së përkohshme, me të cilën do të shtyhej urdhri për largim për shkak *se "është i panevojshëm. Në anën tjetër, me rastin e lëshimit të masës së përkohshme asnjë palë nuk do të mund të kishte dëme të cilat janë të mëdha dhe të pariparueshme"*.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesja e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 11 nëntor 2011.

7. Më 14 nëntor 2011, Gjykata Kushtetuese kërkoi sqarim shtesë nga parashtruesja për çështjet në vijim:

"...

a. Provë për leje pune të znj. Maria Strugari me kohëzgjatje deri në vitin 2012;
b. Provë për leje qëndrim të znj. Maria Strugari me kohëzgjatje deri në vitin 2012;
c. Kontrata e punës së znj. Maria Strugari;
d. Nëse kontrata e punës e znj. Maria Strugari është deponuar edhe në institucione të tjera;
e. A keni kërkuar vënien e masës së përkohshme në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Prizren dhe në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtine; dhe
f. A keni kërkuar vënien e masës së përkohshme në Gjykatën Supreme në pajtim me nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative.

g. Arsyetoni saktësisht pretendimet për shkeljet e të drejtave kushtetuese në dëm të klientes tuaj.

..."

8. Më 14 nëntor 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Ministrinë e Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejmë: MPB) për parashtrimin e kërkesës.

9. Parashtruesja u përgjigj më 16 nëntor 2011, duke thënë që:

"...

a. [...] Parashtrueses së kërkesës i është vazhduar Leja e Punës edhe për një vit gjer më dt.22.06.2010.
b. Leje Qëndrim nuk posedon, [...]. Mirpo pasi që i është vazhduar Leja e Punës edhe për një periudhë kohore për nje vite nga dt.22.06.2011 gjer më dt.22.06.2012, e njëjta ka aplikuar edhe për vazhdimin e Lejës së Përkohëshme të Qëndrimit në RKS, për edhe një periudhë kohore për sa sedhe i është vazhduar Leja e Punës, por kërkesa e saj është refuzuar nga ana e MPB-së, nga të dya shkallët, si nga shkalla e parë e po ashtu edhe nga shkalla e dytë, pas ushtrimit të ankesës kundër vendimit të shkallës së parë, shkalla e dytë fare nuk është lëshuar në shiqimin dhe shtjellimin e provave te ofruara nga ana e parashtrueses, por apriaoi ka vendosur që të refuzojë ankesën si të pa bazuar, dhe kundër këtijë Aktvendimi parashtruesja ka paraqitur Padi për fillimin e Konfliktit administratriv në Gjykatën Supreme të RKS-së, ku edhe tani Lënda është në shqyrtim e sipër.
c. Tani ju dërgojmë edhe kontratën e punës së parashtrueses së kërkesës.
d. Ju lutem, shifnmi në ankesat të cilat janë ushtruar dhe aty mund të shifet shumë kartë se i kemi dërguar shkallës së dytë të MBP-së, kopjen e Kontratës së punës.

e. Nuk kemi kërkuar masë të përkohshme nga Gjykata për Kundërvajtje në Prizren [...].

..."

10. Më 13 janar 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. 147/11, e caktoi gjyqtarin Robert Carolan për Gjyqtar raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. 147/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.

11. Më 2 shkurt 2012, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Komisionin për Shqyrtim të Lejes për Qëndrim të Përkohshëm dhe të Përhershëm (në tekstin e mëtejmë: Komisioni) dhe Komisionin për Ankesa të Komisionit për Shqyrtim (në tekstin e mëtejmë: Komisioni për Ankesa) për parashtrimin e kërkesës.

12. Më 2 shkurt 2012, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Departamentin për Migrim dhe të Huaj të MBP-së (në tekstin e mëtejmë: DMH), Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Prizren dhe Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë për parashtrimin e kërkesës.

13. Më 2 shkurt 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Departamentin për Shtetësi dhe Azil në MBP për parashtrimin e kërkesës dhe kërkoi informacione nëse kanë vendosur për ankesën e parashtrueses të 15 shtatorit 2011. Gjykata Kushtetuese nuk ka marrë asnjë përgjigje deri më tani.

14. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues më 20 mars 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

15. Parashtruesja, Maria Strugari, shtetase e Moldavisë, erdhi në Kosovë në vitin 2011 për të punuar në një restorant në Prizren. Asaj i ishte lëshuar letërnjoftimi për të huaj nga MPB-ja dhe leja për qëndrim të përkohshëm, që vlente deri më 22 qershor 2011. Parashtruesja gjithashtu mori lejen fillestare për punë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që vlente deri më 22 qershor 2011, por u vazhdua deri më 22 qershor 2012.

16. Më 21 qershor 2011, parashtruesja parashtroi kërkesë në DMH për vazhdimin e lejes për qëndrim të përkohshëm.

17. Më 26 korrik 2011, Komisioni e refuzoi kërkesën e parashtrueses duke arsyetuar se në bazë të provave të dorëzuara nga parashtruesja, ajo nuk i përmbush kriteret e parapara me nenin 36, paragrafi 3, dhe nenin 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-126 për të huajt.

18. Më 29 korrik 2011, parashtruesja ushtroi ankesë në Komisionin për Ankesa.

19. Më 8 gusht 2011, Komisioni për Ankesa, që e shqyrtonte ankesën e parashtrueses kundër vendimit të Komisionit për Shqyrtim të 26 korrikut 2011, e refuzoi ankesën e saj duke thënë që Komisioni për Shqyrtim kishte nxjerrë vendime të drejta sipas procedurës së paraparë ligjore, sepse parashtruesja kishte dështuar të vepronte në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për të huajt.

Neni 7 i Ligjit për të huajt përcakton:

I huaji duhet të respekton ligjet dhe rregulloret, përfshirë aktet nënligjore dhe vendimet e organeve shtetërore gjatë qëndrimit dhe lëvizjes së tij/saj në Republikën e Kosovës.

Neni 36, paragrafi 3, i Ligjit për të huajt përcakton:

Kërkesa për vazhdimin e qëndrimit të përkohshëm i paraqitet organit kompetent më së voni tridhjetë (30) ditë para skadimit të afatit të qëndrimit të përkohshëm.

Neni 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, i Ligjit për të huajt përcakton:

Të huajit mund ti lejohet qëndrimi i përkohshëm nëse ai/ajo: posedon mjete të mjaftueshme materiale për jetesë.

Prandaj, Komisioni për Ankesa e miratoi vendimin e Komisionit për Shqyrtim për ta refuzuar kërkesën për vazhdimin e lejes për qëndrim të përkohshëm në Kosovë. Në vendim thuhej se parashtruesja mund të fillojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Supreme në afat prej 30 ditësh pas pranimit të vendimit.

20. Më 9 shtator 2011, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë e MPB-së lëshoi urdhrin për largimin e parashtrueses, në pajtim me Ligjin për të huajt, nenin 46 (1) (3), i cili thotë që një të huaji i cili qëndron në Kosovë [...] dhe të huajit të cilit i është lejuar qëndrimi i përkohshëm, organi kompetent i ndërpret qëndrimin nëse ai/ajo [...] qëndron në Kosovë në kundërshtim me qëllimin për çka i është dhënë leja, dhe nenin 55 (2 dhe (3), i cili thotë që [...] kohën për të cilën i huaji mund ta bëjë lëshimin [...] do [...] të [...] në [...] më i gjatë se tridhjetë (30) ditë dhe [...]". Ankesa kundër vendimit mbi caktimin e afatit për lëshimin e shtetit nuk ndalon ekzekutimin e vendimit. Në Urdhrin për largim më tej thuhej që parashtruesja ka të drejtë të ushtrojë ankesë ndaj këtij vendimi në Departamentin për Shtetësi dhe Azil në MPB në afat prej 8 ditësh nga pranimi i vendimit.

21. Më 15 shtator 2011, parashtruesja ushtroi ankesë në Departamentin për Shtetësi dhe Azil në MPB.

22. Më 20 shtator 2011, parashtruesja filloi procedurën për konflikt administrativ në Gjykatën Supreme, e cila deri më tani nuk ka marrë asnjë vendim për këtë çështje.

23. Më 21 shator 2011, Komisioni për Ankesa e miratoi Urdhrin për largim (Vendimi Nr. 140/2011).

24. Më 27 shator 2011, DMA ushtroi kërkesë në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Prizren për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër parashtrueses.

25. Më 27 shtator 2011, parashtruesja u paraqit në Gjykatën për Kundërvajtje në Prizren dhe kërkoi që gjykata ta hidhte poshtë fillimin e procedurës si të papranueshëm për shkak se ishte e parakohshme, pasi ankesa e saj kundër vendimit të Komisionit për Ankesa ende ishte në procedurë në Gjykatën Supreme. Megjithatë, Gjykata për Kundërvajtje e shpalli parashtruesen fajtore për qëndrim në Kosovë, pasi leja e saj për qëndrim kishte skaduar më 22 qershor 2011, e gjobiti me 50 euro dhe urdhëroi largimin e saj të menjëhershëm nga territori i Kosovës pa të drejtë ri-hyrjeje për tri vjet. Në pajtim me nenin 55 (3) të Ligjit, ankesa kundër vendimit mbi caktimin e afatit për lëshimin e shtetit nuk ndalon ekzekutimin e vendimit (Vendimi Nr. 176/2011-01). Parashtruesja ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje.

26. Më 28 shtator 2011, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje pjesërisht e miratoi ankesën e parashtrueses. Gjykata e Lartë e miratoi vendimin e Gjykatës për Kundërvajtje në Prizren që ka të bëjë me gjobën, por e ndryshoi vendimin që ka të bëjë me kohën gjatë të cilës parashtruesja nuk ka të drejtë ri-hyrjeje në një vit. Gjykata e Lartë konstatoi që i kishte shqyrtuar pretendimet e përshkruara në ankesa, vendimet e kontestuara dhe deklaratën e parashtrueses të deponuar në shqyrtimin kryesor në gjykatën e shkallës së parë, në të cilën kishte pranuar se kishte bërë kundërvajtje, por tha se vendimi ishte i parakohshëm. Gjykata e Lartë më tej arsyetoi se, në bazë të fakteve të tjera nga shkresat e lëndës, u vërtetua edhe gjendja faktike e aktvendimit të ankimuar të Gjykatës Komunale. Gjykata e Lartë konkludoi se gjykata e shkallës së parë nuk kishte bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, respektivisht zbatim të gabuar të së

drejtës materiale. Gjykata e Lartë gjithashtu e njoftoi parashtruesen se kundër aktvendimit të saj nuk është e lejuar ankesa.

Pretendimet e parashtrueses

27. Parashtruesja pretendon që Komisioni, Komisioni për Ankesa, DMH, Gjykata për Kundërvajtje në Prizren dhe Gjykata e Lartë për Kundërvajtje e kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.

28. Më tej, parashtruesja pretendon që Gjykata për Kundërvajtje në Prizren dhe Gjykata e Lartë për Kundërvajtje nuk e kanë shqyrtuar se si është nxjerrë Urdhri për Largim, por vetëm konkluduan se parashtruesja nuk e ka respektuar atë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

29. Gjykata vëren që parashtruesja ankohet për dy çështje:

    1. Procedurën administrative në Komisionin për Shqyrtim dhe Komisionin për Ankesa; dhe

    2. Procedurën në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Prizren dhe në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje.

30. Në këtë drejtim, për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Këto kritere në parim janë: referimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese në mënyrë ligjore (neni 113 (1) i Kushtetutës); shterimi i të gjitha mjeteve juridike të parapara me Ligj (neni 113 (7) i Kushtetutës); parashtrimi i kërkesës brenda afatit të caktuar

kohor (nenet 49 dhe 56 të Ligjit); qartësimi cilat të drejta dhe liri janë shkelur; duke treguar aktin konkret të autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë (neni 48 i Ligjit); arsyetimi i kërkesës dhe bashkëngjitja e provave të nevojshme (neni 22 i Ligjit), duke përfshirë elemente të tjera të informacioneve.

1. Sa i përket procedurës administrative

32. Për ta shqyrtuar ankesën e parashtrueses lidhur me procedurën administrative në Komisionin për Shqyrtim dhe në Komisionin për Ankesa dhe pretendimet e saj se i është mohuar e drejta për mjet juridik siç garantohet me nenin 32 të Kushtetutës, Gjykata konsideron që ajo së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i ka në dispozicion sipas ligjit në fuqi.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

34. Kjo do të thotë që, sa i përket procedurës administrative në Komisionin për Shqyrtim dhe në Komisionin për Ankesa, parashtruesja duhet t'i tregojë kësaj Gjykate se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, duke përfshirë ankesën në Odën Administrative të Gjykatës Supreme.

35. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që parashtruesja ka filluar procedurë administrative në Gjykatën Supreme kundër vendimit të Komisionit për Ankesa të 8 gushtit 2011. Megjithatë, Gjykata Supreme ende nuk ka asnjë vendim lidhur me këtë çështje.

36. Prandaj, rezulton që parashtruesja nuk e ka respektuar rregullin për shterimin e mjeteve juridike. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, Aktvendim për Papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, i 27 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25 803/94, Vendim i 28 korrikut 1999).

2. Sa i përket procedurës në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje dhe në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje

37. Sa i përket ankesës se vendimet e Gjykatës Komunale për Kundërvajtje dhe Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje i kanë shkelur të drejtat e parashtrueses të garantuara me:

a. Nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës pasi gjykata, gjoja, është marrë vetëm me çështje teknike dhe e ka shpallur atë fajtore për mosrespektim të Urdhrit për Largim, kurse fare nuk e ka shqyrtuar "mënyrën arbitrare për nxjerrjen e atij vendimi"; dhe

b. Nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, pasi, gjoja, parashtrueses i është mohuar e drejta për mjete juridike në nivel administrativ, dhe nuk ka pasur mundësi t'i tregonte Gjykatës se vërtetimi i gjendjes faktike ishte bërë në mënyrë plotësisht të padrejtë, gjë që rezultoi në refuzim të kërkesës për leje për qëndrim dhe lëshim të urdhrit për largim,

Gjykata Kushtetuese thekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para.

28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

38. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).

39. Në rastin në fjalë, parashtruesja vetëm konteston nëse Gjykata Komunale për Kundërvajtje dhe Gjykata e Lartë për Kundërvajtje e kanë zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin në fuqi dhe nuk pajtohet me gjetjet faktike të gjykatave lidhur me rastin e saj.

40. Në fakt, parashtruesja nuk e ka mbështetur kërkesën në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e saj janë shkelur nga ai organ publik. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

41. Prandaj, duke marrë parasysh këtë që u tha më lart, rezulton që kërkesa, si tërësi, duhet të hedhet poshtë si qartazi e pabazuar sa i përket procedurës në gjykatën komunale dhe pjesërisht për shkak të dështimit për t'i shteruar të gjitha mjetet juridike sa i përket procedurës së pazgjidhur administrative.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

42. Sa i përket kërkesës së parashtrueses drejtuar Gjykatës për masë të përkohshme, Gjykata i referohet nenit 27 të Ligjit dhe, në veçanti, rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, i cili thotë që, në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme. Megjithatë, duke pasur parasysh që parashtruesja nuk ka kërkuar vendosjen e

masës së përkohshme as në Gjykatën Komunale në Prizren, as në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, as në Gjykatën Supreme në pajtim me nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për konfliktet administrative dhe që kërkesa ishte shpallur e papranueshme, parashtruesja nuk ka të drejtë, sipas rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, të kërkojë masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, rregullin 36 (1.c), rregullin 54 (1) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 20 mars 2012, Gjykata Kushtetuese me shumicë:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 106/11, KI 110/11, KI 115/11 dhe KI 116/11 datë 24 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Gjykatës së Qarkut në Pejë, PN. Nr. 81/11 dhe PN. Nr. 83/11, të 1 korrikut 2011

Rasti KI 106/11, KI 110/11, KI 115/11 dhe KI 116/11, vendimi të 20 marsit 2012

Fjalët kyçe: lënda penale, parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor, interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut, kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta në mjete juridike, shkelja e të drejtave dhe lirive individuale, qartazi e pabazuar, palë e paautorizuar

Parashtruesit parashtruan kërkesë në pajtim me nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pretenduar se të drejtat e tij nga neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], të Kushtetutës dhe neni 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] në lidhje me nenin 13 [E Drejta në Mjet Efektiv] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj, ishin shkelur me vendimet e Gjykatës së Qarkut në Pejë, të cilat konstatuan se ankesa kundër vendimit gjyqësor për konfirmimin e aktakuzës do të lejohej, nëse aktakuza ishte hedhur poshtë, në pajtim me nenin 317(2) të KPPP.
Gjykata i bashkoi kërkesat, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës. Gjykata më tutje konsideroi se kërkesa ishte e papranueshme sepse parashtruesit dështuan të ofrojnë dëshmi që procedurat relevante ishin në ndonjë mënyrë të padrejta ose të prekura nga arbitrariteti. Prandaj, Gjykata konsideroi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës. Përveç kësaj, sa i përket pajtueshmërisë së ligjeve, d.m.th. të KPPK-së me Kushtetutën, Gjykata vëren se vetëm palët e autorizuara nga neni 113.2 të Kushtetutës kanë të drejtë ta parashtrojnë këtë çështje. Prandaj, parashtruesit nuk janë palë e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës. Sidoqoftë, parashtruesit mundën të ngrenë çështjen e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën në gjykatat e rregullta, se kush është i autorizuar sipas nenit 113.8 të Kushtetutës të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese.

Prishtinë, më 20 mars 2012

Nr. ref.: RK213/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastet nr. KI 106/11, KI 110/11, KI 115/11 dhe KI 116/11

Parashtrues

Neki Myha dhe Nijazi Xharavina

Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Gjykatës së Qarkut në Pejë, PN. Nr. 81/11 dhe PN. Nr. 83/11, të 1 korrikut 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtrues të kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Neki Myha, i përfaqësuar nga z. Avdi Rizvanolli, avokat nga Prishtina, dhe z. Nijazi Xharavina, i përfaqësuar nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi, z. Neki Myha, i konteston vendimet e Gjykatës së Qarkut në Pejë, PN. nr. 81/11 dhe Pn. nr. 83/11, të dyja të 1 korrikut 2011, të cilat iu dorëzuan më 14 korrik 2011.

3. Parashtruesi, z. Nijazi Xharavina, gjithashtu i konteston vendimet e Gjykatës së Qarkut në Pejë, PN. nr. 81/11 dhe Pn. nr. 83/11, të dyja të 1 korrikut 2011, të cilat iu dorëzuan më 14 korrik 2011.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) i kushtetutshmërisë së vendimeve të Gjykatës së Qarkut në Pejë, me të cilat, gjoja, janë shkelur të drejtat e të dy parashtruesve të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi, z. Neki Myha, e dorëzoi një kërkesë në Gjykatë më 8 gusht 2011, e cila u regjistrua si Rasti Nr. KI 106/11.

7. Parashtruesi, z. Nijazi Xharavina, e dorëzoi një kërkesë në Gjykatë më 10 gusht 2011, e cila u regjistrua si Rasti Nr. KI 110/11.

8. Më 17 gusht 2011, parashtruesi i parë e dorëzoi edhe një kërkesë tjetër në Gjykatë, e cila u regjistrua si Rasti Nr. KI 115/11.

9. Të njëjtën ditë, parashtruesi i dytë gjithashtu e dorëzoi edhe një kërkesë tjetër në Gjykatë, e cila u regjistrua si Rasti Nr. KI 116/11.

10. Kërkesat e dorëzuara nga parashtruesi, z. Neki Myha, Rastet Nr. KI 106/11 dhe KI 115/11, kanë të bëjnë me objektin e njëjtë të çështjes dhe janë të drejtuara kundër aktit të njëjtë të organit publik; megjithatë, parashtruesi insistoi që rasti duhej të regjistrohej ndaras.

11. Kërkesat e dorëzuara nga parashtruesi, z. Nijazi Xharavina, Rastet Nr. KI 110/11 dhe KI 116/11, kanë të bëjnë me objektin e njëjtë të çështjes dhe janë të drejtuara kundër aktit të njëjtë të organit publik; megjithatë, edhe në këtë rast, parashtruesi insistoi që rasti duhej të regjistrohej ndaras.

12. Më 23 gusht 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI 106/11, KI 110/11, KI 115/11 dhe KI 116/11, e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese, dhe me Vendimin Nr. KSH. KI 106/11, KI 110/11, KI 115/11 dhe KI 116/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Iliriana Islami

13. Më 23 gusht 2011, Kryetari, me Urdhrin Nr. KI 106/11, KI 110/11, KI 115/11 dhe KI 116/11, urdhëroi bashkimin e kërkesave, Rastet Nr. KI 106/11, KI 110/11, KI 115/11 dhe KI 116/11, në përputhje me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

"Sekretariati njofton Kryetarin dhe Gjyqtarin raportues se kërkesa mund të jetë e ndërlidhur, për nga çështja e trajtuar në të me një kërkesë tjetër të parashtruar para Gjykatës dhe të jetë e drejtuar kundër aktit të njëjtë të një autoriteti publik. Kryetari, me rekomandimin e Gjyqtarit raportues, mund të urdhërojë bashkimin e kërkesave të ndara."

14. Më 26 tetor 2011, Gjykata i njoftoi parashtruesit për bashkimin e kërkesave të tyre.

15. Më 26 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe Prokurorin publik komunal në Pejë lidhur me kërkesën e parashtruar.

16. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese më 20 mars 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

17. Më 3 mars 2011, Gjykata Komunale në Gjakovë, me Vendimin P. nr. 108/10, e konfirmoi aktakuzën e ngritur nga Prokurori publik komunal në Pejë kundër parashtruesve për kryerje të veprës penale nga neni 339 (2), në lidhje me nenin 343 (1) dhe nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK). Gjykata Komunale konstatoi se kishte baza të mjaftueshme për ta bërë konfirmimin e aktakuzës në mënyrë që në shqyrtimin gjyqësor të vërtetohej fajësia apo pafajësia e të akuzuarve. Në këshillën juridike të këtyre vendimeve thuhej që kundër këtyre aktvendimeve nuk është e lejuar ankesa.

18. Më 3 mars 2011, Gjykata Komunale në Gjakovë, me Vendimin P. nr. 53/2010, e konfirmoi aktakuzën e ngritur nga Prokurori publik komunal në Pejë kundër z. G. Z. për kryerje të veprës

penale nga nenet 332 (3.1), 334 (1) dhe 344 (1) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK), dhe parashtruesve për kryerje të veprës penale nga neni 339 (2), në lidhje me nenin 343 (1) dhe nenin 23 të KPPK-së. Gjykata Komunale konstatoi se kishte baza të mjaftueshme për ta bërë konfirmimin e aktakuzës në mënyrë që në shqyrtimin gjyqësor të vërtetohej fajësia apo pafajësia e të akuzuarve. Në këshillën juridike të këtyre vendimeve thuhej që kundër këtyre aktvendimeve nuk është e lejuar ankesa.

19. Më 28 mars 2011, parashtruesit iu ankuan Kolegjit prej tre gjyqtarëve të Gjykatës Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Kolegji) kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale P. nr. 53/2010.

20. Më 30 mars 2011, Kolegji e hodhi poshtë ankesën e parashtruesve si të papranueshme (Vendimi P. nr. 53/10). Kolegji konkludoi se ankesa kundër aktvendimit të gjykatës për konfirmimin e aktakuzës lejohet vetëm nëse aktakuza është hedhur poshtë, në përputhje me nenin 317 (2) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale (në tekstin e mëtejmë: KPPP), i cili përcakton: *"Ndaj aktvendimit të gjyqtarit për hudhjen e aktakuzës mund të ushtrohet ankesë nga prokurori dhe i dëmtuari në kolegjin prej **[tre]** gjyqtarësh"*. Prandaj, parashtruesit ushtruan ankesë kundër këtij vendimit në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

21. Më 4 prill 2011, parashtruesi i parë u ankua kundër Vendimit P. nr. 108/10, të 3 marsit 2011, të Gjykatës Komunale në Gjakovë, në Kolegjin e asaj gjykate, ndërsa parashtruesi i dytë këtë e bëri më 8 prill 2011.

22. Më 2 qershor 2011, me Vendimin P. nr. 108/2010, Kolegji e hodhi poshtë ankesën e parashtruesve si të papranueshme dhe konkludoi që ankesa kundër aktvendimit të gjykatës për konfirmimin e aktakuzës lejohet vetëm nëse aktakuza është hedhur poshtë, në përputhje me nenin 317 (2) të KPPP-së.

23. Më 8 qershor 2011, parashtruesit ushtruan ankesë në Kolegj kundër vendimit të 2 qershorit 2011.

24. Më 13 qershor 2011, Kolegji e hodhi poshtë ankesën e parashtruesve si të papranueshme (Vendimi P. nr. 108/10), duke theksuar që: *"Ndaj aktvendimit të gjyqtarit për hudhjen e aktakuzës mund të ushtrohet ankesë nga prokurori dhe i dëmtuari në kolegjin prej* ***[tre]*** *gjyqtarësh"*. Prandaj, parashtruesit ushtruan ankesë kundër këtij vendimit në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

25. Më 1 korrik 2011, me Vendimin P. nr. 81/11, Gjykata e Qarkut në Pejë e hodhi poshtë ankesën e parashtruesve si të pabazuar dhe konkludoi se ankesa kundër aktvendimit të gjykatës për konfirmimin e aktakuzës lejohet vetëm nëse aktakuza është hedhur poshtë, në përputhje me nenin 317 (2) të KPPP-së.

26. Më 1 korrik 2011, me Vendimin P. nr. 81/11, Gjykata e Qarkut në Pejë e hodhi poshtë ankesën e parashtruesve kundër Vendimit të Gjykatës Komunale në Pejë, P. nr. 53/10, të 30 marsit 2011, si të pabazuar dhe konkludoi se ankesa kundër aktvendimit të gjykatës për konfirmimin e aktakuzës lejohet vetëm nëse aktakuza është hedhur poshtë, në përputhje me nenin 317 (2) të KPPP-së.

Pretendimet e parashtrueseve

27. Parashtrueset pretendojnë që:

    a. U është shkelur e drejta e tyre për të ushtruar ankesë dhe e drejta e tyre për qasje në gjykatë për shkak se ata nuk mund të ushtronin ankesë kundër aktvendimit të gjyqtarit për konfirmimin e aktakuzës së 3 marsit 2011;

b. Parimi i barazisë së armëve ndërmjet palëve në procedurë është shkelur gjithashtu për shkak të faktit se ata nuk mund të ushtronin ankesë kundër aktvendimit të gjyqtarit për konfirmimin e aktakuzës, kurse prokurori ka mundësi, në pajtim me nenin 317 (2) të KPPP-së, për të ushtruar ankesë nëse gjyqtari e hedh poshtë konfirmimin e aktakuzës;

c. Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut gabimisht e kishin interpretuar nenin 317 (2), sepse, sipas mendimit të tre, ekziston e drejta për të ushtruar ankesë sipas KPPP-së.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Parashtruesit pohojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 102 [parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive], të KEDNJ-së.

29. Sa u përket ankesave të parashtruesve, Gjykata së pari vëren që, për të gjykuar për ankesat e parashtruesve, ajo së pari duhet të shqyrtojë nëse ata i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës

së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

31. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).

32. Në rastin në fjalë, parashtruesit pretendojnë që ka shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë, pasi atyre nuk u është lejuar të ushtrojnë ankesë kundër vendimit të një gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 102.5 të Kushtetutës i cili thotë: *"Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe"*. Neni 317 (2) i KPPP-së nuk përcakton të drejtën e parashtruesve për të ushtruar ankesë kundër konfirmimit të aktakuzës. Pavarësisht kësaj, kolegji i Gjykatës Komunale dhe Gjykata e Qarkut morën parasysh ankesën e parashtruesve, por konstatuan që kundër konfirmimit të aktakuzës nuk mund të ushtrohet ankesë sipas nenit 317 (2) të KPPP-së, i cili përcakton:

"Ndaj aktvendimit të gjyqtarit për hudhjen e aktakuzës mund të ushtrohet ankesë nga prokurori dhe i dëmtuari në kolegjin prej ***[tre]*** *gjyqtarësh"*.

34. Përveç kësaj, Gjykata vëren që konfirmimi i aktakuzës nuk paragjykon gjykimin e çështjes gjatë shqyrtimit gjyqësor në përputhje me nenin 317 (1) të KPPP-së, i cili përcakton:

"Të gjitha aktvendimet e marra nga gjyqtari lidhur me konfirmimin e aktakuzës duhet të arsyetohen në atë mënyrë që të mos prejudikohet gjykimi i çështjeve të cilat do të shqyrtohen në shqyrtimin gjyqësor."

35. Pas shqyrtimit të procedurave në këto gjykata si tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

36. Prandaj, rezulton që kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhje me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës, i cili përcakton: *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar".*

37. Nëse kjo Gjykatë merr parasysh faktin se parashtruesit ngrenë çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, pra të KPPP-së, me Kushtetutën, Gjykata vëren që vetëm palët e autorizuara sipas nenit 113.2 të Kushtetutës kanë të drejtë ta ngrenë këtë çështje. Prandaj, parashtruesit nuk janë palë e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës. Megjithatë, parashtruesit mund ta ngrenë çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën në gjykata të rregullta, të cilat janë të autorizuara sipas nenit 113.8 të Kushtetutës të referojnë çështje në Gjykatën Kushtetuese.

38. Prandaj, kërkesat duhet të refuzohen si të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, rregullin 36 (1.c) 36 dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 20 mars 2012, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

KI 46/11 datë 29 mars 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë të mosekzekutimit të Aktgjykimit CI.nr.33/2006 të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 5 korrikut 2006

Rasti KI 46/11, vendimi i 12 shkurtit 2007

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, e drejta në pune, qartazi e pabazuar, mos shterje të mjeteve juridike, Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi i ankesës ishte ankuar se me mos ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale CI. nr. 33/2006 të 5 korrikut 2006, ati i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë dhe saktësisht kishte cekur dispozitat Kushtetuese prej nenit 21 deri në nenin 56 të Kushtetutës. Për më tepër ai kishte theksuar se atij i është "cenuar e drejta për pagë"

Gjykata thekson që asnjë nenë të saj në Kushtetuta e Kosovës nuk garanton të drejtën të " drejtën për pagë", Gjykata gjithashtu konsideron se me aktin e autoritetit publik ekzekutimin e të cilit e kërkon parashtruesi i kërkesës nuk ka mundë të ketë shkelje të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të parapara me Kushtetutë duke filluar nga nenet 21-56 sepse ato janë të ndryshme edhe për nga përmbajtja edhe për nga natyra juridike e tyre dhe të gjitha ato, në asnjë mënyrë nuk lidhen me rastin e parashtruesit të kërkesës, andaj në këtë bazë konsideron se kërkesa është qartazi e pabazuar.

Gjykata Kushtetuese , konsideron se kërkesa duhet të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar si dhe për shkak të mos shterjes së mjeteve juridike.

Prishtinë, më 23 mars 2012

Nr. ref.:RK 211 /12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMERI

në

Rastin Nr. KI 46/11

Parashtruesi

Behram Kaçiu

Vlerësimi i kushtetutshmërisë të mosekzekutimit të Aktgjykimit CI.nr.33/2006 të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 5 korrikut 2006

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Behram Kaçiu nga Fshati Lupç i poshtëm, komuna e Podujevës

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë CI nr. 307/2006, i 12 shkurtit 2007.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, është mos ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë CI. nr. 33/2006 i 5 prillit 2011, të cilin pala e ka pranuar sipas pohimit personal më 11 prill 2006.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës(në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i datës 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 prill 2011 , Behram Kaçiu parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me të cilën ka pohuar se ka një vendim të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale –Aktgjykimin CI. Nr .33/2006 të 5 korrikut 2006 sipas të cilit atij në emër të kompensimit të pagave të pa paguara do të duhej ti akordohej kompensimi në vlerë të përgjithshme prej 2.197.65 €, i cili nuk është ekzekutuar as nga debitori KNI" Ramiz Sadiku" e as nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit i cili kishte nën administrim këtë kombinat.

6. Më 19 prill 2011, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodriguez (anëtar)dhe Ivan Cukalovicj, (anëtar).

7. Më 7 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese njoftoi me shkrim Gjykatën Komunale lidhur me regjistrimin e kësaj lënde dhe kërkoi nga kjo Gjykatë komentet eventuale lidhur me lëndën.

8. Më 15 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese nga Gjykata Komunale në Prishtinë ka pranuar përgjigjeje me shkrim në të cilën është thekuar se kjo Gjykatë ka lejuar përmbarimin e Aktgjykimit CI nr. 307/2006, të 12 shkurtit 2007, por pastaj në bazë të ankesës së Agjensionit Kosovar të Privatizimit ka

pezulluar të gjitha veprimet përmbarimore, duke dërguar edhe kopjet e aktvendimeve përkatëse.

9. Më 19 maj 2011, pas dëgjimit të Gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodriguez, (anëtar) dhe Ivan Cukalovic (anëtar), i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë ta shpall kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 5 korrik 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë ka nxjerrë Aktgjykimin **–nga baza a pranimit** CI. nr. 33/2006 me anë të cilit **aprovoj** Padinë e paditësit Behram Kaçiu nga Lupçi i Poshtëm i Podujevës .

11. Gjykata kishte obliguar KNI ”Ramiz Sadiku” nga Prishtina që z.Kaçiu në emër të pagave të papaguara për muajt qershor dhe korrik 2003, muajt prill-dhjetor 2005 shumën e përgjithshme në vlerë prej 2.197.65 € .

12. Meqenëse Aktgjykimi është nxjerr mbi bazën e pranimit të palëve në udhëzimin juridik të tij shkruan se “kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa dhe se palët kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës, andaj Aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm në ditën e marrjes së tij”.

13. Më 16 prill 2009 duke parë se Aktgjykimi i plotfuqishëm nuk po zbatohej z. Behram Kaçiu në Gjykatën Komunale në Prishtinë ka parashtruar kërkesën për përmbarimin e Aktgjykimit CI. nr. 33/2006 të 5 korrikut 2006, dhe në bazë të kësaj kërkese Gjykata Komunale në Prishtinë ka formuar lëndën me nr. E. nr. 343/09.

14. Më 4 mars 2011, z,Behram Kaçiu kishte bërë përmirësimin e propozimit të tij për përmbarim e 16 prillit 2009 në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar që të përmirësohet gabimi teknik i bërë në dy vende të propozimit ku në vend të shumës së përgjithshme 1.271,70€ do të duhej të shkruhet shuma 2.197.65 €.

15. Me 13 prill 2011, duke vlerësuar se propozimi për përmbarimin e Aktgjykimit ë plotfuqishëm po zvarritet në kohë të paarsyeshme z. Kaçiu bëri edhe një urgjencë me shkrim në të cilën kërkonte përshpejtimin e procedurës në Gjykatën Komunale.

16. Më 7 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese kishte kërkuar një përgjigjeje me shkrim nga Gjykata Komunale në Prishtinë lidhur me statusin aktual të lëndës E.nr. 343/09.

17. Më 13 qershor 2011 Gjykata Komunale e Prishtinës dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese shkresën Ag. su 172/11, me anë të së cilës ka shpjeguar ecurinë e kësaj lënde.

18. Më 14 shkurt 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë ka lejuar përmbarimin e propozimit të bërë për përmbarim nga z. Behram Kaçiu.

19. Më 21 prill 2011, duke vendosur sipas kundërshtimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori AKTVENDIM lidhur me lëndën E.nr. 343/09 me të cilin MIRATON kundërshtimin Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe PEZULLON Procedurën e përmbarimit të miratuar nga po kjo Gjykatë lidhur me lëndën E. nr. 343/09 të 14 shkurtit 2011. Në këshillën juridike të këtij aktvendimi shkruan se lejohet ankesa në afat prej shtatë(7) ditësh nga dita e pranimit të tij në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

20. Nga fletëkthesa që Gjykatës Kushtetuese ia ka dërguar Gjykata komunale në Prishtinë konstatohet se z. Behram Kaqiut ky aktvendim i është dërguar me postë.

21. Gjykata Kushtetuese nuk ka njohuri nëse z. Behram Kaçiu ka ushtuar ankesë kundër këtij aktvendimi,

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës ka pohuar se atij i janë shkelur të drejtat themelore të njeriut si e drejta për pagë, ndërsa kërkesën e ka bazuar në shkeljet e supozuara te neneve 21-56 të Kushtetutës, i njëjti nga Gjykata Kushtetuese ka kërkuar përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë CI nr. 307/2006 të 12 shkurtit 2007.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Për te qene ne gjendje për te gjykuar mbi Kërkesën e Parashtruesit te kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht te vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë te cilat përcaktohen ne Kushtetute, ligj dhe Rregullore të Punës.

24. Ne lidhje me ketë, Gjykata i referohet nenit 113.7 te Kushtetutës qe përcakton se:

> *"Individët janë te autorizuar te ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike te drejtave dhe lirive te tyre individuale, te garantuara me Kushtetute**, mirëpo **vetëm** pasi te **kenë shteruar te gjitha mjetet juridike** te përcaktuara me ligj."*

25 Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar

Sa i përket pretendimeve të parashtruesit për shkeljen e të drejtave të njeriut

26. Parashtruesi i ankesës ishte ankuar se me mos ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale CI. nr. 33/2006 të 5 korrikut 2006, ati i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë dhe saktësisht kishte cekur dispozitat Kushtetuese prej nenit 21 deri në nenin 56 të Kushtetutës. Për më tepër ai kishte theksuar se atij i është "**cenuar e drejta për pagë"**

27. Gjykata dëshiron të theksojë se në asnjë nen të saj Kushtetuta e Kosovës nuk garanton të "drejtën për pagë" por ne nenin 49 ka paraparë"

Neini 49[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

28. Gjykata gjithashtu konsideron se me aktin e autoritetit publik ekzekutimin e të cilit e kërkon parashtruesi i kërkesës nuk ka mundë të ketë shkelje të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të parapara me Kushtetutë duke filluar nga nenet 21-56 sepse ato janë të ndryshme edhe për nga përmbajtja edhe për nga natyra juridike e tyre dhe të gjitha ato, në asnjë mënyrë nuk lidhen me rastin e parashtruesit të kërkesës, andaj në këtë bazë konsideron se kërkesa është **qartazi e pabazuar**

Pretendimi për zgjatjen e procedurës në Gjykatën komunale në Prishtinë

29. Në pretendimin e tij parashtruesi i kërkesës thekson se në Gjykatën Komunale nuk është marrë për një kohë të gjatë asnjë veprim procedural për shqyrtimin e kërkesës së tij për përmbarimin Aktgjykimit të formës së prerë e në fakt Gjykata Komunale në Prishtinë aktvendimin për lejimin e përmbarimit E.nr.343/09 e kishte marrë me 14 shkurt 2011, pra 2 muaj përpara se parashtruesi i kësaj kërkese ti drejtohej Gjykatës Kushtetuese dhe ai këtë fakt fare nuk e ka cekur në kërkesën e tij të drejtuar në Gjykatën Kushtetuese.

30. Gjykata gjithashtu vëren se, zgjatjes së procedurës i ka kontribuar edhe parashtruesi i kërkesës sepse sipas pohimit të tij personal ai Aktgjykimin e Gjykatës Komunale

CI.nr.33/2006 e kishte marrë me 11 korrik 2006 ndërsa propozimin për përmbarim e kishte bërë me 16 prill 2009, pra gati tri vite pas marrjes së Aktgjykimit ekzekutimin e të cilit e kërkon andaj edhe në këtë bazë Gjykata Konsideron se kërkesa është **qartazi e pabazuar**

31. Për më tepër Gjykata vëren se nga dokumentacioni i paraqitur në kërkesë nga ana e parashtruesit të saj si dhe nga dokumentacioni i dërguar nga Gjykata komunale në përgjigjejen e saj lidhur me këtë kërkesë,Gjykata Kushtetuese konstaton se çështja e ekzekutimit të Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale CI.nr.33/2006 të datës 05.07.2006 është akoma në procedurë përmbarimore dhe se parashtruesi ka mundësi të shterjes së mëtutjeshme të mjeteve të parapara ligjore për të realizuar të drejtën e tij të pretenduar.

32. Në fakt me Ligjin për Procedurën përmbarimore (Ligji **Nr. 03/L-008)** saktësisht me nenin 12 në pikat 12.4 dhe 12.5 është përcaktuar se:

> 12.4 Kundër aktvendimit të dhënë lidhur me prapësimin mund të paraqitet ankesa brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit.
>
> 12.5 Për ankesën e paraqitur është kompetente të vendos gjykata e shkallës së dytë."

33. Bazuar në këtë gjendje faktike, konsideroj se z. Behram Kaqiu pas aktvendimit të Gjykatës Komunale të datës 21 prill 2011, konforrm kësaj dispozite ligjore por bazuar edhe në udhëzimin juridik të dhënë në at Aktvendim mund të ankohet

në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë pra rrjedhimisht të shterrë edhe këtë mjet juridik efektiv.

34. Në këtë drejtim gjykata thekson se kriteri juridik i shterjes "i të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj" është absolutisht i domosdoshëm si kusht esencial për të paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, dhe përpos që është një kusht juridik i paraparë me Kushtetutë dhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese,si kusht esencial juridik parashihet edhe me rregullin 36 par pika (a) të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese

35. Gjykata dëshiron te theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit te mjeteve juridike është qe t'ua ofrojë autoriteteve ne fjale, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar te Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës, do te sigurojë mjet efikas ligjor për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis,* GJEDNJ, Selmouni v. France nr. *25803/94,* Vendim i 28 korrikut 1999

36. Gjykata një arsyetim të tillë e kishte aplikuar në gjatë shqyrtimit të mëparshëm të kërkesave e në rastet : KI 55/10 Hamide Osaj në kërkesën për Vleresim i Kushtetutshmërisë te Aktgjykimit te Gjykatës Supreme te Kosovës, Pkl. nr. 43/2010, i datës 4 qershor 2010 ; Rastin nr. KI *20/10* Muhamet Bucaliu kunder Vendimit te Prokurorit te Shtetit KMLC.nr. *09/10* te 24 shkurtit 2010 (vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 15 Tetor 2010**).**

37. Në këto rrethana Gjykata Kushtetuese , konsideron se kërkesa duhet të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar si dhe për shkak të mos shterjes së mjeteve juridike në dispozicion andaj :

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47.2 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.1 (a) dhe 36.2 (b) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e mbajtur me 8 korrik 2011, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme .

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20-4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Mr. sc. Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 98/10 datë 17 prill 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve 01 nr. 06/837, të datës 16 prill 2009, dhe Npi-01/132, të datës 30 prill 2009, të Kuvendit Komunal të Shtimes

Rasti KI 98/10, Vendimi për papranueshmëri i datës 13 maj 2011

Fjalët kyçe: palë e paautorizuar, ndalimi i diskriminimit, e drejta e privatësisë, e drejta për respektim të jetës private dhe familjare, shkelje të të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi ka parashtruar Kërkesë në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke kontestuar vendimet e Kuvendit Komunal të Shtimes, atë 01 nr.06/837 të 16 prillit 2009, si dhe Npi-01/132 të datës 30 prill 2009, si të marra me shkelje të nenit 36 [E drejta e privatësisë] të Kushtetutës, si dhe nenit 8.1 [E drejta për respektim të jetës private dhe familjare] dhe nenit 14 [Ndalimi i diskriminimit] të KEDNJ-së, sepse Komuna e Shtimes i kishte anuluar të drejtën Znj. Ristiq që të shfrytëzonte banesën, si dhe i kishte dhënë shfrytëzimit një uzurpatori të paligjshëm.

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së Kërkesës, Gjykata gjeti që Kërkesa ishte e papranueshme, pasi që çështja nuk ishte parashtruar në Gjykatë në mënyrën e ligjshme, nga pala e autorizuar, sipas nenit 113.1 të Kushtetutës.

Prishtinë, më 04 prill 2012

Nr. ref.: RK 216/12

AKTVENDIMI PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 98/10

Parashtruesi

Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve 01 nr. 06/837, të datës 16 prill 2009, dhe Npi-01/132, të datës 30 prill 2009, të Kuvendit Komunal të Shtimes

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Avokati i Popullit) i cili në pajtim me nenin 113.2.2 të Kushtetutës ka parashtruar kërkesën në rastin e znj. Lelica Ristiq, me vendbanim në Jagodinë, Republika e Serbisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston vendimet e Kuvendit Komunal të Komunës së Shtimes, 01 nr.06/837, të datës 16 prill 2009 dhe Npi-01/132, të datës 30 prill 2009.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon se janë shkelur neni 36 [E drejta në privatësi] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe neni 8.1 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare], dhe neni 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

Baza juridike

4. Neni 113.2 (2) i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji") dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 tetor 2010, parashtruesi ka dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 16 dhjetor 2010, Kryetari, me Urdhërin Nr. GJR.98/10, emëroi gjyqtarin Kadri Kryeziu si Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditë, me Urdhrin e Kryetarit Nr.KSH.98/10, është emëruar Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.

7. Më 17 janar 2011, njoftimi për kërkesën e parashtruar i është dërguar Kuvendit Komunal në Shtime (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi Komunal).

8. Më 13 maj 2011, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe shumica rekomandoi papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 30 dhjetor 1996, Kuvendi Komunal ka marrë vendim me Nr. 01 nr.360/659 që zonjës Lelica Ristiq, si punonjëse e administratës komunale t'i ndajë në shfrytëzim për kohë të pacaktuar një banesë. Ndarja e banesës në fjalë është bërë nga

komisioni për strehimin e punëtorëve në nevojë të administratës komunale të Shtimes, dhe u konfirmua me vendimin Nr. 01, 06-605/1, të datës 7 tetor 1996, dhe nr. 360/620, të datës 11 tetor 1996.

10. Znj. Ristiq në qershor të vitit 1999 kishte lëshuar Kosovën, për shkaqe sigurie dhe për shkak të situatës politike, dhe e njëjta ishte zhvendosur përkohësisht në Jagodine, Serbi.

11. Më 7 korrik 2008, znj. Ristiq, e shoqëruar nga pjesëtaret e Policisë së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PK) dhe zyrtarët e Zyrës ndërlidhëse me gjykata në Ferizaj, kanë vizituar banesën në fjalë, ku është vërtetuar se banesën e kishin zënë disa persona në mënyrë joligjore.

12. Znj. Ristiq, më 27 korrik 2008, e shoqëruar sërish nga zyrtarët e Zyrës ndërlidhëse është paraqitur në stacionin e PK-së në Shtime, ku edhe ka paraqitur një ankesë së bashku me kopjen e vendimit 01, nr.360/659, të datës 30 dhjetor 1996, si dëshmi mbi të drejtën e shfrytëzimit të banesës.

13. Më 10 qershor 2009, znj. Ristiq ka parashtruar ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit në Prishtinë, kundër Kuvendit Komunal dhe Policisë së Kosovës, pasi që këta nuk ia kishin mundësuar asaj vendosjen në banesën e kontestuar, e cila ishte uzurpuar jashtëligjshëm nga pala e tretë.

14. Më 18 shtator 2009, parashtruesi i kërkesës ka vepruar mbi kërkesën e znj. Ristiq dhe i është drejtuar Kryeshefit të stacionit policor në Shtime, duke kërkuar nga i njëjti informacione lidhur me statusin e banesës në fjalë.

15. Më 22 tetor 2009, parashtruesi i kërkesës kishte marrë përgjigje nga Kryeshefi i stacionit policor në Shtime, i cili kishte njoftuar se Kuvendi Komunal në Shtime, me vendim 01-Nr.06/837, të datës 16 prill 2009, njëzëri ka miratuar vendimin

për anulimin e vendimit Nr.01.nr.06/605/1 të Kuvendit Komunal të datës 7 tetor 1996, për ndarjen e banesave në "Objektin banesor-tregtar" në Shtime, ish-punëtoreve të administratës komunale për kohë të pacaktuar.

16. Sipas Kryeshefit të Policisë, pasi që Kuvendi Komunal kishte anuluar të drejtën e shfrytëzimit të banesës së kontestuar, e njëjta i është ndarë për banim mbajtësit të jashtëligjshëm. Znj. Ristiq, gjithashtu edhe bartësit tjerë të së drejtës në banesa të tilla, nuk kanë qenë të njoftuar lidhur me vendimin e lëshuar nga Kuvendi Komunal për anulimin e asaj të drejte.

17. Për më tepër, pasojat juridike të vendimit 01 nr. 06/837, të 16 prillit 2009, ishin zbatuar vetëm ndaj znj. Ristiq, pasi që banuesit tjerë të objektit në fjalë e mbajtën të drejtën e banimit.

18. Znj. Ristiq, pas marrjes së përgjigjes nga Kryeshefi i Policisë, i ka dorëzuar tërë dokumentacionin e nevojshëm parashtruesit të kërkesës, duke dëshmuar që është bartës i plotfuqishëm i të drejtës së banimit mbi banesën e kontestuar. Gjithashtu, e njëjta ka shtruar ankesë tek Zyra ndërlidhëse me gjykata në Ferizaj, të cilët së bashku me pjesëtaret stacionit policor në Shtime kanë dëbuar personin i cili jashtëligjshëm ka qëndruar në banesë.

19. Znj. Ristiq, më 26 shkurt 2010, i paraqiti kërkesë Zyrës së Kryeministrit, përkatësisht Zyrës për çështjen e komuniteteve, duke kërkuar *restitutio in integrum* (kthim të gjendjes së mëparshme) duke ia bashkëngjitur kopjen e vendimit nr.360/659, të datës 30 dhjetor, mbi të drejtën e shfrytëzimit të banesës së lartpërmendur. Lidhur me këtë kërkese e njëjta nuk ka marrë asnjë përgjigje.

20. Po të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës i shkroi Kryetarit të Komunës së Shtimes, duke kërkuar që i njëjti të paraqes arsyetimin e tij lidhur me bazën ligjore të vendimit Npi. 01/132, të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Shtimes më 30 prill 2009,

me anë të të cilit i është anuluar e drejta e znj. Ristiq dhe banorëve të tjerë në shfrytëzimin e banesave përkatëse në Komunën e Shtimes.

21. Më 16 mars 2010, parashtruesi i kërkesës ka marrë përgjigje zyrtare nga Kryetari i Komunës, në të cilën thuhet se baza ligjore për vendimin e lëshuar nga Kuvendi Komunal, mbi anulimin e të drejtës së banimit znj. Ristiq, ishte Kontrata me koncesion e lidhur midis Kuvendit Komunal dhe ndërmarrjes ndërtimore GP- "Gradevinar" (Ndërtimtari), nga Kraleva, Republika e Serbisë. Sipas Kryetarit, Kuvendi Komunal ka vepruar në pajtim me nenin 5 (b) dhe nenin 12 (2) (d) të Ligjit nr.30/L-040 për Qeverisjen Lokale.

Pretendimet e parashtruesit lidhur me rastin e znj. Ristiq

22. Parashtruesi i kërkesës pohon se me Vendimin nr.01/132, të Kuvendit Komunal të Shtimes, znj. Ristiq i është mohuar e drejta e shfrytëzimit të banesës në fjalë, duke kryer kështu shkelje të nenit 36 të Kushtetutës.

23. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 36 i Kushtetutës në lidhje me nenin 8 [e Drejta për jetë familjare] dhe 14 [Parandalimi i Diskriminimit] KEDNJ.

24. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pohon se, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), banesa e kontestuar në këtë rast mund të konsiderohet si "shtëpi", dhe ky interpretim vije nga neni 8 i KEDNJ (*shih Gilloë kundër Mbretërisë së Bashkuar, Aktgjykimi i datës 24 nëntor 1986*). Gjithashtu në rastin Larkos kundër Qipros, Aktgjykimi nr.2951/95, GJEDNJ 1999-I, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut i është referuar konkretisht nenit 14 në lidhje me nenin 8, ku thuhet se e drejta e banuesit që të banojë në një vend të caktuar përmban të drejtën në shtëpi dhe jo të drejtën në pronësi.

25. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 14 në lidhje me nenin 8 të KEDNJ, sepse nuk është vepruar drejt nga Kuvendi Komunal i Shtimes pasi që i njëjti kishte marrë vendim për anulimin e të drejtës së banimit znj. Ristiq, përderisa banuesit tjerë e gëzojnë ende të drejtën e shfrytëzimit të banesës. Banesa të cilën e ka pas në shfrytëzim znj Ristiq, i është dhënë mbajtësit të jashtëligjshëm. Në lidhje me këtë fakt, parashtruesi i kërkesës thirret në vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, konkretisht në rastin Larkos kundër Qipros, Aktgjykimi nr. 2951/95, GJEDNJ 1999-I, ku Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut dhe GJEDNJ kanë qenë të mendimit se kishte ardhur deri te shkelja e nenit 14 të KEDNJ në lidhje me nenin 8 të KEDNJ. Kështu që, parashtruesi i kërkesës konsideron që nuk ka ekzistuar arsyetim i racional dhe objektiv që znj. Ristiq t'i mohohet e drejta që gëzojnë banuesit e tjerë.

26. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 2.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 mbi kërkesat Pronësore Banesore, të 31 tetorit 2000, në të cilën thuhet: "*Çdo e drejtë në pronë që është fituar në pajtim me ligjin në fuqi në kohën e fitimit të saj, mbetet e vlefshme përkundër ndryshimeve të legjislacionit në fuqi në Kosovë, përveç rasteve kur kjo rregullore parasheh ndryshe".* Gjithashtu neni 6(b) i rregullores në fjalë citon:

"…….

(b) Pavarësisht nga dispozitat e çfarëdo ligji tjetër, asnjë e drejtë banimi në banesë shoqërore nuk mund të përfundojë:

(i) Pa pëlqimin e bartësit të së drejtës për banim ose të Drejtorisë për çështje banesore dhe pronësore; ose

(ii) Pa urdhëresën e Komisionit, siç parashtrohet me anë të kësaj Rregulloreje dhe…mungon teksti në vazhdim.

…"

27. Prandaj, parashtruesi i kërkesës thirret në ligjin në fuqi për Çështjet banesore përmes Rregullores se UNMIK-ut 2000/60, të datës 31 tetor 2000, për kërkesat pronësore banesore, Rregullores së punës, provave të Drejtorisë për Çështje Pronësore Nanesore, si dhe Komisionit për Marrëdhënie Pronësoro Banesore, duke deklaruar se, në rastin konkret, vendimet e Kuvendit Komunal nuk janë bazuar në ligjin në fuqi, sipas të cilit çdo subjekt juridik dhe politik ka për obligim që ta respektoj sundimin e ligjit dhe qeverisjes së mirë në Kosovë.

28. Parashtruesi i kërkesës përfundon se Kuvendi Komunal i Shtimes, me marrjen e Vendimit 01 nr. 06/837, të datës 16 prill 2009, dhe vendimit Npi-01/132, të datës 30 prill 2009, nuk ka respektuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet ne fuqi, si dhe Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës mendon se veprimet e Komunës së Shtimes, me anulimin e të drejtës së znj. Ristiq mbi shfrytëzimin e banesës dhe dhënien e saj në shfrytëzim mbajtësit të jashtëligjshëm, konsiderohet si cenim i parimeve të qeverisjes së mire.

Vlerësimi për pranueshmëri

29. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit se i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 36 [E Drejta në Privatësi] të Kushtetutës si dhe nenin 8.1 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] dhe nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] të KEDNJ, Gjykata vëren se, në mënyrë që kërkesa të jetë e pranueshme, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë se a i ka përmbushur parashtruesi i kërkesës të

gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregulloren e punës.

30. Gjykata vëren se në pajtim me nenin 135.4 të Kushtetutës, "Avokati i Popullit mund t'i referojë çështje Gjykatës Kushtetuese në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute". Neni 113.2, për më tepër, specifikon kur Avokati i Popullit është i autorizuar që të parashtroi kërkesë pranë Gjykatës.

31. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në lidhje me rastin e znj. Ristiq kundër vendimeve 01 nr.06/837, të 16 prillit 2009, dhe Npi-01/132, të 30 prillit 2009, të marra nga Kuvendi Komunal i Shtimes sipas nenit 113.2.2 të Kushtetutës i cili parasheh:

"Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim: përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën".

32. Në këtë aspekt, Gjykata konkludon se vendimet e lartpërmendura të Kuvendit Komunal nuk paraqesin "Statutin Komunal" në kuptimin e nenit 113.2.2 të Kushtetutës, të cilët janë akte normative që rregullojnë kompetencat dhe organizimin e komunës si dhe marrëdhëniet mes komunës dhe qytetarëve në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe Ligjin, përderisa vendimet e marra nga Kuvendi Komunal në rastin e parashtruesit të kërkesës, përkundër statuteve, janë vendime të marra në një rast të veçantë të individit apo personit juridik.

33. Për më tepër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, me qëllim të sjelljes së një ankese kushtetuese në mënyrë që të ndiqen/paraqiten interesat individuale para kësaj Gjykate, nuk është palë e autorizuar sipas Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës si institucioni pavarur (Avokati i Popullit), në pajtueshmëri me nenin 133 [Zyra e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës, është vetëm pala e autorizuar ajo që paraqet

kërkesa për kontrollin abstrakt të kësaj Gjykate, në pajtueshmëri me nenin 113.2.2 të Kushtetutës.

34. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës me të cilën kontestohen vendimet e Kuvendit Komunal të Shtimes nuk mund të gjykohet, pasi që çështja nuk ishte referuar në Gjykatë në mënyrë të ligjshme nga një palë e autorizuar, në pajtueshmëri me nenin 113.1 të Kushtetutës.

35. Sidoqoftë, një individ mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në pajtueshmëri me nenin 113.7. i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

....

Kështu që, nuk duket të ketë ndonjë arsye pse znj. Ristiq nuk ka mundur të paraqes kërkesën në këtë Gjykatë për rastin e vet.

36. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit është e papranueshme sipas nenit 113.2 (2) dhe 113.7 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtueshmëri me nenin 20 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 56(2) të Rregullores së punës, më 13 maj 2011, me votën e shumicës

VENDOS

I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtueshmëri me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 112/10 datë 17 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të dekreteve të Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, të datës 22 tetor 2010

Rasti KI 112/10, Vendimi për papranueshmëri i datës 9 qershor 2011

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, ndalimi i torturës, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi, Z. Nikollë Kabashi, ka parashtruar Kërkesë në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke kontestuar Vendimin e Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 135/2010, të datës 21 janar, si të marrë me shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 3 [Ndalimi i torturës] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, të plotësuar me Protokollet nr. 11 dhe 14, për shkak të përzgjedhja e gjyqtarëve që ishin emëruar në Gjykatën Komunale në Gjakovë, nuk ishte bërë në pajtim me rregullat e përcaktuara nga KPGJP-ja (Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial).

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së Kërkesës, Gjykata gjeti që Kërkesa ishte e papranueshme, pasi që Parashtruesi nuk ka arritur të ofrojë prova që procedurat përkatëse kishin qenë në çfarëdo mënyre të padrejta apo të njollosura me arbitraritet. Kështu, Gjykata vërejti që Kërkesa ishte qartazi e pabazuar, në bazë të Rregullit 36 (1.c) të Rregullores së Punës.

Prishtinë, më 04.prill 2012

Nr. ref.: RK 217/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 112/10

Parashtruesi

Nikollë Kabashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë të dekreteve të Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, të datës 22 tetor 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Nikollë Kabashi, me vendbanim në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston dekretet e Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, të 25 tetorit 2010, bërë me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për emërimin dhe nominimin e gjyqtarëve të Komunës së Gjakovës.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë të dekreteve të Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Kosovës, të bëra me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që, siç pretendohet, kanë shkelur nenin 3 [Ndalimi i torturës] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të ndryshuar dhe plotësuar me protokollet Nr. 11 dhe 14 (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të vendos masë të përkohshme me të cilën pezullohet ekzekutimi i dekreteve.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009 (Nr. 03/L-121) (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 8 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Me Urdhrin e Kryetarit Nr.GJR. 112/10, të datës 16 nëntor 2010, gjyqtari Ivan Čukalović u emërua Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditë, Kryetari me Urdhrin Nr.KSH. 112/10, emëroi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Almiro Rodrigues.

8. Më 20 janar 2011, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është njoftuar për kërkesën. Po të njëjtën ditë, për kërkesën është njoftuar edhe Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Kosovës.

9. Më 16 maj 2011, Këshilli Gjyqësor i Kosovës u përgjigj se parashtruesi i kërkesës nuk ishte rekomanduar nga ana e Këshillit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial që të emërohej në pozitën e gjyqtarit në Komunën e Gjakovës, ngase parashtruesi i kërkesës kishte më pak pikë se kandidatët e tjerë të

rekomanduar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial.

10. Më 9 qershor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në vitin 2009, Këshilli i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (në tekstin e mëtejmë: KPGJP) shpalli konkursin për përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës.

12. Më 1 prill 2009, parashtruesi i kërkesës aplikoi në KPGJP për pozitën e gjyqtarit.

13. Në vitin 2010, KPGJP e njoftoi parashtruesin e kërkesës se ai nuk ishte rekomanduar për asnjë nga pozitat për të cilat kishte aplikuar në fazën e tretë të përzgjedhjes, ngase kandidatët e tjerë kishin qenë më të suksesshëm (AJP 87907).

14. Më 3 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën në Kolegjin shqyrtues të KPGJP-së për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 6.1 të Urdhëresës Administrative Nr. 2008/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/25 për Kornizën Rregullative të Sistemit të Drejtësisë në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: UA Nr. 2008/2).

15. Më 28 janar 2011, Kolegji shqyrtues i KPGJP nxori vendimin për refuzimin e kërkesës së parashtruesit si të pabazë. Për më tepër, Kolegji shqyrtues i KPGJP-së konstatoi se parashtruesi i kërkesës ka arritur më pak pikë se sa kandidatët e tjerë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pohon se përzgjedhja e gjyqtarëve të emëruar në Gjykatën Komunale të Gjakovës nuk është bërë në bazë të rregullave të parapara nga KPGJP-ja. Këto rregulla, sipas të cilave kandidatët nuk përzgjidhen për t'u emëruar si gjyqtarë, janë si vijon:

"...

a. Kandidatët të cilët nuk kanë marrë pjesë në konkurs;
b. Kandidatët që kanë punuar në sistemin gjyqësor të regjimit të Millosheviqit gjatë viteve 1990-1999;
c. Kandidatët me dosje të dyshimta;
d. Kandidatët që janë në prag të pensionimit;
e. Anashkalimi i kandidatëve që janë anëtarë të familjeve të dëshmorëve duke mos i përzgjedhur ata; dhe
f. Diskriminimi i kandidatëve, etj.

..."

17. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pohon se i kishte kaluar të tri fazat e përzgjedhjes.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës ankohet se dekretet e Ushtruesit të detyrës së Presidentit të Kosovës, të 25 tetorit 2010, të bëra me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, shkelin nenin 3 të KEDNJ.

19. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, është e nevojshme që Gjykata së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, si dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

20. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërimet në pozita gjyqësore pasi që kandidatët të kenë plotësuar kriteret e përzgjedhjes të parapara me ligj në pajtim me nenin 108 të Kushtetutës.

21. Presidenti i Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 104.1 dhe 86 (16), i emëron gjyqtarët me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

22. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka argumentuar në asnjë mënyrë ankesat e bëra sipas nenit 3 të KEDNJ-së, ose në lidhje me të drejtat dhe liritë e tija të garantuara me Kushtetutë, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).

23. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar sipas rregullit 36 (1.c) të Rregullores së punës i cili thotë: "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar".

Vlerësimi i kërkesës për masa të përkohshme

24. Parashtruesi i kërkesës kërkon pezullimin e dekreteve sepse ato "janë tërësisht të paligjshme dhe jokushtetuese, dhe njëkohësisht paraqesin shkelje të rëndë të ligjit", pasi që lejuan emërimin e:

"...

a. Kandidatëve të korruptuar;
b. Kandidatëve të dyshimtë për vepra penale;
c. Kandidatëve jokompetent dhe njerëzve të papërvojë; dhe

d. Kandidatëve që kanë bashkëpunuar me regjimin e Millosheviqit.

..."

25. Si rezultat:

"...

a. Nuk është emëruar asnjë kandidatë nga familjet e dëshmorëve;
b. Dekretet kanë qenë denigrim dhe fyerje e rëndë e familjeve të dëshmorëve;
c. Dekretet ishin fyerje ndaj përpjekjeve dhe rezultateve të luftës së popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi;
d. Dekretet, po ashtu, kualifikuan familjet e dëshmorëve si të "padëshirueshme"; dhe
e. Nuk pati respekt për procedurat e autoriteteve tjera vendore dhe ndërkombëtare.

..."

26. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 27.1 të Ligjit:

"Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të paripareshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".

Dhe në veçanti rregullit 54(1) të Rregullores së punës, i cili parasheh se, në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë

vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se kërkesa u konstatua si e papranueshme, parashtruesi i kërkesës sipas rregullit 54(1) të Rregullores së punës nuk ka të drejtë të kërkojë masa të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 9 qershor 2011, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masa të përkohshme;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KI 86/11 datë 17 prill 2012- Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës rev.nr 20/09 të datës 1.3.2011.

Rastin KI 86/11, Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 1 marsit 2011

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, shkallë e katërt, Aktvendim për papranueshmëri.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimet e Gjykatës Komunale në Suharekë, asaj të Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe atë me nenin 21 al. 1,2,3 e 4 ,nenin 31 al 1 e 2 dhe në mënyrë të veçantë me nenin 46(mbrojtja e pronës).

Gjykata kushtetuese dhe me këtë rast thekson se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe e të plotë është juridiksion i plotë i Gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm qe ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veproje si "gjykate e shkallës se katërt".

Gjykata Kushtetuese konsideron se nuk ka asgjë ne kërkesë qe tregon se Gjykatave të rregullta gjate shqyrtimit te rastit, ju mungonte paanshmëria ose qe procedura ishte e padrejte.

Gjykata konstaton që kërkesa është e papranueshme.

Prishtinë, më 05 prill 2012

Nr. ref.: RK218/12

ATKVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 86/11

Parashtruesi

Milaim Berisha

Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë të:

Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës rev.nr 20/09 të datës 1.3.2011.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z.Milaim Berisha nga Suhareka me banim në Suharekë rr.:Mulla Nura" p.n,të cilin e përfaqëson me autorizim avokati z.Avdullah Robaj nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i final i cili kontestohet nga parashtruesi i kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës rev.nr 20/09 i datës 1.3.2011 ,të cilin pala e ka pranuar sipas pohimit personal me 11 mars 2011,parashtruesi i kërkesës në Gjykatën kushtetuese ka kërkuar gjithashtu vlerësimin Kushtetues të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Suharekë C. nr. 65/08 i datës 18.07.2008 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr379/08, i datës 01.12.2008

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës me date 28 qershor 2011 është vlerësimi i Kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Suharekë C. nr. 65/08 të datës 18.07.2008,të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr379/08,të datës 01.12.2008 dhe Aktgjykimit i Gjykatës Supreme të

Kosovës rev.nr 20/09 i datës 1.3.2011,me të cilat sipas parashtruesit të kërkesës i janë cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë,dhe në mënyrë të paligjshme i është marrë prona duke iu dhënë tjetërkujt dhe nga gjykata Kushtetuese ka kërkuar anulimin e vendimeve të lartcekura

Baza juridike

4. Neni 113.7 Kushtetutës së Republikës së Kosovës(në te tekstin e mëtejmë Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i dt. 16 Dhjetor 2009 i hyrë në fuqi me 15 janar 2010(në tekstin e mëtejmë referuar si Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë i referuar si rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 28 qershor 2011 Gjykata Kushtuese pranoj kërkesën e z.Milaim Berisha nga Suhareka të paraqitur nga përfaqësuesi i tij ,avokati z.Avdullah Robaj nga Prishtina, dhe në sekretariatin e Gjykatës kjo kërkesë u regjistrua me nr KI 86/11

6 Më 17 gusht 2011 me vendimin GJ.R 86/11 Kryetari i Gjykatës caktoj Gjyqtar raportues gjyqtarin Kadri Kryeziu dhe të njëjtën ditë Kryetari i Gjykatës me vendimin KSH, KI 86/11, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje Alltay Suroy (kryesues) dhe gjyqtarët Snezhana Botushorova e Ivan Cukalovic, në cilësi të anëtarëve të kolegjit

7. Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar Gjykatën Supreme të Kosovës, Gjykatën e Qarkut në Prizren Gjykatën Komunale në Prizren i dhe përfaqësuesin e parashtruesit te kërkesës ,avokatin z.Avdullah Robaj për regjistrimin e lëndës me 5 Gusht 2011 .

8. Më 11 Gusht 2011 Gjykata Kushtetuese ka pranuar përgjigjeje nga Gjykata e Qarkut në Prizren e cila kishte dërguar kopjet e tri Aktgjykimeve të cilat kontestohen nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën .Kushtetuese

9. Me 12 shtator 2011 Gjykata Kushtetuese ka pranuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren nëpërmes faksit dokumentin shtesë –vendimin e Komunës së Suharekës nr 360-483/91 të dt. 23.01.1992 i cili ishte pjesë e dosjes së lëndës në këtë Gjykatë.

10. Me 25 nëntor 2011, pas shqyrtimit te raportit te Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës ne përbërje te plote për papranueshmëri te kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës z. Milaim Berisha ka qenë në marrëdhënie pune në IGK ’Ballkan”me seli pune në Suharekë nga viti 1972 e deri më 14.09.1990 dhe kryente detyrat e punës së Kryepunëtorit kontrollues.

12. Më 13. tetor 1998 IGK "Ballkan" ka shpallur konkurs për ndarjen e 76 banesave të në lagjen" Ballkani" në Suharekë,të ndërtuara me kontributin e punëtorëve të vet .

13. Më 01. gusht 1989 sipas vendimit nr 5842 të IGK " Ballkan" z. Milaim Berisha e fiton të drejtën e shfrytëzimit të banesës në sipërfaqe prej 73.95 m² ,duke qenë i ranguar në vendin e nëntë(9) në listën e punëtorëve që u kanë takuar banesat e ndara nga punëdhënësi i tyre.

14. Nga shkresat e lëndës të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese nuk mund të konstatohet fakti nëse z. Milaim Berisha të ketë lidhur kontratë për shfrytëzimin e banesës,ndërsa sipas pohimit tij personal këtë banesën e ka shfrytëzuar i pa penguar deri më datën 29.01.1992..

15. Më 27.09.1990 organi i dhunshëm(masat e përkohshme të asaj kohe) punëdhënës me vendimin nr 6112/9 z. Milaim Berisha i kishte ndërprerë marrëdhënien e punës për shkak se, sipas vendimit kishte bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës .Nga shkresat e lëndës nuk rezulton se z. Berisha ka bërë ankesë ndaj këtij vendimi

16. Më 23 .01.1992 Sekretariati për Urbanizëm dhe çështje banesore e Komunale i Komunës së Suharekës e ka nxjerrë Aktvendimin nr 360-483/91 me anë të cilit i urdhërohet z. Milaim Berisha që në afat prej 10 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi ta lirojë banesën në të cilën jeton nga të gjithë personat dhe orenditë brenda saj.

17. Në arsyetimin e këtij aktvendimi thuhet se ai është marrë në bazë të kërkesës së IGK"Ballkan" dhe duke marrë për bazë faktin se Gjykata e Punës së Bashkuar në Gjakovë me vendimin nr 203 të dt. 12.10.1989 kishe anuluar vendimet e Këshillit të

Punëtorëve nr. 5836 të datës 3.07.1989 dhe të Komisionit për ndarjen e banesave të IGK"Ballkan"të datës 10.07.1989.

18. Në vitin 1993 banesën nga e cila ishte urdhëruar të largohet z. Milaim Berisha e kishte privatizuar z. Jovanovic Zoran nga Suhareka dhe sipas kontratës për shitblerje të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Suharekë ov.br.1976/93 ai e kishte fituar edhe të drejtën e pronësisë mbi te.

19. Më 16.11.2006 sipas përfaqësuesit të z. Milaim Berisha avokatit Avdullah Robaj Drejtorati për Çështje Banesore i UNMIKU-ut i njohur si UN –HABITATI me vendimin HPCC/78/2006 ia kishte njohur të drejtën e pronësisë për banesën kontestuese z. Milaim Berisha por në të vërtetë këtë vendim ai në Gjykatën Kushtetuese nuk e kishte prezantuar si provë dhe nuk gjendet fare në shkresat e lëndës të prezantuara së bashku me kërkesën.

20. Më 28 07 .2007. z Zoran Jovanovic ,kishte autorizuar me shkrim z. Agim Demiri Jurist i dipl. Nga Suhareka që në emër të tij në cilësinë e pronarit të banesës të lidhë kontratë shitblerje me znj Valbonë Baralija nga fshati Bukosh ,KK-Suharekë në cilësinë e blerësit të banesës e cila ndodhej ne Suharekë në Lagjen Fidanishte ,banesa nr 8,ndërtesa 3 ,kati i dytë me sipërfaqe prej 73.95 m^2.

21. Më 30.08.2007 ,kjo kontratë e lidhur dhe e nënshkruar në mes palëve kontraktuese z. Agim Demiri si përfaqësues i z, Zoran Jovanovic dhe znj. Valbonë Baraliu, është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Suharekë dhe në Drejtorinë për Ekonomi e Financa të Komunës së Suharekës është paguar ngarkesa financiare për kompensimin lidhur me transferimin e pasurinë së patundshme në vlerën prej 200.00€.

22. Më 8 tetor 2007 Drejtorati për Çështje banesore i UNMIK-ut në Prishtinë i kishte dërguar një shkresë Kryetarit të Gjykatës Komunale në Suharekë dhe Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prizren që në këtë drejtorat gjendet në procedurë ankesa e z. Milaim Berisha lidhur me një kontest banesor e cila si palë kundërshtare ka z, Zoran Jovanovic dhe se këtyre dy gjykatave u ndalohet vërtetimi i çfarëdo kontrate lidhur me këtë patundshmëri përpos nëse palët në kontest z,Milaim Berisha e z. Zoran Jovanovic do të arrinin pajtueshmëri në mes tyre lidhur me atë kontratë.

23. Kjo kërkesë nga kjo drejtori ishte dërguar Gjykatave me 8 tetor 2007 por në fakt një kontratë shitblerje në mes të z. Zoran Jovanovic i përfaqësuar nga z. Agim Demiri në cilësi të shitësit dhe zonjës Valbonë Baraliu në cilësinë e blerësit të banesës kontestuese tashmë ishte lidhur dhe vërtetuar në Gjykatën Komunale në Suharekë me 30 gusht 2007 dhe sipas shkresave të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese kjo kontratë asnjëherë nuk është anuluar.

24. Më 18.07.2008 duke vepruar sipas kërkesëpadisë së z. Valbonë Baraliu ,Gjykata Komunale në Suharekë ka nxjerrë Aktgjykimin C.nr.65/2008 me anë të së cilës APROVON kërkesëpadinë e z, Baraliu dhe DETYRON z, Milaim Berisha që në afat prej 15 ditësh t`ia dorëzojë pronën e paluajtshme-banesën që gjendet në lagjen Fidanishte në Suharekë znj Valbonë Baraliu e cila është pronare e kësaj banese sipas kontratës për shitblerje të vërtetuar n Gjykatën Komunale në Suharekë me nr.VR.nr 2871/07 të datës 30.08.2007.

25. Më 01.12.2008 Gjykata e Qarkut në Prizren ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të autorizuarit të z. Milaim Berisha dhe kishte lënë në fuqi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.65/08 .

26. Më 1.3.2011 Gjykata Supreme e Kosovës ka **Refuzuar** si të pabazuar Revizionin e të Padituri të paraqitur kundër

Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac.nr.379/2008 të datës 1.12.2008 dhe përfundimisht pronare të ligjshme të palujteshmërisë-banesës kontestuese e kishte caktuar znj. Valbonë Baraliu.

27. Përfundimisht duke qenë i pakënaqur me Aktgjykimeve Gjykatave kompetente z. Milaim Berisha ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me 28.06.2001 duke kërkuar shfuqizimin e të gjitha Aktgjykimeve dhe deklarimin e tyre si jo Kushtetuese e të paligjshme.

Pretendimet e parashtruesit

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimet e cekura më lartë të Gjykatës Komunale në Suharekë,asaj të Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme të Kosovës ,asaj i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe atë me nenin 21 al.1,2,3 e 4 ,:nenin 31 al 1 e 2 dhe në mënyrë të veçantë me nenin 46(mbrojtja e pronës.)

29. Parashtruesi i ankesës ka pohuar se Gjykata Komunale në Suharekë duke vërtetuar kontratën për shitblerje në mes të palëve kontraktuese z.Jovanovic Zoran në cilësinë e shitësit dhe znj.Valbonë Baraliu në cilësinë e blerësit me datë 30.8.2007 në fakt ka bërë një punë juridike të paligjshme sepse ka legjitimuar si pronar të banesës e cila ishte objekt i kësaj kontrate z. Jovanovic edhe pse në fakt pronar i vërtetë është z. Milaim Berisha i cili kishte të drejtën e shfrytëzimit të kësaj banese që nga viti 1989. Ndërsa Gjykata Komunale në Suharekë duke aprovuar si të bazuar padinë e paditëses Valbonë Baraliu me të cilën obligohet z.Berisha si i paditur, t`ia dorëzojë banesën në pronësi dhe Gjykata e qarkut e Gjykata Supreme

duke refuzuar ankesën gjegjësisht revizion e z, Berisha vetëm se e kanë përsëritur vendimin e gabuar të Gjykatës Komunale duke e privuar atë nga gëzimi i të drejtës së pronës në banesën kontestuese.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Për te qene ne gjendje për te gjykuar mbi Kërkesën e Parashtruesit te kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht te vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë te cilat përcaktohen ne Kushtetutë,Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese

31. Ne lidhje me ketë, Gjykata i referohet nenit 113.7 te Kushtetutës qe përcakton se:

*"Individët janë te autorizuar te ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike te drejtave dhe lirive te tyre individuale**, **te garantuara me Kushtetute**, mirëpo **vetëm** pasi te **kenë shteruar te gjitha mjetet juridike** te përcaktuara me ligj."*

32. Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartas e bazuar:

33 Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e verifikimit t fakteve, Gjykata kushtetuese dhe me këtë rast thekson se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe e të plotë është juridiksion i plotë i Gjykatave të rregullta dhe se roli i sajë është vetëm qe ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veproje si "gjykate e shkalës se katërt", (shih, *mutatis mutandis,* i.a., Akdivar kundër Turqise, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

34. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën shihet se parashtruesi i sajë ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe në fakt asnjëra nga Gjykatat e rregullta nuk i ka dhënë të drejtë në pretendimet e tij ,andaj Gjykata Kushtetuese konsideron se nuk ka asgjë ne kërkesë qe tregon se Gjykatave të rregullta gjate ekzaminimit te rastit, ju mungonte paanshmëria ose qe procedura ishte e padrejte.

35. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pohimin e tij duke sqaruar si dhe pse është bërë shkelja, apo nuk ka ofruar prova për të dëshmuar se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me Kushtetutë.

36. Përveç kësaj, kërkesa nuk tregon që Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të zëvendësojë vlerësimin e fakteve të veta me atë të gjykatave të rregullta, dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që të vlerësojnë provat para tyre. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë mënyrën se si është marrë prova.(shihi Edwards kundër Mbretërisë së bashkuar, Aktgjykimi GJEDNJ App. br 13071/87 par 34, dt. 10. korrik 1991.).

37. Fakti i thjeshte se parashtruesit janë te pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund tu shërbejë atyre si e drejtë te ngrenë një kërkesë te argumentueshme për shkelje te Nenit 31 te Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. *5503/02,* Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kunder Hungarise, Aktgjykim i 26 korrikut 2005

38. Në këto rrethana parashtruesi ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij dhe as shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës(e drejta e pronës)sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë se Gjykatat e rregullta të tri shkallëve ti kenë mohuar të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë ,andaj nuk konsiderohet që parashtruesi ka përmbushur kërkesat e sipërpërmendura për marrjen e vendimit për pranueshmëri, dhe kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës ,nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores më 25 nëntor 2011 njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Kadri Kryeziu	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 103/10 datë 19 prill 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 406/2008, të 3 shtatorit 2010

Rasti KI 103/10, Aktgjykimi i 20 marsit 2012
Fjalët kyçe: barazia para ligjit, kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi i kërkesës, z. Shaban Mushtafa, parashtroi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke pretenduar se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 406/2008, u mor në kundërshtim me të drejtat e tij të garantuara me nenin [Barazia para Ligjit], 24.1 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe nenin 6 te KEDNJ-së. Parashtruesi ankohet, në veçanti, se Gjykata Supreme nuk e ka njoftuar dhe as ftuar që të merr pjesë në procedurë dhe as prokurori publik. Prokurori i Shtetit u përgjigj se ata e përkrahën Aktgjykimin e Gjykatës Supreme se të drejtat e parashtruesit, siç janë garantuar me Kushtetutë, nuk janë shkelur.

Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata vendosi që, bazuar në gjuhën e thjeshtë të nenit 113.7, kjo kërkesë ishte e pranueshme sepse në kërkesën e tanishme z. Shaban Mustafa, pronari i kompanisë "Beni Dona" e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit Rev. nr. 406/2008 të Gjykatës Supreme, të 3 shtatorit 2010, drejtuar kompanisë. Prandaj, parashtruesi i kërkesës duhet të konsiderohet palë e autorizuar, me të drejtën e adresimit të kësaj çështjeje në Gjykatë dhe se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, siç parashikohet me ligj, sipas nenit 21.4 adhe nenit 113.7 të Kushtetutës. Sa i përket kërkesës së nenit 49 të Ligjit se parashtruesi është dashur ta dorëzojë kërkesën brenda një periudhe prej katër (4) muajsh Gjykata përcaktoi se nga parashtresat e parashtruesit, parashtruesit i ishte dorëzuar vendimi i lartpërmendur i Gjykatës Supreme më 6 tetor

2010, përderisa parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 12 tetor 2010, dmth. brenda afatit katër mujor, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit. Pastaj, parashtruesi i përcaktoi saktë cilat të drejta sipas Kushtetutës dhe KEDNJ pretendohen të jenë shkelur dhe nga cili autoritet publik. Prandaj, Gjykata gjithashtu gjen se parashtruesi e ka plotësuar kushtin e nenit 48 të Ligjit.

Për meritat e kërkesës, Gjykata vendosi se, pasi që parashtruesi nuk kishte mundur të ushtrojë të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pa qenë prezent në procedurën e Gjykatës Supreme. Prandaj, me mos-njoftimin e parashtruesit në lidhje me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të parashtruar nga prokurori publik dhe duke mos e ftuar si palë në Gjykatën Supreme, Gjykata Supreme në aktgjykimin e 3 shtatorit 2010, e kishte shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (1) të KEDNJ-së. Në arritjen e vendimit të saj, Gjykata gjithashtu u mbështet në vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që adresojnë çështjen e njëjtë ose të ngjashme. Gjykata e shpalli të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe e ktheu aktgjykimin në Gjykatën Supreme për rivendosje, në pajtim me aktgjykimin e kësaj gjykate.

Prishtinë, më 20 mars 2012

Nr. ref.: AGJ.193 /12

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KI 103/10

Parashtrues

Shaban Mustafa

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 406/2008, të 3 shtatorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shaban Mustafa, pronar i Ndërmarrjes "Beni Dona", i përfaqësuar nga z. Hasan Përvetica, avokat nga Podujeva.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 406/2008, të 3 shtatorit 2010, i cili i ishte dorëzuar më 6 tetor 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 12 tetor 2010, me të cilën kërkonte që Gjykata ta vlerësonte kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 406/2008.

4. Parashtruesi pohon që vendimi i kontestuar ia kishte shkelur të drejtat e garantuara me nenet 3.2 [Barazia para Ligjit], 24.1 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

5. Parashtruesi posaçërisht pohon që Gjykata Supreme nxori një aktgjykim pa e njoftuar dhe pa e thirrur parashtruesin që të merrte pjesë në procedurë në të njëjtën mënyrë si e kishte thirrur prokurorin publik.

Baza juridike

6. Kërkesa është e bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 12 tetor 2010.

8. Më 16 dhjetor 2010, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 103/10, e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 103/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Kadri Kryeziu.

9. Më 19 janar 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën Supreme për këtë kërkesë.

10. Më 22 shtator 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit në Prishtinë për këtë kërkesë dhe kërkoi komentet e saj në lidhje me këtë kërkesë.

11. Më 24 janar 2012, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit u përgjigj se ata e mbështetën Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 406/2008, të 3 shtatorit 2010, dhe se të drejtat e parashtruesit të garantuara me Kushtetutë nuk ishin shkelur.

12. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues më 7 mars 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për pranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

13. Më 16 shtator 1996, Ndërmarrja "Beni Dona", pronë e parashtruesit, lidhi kontratë me Komunën e Podujevës për ta marrë me qira objektin e ish-hotelit "Llap" në Podujevë për një periudhë 10-vjeçare, me kusht që Ndërmarrja "Beni Dona" ta rehabilitonte atë në shpenzime të veta në shumë prej 342.760,00 markave gjermane. Pas skadimit të kontratës së qirasë, komuna e Podujevës do të vendoste për vazhdimin ose ndërprerjen e kontratës së qirasë, pra nëse komuna do të vendoste ta ndërpriste kontratën e qirasë, ajo do t'ia kthente Ndërmarrjes "Beni Dona" shumën e shpenzuar për rehabilitimin e hotelit.

14. Prej vitit 2002 deri në vitin 2005, sipas kërkesës së Komunës së Podujevës, përveç shpenzimeve për rehabilitim, Ndërmarrja "Beni Dona" e pagoi edhe tatimin në pronë për pronën e marrë me qira. Pasi këto pagesa ishin shumë të larta dhe nuk ishin paraparë me kontratë të qirasë, Ndërmarrja "Beni Dona" nuk ishte në gjendje t'i paguante dhe kërkoi nga Komuna e Podujevës të sqaronte cilat ishin obligimet e Ndërmarrjes "Beni Dona" dhe ta zgjidhte situatën qoftë duke e vazhduar kontratën e qirasë, duke zbritur në këtë mënyrë nga shuma që ndërmarrja duhet të paguante shumën prej 550 euro si qira për secilin muaj deri në barazimin e shumës së përgjithshme të shpenzimeve të rehabilitimit, ose duke ia kthyer komunës objektin e marrë me qira, e cila më pas do t'ia paguante ndërmarrjes shumën e investuar në rindërtimin e hotelit, siç përcaktohej me kontratën e 16 shtatorit 1996, që e kthyer në euro do të ishte 171.380,00 euro.

15. Pasi Komuna e Podujevës nuk iu përgjigj kërkesës së Ndërmarrjes "Beni Dona", parashtruesi ngriti padi kundër komunës në Gjykatën Komunale në Podujevë më 6 qershor 2007, duke kërkuar që gjykata të vendoste që ose komuna t'ia kthente investimin në shumë prej 171.380,00 eurove ose që ndërmarrja të vazhdonte ta shfrytëzonte objektin e marrë me qira për dhjetë vjet, duke zbritur nga shuma e investuar një qira prej 550 eurove në muaj, derisa të barazohej shuma.

16. Më 9 nëntor 2007, Gjykata Komunale në Podujevë, me Aktgjykim C. nr. 155/2007, e miratoi padinë e parashtruesit dhe i urdhëroi komunës së Podujevës ose t'ia kthente ndërmarrjes fondet e investuara ose ta vazhdonte kontratën e qirasë edhe për dhjetë vjet.

17. Komuna ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 9 nëntor 2007.

18. Më 28 maj 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 28/2008, e refuzoi si të pabazuar ankesën e komunës, duke pohuar që dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës Komunale ishte i kuptueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim dhe që, në arsyetimin e vet, gjykata kishte ofruar arsye të plota dhe të kuptueshme për të gjitha faktet e rëndësisë vendimtare dhe prandaj, arsyetimi i ofruar ishte plotësisht në përputhje me përmbajtjen e provave të administruara.

19. Brenda afatit ligjor, Komuna e Podujevës ushtroi revizion kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjykatën Supreme. Në të njëjtën kohë, Prokurori publik paraqiti kërkesë, në të njëjtën gjykatë, për mbrojte të ligjshmërisë, duke propozuar anulimin e aktgjykimeve të gjykatave të shkallëve më të ulëta për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale, dhe që rasti të rihapej në gjykatën e shkallës së parë.

20. Më 3 shtator 2010, në praninë e Prokurorit publik, Gjykata Supreme e miratoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga Prokurori publik, si dhe revizionin e paraqitur nga Komuna e Podujevës, duke konstatuar që komuna e tani ligjërisht nuk ishte përgjegjëse për kontratën e qirasë ndërmjet parashtruesit dhe ish-kuvendit komunal të Podujevës të nënshkruar në vitin 1996. Gjykata e bazoi arsyetimin e vet ligjor në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1 për Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1) dhe në Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45) në

kuptimin që këto rregullore të UNMIK-ut e ndryshuan statusin juridik të Komunës së Podujevës nga statusi i personit juridik në vitin 1996, kur kontrata për qira ishte nënshkruar, në një status të veçantë juridik. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konkludoi që ky ndryshim i statusit juridik të komunës i eliminoi obligimet ligjore që komuna mund të ketë pasur para miratimit të këtyre rregulloreve të UNMIK-ut. Prandaj, duke u bazuar në këtë gjendje dhe në provat e administruara, Gjykata Supreme gjeti që gjykatat e shkallëve më të ulëta gabimisht e kishin zbatuar të drejtën materiale kur kishin gjetur që padia e parashtruesit ishte e bazuar dhe kishin konkluduar që kontrata për qira e vitit 1996 ndërmjet parashtruesit dhe Komunës së Podujevës më nuk ishte ligjërisht detyruese për atë komunë.

21. Prandaj, Gjykata Supreme e miratoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga Prokurori publik, dhe revizionin e paraqitur nga Komuna e Podujevës, duke i ndryshuar me këtë rast të dy aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta dhe duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit.

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi pohon që arsyetimi i Gjykatës Supreme është i gabuar për shkak se konkludoi që ndërmarrja kishte lidhur kontratë me ish-Komunën e Podujevës në vitin 1996, e cila nuk e ka kontinuitetin – suksesionin e saj në vazhdimësi para dhe pas luftës, dhe, për këtë arsye, ajo komunë nuk obligohej me ligj t'i merrte përsipër obligimet e kontratës së vitit 1996. Sipas mendimit të tij, Komuna e Podujevës vërtet e ka humbur kontinuitetin politik të ish-komunës, por gëzonte kontinuitetin juridik të bartjes së të drejtave dhe detyrimeve, pasi ishte vendosur në të njëjtat lokale dhe administronte pasurinë e patundshme si edhe më parë, dhe pasi kishte pranuar se ishte pronare e objektit të lëshuar me qira, ajo duhej t'i pranonte edhe detyrimet lidhur me këtë objekt.

23. Sipas mendimit të parashtruesit, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/1 nuk i shpallte të pavlefshme kontratat ekzistuese ndërmjet palëve, madje as ato në të cilat komuna ishte njëra prej palëve, pasi kontratat e tilla nuk mund të konsideroheshin

"akt shtetëror" i qeverisur nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/1.

24. Parashtruesi më tej pohon që Gjykata Supreme vendosi për revizionin e Komunës së Podujevës dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit publik në seancën e mbajtur më 3 shtator 2010 vetëm në praninë e Prokurorit publik të Kosovës, pa e thirrur përfaqësuesin e parashtruesit.

25. Në këtë drejtim, parashtruesi pohon që aktgjykimi i Gjykatës Supreme ishte marrë në kundërshtim me nenet 3.2 [Barazia para Ligjit], 24.1 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe nenin 6 të KEDNJ-së, sepse asnjë përfaqësues i Ndërmarrjes "Beni Dona" nuk ishte thirrur apo i pranishëm në procedurën në Gjykatën Supreme. Prandaj, sipas parashtruesit, palët në procedurë nuk ishin trajtuar në mënyrë të barabartë.

Dispozitat e zbatueshme ligjore lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë

26. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë rregullohet me Ligjin për procedurën kontestimore të 20 shtatorit 2008.

Nenet përkatëse të Ligjit (Nr. 03/L-006) për procedurën kontestimore

Neni 250:

"Për seancën në të cilën gjykata do të vendosë lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë do të njoftohet prokurori publik kompetent".

Neni 251:

"Kur vendos për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjykata do të kufizohet vetëm në ekzaminimin e shkeljeve që i thekson prokurori publik në kërkesën e vet".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Parashtruesi ankohet që aktgjykimi i Gjykatës Supreme i shkeli nenet 3.2 [Barazia para Ligjit], 24.1 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe nenin 6 të KEDNJ-së, sepse përveç Prokurorit publik, asnjë përfaqësues i Ndërmarrjes "Beni Dona" nuk ishte thirrur të merrte pjesë në procedurën në të cilën Gjykata Supreme kishte vendosur për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Prandaj, ai, si përfaqësues i ndërmarrjes, nuk ishte trajtuar në mënyrë të barabartë.

28. Gjykata së pari vëren që, në mënyrë që kërkesa të jetë e pranueshme, parashtruesi së pari duhet të tregojë që i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

29. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të përcaktojë nëse parashtruesi mund të konsiderohet palë e autorizuar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë: *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."* Përveç kësaj, sipas nenit 21.4 të Kushtetutës, "*Të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme*". Në kërkesën në fjalë, z. Shaban Mustafa, pronar i Ndërmarrjes "Beni Dona", e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 406/2008, të 3 shtatorit 2010, të drejtuar kundër ndërmarrjes. Prandaj,

parashtruesi duhet të konsiderohet si palë e autorizuar, se ka të drejtë ta ngrejë këtë çështje në Gjykatë dhe se i ka shterur të gjitha mjetet juridike, siç parashihet me ligj, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.

30. Sa i përket kriterit të nenit 49 të Ligjit, se parashtruesi duhet ta ketë dorëzuar kërkesën brenda afatit prej katër (4) muajve që fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi përfundimtar gjyqësor, Gjykata konstaton nga parashtresat e parashtruesit se ndërmarrjes i ishte dorëzuar aktgjykimi i sipërpërmendur i Gjykatës Supreme më 6 tetor 2010, kurse parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 12 tetor 2010, pra brenda afatit prej katër muajve siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.

31. Pasi parashtruesi ka saktësuar në detaje cilat të drejta sipas Kushtetutës dhe KEDNJ-së supozohet të jenë shkelur dhe nga cili autoritet publik, Gjykata gjithashtu gjen që parashtruesi e ka përmbushur kriterin e nenit 48 të Ligjit, i cili thotë:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

32. Në këto rrethana, Gjykata konkludon që duhet të konsiderohet se parashtruesi i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri dhe që tani duhet t'i shqyrtojë meritat e kërkesës.

Vlerësimi ligjor i kërkesës

33. Në rastin aktual, Gjykata vëren që Gjykata Komunale në Podujevë, me Aktgjykimin C. nr. 155/2007, e miratoi padinë e parashtruesit dhe i urdhëroi Komunës së Podujevës ose t'ia kthente ndërmarrjes fondet e investuara ose ta vazhdonte kontratën e qirasë të lidhur ndërmjet tyre edhe për dhjetë vjet.

Komuna e Podujevës paraqiti ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e cila e hodhi poshtë ankesën më 28 maj 2008. Komuna e Podujevës paraqiti revizion kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme, ndërsa, në të njëjtën kohë, Prokurori publik paraqiti kërkesë për mbrojte të ligjshmërisë në të njëjtën gjykatë.

34. Më 3 shtator 2010, Gjykata Supreme gjeti, me Aktgjykimin Rev. nr. 406/2008, që kërkesa e Prokurorit publik për mbrojte të ligjshmërisë, si dhe revizioni i Komunës së Podujevës ishin të bazuara, dhe që nuk mund të pranohej konkluzioni ligjor i gjykatave të shkallëve më të ulëta që komuna obligohej t'i përmbushte detyrimet e një kontrate që datonte nga viti 1996, të nënshkruar ndërmjet ndërmarrjes dhe Kuvendit komunal të Podujevës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që në kohën materiale, Prokurori i shtetit – pa qenë palë në procedurë në gjykata të shkallëve më të ulëta – e ushtroi të drejtën sipas nenit 245 (2) të Ligjit Nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore të Kosovës të ngrinte, ndër të tjera, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë lidhur me një vendim të gjykatës së shkallës së dytë, kundër të cilit njëra prej palëve kishte paraqitur revizion brenda afatit ligjor prej tridhjetë ditësh që fillon të ecë që nga dita kur revizioni i ishte dorëzuar asaj pale.

36. Gjykata më tej vëren që, sipas parashtresave të parashtruesit, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i 3 shtatorit 2010, ishte nxjerrë në praninë e Prokurorit publik, por pa e njoftuar dhe pa e thirrur parashtruesin që të merrte pjesë në procedurë në të njëjtën mënyrë siç e kishte thirrur Prokurorin publik. Prandaj, sipas mendimit të parashtruesit, Gjykata Supreme nuk e kishte trajtuar atë në mënyrë të barabartë dhe ia kishte shkelur të drejtën për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

37. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës ndër të tjera përcakton:

1. *"Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

[...]"

38. Neni 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së përcakton:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.

[...]"

39. Gjykata përsërit që, në përputhje me nenin 53 të Kushtetutës, "*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*"

40. Sa i përket ankesës së parashtruesit se ai nuk kishte qenë i njoftuar dhe i thirrur që të merrte pjesë në procedurën në Gjykatën Supreme, Gjykata i referohet qasjes së GJEDNJ-së në raste të ngjashme. P.sh., në rastin Grozdanoski (shih Grozdanoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21510/03, i 31 majit 2007), GJEDNJ konkludoi se, në

procedurën civile, parimi i barazisë së armëve do të thotë që secilës palë duhet t'i ofrohet mundësia e arsyeshme për ta paraqitur rastin e vet – duke përfshirë provat – në kushte që nuk e vejnë atë në situatë të pafavorshme përballë kundërshtarit të vet. Sipas GJEDNJ-së, koncepti i gjykimit të drejtë, një aspekt i të cilit është barazia e armëve, nënkupton të drejtën e palëve për të pasur njohuri dhe për t'i komentuar të gjitha provat e paraqitura apo vërejtjet e parashtruara.

41. Përveç kësaj, në rastin Grozdanoski, Prokurori publik kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, por parashtruesi kurrë nuk ishte njoftuar për këtë. Kërkesa e Prokurorit publik shpuri në vendim të Gjykatës Supreme, që ishte shumë i pafavorshëm për parashtruesin. GJEDNJ konsideroi që dështimi procedural për të mos e njoftuar parashtruesin e kishte penguar atë që të merrte pjesë në mënyrë efikase në procedurë në Gjykatën Supreme të Maqedonisë.

42. GJEDNJ gjithashtu ishte e mendimit se neni 6 (1) i KEDNJ-së është i menduar, para së gjithash, për t'i siguruar interesat e palëve dhe interesat e administrimit të mirëfilltë të drejtësisë, ndërsa respektimi i të drejtës për gjykim të drejtë, i garantuar me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, kërkonte që parashtruesit t'i ofrohej mundësia për të pasur njohuri dhe për ta komentuar kërkesën e Prokurorit publik. Si rrjedhojë, GJEDNJ konstatoi që dështimi për ta njoftuar parashtruesin për kërkesën e Prokurorit publik për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar në Gjykatën Supreme të Maqedonisë kishte qenë shkelje e nenit 6 (1) të KEDNJ-së.

43. Gjykata më tej i referohet rastit Gusak, *(*shih Gusak kundër Rusisë, 7 qershor 2011, Kërkesa nr. 28956/05, paragrafi 27), me ç'rast GJEDNJ konsideroi që "*ndërgjyqësi duhet të thirret në seancë gjyqësore jo vetëm për ta ditur datën dhe vendin e seancës, por edhe për të pasur kohë të mjaftueshme për ta përgatitur rastin e tij dhe për të qenë i pranishëm në seancë gjyqësore*".

44. Sipas mendimit të Gjykatës, prokurorët publikë, kur veprojnë jashtë fushës së të drejtës penale, duhet të gëzojnë të drejta dhe

obligime të njëjta si çdo palë tjetër dhe nuk duhet të gëzojnë pozitë të privilegjuar që e shkel parimin e barazisë së armëve si pjesë e të drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

45. Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së vet gjyqësore, në veçanti Rastit KI 108/10, Fadil Selmanaj - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 170/2009, të 25 shtatorit 2009, me ç'rast konstatoi se *"parashtruesi është dashur të thirrej në procedurë gjyqësore jo vetëm për të pasur njohuri për ekzistimin e saj, por edhe për t'i parashtruar argumentet dhe provat gjatë rrjedhës së procedurës"*.

46. Sa i përket rasti në fjalë, parashtruesi nuk ka mundur ta ushtrojë të drejtën e tij për gjykim të drejtë pa qenë i pranishëm në këtë procedurë në Gjykatën Supreme. Prandaj, duke mos e njoftuar parashtruesin për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga Prokurori publik, dhe duke mos e thirrur atë si palë në procedurë në Gjykatën Supreme, Gjykata Supreme, në aktgjykimin e vet të 3 shtatorit 2010, shkeli të drejtën e parashtruesit për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 (1) të KEDNJ-së.

47. Sa u përket çështjeve të tjera të ngritura në kërkesë, Gjykata vëren që parashtruesi mund të ngrejë çështje të tilla në procedurë në Gjykatën Supreme.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI

I. E shpall kërkesën të pranueshme;

II. Konstaton që ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6

(1) [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;

III. E shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 406/2008, të 3 shtatorit 2010;

IV. Ia kthen atë Aktgjykim për rishqyrtim Gjykatës Supreme në pajtim me aktgjykimin e kësaj gjykate;

V. Mbetet fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të atij Urdhri;

VI. Urdhëron që ky Aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VII. Deklaron që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Prof. Dr. Enver Hasani

KI 77/11 datë 24 prill 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.330/2008, të datës 06.01.2011

Rasti KI 77/11, vendimi i datës 6 janar 2011

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, Konventa Evropiane të Drejtave të Njeriut (neni 7), Deklaratë Universale të të Drejtave të Njeriut (neni 7), qartazi e pabazuar, Aktvendim për papranueshmëri.

Parashtruesi i ankesës ka pohuar se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. Nr. 330/2008, të datës 06.01.2011, ia ka mohuar të drejtën për punë të cilën përndryshe Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykimin C. Nr .112/06, të datës 08.05.2007, dhe Gjykata e Qarkut, gjithashtu në Prizren, me Aktgjykimin AC. Nr. 296/07, të datës 02.06.2008, ia kishin njohur.

Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si në vijim: neni 24.1 (Barazia para ligjit); neni 31.2 (E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm); neni 102.3 (Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit); neni 49 (E drejta për punë dhe ushtrim të profesionit), si dhe është shkelur Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 7 (Barabarësia para ligjit pa asnjë lloj diskriminimi). Gjithashtu sipas pohimit të paraqitësit të kërkesës është shkelur Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 7, si dhe Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (nenet 2.1, 5 dhe 6).

Gjykata Kushtetuese nuk gjen fakte se Gjykata Supreme nuk ka "Gjykuar drejt dhe paanshëm" duke sjellë vendimin si në revizionin e lartshënuar dhe nuk konstaton se me atë vendim të janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Bazuar në këto rrethana, rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese duke e çmuar kërkesën si qartazi të pabazuar nuk deklarohet lidhur me shkeljen eventuale të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut (neni 7) dhe as të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut

(neni 7), që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Sistemin Juridik të Kosovës, e që sipas z .Mazreku pretendohet të jenë shkelur.

Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij", andaj Kolegjit shqyrtues i propozoj që përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika c dhe d, kërkesën ta refuzojë si qartas të pabazuar.

Prishtinë, më 18 prill 2012

Nr. ref.: RK150 /11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 77/11

Parashtruesi

Mustafa Mazreku

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.330/2008, të datës 06.01.2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Mustafa Mazreku nga Mamusha, me banim në Prizren, rruga 'Selver Maçkaj" nr. 8, të cilin e përfaqëson avokati Masar Pirana, nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik, me të cilin pretendohet se janë bërë shkeljet e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.330/2008, i datës 06.01.2011.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 8 qershor 2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.330/2008, të datës 6 janar 2011, të cilin parashtruesi i kërkesës, sipas pohimit personal, e ka pranuar më 22.02 .2011.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 08.06.2011, Gjykata Kushtuese pranoi kërkesën e z. Mustafa Mazreku dhe e regjistroi atë me Nr. KI 77/11.

6. Më 17 gusht, me vendimin GJ.R 77/11, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Dr. Iliriana Islami si Gjyqtare raportuese.

7. Të njëjtën ditë, Kryetrari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje nga Robert Carolan (kryesues) dhe gjyqtarët Almiro Rodrigues e Prof. dr Enver Hasani, anëtarë të kolegjit.

8. Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar Gjykatën Supreme të Kosovës, si dhe parashtruesin e kërkesës, për regjistrimin e lëndës më 24 qershor 2011, por në afatin ligjor nuk ishte marrë asnjë koment nga asnjëra palë.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 1 tetor 1987, z. Mustafa Mazreku ka themeluar marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar në Shkollën fillore "Fadil Hisari"në Prizren në vendin e punës **Arkëtar,** dhe këtë në bazë të Aktvendimit për "Bashkimin e mjeteve dhe punës" nr. 256, të datës 01 tetor 1987, dhe në këtë vend pune kishte punuar pandërprerë deri pas lufte dhe me themelimin e Administratës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UMNIK).

10. Më 7 gusht 2000, UNMIK-u kishte nxjerrë "Direktivat e Departamentit të Arsimit dhe Shkencës"-Kontratat e punësimit për periudhën 1/9/00 deri më 31.12.00, dhe kishte caktuar kushtet nën të cilat punëtorët arsimorë mund të marrin kontratat e punësimit, kushtet për kontrata të përkohshme për mësuesit, si dhe kushtet për pagesë të atyre që do të punojnë por nuk do të kenë kontrata punësimi për periudhën kohore të cekur në këtë direktivë.

11. Sipas pohimit të z. Mustafa Mazreku, në përputhje me këtë direktivë atij nuk i është dhënë kontrata e punës, edhe pse sipas listës së pagave ai ka marrë avancën në të holla në shumën prej 450 DEM për muajt IX, X, dhe XI të vitit 2000.

12. Gjithashtu sipas pohimit të tij, ai pos që nuk kishte marrë kontratën e punës nuk kishte marrë as 800 DEM shpërblim për ata që kishin mbetur pa kontrata pune dhe të papunësuar. Ndërkohë, kur të gjithë të punësuarit e kësaj shkolle me kontrata pune kishin marrë diferencën e pagës për muajt shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2000, ai nuk e kishte marrë këtë diferencë e as pagën e plotë për muajin dhjetor 2000. Megjithatë, z. Mazreku ka vazhduar të shkojë vazhdimisht në punë edhe pse pa kontratë punë dhe pa të ardhura personale.

13. Më 29janar 2002, duke parë se situata në të cilën gjendej nuk zgjidhej, z Mustafë Mazreku ka parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Prizren duke kërkuar zgjidhjen e kontestit të punës.

14. Më 8 maj 2007, Gjykata Komunale në Prizren ka nxjerr Aktgjykimin C. nr. 112/06, me të cilin **aprovon si të bazuar** padinë e paditësit, z. Mustafë Mazreku, dhe **obligon** Komunën e Prizrenit - Drejtoratin për Arsim dhe Shkencë që paditësin ta kthejë në vendin e punës Arkëtar në Shkollën fillore ”Fadil Hisari” me të gjitha të drejtat që i ka pasur deri më 1 tetor 2001.

15. Më 2 qershor 2008, duke vendosur sipas ankesës së Komunës së Prizrenit–Drejtoratit Komunal, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin AC.nr.296/2007, ka refuzuar si të pabazuar këtë ankesë dhe Aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Komunale C.nr.112/06 e kishte lënë në fuqi.

16. Meqenëse aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës së Qarkut në Prizren nuk po zbatohej, z. Mustafa Mazreku ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Komunale në Prizren për përmbarimin e këtij aktgjykimi, dhe kjo Gjykatë, me Aktvendimin E.nr.1063/08, ka aprovuar këtë kërkesë ndërsa me 10.10.2008 ka bërë edhe ekzekutimin e tij duke e kthyer në punë z. Mustafë Mazrekaj.

17. Në fakt, edhe pse Gjykata Komunale e kishte ekzekutuar vendimin e vet, z. Mazrekaj vetëm fizikisht kishte shkuar në punë sepse atij nuk iu dha ndonjë kontratë pune por vetëm iu premtua

se do t'i ofrohet vendi i punës i bibliotekarit pasi që vend pune për arkëtar nuk ka, jo vetëm në shkollën "Fadil Hisari" por në asnjë shkollë tjetër, pasi që tashmë mjetet financiare nuk menaxhohen nga shkollat por nga Drejtoria Komunale për Arsim dhe Shkencë. Z. Mustafë Mazreku ka vazhduar të shkojë në punë në shkollën fillore "Fadil Hisari" edhe për 5 muaj rresht pas kthimit në punë nga Gjykata Komunale por pa të ardhura personale, dhe pas kësaj ka vendosur të mos shkojë më në punë deri sa të zgjidhet kontestit i tij i punës.

18. Më 25 qershor 2008, Avokatura Publike e Komunës së Prizrenit ka paraqitur revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës me të cilin ka atakuar aktgjykimet e Gjykatës Komunale të Prizrenit (C. Nr. 112/06, i datës 08.05.2006) dhe të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit (AC. nr 296/2007, i datës 02.06.2008), dhe atë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së Drejtës materiale.

19. Më 08.07.2009, Gjykata Komunale në Prizren, si Gjykatë përmbarimore, ka nxjerrë Aktvendimin E.nr.1063/08 me të cilin ka gjobitur Drejtorin e Drejtorisë për Arsim dhe Shkencë të Komunës së Prizrenit, në cilësinë e personit përgjegjës, me 50 Euro dhe Drejtorinë për Arsim dhe Shkencë, në cilësinë e personit juridik, me 200 Euro për shkak të moszbatimit efektiv të vendimit të përmbarueshëm.

20. Më 6 janar 2001, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas revizionit të Avokaturës Publike të Komunës së Prizrenit, mori Aktgjykimin Rev 330/2008 me të cilin aprovoi revizionin e paraqitur dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 112/06, të datës 08.05.2006 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren AC. Nr. 296/2007, të datës 02.06.2008 në atë mënyrë që padia e z. Mustafë Mazreku REFUZOHET. Këtë Aktgjykim z. Mustafë Mazreku e kishte pranuar më 22.02.2011.

21. Gjykata Supreme në aktgjykimin e revizionit të saj kishte theksuar se gjykatat e rregullta të rangut më të ulët kishin vërtetuar drejt

gjendjen faktike, por kishin bërë **gabimisht aplikimin e të drejtës materiale** pasi që me direktivat e UNMIKUT marrëdhënia e punës në institucionet arsimore ka qenë marrëdhënie kontraktuale dhe e lidhur me afate kohore. Ndërsa pasi që zoti Mazreku nuk ka pasur kontratë pune ai nuk ka pasur as marrëdhënie juridike pune valide por vetëm punë faktike në shkollë.

22. Menjëherë pasi kishte marrë aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Komunës së Prizrenit për aprovimin e revizionit, z. Mustafë Mazreku nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, avokatit z. Masar Pirana nga Prizreni, ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit në Prishtinë.

23. Më 31 mars 2011, Prokuroria e Shtetit, me shkresën zyrtare KMLC nr 23/2011, kishte njoftuar z. Mustafa Mazreku se në bazë të dispozitës së nenit 245.3 lidhur me nenin 220 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK) kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë NUK LEJOHET kundër vendimit të marrë me rastin e revizionit nga Gjykata Supreme, andaj edhe në këtë rast kjo kërkesë nuk mund të ngritët.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i ankesës ka pohuar se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. Nr. 330/2008, të datës 06.01.2011, ia ka mohuar të drejtën për punë të cilën përndryshe Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykimin C. Nr .112/06, të datës 08.05.2007, dhe Gjykata e Qarkut, gjithashtu në Prizren, me Aktgjykimin AC. Nr. 296/07, të datës 02.06.2008, ia kishin njohur.

25. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si në vijim: neni 24.1 (Barazia para ligjit); neni 31.2 (E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm); neni 102.3 (Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës

dhe ligjit); neni 49 (E drejta për punë dhe ushtrim të profesionit), si dhe është shkelur **Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,** neni 7 (Barabarësia para ligjit pa asnjë lloj diskriminimi). Gjithashtu sipas pohimit të paraqitësit të kërkesës është shkelur Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 7, si **dhe Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial** (nenet 2.1, 5 dhe 6).

Vlerësimi për pranueshmëri të kërkesës

26. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë që përcaktohen me Kushtetutë.

27. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton se:

*"Individët janë të autorizuar të ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale**, **të garantuara me Kushtetutë**, mirëpo **vetëm** pasi të **kenë shteruar të gjitha mjetet juridike** të përcaktuara me ligj."*

Gjykata gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartas e bazuar".

28. Duke iu referuar shkeljes së supozuar, nga ana e parashtruesit të kërkesës, të të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të konventave e instrumenteve tjera ndërkombëtare, në cilësinë e Gjyqtarit raportues konstatoj:

29. Në nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] pika 3. të Kushtetutës është qartazi e paraparë: "**Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit**."

30. Në nenin 103 [**Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave**) të Kushtetutës, në pikën 2 është gjithashtu qartazi e përcaktuar: "Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor."

31. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese nuk gjen asnjë fakt se Gjykata Supreme duke vendosur sipas kërkesës për revizion, për të cilën shprehimisht është e autorizuar në bazë të nenit 212 të LPK-së, të ketë shkelur nenin 31.2 (E drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm), nenin 49 (E drejta për punë) apo nenin 102.3 (Gjykatat gjykojnë sipas Kushtetutës dhe ligjit), që parashtruesi i kërkesës ka supozuar se janë shkelur.

32. Në fakt parashtruesi i kërkesës, përpos shprehjes së mos kënaqësisë për revizionin e nxjerrë nga Gjykata Supreme, nuk ka ofruar asnjë fakt tjetër të bazuar që gjykimi "nuk ka qenë i drejtë dhe i paanshëm" dhe nuk ka shpjeguar se në cilën mënyrë ai ka qenë i trajtuar si i pabarabartë apo cila fazë e procedurës ka qenë jokushtetuese.

33. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e verifikimit të fakteve, dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i sajë (i Gjykatës Kushtuese) është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që

garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

34. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. *5503/02,* Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

35. Gjykata Kushtetuese nuk mund të neglizhojë faktin se me direktivat e UNMIK-ut, por më vonë edhe me Rregulloren 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës - me nenin 1 të saj, të gjithë të punësuarit që marrin rrogë nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës, pra edhe të punësuarit në arsim, kishin statusin e nëpunësve civilë.

36. Kjo rregullore, në nenin 3.1.(c), kishte paraparë "Që punësimi në Shërbimin civil të rregullohet me anë të kontratave me shkrim të punësimit", dhe në nenin 3.3 që kontratat e punësimit në Shërbimin civil do të jenë për një periudhë kohore deri në tri (3) vjet dhe ato mund të vazhdohen.

37. Këto direktiva, por edhe kjo rregullore në fuqi në atë kohë, pa dyshim se marrëdhënien e punës e kanë definuar si kontraktuale dhe se sistemit të kontratave të punës i janë nënshtruar të gjithë shërbyesit civilë pa asnjë përjashtim, andaj Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesi i kërkesës, z. Mustafa Mazreku, së bashku me kërkesën e tij në këtë Gjykatë nuk ka paraqitur asnjë kontratë të punës me shkollën "Fadil Hisari".

38. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese nuk gjen fakte se Gjykata Supreme nuk ka "Gjykuar drejt dhe paanshëm" duke sjellë vendimin si në revizionin e lartshënuar dhe nuk konstaton se me atë vendim të janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

39. Bazuar në këto rrethana, rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese duke e çmuar kërkesën si qartazi të pabazuar nuk deklarohet lidhur me shkeljen eventuale të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut (neni 7) dhe as të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (neni 7), që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Sistemin Juridik të Kosovës, e që sipas z .Mazreku pretendohet të jenë shkelur.

40. Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij", andaj Kolegjit shqyrtues i propozoj që përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika c dhe d, kërkesën ta refuzojë si qartas të pabazuar, dhe

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.2 (c,d) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e datës 5 tetor 2011, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Dr. Iliriana Islami Prof. Dr. Enver Hasani

KI 01/10 datë 10 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1224/09, të 12 nëntorit 2009

Rasti KI 01/10, vendim i 20 prillit 2012.

Fjalët kyçe: cenim i të drejatve dhe lirive kushtetuese, kërkesë individuale, ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, mos shterje e mjeteve juridike, pengim posedimi.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese janë cenuar me vendimin e Gjykatës së Qarkut, me ç'rast ishte anuluar vendimi i Gjykatës Komunale lidhur me gëzimin e papenguar të pronësisë. Parashtruesi pohoi se Gjykata e Qarkut ka cenuar të drejtat dhe liritë të garantuara me nenet 46 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës në lidhje me nenin 47.2 të Ligjit për shkak se parashtruesi nuk kishte shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Gjykata arsyetoi vendimin e saj duke theksuar se parashtruesi i kërkesës nuk kishte ndërmarrë hapa për të zgjidhur kërkesën e tij siç përshkruhej në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesve si të papranueshme.

Prishtinë, më 20 prill 2012

Nr. Ref.: RK220/12

ATKVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 01/10

Parashtruesi

Gani Ibërdemaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1224/09, të 12 nëntorit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendës-kryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Gani Ibërdemaj nga Prishtina, të cilin e përfaqëson avokati Feriz Gërvalla po ashtu nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin Ac.nr.1224/09 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të 12 nëntorit 2009 që i është dorëzuar atij më 23 nëntor 2009.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës ankohet se me vendimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës Ac. nr. 1224/09, të 12 nëntorit 2009, i janë shkelur të drejtat për pronë të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e pronës] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47.2 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së Punës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 6 janar 2010, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Sekretariatin e Gjykatës Kushtetuese. Kërkesa iu komunikua Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 23 mars 2010.

6. Gjykata e Qarkut u përgjigj më 26 mars 2010 duke thënë se dosja e lëndës në rastin e procedurës civile c. nr. 117/2008 ishte kthyer në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

7. Më 11 maj 2010 Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues si dhe kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj.

8. Më 14 dhjetor 2010 kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe pas këshillimit për këtë çështje i paraqiti rekomandimin Gjykatës në përbërje të plotë.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 15 qershor 2009 Gjykata Komunale në Prishtinë nxori vendimin C. nr 117/2008, me të cilin e miratoi kërkesë padinë e parashtruesit të tanishëm të kërkesës, Gani Ibërdemaj, duke konstatuar që të paditurit, Enver Aliaj dhe Mehmet Alijaj, kanë penguar në pronë parashtruesin e kërkesës dhe i urdhëroi ata që të ndalojnë së penguari tani dhe në të ardhmen si dhe të largojnë të gjitha pengesat e pretenduara.

10. Përfaqësuesi ligjor i të paditurve ushtroi ankesë ndaj këtij vendimi, me propozimin që të prishet vendimi, kërkesë padia e paditësit të refuzohet si e pabazë ose të anulohet, si dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Paditësi parashtroi përgjigje në ankesën e të paditurit me propozimin që ankesa të refuzohet si e pabazë, dhe që vendimi i Gjykatës Komunale të vërtetohet.

11. Më 12 nëntor 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori vendimin Ac. nr. 1224/09 me të cilin vendosi ta anulojë vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C .Nr 117/2008, të 15 qershorit 2009, dhe ta hedhë poshtë kërkesë padinë e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme.

12. Gjykata e Qarkut në Prishtinë konstatoi se Gjykata Komunale ka gabuar sepse çështja në kontest nuk është pengimi në pronë dhe se nuk është në juridiksionin e Gjykatës Komunale.

13. Gjykata e Qarkut në Prishtinë konkludoi që "paditësi në situatën konkrete nuk gëzon mbrojtje gjyqësore për pengim në posedim të pronës së paluajtshme e cila është pjesë e planit urbanistik. Të gjitha çështjet e diskutueshme në raport me të drejtën në pronë mbi pronën e paluajtshme (. . .) do të zgjidhen

në procedurë kontestimore në pajtim me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i Gjykatës së Qarkut është i paligjshëm sepse ai shkel dispozitat e procedurës kontestimore dhe gabimisht konkludon se ky kontest nuk është kontest i posedimit të nënkuptuar dhe nuk është në juridiksionin e Gjykatës Komunale.

15. Parashtruesi i kërkesës argumenton se toka ndërtimore urbane gëzon mbrojtje gjyqësore nga pengimi apo shqetësimi i posedimit të fundit faktik.

16. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës konludon se me vendimin e lartpërmendur gjyqësor i është shkelur "e drejta themelore e mbrojtjes së pronës e parashikuar me nenin 46 paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 54 (mbrojtja gjyqësore e të drejtës për shfrytëzim të pronës) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në

Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

18. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës në lidhje me nenin 47.2 të Ligjit i cili parashikon:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

"47.2 Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

19. Parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar se ka ndërmarrë hapa për të zgjidhur kërkesën e tij nëpërmjet procedurës kontestimore në pajtim me Ligjin për Pronën dhe të Drejtat tjera Sendore, siç përshkruhet në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

20. Gjykata e përdori të njëjtin arsyetim mbi baza të mos-shterjes së mjeteve juridike kur e nxori Aktvendimin për Papranueshmëri, më 27 janar 2010, në rastin Nr. KI41-09, Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe në vendimin e saj të 23 marsit 2010, në rastin Nr. KI73/09, Mimoza Kusari Lila kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

21. Më herët Gjykata kishte theksuar se arsyetimi mbi kërkesën e shterimit është që t'iu ofrojnë autoriteteve në fjalë, duke përfshire gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar te Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. (shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25 803/94, vendim i datës 28 korrik 1999). Megjithatë, nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese të ceken në mënyre

eksplicite gjatë procedurës në fjalë. Deri sa kjo çështje është ngritur në mënyrë implicite ose substanciale, kërkesa mbi shterimin e mjeteve është plotësuar (shihni, *mutatis mutandis*, ECHR, Azinass kundër Qipros, nr. 56679/00, Vendimi i 28 prillit 2004)

22. Gjykata rrjedhimisht konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur të gjitha mjetet e disponueshme juridike të parashikuara me ligj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës, me shumicë votash

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Prof. Dr. Enver Hasani

KI 32/11 datë 18 maj 2012- Kërkesë për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së

Rasti KI 32/11,

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, barazia para ligjit, parimet e përgjithshme, , të drejtat dhe liritë themelore, e parakohshme, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi paraqiti kërkesën në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës duke pretenduar që për shkak se organizata e UÇK-së nuk ia ka njohur statusin e veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) organizata e UÇK-së i ka shkelur nenet 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 24 [Barazia para Ligjit], të parashikuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës. Parashtruesi më tej pohon për shkelje të nenit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenit 29 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 2 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Parashtruesi dorëzoi një peticion pranë Gjykatës Supreme më 13 dhjetor 2010, për shkak të heshtjes administrative të Organizatës Qendrore të Veteranëve të UÇK-së. Parashtruesi pohon që nuk ka marrë asnjë vendim nga Gjykata Supreme.

Peticioni i parashtruesit ende është në procedurë pranë Gjykatës Supreme. Prandaj, duket që kërkesa e tij është parakohshme. Prandaj Gjykata ka konstatuar qe Kërkesa refuzohet si qartazi e pabazuar, dhe është e papranueshme, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Prishtinë, më 20. prill 2012

Nr.Ref.:RK219/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 32/11

Parashtruesi

Lulzim Ramaj

Kërkesë për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Lulzim Ramaj nga Peja.

Ankesat dhe pretendimet e parashtruesit

2. Ankesa e parashtruesit buron nga mohimi i statusit të veteranit nga organizata e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

3. Parashtruesi pohon që me këtë veprim, organizata e UÇK-së i ka shkelur nenet 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 24 [Barazia para Ligjit], të parashikuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës.

4. Parashtruesi më tej pohon për shkelje të nenit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenit 29 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 2 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), bashkë me dokumentacionin e nevojshëm, më 3 mars 2011.

7. Të njëjtën datë, parashtruesi dorëzoi "një kërkesë për mospublikim" në "mediet publike, në mediet e shkruara dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës".

8. Më 18 prill 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.

9. Më 18 janar 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 17 shtator 2010, parashtruesi dorëzoi një kërkesë në Organizatën e Veteranëve të UÇK-së, dega në Pejë, për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së dhe gjithashtu kërkoi lëshimin e "librezës së UÇK-së".

11. Më 12 tetor 2010, për shkak të heshtjes administrative nga dega në Pejë, duke u bazuar në nenin 131 të Ligjit për procedurën administrative në Kosovë (Ligji Nr. 02/L-28), parashtruesi paraqiti ankesë në Organizatën Qendrore të Veteranëve të UÇK-së në Prishtinë.

12. Më 13 dhjetor 2010, parashtruesi paraqiti peticion në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë për shkak të faktit se nuk kishte marrë asnjë vendim për ankesën e tij drejtuar Organizatës Qendrore të Veteranëve të UÇK-së.

13. Më 28 dhjetor 2010 dhe më 29 janar 2011, parashtruesi paraqiti ankesa në Këshillin Gjyqësor të Kosovës kundër mosveprimit nga Gjykata Supreme.

14. Më 9 shkurt 2011, parashtruesi mori një letër nga Zyra e Prokurorit Disiplinor e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me anë të së cilës njoftohej se parashtresa e tij lidhur me vonesën e Gjykatës Supreme të Kosovës për shqyrtim nuk e përmbushte kriterin kohor për t'u shqyrtuar.

15. Më 9 shkurt 2011, parashtruesi përsëri iu drejtua me një kërkesë Këshillit Gjyqësor të Kosovës me ç'rast kërkoi të shqyrtoheshin ankesat e tij të 28 dhjetorit 2010 dhe të 29 janarit 2011.

16. Parashtruesi pohon që nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës lidhur me kërkesën e tij të 9 shkurtit 2011.

17. "Kërkesa për mospublikim", e përmendur më sipër, nuk mbështetet me asnjë bazë apo justifikim faktik.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregullore të punës.

19. Gjykata rikujton që substanca e kërkesës së parashtruesit është mohimi i njohjes së statusit të veteranit të UÇK-së.

20. Gjykata vëren që në periudhën prej 17 shtatorit 2010 e deri më 9 shkurt 2011, parashtruesi kishte dorëzuar një sërë kërkesash në organet dhe institucionet e ndryshme shtetërore në të cilat e përsëriste kërkesën e tij. Parashtruesi gjithashtu e dorëzoi një peticion në Gjykatën Supreme më 13 dhjetor 2010 për shkak të heshtjes nga Organizata Qendrore e Veteranëve të UÇK-së.

21. Parashtruesi pohon që nuk ka marrë asnjë vendim nga Gjykata Supreme.

22. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që në përputhje me nenin 113 (7) të Kushtetutës *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

23. Peticioni i parashtruesit ende është në procedurë në Gjykatën Supreme. Prandaj, duket që kërkesa e tij është e parakohshme. Ky konkluzion është në përputhje me informacionin që parashtruesit i është dhënë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës se *"parashtresa e tij lidhur me vonesën e Gjykatës Supreme të Kosovës për shqyrtim nuk e përmbush kriterin kohor për t'u konsideruar se është duke u vonuar nga Gjykata"*.

24. Sa i përket "kërkesës së parashtruesit për mospublikim", ajo duhet të konsiderohet si kërkesë për konfidencialitet. Megjithatë, Gjykata vëren që kërkesa është dorëzuar pa asnjë arsyetim. Si rrjedhojë, refuzohet si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Prof. Dr. Enver Hasani

KI 104/10 datë 10 maj 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan GŽ Nr. 78/2010, të 7 qershorit 2010

Rasti KI 104/10, vendimi i 13 dhjetorit 2011

Fjalët kyçe: Kërkesë individuale, e drejta e posedimit, mbrojtja e pronës, res judicata, dualiteti i vendimeve gjyqësore dhe administrative, kompetenca e gjykatës.

Parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke kontestuar aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan GŽ nr. 78/2010 të 7 qershorit 2010. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me aktgjykimet P. Posl. Nr. 36/2000 të Gjykatës Komunale në Kamenicë, të 26 shtatorit 2000; GZ Nr. 10/2001 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të 23 prillit 2001; Rev. Nr. 141/2003 të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, të 30 dhjetorit 2004, si dhe vendimet në vijim P. Posl. Nr. 36/2000 të Gjykatës Komunale në Kamenicë, të 11 janarit 2010 dhe GZ Nr. 10/2001 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të 7 qershorit 2010 i është cenuar e drejta për të gëzuar pronën personale si dhe e drejta për siguri juridike për shkak të ekzistimit të dualitetit të vendimeve gjyqësore dhe administrative.

Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të vërtetojë vendimet nr. HPCC/D/194/2005/C të 18 qershorit 2005 dhe nr. HPCC/REC/66/2006 të 15 korrikut 2006, të cilat i ka nxjerrë HABITAT-i dhe me anë të së cilave urdhërohet që t'i kthehet pronësia mbi pronën në fjalë. Parashtruesi i kërkesës ka konsideruar se vendimet e HABITAT-it janë të formës së prerë dhe të obligueshme dhe si të tilla ato duhet të njihen. Ai pretendon se me aktgjykimet e lartpërmendura i cenohen të drejtat për të gëzuar pronën personale dhe e drejta për siguri juridike.

Parashtruesi i kërkesës ka konsideruar se janë shkelur neni 46 (Mbrojtja e pronës) i Kushtetutës së Kosovës dhe neni 1 (E drejta e pronës) i Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Draža Arsić, Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të procedurës në tërësi konstatoi se kërkesa e parashtruesit është e pranueshme. Gjykata është e mendimit se Vendimi HPCC/REC/66/2006 i 15 qershorit 2006 është i formës së prerë në përputhje me nenin 2 paragrafin 7 UNMIK/UREDBE/1999/23, dhe rrjedhimisht nuk i nënshtrohet rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë. Pasi që Vendimi i KKPB-së i 15 korrikut 2006 u bë *res judicata* më 4 shtator 2006, parashtruesi i kërkesës e ka gëzuar të drejtën e posedimit të pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, dhe se çdo ndërhyrje në këtë të drejtë, nga cilado gjykatë apo organ administrativ, do të duhej konsideruar shkelje e të drejtave të parashtruesit.

Në bazë të asaj që u përmend më lart, Gjykata konkludoi se ka pasur shkelje të të drejtave të parashtruesit të kërkesës, se vendimi HPCC/REC/66/2006 i 15 korrikut 2006 ishte bërë *res judicata* më 4 shtator 2006 dhe se rrjedhimisht kishte pasur shkelje të të drejtës së pronës e paraparë me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së. Gjykata në fund konkludon se gjykatat si dhe organet administrative në fjalë ishin përgjegjëse që të merrnin parasysh në mënyrën e duhur procedurat e zhvilluara në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 pranë DPB-së dhe KKPB-së, në të cilat ishte i përfshirë parashtruesi i kërkesës, dhe që të zbatonin vendimet e tyre.

Prishtinë, 23 prill 2012

Nr. ref.:AGJ221 /12

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KI 104/10

Parashtrues

Draža Arsić

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan GŽ Nr. 78/2010, të 7 qershorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Draža Arsić, me profesion inxhinier dhe me vendbanim në Kamenicë.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kërkesës i konteston aktgjykimet: P. Posl. Nr. 36/2000 të Gjykatës Komunale në Kamenicë, të 26 shtatorit 2000; GZ Nr. 10/2001 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të 23 prillit 2001; Rev. Nr. 141/2003 të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, të 30 dhjetorit 2004, si dhe vendimet në vijim P. Posl. Nr. 36/2000 të Gjykatës Komunale në Kamenicë, të 11 janarit 2010 dhe GZ Nr. 10/2001 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të 7 qershorit 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet e lartpërmendura i është cenuar *"e drejta për të gëzuar pronën personale si dhe e drejta për siguri juridike për shkak të ekzistimit të dualitetit të vendimeve gjyqësore dhe administrativ*e".

4. Ai po ashtu, kërkon vërtetimin e vendimit grupor të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore HPD HPCC/REC/66/2006, të 15 korrik 2006.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 (1) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 14 tetor 2010, dhe kërkoi që në komunikimin e tij me Gjykatën të përdorej gjuha serbe.

7. Me Urdhër të Kryetarit (Nr. GJR. 104/10 të 16 dhjetorit 2010), gjyqtari Ivan Čukalović u emërua Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Urdhrin e Kryetarit Nr. KSH. 104/10, gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami u emëruan anëtarë të Kolegjit shqyrtues.

8. Më 19 janar 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën Komunale në Kamenicë se parashtruesi ka parashtruar një kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve dhe aktvendimeve të lartpërmendura.

9. Gjykata Komunale në Kamenicë, më 2 shkurt 2011, ia dorëzoi Gjykatës tërë dosjen e lëndës.

10. Me shkresën e datës 4 prill 2011, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të ofronte informacione shtesë në lidhje me gjendjen faktike.

11. Po të njëjtën ditë, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Agjencia Kosovare e Pronës (në tekstin e mëtejmë: AKP) informacione

shtesë në lidhje me gjendjen faktike, dhe prova të caktuara në mënyrë që Gjykata të mund të gjykojë për rastin në mënyrë të duhur.

12. Më 14 prill 2011, AKP-ja ia dorëzoi përgjigjen Gjykatës Kushtetuese së bashku me dokumentacionin mbështetës. AKP-ja i konfirmoi Gjykatës se, për kërkesat e parashtruara nga ana e parashtruesit të kërkesës dhe bashkëshortes së tij (kërkesat DS00636/DS200053) në Drejtorinë e Çështjeve Pronësore Banesore (DKPB) ishte vendosur më 18 qershor 2005. Më tej, AKP-ja theksoi se KKPB-ja me Vendimin HPCC/REC/66/2006, të 15 korrikut 2006, e vërtetoi vendimin e tij të parë, të 18 qershorit 2005, dhe ia miratoi parashtruesit të kërkesës posedimin e pronës. AKP po ashtu, parashtroi se në bazë të vendimit të formës së prerë të KKPB-së parashtruesi i kërkesës kërkoi t'i kthehej prona në riposedim dhe të dëbohej uzurpuesi nga prona, gjë të cilën e bëri AKP-ja më 31 tetor 2006, ndërsa çelësat iu dorëzuan parashtruesit të kërkesës më 20 nëntor 2006. AKP-ja në fund e njoftoi Gjykatën se rasti ishte mbyllur më 20 shkurt 2007, pasi që prona i ishte kthyer në riposedim parashtruesit të kërkesës dhe se AKP-ja kishte nënshkruar një memorandum me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: AKK) më 13 korrik 2009, ku në njërin nga nenet thuhej: *"AKP-ja do t'i sigurojë AKK-së kopje elektronike të vendimeve të formës së prerë të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore me qëllim të azhurnimit të të dhënave kadastrale."*

13. Më 20 prill 2011, parashtruesi i kërkesës e dërgoi përgjigjen në kërkesën e Gjykatës për informacione shtesë së bashku me dokumentacionin mbështetës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 24 shkurt 1992, ndërmarrja „KARAÇEVAKARAÇEVA" (në tekstin e mëtejmë: KARAÇEVA) i ofroi parashtruesit të kërkesës dhe familjes së tij strehim të përkohshëm në ndërtesën e saj

administrative, e cila më vonë u shndërrua në hapësirë banimi edhe për dy familje tjera.

15. Më 11 dhjetor 1992, parashtruesi i kërkesës lidhi kontratë me ndërmarrjen „KARAÇEVA“ për shfrytëzimin e banesës nr. 115 në ndërtesën e administratës.

16. Më 20 prill 1993, parashtruesi i kërkesës lidhi kontratë me ndërmarrjen „KARAÇEVA“ për blerjen e banesës. Kontrata u vërtetua në Gjykatën Komunale dhe u regjistrua me nr. 413/93, dhe të njëjtën ditë e kishte të bashkëngjitur dëftesën e pagesës për shumën 4.509.981 dinarë, që paraqet çmimin e blerjes që parashtruesi i kërkesës e kishte paguar për banesën.

17. Parashtruesi i kërkesës dhe familja e tij jetuan në banesën e blerë deri në muajin korrik të vitit 1999.

18. Më 5 korrik 1999, ndërmarrja „KARAÇEVA“ i dërgoi njoftim parashtruesit të kërkesës dhe familjes së tij se qëndrimi i tyre në banesë ishte i paligjshëm dhe se e kishin uzurpuar pronën shoqërore. Ata u urdhëruan që të largohen nga banesa në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit. Parashtruesi i kërkesës dhe familja e tij u larguan, siç duket, nga frika, ndërsa një person i tretë u vendos në banesë pas largimit të tyre.

19. Më 15 nëntor 1999, hyri në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 për Themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DPB) dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore e cila në nenin 1.2, mes tjerash, parasheh [...] “*Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Drejtoria merr dhe regjistron kategoritë e mëposhtme të kërkesave që kanë të bëjnë me pronën banesore, duke përfshirë këtu edhe pronën e shoqëruar me të; Ankesat e personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit në pronën banesore para datës 24 mars 1999, e që tani nuk e kanë atë pasuri në posedim, dhe kur e drejta e pronësisë nuk është transferuar vullnetarisht. Drejtoria ia paraqet këto kërkesa Komisionit për Ankesa*

Pronësore dhe Banesore ose, nëse e sheh të përshtatshme, kërkon të ndërmjetësojnë në këto mosmarrëveshje dhe kur nuk ka sukses, ia drejton ato për zgjidhje Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore[...]".

20. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 më tej në nenin 2.7 parashikonte që: *"Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për t'u zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë*".

21. Më 13 korrik 2000, ndërmarrja „KARAÇEVA" paraqet padi në Gjykatën Komunale në Kamenicë kundër parashtruesit të kërkesës, me të cilën kërkon që të anulohen kontratat për shfrytëzimin dhe blerjen e banesës të nënshkruara në mes tyre në vitin 1993.

22. Më 7 shtator 2000, Këshilli Norvegjez për Refugjatë në Kralevë e njoftoi Gjykatën Komunale në Kamenicë se, me kërkesë të parashtruesit të kërkesës, e kishte përcjellë kërkesën e tij për pronësi të banesës në DPB dhe KKPB. Më tutje, Këshilli konsideronte se në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 të drejtat e pronës binin ekskluzivisht në juridiksionin e KKPB-së, vendimet e të cilit ishin të obligueshme dhe hynin në fuqi menjëherë, dhe rrjedhimisht nuk mund të kontestoheshin nga asnjë organ tjetër administrativ apo gjyqësor siç parashihet me nenin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut. Këshilli, rrjedhimisht kërkoi nga Gjykata Komunale që menjëherë të ndalonte çfarëdo procedure të mëtutjeshme në lidhje me këtë padi për shkak të mungesës së juridiksionit.

23. Më 14 shtator 2000, avokati i parashtruesit të kërkesës dorëzoi përgjigje në Gjykatën Komunale të Kamenicës në lidhje me padinë e ndërmarrjes"KARAÇEVA", duke pohuar se blerja e kontestuar e banesës ishte e vlefshme, posaçërisht për arsyen se nuk mund t'i cenohej e drejta e pronësisë të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte fituar në vitin 1993, e që ishte e ngjashme me të drejtën e punëtorëve tjerë të "KARAÇEVËS" të cilët e kishin fituar pronësinë pavarësisht nacionalitetit të tyre.

24. Më 26 shtator 2000, Gjykata Komunale në Kamenicë vendosi në lidhje me padinë e ndërmarrjes „KARAÇEVA“, duke theksuar se nuk kishte bazë ligjore për kontratat e kontestuara në atë kohë, sepse KARAÇEVA nuk ishte pronar i përhershëm i ndërtesës së kërkuar dhe rrjedhimisht nuk ka mundur të tjetërsonte pronësinë e saj.

25. Më 23 nëntor 2000, avokati i parashtruesit të kërkesës ushtroi ankesë ndaj këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, duke pretenduar, mes tjerash, se Gjykata Komunale në Kamenicë kishte vendosur për një kërkesë e cila nuk ishte nën juridiksionin e saj, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23, të 15 nëntorit 1999, pasi që vetëm DPB-ja dhe KKPB-ja ishin kompetente për të shqyrtuar këtë kontest dhe jo gjykatat.

26. Më 1 shkurt 2001, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë (nr. DS00053) në DPB në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23.

27. Gjykata e Qarkut në Gjilan, me anë të Aktgjykimit GŽ nr. 10/2001 të 23 prillit 2001, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kamenicë, duke e bazuar vendimin e saj në vendimin e asaj gjykate. Në vendimin e saj, Gjykata e Qarkut nuk u mor me çështjen e ngritur nga parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij se Gjykata Komunale kishte vendosur për kërkesën e tij, edhe pse në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 ajo nuk ishte kompetente për të bërë një gjë të tillë, pasi që parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë pranë DPB-së.

28. Më 26 qershor 2001, avokati i parashtruesit të kërkesës ushtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, e cila me vendim të 18 qershorit 2002 e hodhi poshtë revizionin si të paafatshëm.

29. Më 24 maj 2002, bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës parashtroi kërkesë të ngjashme (Nr. DS006436) në DPB në Nish në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23.

30. Më 28 qershor 2002, avokati i parashtruesit të kërkesës ushtroi ankesë ndaj vendimit të Gjykatës Supreme, sipas të cilit revizioni ishte i paafatshëm, në të njëjtën gjykatë, duke bashkëngjitur si provë fletëdorëzimin që përmbante datën kur i ishte dorëzuar atij vendimi i Gjykatës së Qarkut. Si rezultat i kësaj Gjykata Supreme e pranoi ankesën për shqyrtim.

31. Më 18 qershor 2004, KKPB-ja me vendimin nr. HPCC/D/194/2005/C, në lidhje me 61 paraqitës të kërkesave (përfshirë parashtruesin e kërkesës dhe bashkëshorten e tij) të përmendur në Urdhër, urdhëroi që:

1. Paraqitësit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, varësisht nga rasti, t'i jepet posedimi mbi pronën që kërkohet;

2. Pala përgjegjëse apo cilido person tjetër që banon në pronë, ta lëshojë atë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, që nga dita e marrjes së këtij urdhri; dhe

3. Nëse pala përgjegjëse apo cilido person tjetër që e banon në pronë, nuk i përmbahet urdhrit për lirimin e pronës brenda afatit të caktuar, do të dëbohet nga aty.

32. Në pjesën e arsyetimit të Urdhrit, KKPB-ja vendosi që ishte e mjaftueshme që, mes tjerash, paraqitësi i kërkesës, në bazë të provave të paraqitura, në secilin nga rastet ka provuar prima facie se paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, varësisht nga rasti, ka pasur të drejtë pronësore mbi pronën që kërkohet; se i padituri në secilin nga rastet ka ofruar përgjigje në kërkesë që nuk përbën kundërshtim të vlefshëm*;*dhe se paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, varësisht nga rasti,

ka qenë në posedim të pakontestueshëm të pronës para 24 marsit 1999.

33. KKPB-ja më tej gjeti se, sa i përket kërkesave DS200053 dhe DS006436 [të parashtruesit të kërkesës dhe bashkëshortes së tij], të padituri [KARAÇEVA dhe të tjerët] nuk kanë paraqitur ndonjë mbrojtje të vlefshme ndaj kërkesës së paraqitësve [të parashtruesit të kërkesës dhe bashkëshortes së tij], por kishin iniciuar procedurë gjyqësore për të shfuqizuar kontratat e shitblerjes të lidhura në mes të paraqitësit të kërkesës [parashtruesit të kërkesës] dhe bartësit të ndarjes së banesës ["KARAÇEVA"].

34. Më 30 dhjetor 2004, Gjykata Supreme e Kosovës e hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion në rastin në lidhje me anulimin e kontratës së shitblerjes, të iniciuar nga ndërmarrja KARAÇEVA më 13 korrik 2000, duke theksuar se Gjykata e Qarkut i kishte vlerësuar drejt faktet e konstatuara nga ana e Gjykatës Komunale dhe se e kishte arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme vendimin e saj. Gjykata Supreme, në vendimin e saj, nuk iu referua argumenteve të parashtruesit të kërkesës se Gjykata e Qarkut e injoroi parashtrimin e tij, sipas të cilit Gjykata Komunale kishte vendosur për një kërkesë që, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 të 15 dhjetorit 1999, nuk ishte në juridiksionin e saj pasi që vetëm DPB-ja dhe KKPB-ja ishin kompetente për këtë çështje. Po ashtu, Gjykata Supreme nuk përmendi Urdhrin e KKPB-së të 18 qershorit 2004, të cilit i ishte referuar parashtruesi i kërkesës..

35. Më 18 korrik 2005, Sekretari i KKPB-së lëshoi vendimin e certifikuar me të cilin vërtetonte vendimin e KKPB-së të datës 18 qershor 2005 në lidhje me kërkesat nr. DS200053/DS006436, të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës dhe bashkëshortja e tij.

36. Me vendim nr. HPPCC/REC/66/2006, të 15 korrikut 2006, KKPB-ja e hodhi poshtë kërkesën për rishqyrtim në lidhje me kërkesat nr. DS200053/DS006436, të paraqitur nga ana e uzurpuesit të banesës, duke theksuar se:

"Në kërkesat nr. DS20053/DS006436 Pala Kërkuese [uzurpuesi], e cila është palë e interesuar dhe që nuk ka marrë pjesë në kërkesën fillestare, pohon se prona e kërkuar nuk ishte pronë banimi. Megjithatë, ai pranon se është shndërruar në pronë banimi në vitin 1991. Si dëshmi tregon se prona e kërkuar në mënyrë ligjore është shndërruar në pronë të banimit, rasti është nën juridiksion të Komisionit dhe, si Paraqitës C në procedurën e shkallës së parë ka dëshmuar të drejtën pronësore së paku në formën e posedimit të ligjshëm të pronës së kërkuar, kërkesa për rishqyrtim qëndron të refuzohet."

37. Më 4 shtator 2006, vendimi i veçantë i KKPB-së për kërkesat e parashtruesit të kërkesës dhe bashkëshortes së tij, me nr. DS200053/DS006436, u certifikua nga ana e sekretarit të KKPB-së.

38. Më 1 nëntor 2006, UN-HABITAT-i (i cili menaxhonte me DPB-në dhe KKPB-në deri kah mesi i vitit 2002 para se t'ia dorëzonte UNMIK-ut) ua dorëzoi çelësat e banesës së bashku me protokollin e dorëzimit parashtruesit të kërkesës, i cili siç duket jeton aty me familjen e tij që atëherë.

39. Me shkresën e datës 7 maj 2008, KKPB-ja e siguroi parashtruesin e kërkesës se vendimi HPCC/REC/66/2006 ishte i formës së prerë, dhe në pajtim me nenin 2, paragrafin 7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23, nuk mund t'i nënshtrohej rishqyrtimit nga asnjë gjykatë apo organ administrativ në Kosovë.

40. Më 14 janar 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Komunale në Kamenicë për përsëritjen e procedurës, duke kërkuar që e njëjta të shfuqizonte vendimin e saj të 26 shtatorit 2000 me të cilin i kishte shpallur të pavlefshme kontratën për shfrytëzimin dhe kontratën e blerjes së banesës. Ai

e njoftoi Gjykatën Komunale se, si pronar i banesës në Kamenicë, ai kishte paraqitur përmes Zyrës së Këshillit Norvegjez për Refugjatë kërkesë në DPB/KKPB në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe se, me vendim të certifikuar të 28 korrikut 2005 KKPB-ja ia kishte kthyer banesën në posedim, ndërsa personi që e kishte nxënë banesën ishte urdhëruar që të largohej nga prona në afat prej 30 ditësh nga dita e njoftimit. Ai më tej, e informoi Gjykatën Komunale se kërkesa e uzurpuesit për rishqyrtim ishte refuzuar me "Vendim të Certifikuar në lidhje me Kërkesën për Rishqyrtim të 4 shtatorit 2006", të nxjerrë nga ana e KKPB-së, për arsye se provat kishin treguar se prona e kërkuar ishte shndërruar në mënyrë të ligjshme në pronë banimi dhe se rrjedhimisht ishte në juridiksion të KKPB-së, dhe se parashtruesi i kërkesës kishte provuar në procedurën e shkallës së parë të drejtën pronësore, të paktën në formën e posedimit të ligjshëm të pronës, për të cilën ishte bërë kërkesa.

41. Më 11 janar 2010, Gjykata Komunale në Kamenicë me Vendimin nr. 36/2000 e refuzoi kërkesën për përsëritje të procedurës si të paafatshme. Gjykata theksoi se parashtruesi i kërkesës kishte siguruar prova të reja më 15 shtator 2006, pasi që ai e mori Vendimin e Certifikuar në lidhje me Rishqyrtimin Nr. DS200053&DS006436 të organit të shkallës së dytë të DPB më 15 shtator 2006, ndërsa vendimi i organit të shkallës së parë iu dorëzua atij më 28 korrik 2005. Kjo gjykatë ishte e mendimit se propozimi për përsëritjen e procedurës, i paraqitur në gjykatë më 14 janar 2009, duhej dorëzuar në afat prej 30 ditësh nga dita kur pala është në gjendje të paraqes fakte apo prova të reja në gjykatë, në pajtim me nenin 423 (1) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Gjykata më tej vlerësoi se parashtruesi i kërkesës e mori vendimin e organit të shkallës së parë të KKPB-së më 28 korrik 2005 dhe vendimin e organit të shkallës së dytë të KKPB-së më 15 shtator 2006, dhe rrjedhimisht, ishte në gjendje që t'i ofronte gjykatës prova të reja që nga data 15 shtator 2006. Në vend të kësaj, parashtruesi i kërkesës e paraqiti propozimin për përsëritjen e procedurës më 14 janar 2009, pra pas më shumë se dy vitesh nga kalimi i afatit prej 30 ditësh, që llogaritet nga dita kur parashtruesi i kërkesës i mori vendimet. Gjykata prandaj konkludoi se propozimi i parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës ishte dorëzuar pas afatit dhe si i tillë duhej refuzuar.

42. Pastaj, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan duke theksuar se Gjykata Komunale gabimisht e kishte zbatuar të drejtën materiale kur nuk e kishte marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23, e cila parasheh që vendimet e formës së prerë të KKPB-së janë të obligueshme dhe të zbatueshme dhe nuk mund t'i nënshtrohen rishqyrtimit nga asnjë organ gjyqësor në Kosovë.

43. Më 7 qershor 2010, Gjykata e Qarkut në Gjilan me Vendim GŽ. Nr. 78/2010 e hodhi poshtë ankesën si të pabazuar dhe e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale në Kamenicë. Gjykata e Qarkut konstatoi se, më 28 korrik 2005 KKPB kishte vendosur t'ia kthejë parashtruesit të kërkesës pronën e kërkuar në posedim, ndërsa ankesa e ushtruar nga ana e uzurpuesit të banesës ishte refuzuar me Vendim të Certifikuar të KKPB-së në lidhje me kërkesën për rishqyrtim duke theksuar se parashtruesi i kërkesës ishte pronar i pronës.

44. Gjykata e Qarkut më tej theksoi se sa i përket propozimit të mëpastajmë të parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës, Gjykata Komunale kishte konkluduar se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar vendimin e organit të shkallës së parë të KKPB-së më 28 korrik 2005, ndërsa vendimin e organit të shkallës së dytë të KKPB-së më 15 shtator 2006, dhe rrjedhimisht kishte gjetur se propozimi për përsëritjen e procedurës ishte i paafatshëm pasi që parashtruesi i kërkesës nuk e kishte dorëzuar propozimin në afat prej 30 ditësh nga data kur vendimi i ishte dorëzuar atij.

45. Më 29 qershor 2010, Vendimi GZ. Nr. 78/2010 i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit iu dorëzua parashtruesit të kërkesës, por nuk përmbante këshillën për mjetin juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës për të ushtruar ankesë ndaj këtij vendimi. Parashtruesi i kërkesës sqaron se nuk ka ushtruar ankesë në Gjykatë Supreme ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut, pasi që ai vendim nuk përmbante udhëzim për mjetin juridik dhe se nuk ka pasur mundësi të angazhojë avokat për shkak të shpenzimeve, pasi që shpenzimet në kërkimin e tij për drejtësi deri më tani arrinin në rreth 2000 euro.

46. Më 6 korrik 2010, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Zyra Komunale e Kadastrës (në tekstin e mëtejmë: ZKK) në Kamenicë që të bëjë regjistrimin e të drejtave të tij pronësore mbi atë pjesë të ndërtesës – banesës, në bazë të kontratës së blerjes dhe bashkëngjiti kopje të kontratave të blerjes dhe të shfrytëzimit si dhe Vendimin e Certifikuar të KKPB-së në lidhje me kërkesën për rishqyrtim dhe Protokollin e dorëzimit të çelësave të banesës, të datës 1 nëntor 2006.

47. Më 4 gusht 2010, ZKK e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës me ç'rast parashtruesi i kërkesës kërkoi nga ZKK-ja, me shkresë të datës 9 gusht 2010, që të rishqyrtonte kërkesën e tij në bazë të të dhënave të ofruara.

48. Në vendimin e saj Nr. 280/10 të 24 gushtit 2010, ZKK bëri me dije se e kishte siguruar historinë gjyqësore të rastit të parashtruesit të kërkesës të lartpërmendur nga Gjykata Komunale, duke përfshirë rezultatin e kërkesës së parashtruesit, të datës 29 qershor 2010, për Përsëritje të Procedurës në Gjykatën e Qarkut (Vendimi GZ. Nr. 78/2010). ZKK-ja po ashtu, ishte njoftuar nga AKP-ja se kërkesat për rishqyrtim në lidhje me pronën e parashtruesit të kërkesës ishin hedhur poshtë, por me sa duket prona i ishte kthyer parashtruesit të kërkesës.

49. ZKK-ja vlerësoi se, në kuptim të nenit 3. 4 (iii) ("nëse validiteti i kërkesës ose ndonjë nga dokumentet mbështetëse është në pyetje") të Ligjit Nr. 2002/ (Ligji për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme), kërkesa e parashtruesit për regjistrim të pronës së paluajtshme ishte hedhur poshtë. ZKK-ja bëri me dije se parashtruesi i kërkesës kishte të drejtë të ushtrojë ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës në Prishtinë brenda 30 ditësh nga dita kur i është komunikuar ky vendim.

50. Po ashtu më 24 gusht 2010, parashtruesi i kërkesës i dërgoi letër Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) në të cilën i sqaroi detajet e rastit të tij, duke përfshirë faktin se KKPB i kishte certifikuar të

drejtat e tij pronësore mbi banesën, se i kishte marrë çelësat nga HABITAT-i më 1 nëntor 2006 dhe se ai e familja e tij po jetonin aty që atëherë. Parashtruesi i kërkesës më tej tregoi se KARAÇEVA, prej së cilës ai e kishte blerë banesën, ishte shitur dhe se rrjedhimisht Agjencia e Kosovare e Privatizimit po e administronte atë duke i konsideruar vendimet e gjykatave dhe të KKPB-së si jo të obligueshme dhe të pavlefshme. Prandaj, ai kërkoi nga AKP-ja që të ndikonte tek ZKK-ja ashtu që kjo e fundit të zbatonte dhe të respektonte ligjin në mënyrë që t'ia mbronte të drejtat e njeriut dhe të drejtat ligjore. Parashtruesi i kërkesës, me sa duket, nuk ka marrë ndonjë përgjigje deri më tani.

51. Më 21 shtator 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës në Prishtinë, duke pretenduar se ZKK-ja kishte shkelur dispozitat e Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative kur hodhi poshtë kërkesën për regjistrimin e të drejtave pronësore mbi banesën në fjalë, sepse nuk kishte marrë parasysh dhe as që kishte dhënë arsyet e refuzimit të përmbarimit të vendimit të KKPB-së që ishte i formës së prerë dhe i zbatueshëm në bazë të ligjeve të Kosovës dhe me atë rast kishte zbatuar gabimisht Ligjin për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Agjencia Kadastrale e Kosovës që të bënte regjistrimin e banesës në emër të tij. Rasti, siç duket, është ende në procedurë e sipër.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

52. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet P. Posl. Nr. 36/2000 të Gjykatës Komunale në Kamenicë, të 26 shtatorit 2000; GŽ nr. 10/2001 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të 23 prillit 2001; Rev nr. 141/2003 të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, të 30 dhjetorit 2004; dhe vendimet P. Posl. Nr. 36/2000 të Gjykatës Komunale në Kamenicë, të 11 janarit 2010 e GŽ nr. 10/2001 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të 7 qershorit 2010, i është cenuar e drejta për të gëzuar pronën e tij personale si dhe e drejta për siguri juridike sepse ekziston një dualitet i vendimeve gjyqësore dhe administrative.

53. Parashtruesi i kërkesës po ashtu, pohon se në ndërtesë gjendet edhe një banesë pronar i së cilës është një punëtor i të njëjtës firmë. Ai punëtor kishte lidhur kontratë të blerjes me të njëjtat kushte siç kishte bërë edhe parashtruesi i kërkesës, por ndaj tij nuk ishte iniciuar padi. Parashtruesi i kërkesës mendon se arsyeja pse padia është ushtruar vetëm ndaj tij është se ai është serb.

54. Më tej, ai kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të vërtetojë vendimet nr. HPCC/D/194/2005/C të 18 qershorit 2005 dhe nr. HPCC/REC/66/2006 të 15 korrikut 2006, të cilat i ka nxjerrë HABITAT-i dhe me anë të së cilave urdhërohet që t'i kthehet pronësia mbi pronën në fjalë.

55. Parashtruesi i kërkesës më tej thekson se banesa gjendet në tokë në pronësi shoqërore dhe se ndërmarrja "KARAÇEVA" nuk ekziston më pasi që e njëjta është privatizuar; prandaj Agjencia Kosovare e Privatizimit menaxhon me tokën dhe as nuk ia njeh pronësinë mbi banesën e referuar në vendimet gjyqësore dhe as nuk lejon Agjencinë Kadastrale që të bëjë regjistrimin e banesës në emër të tij.

56. Parashtruesi i kërkesës pret se do të dëbohet edhe një herë nga banesa, edhe pse sipas mendimit të tij vendimet e DPB-së janë të formës së prerë dhe të obligueshme dhe si të tilla duhet të pranohen. Ai pretendon se aktgjykimet e lartpërmendura ia cenojnë të drejtën për të gëzuar pronën personale dhe të drejtën për siguri juridike.

Ligji i zbatueshëm

57. Dispozitat të cilave iu referohet KKPB-ja në vendimet e veta janë të definuara në instrumentet e mëposhtme ligjore:

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/23 për themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore:

Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore

[...]

Neni 1.2 Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Drejtoria merr dhe regjistron kategoritë e mëposhtme të kërkesave që kanë të bëjnë me pronën banesore, duke përfshirë këtu edhe pronën e shoqëruar me të;

Kërkesat e personave fizikë, pronësia, posedimi ose e drejta e banimit në pronën e patundshme banesore të të cilëve u është revokuar pas datës 23 mars 1989 në bazë të legjislacionit i cili është diskriminues si në zbatim ashtu edhe në qëllimet e tij;

Kërkesat e personave fizikë që kanë bërë transaksione jozyrtare me prona të patundshme banesore në bazë të vullnetit të lirë të palëve pas datës 23 mars 1989;

Ankesat e personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit në pronën banesore para datës 24 mars 1999, e që tani nuk e kanë atë pasuri në posedim, dhe kur e drejta e pronësisë nuk është transferuar vullnetarisht."

Drejtoria i ia paraqet këto kërkesa Komisionit për Ankesa Pronësore dhe Banesore ose, nëse e sheh të përshtatshme, kërkon të ndërmjetësojnë në këto mosmarrëveshje dhe kur nuk

ka sukses, ia drejton ato për zgjidhje Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.

[...]"

Neni 2:

Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore

2.1 Komisioni për kërkesa pronësore dhe Banesore ("Komisioni") është organ i pavarur i Drejtorisë, i cili i zgjidh mosmarrëveshjet private jotregtare që kanë të bëjnë me pronën banesore të cilat ia parashtron Drejtoria, derisa Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të gjykojë se gjykatat lokale janë në gjendje të kryejnë funksionet që i janë besuar Komisionit.[...]

2.7 Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për t'u zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/60 e 31 tetorit 2000

[...]

Neni 2.4: "Çdo person që ka fituar të drejtën e pronësisë në një pronë nëpërmjet ndonjë transaksioni jozyrtar ndërmjet datës

23 mars 1989 dhe 13 tetor 1999, bazuar në vullnetin e lirë të palëve, ka të drejtë në urdhëresën e Drejtorisë ose të Komisionit për regjistrimin e pronësisë së vet në regjistrat përkatës publikë. Një urdhër i këtillë nuk e liron kërkuesin nga asnjë detyrim për të paguar çfarëdo takse apo tatimi lidhur me pronën ose qarkullimin e pronës."

Neni 2.5: " Çdo refugjatë ose person i zhvendosur, me të drejtë mbi pronën, gëzon të drejtën e kthimit të pronës ose të disponojë me të në pajtim me ligjin dhe në përputhje me këtë rregullore."

Neni 2.6: "Çdo person me të drejtë pronësie më 24 mars 1999, i cili e ka humbur pronësinë mbi atë pronë dhe nuk ka hequr dorë vullnetarisht nga e drejta e pronësisë, ka të drejtë të marrë vendim nga Komisioni për riposedim të pronës. Komisioni nuk do të pranojë kërkesa për kompensimin e dëmtimeve apo të shkatërrimeve të pronës."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

58. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregulloren e punës.

59. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet 113.7 të Kushtetutës, i cili parashikon si në vijim:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

*S*i dhe nenit 47.2 të Ligjit i cili përcakton që:

Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

60. Gjykata rikujton se një kriter i ngjashëm i pranueshmërisë parashihet me nenin 35 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

61. Në këtë kuptim, Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës, dhe se rendi juridik i vendit do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ Selmouni kundër Francës, nr. 25803194, vendim i datës 28 korrik 1999). Sidoqoftë, nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese të ngritën në mënyrë eksplicite gjatë procedurave në fjalë. Deri sa kjo çështje është ngritur në mënyrë implicite ose substanciale, kërkesa për shterimin e mjeteve është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, nr. 56679/00, Vendimi i datës 28 prill 2004).

62. Gjykata e përdori arsyetimin e njëjtë kur nxori Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin nr. KI 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K. kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 27 janarit 2010, dhe në rastin nr. KI 73/09, Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të 23 marsit 2010.

63. Sa i përket kësaj kërkese, Gjykata vëren se, më 15 korrik 2006 KKPB e hodhi poshtë kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga pala kundërshtare e parashtruesit të kërkesës ndaj vendimit të KKPB-së të 28 korrikut 2005, me të cilin parashtruesit të kërkesës i ishte dhënë në posedim prona e kërkuar. Më 4 shtator 2006, vendimi i KKPB-së me të cilin u hodh poshtë kërkesa për rishqyrtim u certifikua nga Sekretari i KKPB-së, pas të cilit, më 1 nëntor 2006 UN HABITAT-i ia dorëzoi parashtruesit të kërkesës çelësat e banesës së bashku me Protokollin e dorëzimit.

64. Gjykata është e mendimit se Vendimi i KKPB-së i datës 15 korrik 2006 duhet konsideruar si vendim i formës së prerë dhe që është bërë *res judicata* me rastin e certifikimit nga ana e sekretarit të KKPB-së më 4 shtator 2006, siç konfirmohet me Letrën e Konfirmimit të KKPB-së të 7 majit 2008 drejtuar parashtruesit të kërkesës. Në këtë letër po ashtu, thuhej se procedura në lidhje me kërkesën e parashtruesit i ishte bartur Drejtorisë së Çështjeve Pronësore Banesore në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe se kishte përfunduar, ndërsa mjetet juridike në dispozicion të palëve në bazë të dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 ishin shterur.

65. Në letër me tutje theksohej se Vendimi HPCC/REC/66/2006 ishte i formës së prerë dhe, në pajtim me nenin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23, nuk mund t'i nënshtrohej rishqyrtimit nga asnjë gjykatë apo organ administrativ në Kosovë.

66. Në këto rrethana, Gjykata konludon se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion në bazë të ligjit të zbatueshëm.

Vlerësimi i meritave të kërkesës

67. Sa i përket vlerësimit të meritave të kësaj kërkese, Gjykata vëren se ligj i aplikueshëm në kohën e ngjarjeve që përbëjnë bazën e

ankesës së parashtruesit të kërkesës ishte Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/23 për themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DPB) dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB), dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 mbi kërkesat pronësore dhe banesore dhe rregullat e procedurës e të provave të Drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore si dhe të Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore, e 31 tetorit 2000.

68. Neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23, *inter alia,* parashikon që "*Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Drejtoria merr dhe regjistron kategoritë e mëposhtme të kërkesave që kanë të bëjnë me pronën banesore, duke përfshirë këtu edhe pronën e shoqëruar me të; [...] Ankesat e personave fizikë të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose që kanë pasur të drejtën e banimit në pronën banesore para datës 24 mars 1999, e që tani nuk e kanë atë pasuri në posedim, dhe kur e drejta e pronësisë nuk është transferuar vullnetarisht".*

69. Për më tepër, neni 2.5 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 përcakton se: *Si përjashtim nga juridiksioni i gjykatave lokale, Komisioni ka kompetencë ekskluzive për të zgjidhur kategoritë e kërkesave të theksuara në paragrafin 1.2. të kësaj Rregulloreje [...]. Ndërsa neni 2.7 përcakton se "Vendimet përfundimtare të Komisionit janë të detyrueshme për t'u zbatuar dhe nuk janë subjekt i rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë."*

70. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në Vendimin HPCC/REC/66/2006, të 15 korrikut 2006, KKPB-ja gjeti se, "*Si dëshmi tregon se prona e kërkuar në mënyrë ligjore është shndërruar në pronë të banimit, rasti është nën juridiksion të Komisionit (KKPB) [...].* Gjykata është e mendimit se kjo do të thotë që prona e kërkuar nga parashtruesi i kërkesës ishte trajtuar në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23 që nga hyrja e saj në fuqi më 15 nëntor 1999, dhe se gjykatat vendore nuk ishin më kompetente të merreshin me kërkesat pronësore që hynin në kuadër të nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut, sikur që është kërkesa pronësore e parashtruesit të kërkesës.

71. Në këtë kuptim, Gjykata gjen se më 13 korrik 2000, kur Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 me të vërtetë kishte hyrë në fuqi, KARAÇEVA ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Kamenicë kundër parashtruesit të kërkesës, i cili ishte larguar nga ndërtesa me urdhër të ndërmarrjes KARAÇEVA, duke kërkuar nga gjykata që të anulonte kontratat për shfrytëzimin dhe shitblerjen e banesës të nënshkruara nga parashtruesi i kërkesës dhe KARAÇEVA, më 20 prill 1993.

72. Gjykata më tej vëren se më 7 shtator 2000, Këshilli Norvegjez i Refugjatëve në Kralevë e njoftoi Gjykatën Komunale në Kamenicë se, me kërkesë të parashtruesit të kërkesës, ia kishte përcjellë kërkesën e tij në lidhje me pronësinë e banesës DPB-së dhe KKPB-së së porsaformuar dhe se, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23, çështja duhet të jetë në juridiksionin ekskluziv të KKPB-së. Këshilli rrjedhimisht kërkoi nga Gjykata Komunale që menjëherë të ndërpriste procedurën e mëtutjeshme në lidhje me padinë për shkak se nuk ishte kompetente.

73. Gjykata po ashtu, vëren se Gjykata e Qarkut e vërtetoi padinë e KARAÇEVËS pa iu referuar Rregullores së UNMIK-ut 1999/23, dhe se jo vetëm që Gjykata e Qarkut e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës më 23 prill 2001 pa iu referuar argumenteve të tij përkitazi me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23, por edhe Gjykata Supreme në vendimin e saj të 30 dhjetorit 2004 e injoroi informacionin e parashtruesit të kërkesës, sipas të cilit KKPB tashmë kishte vendosur me Urdhër HPCC/D/194/2005/C, të 18 qershorit 2004, që atij t'i kthehej prona në posedim. Siç u përmend më lart, Urdhri i KKPB-së u vërtetua me Vendimin e KKPB-së Nr. HPCC/REC/66/2006, të 15 korrikut 2006, që në bazë të nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut ishte i formës së prerë dhe ishte bërë *res judicata* dhe rrjedhimisht i zbatueshëm më 4 shtator 2006. Si rezultat, UN Habitati ia dorëzoi çelësat e banesës parashtruesit të kërkesës së bashku me protokollin e dorëzimit më 1 nëntor 2006.

74. Për më tepër, Gjykata vëren se me shkresën e datës 7 maj 2008, të përmendur më lart, KKPB-ja e siguroi parashtruesin e kërkesës se Vendimi i tij HPCC/REC/66/2006 ishte i formës së prerë dhe në pajtim me nenin 2, paragrafin 7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 nuk mund t'i nënshtrohej rishqyrtimit nga asnjë gjykatë apo organ administrativ në Kosovë.

75. Gjykata është e mendimit se kjo vetëm mund të kuptohet që, pasi që konkluzioni i KKPB-së i 15 korrikut 2006 u bë *res judicata* më 4 shtator 2006, parashtruesi i kërkesës e ka gëzuar të drejtën e posedimit të pronës, siç garantohet me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, dhe se çdo ndërhyrje në këtë të drejtë, nga cilado gjykatë apo organ administrativ, do të duhej konsideruar shkelje e asaj të drejte.

76. Sidoqoftë, deri më tani përpjekjet e parashtruesit të kërkesës pranë gjykatave dhe organeve kompetente administrative për ta zbatuar vendimin e KKPB-së, kanë përfunduar pa sukses dhe kanë krijuar gjendje të pasigurisë juridike për parashtruesin e kërkesës dhe të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, edhe pse ai dhe familja e tij tani janë duke banuar në këtë pronë.

77. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të Strasburgut nga neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së, ku GJEDNJ ka vendosur *inter alia* se autoritetet kompetente kanë obligimin pozitiv që të organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, si dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme (shih për shembull Pecevi kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008).

78. Është e vërtetë se në rastin konkret është nënshkruar një memorandum në mes të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) me datë 13 korrik 2009, ku *inter alia* përcaktohet që: *AKP-ja do t'i sigurojë AKK-së kopje elektronike të vendimeve të formës së prerë të Komisionit për*

Kërkesa Pronësore Banesore me qëllim të azhurnimit të të dhënave kadastrale", por fakti qëndron se, edhe pas gjashtë vitesh nga vendimi i KKPB-së i 15 korrikut 2006, e drejta parashtruesit të kërkesës për posedimin e pronës në fjalë ende nuk është regjistruar në bazën përkatëse të të dhënave të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

79. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se gjykatat si dhe organet administrative në fjalë ishin përgjegjëse që të merrnin parasysh në mënyrën e duhur procedurat e zhvilluara në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 pranë DPB-së dhe KKPB-së, në të cilat ishte i përfshirë parashtruesi i kërkesës, dhe që të zbatonin vendimet e tyre.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në seancën e mbajtur më 13 dhjetor 2011, njëzëri

VENDOSI

I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. KONSTATON se ka pasur shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 [E drejta e pronës] të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.

III. UA RIKUJTON autoriteteve kompetente obligimet e tyre në bazë të rregullit 63 [Zbatimi i vendimeve] të Rregullores së Punës të Gjykatës.

IV. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe gjykatave përkatëse, si dhe Agjencisë Kosovare të Pronës dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës;

V. Në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ky Aktgjykim do të publikohet në Gazetën Zyrtare.

VI. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë dhe mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Prof. Dr. Ivan Čukalović	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 08/11 datë 10 maj 2012- Malush Sopa, Sedat Kuqi, Fazli Morina, Rrahman Kabashi dhe Liman Gashi kundër Autoritetit të panjohur publik

Rasti KI 08/11, vendim i 24 prillit 2012.

Fjalët kyçe: agjencia kosovare e privatizimit, cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese, dhoma posaçme e gjykatës supreme të Kosovës, kërkesë individuale, mos shterje e mjeteve juridike, parimi i subsidiaritetit, person juridik.

Parashtruesit paraqitën kërkesën bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese janë cenuar nga vendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, me ç'rast u vërtetua vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me privatizimin e ndërmarrjes shoqërore "Suhareka" në Suharekë. Parashtruesit pohuan se Dhoma Posaçme e Gjykatës Supreme ka cenuar të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara *mes tjerash* me nenet 23, 24, 31, 32, 44, 53, 54, 84.6, 102, 103, 104, dhe 119 të Kushtetutës së Kosovës. Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesve ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 36 të Rregullores së Punës për shkak se parashtruesit *mes tjerash* pikësëpari nuk kishin respektuar parimin e subsidiaritetit që nënkupton shterimin hap pas hapi të mjeteve juridike. Gjykata po ashtu aryetoi vendimin e saj duke theksuar se parashtruesit nuk kishin saktësuar se cilat të drejta dhe liri u janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik që parashtruesit e kontestojnë. Duke cituar vendimin e GJEDNJ-së, *Scordino kundër Italisë,* Gjykata më tutje arsyetoi se parashtruesit nuk kanë mbështetur me prova pohimet për cenim të të drejtave dhe lirive kushtetuese. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesve si të papranueshme.

Prishtinë, më 24 prill 2012

Nr. ref.: RK223/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 08/11

Parashtrues të kërkesës

Malush Sopa, Sedat Kuqi, Fazli Morina, Rrahman Kabashi dhe Liman Gashi

kundër

Autoritetit të panjohur publik

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtrues të kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Malush Sopa, në cilësinë e kryetarit të Sindikatës së Pavarur të NBI "Suhareka" në Suharekë, Sedat Kuqi, ish-drejtor i NBI "Suhareka" në Suharekë, Fazli Morina, drejtor i Vreshtarisë, Rrahman Kabashi, drejtor i Verëtarisë në fshatin Mohlan, dhe Liman Gashi, drejtor komercial në Suharekë.

2. Parashtruesit e kërkesës parashtruan një sërë dokumentesh në Gjykatën Kushtetuese, të cilat i quajtën "Vërejtje para padisë".

Ata dorëzuan autorizimin për t'i përfaqësuar tetëdhjetë (80) ish punëtorët e "Suharekës".

3. "Gjykata Kushtetuese e Kosovës - Kryetari" është ndër 12 (dymbëdhjetë) autoritetet publike të adresuara, të cilëve ua dërguan "Vërejtjen para padisë".

Vendimi i kontestuar

4. Lënda e atij memorandumi është: "Vërejtje para padisë kundër zvarritësve të lëndës SCC-09-0213, të 31.01.2011, sipas padisë së 16 nëntorit 2009 dhe ankesës Nr. 474, të 15.02.2011" dhe ka të bëjë me blerjen e NBI "Suhareka" sh.p.k., në Suharekë.

5. Parashtruesit pohojnë që, *"Më 19 nëntor 2009, Sindikata e Pavarur e NBI "Suhareka" në Suharekë, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar me autorizimin e 23 tetorit 2009, i ka paditur: 1) Agjencinë Kosovare të Privatizimit në Prishtinë; 2) QMI – Qendrën e Mobileve Italiane, Sh.p.k., me seli në Suhodoll të komunës së Lipjanit; 3) Gruppo Vinicolo Fantinel Spa nga Italia, kjo padi mund të gjendet në lëndën SCC-09-0213".*

6. Parashtruesit më tej theksojnë që, *"Më 31 janar 2011, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (...) lëshoi (...) Vendim*

me të cilin e hedh poshtë padinë tonë si të papranueshme dhe pa asnjë bazë, edhe pse në çështjen ligjore SCC-09-0213 të gjitha faktet dhe provat u ishin bashkëngjitur dokumenteve që u nënshkruan më 28 nëntor 2006 në Treviso të Italisë për mashtrim dhe konspiracion kundër kolektivit tonë".

7. Së fundi, parashtruesit theksojnë që, "M*ë 15 shkurt 2011, Sindikata e Pavarur e NBI "Suhareka" në Suharekë e ka parashtruar, brenda afatit ligjor, ankesën Nr. 474 në Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë dhe i ka njoftuar të gjitha misionet vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë për (...) Vendimin SCC-019-0213 të 31 janarit 2011 kundër kolektivit tonë në kundërshtim me nenin 346 të KPK-së dhe nenit 102, paragrafëve 2, 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (...)".*

Çështja e lëndës

8. Parashtruesit e dorëzuan "Vërejtjen para padisë" në Gjykatën Kushtetuese, në mesin e shumë dispozitave të tjera ligjore, "në pajtim me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për mjete juridike], 44 [Liria e Asociimit], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 84.6 [Kompetencat e Presidentit], 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave], 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i

Gjyqtarëve], 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".

Baza juridike

9. Nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

10. Më 26 janar 2011, parashtruesit e dorëzuan "Vërejtjen para padisë" të përmendur më sipër.

11. Më 14 shkurt 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

12. Më 16 shkurt 2011, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë dhe gjithashtu ua dërguan dokumentet e

sipërpërmendura shtesë 12 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.

13. Më 1 qershor 2011, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë dhe përsëri ua dërguan dokumentet e sipërpërmendura 12 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.

14. Më 26 korrik 2011, Ndërmarrja Shërbyese "Ekspertimi" dorëzoi në Gjykatë një dokument të quajtur "Mendimi financiar" në lidhje me kërkesën e parashtruesit. Të njëjtën datë, ndërmarrja e sipërpërmendur ua dërgoi dokumentin e sipërpërmendur 11 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.

15. Më 28 korrik 2011, Ndërmarrja Shërbyese "Ekspertimi" dorëzoi një letër në Gjykatë, me anë të së cilës i sqaronte disa gabime teknike në dokumentin e quajtur "Mendimi financiar", të cilin e dorëzoi në Gjykatë më 26 korrik 2011.

16. Më 2 gusht 2011, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë, dhe ua dërguan dokumentet e sipërpërmendura 14 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.

17. Më 2 gusht 2011, Ndërmarrja Shërbyese "Ekspertimi" iu përgjigj pyetjeve të Gjykatës, të parashtruara më 26 korrik 2011, lidhur me cilësinë e saj për ta dorëzuar në Gjykatë "Mendimin financiar" lidhur me kërkesën e parashtruesit.

18. Më 12 gusht 2011, parashtruesit u njoftuan për regjistrimin e "Vërejtjes para padisë" (kërkesës). Të njëjtën datë, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, QMI – Qendra e Mobileve Italiane dhe Gruppo Vinicolo Fantinel Spa, u njoftuan për regjistrimin e kërkesës; ata nuk kanë ofruar asnjë përgjigje deri më sot.

19. Më 17 gusht 2011, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë. Dokumentet e sipërpërmendura ua dërguan 16 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.

20. Më 5 shtator 2011, parashtruesit dorëzuan dokumente shtesë në Gjykatë dhe, përsëri, të njëjtat dokumente ua dërguan 18 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.

21. Më 14 shtator 2011, nga parashtruesit u kërkua t'i sqaronin dhe plotësonin disa aspekte të kërkesës që kishin të bënin kryesisht me: të dhënat personale të përfaqësuesit; të dhënat faktike për aktin/aktet e autoriteteve publike për të cilin/cilat ankohen; emrin e saktë të gjykatës ose të autoritetit publik për të cilin pohojnë se me veprimet ose lëshimet e veta ua ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë; të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë të cilat pohojnë se u janë shkelur; ankesën sipas Kushtetutës, që tregon cili nen i/cilat nene të Kushtetutës gjoja është/janë shkelur nga autoriteti publik dhe që

tregon pse akti i këtij autoriteti/aktet e këtyre autoriteteve përbën/përbëjnë shkelje të Kushtetutës; vendimin përfundimtar të gjykatës apo të autoritetit, nëse ka; dhe çka dëshirojnë të arrijnë përmes parashtrimit të kësaj kërkese në Gjykatë.

22. Më 20 shtator 2011, parashtruesit i dorëzuan pak a shumë të njëjtat dokumente, të cilat iu dërguan 19 autoriteteve të ndryshme në Republikën e Kosovës.

23. Më 4 tetor 2011, parashtruesit iu përgjigjën pyetjeve të Gjykatës duke dorëzuar të njëjtin grup të dokumenteve, por tani e dorëzuan edhe marrëveshjen e 27 gushtit 2007, të lidhur ndërmjet Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), në njërën anë, dhe QMI-së – Qendrës së Mobileve Italiane dhe Gruppo Vinicolo Fantinel Spa, në anën tjetër.

24. Më 23 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe Gjykatës i rekomandoi papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

25. Më 19 qershor 2006, Gjykata Komunale në Suharekë lëshoi *Aktgjykim në bazë të pohimit* C. nr. 217/05, duke u bazuar në padinë e parashtruesve kundër të padituréss NBI – NSH "Suhareka" në Suharekë, të cilën e përfaqësonte me autorizim

Nazim Elshani, avokat, lidhur me kompensimin e të ardhurave personale të punëtorëve për periudhën prej vitit 1991-1998, i cili përmbante me sa vijon:

"APROVOHET padia dhe kërkespadija e punëtorëve të NBI "Suhareka" në Suharekë, sipas regjistrit të dt. 11.11.2003. j cili gjindet në shkresat e landës prej 1 duke filluar nga punëtori Sadik Ahmeti e deri në 186 deri te punëtori Muhamet Elshani ndaj të padituës NBI "Suhareka" në Suharekë.

OBLIGOHET e paditura NBI "Suhareka" në Suharekë që të gjithë punëtorve sipas regjistrit te dt. 11.11.2003 i cili gjindet ne shkresat e landes nga nr. rendor 1 duke filluar nga punetori Sadik Ahmeti e deri te numri rendor 186 te punetori Muhamet Etshani te ia paguaj te ardhurat sipas regjistrit te punetorve si dhe Vendimeve te veqanta te Keshillit te punetorve secilit veq e veq te parapara ne regjisterin . dhe ate shuma e pergjithshme ae te gjithe punetorve sipas regjistrit e dt. 11.11.2003 e nenshkruar nga ana e komisjonit eshte 750.087,00 Euro. ne shume te pergjithshme pa kamat.

Ky aktgjykim mund te ekzekutohet ne momentin e privatizimit te ndermarjes NBI "Suhareka" ne Suhareke., per realizimin e kesaje te drejte".

26. Në arsyetimin e të njëjtit *Aktgjykim në bazë të pohimit*, Gjykata Komunale në Suharekë tha me sa vijon:

> *"Gjykata duke u bazuar ne pohimet e pef. Te punetorve dhe perf. te NBI "Suhareka" ne Suhareke se per kete qeshtje eshte e njoftuar edhe agjensioni i Mirebesiit vendosi qe kerkespadin te aprovoi ne teresi dhe te bjen Aktgjykim ne baze te pohimit 331 te LPC".*

27. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM) në vitin 2006-2007, gjatë valës së 19 të privatizimit me spin-off special, i shpalli QMI-në – Qendrën e Mobileve Italiane, me seli në Lipjan, dhe Gruppo Vinicolo Fantinel Spa, me seli në Spilimbergo (Pordenone) të Italisë, fitues të përkohshëm të tenderit të privatizimit.

28. Më 16 nëntor 2009, parashtruesit e kërkesës ushtruan padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS) kundër të padituve: Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, QMI– Qendra e Mobileve Italiane, me seli në Lipjan, dhe Gruppo Vinicolo Fantinel Spa, me seli në Spilimbergo (Pordenone) të Italisë, përmes të cilës kërkuan anulimin e privatizimit të NSH "Suhareka" në Suharekë, duke pohuar se fituesi i përkohshëm konspiroi me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) si shitës.

29. Më 21 janar 2010 dhe 23 shkurt 2010, DHPGJS lëshoi një urdhër me të cilin e udhëzonte parashtruesin lidhur me nevojën për përkthime, dhe që Sindikata duhet të jetë e përfaqësuar nga një avokat në DHPGJS.

30. Më 19 mars 2010, parashtruesi e dorëzoi përkthimin e padisë në DHPGJS. Parashtruesi kërkoi anulimin e privatizimit të NSH "Suhareka" në Suharekë, duke pohuar se fituesi i përkohshëm i tenderit të privatizimit konspiroi me Agjencinë Kosovare të Privatizimit si shitës. Më 30 korrik 2010, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në DHPGJS, duke theksuar lidhjen e mundshme kriminale të rastit.

31. Më 4 gusht 2010, DHPGJS përsëri lëshoi një urdhër me të cilin e udhëzonte parashtruesin që ta dorëzonte autorizimin dhe një instrument, ose instrumente, për themelimin e personit juridik (Sindikatës) në pajtim me nenet 24.1 dhe 25.4 të UA të UNMIK-ut 2008/6. Të njëjtën ditë, DHPGJS iu drejtua Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe kërkoi të mësonte nëse ka pasur hetime penale lidhur me pretendimet e parashtruesit. DHPGJS iu drejtua edhe Gjykatës Komunale në Suharekë për ta marrë një kopje të lëndës C. nr. 233/2009, të përmendur në padi.

32. Më 12 gusht 2010, Gjykata Komunale në Suharekë e dorëzoi dosjen e kërkuar, në të cilën deklaroi se nuk ishte kompetente dhe e informoi parashtruesin që DHPGJS ka juridiksion për këtë rast.

33. Më 25 gusht 2010, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në DHPGJS me të cilat e plotësonte padinë e vet. Më 23 shtator 2010, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në DHPGJS. Parashtruesi nuk i bashkëngjiti dokumentet e kërkuara nga DHPGJS-ja në asnjërën parashtresë.

34. Më 25 gusht 2010, gjithashtu, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ia konfirmoi DHPGJS-së se janë duke e intervistuar parashtruesin por nuk mund ta konfirmonte ekzistencën e një hetimi në vazhdim e sipër.

35. Më 24 shtator 2010, DHPGJS-ja edhe një herë e urdhëroi parashtruesin që ta dorëzonte autorizimin dhe një instrument, ose instrumente, për themelimin e personit juridik (Sindikatës) në pajtim me nenin 25.4 të UA të UNMIK-ut 2008/6. DHPGJS ofroi sqarim të detajuar në urdhrin me të cilën ia tërhiqte vërejtjen parashtruesit se dështimi për të vepruar në përputhje me këtë urdhër do të rezultojë në refuzim të padisë mbi bazën e papranueshmërisë.

36. Në kuadër të ankesës së vet të 11 tetorit 2010 kundër këtij urdhri, të plotësuar më 23 nëntor 2010, parashtruesi kërkoi *"që të*

përjashtohet nga vendimi në këtë lëndë Gjyqtarja e EULEX-it Esma Erterzi për shkak të sjelljes së saj të njëanshme ku ajo dha aktvendimin e paligjshëm, antikushtetues dhe diskriminues dhe duke mashtruar kolektivin tonë prej 237 punëtorësh sipas dispozitave ligjore", duke iu referuar në këtë mënyrë argumenteve të veta në ankesë se duhet t'i lejohet që të vetë-përfaqësohet dhe se nuk do *"të pranojë asnjë avokat nga askush"*.

37. Më 23 nëntor 2010, "Kërkesa për përjashtim" e parashtruesit u refuzua si e pabazuar me vendimin e Kryetarit të DHPGJS-së, me numrin AGJ-2010-132. Megjithatë, procedura e ankesës kundër urdhrit të Gjyqtares raportuese të DHPGJS-së, e 24 shtatorit 2010, është në procedurë e sipër. Megjithatë, Trupi Gjykues konsideron se ankesa kundër urdhrit të gjyqtares përgjegjëse nuk e pengon Trupin Gjykues që të marrë vendim për pranueshmëri të padisë.

38. Më 31 janar 2011, DHPGJS (Vendimi SCC-0213) hodhi poshtë si të papranueshme padinë e parashtruesit për anulimin e privatizimit të NSH "Suhareka". Në vendimin në fjalë, DHPGJS ia ofroi parashtruesit këtë këshillë ligjore:

"Pasi që Dhoma e Posaçme nuk ka lëshuar një Aktvendim për meritat e padisë, Paditësi mund të ushtrojë një padi të kompletuar apo të korrigjuar në bazë të Rregulloreve të

UNMIK-ut dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6."

"Në bazë të nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 ankesa kundër këtij aktvendimi parashtrohet me shkrim tek Kolegji i Ankesave pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi."

Vlerësimi i pranueshmërisë

39. E ashtuquajtura "Vërejtje para padisë", që përfshinë, pak a shumë, të njëjtat dokumente që u parashtruan në data të ndryshme dhe që iu dërguan autoriteteve të ndryshme, nuk figuron si kërkesë e formatit ligjor e dizajnuar për t'u ankuar kundër shkeljes së të drejtave të mbrojtura kushtetuese nga autoritetet publike, që është çështja kryesore e punës së Gjykatës Kushtetuese.

40. Përkundrazi, parashtruesit njëkohësisht dhe paralelisht dhanë "Vërejtjen para padisë", duke ua dërguar të njëjtën informatë dymbëdhjetë/nëntëmbëdhjetë institucioneve dhe autoriteteve të ndryshme.

41. Prandaj, duke pasur parasysh natyrën ligjore dhe fushëveprimin e Gjykatës Kushtetuese, "Vërejtja para padisë" nuk do të binte nën shqyrtimin paraprak të Gjykatës dhe fare nuk do të duhej të ishte regjistruar, megjithatë, Gjykata do ta shqyrtojë për hir të qëllimeve pedagogjike.

42. Neni 113 (1 dhe 7) i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme të kritereve juridike për pranueshmëri. Ai thotë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *(...)*
>
> *7 Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

43. Ato kritere për pranueshmëri shtjellohen më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës, të cilat specifikojnë ndër të tjera: respektimin e afatit të paraparë; arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës, me një përmbledhje të shkurtër të fakteve dhe sqarim të përpiktë të të drejtave që janë shkelur; aktin konkret të autoritetit publik që kontestohet dhe mbrojtjen juridike që kërkohet; dhe bashkëngjitjen e informacioneve dhe dokumentacionit të nevojshëm mbështetës.

44. Parashtruesit nuk janë duke vepruar si individë, por si përfaqësues të personave juridikë. Neni 21.4 i Kushtetutës thotë që *"të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme"*. Prandaj, parashtruesit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë kushtetuese *(Shih Aktvendimin në rastin Nr. KI. 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, paragrafi 14)*.

45. Megjithatë, kjo do të thotë që edhe parashtruesit janë të obliguar t'i shterojnë të gjitha mjetet juridike të parapara me Ligj, siç përcaktohet në nenin 113.7 për individë.

46. Qëllimi i rregullit të shterimit të mjeteve juridike është që t'u lejojë autoriteteve publike, përfshirë gjykatat e rregullta, mundësinë për t'i parandaluar ose korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli i shterimit të mjeteve juridike është i ndërlidhur në mënyrë operative me karakterin subsidiar të kornizës procedurale të drejtësisë kushtetuese *(Shih Selmouni kundër Francës [DHM], paragrafi 74; Kudła kundër Polonisë [DHM], paragrafi 152; Andrášik dhe të tjerët kundër Sllovakisë (vendim))*.

47. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesit t'i shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedura të rregullta, qoftë administrative apo gjyqësore, për ta parandaluar shkeljen e Kushtetutës, ose, nëse ka, për ta korrigjuar shkeljen e një të drejte

themelore. Prandaj, parashtruesit rrezikojnë që rastet e tyre t'u shpallen të papranueshme nga Gjykata Kushtetuese nëse dështojnë t'i shfrytëzojnë procedurat e rregullta ose nëse dështojnë ta raportojnë shkeljen e Kushtetutës në procedura të rregullta. Ai dështim do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për ta kundërshtuar shkeljen dhe për t'u ankuar *(Shih Aktvendimin në rastin Nr. KI. 07/09, Demë KURBOGAJ dhe Besnik KURBOGAJ, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl.nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18).*

48. Në rastin në fjalë, parashtruesit vepruan njëkohësisht dhe paralelisht, gjë që është tërësisht kundër natyrës pasuese dhe hap pas hapi të rregullit të shterimit të mjeteve juridike. Prandaj, ata treguan se nuk i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me sistemin e rregullt juridik.

49. Prandaj, duke pasur parasysh tërë këtë që u tha më lart, Gjykata duhet të konkludojë që e ashtuquajtura kërkesë qartazi duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

50. Në anën tjetër, neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë

cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

51. Parashtruesit gjithashtu dështuan të saktësonin se cilat të drejta dhe liri u janë shkelur dhe cilin akt të autoritetit publik e kontestojnë. Ata nuk tregojnë asnjë formë të shkeljes së të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

52. Përveç kësaj, parashtruesit as nuk e kanë mbështetur me prova rastin në të cilin konsiderojnë se janë viktima të shkeljes së Kushtetutës *(Shih Scordino kundër Italisë (nr. 1) [DHM], paragrafi 179)*, as nuk kanë bashkëngjitur informacione dhe dokumentacion të nevojshëm mbështetës, as që kanë treguar mbrojtjen juridike që kanë kërkuar.

53. Në të vërtetë, procedurat në Gjykatën Kushtetuese janë kundërthënëse në natyrë. Prandaj, u takon palëve që t'i mbështesin argumentet e tyre faktike (duke ia dorëzuar Gjykatës provat e nevojshme faktike) dhe argumentet e tyre ligjore (të cilat sqarojnë si dhe pse, sipas mendimit të tyre, dispozitat kushtetuese në të cilat janë mbështetur janë apo nuk janë shkelur). Gjykata është përgjegjëse për vërtetimin e fakteve; është detyrë e palëve të sigurojnë ndihmë aktive duke ia dorëzuar të gjitha informatat e duhura mbështetëse dhe dokumentacionin përkatës.

54. Nga sa u tha më lart, nuk është detyrë e Gjykatës të supozojë cili është qëllimi i parashtruesve apo ta ndërtojë rastin në emër të tyre. Përkundrazi, sipas nenit 113.1 të Kushtetutës, është detyrë e parashtruesve të parashtrojnë çështjen në Gjykatë "në mënyrë ligjore" dhe në pajtim me të gjitha kriteret për pranueshmërinë e kërkesës.

55. Shkurtimisht, Gjykata mendon që "Vërejtja para padisë", e përmendur më lartë, nuk e arrin pragun minimal për t'u konsideruar "mënyrë ligjore" e parashtrimit të çështjes në këtë Gjykatë.

56. Mënyra në të cilën "Vërejtja para padisë" është parashtruar në Gjykatë mund të shihet, në qasje të rreptë, si abuzim i të drejtës për t'u ankuar. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcaktoi që *"çdo sjellje e parashtruesit e cila është qartazi në kundërshtim me qëllimin e të drejtës së kërkesës individuale, siç parashihet në Konventë, dhe që e pengon funksionimin e mirëfilltë të Gjykatës apo zhvillimin e mirëfilltë të procedurës para saj përbën abuzim të drejtës së kërkesës" (Shih Mirolubovs dhe të tjerët kundër Lituanisë*, paragrafët 62 dhe 65).*

57. Gjykata Kushtetuese është e detyruar me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili përcakton që *"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me*

vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

58. Megjithatë, Gjykata mendon që në këtë fazë të zhvillimit të praktikës gjyqësore kushtetuese në Kosovë, nuk këshillohet të miratohet një qasje e rreptë e tillë. Megjithatë, është me rëndësi që parashtruesit ta dinë këtë, pasi duket që e kanë keqkuptuar rolin e Gjykatës Kushtetuese dhe natyrën e kornizës së punës së drejtësisë kushtetuese, siç përcaktohet në Kushtetutë, në Ligj dhe në Rregulloren e punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 të Rregullores, më 23 nëntor 2011, me SHUMICË VOTASH

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 56/11 datë 10 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ae. nr. 104/2009, të 21 shtatorit 2010

Lënda KI 56/11, vendim i marsit 2012.

Fjalët kyqe; kërkesë individuale, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur parashtresë në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, të neneve 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 15 janar 2009.
Paraqitësi i kërkesës, më 26 prill 2011, i ka paraqitur kërkesë Gjykatës Kushtetuese.
Kryetari, më 28 prill 2011 e ka emëruar gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin për shqyrtim në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Ivan Çukaloviq dhe Kadri Kryeziu.Gjykata, më 6 dhjetor 2011 ka kërkuar nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë informatë për datën e dorëzimit të aktvendimit të Gjykatës Supreme, paraqitësit të kërkesës.
Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, më 27 qershor 2008, ka marrë aktvendim për lejimin e ekzekutimit në rastin ku paraqitës i kërkesës ka qenë paditësi.Paraqitësi i kërkesës ka ushtruar ankesë kundër këtij aktvendimi, më 16 janar 2009, ndërsa Gjykata Ekonomike e Qarkut, lidhur me këtë rast e ka anuluar aktvendimin për lejimin e ekzekutimit, nga data 27 qershor 2008, duke anuluar në këtë mënyrë edhe obligimin e paraqitësit të kërkesës për pagesë të bazës së borxhit, kamatës dhe të shpenzimeve të procedurës.
Paraqitësi, në shkurt 2009 ka paraqitur kërkesë "për kthim në gjendjen paraprake".Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, më 12 maj 2009 ka vendosur ta "REFUZOJË kërkesën e paraqitësit për kthim në gjendjen paraprake, si të pabazuar".
Paraqitësi i kërkesës ka ushtruar padi në Gjykatën Supreme.
Gjykata Supreme e Kosovës, më 21 shtator 2010, ka vendosur ta refuzojë ankesën [e paraqitësit të kërkesës].Gjykata Kushtetuese lidhur me kërkesën e paraqitësit përsërit se sipas kushtetutës nuk është gjykatë e apelit, apo gjykatë e instancës së katërtë, kur shqyrtohen vendimet e marra nga ana e gjykatave të rregullta.Roli i gjykatave të rregullta është që ta interpretojnë ligjin dhe ti zbatojnë

rregullat përkatëse të procedurës dhe të së drejtës materiale.Kërkesa e paraqitësit nuk dëshmon se Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë.Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që ta zëvendësoj vlerësimin e vet të fakteve për shkak të atij të gjykatave të rregullta dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e të gjitha gjykatave që ti vlerësojnë dëshmitë para tyre.
Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. paragrafi 7. i Kushtetutës dhe rregullin 36. të Rregullores së punës, njëzëri ka vendosur që kërkesën ta refuzojë si të papranueshme.

Prishtinë, më 24 prill 2012

Nr. ref.: RK22/12

ATKVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 56/11

Parashtruesi

NP Media Print

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ae. nr. 104/2009, të 21 shtatorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është ndërmarrja private "NP-Media Print" nga Prishtina, që përfaqësohet nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ae. nr. 104/2009, të 21 shtatorit 2010.

3. Parashtruesi pohon që ka pasur shkelje të nenit 21 (Parimet e përgjithshme të të drejtave të njeriut), nenit 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare) dhe nenit 53 (Të drejtat dhe liritë themelore të

njeriut të garantuara me Kushtetutë duhet të interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta). Parashtruesi më tej pohon që ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa), si dhe të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 26 prill 2011, parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 28 prill 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues për Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 6 dhjetor 2011, Gjykata kërkoi informacione nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë lidhur me datën se kur i është dorëzuar parashtruesit aktgjykimi i Gjykatës Supreme. Më 13 dhjetor 2011, Gjykata Ekonomike e Qarkut u përgjigj se Gjykata Ekonomike e Qarkut u përpoq, në dy raste të veçanta, t'ia dorëzonte aktgjykimin parashtruesit, por pa sukses. Arsyeja kryesore e pamundësisë për t'ia dorëzuar aktgjykimin ishte vdekja e përfaqësuesit të atëhershëm të parashtruesit, Lekë Vuksani. Më 13 mars 2011, Teki Bokshi u bë përfaqësues i autorizuar i

parashtruesit dhe atëherë Gjykata Ekonomike e Qarkut i ofroi qasje në dosjen e gjykatës.

8. Më 16 mars 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 27 qershor 2008, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin E. nr. 260/08 për lejimin e përmbarimit në rastin E. Nr. 260/08, ku parashtruesi ishte paditës.

10. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër atij aktgjykimi dhe, më 16 janar 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut e caktoi seancën dëgjimore lidhur me çështjen.

11. Më 16 janar 2009, përfaqësuesi i atëhershëm i parashtruesit, Lekë Vuksani, ndonëse u ftua në çështjen e rregullt, nuk morri pjesë në seancë duke mos dhënë arsyetim për mospjesëmarrjen e tij.

12. Në të njëjtën datë, më 16 janar 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin II. C. nr. 290/2008, e shfuqizoi Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë E. nr. 260/08, të 27 qershorit 2008, dhe e suprimoi në tërësi detyrimin e parashtruesit për pagesën e borxhit kryesor, kamatën dhe shpenzimet e procedurës.

13. Më 2 shkurt 2009, Lekë Vuksani, ushtroi propozim "për kthim në gjendjen e mëparshme për shkak të mungesës së tij nga seanca e mbajtur më 16 janar 2009. Me rastin e ushtrimit të propozimit, Lekë Vuksani bashkëngjiti vetëm raportin e mjekut specialist."

14. Më 12 maj 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin II. C. nr. 290/2008, vendosi TË REFUZOJË si "të

pabazuar" propozimin sepse përfaqësuesi nuk kishte vepruar në përputhje me nenin 130 (4) të Ligjit për procedurën kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK), i cili thotë:

"Po që se kthimi në gjendje të mëparshme kërkohet për shkak të mos ruajtjes së afatit për kryerjen e veprimit procedural, propozuesi ka për detyrë që propozimit t'ia bashkëngjisë veprimin e shkruar procedural të pakryer me kohë."

15. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut.

16. Më 21 shtator 2010, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Ae. nr. 104/2009, vendosi "të refuzojë ankesën (e parashtruesit) si të pabazuar dhe të vërtetojë Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë C. nr. 290/2008, të 16 janarit 2009, me të cilin u shfuqizua Aktgjykimi për lejimin e përmbarimit E. nr. 260/2008.

17. Gjykata Supreme konsideroi se "gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore të nenit 130.4 të LPK". Gjykata Supreme konstatoi se përfaqësuesi i parashtruesit nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 130 (4) për të mbështetur kthimin në gjendjen e mëparshme, sepse sëmundja nuk arsyeton mungesën e avokatit në seancën gjyqësore.

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi pohon që situata kur avokati mungon në seancë gjyqësore është e paraparë me nenin 129 (1) të LPK-së, i cili thotë:

"Në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se

ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen."

19. Parashtruesi pohon për shkelje të nenit 21 të Kushtetutës, i cili i përcakton parimet e përgjithshme për të drejtat e njeriut, dhe nenit 22 të Kushtetutës, i cili garanton zbatim të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, posaçërisht të nenit 6 të Konventës, sepse Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut II. C. nr. 290/2008, i 12 majit 2009, nuk ishte "i bazuar në realitetin objektiv".

20. Parashtruesi gjithashtu pohon që ka pasur shkelje të nenit 53 të Kushtetutës, i cili përcakton që të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të garantuara me Kushtetutë, duhet të interpretohen në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë drejtim, parashtruesi beson që aktgjykimet e Gjykatës Ekonomike të Qarkut dhe të Gjykatës Supreme ishin "absolutisht të padrejta".

Vlerësimi i pranueshmërisë

21. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

22. Neni 49 i Ligjit (Afatet) thotë që:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht".

23. Parashtruesi pohon që vendimi i Gjykatës Supreme, i 21 shtatorit 2010, i ishte dorëzuar më 6 prill 2011, dhe për këtë arsye ai ka pasur mundësi ta parashtronte kërkesën në Gjykatën Kushtetuese vetëm më 26 prill 2011.

24. Megjithatë, ai nuk i ka ofruar Gjykatës vërtetim me të cilin do ta dëshmonte datën e dorëzimit, i cili parashihet me ligj si provë se kur i është dorëzuar aktgjykimi parashtruesit. Në vend të kësaj, ai ka sjellë në Gjykatë një dëftesë nga Gjykata Ekonomike e Qarkut, e 6 prillit 2011, për shpenzimet e fotokopjimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme nr. 290/08.

25. Me sa duket, parashtruesi kërkon të mbështetet në datën e dëftesës për shpenzimet e fotokopjimit të aktgjykimit si datë e njëjtë kur i është dorëzuar aktgjykimi për herë të parë, që logjikisht nuk është e domosdoshme. Përveç kësaj, duket që aktgjykimi nuk i është dorëzuar parashtruesit gjoja për shkak të faktit se përfaqësuesi i tij kishte vdekur dhe përfaqësuesi i ri ishte caktuar vetëm më 13 mars 2011.

26. Edhe pse dëftesa për fotokopjimin e aktgjykimit nuk është provë bindëse e datës së dorëzimit të aktgjykimit, rrethanat specifike të rastit kështillojnë për rishqyrtim.

27. Në të vërtetë, Gjykata Ekonomike e Qarkut theksoi se u përpoq në dy raste të veçanta t'ia dorëzonte aktgjykimin parashtruesit, por pa sukses, për shkak të mungesës/vdekjes së përfaqësuesit. Gjykata Ekonomike e Qarkut, thekson më tej, se ata i kanë ofruar përfaqësuesit të ri qasje në dosjen e gjykatës dhe kjo ka mundur të ndodhte më 6 prill 2011, data e futur në dëftesën për fotokopjimin e aktgjykimit të dorëzuar në atë dosje.

28. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se është e arsyeshme të pranojë që parashtruesi kuptoi për herë të parë për këtë aktgjykim dhe përmbajtjen e tij më 6 prill 2011, data kur përfaqësuesi i ri e mori një kopje, dhe ajo datë është relevante për vlerësimin e afatit brenda të cilit kërkesa duhet të parashtrohet në përputhje me nenin 49 të Ligjit.

29. Prandaj, konkluzioni është që kërkesa është parashtruar me kohë.

30. Gjykata gjithashtu u referohet:

a. Rregullit 36 (1) (a) dhe (c) të Rregullores së punës: *Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse (...) kërkesa është qartazi e bazuar;* dhe

b. Rregullit 36 (2) (b) dhe (d): *Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se faktet e paraqitura nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

31. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pohimin e tij duke sqaruar si dhe pse është bërë shkelja, apo nuk ka ofruar prova për të dëshmuar se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me Kushtetutë.

32. Gjykata Kushtetuese përsëritë që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

33. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. *5503/02,* Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

34. Përveç kësaj, kërkesa nuk tregon që Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të zëvendësojë vlerësimin e fakteve të veta me atë

të gjykatave të rregullta, dhe si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që të vlerësojnë provat para tyre. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë mënyrën se si është marrë prova.

35. Kërkesa nuk zbulon asnjë formë të shkeljes së të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Kushtetutë dhe në Konventë. Në veçanti, parashtruesi ka dështuar të tregojë dhe vërtetojë se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ishte "absolutisht i padrejtë" dhe kështu i ka shkelur nenet 21, 22 dhe 53 të Kushtetutës, dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

36. Në këto rrethana, nuk konsiderohet që parashtruesi ka përmbushur kërkesat e sipërpërmendura për marrjen e vendimit për pranueshmëri, prandaj kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 të Rregullores, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 161/11 datë 22 maj 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. Nr. 2/2011 të 10 qershorit 2011

Rasti: KI 161/11, vendimi i 19 prillit 2012

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta për pronë, njohja e aktgjykimeve të huaja, qartazi i pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. nr. 2/2011 të 10 qershorit 2011, me të cilin është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren NDr. Nr. 302/10, të 23 nëntorit 2010, dhe është hedhur poshtë propozimi i parashtruesit të kërkesës që t'i njihet kontrata e shitblerjes Leg. Nr. 1255/99 ë 25 qershorit 1999 i vërtetuar në Gjykatën e Parë Komunale në Beograd si aktvendimi i shtetit të huaj.

Parashtruesi i kërkesës duke kontestuar aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ac.nr. 2/2011 të 10 qershorit 2011, ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që rasti i kontratës kontestuese duhet trajtuar si aktvendim i shtetit të huaj, përkatësisht shtetit të Serbisë, pra Gjykata duhet të njohë këtë kontratë si aktvendim i shtetit të huaj.

Duke vendosur për kërkesën e parashtruesit Milan Petrović, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta dhe arbitrare.

Prandaj Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se kërkesa është qartazi e pabazuar sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese.

Prishtinë, më 25 prill 2012

Nr. ref.: RK224/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI 161/11

Parashtruesi

Milan Petrović

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës

Ac. Nr. 2/2011 të 10 qershorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Milan Petrović nga Prizreni, që e përfaqëson avokati Ymer Koro po ashtu nga Prizreni

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. Nr. 2/2011 i 10 qershorit 2011 që i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 gusht 2011, me të cilën vërtetohet vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren NDr. Nr. 302/10 i 23 nëntorit 2010 dhe refuzohet propozimi i parashtruesit të kërkesës për njohjen e kontratës së shitblerjes Leg. Nr. 1255/99 të 25 qershorit 1999 i vërtetuar në Gjykatën e Parë Komunale në Beograd si aktvendim i shtetit të huaj.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. nr. 2/2011 të 10 qershorit 2011, duke mos precizuar nenet konkrete të Kushtetutës të cilat janë shkelur, por nga kërkesa mund të konstatohet se objekti i çështjes është çështje pronësore në të cilën parashtruesi i kërkesës konsideron

se: "...rasti i kontratave në kontest duhet të trajtohet si aktvendim i shtetit të huaj, konkretisht të shtetit të Serbisë dhe Gjykata duhet të pranojë edhe këtë kontratë si aktvendim i shtetit të huaj".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20,22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe Rregullin 56 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesi i kërkesës më 10 dhjetor 2011 në Prizren me anë të postës, ka dorëzuar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) e cila është regjistruar në Gjykatë me 13 dhjetor 2012.

6. Më 27 janar 2012 Gjykata Kushtetuese informoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, për inicimin e procedurës së vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimit për lëndën nr. KI 161/11.

7. Më 19 prill 2012 pas shqyrtimit të raportit te gjyqtarit Altay Suroy, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Ivan Čukalović (kryesues), Iliriana Islami, dhe Gjyljeta Mushkolaj kanë paraqitur rekomandimin, para Gjykatës në përbërje të plotë, për papranushemërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar, në Gjykatën e Qarkut në Prizren, propozimin për njohjen e kontratës së shitblerjes së banesës Leg. Nr. 1255/99, të vërtetuar në Gjykatën e Parë Komunale në Beograd më 25 qershor 1999, me të cilën parashtruesi ka blerë banesën e kontestuar nga Sekretariati i Punëve të Brendshme në Prizren, që ishte pronar i kësaj banese, banesa e përmendur gjendet në Prizren, por e njëjta kontratë është vërtetuar në Gjykatën e Parë Komunale në Beograd për shkak të rrethanave që kanë ndodhur pas intervenimit të NATOS.

9. Gjykata e Qarkut në Prizren, me aktvendimin NDr. nr. 302/10 të 23 nëntorit 2010, hodhi poshtë propozimin e parashtruesit si të pabazë duke marrë parasysh se kontrata nuk përmbushë kushtet e parapara me Ligjin për zgjidhjen e konflikteve te Ligjeve me rregulloret e shteteve tjera, Gazeta Zyrtare e RSFJ nr. 43/1982 që me nenin 86 parasheh:

„Vendimi i gjykatës së huaj barazohet me vendimin e Gjykatës së Republikës Federale të Jugosllavisë dhe prodhon efekt juridik në Republikën Federale të Jugosllavisë, vetëm nëse e pranon Gjykata e Republikës Federale të Jugosllavisë."

„Vendim i gjykatës së huaj sa i përket paragrafit 1 të këtij neni konsiderohet pajtimi i arritur në gjykatë (pajtim gjyqësor)."

„Vendim i gjykatës së huaj konsiderohet edhe vendimi autoriteti tjetër që gjendet në shtetin ku është lëshuar, i barazuar me vendimin gjyqësor respektivisht me pajtimin nëse me të rregullohen raportet e parapara me nenin 1 të këtij ligji".

10. Ndaj këtij aktvendimi parashtruesi i kërkesës ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës me vendimin Ac. Nr. 2/2011 hodhi poshtë propozimin e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në

Prizren NDr. Nr. 301/2010 të 23 nëntorit 2010, *duke arsyetuar vendimin si vijon:*

"...nuk janë përmbushur kushtet për njohjen e kontratës së shitjes së banesës si palë e huaj, sepse kontrata e ngjashme nuk mund të trajtohet si një urdhër i gjykatës e as si marrëveshje gjyqësore ashtu si supozon propozuesi në ankesën e tij".

Pretendimet e parashtruesit

11. Parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. nr. 2/2011 të 10 qershorit 2011, duke theksuar se:

"Në territorin e Kosovës vazhdimisht kemi raste, dhe atë me qindra raste, kur qytetarët e Kosovës i drejtohen Gjykatës së Qarkut si kompetente për njohjen e vendimeve të shteteve të huaja në shtetin e Kosovës, dhe atë më së shumti vendimeve gjyqësore për prishjen e martesës dhe deri më tash çdo vendim i tillë është trajtuar si vendim i huaj dhe si të tillë edhe Gjykatat kompetente e kanë pranuar.

"Poashtu edhe rasti i kontratës kontestuese duhet të trajtohet si vendim i shtetit të huaj konkretisht të shtetit të Serbisë, dhe Gjykata duhet të pranojë edhe këtë kontratë si vendim i shtetit të huaj".

"Krahas gjithë kësaj parashtruesi i kërkesës konsideron se i janë shkelur të drejtat që i përkasin në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe për këtë propozohet që Gjykata Kushtetuese e Kosovës të aprovojë këtë kërkesë si të bazuar dhe me vendimin e vet të vlerësojë dhe konstatojë se aktvendimet e paraqitura në këtë kërkesë janë në kundërshtim

me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe si të tilla të anulohen"

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

12. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të Punës të Gjykatës.

13. Kërkesa e parashtruesit është në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të Punës, mënyra e llogaritjes së afateve kohore përcaktohet me Rregullin 27 pikat 3 dhe 6 të Rregullores së Punës të cilat parashohin si në vijim :

"3. Kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë të muajit me ditën gjatë të cilës k ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore;"

"6. Përndryshe, nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj."

14. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i

janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."

15. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis* , Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr 30544/996, par. 28, Gjykata Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut [GJEDNJ] 1990-I).

16. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr 53363/99 të 31 majit 2005).Parashtruesi i kërkesës nuk pohon se në çfarë mënyre neni 22 dhe Karta Sociale Evropiane e vitit 1996 mbështesin kërkesën e tij, ashtu siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

17. Në këtë rast parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë, para Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre , kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064 të 30 qershorit 2009).

18. Përfundimisht kushtet për pranueshmëri nuk janë përmbushur në këtë kërkesë. Ai ka dështuar të theksojë dhe mbështesë me dëshmi se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

19. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës që parasheh: "Gjykata

do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 20 të Ligjit, dhe Rregullin 56 pika 2 dhe Rregullin 36(2b) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 19 prillit 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Prof. Dr. Enver Hasani

KI 160/11 datë 10 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ASC-09-0106, të datës 7 tetor 2011

Rasti KI 160/11, vendimi i 19 prillit 2012

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, masa të përkohshme, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkelja e të drejtave dhe lirive individuale, qartazi i pabazuar

Parashtruesi parashtroi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pohuar se i janë shkelur të drejtat dhe liritë individuale, të garantuara me dhe KEDNJ, me vendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ASC-09-0106 të 7 tetorit 2011, e cila e refuzoi ankesën e AKP-së si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e trupit gjykues të 22 tetorit 2009 (Aktgjykimi ASC-08-0056). Kolegji i Apelit vendosi se "Për shkak të faktit se Paditësi i rastit në fjalë nuk ishte palë e procesit të mëparshëm ligjor dhe pasi që kompania nuk kishte mundësi të rregullta të paraqes prova që e mbështesin qëndrimin e saj dhe përdor mjetet ligjore që janë në dispozicion të palëve në procedurë, nga të gjitha këto raste procedurale duhet të nxirret përfundimi se aktgjykimi i mëparshëm nuk mund ta parandaloj shqyrtimin e padisë së Paditësit ENG Office." Për më tepër, parashtruesi kërkoi nga gjykata që të vendosë masë të përkohshme.

Gjykata konkludoi se kërkesa ishte e papranueshme sepse parashtruesja nuk ka ofruar prova që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti. Prandaj, Gjykata vendosi se kërkesa ishte e pabazuar sipas rregullit 36 (1.c) të Rregullores së Punës. Për më tepër, sa i përket çështjes së pyetjes së parashtruesit në lidhje me statusin ligjor të PAK, Gjykata vendosi se ajo tanimë ka vendosur për këtë çështje në Aktgjykimin në Rastin Nr. KI. 25/10. Prandaj, kjo nuk do të diskutohet në rastin konkret, sipas rregullit 36 (3) (e) të Rregullores, që parasheh: "Po ashtu, një kërkesë

mund te konsiderohet si e papranueshme edhe ne rastet vijuese, kur: Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi te ri;". Sa i përket kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata konsideron se duke marrë parasysh se Kërkesa ishte e papranueshme, parashtruesi nuk ka të drejtë sipas rregullit 54 (1) të Rregullores së punës të kërkojë masa të përkohshme

Prishtinë, më 26 prill 2012

Nr. ref.: RK226 /12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 160/11

Parashtruesi

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ASC-09-0106, të datës 7 tetor 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), e përfaqësuar nga Zyrtari i lartë ligjor i AKP-së, z. Gani Ademi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit) ASC-09-0106, të 7 tetorit 2011, i cili i ishte dorëzuar më 18 tetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i lartpërmendur ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 102.3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] si dhe nenin 6 [E Drejta për Gjykim të Drejtë] të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga gjykata që të vendos masat e përkohshme për të ndaluar ekzekutimin e Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme ASC-09-0106, për arsyen se, *"Ekziston rreziku që paditësi të kërkoj përmbarimin e dhunshëm të aktgjykimit ASC-09-0 I 06, dhe në këtë mënyrë të shkaktohen dëme të pariparueshme për të paditurën dhe të cenohet interesi publik. Njëherësh, pasi që e tërë procedura publike e tenderimeve gjatë procesit të privatizimit e vendosur me ligjin e zbatueshëm, mundet të perceptohet negativisht nga publiku dhe të bie numri i pjesëmarrësve në tender."*

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 dhjetor 2011, parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 17 janar 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.

8. Më 6 shkurt 2012, kërkesa iu komunikua Dhomës së Posaçme.

9. Më 19 prill 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në vitin 2006, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM) tenderoi shitjen e New Co "Jugoterm" në Gjilan.

11. Më 14 nëntor 2006, një nga ofertuesit, z. Sh. A, u ankua në Dhomën e Posaçme duke kërkuar anulimin e procedurës së tenderit sepse, gjoja, kishte marrëveshje të fshehta mes ofertuesve, pjesë e cilës marrëveshje ishte edhe ai vetë, kështu që ishin shkelur rregullat e tenderimit.

12. Më 8 gusht 2007, Dhoma e Posaçme nxori një aktgjykim (Aktgjykimin SCC-06-0475), me të cilin pjesërisht pranoi kërkesën. Dhoma e Posaçme obligoi AKM-në që ta anulojë tenderin në të cilin Ndërmarrja Publike "Eng Office" ishte shpallur fituese e shitjes së New Co "Jugoterm", sepse Dhoma e Posaçme kishte gjetur parregullsi në procedurën e tenderimit. Pjesa e kërkesës përmes së cilës është kërkuar nga Dhoma e Posaçme që të urdhëroi AKM-në të organizojë tender të ri për New Co e lartpërmendur, ishte refuzuar sepse varej nga AKM-ja që të vendoste për tenderim të ri apo jo.

13. Ofertuesi “Eng Office”, i cili kishte blerë New Co “Jugoterm”, kërkoi nga njëjta, Dhoma e Posaçme, që të shqyrtonte Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të 8 gushtit 2007.

14. Më 5 shkurt 2008, e njëjta, Dhoma e Posaçme (Vendimi SCA-08-0007), refuzoi kërkesën e “Eng Office” për shqyrtim me arsyetimin se nuk ishte ngritur asnjë pretendim i ri ose faktik dhe se Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme i 8 gushtit 2007 ishte në pajtim me ligjin në fuqi. Ky vendim ishte i formës së prerë dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të ushtrohej ankesë ndaj tij.

15. Më 3 mars 2008, “Eng Office” i parashtroi ankesë Dhomës së Posaçme kundër AKM-së për shkeljen e rregullave të tenderimit dhe propozoi se duhej obliguar AKM-në për nënshkrimin e marrëveshjes me “Eng Office” si fitues në procesin e ofertimit dhe të paguaj kompensim për dëmet materiale dhe jo-materiale.

16. Ndërkohë, më 21 maj 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi) kaloi Ligjin Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP). Neni 1 i Ligjit për AKP thotë se “Agjencia themelohet si organ i pavarur publik...” dhe “...është pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM) rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 ‘për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit’ (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12), me ndryshime, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e kësaj të fundit do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë.” Për më tepër, neni 31 paragrafi 1 i Ligjit për AKP parasheh se Ligji për AKP ”do të mbisundojë çdo dispozitë tjetër të Ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të”, përderisa në paragrafin 2 thuhet se “Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, me ndryshimet dhe plotësimet e saj, nuk do të prodhojë efekte juridike pas hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

17. Më 22 tetor 2009, Trupi Gjykues i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Trupi Gjykues) pjesërisht pranoi ankesën e “Eng Office”. Trupi Gjykues konkludoi (Aktgjykimi SCC-08-0056) se “Eng Office” është ofertuesi fitues, obligoi AKM-në dhe AKP-në të gjejë mënyrën dhe procedurën për të përmbyllur tenderin, si dhe

obligoi AKM-në të paguante kompensim për dëmet materiale. Në bazë të dëshmive të paraqitura Trupi Gjykues arriti në përfundim se anulimi i bërë nga Drejtori Gjeneral nuk është i vlefshëm sepse Bordi i Drejtorëve është organi i vetëm i autorizuar për anulimin e tenderëve. Më tej, Trupi Gjykues konkludoi se ky rast nuk mund të konsiderohet *res judicata* sepse palët në Aktgjykimin SCC-06-0475, të 8 gushtit 2007, ishin tjera nga ato në këtë rast dhe se kërkesa gjithashtu ishte tjetër.

18. Më 17 dhjetor 2009, AKP-ja i paraqiti ankesë Kolegjit të Apelit kundër Aktgjykimit të 22 tetorit 2009, sepse aktgjykimi shkel parimin e *res judicata*.

19. Më 7 tetor 2010, Kolegji i Apelit (Aktgjykimi ASC-09-0106) refuzoi ankesën e AKP-së si të pabazë dhe mbështeti Aktgjykimin e Trupit Gjykues të 22 tetorit 2009 (Aktgjykimi ASC-08-0056). Kolegji i Apelit vendosi se *"Për shkak të faktit se Paditësja e lëndës në fjalë nuk ka qenë palë e procesit gjyqësor të mëparshëm dhe meqë kompania nuk i ka pasur mundësitë e rregullta për të prezantuar dëshmi që e mbështesin qëndrimin e saj dhe të përdorë mjetet e zakonshme që janë në dispozicion të palës në procedurë, nga këto çështje plotësisht procedurale duhet të nxirret përfundimi se aktgjykimi i mëparshëm nuk mund të parandalojë shqyrtimin e padisë së Paditëses ENG Office SHPK."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

I. Sa i përket statusit ligjor të AKP-së

20. Parashtruesi i kërkesës pohon se Dhoma e Posaçme ka shkelur Ligjin për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 03/L-067), të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, ligj ky në fuqi, si dhe nenin 102 të Kushtetutës, me njohjen e statusit ligjor të AKM-së para Dhomës së Posaçme.

21. Sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, Dhoma e Posaçme është pjesë e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe se ka për obligim zbatimin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

Me Aktgjykimin ASC-09-0106, AKM-së i është njohur statusi ligjor dhe e drejta për të qenë palë para Dhomës së Posaçme, edhe pse AKM-ja si entitet ka mbaruar së ekzistuari me Ligjin Nr. 03/L-067. Vendimi ekzekutiv i UNMIK-ut nr. 2008/34, i 29 qershorit 2008, tregon se aktivitetet e AKM-së kanë mbaruar *de facto* dhe *de jure*.

22. Pretendohet se Dhoma e Posaçme në aktgjykimet e mëparshme ka vendosur që AKP-ja mund të përfaqësojë ndërmarrjet shoqërore para Dhomës së Posaçme, vetëm nëse AKM-ja nuk ushtron të drejtën e përfaqësimit të ndërmarrjeve shoqërore, apo nuk e ka një të drejtë të tillë. Rrjedhimisht, pretendohet se kjo është në kundërshtim me ligjin në fuqi në Kosovë, Ligji Nr. 03/L-067.

II. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të parimit *res judicata*

23. Më tej, parashtruesi i kërkesës pohon se me Aktgjykimin SCC-08-0056 dhe ASC-09-0106, Dhoma e Posaçme ka vendosur për një çështje ligjore mbi të cilën është vendosur më parë me Aktvendimin SCC-06-0475, të 8 gushtit 2007. Prandaj, pretendohet se Dhoma e Posaçme e ka shkelur parimin *res judicata,* pasi që objekt në Aktgjykimin SCC-06-0475 e 8 gushtit 2007 dhe atë SCC-08-0056 të 22 tetorit 2009 ishte çështja e tenderit të publikuar nga AKM-ja për privatizimin e New Co "Jugoterm". Në rastin e parë, SCC-06-0475 të 8 gushtit 2007, Dhoma e Posaçme nxori vendimin për anulimin e tenderit, përderisa në rastin e dytë, SCC-08-0056 të 22 tetorit 2009, nxori vendimin me të cilin kërkonte mbylljen e tenderit me nënshkrimin e marrëveshjes për shitje.

24. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Dhoma e Posaçme në mënyrë indirekte edhe vetë e pranon se po shqyrton një çështje të gjykuar:

"…

i)

> *Në aktgjykimin SCC-08-0056 (fq. 10), DHP ka theksuar se Aktgjykimi SCC-06-0475, është marrë nën ndikimin e këtyre rrethanave:*

"Dhoma e thekson faktin se në atë kohë ka qenë e informuar me anë të një letre që Bordi i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit e kishte anuluar tenderin. Kjo del se është një deklaratë e rrejshme". Vazhdon me konstatimin tjetër se: '"Mbase do të kishte qenë e udhës që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me AKM-në ta ftonte në gjykim ofertuesin fitues të përkohshëm, saktësisht ENG Office, Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit rreth anulimit të tenderit".

dhe

ii) Në aktgjykimin ASC-09-0 I 06 (faqja e fundit) Dhoma e Posaçme ka theksuar se në rastin SCC-06-0475, ENG Office nuk ka qenë palë në procedurë andaj edhe nuk ka pasur mundësi që të paraqes mbrojtjen e saj, prandaj nuk duhet t'i ndalohet procesi i ri gjyqësor.

..."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Gjykata vëren se parashtruesit ankohen për dy çështje:

i. Statusin ligjor të AKP-së;

ii. Shkeljen e parimit *res judicata*.

26. Lidhur me këtë, për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha

kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë, specifikuar me Ligjin për Gjykatës Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.

I. Sa i përket statusit ligjor të AKP-së

27. Gjykata Kushtetuese ka vendosur lidhur me statusin ligjor të AKP-së në Aktgjykimin e Rastit Nr. KI. 25/10.

28. Gjykata vlerësoi se *"Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (...) nuk e ka konsideruar Ligjin Nr. 03/L-067 si ligj, drejtësisht i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, por si rregulla të brendshme të vlefshme dhe të detyrueshme të organizatës së AKP-së, që e karakterizoi si entitet faktik, në vend të një organi publik të pavarur me zotësi të plotë juridike, siç është përcaktuar në Ligjin Nr. 03/L-067. "*

29. Gjykata Kushtetuese konkludoi se, "*duke mos zbatuar Ligjin 03/L-067 për AKP-në, sipas rregullit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, Dhoma e Posaçme me veprimet e saj ka shkelur nenin 102 të Kushtetutës"*.

30. Prandaj, kjo nuk do të trajtohet në këtë rast në pajtim me rregullin 36(3) (e) të Rregullores së punës, ku parashihet: *"një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet kur: Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri"*.

III. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të parimit *res judicata*

31. Sa i përket shkeljes së parimit *res judicata* Gjykata thekson se sipas Kushtetutës, Gjykata nuk është për të vepruar si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta.

32. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis*, García kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

33. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kërkesës ka pasur gjykim të drejtë (shih, për shembull, Raporti i Komisionit Evropian për të drejtat e njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87, të miratuar më 10 korrik 1991).

34. Në rastin konkret, parashtruesi kërkesës thjeshtë konteston konstatimet e gjykatave lidhur me rastin dhe cek disa dispozita ligjore të Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane si të shkelura me vendimin e kontestuar të Dhomës së Posaçme. Sidoqoftë, parashtruesi i kërkesës nuk sqaron se si dhe pse Dhoma e Posaçme ka shkelur këto dispozita, që do të thotë se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur rastin mbi bazën e kushtetutshmërisë.

35. Si përfundim, parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon se procedurat para Dhomës së Posaçme ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

36. Rregulli 36 (2) d) i Rregullores parasheh se "*Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se (...) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij*".

37. Prandaj, duke pasur parasysh vlerësimet e mësipërme, rrjedhë se kërkesa si tërësi duhet refuzuar si qartazi e pabazuar.

Vlerësimi i kërkesës për masa të përkohshme

38. Neni 27 i Ligjit dhe, në veçanti, rregulli 54 (1) i Rregullores së punës, parasheh se *"Në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme"*. Sidoqoftë, kur kemi parasysh se kërkesa ishte e papranueshme, parashtruesi i kërkesës nuk gëzon të drejtën nga rregulli 54(1) i Rregullores së punës, për kërkimin e masës së përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me rregullat 36(3) (e), 36 (3) (d), 54 (2) dhe 56 (2) të Rregullores së punës të 19 prillit 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TË HEDHË POSHTË kërkesën për masa të përkohshme;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodriguez Prof. Dr. Enver Hasani

KI 153/11 datë 22 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 564/2011, të 5 gushtit 2011

Rasti KI 153/11, vendimi i 19 prillit 2012

Fjalët kyçe: procedurë administrative, barazia para ligjit, mbrojtja shëndetësore dhe sociale, kërkesë individuale, shkelja e të drejtave dhe lirive individuale, kërkesë qartazi e pabazuar

Parashtruesja parashtroi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës , duke pohuar se të drejtat e saj nga neni 24 [Barazia para Ligjit] dhe 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] janë shkelur me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, që konkludoi se provat dëshmojnë se parashtruesja nuk i plotëson kriteret ligjore për njohjen e së drejtës së kërkuar për pension të personave me aftësi të kufizuar.

Gjykata konkludoi se kërkesa ishte e papranueshme sepse parashtruesja nuk ka ofruar prova që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti. Prandaj, Gjykata vendosi se kërkesa ishte e pabazuar sipas rregullit 36 (1.c) të Rregullores së Punës.

Prishtinë, më 26 prill 2012

Nr. ref.: RK225/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 153/11

Parashtruesja

Fazilja Berisha

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 564/2011, të 5 gushtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Fazilja Berisha, të cilën e përfaqëson i biri i saj, z. Ramadan Berisha, nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr. 564/2011, të 5 gushtit 2011, i cili nuk dihet se kur iu dorëzua parashtrueses së kërkesës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të Aktgjykimit A. nr. 564/2011 të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet t'i jenë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe atë nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 51 [Mbrojtja sociale dhe shëndetësore].

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56(2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 30 nëntor 2011, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 17 janar 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI 153/11 emëroi gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar Raportues. Po të njëjtën ditë, Kryetari me Vendimin Nr. KSH. KI 153/11, emëroi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.

7. Më 3 shkurt 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës që të njoftojë Gjykatën se kur i ishte dorëzuar Aktgjykimi A. nr. 564/2011 i 5 gushtit 2011 i Gjykatës Supreme, dhe që të dorëzonte vendimin Nr. 5066727 të datës 20 prill 2011 të Këshillit për Ankesa. Deri më tani nuk është pranuar asnjë përgjigje.

8. Më 6 shkurt 2012, Gjykata i njoftoi për kërkesën Gjykatën Supreme dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Këshillin për Ankesa (në tekstin e mëtejmë: Këshilli për Ankesa).

9. Më 19 prill 2012, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 19 janar 2011, Komisioni Mjekësor, i themeluar për përcaktimin e të drejtës mjekësore për pensionet e personave me aftësi të kufizuar, refuzoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës për pension të aftësisë së kufizuar, në bazë të gjetjeve dhe mendimit të komisionit mjekësor të gjykatës së shkallës së parë të 6 dhjetorit 2010, me çka vlerësohet se parashtruesja e kërkesës nuk shfaqte paaftësi të përhershme për të punuar siç parashihet me nenin 3 [Kriteret për përcaktimin e Aftësisë së kufizuar] të Ligjit Nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të

Kufizuar në Kosovë (Vendimi Nr. 5066727). Parashtruesja e kërkesës u ankua ndaj këtij vendimi në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale.

11. Më 7 mars 2011, Departamenti i Administratës Pensionale refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe mbështeti vendimin e Komisionit Mjekësor (Vendimi Nr. 5066727). Parashtruesja e kërkesës u ankua ndaj këtij vendimi në Këshillin e Ankesave.

12. Më 20 prill 2011, Këshilli i Ankesave refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazë dhe mbështeti vendimin e Departamentit të Administratës Pensionale (Vendimi Nr. 5066727). Parashtruesja e kërkesës inicioi kontest administrativ në Gjykatën Supreme.

13. Më 5 gusht 2011, Gjykata Supreme refuzoi ankesën si të pabazë. Gjykata Supreme konstatoi se dëshmitë tregonin se parashtruesja e kërkesës nuk i plotësonte kriteret ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar për pension të aftësisë së kufizuar (Aktgjykimi A. nr. 564/2011).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme *"nuk i ka ekzaminuar si duhet faktet dhe se Gjykata Supreme nuk ka kryer fare ekzaminim të dëshmive fizike, nuk na ka ftuar në seancë si paditës dhe se aktgjykimi është i bazuar vetëm në dosjen e lëndës"*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Parashtruesja e kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 51 [Mbrojtja sociale dhe shëndetësore] të Kushtetutës. Gjykata rikujton se, për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse

parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë, specifikuar me Ligjin për Gjykatës Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.

16. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga ana e Gjykatës Supreme, përveç nëse ato kanë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Kështu që, Gjykata nuk është për të vepruar si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

17. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesja e kërkesës ka pasur gjykim të drejtë (shih, për shembull, Raporti i Komisionit Evr. për të drejtat e njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87 të miratuar më 10 korrik 1991).

18. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës thjesht konteston nëse Gjykata Supreme ka zbatuar në mënyrë të rregullt ligjin e aplikueshëm dhe shpreh mospajtimin me gjetjet faktike të gjykatave lidhur me rastin e saj.

19. Pas shqyrtimit të procedurave në këto gjykata të rregullta si tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta o të prekura nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis* Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

20. Nga kjo del se, kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhshmëri me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës i

cili parasheh: *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar."*

21. Prandaj rezulton që kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (1) (c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës, më 19 prill 2012, njëzëri,

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Prof. Dr. Enver Hasani

KI 05/11 datë 28 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Deklaratës së Përbashkët, Nr. 122/08, të 14 tetorit 2008

Rasti KI 05/11, vendimi i 19 prillit 2012

Fjalët kyçe: procedurë administrative, parimet themelore të financave komunale, kompetencat e qeverisë, kërkesë individuale, drejtorët komunalë, mos-shterimi, deklarata universale për të drejtat e njeriut, shkelja e të drejtave dhe lirive individuale,

Parashtruesja parashtroi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pohuar se të drejtat e saj nga neni 93 [Kompetencat e Qeverisë], paragrafët 6 dhe 7, të Kushtetutës, neni 23.2 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe neni 62 [Drejtorët Komunalë], paragrafi 3, dhe 24 [Parimet Themelore të Financave Komunale], 4, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, (Nr. 03 – L-040), janë shkelur me Deklaratën e Përbashkët Nr. 122/08, të 14 tetorit 2008, të lidhur në mes të parashtruesit, Këshillit të Grevës Qendrore dhe Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës, e cila u lejoi parashtruesve ngritje të pagave.

Gjykata konkludoi se kërkesa ishte e papranueshme sepse parashtruesit nuk i kishin shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi, siç parashihet me Rregullore të UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës ose Ligjin Nr. 03/L –212 për Punën.

Prishtinë, më 26 prill 2012

Nr. ref.: RK227/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 05/11

Parashtruesi

Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Deklaratës së Përbashkët, Nr. 122/08,

të 14 tetorit 2008

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruese e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: FSSHK), e përfaqësuar nga z. Armend Shkoza, avokat nga Mitrovica, që vepron sipas autorizimit të 13 janarit 2011, të nënshkruar nga Kryetari i FSSHK-së, z. Blerim Syla.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e konteston Deklaratën e Përbashkët Nr. 122/08 të 14 tetorit 2008, të lidhur ndërmjet parashtrueses, Këshillit Qendror Grevist dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ministria).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesja pohon për shkelje të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], paragrafëve 6 dhe 7, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenit 23.2 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, dhe neneve 62 [Drejtorët Komunalë], paragrafi 3, dhe 24 [Parimet themelore të financave komunale], paragrafi 4, të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Nr. 03-L-040).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesja më 17 janar 2011 e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 shkurt 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI05/11, e caktoi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI05/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Almiro Rodrigues dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 4 maj 2011, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Qeverinë dhe të 14 komunat (shih Shtojcën A) për parashtrimin e kërkesës.

8. Më 16 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese kërkoi informacion shtesë nga parashtruesja, Qeveria dhe komunat.

9. Më 24 qershor 2011, komuna e Fushë Kosovës u përgjigj duke thënë se e kishin zbatuar në tërësi Deklaratën e Përbashkët.

10. Më 27 qershor 2011, komuna e Lipjanit u përgjigj duke thënë se do ta kompensonin shumën e mbetur, sa më shpejt që të jetë e mundur, pas rishikimit të buxhetit për vitin 2011.

11. Më 28 qershor 2011, parashtruesja u përgjigj duke thënë se ka kërkuar nga komunat që ta zbatojnë Deklaratën e Përbashkët dhe gjithashtu e ka njoftuar Qeverinë Qendrore se Deklarata e Përbashkët nuk është zbatuar në tërësi.

12. Më 1 korrik 2011, komuna e Vushtrrisë u përgjigj duke thënë se i kanë përmbushur të gjitha detyrimet lidhur me Deklaratën e Përbashkët.

13. Më 6 korrik 2011, komuna e Klinës u përgjigj duke thënë se do t'ua paguajë shumën e mbetur punëtorëve shëndetësorë sa më shpejt që të jetë e mundur.

14. Më 18 korrik 2011, komuna e Klinës ia dërgoi Gjykatës Kushtetuese vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për t'ua kompensuar shumën e mbetur punëtorëve shëndetësorë.

15. Deri më tani, 11 komuna nuk i janë përgjigjur kërkesës për informacione.

16. Më 28 korrik 2011, Gjykata Kushtetuese kërkoi informacione shtesë nga Qeveria, duke përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Administratës Publike, dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, të cilat u përgjigjën më 9, 10, 11 dhe 15 gusht 2011.

17. Më 12 tetor 2011, Gjykata kërkoi nga parashtruesja që ta dorëzonte autorizimin e anëtarëve të FSSHK-së për Kryetarin e FSSHK-së, z. Blerim Syla, si dhe listat me emrat e punëtorëve të kujdesit shëndetësorë për secilën komunë veç e veç, të cilët pohojnë se komunat përkatëse nuk ua kanë paguar kompensimin prej 44 eurove, të cilin ato e bënë më 30 nëntor 2011.

18. Më 21 mars 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të dorëzonte informacione nëse kanë filluar ndonjë procedurë në ndonjërën nga gjykatat e rregullta në Kosovë lidhur me çështjen e ngritur në Gjykatën Kushtetuese.

19. Më 22 mars 2012, parashtruesja iu përgjigj Gjykatës se nuk kanë ngritur asnjë procedurë tjetër në gjykatat e rregullta sepse vetëm Gjykata Kushtetuese është kompetente për të vendosur për aktin e Deklaratës së Përbashkët të nënshkruar nga përfaqësuesit e FSSHK-së dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Më tej, gjoja,

Ligji për konfliktet administrative nuk u lejon të fillojnë procedurë për konflikt administrativ.

20. Kolegji shqyrtues më 19 prill 2012 e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

21. Parashtruesja është e regjistruar si person juridik në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në përputhje me Vendimin 200/06, të lëshuar më 11 prill 2006, dhe Vendimin 531 të 1 shkurtit 2010.

22. Më 13 tetor 2008, parashtruesja, e cila i përfaqëson interesat e anëtarëve të vet, të cilët janë punëtorë shëndetësorë, organizoi një grevë në nivel të vendit me qëllim të përmbushjes së kërkesës legjitime të punëtorëve shëndetësorë.

23. Negociatat pasuese ndërmjet parashtrueses, Këshillit Qendror Grevist dhe Ministrisë së Shëndetësisë rezultuan në një deklaratë të përbashkët ndërmjet tyre dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

24. Deklarata e Përbashkët u nënshkrua më 14 tetor 2008, e cila siguronte që 13.247 punëtorë shëndetësorë do të merrnin kompensim në vlerë prej 44 eurove. Kompensimi do të paguhej gjatë dy vjetëve të ardhshme nga komunat, të cilave Qeveria do t'ua ndante mjetet e nevojshme financiare.

25. Pas nënshkrimit të Deklaratës së Përbashkët filluan të paraqiten probleme lidhur me zbatimin e saj, pasi palët e interpretonin atë në mënyra të ndryshme.

26. Si rrjedhojë, kompensimi prej 44 eurove nuk u pagua nga komunat, të cilat sipas Ligjit për vetëqeverisjen lokale bartin kompetencën për menaxhimin e sektorit të kujdesit primar shëndetësor.

27. Më 24 shkurt 2009, punëtorët shëndetësorë organizuan grevë me qëllim të zbatimit të Deklaratës së Përbashkët të 14 tetorit 2008.

28. Për ta sanuar këtë problem, më 3 mars 2009 Kryeministri mbajti një takim publik me krerët komunalë, në të cilin ishin të pranishëm edhe anëtarët e Këshillit Kombëtar të parashtrueses, si dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut si palë e tretë dhe garantues për vazhdimin e zbatimit të Deklaratës së Përbashkët. Në këtë takim, Kryeministri ka kërkuar nga krerët komunalë vazhdimin e zbatimit të Deklaratës së Përbashkët.

29. Më 26 gusht 2009, për t'iu shmangur keqkuptimeve të mundshme, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave kërkoi nga kryetarët e të gjitha komunave vazhdimin e pagesës së kompensimit në shumë prej 44 eurove.

30. Që nga miratimi i Deklaratës së Përbashkët, parashtruesja ka qenë duke e vëzhguar zbatimin e saj dhe i ka identifikuar pengesat në zbatimin e saj nga komunat përkatëse, të cilat janë përgjegjëse për sektorin e kujdesit primar shëndetësor.

31. Më 23 gusht 2010, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave ua dërgoi qarkoren buxhetore të gjitha komunave, duke konfirmuar se ua kishte alokuar mjetet e nevojshme për t'ua paguar punëtorëve të kujdesit primar shëndetësor kompensimin prej 44 eurove.

Pretendimet e parashtrueses

32. Parashtruesja pretendon se 14 komuna (shih Shtojcën A) gjatë vitit 2009 dhe 2010 nuk i kanë kryer obligimet e tyre për pagesën e kompensimit në lartësi prej 44 eurove.

33. Parashtruesja pohon që komunat në fjalë, me veprimet e tyre, e kanë shkelur kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e rendit juridik të Republikës së Kosovës, si dhe marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

34. Në veçanti, neni 93, paragrafët 1, 6 dhe 7, i Kushtetutës, nenet 62 (3) and 24 (4) të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, dhe neni 23 (2) i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut janë shkelur për shkak të moszbatimit të Deklaratës së Përbashkët të Qeverisë lidhur me kompensimin në lartësi prej 44 eurove.

35. Parashtruesja pohon që me zbatimin jo të drejtë të Deklaratës së Përbashkët është bërë diskriminimi i punëtorëve shëndetësorë të kujdesit primar, afërsisht rreth 3.545 (nga 5.892 punëtorë), për shkak se kolegëve të tyre nga kujdesi sekondar dhe terciar, si dhe të disa njësive të sektorit të kujdesit primar shëndetësor, u kompensohej shtesa prej 44 eurove.

36. Përveç kësaj, parashtruesja pohon që komunat në fjalë nuk e zbatojnë Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2010 (Ligji Nr. 03/L-177, të 14 janarit 2010), në të cilin janë paraparë mjetet për pagesën e kompensimit prej 44 eurove edhe për sektorin e kujdesit primar shëndetësor nga organet komunale.

37. Së fundi, parashtruesja kërkon nga Gjykata:

- Ta vërtetojë detyrimin e komunave përkatëse për pagesën e kompensimit prej 44 eurove për të gjithë punëtorët e kujdesit primar shëndetësor dhe ta evidentojë cenimin e kushtetutshmërisë në lidhje me Kapitullin VI, nenin 93 (1) dhe (6) mbi kompetencat e Qeverisë, si dhe cenimin e ligjshmërisë lidhur me zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-177 për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës;

- T'i obligojë këto komuna që për vitet 2009 dhe 2010 t'i shlyejnë të gjitha detyrimet ndaj punëtorëve shëndetësorë, në afat kohor jo më vonë se tre mujori i parë i vitit 2011;

- Ta vërtetojë vazhdimësinë e Deklaratës së Përbashkët të 14 tetorit 2008;

- T'i obligojë organet kompetente komunale që të gjithë veprimtarinë e tyre financiare ta kryejnë ne përputhje me

Ligjin mbi ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2010 (Ligji Nr. 03/L-177);

- Të sigurojë që kompensimin prej 44 eurove, që nuk mund të jepet në emër të shujtës ditore, të e gëzojnë të gjithë punëtorët pa marrë parasysh nëse e shfrytëzojnë a jo ndonjërin nga pushimet e parapara me legjislacionin në fuqi.

- T'i identifikojë mjetet e dedikuara për performancë dhe ta bëjë diferencimin e pagesës prej 44 euro nga ato të performancës;

- T'i lirojë të gjithë parashtruesit nga të gjitha shpenzimet procedurale që paraqiten në këto procedura.

Përgjigja nga Qeveria dhe Ministritë përkatëse

38. Më 15 gusht 2011, Qeveria dhe Ministritë përkatëse u përgjigjën:

"Niveli primar i shëndetësisë është në përgjegjësinë e plotë të komunave; prandaj komunat janë të obliguara që për këtë nivel të sigurojnë mjete nga të hyrat vetanake dhe të paguajnë shumën prej 44 euro, meqë me decentralizimin e shpenzimeve nga Ministria e Financave, menaxhimi i drejt dhe në kohë i buxhetit komunal është përgjegjësi e organizatave buxhetore në nivel lokal. Poashtu, Ministria e Administratës Publike, është e gatshme për ekzekutimin e këtyre mjeteve posa të sigurohen mjetet buxhetore për këtë destimin nga ana e komunave përkatëse".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

39. Gjykata vëren që parashtruesja pohon për shkelje të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], paragrafëve 6 dhe 7, të Kushtetutës, nenit 23.2 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, dhe

neneve 62 [Drejtorët Komunalë], paragrafi 3, dhe 24 [Parimet themelore të financave komunale], paragrafi 4, të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Nr. 03/L-040).

40. Megjithatë, për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës, në veçanti nëse parashtruesja i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit.

41. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, Aktvendim për Papranueshmëri: Maliqi dhe të tjerët kundër Shoqatës së Avokatëve të Kosovës, të 16 dhjetorit 2010, dhe *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999).

42. Sa i përket kërkesës në fjalë, Gjykata vëren që sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, nëpunës civil është *"çdo person i punësuar i një organi të punësimit, rroga e të cilit paguhet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës"*, pra duke përfshirë edhe stafin mjekësor të sistemit shëndetësor.

43. Në këtë drejtim, parashtruesit, si nëpunës civilë, patën mundësi të inicionin procedurë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në pajtim me nenet 10 dhe 11 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës.

44. Megjithatë, Gjykata vëren që me miratimin e Ligjit Nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor ishte lënë jashtë si kategori nga Shërbimi Civil në pajtim me nenin 4 [Kategoritë e punonjësve publikë të cilët nuk janë pjesë e Shërbimit Civil] të Ligjit Nr. 03/L-149.

45. Pavarësisht kësaj, Gjykata vëren që stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, në pajtim me nenin 78 [Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit] dhe nenin 79 [Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë] të Ligjit të punës Nr. 03/L-212, mund të ushtrojë padi në gjykata të rregullta.

46. Megjithatë, nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesja duket që ata nuk i kanë zbatuar procedurat e përcaktuara me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës apo me Ligjin e punës Nr. 03/L-212,

47. Prandaj, Gjykata konkludon që parashtruesja nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i ka në dispozicion sipas ligjit në fuqi.

48. Prandaj, rezulton që kërkesa duhet të hidhet poshtë në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 19 prill 2012, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Dr.Iliriana Islami Prof. Dr. Enver Hasani

Shtojca A

<u>Komunat</u>

1. Komuna e Gjakovës
2. Komuna e Podujevës
3. Komuna e Kamenicës
4. Komuna e Lipjanit
5. Komuna e Pejës
6. Komuna e Mitrovicës
7. Komuna e Vushtrrisë
8. Komuna e Klinës
9. Komuna e Rahovecit
10. Komuna e Shtimes
11. Komuna e Kastriotit
12. Komuna e Prishtinës
13. Komuna e Fushë Kosovës
14. Komuna e Gjilanit

KI 125/11 datë 28 maj 2012- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 217/2008, të datës 10.06.2011

Rasti KI 125/11, vendimi i datës 10 qershorit 2011

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, e drejta në pune, qartazi e pabazuar , Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi i kërkesës ka theksuar se me vendimin e kontestuar të autoritetit publik i është shkelur e drejta kushtetuese për punë (neni 49 - E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit).

Gjykata Kushtetuese nuk gjen fakte se Gjykata Supreme nuk ka gjykuar "drejt dhe paanshëm" duke sjellë vendimin si në revizionin e lartshënuar dhe nuk konstaton se me atë vendim të janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij", dhe Gjykata Kushtetuese nuk gjen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, andaj bazuar në rregullin 36, paragrafi 2, pika c dhe d, vendos që kërkesën ta refuzojë si qartas të pabazuar.

Prishtinë, më 30 prill 2012

Nr. ref.: RK 228/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 125/11

Parashtruesi

Shaban Gojnovci

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 217/2008, të datës 10.06.2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shaban Gojnovci nga fshati Lismir, Komuna e Fushë-Kosovës

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohet se janë bërë shkeljet e të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Kosovës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 217/2008, i datës 10.06.2011, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 01. 08. 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 28 shator 2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 217/2008, të datës 10.06.2011, me anë të të cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i është mohuar e drejta kushtetuese për punë.

Baza ligjore

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009, i

hyrë në fuqi më 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 28 shtator 2011, Gjykata Kushtuese pranoi kërkesën e z. Shaban Gojnovci dhe e regjistroi atë me nr. KI 125/11.

6. Më 3 tetor 2011, Kryetari i Gjykatës, me vendimin GJ.R. 125/11, e caktoi gjyqtaren Dr. Iliriana Islami si Gjyqtare raportuese, dhe të njëjtën ditë, me vendimin Ksh. Ki125/11, Kryetari i Gjykatës e caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje nga Robert Carolan (kryesues) dhe gjyqtarët Ivan Čukalović e Mr. sc. Kadri Kryeziu në cilësi të anëtarëve të Kolegjit.

7. Më 20 shkurt 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës dhe parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 28 shkurt 2001, Hekurudhat e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: HK) kishin nxjerrë Vendimin nr. 175 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, për shkak të shkuarjes në pritje të pensionit, për punëtorin Shaban Gojnovci, të sistemuar në vendin e punës makinist, dhe atë nga data 28 shkurt 2001.

9. Në pikën dy të këtij vendimi përcaktohet se punëtorit i sigurohet beneficioni për shërbim afatgjatë në shumë prej 120 DM për tërë vitin.

10. Në hyrje të vendimit, si bazë juridike për nxjerrjen e tij përcaktohen: ”Instruksionet Administrative 2001/3 të Departamentit të Transportit dhe Infrastrukturës”, të aprovuara më 27.02.2001”. Ndërsa në arsyetimin e tij thuhet se në bazë të këtyre instruksioneve të gjithë të punësuarve aktiv e rezervë të HK-së (rreth 350 sish) e që në vitin 2001 kanë mbërri ose e mbërrijnë moshën 60 vjeçare ose kanë 35 vjet përvojë pune duke llogaritur edhe stazhin e beneficuar, do t’u akordohet ky beneficion material për shërbim afatgjatë.

11. Më 4 maj 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë ka nxjerrë Aktgjykimin CI. nr. 428/06 me të cilin ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e përfaqësuesit të paditësit, z. Gojnovci, dhe me këtë rast ka anuluar Vendimin e HK nr. 175, të datës 28.02.2001, duke detyruar të padituren HK që paditësin ta kthejë në detyrat e punës së makinistit apo në ndonjë vend tjetër që i përgjigjet përgatitjes së tij profesionale duke ia njohur të gjitha të drejtat e marrëdhënies së punës nga data 28.02.2001.

12. Në arsyetimin e aktgjykimit të vet, Gjykata Komunale kishte theksuar se është konstatuar në mënyrë të pakontestueshme se paditësi kishte marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar tek e paditura dhe se ‘Instruksionet administrative“ të Departamentit të Transportit dhe Infrastrukturës, të 27 shkurtit 2001, nuk kishin fuqinë e akteve ligjore dhe se në kuptimin juridik –formal nuk ishin urdhëresa as rregullore të UNMIK-ut e as urdhëresa administrative, andaj shkëputja e marrëdhënies së punës duke u bazuar në dispozitat e tyre ishte e jashtëligjshme.

13. Kundër këtij aktgjykimi e paditura HK ka bërë ankesë në Gjykatën e kompetente të Qarkut në Prishtinë.

14. Më 26 shkurt 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin Ac. nr. 853/2007, me të cilin refuzoi si të pabazë ankesën e të padituës HK dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë Ci 428/2006 e vërtetoi duke e lënë në fuqi.

15. Kundër këtij aktgjykimi e paditura HK, në afat ligjor, kishte paraqitur kërkesë për Revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

16. Më 10 qershor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë Aktgjykimin Rev. nr. 217/2008, me të cilin ka aprovuar si të bazuar Revizionin e të Padituresë HK dhe me këtë rast ka ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 853/2007, të datës 26.02 2008, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë CI. nr. 428/06, të datës 04.05.2007, në mënyrë që kërkesëpadinë e paditësit, z. Shaban Gojnovci, për anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës e ka refuzuar si të PABAZUAR.

17. Gjykata Supreme në arsyetimin e aktgjykimit të saj të revizionit kishte theksuar se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vërtetuar "drejtë dhe të plotë" gjendjen faktike lidhur me faktet vendimtare, por se në këtë gjendje të vërtetuar kanë aplikuar gabimisht të drejtën materiale sepse HK, në bazë të dokumentacionit faktik të prezantuar, kanë qenë të regjistruara dhe kanë operuar me emrin "Hekurudhat e UNMIK-ut" dhe kanë qenë të administruara nga UNMIK-u, në përputhje me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47, të datës 18 gusht 2000: "UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe pasuria e tij janë të liruara nga çfarëdo lloj procesi ligjor".

18. Më 28 shtator 2011, përfundimisht i pakënaqur me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Gojnovci ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me pretendim se atij i është shkelur e drejta e garantuar për punë sipas nenit 49 të Kushtetutës së Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës ka theksuar se me vendimin e kontestuar të autoritetit publik i është shkelur e drejta kushtetuese për punë (neni 49 - E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit).

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë.

21. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë* ***shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale****,* ***të garantuara me Kushtetutë****, mirëpo* ***vetëm*** *pasi të* ***kenë shteruar të gjitha mjetet juridike*** *të përcaktuara me ligj."*

Gjykata gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartas e bazuar".

22. Duke iu referuar shkeljes së supozuar të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të konventave e instrumenteve tjera ndërkombëtare nga ana e parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstaton:

23. Në nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] pika 3 të Kushtetutës është qartazi e paraparë që: **"Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit."**

24. Në nenin **103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave)** të Kushtetutës, në pikën 2, është gjithashtu qartazi e përcaktuar se: "Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor."

25. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e verifikimit të fakteve dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, dhe se roli i sajë (Gjykatës Kushtuese) është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, *mutatis mutandis,* i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

26. Sa i përket shkeljes së pretenduar të së drejtës së garantuar për punë sipas nenit 49 të Kushtetutës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese thekson se Kushtetuta e Kosovës këtë të drejtë themelore të njeriut e garanton dhe i mundëson të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallim dhe në kushte të njëjta, ushtrimin e kësaj të drejte. Kushtetuta e Kosovës nuk i përcakton kushtet për gëzimin e kësaj të drejte, por këto kushte përcaktohen me ligje përkatëse të fushës së punës. Në këtë drejtim, nëse mënyra e themelimit, ndërprerjes apo kushteve tjera lidhur me punën janë respektuar, janë çështje të vlerësimit të ligjshmërisë dhe jo kushtetutshmërisë, andaj nëse ligji është aplikuar drejt apo jo është kompetencë e vlerësimit nga gjykatat e rregullta e që lidhen me çështjen e verifikimit të fakteve.

27. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese nuk gjen se parashtruesi i kërkesës të ketë ofruar ndonjë fakt qenësor se Gjykata Supreme, duke vendosur sipas kërkesës për revizion për të cilën shprehimisht është e autorizuar në bazë të nenit 212 të LPK-së, të ketë shkelur nenin 31.2 (E drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm), apo nenin 49 (E drejta e garantuar për punë dhe

zgjedhje të profesionit) për të cilët parashtruesi i kërkesës ka supozuar se janë shkelur.

28. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. *5503/02,* Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

29. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese nuk gjen fakte se Gjykata Supreme nuk ka gjykuar "drejt dhe paanshëm" duke sjellë vendimin si në revizionin e lartshënuar dhe nuk konstaton se me atë vendim të janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

30. Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij", dhe Gjykata Kushtetuese nuk gjen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, andaj bazuar në rregullin 36, paragrafi 2, pika c dhe d, vendos që kërkesën ta refuzojë si qartas të pabazuar, dhe

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 18 janarit 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Dr. Iliriana Islami Prof. Dr. Enver Hasani

KI 155/11 datë 18 maj 2012- Kërkesë për vlerësimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Viti nr. 22/2004, të 28 majit 2007, Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan nr. 323/2007, të 26 tetorit 2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 52/2008, të 10 qershorit 2011

Lënda Kl 155/11, vendimi i 19 prillit 2012

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të Gjykatës Komunale, Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme të Kosovës

Parashtruese i kërkesës paraqiti kërkesën në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese së Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009.
Më 1 dhjetor 2011 parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë në Gjykatë.
Më 17 janar 2012 Kryetari e emëroi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues si dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.
Më 10 shtator 2002, Gjykata Komunale në Viti nxori aktgjykimin (nr. P.o. 92/2002), me të cilin e shpalli fajtor A.B. për vepër të rëndë kundër sigurisë së komunikacionit që kishte rezultuar me vdekjen e Binaze Sahitit dhe shkaktimin e lëndimeve të rënda Mergim Sahitit. A.B. u dënua me 18 muaj burgim.
Më 27 dhjetor 2003 Gjykata Komunale në Ferizaj konkludoi se nuk ishte kompetente për çështjen e kompensimit dhe vendosi që lënda t'i dërgohej Gjykatës Komunale në Viti.
Më 28 maj 2007, me Aktgjykimin nr. 22/2004, Gjykata Komunale në Viti e urdhëroi kompaninë e sigurimeve që t'ua paguante dëmshpërblimin vetëm disa prej paditësve, më saktësisht anëtarëve të familjes së ngushtë.
Paditësit pastaj parashtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan kundër vendimit të Gjykatës Komunale në lidhje me kompensimin që u ishte caktuar.
Më 26 dhjetor 2007, me Aktgjykimin nr. 323/2007, Gjykata e Qarkut në Gjilan e vlerësoi ankesën dhe e hodhi poshtë si pjesërisht të pabazuar. Gjykata e Qarkut e vërtetoj vendimin e Gjykatës Komunale në Viti.

Më 10 qershor 2011, me Vendimin nr. 52/2008, Gjykata Supreme e Kosovës e refuzoi revizionin si të pabazuar pasi që shumat që u ishin caktuar paditësve (prindërve dhe vëllezërve) nga ana e Gjykatës së Qarkut ishin në pajtim me dispozitat materiale dhe procedurale.
Parashtruesi i kërkesës pohon se gjykatat e ulëta i kanë shkelur procedurat gjyqësore që nga fillimi i procedurave në Gjykatën e Qarkut e deri të vendimi i përfundimtar i Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e kanë shkelur Kushtetutën pa specifikuar ndonjë nen konkret të saj.
Nga kërkesa është e qartë se parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata të vlerësojë vendimet e gjykatave të ulëta në lidhje me mjaftueshmerinë e kompensimit që i është caktuar familjes Sahiti si dhe të vlerësojë vendimin për të mos dëmshpërblyer parashtruesin e kërkesës dhe anëtarët e familjes së gjerë.
Gjykata duhet të theksojë se nuk është gjykate e shkallës së katërt dhe si e tillë nuk mund të rigjykojë rastet apo të vlerësoj faktet që kane shpie gjykatat në marrjen e një vendimi të caktuar. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk i ka argumentuar pretendimet se me vendimet e gjykatave të ulëta atij dhe familjes së tij i janë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kësaj kërkese, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullave 36. (1a) dhe 36. (3c) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 19 prill 2012, njëzëri vendosi ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

Prishtinë, më 04 maj 2012

Nr. ref.: RK230/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 155/11

Parashtrues

Avni Sahiti dhe anëtarë të tjerë të familjes Sahiti

Kërkesë për vlerësimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Viti nr. 22/2004, të 28 majit 2007, Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan nr. 323/2007, të 26 tetorit 2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 52/2008, të 10 qershorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Avni Sahiti nga Lubishta, Komuna e Vitisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), në emër të tij dhe në emër të të afërmve: Binaze Sahitit dhe Mërgim Sahitit. Parashtruesi i kërkesës është xhaxhai i të ndjerës Binaze Sahiti.

2. Parashtruesi i kërkesës beson se atij dhe të gjithë anëtarëve të familjes së tij, gjithsej 27 anëtarë, u është cenuar e drejta për dëmshpërblim si rezultat i vendimeve të gjykatave të ulëta të cilat kishin vendosur që të mos u jepnin kompensim të gjithë anëtarëve të familjes, përfshirë anëtarët e familjes së gjerë, por duke e kufizuar kompensimin vetëm për prindërit dhe vëllezërit e motrat e viktimës.

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenet 113 (1) dhe 113 (7) të Kushtetutës, nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

4. Më 1 dhjetor 2011, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatë e cila u regjistrua me nr. KI155/11.

5. Më 17 janar 2012, Kryetari e emëroi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues si dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga

gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.

6. Më 19 prill 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

7. Më 10 shtator 2002, Gjykata Komunale në Viti nxori aktgjykimin (nr. P.o. 92/2002) me të cilin e shpalli fajtor A. B. për vepër të rëndë kundër sigurisë së komunikacionit që kishte rezultuar me vdekjen e Binaze Sahitit dhe shkaktimin e lëndimeve të rënda Mërgim Sahitit. A.B. u dënua me 18 muaj burgim.

8. A.B. kishte sigurim të automjetit me kompaninë "Kosova e Re". Anëtarët e familjes së gjerë dhe të ngushtë të Binaze Sahitit dhe Mërgim Sahitit parashtruan padi për dëmshpërblim nga kompania e sigurimeve për "dhimbje shpirtërore dhe fizike" si rezultat i humbjes së anëtarit të familjes së tyre, Binaze Sahiti, dhe dhimbjes së shkaktuar nga lëndimi i Mërgim Sahitit. Babai i të ndjerës po ashtu i kërkoi shpenzimet e trajtimit mjekësor të shkaktuara nga koha e aksidentit deri më 29 maj 2002 kur Binaze Sahiti vdiq në spital. Shpenzimet tjera të kërkuara përfshinin shpenzimet e varrimit dhe ngritjen e një përmendoreje.

9. Më 27 dhjetor 2003, Gjykata Komunale në Ferizaj konkludoi se nuk ishte kompetente për çështjen e kompensimit dhe vendosi që lënda t'i dërgohej Gjykatës Komunale në Viti.

10. Më 28 maj 2007, me Aktgjykimin nr. 22/2004, Gjykata Komunale në Viti e urdhëroi kompaninë e sigurimeve që t'ua paguante dëmshpërblimin vetëm disa prej paditësve, më saktësisht anëtarëve të familjes së ngushtë. Gjykata Komunale e bazoi vendimin e saj në nenin 154 të LPC duke marrë parasysh deklaratën e padisë, ekspertizën e mjekësisë ligjore dhe përfaqësimet e palëve në gjykatë. Pas vlerësimit të padisë, Gjykata Komunale vendosi që të mos miratojë tërë shumën e kërkuar.

11. Paditësit pastaj parashtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan kundër vendimit të Gjykatës Komunale në lidhje me kompensimin që u ishte caktuar. Paditësit pretendonin se Gjykata Komunale gabimisht kishte zbatuar të drejtën materiale, i kishte shkelur dispozitat procedurale dhe kishte bërë vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.

12. Më 26 tetor 2007, me Aktgjykimin nr. 323/2007, Gjykata e Qarkut në Gjilan e vlerësoi ankesën dhe e hodhi poshtë si pjesërisht të pabazuar. Gjykata e Qarkut e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale në Viti. Të pakënaqur me rezultatin në Gjykatën e Qarkut, paditësit parashtruan revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut.

13. Më 10 qershor 2011, me Vendimin nr. 52/2008, Gjykata Supreme e Kosovës e refuzoi revizionin si të pabazuar pasi që shumat që u ishin caktuar paditësve (prindërve dhe vëllezërve e motrave) nga ana e Gjykatës së Qarkut ishin në pajtim me dispozitat materiale dhe procedurale. Rrjedhimisht, u konstatua se Gjykata e Qarkut e kishte zbatuar ligjin në mënyrë të drejtë. Për më tepër, Gjykata Supreme nuk gjeti shkelje të dispozitave procedurale nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Komunale.

14. Në arsyetimin e saj Gjykata Supreme theksoi si në vijim: "Kjo gjykatë vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët në mënyre të drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale edhe në pjesën e kërkesë-padisë të paditësve tjerë kur kanë gjetur se ajo është në tërësi e pabazuar, për arsye se sipas nenit 201 par. l të LMD, parashikohet që në rast vdekjeje të ndonjë personi gjykata mund të gjykojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijës dhe prindërit) kompensim të drejtë në të holla për dhimbjet e tyre shpirtërore, ndërsa me par. 2 të të njëjtit nen parashikohet që ky kompensim mund të gjykohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se midis tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme. Në këtë rast paditësit nuk hyjnë në anëtarët e familjes së ngushtë e të ndjerës dhe nuk janë plotësuar kushtet nga par. 2 të lartpërmendur të njëjtit ligj."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se familja e gjerë po ashtu ka të drejtë në dëmshpërblim pasi që ata kanë jetuar në "bashkësi familjare" në bazë të "dokeve, zakoneve dhe traditave shqiptare (kosovare)" dhe prandaj kanë të drejtë në dëmshpërblim, jo vetëm prindërit dhe motrat e vëllezërit, pasi që ata janë "familje e madhe" dhe të gjithë kanë përjetuar humbje.

16. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se kompania e sigurimit është dashur t'i përgjigjet kërkesës së tij për të paguar për dërgimin e Binaze Sahitit jashtë vendit për trajtim mjekësor që mund t'ia kishte shpëtuar jetën.

17. Parashtruesi i kërkesës pohon se gjykatat e ulëta i kanë shkelur procedurat gjyqësore që nga fillimi i procedurave në Gjykatën e Qarkut e deri te vendimi i përfundimtar i Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e kanë shkelur Kushtetutën pa specifikuar ndonjë nen konkret të saj.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë.

19. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) (a) dhe (c) të Rregullores që përcakton se Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj dhe nëse kërkesa nuk është qartazi e pabazuar. Rregulli 36 (2) parashikon që Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se (a) kërkesa nuk arsyetohet *prima facie*; (b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese; (c) parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; apo (d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

20. Nga kërkesa është e qartë se parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata të vlerësojë vendimet e gjykatave të ulëta në lidhje me mjaftueshmërinë e kompensimit që i është caktuar familjes Sahiti si dhe të vlerësojë vendimin për të mos dëmshpërblyer parashtruesin e kërkesës dhe anëtarët e familjes së gjerë.

21. Gjykata duhet të theksojë se nuk është gjykatë e shkallës së katërt dhe si e tillë nuk mund të rigjykojë rastet apo të vlerësojë faktet që kanë çuar gjykatat në marrjen e një vendimi të caktuar.

22. Kjo kërkesë buron nga keqkuptimi i rolit të Gjykatës. Gjykata mund të mos vlerësojë faktet që çuan në marrjen e vendimeve nga ana e gjykatave të ulëta përderisa nuk ka pasur konkluzione flagrante dhe qartazi arbitrare të nxjerra nga gjykatat e që kanë rezultuar në cenimin e të drejtave dhe lirive individuale të mbrojtura me Kushtetutë (*Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë,* Vendimi i GJEDNJ-së, nr. 60654/00 i 15 janarit 2007).

23. Pas shqyrtimit të procedurave në tërësi, nuk ka prova se vendimet e gjykatave të ulëta kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë, nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).

24. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk i ka argumentuar pretendimet se me vendimet e gjykatave të ulëta atij dhe familjes së tij i janë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Prof. Dr. Enver Hasani

KI 27/11 datë 18 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 820/2010, të 25 janarit 2010

Rasti KI 27/11, vendim i 4 majit 2012

Fjalët kyçe: komisioni mjekësor për shqyrtime, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, këshilli për ankesa, pension për persona me aftësi të kufizuar,të drejtat dhe liritë kushtetuese.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me ç'rast u vërtetua vendimi i komisionit mjekësor për shqyrtime lidhur me pensionin për persona me aftësi të kufizuara. Parashtruesi pohoi se ishin shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me kushtetutë pa saktësuar ndonjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme bazuar në nein 36 (2b) të Rregullores së Punës për shkak se kërkesa ishte qartazi e pabazuar dhe se faktet e parashtruara në asnjë mënyrë nuk arsyetonin shkeljen e pretenduar të të drejtave dhe lirive kushtetuese. Duke cituar praktikën e saj gjyqësore në *rastin Nr. KI. 06/09, Parashtruesi X kunder Aktgjykimit te Gjykates Supreme Nr. 215/2006; Aktgjykimit te Gjykates se Qarkut Nr. 741/2005; Aktgjykimit te Gjykates Komunale Nr. 217/2004,* Gjykata më tujte përsëriti se nuk është gjykatë e apelit për gjykatat tjera në Kosovë dhe nuk mund të ndërhyjë mbi bazën se gjykatat e rregullta kanë marrë vendim të gabuar ose kanë bërë vlerësim të gabuar të fakteve. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

Prishtinë, më 04 maj 2012

Nr. ref.: RK 229/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 27/11

Parashtruesi

Xhevdet Rrahmani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme

Rev. Nr. 820/2010, të 25 janarit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Xhevdet Rrahmani nga fshati Lladovc i Komunës së Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 820/2010, i 25 janarit 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon se i janë shkelur të drejtat e tij si person me aftësi të kufizuara. Parashtruesi nuk përmend në mënyrë specifike asnjë nen të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për të cilin thuhet se është shkelur. Parashtruesi kërkon njohjen e të drejtës së tij për të marrë pension si person me aftësi të kufizuara.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë:

Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 28 shkurt 2011.

6. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), prof. Dr. Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.

7. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues më 7 mars 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

8. Më 5 shtator 1980, babait të parashtruesit i ishte njohur e drejta për shtesa për asistencë dhe kujdes për fëmijën me aftësi të kufizuara (për parashtruesin) nga BVI-ja republikane (Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit) për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Punëtorëve, Bashkësia për qytetin e Beogradit.

9. Më 27 janar 2006, parashtruesit iu miratua pensioni për persona me aftësi të kufizuara, u bë rektoaktiv që nga 12 janari 2005. Në atë kohë ishte konstatuar që parashtruesi i përmbushte kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë lidhur me përzgjedhshmërinë për pension të aftësisë së kufizuar dhe ishte njoftuar me anë të një shkrese se përzgjedhshmëria e tij do të shqyrtohej sërish brenda pesë vjetësh.

10. Më 20 prill 2010, përzgjedhshmëria e parashtruesit ishte rishqyrtuar nga Komisioni mjekësor për shqyrtime – Departamenti i Administratës Pensionale (në tekstin e mëtejmë: Komisioni) dhe parashtruesit i ishte mohuar pensioni i aftësisë së kufizuar ngaqë konsiderohej se ai nuk kishte paaftësi të plotë dhe të përhershme.

11. Më 8 qershor 2010, parashtruesi ushtroi ankesë në Këshillin e ankesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuar (në tekstin e mëtejmë: Këshilli).

12. Më 28 korrik 2010, ankesa e parashtruesit u refuzua si e pabazuar. Këshilli gjeti që vlerësimi i Komisionit se nuk kishte pasur prova të mjaftueshme për t'ia lejuar përzgjedhshmërinë për përfitime nga pensioni për paaftësi të plotë dhe të përhershme ishte i drejtë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

13. Parashtruesi u ankua në Gjykatën Supreme kundër vendimit të Këshillit. Në këtë ankesë, parashtruesi e kontestonte ligjshmërinë e vendimit të Komisionit dhe pretendoi se Komisioni nuk i kishte marrë parasysh provat që ai i kishte paraqitur lidhur me gjendjes e tij të rëndë mjekësore dhe paaftësinë e tij për punë.

14. Më 25 janar 2011, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin A. nr. 820/2010, e refuzoi ankesën si të pabazuar. Gjykata Supreme gjeti që komisioni e kishte zbatuar drejt Ligjin Nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë pasi kishte konstatuar se parashtruesi nuk i përmbushte kriteret e nenit 3 të atij Ligji.

15. Ky vendim iu dorëzua parashtruesit më 15 shkurt 2011.

Pala që bart barrën e të provuarit të fakteve

16. Në përputhje me rregullin 29.2 (h) të Rregullores së punës, është detyrë e parashtruesit që kërkesës t'ia bashkëngjisë "informacionet dhe dokumentacionin mbështetës".

Argumentet ligjore të paraqitura nga parashtruesi

17. Parashtruesi pohon që gjetjet e Gjykatës Supreme, të Këshillit dhe të Komisionit ia shkelin të drejtat e tij si person me aftësi të kufizuara. Në veçanti, parashtruesi duket të argumentojë se Komisioni dështoi t'i merrte parasysh provat e paraqitura nga parashtruesi kur erdhi në përfundim se ai nuk ishte i përzgjedhshëm për pension për aftësi të kufizuara. Parashtruesi nuk ka specifikuar cili nen i Kushtetutës së Republikës së Kosovës është shkelur, por mund të konkludohet se ai beson që është shkelur neni 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale].

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregullore të punës.

19. Neni 113, paragrafët 1 dhe 7, i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme ligjore që kërkohet për pranueshmëri. Ai përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *(...)*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

20. Përveç kësaj, neni 48 i Ligjit thotë:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

21. Së fundi, rregulli 36 i Rregullores së punës thotë:

"1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) kërkesa është qartazi e bazuar.

2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

22. Parashtruesi duket të pohojë, por nuk e cek në mënyrë specifike në kërkesën e tij, që është shkelur neni 51 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 51 thotë:

"1. Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.

2. Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj."

23. Dispozita përkatëse e Ligjit në fjalë, neni 3 i Ligjit Nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, përcakton kriteret për përcaktimin e aftësisë së kufizuar:

"3.1 Për të fituar të drejtën në pension të aftësisë së kufizuar, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë banim të përhershëm në Kosovë dhe t'i përmbushë kërkesat, sipas këtij ligji, që duhet përmbushur për pension të aftësisë së kufizuar.

3.2 Komisionet mjekësore do të vlerësojnë gjendjen shëndetësore të parashtruesve të kërkesave për pensionet e aftësisë së kufizuar. Vlerësimet e aftësisë së kufizuar nga ana e komisioneve mjekësore duhet të jenë me shkrim dhe duhet të përfshijnë me sa vijon:

a) Deklaratën e posaçme të diagnozës për gjendjen faktike, ndijore apo mendore, sëmundjen apo aftësinë e kufizuar prej të cilës parashtruesi i

kërkesës vuan dhe datën e paraqitjes së gjendjes, sëmundjes apo aftësisë së kufizuar; diagnoza duhet të përshkruajë gjendjen shëndetësore, sëmundjen ose aftësinë e kufizuar si dhe ndikimin e posaçëm të gjendjes shëndetësore, sëmundjes apo aftësisë së kufizuar në punësim, duke përfshirë përshkrimin e thukët të funksionimit të dobësuar të parashtruesit të kërkesës.

b) Vlerësimin e funksionimit të parashtruesit të kërkesës për sa i përket detyrave të përditshme dhe atyre lidhur me punësim; ky duhet të përfshijë referencën e punësimit të mëparshëm të parashtruesit të kërkesës, nëse ka qenë i punësuar.

c) Përcaktimi se a mund apo nuk mund të punësohet parashtruesi i kërkesës, në çfarëdo cilësie, duke i pasur parasysh rrethanat e përgjithshme të sëmundjes ose aftësisë së kufizuar.

d) Përcaktimi i aftësisë së plotë të kufizuar për një periudhë prej një viti apo më gjatë, gjatë secilës kohë parashtruesi i kërkesës ka qenë i paaftë për punësim të shpërblyeshëm.

e) Prognozimi i aftësisë së kufizuar të përhershme.

3.3 Personat që banojnë ose janë mbyllur në institucione të tipit të mbyllur ose që marrin ndihmë të rregullt dhe të vazhdueshme financiare nga institucionet që përkujdesen për personat me aftësi të kufizuar, duke i përfshirë institucionet psikiatrike, institucionet religjioze që përkujdesen për të sëmurit ose njerëzit me aftësi të kufizuar, shkollat rezidenciale, burgjet dhe institucionet e tjera që mbështeten nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për t'u përkujdesur për njerëzit me aftësi të kufizuar, nuk do të jenë të përzgjedhshëm për pensionin e aftësisë së kufizuar, sipas këtij ligji.

3.4 Personat të aftë për punësim apo që aktualisht janë të punësuar në çfarëdo mënyre duke përfshirë çfarëdo lloji vetëpunësimi, siç përkufizohet në ligjet tatimore të Kosovës, nuk do të jenë të përzgjedhshëm për pensionin e aftësisë së kufizuar. Përzgjedhshmëria për pensionin e aftësisë së kufizuar do të pushojë në ditën e parë të punësimit ose vetëpunësimit...”

24. Neni 4.6 i Ligjit Nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, u referohet dëshmive në të cilat Komisioni mund ta bazojë vendimin e vet, duke përcaktuar:

“Komisioni mjekësor mund ta mbështesë vendimin e vet në bazë të dëshmive të parashtruesit të kërkesës për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të aftësisë së kufizuar të përhershme dhe/ose në bazë të ekzaminimeve dhe të gjeturave të tyre mjekësore. Të gjithë parashtruesit e kërkesave duhet t’u nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore që bëhen nga komisioni mjekësor. Komisioni mjekësor nuk është i obliguar që ta pranojë dëshminë mjekësore të cilën e paraqet parashtruesi i kërkesës por mund ta marrë atë parasysh në përcaktimin e tij.”

25. Parashtruesi nuk paraqet prova në kërkesën tij se Ligji Nr. 2003/23 ishte shkelur, duke rezultuar kështu në shkelje të nenit 51 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në të vërtetë, ligji posaçërisht thekson se Komisioni nuk duhet të mbështetet në provat e ofruara nga parashtruesi i kërkesës në përcaktimin e tij.

26. Siç është thënë nga Gjykata Kushtetuese në Rastin Nr. KI. 06/09, Parashtruesi X kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Nr. 215/2006; Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Nr. 741/2005; Aktgjykimit të Gjykatës Komunale Nr. 217/2004:

"...Gjykata dëshiron të theksojë se nuk është gjykatë e apelit për gjykatat e tjera në Kosovë dhe se nuk mund të ndërhyjë mbi bazën se gjykatat e tilla kanë marrë vendim të gabuar ose kanë bërë vlerësim të gabuar të fakteve. Roli i Gjykatës është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si gjykatë "e shkallës së katërt", (shih, mutatis mutandis, ndër të tjera, Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65).

27. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhje me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, i cili thotë: *"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese"*.

PËR KËTO ARSYE

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 7 mars 2012, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'i komunikohet parashtruesit; dhe

III. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 87/11 datë 11 qershor 2012- Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.Nr.247/2007, të 12 janarit 2011

Lënda KI 87/11, vendimi i marsit 2012

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, e drejta e pronës, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Paraqitësi i kërkesës e ka paraqitur parashtresën në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 15 janar 2009.

Paraqitësi i kërkesës, më 29 qershor 2011 i ka paraqitur kërkesë Gjykatës.
Kryetari, më 17 gusht 2011 e ka emëruar gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj gjyqtare raportuese dhe Kolegjin për shqyrtim në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur padi pranë Gjykatës Komunale në Gjilan për përcaktimin e së drejtës pronësore.
Gjykata Komunale në Gjilan, me aktvendimin e datës 10 janar 2007, e ka miratuar padinë e paraqitësit të kërkesës dhe ka konstatuar se paraqitësi i kërkesës dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij janë pronar të pronës.Gjykata e Qarkut në Gjilan, me aktvendimin e datës 22 qershor 2007 e ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe e ka refuzuar ankesën e anës së kundërt.
Ndërkaq, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktvendimin e datës 12 janar 2011 i ka anuluar aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta duke refuzuar padinë e paraqitësit të kërkesës lidhur me pronën.
Gjykata Supreme e ka shqyrtuar gjendjen faktike në lëndë dhe ka konstatuar se gjykatat më të ulëta në mënyrë të gabueshme e kanë zbatuar ligjin duke vendosur në dobi të kërkesëpadisë së paraqitësit të kërkesës.Gjykata Supreme i ka marrë parasysh këto fakte: Gjykata Supreme nuk është pajtuar me vendimin e gjykatave më të ulëta se

paraqitësi i kërkesës e ka fituar të drejtën e pronës me anë të mbajtjes (ruajtjes së pronës).

Paraqitësi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese shqyrtimin e plotfuqishmërisë kushtetuese të vendimit të Gjykatës Supreme dhe të zbatoj masat e përkohshme, në mënyrë që të sigurohet që aktvendimi i Gjykatës Supreme të mos ketë efekt juridik, nëse konstatohet se e shkel Kushtetutën.
Gjykata Kushtetuese thekson se sipas Kushtetutës nuk është detyrë e saj që të veproj si gjykatë apeli apo gjykatë e shkallës së katërt.Gjykata Kushtetuese thekson se ajo vetëm mund ta shqyrtojë se a janë paraqitur provat në atë mënyrë, si dhe procedura në përgjithësi, duke shikuar në tërësi që paraqitësi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë.
Gjykata ka qëndrim se faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pohimin për shkeljen e së drejtës kushtetuese të mbrojtjes së pronës.Gjykata Kushtetuese, në vështrim të nenit 113. paragrafi 7. të Kushtetutës, nenit 27. të Ligjit dhe rregullit 36 të Rregullores së punës, njëzëri vendos të REFUZOJË kërkesën për masa të përkohshme dhe kërkesën e refuzon si të papranueshme.

Prishtinë, më 10 maj 2012

Nr. ref.: RK231/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 87/11

Parashtruesi

Ukshin Aliti

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.Nr.247/2007, të 12 janarit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Ukshin Aliti, banor i Gjilanit. Ai përfaqësohet nga avokati Gani Tigani.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Gjilan për përcaktimin e të drejtave të tij pronësore për parcelat Nr. 1727 dhe 1728, të regjistruara në komunën kadastrale të Gjilanit (në tekstin e mëtejmë: prona). Parashtruesi pohon që këtë pronë e ka trashëguar nga babai i tij i ndjerë, z. Riza Aliti. Më 10 janar 2007, Gjykata Komunale e miratoi kërkesëpadinë dhe vërtetoi se parashtruesi është pronar i pronës. Palët kundërshtare në atë çështje ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan. Më 22 qershor 2007, Gjykata e Qarkut e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale dhe e refuzoi ankesën. Më 12 janar 2011, Gjykata Supreme e Kosovës i anuloi vendimet përkatëse të Gjykatës Komunale dhe të Gjykatës së Qarkut dhe e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit.

3. Parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese ta shqyrtojë vlefshmërinë kushtetuese të vendimit të Gjykatës Supreme dhe të lëshojë masë të përkohshme për të siguruar që aktgjykimi i Gjykatës Supreme të mos ketë efekt ligjor nëse konstatohet se është ai marrë në kundërshtim me Kushtetutën.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 27, 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Gjykatën Kushtetuese), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 29 qershor 2011.

6. Më 17 gusht 2011, Kryetari e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues) dhe Enver Hasani e Iliriana Islami.

7. Më 19 mars 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

8. Thuhet që babai i ndjerë i parashtruesit e kishte blerë pronën në vitin 1964 dhe kishte lidhur kontratë gojore për shitblerje. Prandaj, parashtruesi pohon që posedimi filloi prej vitit 1964 nga babai i tij pa ndërprerje, dhe më pas nga pasardhësit e tij, duke përfshirë parashtruesin, deri në vitin 1996 – 1997.

9. Gjykata Komunale në Gjilan, me Aktgjykimin C.Nr.26/2004, të 10 janarit 2007, e miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit dhe vërtetoi se parashtruesi dhe anëtarët e tjerë të familjes së tij ishin pronarë të pronës.

10. Gjykata e Qarkut në Gjilan, me Aktgjykimin Ac.Nr.165/2007, të 22 qershorit 2007, e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe e refuzoi ankesën e palës kundërshtare.

11. Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev.Nr.247/2007, të 12 janarit 2007, i anuloi aktgjykimet e gjykatave më të ulëta dhe e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit për pronë.

12. Parashtruesi pohon që aktgjykimi i Gjykatës Supreme, i 12 janarit 2011, i është dorëzuar më 13 prill 2011.

13. Gjykata Supreme e shqyrtoi gjendjen faktike të rastit dhe gjeti që gjykatat më të ulëta e kishin zbatuar gabimisht ligjin duke vendosur në favor të kërkesëpadisë së parashtruesit. Gjykata Supreme i shqyrtoi faktet në vijim:

a. Në bazë të raportit të ekspertit të gjeodezisë, të 2 gushtit 2000, prona ishte e regjistruar në emrin e KB "Mlladost" në vitin 1954-1955. Tani, prona është e regjistruar nën emrin e KM "Agrokultura";

b. KB "Mlladost" dhe një palë e tretë "A" (emrat nuk tregohen) lidhën kontratë për ndërrimin e pronës së paluajtshme nr.804, të 28 korrikut 1997, e cila u vërtetua nga Gjykata Komunale në Gjilan (Vr.nr.1427/97, e 28 korrikut 1997);

c. Pala e tretë "A" (emrat nuk tregohen) lidhi kontratë për shitblerjen e pronës më 20 shtator 1997, e cila u vërtetua nga Gjykata Komunale në Gjilan (Vr.nr.1315/2000, e 11 korrikut 2000);

d. Prandaj, parashtruesi humbi posedimin e pronës në vitin 1996-1997 kur pala e tretë fitoi të drejtën pronësore mbi pronën;

e. Prona u rregullua nga pronari, pala e tretë, dhe shumë shtëpi u ndërtuan në të dhe disa u shitën më pas;

f. Kontrata gojore e shitblerjes që parashtruesi e konsideron si bazë të së drejtës pronësore është e pavlefshme pasi nuk i përmbush kriteret formale që kërkohen me ligjin në fuqi për pronën e paluajtshme. Ligji në fuqi kërkon që kontratat e këtij lloji të jenë në formë të shkruar dhe të nënshkruara nga palët, dhe të vërtetuara në gjykatë. Nuk u përmbush asnjëri kriter për kontratë të vlefshme;

g. Gjykata Supreme nuk u pajtua me vendimin e gjykatave më të ulëta se parashtruesi i fitoi të drejtat pronësore përmes parashkrimit fitues;

h. Parashtruesi u bë mbajtës me mirëbesim i patundshmërisë nga momenti i trashëgimisë, që thuhet se ka ndodhur më 20 shkurt 1994, data e vdekjes së Riza Alitit. Gjykata Supreme tha me sa vijon: *"Paditësi si trashëgimtar bëhet mbajtës me mirëbesim të patundshmëris nga momenti i hapjes së trashëgimisë. Nga çertifikata e vdekjes shifet se paraardhësi i paditësve Riza Aliti ka vdekur më 20.02.1994, ndërsa paditësit kanë humbur posedimin kontestues në vitin 1996-1997, aandaj në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga paragrafi 4 i nenit 28 i LMTHJP, që paditësit të fitojnë të drejtën e pronësis në pronën kontestuese me parashkrim."*

14. Duke pasur parasysh situatën faktike të përshkruar më sipër, Gjykata Supreme konsideroi që ka pasur arsye për ndryshimin e aktgjykimeve të gjykatave më të ulëta.

Shkeljet e supozuara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë

15. Parashtruesi pohon se aktgjykimi i Gjykatës Supreme ia shkel të drejtat e garantuara me Kushtetutë për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje të pronës në përputhje me nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës. Parashtruesi pohon që qasja e Gjykatës Supreme është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 80.6 (Hyrja në Fuqi e Ligjit) lidhur me nenin 102.3 (Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor), i cili thotë që *"Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit"*. Parashtruesi e pohon këtë pasi koha e parashtrimit përfundoi gjersa vetë Riza Aliti ishte gjallë (1964 fillimi i kohës së parashkrimit dhe posedimi i 20 vjetëve mbaron me vitin 1984), gjë që nuk kontestohet. Nga ky këndvështrim, parashtruesit i duket që qëndrimi i Gjykatës

Supreme të Kosovës është shumë i papranueshëm dhe jokushtetues.

Vlerësimi i masës së përkohshme

16. Sa i përket kërkesës së parashtruesit që Gjykata Kushtetuese të lëshojë masë të përkohshme për të siguruar që aktgjykimi i Gjykatës Supreme të mos ketë efekt ligjor, kjo kërkesë nuk përmban prova apo arsye të mjaftueshme që mund ta justifikojnë vënien e masës së përkohshme.

17. Në veçanti, parashtruesi nuk ka treguar, siç kërkohet me nenin 27 të Ligjit, se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse masa e përkohshme nuk vihet. Përveç kësaj, nuk është përcaktuar që vënia e masës së përkohshme do të ishte në interes publik.

18. Prandaj, kriteret për vënien e masës së përkohshme nuk janë përmbushur dhe kërkesa e parashtruesit duhet të hidhet poshtë.

Vlerësimi i pranueshmërisë

19. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë.

20. Në këtë drejtin, Gjykata i referohet nenit 53 të Kushtetutës, i cili thotë:

> *"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."*

21. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

> "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*"

22. Së fundi, Gjykata i referohet Rregullores së punës, sidomos:

    a. Rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, sipas të cilit: *Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse kërkesa është qartazi e bazuar.*

    b. Dhe rregullit 36 (2) (b) dhe (d), sipas të cilit: *Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se faktet e paraqitura nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

23. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

24. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).

25. Fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim, ECHR Kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

26. Sa i përket ankesës së parashtruesit për shkeljen e supozuar të nenit 46 të Kushtetutës, mbrojtja e pronës, si dhe të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, Gjykata rikujton që kjo zbatohej vetëm për posedimet ekzistuese të personit.

27. Prandaj, shpresa që e drejta në pronë që është shuar kaherë mund të rikthehet nuk mund të konsiderohet "posedim", e as kërkesa me kusht që është parashkruar si rezultat i mospërmbushjes së kushtit (shih *Gratzinger dhe Gratzingerova* kundër Republikës së Çekisë (vendim) [DHM], nr. 39794/98, paragrafi 69, GJEDNJ 2002-VII). Megjithatë, në rrethana të caktuara, "pritja legjitime" e fitimit të një "pasurie" gjithashtu mund ta gëzojë mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Prandaj në rastet kur interesi pronësor është në natyrën e kërkesës, mund të konsiderohet se personi në fjalë ka pritje legjitime nëse ka bazë të mjaftueshme për atë interes në ligjin vendës, p.sh. kur ka praktikë gjyqësore të përcaktuar nga gjykatat vendëse me të cilën vërtetohet ekzistimi i saj (shih *Kopecký kundër Sllovakisë* [DHM], nr. 44912/98, paragrafi. 52, GJEDNJ 2004-IX). Megjithatë, nuk mund të thuhet që pritja legjitime mund të ndodhë nëse ka kontest lidhur me interpretimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit vendës dhe më pas parashtresat e parashtruesit refuzohen nga gjykatat vendëse (shih *Kopecký*, cituar më lart, paragrafi 50).

28. Gjykata rikujton që në rastin në fjalë ka kontest lidhur me interpretimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit në fuqi dhe më pas parashtresat e parashtruesit refuzohen nga Gjykata Supreme.

29. Prandaj, Gjykata është e kënaqur që faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e justifikojnë pohimin për shkelje të së drejtës kushtetuese për mbrojtje të pronës.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Dr. Gjyljeta Mushkolaj Prof. Dr. Enver Hasani

KI 150/11 datë 28 maj 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 396/11, të 7 qershorit 2011

Lënda KI 150/11, vendimi i datës 05 maj 2012.

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur parashtresë në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20,22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 15 janar 2009.Paraqitësi i kërkesës më 21 nëntor 2011 i ka paraqitur kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.
Kryetari, më 17 janar 2012, e ka emëruar Kadri Kryeziun gjyqtar raportues dhe Kolegjin për shqyrtim në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Enver Hasani.

Paraqitësit të kërkesës, Departamenti për familjet e viktimave, të invalidëve të luftës dhe të viktimave cilivile, më 28 janar 2011, ia ka refuzuar kërkesën për pension të invalidit të UÇK-së pasi që i ka munguar vërtetimi origjinal i shtabit të përgjithshëm të KZK-së.

I pakënaqur me këtë vendim, paraqitësi i kërkesës ka ushtruar ankesë pranë departamentit të lartpërmendur.

Seksioni i ankesave i departamentit të lartpërmendur, më 8 prill 2011, ka marrë vendim me të cilin është refuzuar ankesa e paraqitësit të kërkesës.Sipas vendimit të datës 8 prill 2011, ankesa e paraqitësit të kërkesës është refuzuar sepse dokumentin të cilin e ka dërguar paraqitësi i kërkesës nuk ka vërtetuar se i njëjti ka qenë anëtarë i UÇK-së dhe që është plagosur.
Paraqitësi i kërkesës, më 5 maj 2011 ka ushtruar padi pranë Gjykatës Supreme për anulim të vendimit të datës 8 prill 2011.Paraqitësi i kërkesës ka pohuar se vendimi i përmendur është i padrejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata Supreme, më 7 qershor 2011, me aktvendimi A.nr.396/2011, e ka refuzuar padinë e paraqitësit të kërkesës.

Paraqitësi i kërkesës pohon se Gjykata Supreme dhe organet e mëparme drejtuese nuk i kanë konstatuar faktet në mënyrë të drejtë.

Gjykata, pas shqyrtimit të kërkesës së paraqitësit thekson se sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt në rastin e shqyrtimit të vendimeve të marra nga ana e gjykatave të rregullta.Roli i gjykatave të rregullta është interpretimi dhe zbatimi i rregullave përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale.Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, gjykata nuk ka konstatuar që veprimet përkatëse në çfarëdo mënyrë të kenë qenë të padrejta apo të baltosura me arbitraritet.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. paragrafin 7. të Kushtetutës dhe rregullin 36. të Rregullores së punës, njëzëri ka vendosur që kërkesën e paraqitësit ta refuzojë si të papranueshme.

Prishtinë, më 11 maj 2012

Nr. ref.: RK232/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 150/11

Parashtrues

Naser Shala

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Gjykatës Supreme të Kosovës

A. nr. 396/11, të 7 qershorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi është Naser Shala, banor i Prishtinës.

Objekti i çështjes

2. Objekti i çështjes në kërkesë është shkelja e pretenduar e të drejtës së parashtruesit për pensionin invalidor të garantuar me Ligjin nr. 02/L- për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Heronjve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe të Familjeve të Viktimave Civile të Luftës.

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit nr. 03/L0121 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe Rregullin 56(2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Vendimi i kontestuar

4. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 396/11, të datës 7 qershor 2011, që parashtruesit i është dorëzuar më 10 tetor 2011.

Procedura në Gjykatë

5. Më 21 nëntor 2011, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 17 janar 2011, Kryetari caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Enver Hasani.

7. Më 4 maj 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Sipas dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesi faktet e rastit mund të përmblidhen si në vijim:

9. Më 28 janar 2011, Departamenti i Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në Prishtinë me Vendimin e vet nr. 01-01/7043 hodhi poshtë ankesën e parashtruesit për pensionin invalidor të UÇK–së sepse i mungonte certifikata origjinale nga Zyra Qendrore e TMK-së.

10. Parashtruesi, i pakënaqur me këtë vendim, u ankua në divizionin e ankesave të departamentit të lartpërmendur.

11. Divizioni i ankesave, më 8 prill 2011, ka sjellë vendimin e vet dhe hodhi poshtë ankesën e parashtruesit. Sipas vendimit të 8 prillit 2011, ankesa e parashtruesit është hedhur poshtë sepse dokumenti i paraqitur nga parashtruesi nuk dëshmonte që ai ishte anëtar i UÇK-së dhe që ishte plagosur mes datës 30.12.1991 dhe 19.09.1999 gjatë periudhës së veprimit në UÇK, ashtu si përshkruhet në nenin 7.4 dhe nenin 19, paragrafi 4 të Ligjit për vlerat e luftës nr.02/L (në tekstin e mëtejmë: Ligji nr. 02/L) dhe Urdhëresa Administrative nr. 09/2006 të MPMS.

12. Parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme për anulimin e vendimit të 8 prillit 2011. Parashtruesi pohoi se vendimi i kontestuar ishte i padrejtë dhe joligjor për shkak të konfirmimit jo të plotë dhe të gabuar të situatës faktike dhe zbatimin e gabueshëm të së drejtës materiale. Parashtruesi thekson se autoriteti i shkallës së parë ka konstatuar situatën faktike në mënyrë të gabuar, pa shqyrtuar si duhet dokumentet mjekësore të paraqitura nga parashtruesi.

13. Më 7 qershor 2011, Gjykata Supreme me Aktgjykimin A. nr. 396/2011 hodhi poshtë ankesën e parashtruesit. Gjykata

Supreme erdhi në përfundim se divizioni i ankesave në Departamentin e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, ka konfirmuar situatën faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë kur ka hedhur poshtë ankesën e parashtruesit. Gjykata Supreme u pajtua me arsyetimin e vendimit të parë dhe të dytë administrativ se parashtruesi ka dështuar të paraqesë certifikatën që do të dëshmonte datën dhe vendin e plagosjes së supozuar të parashtruesit gjatë kryerjes së detyrës si ushtar i UÇK-së.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme si dhe organet administrative kanë vërtetuar faktet në mënyrë jo të drejtë, dhe se në fakt ai ka qenë pjesëtar i plagosur i UÇK-së i cili pra ka të drejtë në përfitime sipas ligjeve në fuqi.

15. Parashtruesi pretendon se janë shkelur dispozitat përkatëse të Ligjit n3. 02/L-2 për Statusin dhe te Drejtat e Familjeve të Heronjve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës.

16. Parashtruesi thjeshtë pretendon se gjykatat e mëparshme kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të GJEDNJ.

Vlerësimi i pranueshmërisë

17. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë.

18. Sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të veprojë si gjykatë e apelit lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García

Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

19. Në rastin e ankesës së parashtruesit për pension invalidor, parashtruesit i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë, para Departamentit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile dhe para Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

20. Përfundimisht, kërkesa për pranueshmëri nuk është përmbushur në këtë kërkesë. Parashtruesi ka dështuar të mbështesë pretendimin se vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të tij.

21. Prandaj, del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me Rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës që përcakton: "Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b)faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese."

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 12/59, të datës 1 shkurt 2012

Rasti KI 17/12, vendimi i datës 11 maj 2012

Fjalet kyçe: dinjiteti i njeriut, kërkesë individuale, mosshterje e mjeteve juridike.

Parashtruesi paraqiti kërkesën në perputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës duke pretenduar që me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 12/59, të datës 1 shkurt 2012, në bazë të cilit parashtruesi i kërkesës është shkarkuar nga pozita e anëtarit të Bordit të Kompanisë Rajonale Ujësjellësi "Hidrodrini" SH.A, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Dinjiteti i Njeriut) dhe neni 26 (E Drejta e Integritetit Personal), duke e shkarkuar parashtruesin e kërkesës nga pozita e anëtarit të Bordit të Kompanisë Rajonale Ujësjellësi " Hidrodrini".

Gjykata Kushtetuese ka konstatuar që kërkesa është e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike efektive.

Prishtinë, më 11 maj 2012

Nr. ref.: RK 254/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 17/12

Parashtrues

Elez Hajdaraj

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 12/59, të datës 1 shkurt 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Elez Hajdaraj (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës) me banim në fshatin Shushicë, Komuna e Istogut.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik, vlerësimi i kushtetutshmërisë i të cilit kërkohet nga Gjykata Kushtetuese, është Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 12/59, i datës 1 shkurt 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më datën 23 shkurt 2012.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), më 28 shkurt 2012, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 12/59, të datës 1 shkurt 2012, në bazë të cilit parashtruesi i kërkesës është shkarkuar nga pozita e anëtarit të Bordit të Kompanisë Rajonale Ujësjellësi "Hidrodrini" SH.A. (në tekstin e mëtejmë: KUR), me seli në Pejë.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

6. Më 28 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë dhe e njëjta u regjistrua në Gjykatë më nr. KI 17/12.

7. Më 29 shkurt, me Vendimin GJ.R.KI 17/12, Kryetari i Gjykatës e caktoi Gjyqtar raportues gjyqtarin Altay Suroy, ndërsa me Vendimin KSH 17/12 Kolegjin shqyrtues në përbërje Ivan Cukalovic (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami në cilësi të anëtarëve të Kolegjit.

8. Më 5 mars 2012, Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar Agjencinë kundër Korrupsionit lidhur me kërkesën e parashtruar.

9. Më 5 mars 2012, Gjykata kishte njoftuar Qeverinë e Republikës së Kosovës lidhur me kërkesën e parashtruar.

10. Më 16 mars 2012, Agjencia kundër Korrupsionit kishte dërguar në Gjykatë përgjigje lidhur me kërkesën, në të cilën thekson se ”z. Hajdaraj ka qenë i informuar me kohë lidhur me dyshimin për ekzistimin e konfliktit të interesit pasi që i njëjti ka ushtruar funksionin e anëtarit të Bordit të Drejtorëve dhe si ‘Zyrtar përgjegjës i sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime”, situatë kjo që është në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.02-L-133 dhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr.03-L-087. Ndërsa ai nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që brenda afatit ligjore të zgjidhë këtë situatë, andaj kjo agjenci, në përputhje me kompetencat ligjore, i ka

propozuar Qeverisë shkarkimin e tij nga funksioni i anëtarit të Bordit në Ndërmarrjen publike KUR "Hidrodrini" SH.A.-Pejë.

11. Më 20 mars, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte dërguar në Gjykatë përgjigje në njoftim në të cilën shpjegon se procedura e shkarkimit të z,Elez Hajdaraj nga pozita e anëtarit të Bordit të N.P. KUR "Hidrodrini" ishte iniciuar nga Agjencia kundër Korrupsionit, dhe se propozimin e kësaj agjencie Qeveria e kishte miratuar si të bazuar, andaj, konform gjendjes së konstatuar nga kjo Agjenci për konfliktin e interesit të cilin z. Hajdaraj nuk e kishte mënjanuar, edhe është marrë vendimi për shkarkim.

12. Më 9 maj 20012, Kolegji shqyrtues, në përbërje si në paragrafin 6 të këtij aktvendimi, i propozoi njëzëri Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

13. Më 16 tetor 2008, Zyra e Sekretarit të Përhershëm e Qeverisë së Kosovës ka publikuar në mediumet publike në Kosovë konkursin për Drejtor të Bordeve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore, e në pikën 11 edhe për KUR "Hidrodrini" SH.A.-Pejë.

14. Më 24 dhjetor 2008, Qeveria e Republikës së Kosovës mori Vendimin Nr. 12/48, me të cilin në Bordin e Ndërmarrjes Publike KUR "Hidrodrini" SHA-Pejë emëroi këta kandidatë: 1) z. Shkëlzen Hyseni, kryesues; 2) z. Rexhë Abazi; 3) z. Elez Hajdaraj (parashtruesin e kërkesës në GJ.K.) dhe 4) z. Kolë Berisha.

15. Më 23 prill 2009, Qeveria e Republikës së Kosovës mori Vendimin Nr. 10/61 për ndryshimin e Vendimit Nr. 12 /48, të datës 24 dhjetor 2008, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të KUR "Hidrodrini" SH.A.-Pejë, me të cilin anëtarin e bordit, z. Kolë Berisha, e zëvendëson me anëtarin e ri z. Gjelosh Gojani, ndërsa edhe në bazë të këtij vendimi i z. Elez Hajdaraj mbetet i emëruar në pozitën e anëtarit të Bordit të kësaj Ndërmarrje Publike.

16. Më 4 nëntor 2009, parashtruesi i kërkesës e paditë KUR " Hidrodrini" në Gjykatën Komunale në Istog, për kompensim të ardhurave të realizuara në bazë të punës si anëtar i Bordit. Gjykata Komunale në Istog këtë padi e regjistroi më shifrën C. Nr. 314/09.

17. Më 28 dhjetor 2009, pala e paditur, KUR "Hidrodrini", përgjigjet në padinë e parashtruesit të kërkesës C.Nr 314/09, duke e kundërshtuar në tërësi padinë si të pabazë. Sipas palës së paditur, parashtruesi i kërkesës në këtë kompani, në bazë të kontratës për punësim në mes të parashtruesit të kërkesës dhe palës së paditur nr. 27 të datës 19 shkurt 2009, z. Elez Hajdaraj është emëruar në pozitën " Përgjegjës i sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizim" dhe sipas tyre një person nuk mund të merr të ardhura të dyfishta nga e njëjta ndërmarrje.

18. Më 24 shtator 2010, Gjykata Komunale në Istog, në bazë të Aktgjykimit C. nr. 314/09, e aprovon padinë e parashtruesit të kërkesës dhe në këtë mënyrë pala e paditur është e obliguar që t'ia kompensojë, në afat prej 15 ditësh, shumën në vlerë prej 5.400,00 Euro (pesë mijë e katërqind) të realizuara në bazë te punës si anëtar i Bordit.

19. Nga shkresat e bashkangjitura me kërkesën nuk mund të konstatohet fakti nëse ndaj këtij aktgjykimi është ushtruar ndonjë ankesë.

20. Më 17 maj 2011, Agjencia kundër Korrupsionit e kishte njoftuar z. Elez Hajdaraj lidhur me inicimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit lidhur me funksionin e parashtruesit të kërkesës si anëtar i Bordit të drejtorëve krahas pozitës si punëtor i rregullt në kompaninë KUR "Hidrodrini".

21. Më 20 korrik 2011, Agjencia kundër Korrupsionit e kishte paralajmëruar sërish parashtruesin e kërkesës për gjendjen e konfliktit të interesit, dhe kishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që në afat prej 30 ditësh të ndërmarrë të gjithë hapat për shmangien e konfliktit të interesit.

22. Më 1 gusht 2011, parashtruesi i kërkesës i është përgjigjur Agjencisë kundër Korrupsionit, duke theksuar se persona për qëllime të caktuara brenda ndërmarrjes i kishin falsifikuar shkresat në të cilat parashtruesi emërohej si "Zyrtar", dhe se ai në pozitën e anëtarit të Bordit të Drejtorëve ishte zgjedhur në bazë të konkursit të rregullt.

23. Më 6 tetor 2011, Agjencia kundër Korrupsionit, me shkresën nr. AKK-DP-03/11, i propozon Qeverisë së Kosovës **shkarkimin** e z. Elez Hajdaraj nga pozita e anëtarit të Bordit të KUR "Hidrodrini" SH.A., në Pejë, pasi që është konstatuar gjendja e konfliktit të interesit të tij me Ndërmarrjen publike ku është anëtarë i Bordit të drejtorëve.

24. Më 1 shkurt 2012, Qeveria e Kosovës në bazë të vendimit 12/59 e aprovon kërkesën e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe vendos që parashtruesin e kërkesës, z. Elez Hajdaraj, të shkarkojë nga pozita e anëtarit të Bordit të drejtorëve në KUR "Hidrodrini" SH.A. -Pejë, duke dhënë arsyetimin sikur në paragrafin 12 të këtij raporti.

Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara kushtetuese

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 12/59, të datës 1 shkurt 2012, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si në vijim: neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Dinjiteti i Njeriut) dhe neni 26 (E Drejta e Integritetit Personal),
ndërsa nga Gjykata Kushtetuese ka kërkuar prishjen e Vendimit të Qeverisës së Kosovës nr. 12/59, të datës 01.02.2012, dhe gjithashtu ka kërkuar që Gjykata Kushtetuese ta "detyrojë" Agjencinë kundër Korrupsionit që atij t'i kërkojë "falje publike" nëpërmes mjeteve të informimit publik për shkak të shkeljes së dinjitetit të tij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës të Gjykatës.

25. Lidhur me këtë i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

> "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

26. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 par. 1, pika(a) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese ku qartë përcaktohet se Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

> " Janë shterur të gjitha mjetet efektive juridike të përcaktuar me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar".

27. Për të konstatuar faktin nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriterin e pranueshmërisë së shterjes së mjeteve juridike para se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese, Gjykata merr parasysh dispozitat ligjore që rregullojnë këtë materie juridike dhe veçanërisht dispozitat e: Ligjit për Administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Ligji nr 03/L-189), Ligjit për Procedurën Administrative (Ligji nr. 02/L-28), Ligjit Për Konfliktet Administrative (Ligji nr. 03. L/202) dhe Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, dhe atë:

Ligji për Procedurën Administrative

Neni 1.

1.1. Dispozitat e këtij Ligji zbatohen nga të gjitha organet e administratës publike gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre nëpërmjet akteve individuale dhe kolektive.

Ligji për Administratën Shtetërore

Neni 2

1.1 Autoritetet e larta të administratës shtetërore – Qeverinë si tërësi, Kryeministrin, Zëvendës Kryeministrat dhe ministrat.

1.2. Organet e larta të administratës shtetërore - Zyra e Kryeministrit dhe Ministritë janë organet e larta të administratës shtetërore përmes të cilave Autoritetet e Larta të Administratës Shtetërore ushtrojnë kompetencat e tyre qeveritare dhe administrative.

Neni 4 - Punët e Administratës Shtetërore

1. Punët e administratës shtetërore janë:

1.6 Vendosja në procedurën administrative mbi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe personave juridik.

Ligji Për Konfliktet Administrative

Neni 3 -Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Organ -** organet e administratës publike, organet e qeverisjes qendrore dhe organet e tjera në varësi të tyre, organet e vetëqeverisjes lokale dhe organet në varësi të tyre, kur në ushtrimin e autorizimeve publike vendosin në çështjet administrative.

1.2. **Akt administrativ -** çdo vendim të organit të paraparë në nën-paragrafin 1.1. të këtij paragrafi, i cili merret në fund të një procedure administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe që prek, në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjërisht, liritë ose interesat e personave fizikë ose juridikë përkatësisht palës tjetër në vendosjen e çështjes administrative.

Neni 11

Konflikti administrativ, sipas aktpadisë, zgjidhet nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Neni 13

1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë.

2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.

28. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të sigurojë mjet efikas ligjor për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis,* GJEDNJ, Selmouni v. France nr. *25803/94,* Vendim i 28 korrikut 1999).

29. Sa i përket çështjeve të ngritura lidhur me procedurën e zhvilluar nga Agjencia kundër Korrupsionit dhe dyshimit të ngritur lidhur me aplikimin e drejtë të Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Ligji nr. 03 L -155) dhe të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji 03L-087), Gjykata thekson se Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e verifikimit të fakteve dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i sajë (i Gjykatës Kushtuese) është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, *mutatis mutandis,* i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

30. Për më tepër, në nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], pika 3, të Kushtetutës është qartazi e paraparë që: **"Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit."**

31 Në këto rrethana, kërkesa është **e papranueshme,** sepse parashtruesi i kërkesës **nuk i ka shteruar** të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohej Gjykatës **Kushtetuese** dhe rrjedhimisht nuk i ka plotësuar kriteret për pranueshmërinë e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 9 majit 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 129/10 datë 28 maj 2012 - Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 15/2003 të 30 qershorit 2004

Rasti KI 129/2010, vendimi i datës 4 maj 2012
Fjalët kyçe: kontest administrativ, kërkesa individuale, kërkesë e paafatshme "ratione temporis" me dispozitat kushtetuese dhe të ligjit.

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr 15/ 2003 i janë shkeluar te te drejtat e tij kushtetuese te garantuara me Nenin 24 [Barazia para Ligjit], Nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], si dhe me Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata ka vërejtur se kërkesa kishte të bënte me ngjarje para 15 qershorit 2008, respektivisht para datës së hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prandaj, në bazë të kësaj, kërkesa ishte dorëzuar pas afatit kohor të parapare dhe kësisoj Gjykata konsideroi se kërkesa nuk ishte në përputhje *"ratione temporis"* me dispozitat e Kushtetutës. Gjykata në këtë raste kishte cituar rastin *Jasiunienė kundër Lituanisë*, Kërkesa nr. 41510/98, aktgjykimi i GJEDNJ-së të 6 marsit dhe 6 qershorit 2003). Si përfundim, Gjykata kishte konstatuar se kërkesa nuk i kishte përmbushur kriteret procedurale të lejueshmërisë, siç kërkoheshin me rregullin 36.3 (h) të Rregullores se punës se Gjykatës.

Prishtinë, më 14 maj 2012

Nr.Ref.:RK233/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 129/10

Parashtruesi

Agron Xhaferi

Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 15/2003 të 30 qershorit 2004

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Z. Agron Xhaferi, me banim në Prishtinë, të cilin e përfaqëson z. Ferki Xhaferi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutë është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr 15/2003 i 30 qershorit 2004, i cili i është dorëzuar parashtruesit të Kërkesës më 5 korrik 2004.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr 15/2003 të 30 qershorit 2004, ku parashtruesi i Kërkesës pretendon që me këtë aktgjykim i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, për shkak të refuzimit të ankesës se tij, si e të pabazuar, lidhur me kundërshtimin e vendimeve e të Shërbimit Doganor të Kosovës,

përkatësisht, me procedurat e vlerësimit të mallit ne pikën doganore të Pejës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe Rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtuese

5. Më 22 dhjetor 2010, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 14 shkurt 2011 Kryetari me vendimin GJR KI 129/10 caktoi Gjyqtar raportues, gjyqtaren Iliriana Islami. Të njëjtën ditë, Kryetrari, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu (anëtar) dhe Enver Hasani (anëtar).

7. Më 27 janar 2011, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme të Kosovës.

8. Më 4 maj 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 18 qershor 2002, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur Kontratë me ndërmarrjen "Fabrika Duhana Sarajeva" me qëllim të blerjes së duhan cigareve të llojit " Aura", për import dhe shitje me pakicë në tregun e Kosovës.

10. Më 27 shtator 2002, në Degën Doganore në Pejë kishte arritur një sasi e duhanit në bazë të faturës nr. 22 të 23 shtatorit 2002, me ç'rast parashtruesi pretendon se malli i tije është mbivlerësuar në dëm të tij dhe në bazë të vlerësimit të mallit, i është caktuar edhe lartësia e pagesës doganore me të cilën parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë dakord.

11. Parashtruesi i kërkesës, pohon se, më 11 nëntor 2002 në baze të prezantimit të Dokumentit Unik Doganor nr.17419 nga i cili rezulton se në të njëjtën pikë doganore, me të njëjtin lloj të mallit, ka kaluar proceduarat doganore ndërmarrja " Gradina" nga Zveqani malli i së cilës është vlerësuar shumë më ulët krahasuar me vlerësimin që i është bërë parashtruesit të kërkesës.

12. Më 15 nëntor 2002, Shërbimi Doganor i UNMIK-ut, pas paraqitjes së Kërkesës për përsëritje të procedurës nga ana e parashtruesit të kërkesës, nxori vendimin 07/Nr.2391, me ç'rast e refuzoi kërkesën e parashtruesit për përsëritje të procedurës lidhur me vlerësimin e vlerës doganore të mallit (duhanit), pasi që në Nenin 129 paragrafi 2 të Ligjit të Aplikueshëm Doganor thuhet se, kundërshtimi nuk mund të ushtrohet pasi që malli lëndor të dalë nga mbikëqyrja Doganore, si dhe nga shkresat e lëndës shihet se, vlera doganore e caktuar, është caktuar drejtë dhe në përputhje me nenin 35 të Ligjit Doganor.

13. Më 26 nëntor 2002, Drejtori i Shërbimi Doganor i emëruar nga Administrata e UNMIK-ut, duke vendosur në shkallë të dytë në bazë të ankesës së parashtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër vendimit 07/Nr.2391, nxori vendimin nr. 2391, me ç'rast e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pa bazë. Më tutje në arsyetim thuhet se, organi i shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe konform metodës së përcaktuar me nenin 35 të Ligjit të aplikueshëm Doganor.

14. Më 30 qershor 2004, Gjykata Supreme, pas ushtrimit të padisë nga ana e parashtruesit të kërkesës, nxori aktgjykimin A.nr.15/2003 dhe e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës, përmes së cilës kishte kërkuar që të prishet vendimi i shërbimit doganor 07 nr. 2392 i 16 dhjetorit 2002. Në arsyetimin e kësaj

gjykate thuhet se, parashtruesi i kërkesës (paditësi) nuk ka paraqitur prapësim në afatin e paraparë, siç është përcaktuar me nenin 129 të Ligjit të aplikueshëm Doganor të Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr 15/ 2003 te 30 qershorit 2004, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si në vijim:

- Neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës;
- Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës;
- Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës;
- Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe
- Neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës.

17. Në lidhje me këtë kërkesës, Gjykata Kushtetuese konstaton se parashtruesi i kërkesës konteston aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr 15/ 2003 të 30 qershorit 2004. Kjo do të thotë se kërkesa ka të bëjë me ngjarje para 15 qershorit 2008, respektivisht para datës së hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prandaj, në bazë të kësaj, kërkesa është dorëzuar pas afatit kohor të parapare dhe kësisoj nuk është në përputhje *"ratione temporis"* me dispozitat e Kushtetutës dhe

të Ligjit (shih *mutatis mutandis Jasiūnienė kundër Lituanisë, Kërkesa nr. 41510/98, aktgjykimi i GJEDNJ-së të 6 marsit dhe 6 qershorit 2003).*

18. Rrjedhimisht kërkesa është e papranueshme në pajtim me rregullin 36.3 (h) të Rregullores së Punës që parasheh:

Rregulli 36.3(h) *„një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:*

h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën.“

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim Rregullin 36.3 (h), dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 4 maj 2012, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar Raportues **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Dr. Iliriana Islami Prof. Dr. Enver Hasani

KO 38/12 datë 05 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012

Lënda KO 38/12, nga data 15 maj 2012.

Fjalët kyçe;Kryetari i Kuvendit të Republikës, vlerësimi i amendamenteve kushtetuese

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë (parashtresë) në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 15 janar 2009.
Më 26 nëntor 2011 paraqitësi i kërkesës i ka bërë kërkesë Gjykatës Kushtetuese.
Kryetari i Kuvendit, më 12 prill 2012 ka paraqitur kërkesë lidhur me propozimin e Qeverisë për amendamentet kushtetuese.
Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës i është dërguar kryetarit të Republikës së Kosovës, kryeministrit të Kosovës dhe Ombudspersonit.

Gjykata ka theksuar se amendamentet, ndër të tjera, propozojnë shlyerjen e nenit 146. dhe 147. të Kushtetutës, me të cilat përcaktohet mandati, pushteti dhe obligimet e PNC-së.Gjykata po ashtu është thirrur në nenin 5. paragrafi 2. të Aneksit IX të propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (PGJZ) në të cilin thuhet:”*5.2 Mandati i PNC-së pushon atëherë kur Grupi Drejtues Ndërkombëtar konstaton se Kosova i ka zbatuar dispozitat e kësaj zgjidhjeje”.*

Gjykata përkujton se në pajtim me nenin 113. paragrafi 9. i Kushtetutës:*”Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës”.*

Pas shqyrtimit të Kërkesës e cila përmban propozimit e Qeverisë për amendamentet kushtetuese, të cilin më 12 prill 2012 e ka paraqitur kryetari i Kuvendit të Republikës, në bazë të nenit 113. paragrafi 9. Gjykata Kushtetuese njëzëri vendosi se kërkesa është e papranueshme.

Gjykata konstaton se nga 22 amendamente që përfshihen në propozimin e Qeverisë lidhur me amendamentet kushtetuese që me 12 prill 2012 i ka paraqitur kryetari i Kuvendit, del se vetëm amendamenti nr.17 i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

Prishtinë, më 15 maj 2012

Nr. ref.:AK 234 /12

Rasti KO 38/12

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Kërkesa

1. Më 28 mars 2012, Qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 92.4, 93.4 dhe 9, dhe 144.1, nxori Vendimin Nr. 02/68 për miratimin e Propozimeve për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës).

2. Në përputhje me të njëjtin Vendim, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit u obligua t'ia procedonte Kuvendit të Republikës së Kosovës Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës.

3. Më 5 prill 2012, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit ia përcolli Sekretarit të Kuvendit të Kosovës Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës.
4. Më 12 prill 2012, Kryetari i Kuvendit të Kosovës, në përputhje me nenin 114.3 të Kushtetutës, ia paraqiti Gjykatës Kushtetuese Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës për të

vlerësuar paraprakisht nëse amendamentet e propozuara pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

5. Prandaj, Kryetari i Kuvendit është parashtrues i kërkesës në procedurën në Gjykatën Kushtetuese.

6. Kërkesa është e bazuar në nenet 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 54 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-121), të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

7. Objekt i çështjes së kërkesës janë 22 amendamentet e propozuara për Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të miratuara me Vendimin Nr. 02/68 të Qeverisë së Kosovës më 28 mars 2012.

8. Që në fillim duhet të theksohet se pjesa më e madhe e amendamenteve të propozuara kanë të bëjnë me ndryshimet brenda Kapitullit XIII "Dispozitat Përfundimtare" dhe Kapitullit XIV "Dispozitat Kalimtare" të Kushtetutës.

9. Në të vërtetë, këto amendamentime shprehin synimin e Qeverisë për të propozuar ndryshime në Kushtetutë që janë të nevojshme për përmbylljen e pavarësisë së mbikëqyrur të Republikës së Kosovës. Kjo gjithashtu shihet qartë nga preambula e Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, pasi ajo thirret në Rezolutën për Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 31 janar 2012.

Procedura në Gjykatë

10. Kryetari i Kuvendit e dorëzoi kërkesën lidhur me Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës më 12 prill 2012.

11. Më 13 prill 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova.

12. Më 20 prill 2012, Kryetari i Kuvendit u njoftua se Gjykata e ka regjistruar kërkesën.

13. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Presidentes së Republikës së Kosovës, Kryeministrit të Kosovës dhe Avokatit të Popullit.

14. Më 23 prill 2012, Gjykata e njoftoi Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar (PCN) se kërkesa e sipërpërmendur ishte pranuar nga Gjykata.

15. Më 2 maj 2012, Gjykata e njoftoi PCN-në se Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës kanë të bëjnë, ndër të tjera, me disa dispozita kalimtare në Kushtetutë, si dhe me autoritetin e PCN-së për të vazhduar funksionin e vet. Në atë shkresë, Gjykata theksoi se Ligji për Gjykatën Kushtetuese përcakton që Gjykata duhet të vendosë lidhur me amendamentet e propozuara, sipas mundësisë, brenda 60 ditëve pas pranimit të kërkesës.

16. Gjykata theksoi se amendamentet propozojnë, ndër të tjera, fshirjen e neneve 146 dhe 147 të Kushtetutës, të cilët specifikojnë mandatin, kompetencat dhe obligimet e PCN-së. Gjykata gjithashtu iu referua nenit 5.2 të Aneksit IX të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (PGJZ), i cili përcakton që "Mandati i PCN-së do të skadojë atëherë kur Grupi Drejtues Ndërkombëtar të konstatojë se Kosova i ka përmbushur kushtet e kësaj zgjidhjeje".

17. Ligji për Gjykatën Kushtetuese e obligon Gjykatën të vendosë për amendamentet e propozuara brenda 60 ditëve. Ndërkohë, Gjykata do të vazhdojë vlerësimin e vet nën arsyetimin se

Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës nuk do të parashtrohen për miratim nga Kuvendi para se të jetë përmbushur kushti nga neni 5.2 i Aneksit IX të PGJZ-së lidhur me përfundimin e mandatit të PCN-së.

18. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e përgatitur nga Gjyqtari raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë.

19. Gjykata u këshillua dhe votoi për këtë kërkesë më 10 maj 2012.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Sa i përket kërkesës për vlerësimin paraprak të amendamenteve të propozuara të Kushtetutës, në përputhje me nenin 144 [Amendamentimi], Gjykata vëren që, për të gjykuar për kërkesën, ajo së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata duhet së pari të përcaktojë nëse ka juridiksion për të ofruar vlerësim për Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës.

22. Gjykata rikujton që, në përputhje me nenin 113.9 të Kushtetutës, *"Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës*".

23. Si rrjedhojë, Gjykata ka juridiksion të vlerësojë nëse amendamentet e propozuara i zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

24. Pyetja tjetër është kush mund të konsiderohet palë e autorizuar për ta parashtruar kërkesën në Gjykatë në përputhje me nenin 113.9 të Kushtetutës. Gjykata ripërsërit se në përputhje me pjesën

e parë të fjalisë së nenit 113.9: "*Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara .....*".

25. Në kërkesën në fjalë, Kryetari i Kuvendit, Dr. Jakup Krasniqi, e dorëzoi kërkesën për të vlerësuar paraprakisht amendamentet e propozuara të Kushtetutës. Prandaj, parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, ka të drejtë ta ngrejë këtë rast në Gjykatë sipas nenit 113.9 të Kushtetutës.

26. Prandaj, kërkesa është e pranueshme pasi Gjykata ka juridiksion për ta shqyrtuar atë dhe parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara

Shtrirja e vlerësimit kushtetues

27. Gjykata tani do ta shqyrtojë secilin amendament të përmendur në Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës dhe të dorëzuar nga parashtruesi më 12 prill 2012.

28. Si vërejtje paraprake, Gjykata thekson se në përputhje me nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit VIII [Gjykata Kushtetuese], Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Prandaj, është detyrë e Gjykatës ta interpretojë nenin 144 [Amendamentimi] të Kushtetutës siç e konsideron të nevojshëm.

29. Duke marrë këtë parasysh, Gjykata, sipas nenit 144.3 të Kushtetutës, vlerëson nëse një amendament i propozuar i Kushtetutës do të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës [Të Drejtat dhe Liritë Themelore].

30. T'i kthehemi Kapitullit II, Gjykata vëren që në përputhje me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit II, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, sipas nenit 21.2, Republikës së Kosovës i takon t'i mbrojë dhe garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara në këtë Kushtetutë.

31. Prandaj, Gjykata konsideron që neni 21 përcakton shtrirjen e Kapitullit II për t'i përfshirë edhe ato të drejta dhe liri themelore të njeriut të përcaktuara gjetiu në Kushtetutë. Rezulton që Gjykata duhet të vlerësojë nëse amendamentet e propozuara pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e garantuara me Kushtetutë si tërësi.

Amendamentet e propozuara

I. Amendamenti 1 i propozuar

32. Amendamenti 1 propozon që paragrafi 4 i nenit 58 të ndryshohet si vijon:

> *"Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar barazi të plotë dhe efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore dhe* ***pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje.*** *Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit".*

33. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar për nenin 58.4 të Kushtetutës e fuqizon pjesëmarrjen efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në jetën publike.

34. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti 1 i propozuar nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

II. Amendamenti 2 i propozuar

35. Amendamenti 2 propozon që paragrafi 1 i nenit 81 të ndryshohet si vijon:

> **Neni 81 [Legjislacioni me Inertes Vital]**
>
> 1. Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet **vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë në shumicë** :"

36. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar për nenin 81.1 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

37. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti 2 është në përputhje me Kapitullin II.

III. Amendamenti 3 i propozuar

38. Amendamenti 3 propozon që paragrafi 5 i nenit 81 të Kushtetutës të ndryshohet si vijon:

(5) Ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe **zonave të veçanta të mbrojtura**."

39. Gjykata konsideron se formulimi i amendamentit të propozuar për nenin 81.5 të Kushtetutës, pra shtimi i "*dhe zonave të veçanta të mbrojtura*", nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

40. Prandaj, Gjykata konfirmon se amendamenti 3 i propozuar është në përputhje me Kapitullin II.

IV. Amendamenti 4 i propozuar

41. Amendamenti 4 propozon që neni 143 i Kushtetutës të fshihet.

42. Neni 143 i Kushtetutës thotë si vijon:

"Neni 143 [Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës]

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute:

1. Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Ato do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre.

2. Dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë.

3. Kushtetuta, ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë."

43. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 143 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

V. Amendamenti 5 i propozuar

44. Amendamenti 5 propozon që neni 144 i Kushtetutës (Amendamentimi) të bartet tek Kapitulli I – Dispozitat Themelore.

45. Neni 144 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 144 [Amendamentimi]

1. Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, sipas Rregullores së Punës të Kuvendit, mund të propozojnë ndryshime dhe amendamentime të kësaj Kushtetute.

2. Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës.

3. Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

4. Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

46. Gjykata konsideron se bartja e propozuar e nenit 144 të Kushtetutës tek Kapitulli I (Dispozitat Themelore) nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

VI. Amendamenti 6 i propozuar

47. Amendamenti 6 propozon që neni 145 i Kushtetutës (Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm) të bartet tek Kapitulli I – Dispozitat Themelore.

48. Neni 145 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 145 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm]

1. Marrëveshjet ndërkombëtare dhe aktet e tjera për bashkëpunimin ndërkombëtarë, që janë në fuqi ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të vazhdojnë të respektohen deri atëherë kur ato marrëveshje ose akte të rinegociohen ose kur të bëhet tërheqja nga to në pajtueshmëri me kushtet e tyre ose deri atëherë kur ato të zëvendësohen nga marrëveshje ose akte të reja ndërkombëtare me të cilat mbulohen fushat e njëjta dhe që janë miratuar në pajtim me këtë Kushtetutë.

2. Legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë.

49. Gjykata konsideron se bartja e propozuar e nenit 145 të Kushtetutës tek Kapitulli I (Dispozitat Themelore) nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

VII. Amendamenti 7 i propozuar

50. Amendamenti 7 propozon që neni 146 i Kushtetutës të fshihet.

51. Neni 146 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 146 [Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil]

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:

1. Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil dhe organizatat e akterët e tjerë ndërkombëtarë të mandatuar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, kanë mandatin dhe kompetencat e përcaktuara me Propozimit Gjithëpërfshirës duke përfshirë zotësinë juridike si dhe privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara me të.

2. Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës bashkëpunojnë plotësisht me Përfaqësuesin Ndërkombëtarë Civil, organizatat dhe akterët tjerë ndërkombëtarë të mandatuar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007 dhe ndër të tjera i'u japin fuqi ligjore vendimeve ose akteve të tyre.

52. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 146 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

VIII. Amendamenti 8 i propozuar

53. Amendamenti 8 propozon që neni 147 i Kushtetutës të fshihet.

54. Neni 147 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 147 [Autoriteti Përfundimtarë i Përfaqësuesit Ndërkombëtarë Civil]

> Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute, Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, është autoriteti përfundimtarë në Kosovë lidhur me interpretimin e aspekteve civile të Propozimit Gjithëpërfshirës. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka jurisdiksion të rishikojë, të pakësojë ose në ndonjë mënyrë të kufizojë mandatin, kompetencat dhe detyrimet e përcaktuara në nenin 146 dhe në këtë nen.

55. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 147 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

IX. Amendamenti 9 i propozuar

56. Amendamenti 9 propozon që neni 148 i Kushtetutës të fshihet.

57. Neni 148 i Kushtetutës thotë si vijon:

> **Neni 148 [Dispozitat Transicionale për Kuvendin e Kosovës]**
>
> 1. Për dy (2) mandatet e para zgjedhore, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të ketë njëzet (20) vende të rezervuara për përfaqësim të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë në mënyrën si vijon: Dhjetë (10) vende do t'u ndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, që janë deklaruar se përfaqësojnë

komunitetin Serb të Kosovë, dhe dhjetë (10) vende do t'u ndahen komuniteteve të tjera si vijon: komunitetit Rom një (1) vend; komunitetit Ashkali një (1) vend; komunitetit Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali ose Egjiptian, i cili ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komunitetit Boshnjak tri (3) vende, komunitetit Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend. Çdo vend i fituar përmes zgjedhjeve, do të jetë vend shtesë, përveç dhjetë (10) vendeve të rezervuara që u ndahen përkatësisht komunitetit Serb të Kosovës dhe komuniteteve të tjera.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, mandati ekzistues në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të konsiderohet si mandati i parë zgjedhor i Kuvendit, në rast se ky mandate zgjat për së paku dy vite nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.

58. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 148 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

X. Amendamenti 10 i propozuar

59. Amendamenti 10 propozon që neni 149 i Kushtetutës të fshihet.

60. Neni 149 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 149 [Miratimi Fillestar i Ligjeve me Interes Vital]

Pavarësisht nga dispozitat e Nenit 81 të kësaj Kushtetute, ligjet me interes vital të radhitura në atë nen, do të miratohen fillimisht me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm të Kuvendit dhe që votojnë.

61. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 149 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XI. Amendamenti 11 i propozuar

62. Amendamenti 11 propozon që neni 150 i Kushtetutës të fshihet.

63. Neni 150 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 150 [Procesi i Emërimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve]

1. Shqyrtimi gjithëpërfshirës mbarëkosovar për përshtatshmërinë e të gjithë kandidatëve për emërime të përhershme për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë, deri në moshën e pensionimit të përcaktuar me ligj, do të vazhdojë të bëhet në pajtim me Urdhëresën Administrative 2008/2 dhe nuk do të ndikohet nga përfundimi i mandatit të UNMIK-ut, ose nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute.

2. Të gjithë kandidatët e suksesshëm, të cilët janë emëruar ose riemëruar për gjyqtarë dhe prokurorë nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, si pjesë e procesit të emërimit, do të vazhdojnë të shërbejnë në postet e tyre deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre, ose deri atëherë kur ata të shkarkohen në pajtim me ligjin.

3. Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial do t'i paraqesë me shkrim Këshillit Gjyqësor të Kosovës rekomandimet për kandidatët për emërimin dhe riemërimin e tyre si gjyqtarë dhe prokurorë, i cili ushtron pushtetin përfundimtar, që t'ia propozojë Presidentit të Kosovës kandidatët për emërim dhe riemërim si gjyqtarë dhe prokurorë.

4. Të gjithë kandidatët e suksesshëm, të cilët janë emëruar ose riemëruar nga Presidenti I Kosovës si gjyqtarë dhe prokurorë, sipas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si pjesë e procesit të emërimit, do të vazhdojnë të shërbejnë në këto poste deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre, ose deri atëherë kur ata të shkarkohen në pajtim me ligjin.

5. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 105 të kësaj Kushtetute, mandati i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve që në mënyrë të suksesshme e kalojnë procesin e emërimit siç është përcaktuar në këtë nen dhe të cilët kanë ushtruar funksionin së paku dy vjet para emërimit, sipas këtij neni, është i përhershëm deri në moshën e pensionimit sikurse është përcaktuar më ligj, përveç nëse shkarkohen në pajtim me ligjin.

64. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 150 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XII. Amendamenti 12 i propozuar

65. Amendamenti 12 propozon që neni 151 i Kushtetutës të fshihet.

66. Neni 151 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 151 [Përbërja e Përkohshme e Këshillit Gjyqësor të Kosovës]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të përbëhet siç vijon:

1. Pesë (5) anëtarë janë anëtarë kosovarë të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, që janë verifikuar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, si pjesë e fazës së parë dhe të dytë të procesit të emërimit, në pajtim me Urdhëresën Administrative 2008/02. Prej këtyre pesë (5) anëtarëve, një (1) gjyqtar dhe një (1) prokuror të zgjedhur sipas metodës së rastësisë, do të shërbejnë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës deri në skadimin e natyrshëm të mandateve të tyre ekzistuese, kur do të zëvendësohen me një (1) gjyqtar dhe një (1) prokuror të verifikuar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial dhe që janë zgjedhur nga ana e kolegëve të tyre, duke iu përmbajtur metodave që kanë për qëllim sigurimin e përfaqësimit sa më të gjerë të shërbimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë. Dy (2) gjyqtarët e mbetur dhe një (1) prokuror nga radhët e pesë (5) anëtarëve kosovarë të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, do të shërbejnë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës për një mandat plotësues njëvjeçar pas skadimit të natyrshëm të mandatit të tyre, kur ata do të zëvendësohen me procedurë të njëjtë sikur edhe ish-kolegët e tyre të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Në rast të themelimit të një subjekti përgjegjës për çështjet e emërimit,

disiplinës dhe shkarkimit të prokurorëve, të gjithë anëtarët e tjerë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të jenë gjyqtarë.

2. Tetë (8) anëtarët e tjerë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të zgjedhen nga Kuvendi i Kosovës në mënyrën e përcaktuar me këtë Kushtetutë, përveç dy (2) nga katër (4) anëtarët e zgjedhur nga deputetët e Kuvendit që mbajnë vende të fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve, duhet të jenë ndërkombëtarë, të përzgjedhur nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil, sipas propozimit të Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtes. Njëri nga anëtarët ndërkombëtarë duhet të jetë gjyqtar.

67. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 151 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XIII. Amendamenti 13 i propozuar

68. Amendamenti 13 propozon që neni 152 i Kushtetutës të fshihet.

69. Neni 152 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 152 [Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Gjykata kushtetuese do të përbëhet si në vijim:

1. Gjashtë (6) nga nëntë (9) gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit.

2. Nga gjashtë (6) gjyqtarët, dy (2) do të shërbejnë për një mandat trevjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, dy (2) do të shërbejnë për një periudhë gjashtëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe dy (2) do të shërbejnë për një periudhë nëntëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes. Mandatet e gjyqtarëve fillestarë do të zgjidhen me short, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, menjëherë pas emërimit të tyre.

3. Nga gjashtë (6) gjyqtarët, katër (4) do të zgjidhen votat e dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë. Dy (2) do të zgjidhen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, pas pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet që janë rezervuar ose garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

4. Tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tre (3) gjyqtarët nuk do të jenë qytetarë të Kosovës dhe as të ndonjë vendi fqinj.

5. Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil do të përcaktojë se kur skadon mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë, dhe gjyqtarët do të ndërrohen sikur është e parashikuar me Kushtetutë.

70. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 152 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XIV. Amendamenti 14 i propozuar

71. Amendamenti 14 propozon që neni 153 i Kushtetutës të fshihet.

72. Neni 153 i Kushtetutës thotë si vijon:

> **Neni 153 [Prania Ndërkombëtare Ushtarake]**
>
> Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute, Prania Ndërkombëtare Ushtarake ka mandatin dhe kompetencat e përcaktuara nga instrumentet relevante ndërkombëtare, përfshirë Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007. Kryesuesi i Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, është autoriteti final në zonën operative për sa i përket interpretimit të atyre aspekteve të marrëveshjes së përmendur që i referohen Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka jurisdikcion të rishikojë, të pakësoj ose përndryshe të kufizoj mandatin, kompetencat dhe detyrimet e referuara në këtë nen.

73. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 153 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XV. Amendamenti 15 i propozuar

74. Amendamenti 15 propozon që neni 154 i Kushtetutës të fshihet.

75. Neni 154 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 154 [Trupat e Mbrojtjes të Kosovës]

Trupat e Mbrojtjes të Kosovës do të shpërbëhen brenda një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute. Deri në shpërbërje, Prania Ndërkombëtare Ushtarake, në konsultim me Përfaqësuesin Ndërkombëtarë Civil dhe Republikën e Kosovës do të ketë autoritet ekzekutiv mbi Trupat e Mbrojtjes të Kosovës dhe vendos për dinamikën kohore të shpërndarjes.

76. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 154 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XVI. Amendamenti 16 i propozuar

77. Amendamenti 16 propozon që neni 155 (Shtetësia) i Kushtetutës të bartet tek Kapitulli I – Dispozitat Themelore.

78. Neni 155 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 155 [Shtetësia]

1. Të gjithë banorët e ligjshëm të Kosovës në datën e miratimit të kësaj Kushtetute, gëzojnë të drejtën e shtetësisë së Republikës së Kosovës.

2. Republika e Kosovës ua njeh të drejtën në shtetësinë e Republikës së Kosovës, pavarësisht nga vendbanimi i tyre i tanishëm dhe shtetësia që ata kanë, të gjithë qytetarëve të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë, të cilët kanë qenë banorë të përhershëm të Kosovës me datën 1 janar 1998, dhe pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë.

79. Gjykata konsideron se bartja e propozuar e nenit 154 të Kushtetutës tek Kapitulli I (Dispozitat Themelore) nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XVII. Amendamenti 17 i propozuar

80. Amendamenti 17 propozon që neni 156 (Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit) të fshihet.

81. Neni 156 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit]

Republika e Kosovës promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre.

82. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 156 të Kushtetutës do të mund të pakësonte disa të drejta dhe liri të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

83. Në të vërtetë, me nenin 22 të Kushtetutës miratohen disa konventa ndërkombëtare duke u thirrur në to. Në një pjesë të nenit posaçërisht përcaktohet:

> **Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]**
>
> Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:
>
> (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
>
> (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

84. Nenet 13 dhe 14 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) posaçërisht përcaktojnë si vijon:

> **Neni 13 i DUDNJ-së**

"(1) Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të çdo shteti.

(2) Gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet".

Neni 14

"(1) Gjithkush ka të drejtë të kërkojë dhe gëzoje në vende të tjera azil nga ndjekjet.

(2) Këtë të drejtë nuk mund ta gëzojë askush në rast se ndiqet për krime jopolitike ose për vepra në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara".

85. Ngjashëm, neni 2 i Protokollit Nr. 4 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ) garanton lirinë e lëvizjes. Ai thotë si vijon:

Neni 2 i Protokollit Nr. 4 të KEDNJ-së

"Liria e lëvizjes

1. Kushdo që ndodhet në mënyrë të ligjshme në territorin e një Shteti ka të drejtë, brenda këtij territori, të lëvizë lirisht në të dhe të zgjedhë lirisht vendbanimin e tij.

> 2. Çdo person është i lirë të largohet nga çdo vend, duke përfshirë të tijin.
>
> 3. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund të bëhet objekt i kufizimeve të tjera nga ato të parashikuara në ligj dhe të domosdoshme në një shoqëri demokratike për sigurimin kombëtar ose sigurinë publike, ruajtjen e rendit publik, parandalimin e veprave penale, mbrojtjen e shëndetit apo të moralit, ose mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.
>
> 4. Të drejtat e parashtruara në paragrafin 1, në disa fusha të caktuara, mund t'u nënshtrohen disa kufizimeve të vendosura në përputhje me ligjin dhe të justifikuara nga interesi publik në një shoqëri demokratike.

86. Pa nenin 156, detyrimi pozitiv që ka Republika e Kosovës për t'i zbatuar të drejtat e njeriut të garantuara me nenet 13 dhe 14 të DUDNJ-së do të mund të pakësohej së tepërmi. Pa mbështetjen pozitive të Qeverisë, siç kërkohet tani me nenin 156 të Kushtetutës, garantimi i të drejtës së njeriut për liri të lëvizjes, të përcaktuar, ndër të tjera, në DUDNJ dhe KEDNJ, kjo e drejtë lehtë do të mund të injorohej apo pakësohej.

87. Kjo do të ishte në kundërshtim me nenin 1 të KEDNJ-së, i cili i obligon shtetet t'ia "sigurojnë çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Titullin I të kësaj Konvente".

88. Neni 35 i Kushtetutës ua garanton shtetasve dhe të huajve të drejtën për lëvizje të lirë brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës. Ai posaçërisht përcakton:

“Neni 35 [Liria e Lëvizjes]

1. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.

2. Secili person ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.

3. Shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t’u ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës.”

89. Neni 156 vë obligim pozitiv në Republikën e Kosovës për t’u ndihmuar refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit në ushtrimin e të drejtave të tyre për lëvizje të lirë. Pa këtë mandat kushtetues për Republikën e Kosovës që pozitivisht t’u ndihmojë atyre personave në ushtrimin e asaj të drejte, ata mund të mos jenë në gjendje ta ushtrojnë atë të drejtë.
90. Neni 46 i Kushtetutës garanton që askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Ai përcakton:

“Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente."

91. Gjykata rikujton që mbrojtja e pronës garantohet edhe me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, i cili thotë:

"Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij.

Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

> Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cënojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera."

92. Neni 156 vë barrë pozitive në Republikën e Kosovës për t'u ndihmuar refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit në ushtrimin e të drejtave të tyre për të mos u privuar në mënyrë arbitrare nga prona. Pa këtë mandat kushtetues për Republikën e Kosovës që pozitivisht t'u ndihmojë atyre personave në ushtrimin e asaj të drejte, ata mund të mos jenë në gjendje ta ushtrojnë atë të drejtë.

93. Për të gjitha këto arsye, Gjykata konfirmon se amendamenti 17 i propozuar duket të pakësojë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës, siç u cek më lartë.

XVIII. Amendamenti 18 i propozuar

94. Amendamenti 18 propozon që neni 157 i Kushtetutës të fshihet.

95. Neni 157 i Kushtetutës thotë si vijon:

> **Neni 157 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]**
>
> Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, Revizori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës do të jetë një ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil.

96. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 157 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XIX. Amendamenti 19 i propozuar

97. Amendamenti 19 propozon që neni 158 i Kushtetutës të fshihet.

98. Neni 158 i Kushtetutës thotë si vijon:

> **Neni 158 [Autoriteti Qendror Bankar]**
>
> Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës do të emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas marrjes së pëlqimit nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil.

99. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 158 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XX. Amendamenti 20 i propozuar

100. Amendamenti 20 propozon që neni 159 i Kushtetutës të fshihet.

101. Neni 159 i Kushtetutës thotë si vijon:

> **Neni 159 [Pronat dhe Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore]**

1. Të gjitha ndërmarrjet që ishin në tërësi ose pjesërisht në pronësi shoqërore, para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të privatizohen në pajtim me ligj.

2. Të gjitha interesat në pronësi shoqërore në prona dhe ndërmarrje në Kosovë do të jenë në pronësi të Republikës së Kosovës.

102. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 159 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XXI. Amendamenti 21 i propozuar

103. Amendamenti 21 propozon që neni 160 i Kushtetutës të fshihet.

104. Neni 160 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 160 [Ndërmarrjet në Pronësi Publike]

1. Republika e Kosovës do t'i ketë në pronësi të vet të gjitha ndërmarrjet në Republikën e Kosovës që janë ndërmarrje në pronësi publike. Të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me këto të drejta pronësore do të jenë obligime të Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës mund të privatizojë, të japë me koncesion ose të japë me qira ndërmarrjet në pronësi publike në mënyrën e rregulluar me ligj.

> 2. Të drejtat e pronësisë, që kanë të bëjnë me një ndërmarrje në pronësi publike e cila ofron shërbime vetëm në një komunë specifike ose në një numër të kufizuar të komunave, do të jenë të drejta pronësore të komunës ose komunave përkatëse. Obligimet në lidhje me të drejtat e tilla pronësore do të jenë obligime të komunës ose komunave përkatëse. Kuvendi mundet me ligj të identifikojë një ndërmarrje të tillë dhe komunën a komunat, që kanë të drejta pronësore dhe obligimet lidhur me to. Nëse përcaktohet me ligj, komuna a komunat përkatëse, ndërmarrjet në pronësi shoqërore mund t'i privatizojnë, t'i japin me koncesion ose t'i lëshojnë me qira.

105. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 160 të Kushtetutës nuk duket të pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XXII. Amendamenti 22 i propozuar

106. Amendamenti 22 propozon që neni 161 i Kushtetutës të fshihet dhe të shtohet një nen i ri, si vijon.

> "Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtarë, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklarimit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre në institucionet ku janë deri në fund të mandatit të specifikuar. Kosova do t"ua japë këtyre individëve të njëjtat privilegje dhe imunitete që i gëzojnë diplomatët dhe familjet e tyre sipas Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike."

107. Neni 161 i Kushtetutës thotë si vijon:

Neni 161 [Transicioni i Institucioneve]

1. Me përjashtim të rastet kur Kushtetuta përcakton një transicion tjetër, të gjitha kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrimet e institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë, do t'u kalojnë menjëherë atyre institucioneve në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute. Kohëzgjatja e mandatit të secilit institucion para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të mbetet e paprekur dhe e pandryshuar deri në skadimin e rregullt, ose deri në zgjedhjet e reja.

2. Deri ne zgjedhjet e para parlamentare pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, Kryesia e Kuvendit mbetet me kompetencat e parapara në mandatin e saj ekzistues. Pas seancës konstituive të Kuvendit të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, Kryesia e Kuvendit ristrukturohet në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.

3. Dispozitat e nenit 70.3.(3) nuk do të aplikohen deri në seancën konstituive të Kuvendit pas zgjedhjeve të para parlamentare pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.

4. Deri në formimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, funksionet dhe përgjegjësitë e tij do të i kryejë Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

108. Gjykata konsideron se fshirja e propozuar e nenit 161 të Kushtetutës dhe zëvendësimi i tij me një nen të ri nuk duket të

pakësojë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE, NË BAZË TË NENIT 113.9 TË KUSHTETUTËS, GJYKATA NJËZËRI VENDOSI SI VIJON :

I. Kërkesa që përmban Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012, është e pranueshme;

II. Gjykata konfirmon që prej 22 amendamenteve të përfshira në Propozimet e Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012, vetëm amendamenti 17 duket të pakësojë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 26/11 datë 15 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl-Kzz-93/09, të 1 marsit 2010

Lënda KI 26/11, vendimi i datës 25 nëntor 2011.

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur parashtresë në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës të 15 janarit 2009.
Më 25 shkurt 2011 paraqitësi i kërkesës i ka paraqitur kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.Të njëjtën ditë kryetari i Gjykatës e ka emëruar gjyqtaren Snezhana Botushareva gjyqtare raportuese dhe Kolegjin për shqyrtim të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Iliriana Islami.
Më 20 korrik 2005, në rastin P.nr. 02/05, Gjykata e Qarkut në Prizren e ka shpallur paraqitësin e kërkesës fajtor për kryerjen e këtyre veprave penale: prostitucion apo marrëdhënie të panatyrshme me keqpërdorim të pozitën nga neni 78. paragrafi 1. i LPK-së, i ndryshuar dhe i plotësuar me nenin 1. paragrafin 4. të rregullores së UNMIK-ut nr.2003/1 me të cilën ndryshohet dhe plotësohet ligji i zbatueshëm për veprat penale duke përfshirë dhunën seksuale; mundësimin e prostitucionit nga neni 201. paragrafi 3. PLPK; tregtia me njerëz në bashkëpunim nga neni 2. paragrafi 2. i rregullores së UNMIK-ut nr.2001/04 për ndalimin e tregtisë me njerëz në Kosovë, lidhur me nenin 22. të LPJ dhe tregtia me njerëz në bashkëpunim nga neni 139. paragrafi 2. i PLPK dhe e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 12 vjetësh.
Më 24 shtator 2007, paraqitësi i kërkesës i ka paraqitur ankesë Gjykatës Supreme, e cila më 1 qershor 2009 është refuzuar si e papranueshme.

Paraqitësi në kërkesën Gjykatës Kushtetuese pohon se ka pasur shkelje të nenit 31. të Kushtetutës sepse Gjykata e Qarkut në Prizren në mënyrë të padrejtë e ka shpallur fajtor.Ai pohon se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, plotësisht është mbështetur në raportin policor të cilin ai e refuzon plotësisht.Paraqitësi i kërkesës pohon po ashtu se policia ia ka mohuar të drejtën e mbrojtësit dhe se

nuk i është lejuar të kontaktojë me ambasadën, si shtetas i huaj dhe se i është shkelur e drejta e shfrytëzimit të mjeteve juridike.
Nga dokumentet në dosjen e lëndës Gjykata ka konkluduar se paraqitësit të kërkesës i është dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren i datës 20 korrik 2005 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme i datës 28 maj 2007, para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, do të thotë para datës 15 qershor 2008.

Kërkesa nuk i është paraqitur Gjykatës në afatin e paraparë në nenin 49. të Ligjit.
Gjykata ka konstatuar se faktet e paraqitura të rastit të cilat i ka paraqitur paraqitësi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese,"në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pohimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese" në pajtim me rregullin 36. paragrafin 2. pikat b dhe c të Rregullores së punës, prandaj Gjykata njëzëri ka vendosur që kërkesën e paraqitësit ta refuzojë si të papranueshme.

Prishtinë, më 21 maj 2012

Nr. ref.: RK236/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 26/11

Parashtruesi

Vladimir Ukaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl-Kzz-93/09, të 1 marsit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Vladimir Ukaj, i lindur në Pukë, Shqipëri, momentalisht në vuajtje të dënimit me burg në burgun e Dubravës.

2. Parashtruesi i kërkesës pohon se ka pasur shkelje të paragrafëve 1, 2 dhe 4 të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 32 [E drejta për Mjete Juridike] dhe nenit 41 [E drejta për Qasje në Dokumente Publike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

3. Kërkesa mbështetet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Vendimi i kontestuar

4. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi Pkl-Kzz-93/09 të cilin e ka nxjerrë Gjykata Supreme e Kosovës më 1 mars 2010, sipas të cilit kërkesa e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë u hodh poshtë si e papranueshme.

Procedura në Gjykatë

5. Më 25 shkurt 2011, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës e emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese si dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Iliriana Islami.

7. Më 23 nëntor 2011, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 20 korrik 2005, në rastin P. Nr. 02/05, Gjykata e Qarkut në Prizren e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e

këtyre veprave penale: marrëdhënie apo veprim i panatyrshëm seksual përmes keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga neni 78 paragrafi 1 i LPK-së, të ndryshuar dhe plotësuar me nenin 1.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/1 me të cilën është ndryshuar dhe plotësuar Ligji i zbatueshëm për veprat penale përfshirë dhunën seksuale, mundësimi i prostitucionit nga neni 201, paragrafi 3 i KPPK-së, Trafikimi me njerëz në bashkëkryerje nga neni 2.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/4 mbi Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë në lidhje me nenin 22 të KPJ-së dhe Trafikimi me njerëz në bashkëkryerje nga neni 139 paragrafi 2 i KPPK-së në lidhje me nenin 23 të KPPK-së.

9. Rrjedhimisht, në bazë të nenit 71 paragrafi 1 i KPPK-së, parashtruesi i kërkesës duhet ta vuajë dënimin unik apo dymbëdhjetë (12) vjet dënim me burgim.

10. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të lartpërmendur. Më 28 maj 2007, Gjykata Supreme me Aktgjykim Ap-KZ 478/2005 në tërësi e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës. Ky aktgjykim iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 5 shtator 2007.

11. Më 24 shtator 2007, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme e cila u hodh poshtë si e papranueshme më 1 qershor 2009.

12. Më 26 qershor 2009, parashtruesi i kërkesës bëri kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Gjykata Supreme më 1 mars 2010 vendosi ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme. Parashtruesit të kërkesës iu dorëzua aktgjykimi në fjalë më 19 mars 2010.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës pasi që Gjykata e Qarkut në mënyrë të padrejtë e kishte shpallur atë fajtor. Ai pohon se Aktgjykimi i

Gjykatës së Qarkut në Prizren P. Nr. 02/2005, i datës 20 korrik 2005, është tërësisht i bazuar në raportin e policisë të cilin ai e kundërshton në tërësi. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu pretendon se policia ia kishte mohuar të drejtën për avokat mbrojtës dhe se nuk i ishte lejuar që ta kontaktonte ambasadën si shtetas i huaj.

14. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu pretendon se ai ishte akuzuar se më 30 qershor 2004 kishte kryer veprën penale të trafikimit me njerëz, mirëpo në këtë datë ai gjendej në Konispol dhe kishte ofruar dokumente për të konfirmuar një gjë të tillë.

15. Parashtruesi i kërkesës më tej pohon se i është cenuar e drejta për mjete juridike e garantuar me nenin 32 të Kushtetutës. Sipas tij, gjatë procedurës në shkallën e dytë ai ishte ndërprerë teksa po paraqiste fjalën përfundimtare në cilësinë e të akuzuarit.

16. Ai gjithashtu pretendon se i është mohuar e drejta e qasjes në dokumente publike në kundërshtim me nenin 41 të Kushtetutës pasi që nuk i ishte dhënë një kopje e procesverbalit nga procedura në shkallën e dytë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregullore të punës.

18. Nga dokumentet në dosjen e rastit në këtë Gjykatë, del se parashtruesit të kërkesës i janë dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren i datës 20 korrik 2005 (P. Nr. 02/05) dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i datës 28 maj 2007 (Ap-KZ 478/2005) para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, pra para 15 qershorit 2008.

19. Gjykata pra duhet së pari, të përcaktojë nëse çështjet e ngritura në kërkesë "janë nën juridiksionin" e saj. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se nga autoritetet publike të Republikës së Kosovës mund të kërkohet të përgjigjen vetëm për faktet apo aktet që kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë një kërkesë që ka të bëjë me ngjarje që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës (shih, Aktvendimi i Gjykatës për Papranueshmëri në Rastin nr. 18/10, Denic *et al,* i datës 17 gusht 2011*).*

20. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 49 (Afatet) të Ligjit, i cili përcakton se:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht."

21. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pkl-Kzz-93/09, të datës 1 mars 2010, që i është dorëzuar atij më 19 mars 2010.

22. Siç u përmend më lart, kërkesa është parashtruar më 25 shkurt 2011, gjë që është pothuajse një vit pasi Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i datës 1 mars 2010, iu dorëzua parashtruesit të kërkesës.

23. Rrjedhimisht, kërkesa nuk është parashtruar në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

24. Gjykata gjithashtu thekson se edhe nëse supozohet se kërkesa ishte parashtruar brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, parashtruesi nuk ka arsyetuar *prima facie* kërkesën e tij. Në të vërtetë faktet e rastit që janë paraqitur nga parashtruesi në Gjykatën Kushtetuese "në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë

pretendimet për shkelje të të drejtave kushtetuese" në kundërshtim me rregullin 36.2 (b) dhe (c) të Rregullores së punës.

25. Prandaj, rezulton se kërkesa e parashtruesit duhet të hidhet poshtë si e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË poshtë kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 146/11 datë 15 qershor 2012- Kërkesë për zbatimin e dy rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2001/35 dhe 2005/20

Rasti KI 146/11, vendimi i 9 majit 2012

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, shterim i të gjitha mjeteve efektive juridike, pensioni, fondi plotësues pensional, ratione materiae.

Parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, me të cilën kërkon nga Gjykata Kushtetuese zbatimin e plotë të dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/20 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/35 për Pensionet në Kosovë si dhe zbatimin e urdhëresës së Fondit Plotësues Pensional (suplementar-shtesë) Aneks „B“ BPK-A, (Autoriteti Bankar dhe i Pagesave në Kosovë) të 24 prillit 2006, si dhe të përmbushen dhe zbatohen në tërësi vendimet e Bordit të Drejtorëve të PTK-së nr. 05-987/06 dhe 07/06.

Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ai edhe tej i ka dy lëndë në procedurë pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë në bazë të padisë së parashtruesit Pl. 377/2011 dhe njëkohësisht pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në bazë të ankesës që ka ushtruar PTK-ja.
Duke vendosur për kërkesën e parashtruesit Isak Berisha, Gjykata Kushtetuese, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, ka konstatuar se individët mund të iniciojnë procedurë nëse të drejtat dhe liritë që ua garanton kjo Kushtetutë u janë cenuar nga ana e autoriteteve publike, por vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet tjera juridike të rregulluara me ligj.

Po ashtu Gjykata Kushtetuese vëren se *“zbatimi i dy rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2001/35 dhe 2005/20“* nuk bie në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese kështu që kjo kërkesë nuk është në pajtim me *ratione materiae* e Gjykatës Kushtetuese.

Prishtinë, më 21 maj 2012

Nr. ref.: RK242/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 146/11

Parashtruesi

Isak Berisha

Kërkesë për zbatimin e dy rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2001/35 dhe 2005/20

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Isak Berisha nga Prishtina.

Kërkesa e parashtruesit

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese "*zbatimin e dy rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2001/35 dhe 2005/20 dhe sidomos zbatimin e urdhëresës së Fondit Plotësues Pensional (suplementar-shtesë). Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/35 e ka nënshkruar Hans Hakerup, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm, ndërsa Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/20 e ka nënshkruar Soren Jesen-Petersen, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm.*"

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës nuk përmend ndonjë nen konkret të Kushtetutës që është shkelur, mirëpo moszbatimin e rregulloreve e konsideron shkelje të të drejtave. Nga kërkesa mund të konkludohet që objekt i çështjes është kontesti juridik në mes të parashtruesit të kërkesës dhe Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PTK) që ka lindur si pasojë e

mospagesës së sigurimit pensional plotësues, që sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka vlerën 48000 Euro.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 11 nëntor 2011.

6. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të marrë parasysh mbrojtjen e identitetit tij pa arsyetuar se përse ai ka nevojë për një mbrojtje të tillë.

7. Më 27 janar 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Komunale në Prishtinë se është iniciuar procedura e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së aktgjykimit në lidhje me lëndën nr. KI146-11.

8. Më 22 shkurt 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Gjykatën e Qarkut në Prishtinë se është iniciuar procedura e shqyrtimit të kushtetutshmërisë në lidhje me lëndën nr. KI146-11.

9. Më 9 maj 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe prof. Dr. Enver Hasani i

paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie pune me PTK-në deri në pensionimin e tij, kur me aktvendimin nr. 3280/07, të 8 gushtit 2007, ai u pensionua.

11. Gjatë kohës sa parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie pune me PTK-në, ai u anëtarësua në Fondin Plotësues Pensional të PTK-së që ishte formuara nga drejtori i PTK-së me Vendimin nr. 01-4083/02, të 29 korrikut 2002. Në bazë të vendimit, në pikën IV është paraparë se lartësia e Fondit Plotësues Pensional, të cilin plotësisht e ka financuar PTK-ja, ishte caktuar në 10.1% të lartësisë bruto të të ardhurave personale mujore për të gjithë punëtorët e PTK-së. Pronarë të këtij fondi janë të gjithë punëtorët. Në rast të vdekjes së punëtorit para përmbushjes së kushteve për pension të pleqërisë, trashëgimtari i tij/saj mund të trashëgojë tërë shumën e kursimeve të grumbulluara. Secili punëtor mund të caktojë trashëgimtarin që do të trashëgojë kursimet. Nëse punëtori shpallet invalid, kursimet e tij mund të shfrytëzohen për pension.

12. Shuma në Fondin Plotësues Pensional nuk mund të tërhiqet përderisa përfituesi i fondit nuk i mbush 65 vjet, ose përndryshe mund të shfrytëzohet me rastin e pensionimit të parakohshëm për shkak të sëmundjes apo rrethanave tjera, nëse e ka përmbushur kushtin prej 35 vjet stazh pune.

13. Shpenzimet për këtë fond seriozisht kanë rrezikuar vlerën e PTK-së për një periudhë afatgjate, dhe për këto arsye fondi i PTK-së u mbyll më 31 dhjetor 2005 me pajtimin e Autoriteti Qendror Bankar të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: AQBK).

14. Obligimet e krijuara ndaj punëtorëve në bazë të sigurimit plotësues të themeluar në këtë mënyrë u transferuan në tri fonde

pensionale, me ç'rast secili punëtor ka pasur të drejtë, sipas dëshirës së tij, të zgjedhë njërin nga këto fonde pensionale:

- ACP -Siguruesi i Pensioneve Plotesuese Individuale Amerikano-Kosovar;
- FSKP -Fondi Slloven Kosovar i Pensioneve; dhe
- TKPK -Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës.

15. Në bazë të dokumentacionit të parashtruar mund të supozohet se parashtruesi i kërkesës zgjodhi si fond pensional TKPK - Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

16. Pas pensionimit, parashtruesi i kërkesës iu drejtua me shkrim personave përgjegjës në PTK në emër tij, por edhe si anëtar i Bordit të drejtorëve të sindikatës së pavarur të PTK-së, me kërkesë që PTK t'ia shlyejë obligimet e krijuara me formimin e sigurimit plotësues pensional.

17. Në një nga përgjigjet e dhëna në emër të PTK-së nga Menaxheri Special, Suzana Vokshi, në të cilën i sqaron të drejtat e parashtruesit të kërkesës në raport me Fondin Plotësues Pensional të PTK-së (në tekstin e mëtejmë: Fondi i PTK-së), ku parashtruesi i kërkesës ishte anëtar deri më 31 dhjetor 2005, thuhet se:

> *"Bazuar në të dhënat e paraqitura më poshtë dhe sipas ligjeve të Fondit të PTK-se vlera e të drejtave tuaja në fondin e PTK-së deri më 31 dhjetor 2005 ka shumën prej 22921.3 euro në këtë shumë nuk është llogaritur kamata prej 4% prej 1 janarit 2006 deri me datën e transferimit të mjeteve në skemën e re pensionale. Taksat do të ndahen nga mjetet e transferuara sipas ligjeve të obligueshme në fuqi."*

18. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë me të cilën kërkon që PTK t'ia paguajë shpërblimet jubilare në shumën prej dy pagave bazë.

19. Duke vendosur në lidhje me padinë e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 770/2009, të 23 shkurtit 2011, e pranoi padinë e parashtruesit të kërkesës dhe me aktgjykim e obligoi PTK-në që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë në emër të shpërblimit jubilar shumën prej 3499,22, në emër të kontributit pensional shumën 190,87 Euro dhe në emër të tatimit në pagë shumën prej 330,85 Euro, dhe të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita kur aktgjykimi merr formë të prerë.

20. Sipas parashtruesit ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 770/2009, të 23 shkurtit 2011, PTK-ja është ankuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Lënda u regjistrua me nr. Pl. 377/2011 dhe sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lënda "gjendet në procedurë gjyqësore pranë Gjykatës së Qarkut".

21. Më 1 gusht 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi të re në Gjykatën Komunale në Prishtinë, të regjistruar me nr. C 1756 /2011, me të cilën kërkoi që PTK-ja, në bazë të skemës pensionale, t'ia paguajë shumën prej 48.000 Euro, dhe e tërë kjo në bazë të një studimi të kryer nga firma Deloitte and Touche. Kjo lëndë gjendet në procedurë gjyqësore në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me këto kërkesa:

> *"Kërkoj zbatimin e plotë të dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/20 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/35 për pensionet në Kosovë dhe zbatimin e*

Urdhëresës e Fondit Plotësues Pensional (suplementar-shtesë) Aneks „B“ BPK-A, (Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës) të 24.04.2006, që të përmbushen dhe zbatohen në tërësi Vendimet e Bordit të Drejtorëve të PTK-së nr. 05-987/06 dhe 07/06...”

“E lus Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës që ta kërkojë regjistrin e përfituesve nga fondi plotësues pensional (Suplementar shtesë) nga posta dhe telekomunikacioni i Kosovës, nga drejtori menaxhues z. Shyqyri Haxha dhe Besnik Jani dhe nga z. Gani Gurguri, guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës dhe nga Suzana Vokshi, menaxhere speciale e cila e ka regjistrin e përfituesve plotësues.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Për të qenë në gjendje të vendos për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë. Në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parashikon si në vijim:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

24. Gjykata e thekson se arsyetimi për kërkesën e shterimit është që t'iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshire gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ Selmouni kundër Francës, nr. 25803194,

Vendim i datës 28 korrik 1999). Sidoqoftë, nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese të ngritën në mënyrë eksplicite gjatë procedurave në fjalë. Deri sa kjo çështje është ngritur në mënyrë implicite ose substanciale, kërkesa për shterimin e mjeteve është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, nr. 56679/00, Vendimi i datës 28 prill 2004).

25. Kjo Gjykatë e ka përdorur të njëjtin arsyetim me rastin e marrjes së Vendimit për papranueshmëri të datës 27 janar 2010 mbi bazën e mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në rastin Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K, Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, lënda nr. KI. 41/09 dhe Vendimit të 23 marsit 2010 në rastin Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lënda nr. KI 73/09.

26. Duke pasur parasysh se në bazë dokumentacionit të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese nga ana e parashtruesit të kërkesës, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 770/2009, i 23 shkurtit 2011, nuk është i formës së prerë dhe se në bazë të ankesës së PTK-së është duke u zhvilluar procedura në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë me nr. Pl.377/2011, e cila ende nuk ka përfunduar, si dhe duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës më 1 gusht 2011 ka ushtruar padi të re në Gjykatën Komunale në Prishtinë, të regjistruar me nr. C 1756, e cila po ashtu nuk ka përfunduar. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj ashtu që të mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

27. Nga kjo del se kërkesa nuk është e pranueshme për shqyrtim në pajtim me nenin 113.7 dhe rregullin 36 (1a) të Rregullores së punës, i cili parashikon se, *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: a) janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar..."*.

28. Më tej, përderisa parashtruesi i kërkesës insiston që Gjykata Kushtetuese të vendosë në mënyrë meritore në lidhje me kërkesën e tij për zbatimin e dy rregulloreve të UNMIK-ut nr.

2001/35 dhe 2005/20, Gjykata Kushtetuese vëren se, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e rregullt për të vendosur në lidhje me kontestet në shkallën e parë, gjë e cila është kompetencë e gjykatave të rregullt, në të cilat parashtruesi i kërkesës ka iniciuar procedurat.

29. Gjykata Kushtetuese po ashtu vëren se "zbatimi i dy rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2001/35 dhe 2005/20", nuk bie në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, prandaj një kërkesë e tillë nuk është në pajtim me *ratione materiae* të Gjykatës Kushtetuese, pasi që në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese hyjnë procedura që kanë të bëjnë me shkeljen e pretenduar të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 56 (2), 36 (1a) dhe 36 (3f) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 9 maj 2012, Gjykata Kushtetuese, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KO 123/10 datë 11 qershor 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë Nr. C. nr. 183/2009 të 17 qershorit 2009

Lënda KO 123/10, vendimi i datës 18 maj 2012.

Fjalët kyçe; Komuna e Gjakovës, vlerësimi i kushtetutshmërisë të aktgjykimit.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur parashtresë në pajtim me nenet 113.7. dhe 21.4. të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8. të Ligjit nr.03/L-121 për Kushtetutën Republikës së Kosovës, të datës 15 janar 2009.
Më 9 dhjetor 2010, paraqitësi i kërkesës i ka paraqitur kërkesë Gjykatës.
Çështja e lëndës së kësaj kërkese ka të bëjë me ankesën të cilën Instituti i Mbrojtjes së Përmendoreve nga Tirana e ka paraqitur kundër Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Gjakovës, për pagesë të borxhit në shumë prej 16.206,00 euro.

Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë me aktgjykim ka konstatuar se Instituti i Mbrojtjes së Përmendoreve nga Tirana dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Komunës së Gjakovës kanë qenë në marrëdhënie kontraktuese, lidhur me përgatitjen e dokumentacionit teknik-investues nr.18, me të cilën paditësi ka qenë i obliguar që në dobi të të paditurës ta hartojë projektin për konservim "Ura e Taliqit" në Gjakovë dhe kontratën për përgatitjen e dokumentacionit teknik-investues nr.19, me të cilën paditësi ka qenë i obliguar që në dobi të të paditurës ta hartojë projektin për konservimin e "Urës së Tabakut" në Gjakovë.Paditësi i ka përmbushur obligimet e veta nga kontrata ndaj të paditurës, ndërsa e paditura nuk e ka përmbushur obligimin ligjor lidhur me pagesën e çmimit të kontraktuar edhe pse Këshilli i Drejtorëve të Komunës së Gjakovës me vendimin e datës 10 maj 2004, ka vendosur që paditësit ti bëhet pagesa për punët e kryera.
Paraqitësi i kërkesës thekson se aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë përmban shkelje serioze të Ligjit për

Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësive nr.03/L-048, përkatësisht të nenit 68 (par.1, 2, 3 dhe 4).
Gjykata vëren se aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut është marrë më 17 qershor 2009 dhe i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës, më 18 korrik 2009, ndërsa paraqitësi i kërkesës i ka bërë kërkesë Gjykatës Kushtetuese më 9 dhjetor 2010.
Prandaj, kërkesa është bërë jashtë afatit të paraparë në nenin 49. të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.4 dhe nenin 113.7, si dhe në pajtim me nenin 49. të Ligjit, njëzëri ka vendosur që kërkesën ta refuzojë si të papranueshme.

Prishtinë, me 21 maj 2012

Nr.ref.:RK 239/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KO 123/10

Parashtruesi

Komuna e Gjakovës

Vlerësimi i kushtetutshmërisë të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë Nr. C. nr. 183/2009 të 17 qershorit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Komuna e Gjakovës. Në procedurën pranë Gjykatës Kushtetuese, Komuna përfaqësohet nga z. Afrim Radoniqi, përfaqësues ligjor i Komunës së Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin Nr. C. Nr. 183/2009 të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë të datës 17 qershor 2009 që i është dorëzuar parashtruesit më 18 korrik 2009.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkese ka të bëjë me padinë e ushtruar nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve –Tiranë kundër Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të komunës së Gjakovës për kompensimin e borxhit në shumën prej 16,206.00 Euro.

Baza juridike

4. Neni 113.4 dhe neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 20 dhe 49 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë : Ligji) dhe Rregulli 56 i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 9 dhjetor 2010, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 27 janar 2011 Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, lidhur me dorëzimin e kërkesës së përmendur. Më 4 shkurt 2011, Gjykata Ekonomike e

Qarkut në Prishtinë ia dorëzoi Gjykatës dosjen e lëndës së parashtruesit të kërkesës.

7. Më 13 maj 2011 pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtares Raportuese, Gjyljeta Mushkolaj, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve dhe pretendimeve siç janë paraqitur nga parashtruesi i kërkesës

8. Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve –Tiranë dorëzoi një ankesë kundër Drejtorisë së kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Gjakovës, për kompensimin e borxhit në shumën prej 16,206.00 Euro.

9. Me Aktgjykimin Nr. C. nr. 183/2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë konstaton se Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve-Tiranë dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Gjakovës kanë pasur marrëdhënie kontraktuese, sipas kontratave dhe atë: Kontratë mbi kryerjen e dokumentacionit tekniko-investues nr. 18, me të cilën paditësi është obliguar që për llogari të padituës të hartojë projektin të konservimit të "Urës së Taliqit" në Gjakove dhe Kontratën mbi kryerjen e dokumentacionit tekniko-investues nr. 19, me të cilën paditësi është obliguar që për llogari të padituës ta kryejë hartimin e projektit të konservimit të "Urës së Tabakut" në Gjakovë. Paditësi i ka përmbushur obligimet e veta kontraktuese ndaj të padituës, ndërsa e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e lidhur me pagesën e çmimit kontraktues, edhe pse Bordi i Drejtorëve të Komunës së Gjakovës me Vendimin e datës 10 maj 2004, ka vendosur që paditësit t'i bëhet pagesa për punët e kryera.

10. Gjykata Ekonomike e Qarkut përmes Aktvendimit II. C. nr. 183/209, të datës 21 maj 2009, detyroi Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Gjakovës që të paraqes përgjigje në

padi dhe në bazë të dokumenteve të dorëzuara, nuk është dorëzuar asnjë përgjigje.

11. Të njëjtën ditë, më 21 maj 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut lëshoi një thirrje për paraqitje në seancë përgatitore që do të mbahej më 17 qershor 2009. Mirëpo, në aktgjykimin nr. C. nr. 183/2009 nuk përmendet nëse e paditura ishte e pranishme në seancë.

12. Kundër aktgjykimit Nr. C. nr. 183/2009, të datës 17 qershor 2009, e paditura ka paraqitur Ankesë me datën 6 gusht 2009, duke mos e përfillur afatin e përcaktuar ligjor për parashtrimin e ankesës. Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë përmes Aktvendimit të datës 12 gusht 2009 e hodhi poshtë ankesën si të paafatshme.

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, i datës 17 qershor 2009, nr. C .nr. 183/2009, përmban shkelje të rëndë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike Nr. 03/L-0478, përkatësisht nenit 68 (1,2,3 dhe 4),

14. Rrjedhimisht, Komuna e Gjakovës pretendon se Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë nuk ka zbatuar dispozitat e lartcekura të nenit 68 duke mos marrë parasysh kërkesën e Komunës, të datës 26 maj 2009, për pezullimin e çështjes në afat prej 180 ditësh.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Në mënyrë që të jetë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë paraprakisht nëse parashtruesi i ka përmbushur të gjitha kërkesat për pranueshmëri të kërkesës, të parapara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të Punës.

16. Përmbushja e të gjitha kushteve në mënyrë kumulative është qenësore për të parashtruar një çështje në Gjykatën Kushtetuese në mënyrë ligjore.

17. Dhe në lidhje me këtë Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës ku thuhet:

18. "*Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar*".

19. Neni 113.4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton si në vijim:

    "Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt".

20. Gjykata vëren se çështja e parashtruar nga Komuna e Gjakovës nuk ka të bëjë me "*kontestimin e kushtetutshmërisë së ligjeve ose të akteve të Qeverisë",* por ajo sfidon Aktgjykimin e një Gjykate të rregullt, dhe si e tillë është e papranueshme.

21. Gjykata gjithashtu vëren se në pajtim me nenin 21 të Kushtetutës:

22. *" Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë ,vlejnë edhe për personat juridikë për aq sa janë të zbatueshme"*

    Dhe neni 5 i Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, në nenin 5 përcakton se:

23. *"Komuna është person juridik. Si person juridik, çdo komunë ka kompetenca, në mes tjerash, të padisë dhe të paditet në gjykata;*

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113(7) të Kushtetutës i cili përcakton*:*

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"

25. Përkundër faktit se Komuna është e autorizuar që të ngrejë këtë rast në Gjykatën Kushtetuese, duhet të përmbushen kërkesat tjera për papranueshmëri të parapara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të Punës.

26. Në këtë drejtim Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…"

27. Gjykata vëren se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Ekonomike të Qarkut është nxjerrë më 17 qershor 2009 dhe i është dorëzuar parashtruesit së kërkesës më 18 korrik 2009, ndërkaq parashtruesi ka dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 9 dhjetor 2010.

28. Prandaj, kërkesa është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.4 dhe 113.7 të Kushtetutës si dhe me nenin 49 të Ligjit, njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë .

Gjyqtarja Raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Dr. Gjyljeta Mushkolaj Prof. Dr. Enver Hasani

KI 110/10 datë 15 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës, të 3 shkurtit 2010

Lënda KI 110/10, e datës 20 maj 2011

Fjalët kyçe; kërkesë individuale,vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur parashtresën në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr.03/L-121 për Kushtetutën e Republikës së Kosovës të datës 15 janar 2009.
Paraqitësi i kërkesës, më 29 tetor 2010 i ka paraqitur kërkesë Gjykatës
Kryetari, më 16 dhjetor, me urdhëresën nr.GJR. 110/10, e ka emëruar gjyqtaren Snezhana Batusharova gjyqtare raportuese.Të njëjtën ditë, kryetari me urdhëresën nr.KSH.110/10, e ka emëruar Kolegjin për shqyrtim në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (Kryesues), Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj.
Në kërkesën e tij paraqitësi pohon se i është shkelur e drejta e garantuar kushtetuese për punë, sepse Komuna e Junikut më 20 korrik 2009, me aktvendim e ka refuzuar ankesën e paraqitësit të ankesës dhe ka konstatuar se:"Paraqitësi i kërkesës e ka shkelur Urdhëresën administrative nr.2003/2 për zbatimin e Statutit nr.2001/36 për Shërbimin Publik të Kosovës, përkatësisht neni 30. paragrafi 1. pika j) sjellje apo përdorim i gjuhës së dhunshme, kërcënuese dhe primitive në vend të punës".

Pas shikimit të kërkesës së paraqitësit, Gjykata ka konstatuar se paraqitësi asnjëherë nuk i ka ngritur apo paraqitur shkeljet e cekura para Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

Gjykata ka konstatuar se paraqitësi i kërkesës nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike që i ka pasur në dispozicion sipas ligjit në zbatim, siç është paraparë në nenin 113. pika 7. e Kushtetutës.
Prandaj, Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. paragrafi 7. i Kushtetutës, nenin 20. të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe

rregullin 36. të Rregullores së Punës, të datës 20 maj 2011, njëzëri vendosi ta refuzojë kërkesën si të papranueshme.

Prishtinë, 21 maj 2012

Nr. ref.: RK235/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 110/10

Parashtrues

Ismet Hebibi

Vlerësim i kushtetutshmërisë të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës, të 3 shkurtit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Ismet Hebibi, me vendbanim në Junik.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston vendimin e komunës së Junikut, të 20 korrikut 2009, dhe vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK), të 3 shkurtit 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon që i është shkelur e drejta për të punuar, e garantuar me Kushtetutë.

4. Parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese ta kthejë në punë dhe të urdhërojë kompensimin e pagës.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 20, 22 dhe 47 (2) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe rregulli 36 (1) (a) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 29 tetor 2010. Parashtruesi kërkoi në kërkesë që identiteti i tij të mos zbulohej në vendimin e Gjykatës

7. Më 16 dhjetor 2010, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 110/10, e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 110/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj.

8. Më 20 maj 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

9. Më 20 janar 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi KPMK-në për parashtrimin e kërkesës së sipërpërmendur. Më 27 janar 2011, KPMK ia dërgoi Gjykatës dosjen e parashtruesit.

Përmbledhja e fakteve dhe pretendimeve siç janë paraqitur nga parashtruesi

10. Parashtruesi ishte punësuar si oftalmolog në Qendrën Mjekësore "Dr. Ali Hoxha" në Deçan.

11. Më 4 qershor 2009, me Vendimin nr. 05/379, Komuna e Junikut, përmes masës disiplinore, e shkëputi marrëdhënien e punës me parashtruesin. Parashtruesi paraqiti ankesë kundër këtij vendimi më 18 qershor 2009.

12. Më 20 korrik 2009, Komuna e Junikut, me Vendimin nr. 01-01-2009, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit dhe gjeti që "parashtruesi e ka shkelur Urdhëresën Administrative Nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores nr. 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës, respektivisht nenin 30 (1) (j), sjellja apo gjuha e dhunshme, kërcënuese ose fyese në vendin e punës".

13. Më 29 dhjetor 2009, parashtruesi u ankua në KPMK kundër vendimeve të Komunës së Junikut.

14. Më 3 shkurt 2010, KPMK hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pakohshme duke theksuar që "ankesa e parashtruesit është dashur të dorëzohej në KPMK brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh...".

15. Parashtruesi ka theksuar në kërkesën e tij se nuk e ka shfrytëzuar mundësinë për ta kontestuar vendimin e KPMK në Gjykatën Supreme për shkak se "Gjykata Supreme i respekton afatet

kohore dhe do ta hidhte poshtë rastin e parashtruesit si të pakohshëm".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

dhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili thotë:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

18. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për shterimin e mjeteve juridike është që t'ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës, të ngritur nga parashtruesi para atyre instancave. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë një mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat

kushtetuese të ceken në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Nëse çështja ishte ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, *mutatis mutandis,* GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, Vendim i 28 prillit 2004).

19. Gjykata zbatoi të njëjtin arsyetim kur nxori Aktvendim për Papranueshmëri në Rastin e Veli Sermaxhajt, KI 49/09, të dhjetorit 2010.

20. Nga parashtresat e parashtruesit shihet qartë që ai kurrë nuk i ka ngritur shkeljet e supozuara në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

21. Gjykata gjen që parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i ka në dispozicion sipas ligjit në fuqi, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113(7) të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, më 20 maj 2011, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

II. TA HEDHË POSHTË si të pabazë kërkesën për mos zbulim të identitetit të tij.

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja Raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 66/11 datë 15 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pn-Kr 56/2006, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap. nr. 52/2004 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtine P. nr. 94/01

Rasti KI 66/11, vendim i 21 majit 2012

Fjalët kyçe: dënim me burgim, e drejta në gjykim të drejtë, kërkesë individuale, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, kodi i përkohshëm i procedures penale të Kosovës, ratione temporis.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, me ç'rast u vërtetua dënimi me burgim i parashtruesit të kërkesës nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Parashtruesi pohoi pa saktësuar ndonjë dispozitë kushtetuese se janë cenuar të drejtat e tij kushtetuese në saje të dënimit të bazuar në prova që nuk ekzistojnë dhe në prova të falsifikuara.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte papranueshme bazuar në Rregullin 36 (3) (h) të Rregullores së Punës. Duke cituar praktikën e saj gjyqësore në *rastin KI 25/09 Shefqet Haxhiu kundër Organizatës së Punëtorëve të "Industrisë së Akumulatorëve"* dhe vendimin e GJEDNJ-së *në rastin Blećić kundër Kroacisë*, Gjykata më tutje arsyetoi se kërkesa nuk ishte e pajtueshme ratione temporis me Kushtetutën. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

Prishtinë, më 21 maj 2012

Nr. ref.: RK238/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 66/11

Parashtruesi

Astrit Shabani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,

Pn-Kr 56/2006, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap. nr. 52/2004 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtine P. nr. 94/01

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Astrit Shabani nga Mramori, Komuna e Prishtinës. Parashtruesi është duke vuajtur dënimin me burgim në burgun e Dubravës, Istog.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi pohon, pa precizuar ndonjë dispozitë të Kushtetutës, se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë në saje të dënimit të bazuar në prova që nuk ekzistojnë dhe në prova të falsifikuara (Neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës). Parashtruesi gjithashtu pohon, pa specifikuar ndonjë dispozitë të Kushtetutës se dënimi i tij shkel parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në rastet penale (Neni 33 i Kushtetutës).

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullin 56(2) të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

4. Më 16 maj 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

5. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova për Gjyqtare Raportuese dhe Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Dr. Altay Suroy, dhe Dr. Iliriana Islami.

6. Më 20 mars 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi Raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

7. Më 14 gusht 2003 Gjykata e Qarkut në Prishtinë në Aktgjykimin P. nr. 94/01 gjeti parashtruesin fajtor për vrasje sipas nenit 30 paragrafi 2 të Ligjit Penal të Kosovës në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të RFJ të zbatuar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24. Parashtruesi ishte dënuar me 20 vjet burg.

8. Parashtruesi parashtroi ankesë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut brenda afatit ligjor për arsyet në vijim: shkelje esenciale të Ligjit të Procedurës Penale, vendosjen e gabuar dhe jo të plotë të fakteve dhe shqiptimin e dënimit në mënyrë të gabuar. Parashtruesi kërkoi që Gjykata Supreme të anulojë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe të kthejë rastin në gjykatë më të ultë për rigjykim ose të shfajësojë dhe të lirojë parashtruesin, ose t'i shqiptohet një dënim i zvogëluar.

9. Më 2 gusht 2005 Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës rekomandoi që Gjykata Supreme të ndryshojë dispozitivin e aktgjykimit në mënyrë që të reflektojë zbatueshmërinë e rregullores së UNMIK-ut 2000/59 dhe të refuzojë si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.

10. Më 21 nëntor 2005 Gjykata Supreme në Aktgjykimin Ap. 52/2004 pjesërisht miratoi ankesën e parashtruesit dhe ndryshoi dënimin e tij me 18 vjet burg. Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të ankesës së Parashtruesit.

11. Më 6 prill 2006 parashtruesi dorëzoi një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap. 52/2004 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut P. nr. 94/01. duke pretenduar shkeljen e rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/59 dhe Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale te Kosovës.

12. Më 7 nëntor 2006 Gjykata Supreme në Aktgjykimin Pn-Kr 56/2006 hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar.

13. Në kërkesën e tij parashtruesi thekson se ka parashtruar kërkesa në Gjykatën Supreme në datat në vijim: më 10 qershor 2009,më 31 korrik 2009 dhe më 3 shtator 2009. Sidoqoftë, kopjet e këtyre kërkesave nuk janë përfshirë në kërkesë/parashtresë. Gjithashtu në kërkesë nuk ka diçka që do të dëshmonte se këto kërkesa janë të bazuara në mjet të duhur juridik në dispozicion të parashtruesit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Sa i përket kërkesës në fjalë, Gjykata vëren se vendimi origjinal i Gjykatës Supreme ka datën 21 Nëntor 2005 dhe kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë ishte refuzuar nga Gjykata Supreme më 7 nëntor 2006, ndërkaq kërkesa ishte dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese më 16 maj 2011. Kjo nënkupton se kërkesa ka të bëjë me ngjarjet para 15 qershorit 2008, kur Kushtetuta ka hyrë

në fuqi. Nga kjo del se kërkesa është e paafatshme, dhe nuk është në përputhje "*ratione temporis*" me dispozitat e Kushtetutës dhe me Ligjin (shih Aktvendimi për papranueshmërinë të Gjykatës Kushtetuese, **rasti KI 25/09** Shefqet Haxhiu kundër Organizatës së Punëtorëve të "Industrisë së akumulatorëve", të 21 qershorit 2010, dhe Blecic kundër Kroacisë, Kërkesa nr. 59532/00, Aktgjykimi i KEDNJ i 29 korrikut 2004).

15. Veç tjerash, Rregulli 36 (3) (h) i Rregullores së Punës parasheh se "një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur" "kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën". Prandaj Gjykata konsideron se kërkesa është e paafatshme "*ratione temporis*".

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, rregullin 56(2) të Rregullores së punës, më 20 mars 2012, Gjykata Kushtetuese:

VENDOSI

I. Njëzëri, TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Me shumicë të konkludojë se arsyetimi për papranueshmëri nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën;

III. Ky vendim do t'u komunikohet parashtruesit; dhe

IV. Ky vendim do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë;

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 114/11 datë 15 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc. nr. 2/2009, të 5 prillit 2011

Rasti KI 114/11, vendimi i datës 4 maj 2012.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta në pronë, qartazi e pabazuar, mbrojtja e pronës.

Parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc. Nr. 2/2009 të 5 prillit 2011, që i është dorëzuar parashtruesit më 17 maj 2011, me të cilën pranohet kërkesa e Prokurorit Publik për mbrojtjen e ligjshmërisë, dhe ndryshohen aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 338/ 2008 të 6 tetorit 2008, dhe i Gjykatës Komunale të Rahovecit, C.nr. 45/2007 të 2 qershorit 2008, dhe njëkohësisht është refuzuar si e pabazuar padia e parashtruesit me të cilën kërkonte vërtetimin e të drejtës në pronën e evidentuar si ngastër kadastrale nr. 835/3 në vendin e quajtur "Rakita"sipas listës poseduese nr. 97 KZ të Xërxes, me sipërfaqe prej 0, 57.13 ha.

Duke vendosur për kërkesën e parashtruesit Veli Kryeziu, Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse para gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Komunale në Rahovec, Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme të Kosovës të kenë qenë në çfarëdo mënyre të padrejta apo arbitrare. Prandaj Gjykata ka vendosur se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36(2b) të Rregullores së Punës, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese.

Prishtinë, më 21 maj 2012

Nr. ref.: RK241/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 114/11

Parashtruesi

Veli Kryeziu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc. nr. 2/2009, të 5 prillit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Veli Kryeziu nga fshati Xërxe, Komuna e Rahovecit.

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc. Nr. 2/2009, i 15 prillit 2011, që i është dorëzuar parashtruesit më 17 maj 2011, me të cilën është pranuar kërkesa e Prokurorit publik të Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe me të cilën janë ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 338/2008 i 16 tetorit 208 dhe ai i Gjykatës Komunale të Rahovecit C. nr. 45/2007 i 2 qershorit 2008, dhe njëkohësisht refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e parashtruesit me të cilën kërkonte përcaktimin e të drejtës së pronës së regjistruar si parcelë kadastrale nr. 835/3, në vendin e quajtur "Rakita", sipas listës poseduese nr. 97 të KZ Xërxe, me sipërfaqe prej 0,57.13 ha.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Mlc. Nr. 2/2009, i 5 prillit 2011, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit, "i është shkelur e drejta e mbrojtjes së pronës, e përcaktuar me nenin 46 pika 1 e Kushtetutës së Kosovës" për shkak të mosmarrëveshjes mbi të drejtën e pronës në mes të parashtruesit dhe Komunës së Rahovecit në lidhje me përcaktimin e të drejtës në pronën e regjistruar si parcelë kadastrale nr. 835/3, në vendin e quajtur "Rakita".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi më 11 gusht 2011, parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 21 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese informoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Komunale të Rahovecit dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, për inicimin e procedurës së shqyrtimit të kushtetutshmërisë së vendimeve për rastin KI114/11.

7. Më 04 maj 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodriguez dhe Prof. Dr. Enver Hasani, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

8. Ali Kryeziu, përndryshe babai i parashtruesit, ka qenë pronar i pronës me sipërfaqe prej 0,57.13 ha, në vendin e quajtur "Rakita", i regjistruar në regjistrin për të drejtat e pronës së paluajtshme si ngastër kadastrale nr. 835 të KZ Xrxe. Sipërfaqja e përmendur ka qenë pronë e Ali Kryeziut derisa ai ishte gjallë, ndërkaq pas vdekjes së tij ishte pronë e djalit të tij, Veli Kryeziu.

9. Në bazë të regjistrit të kadastrës së viti 1952, kjo sipërfaqe ka qenë e regjistruar në ngastrën kadastrale nr. 21 në emër të Ali Kryeziut.

10. Në bazë të regjistrimit ajror fotogrametrik që kishte hyrë në fuqi në vitin 1959, i ekspozuar në shikim publik në vitin 1965, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 1967, ngastra e kontestuar ka marrë numër të ri si pjesë përbërëse a ngastrës nr. 835/1. Gjatë paraqitjes së të dhënave për shqyrtim publik të vitit 1965, çdo ngastër të cilën pronari nuk e ka regjistruar si të veten, është regjistruar si pronë shoqërore. Për pjesën e ngastrës së kontestuar nr. 835/3 si pjesë e ngastrës nr. 835/, pasi që pronari nuk është paraqitur që ta regjistrojë si pronar, Komision e ka regjistruar si pronë shoqërore në regjistrin ABC nr. 130 Xërxe, në emër të KK të Rahovecit.

11. Pas hyrjes në fuqi të kadastrit teknik, më 01.01. 1969, ngastra e kontestuar regjistrohet si pronë shoqërore e KK të Rahovecit. Ngastra nr. 835/3, me sipërfaqe prej 0.57.13 ha, mbeti me të dhëna të njëjta në listën poseduese nr. 97 KZ të Xërxes, kurse prona në emër të pronës shoqërore të KK Rahovec deri në vitin 1999, kur me dekretin nr. 1/1999 të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, sipas listës poseduese nr. 97, ndryshon emrin në pronë shtetërore të KK të Rahovecit.

12. Gjatë kohës së regjistrimit ajror fotogrametrik pronari i sipërfaqes në fjalë nuk ndodhej në shtëpi, kështu që me rastin e paraqitjes s të dhënave të regjistrimit publik nuk ka qenë në gjendje të paraqitet si pronar i pronës së kontestuar. Prandaj, prona është regjistruar si pronë shoqërore. Prona tjetër në

fqinjësi të së njëjtës ngastër kadastrale, sipas regjistrit kadastral, ka qenë e regjistruar në emër të Ali Kryeziut. Ali Kryeziu, e më vonë edhe djali i tij Veli Kryeziu sipas pohimeve të parashtruesit, nuk kanë mundur të parashikojnë se kjo pronë e kontestuar është regjistruar si pronë shoqërore, deri në ditën e inicimit të kontestit gjyqësor për përcaktimin e të drejtës në pronë.

13. Duke pasur parasysh faktin se ngastra nr. 835/3 (regjistrimet në bazë të ndryshimeve të mëvonshme kadastrale) pa asnjë bazë ligjore të përcaktuar me ligjin për përvetësimin e të drejtës pronësore, por vetëm në bazë të regjistrimit ajror fotogrametrik, i cili është bërë publik në vitin 1965, është regjistruar si pronë shoqërore ndërsa të drejtën në këtë pronë e ka pronari i saj Ali Kryeziu, kurse pas vdekjes së tij, në bazë të trashëgimisë, Veli Kryeziu – parashtruesi i kërkesës i cili kishte iniciuar procedurën gjyqësore për përcaktimin e të drejtës pronësore.

14. Nga sa u tha më lartë, parashtruesi i kërkesës ka nisur proces gjyqësor në shkallën e parë në Gjykatën Komunale të Rahovecit, i cili përcakton faktet e lartpërmendura në bazë të raportit të ekspertit të gjeodezisë, Miftar Krasniqit, dhe raportit të dëshmitarit I.K. dhe Sh. K. Në bazë të provave administrative dhe fakteve të vërtetuara, me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Rahovecit C. nr. 45/2007, të 02 qershorit 2008, është përcaktuar e drejta pronësore e Veli Kryeziut në ngastrën kadastrale nr. 835/3 KZ të Xërxes.

15. Kundër këtij Aktgjykimi të Gjykatës Komunale të Rahovecit C. nr. 45/2007, të 2 qershorit 2008, është ushtruar ankesë nga avokati publik i Komunës së Rahovecit. Duke vendosur për ankesën e avokatit publik, Gjykata e Qarkut në Prizren me aktgjykimin Ac. nr. 338/2008, të 6 tetorit 2008, refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Rahovecit C. nr. 45/2007, të 2 qershorit 2008.

16. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 338/2008, të 6 tetorit 2008, Prokurori publik i Kosovës parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë. Duke vendosur për kërkesën e mbrojtjes së ligjshmërisë, Gjykata Supreme e

Kosovës me Aktgjykimin Mlc. nr. 2/2009, të 5 prillit 2011, pranoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të bazuar dhe në bazë të gjendjes së njëjtë faktike ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Rahovec C. nr. 338/2008, të 6 tetorit 2008, dhe hodhi poshtë kërkesëpadinë e paditësit Veli Kryeziu me të cilën ai kërkoi përcaktimin e të drejtës në pronë të ngastrës kadastrale nr. 835/3 KZ të Xërxes. Në arsyetimin e Aktgjykimit Mlc. Nr. 2/2009, të 5 prillit 2011, Gjykata Supreme ka deklaruar si në vijim:

> *"Paditësi (*parashtruesi i kërkesës**)***është i detyruar që të provojë ekzistimin e fakteve juridike në bazë të cilës fitohet apo mund të fitohet e drejta e kërkuar në pronë. Paditësi në padi dhe në seancat e mbajtura pranë gjykatës së shkallës së parë deklaron se është pronar i pronës kontestuese në baze të trashëgimisë së paraardhësit të tyre, mirëpo nuk provon mënyrën e fitimit të pronës kontestuese e as të pasardhësit të tij. Fakti se dëshmitarët kanë deklaruar se paditësi ngastrën kontestuese e ka trashëguar nga paraardhësi i tij, nuk paraqet bazë të vlefshme juridike për vërtetimin e pronësisë së paditësit. Prona kontestuese që nga viti 1965 në librat kadastrale evidentohet në emër të paditurës (Komuna e Rahovecit) ndërkaq paditësi nuk ka dëshmuar me fakte se paraardhësi i tij dhe paditësi të kenë ndërmarrë ndonjë veprim juridik për kthimin e pronës dhe posedimin e pronës kontestuese për të cilin shkak është dashur që të pranohet revizioni i të paditurës si i bazuar dhe të ndryshohet aktgjykimi i gjykatave të instancës më të ulët dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit."*

17. Parashtruesi i kërkesës, pas zgjidhjes së rastit me aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës së Qarkut Ac. nr. 338/2008, të 6 tetorit 2008, dhe para marrjes së vendimit në lidhje me mjetin e jashtëzakonshëm juridik për mbrojtjen e ligjshmërisë nga Gjykata Supreme e Kosovës, e ka shitur pronën në fjalë, ashtu që tani është e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme nën emrin e blerësit Agron Rexhep Morina.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc. Nr. 2/2009, të 5 prillit 2011, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese si në vijim:

> *"Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc.nr. 2/2009 të 05.04.2011 të shpallet i paligjshëm dhe të më mundësohet mbrojtja e të drejtës në pronë e përcaktuar me nenin 46 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

> *„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

21. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih,

mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

22. Parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi KEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se si dhe në ç'mënyrë neni 46 pika 1 i Kushtetutës mbështetë kërkesën e tij, siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

23. Në këtë rast parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesë rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë, para Gjykatës Komunale në Rahovec, Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëd mënyre kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

24. Në lidhje me ankesën e parashtruesit për shkeljen e pretenduar të nenit 46 të Kushtetutës, mbrojtja e pronës, Gjykata vëren se kjo vlen vetëm për pronën ekzistuese të personave.

25. Prandaj, shpresa se mund të kthehet e drejta në pronën e humbur prej kohësh, nuk mund të konsiderohet si "posedim" e as kërkesë e kushtëzuar e cila është vjetruar si pasojë e mospërmbushjes së kushteve (shih *Gratzinger dhe Gratzingerova* kundër Republikës Çeke (vendimi)) [VK], nr. 39794/ 98, pasusi 69, KEDNJ 2002-VII).

26. Megjithatë, në rrethana të caktuara "pritja legjitime" për përvetësimin e "pasurive" mund të gëzojë gjithashtu mbrojtjen nga neni 1 të Protokollit 1. Prandaj, në rastet kur interesi pronësor në esencën e padisë, mund të konsiderohet që personi ka "pritje

të ligjshme" përderisa ekziston bazë e mjaftueshme e interesimit në ligjin vendor, për shembull kur ekziston praktika e themeluar gjyqësore e gjykatave vendore me të cilën vërtetohet ekzistimi i së njëjtës (shih Kopecky kundër Sllovakisë [VK], nr. 44912/98, pasus 52, GJEDNJ 2004-IX). Megjithatë, nuk mund të thuhet se pritshmëria legjitime paraqitet në rastet kur ekziston një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin e drejtë dhe zbatimin e ligjit vendor kurse, kërkesat e parashtruesit i hedhin poshtë gjykatat vendore më vonë (shih *Kopecky,* i cituar më lartë, pasusi 50).

27. Gjykata vëren se në rastin konkret ekziston mosmarrëveshje në zbatimin dhe interpretimin e drejtë të ligjit të zbatueshëm dhe që Gjykata Supreme rrjedhimisht ka refuzuar kërkesat e parashtruesit të kërkesës.

28. Përfundimisht, në këtë kërkesë nuk janë përmbushur kushtet për pranueshmëri. Ai nuk ka arritur të mbështesë me fakte se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara kushtetuese.

29. Nga kjo del se, kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, që parashikon se *" Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 maj 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

KI 130/11 datë 15 qershor 2012- Kërkesë për rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KI18/10, të 12 prillit 2011

Rasti KI 130/11, vendimi i datës 4 maj 2012
Fjalët kyçe: kërkesa individuale, e papranueshme

Parashtruesi ka parashtruar Kërkesën në bazë të Rregullit 36 (3.e) të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke pretenduar që Gjykata Kushtetuese nuk ka marrë parasysh një letër që është dorëzuar në këtë Gjykatë më 12 maj 2011.

Gjykata vendosi që Kërkesa ishte e papranueshme, sepse pretendimet e Parashtruesit janë të njëjtat me ato pretendime që i ka bërë në Kërkesën e parë, të cilat janë trajtuar nga kjo Gjykatë në Vendimin e saj për papranueshmëri në rastin nr. KI. 18/10, me të cilin ka vendosur që Parashtruesit nuk kishin shteruar gjitha mjetet juridike në dispozicion. Kështu, Gjykata nuk mund t'i trajtojë ato këtu, sipas Rregullit 36(3) (e) të Rregullores së Punës. Për më tepër, Gjykata vëren që një prej pretendimeve të Parashtruesve është një ankesë e re në lidhje me stërzgjatjen e procedurave, që nuk bie në fushëveprimin e Kërkesës fillestare të shqyrtuar nga Gjykata me Vendimin e saj për papranueshmëri në rastin KI. 18/10. Megjithatë, kjo nuk i pengon Parashtruesit të dorëzojnë një Kërkesë të re për t'u ankuar për procedurat tepër të zgjatura.

Prishtinë, më 21 maj 2012

Nr. ref.: RK237/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 130/11

Parashtruesi

Z. Denić Mladen dhe z. Vitković-Denić Milorad

Kërkesë për rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KI18/10, të 12 prillit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtrues i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Denić D. Mladen dhe z. Vitković-Denić D. Milorad, me vendbanim në Kralevë, Serbi, të përfaqësuar nga z. Vitković M. Branislav, avokat nga Kraleva, Serbia, të cilët i paraqitën kërkesën a parë (Rasti Nr. KI18/10) Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 24 shkurt 2010. Kërkesa ishte refuzuar si e papranueshme më 12 prill 2011.

Vendimi i kontestuar

2. Me kërkesën e tanishme, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të rishqyrtojë Aktvendimin për papranueshmëri të kësaj Gjykate në Rastin KI18/10, të po kësaj Gjykate, të datës 12 prill 2011, me të cilin Gjykata deklaroi të papranueshme kërkesën e parashtruesve të kërkesës për shkak se nuk i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore. Aktvendimi iu ishte dorëzuar parashtruesve të kërkesës më 19 shtator 2011.

Objekti i çështjes

3. Me këtë kërkesës për rishqyrtimin e aktvendimit për papranueshmëri, parashtruesit e kërkesës ankohen se Gjykata nuk kishte marrë parasysh letrën e dorëzuar Gjykatës më 12 maj 2011.

Baza juridike

4. Rregulli 36 (3e) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 3 tetor 2011, parashtruesit i paraqitën kërkesën Gjykatës për rishqyrtimin e Aktvendimit për papranueshmëri të kësaj Gjykate në rastin KI18/10, të datës 12 prill 2011, dhe i publikuar më 19 shtator 2011.

6. Më 18 janar 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 130/11, emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 130/11, emëroi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Almiro Rodrigues.

7. Më 2 shkurt 2012, Gjykata kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë informata lidhur me statusin procedurës.

8. Më 29 shkurt 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë u përgjigj se po shqyrtohej rasti i parashtruesve. Megjithatë, për shkak të kompleksitetit të rastit, numrit të madh të rasteve në pritje para gjykatës dhe vështirësive në komunikim me parashkruesit e kërkesës të cilët banojnë në Serbi, Gjykata Komunale në Prishtinë nuk kishte pasur mundësinë të mbajë seancë.

9. Më 4 maj 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Sa i përket rastit të mëhershëm të parashtruesve të kërkesës, rasti KI. Nr. 18/10, gjykuar më 12 prill 2011, kjo Gjykatë gjeti se kërkesa ishte e papranueshme në bazë të asaj se parashtruesit e

kërkesës dështuan të dëshmojnë se i kishin shteruar të gjitha mjetet ligjore të parapara me ligj, pasi që ata nuk kishin ngritur apo ndjekur shkeljet e pretenduara gjatë kohës kur procedurat ishin në pritje para Gjykatës Komunale apo para cilësdo gjykatë të shkallës më të lartë. Ky vendim ishte publikuar më 19 shtator 2011.

11. Më 12 maj 2011, parashtruesit e kërkesës i kishin dorëzuar një letër kësaj Gjykate, duke pretenduar se neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës ishte shkelur, sepse deri më sot Gjykata Komunale në Prishtinë ende nuk kishte marrë ndonjë vendim lidhur me rastin e tyre, brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

12. Në kërkesën e parashtruesve për rishqyrtim, ata pretendojnë se kjo Gjykatë nuk ka marrë parasysh letrën të cilën parashtruesit e kërkesës ia kishin dorëzuar Gjykatës më 12 maj 2011, me të cilën parashtruesit kishin pretenduar se:

> "...
>
> a. Është shkelur neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës, sepse deri më sot Gjykata Komunale në Prishtinë nuk ka marrë ndonjë vendim lidhur me rastin e tyre, brenda një afati të arsyeshëm kohor;
>
> b. Është shkelur neni 143.1 [Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës] i Kushtetutës, sepse Gjykata Supreme me Aktgjykimin e vet Nr. Cml.-Gzz. br. 36/2007, të 13 dhjetorit 2007, nuk ka respektuar dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës (Propozimi i Ahtisaarit), Aneksi VII, neni 2 para. 2.1 [Ndërmarrjet Shoqërore] dhe neni 3, para. 3.1 dhe 3.3 [Procesi i Shqyrtimit të Kërkesave në AKM], i cili parasheh se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës është kompetente për të vendosur për këtë çështje e jo Gjykata Supreme; dhe

c. Është shkelur neni 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit] i Kushtetutës, sepse atyre nuk u ishte kthyer pasuria e vet.
…"

13. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 36 (3.e) të Rregullores së punës i cili parasheh:

"…
Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur: Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri;

…"

14. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se sa i përket pretendimeve b) dhe c), ato janë po të njëjtat pretendime të bëra në kërkesën e parë. Kjo Gjykatë është marrë me këto pretendime në Aktvendimin për papranueshmëri në rastin Nr. KI. 18/10, me të cilin është vendosur se parashtruesit e kërkesës nuk i kishin shteruar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion.

15. Prandaj, në bazë të rregullit 36(3) (e) të Rregullores së punës, Gjykata nuk mund të merret me to këtu.

16. Sa i përket pretendimit a), Gjykata vëren se është ankesë e re lidhur me zgjatjen e tepruar të procedurës e cila nuk bie brenda fushëveprimit të kërkesës së parë me të cilën është marrë kjo Gjykatë në Aktvendimin për papranueshmëri në rastin Nr. KI. 18/10. Megjithatë, kjo nuk i ndalon parashtruesit e kërkesës të paraqesin kërkesë të re për t'u ankuar në zgjatjen e tepruar të procedurës.

17. Për më tepër, Gjykata vëren se për ankesën e parashtruesve të kërkesës, të cilën po e bëjnë tani para kësaj Gjykate lidhur me zgjatjen e tepruar të procedurës, nuk është vendosur ende nga Gjykata Komunale. Andaj, të gjitha argumentet lidhur me pretendimet e zgjatjes së tepruar të procedurës duhet paraqitur

nga parashtruesit e kërkesës në Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe nëse nuk janë të kënaqur, të ngrenë ankesë në gjykatat më të larta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme.

18. Nga kjo rrjedh se, në bazë të rregullit 36 (3.e) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme. Megjithatë, siç është cekur më parë, kjo nuk i parandalon parashtruesit e kërkesës nga parashtrimi i një kërkesë të re duke u ankuar për stërzgjatje të procedurës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të Rregullit 36 (3.e) të Rregullore së punës, më 4 maj 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. Ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 18/12 datë 25 qershor 2012 -Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 1285/2011, të 30 dhjetorit 2011

Rasti KI 18/02, vendimi i 7 majit 2012.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, pension invalidor, qartazi e pabazuar, barazia para ligjit.

Parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesë për shfuqizimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 1285/2011 të 30 dhjetorit 2011, me të cilën parashtruesit i është hequr e drejta për pension për persona me aftësi të kufizuar. Parashtruesi pretendon se më këtë vendim i janë shkelur të drejtat kushtetuese, duke mos specifikuar saktësisht dispozitat kushtetuese të cilat mund të ishin shkelur.

Duke vendosur për kërkesën e parashtruesit Remzije Arifi, Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, nuk ka gjetur se procedurat përkatëse të Komisioneve mjekësore të shkallës së parë dhe të dytë, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies sociale dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës në çfarëdo mënyre kanë qenë të padrejta apo arbitrare. Prandaj Gjykata ka vendosur se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36(2b) të Rregullores së Punës, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese.

Prishtinë, më 21 maj 2012

Nr. ref.: RK240/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 18/12

Parashtruesi

Remzije Arifi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës

A. nr. 1285/2011, të 30 dhjetorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Remzije Arifi nga Lipjani, Rr. Adem Jashari, të cilën para Gjykatës Kushtetuese e përfaqëson avokati Rrahman Retkoceri, nga Lipjani.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A. Nr. 1285/2011, i 30 dhjetorit 2011, me të cilin është refuzuar padia e ngritur kundër Aktvendimit Nr. 5062525, të 18 gushtit 2011, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS) – Departamenti i Administratës Pensionale (në tekstin e mëtejmë: DAP), me të cilin aktvendim është refuzuar kërkesa e parashtrueses që t'i njihet e drejta për pension të personave me aftësi të kufizuar.

Çështja e kërkesës

3. Çështje e kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A. Nr. 1285/2011, i 30 dhjetorit 2011, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtrueses së kërkesës *„ ... janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore nga neni 24 (barazia para ligjit) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut Protokolli 1 neni 6.“*

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të

Republikës së Kosovës, të 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 para. 2 i Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 28 shkurt 2012, parashtruesja e kërkesës i paraqiti kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 27 mars 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën Supreme se ka filluar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimeve për lëndën Nr. KI-18-12.

7. Më 7 mars 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares Iliriana Islami, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe prof. dr Enver Hasani, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesja e kërkesës ka kërkuar nga MPMS-DAP që t'i njihet e drejta për pension për persona me aftësi të kufizuara. MPMS-DAP-Këshilli për ankesa dhe pensione të personave me aftësi të kufizuar në Prishtinë, me Aktvendimin Nr. 5062525 të 23 nëntorit 2007, refuzoi kërkesën e Remzije Arifit për njohjen e të drejtës në pension të personave me aftësi të kufizuar.

9. Ndaj Aktvendimit të MPMS-DAP Nr. 5062525, të 23 nëntorit 2007, parashtruesja e kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Supreme, e cila vendosi lidhur me padinë e parashtrueses së kërkesës me Aktgjykimin A. Nr. 109/2008, të 12 nëntorit 2008, duke pranuar padinë e parashtrueses së kërkesës dhe anuluar Aktvendimin e MPMS-DAP Nr. 5062525, të 23 nëntorit 2007.

10. Bazuar në rrjedhën e këtillë të gjendjes faktike, MPMS-DAP nxori Aktvendimin e ri Nr. 5062525, të 29 prillit 2010, me të cilin parashtrueses së kërkesës i njihet e drejta për pension të personave me aftësi të kufizuar, me shënimin se pas një viti do të rishqyrtohet e drejta për pension.

11. Në rishqyrtim, pas ekzaminimeve të kryera nga komisioni mjekësor i përbërë nga mjekë specialistë të fushave përkatëse, pas vlerësimit të dokumentacionit mjekësor dhe rezultateve të ekzaminimit të drejtpërdrejt nga komisioni i shkallës së parë, si dhe mendimeve të komisionit se tek parashtruesja e kërkesës nuk ekziston kufizim i plotë dhe i përhershëm i aftësive, MPMS-DAP nxori Aktvendimin e ri Nr. 5062525, të 18 gushtit 2011, me të cilin refuzohet kërkesa e Remzije Arifit për njohjen e të drejtës për pension të personave me aftësi të kufizuar.

12. Ndaj Aktvendimit të MPMS-DAP Nr. 5062525, të 18 gushtit 2011, parashtruesja e kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Supreme të Kosovës.

13. Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e parashtrueses së kërkesës, me Aktgjykimin A. Nr. 1285/2011 të 30 dhjetorit 2011, hodhi poshtë padinë e parashtrueses së kërkesës me arsyetimin:

> *"Duke pasur parasysh, se komisionet mjekësore me ligj të autorizuara, kanë konstatuar se te paditësja nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme, se organi i shkallës së parë dhe e paditura, në procedurën që i ka parapri nxjerrjes së aktvendimit të goditur, kanë respektuar dispozitat e procedurës administrative, Gjykata konstatoi se e paditura, duke refuzuar padinë e paditëses, e ka zbatuar drejt te drejtën materiale kur ka konstatuar se paditësja nuk i përmbushë kriteret e parashikuara me nenin 3 të LPPAK, për të fituar të drejtën e pensionit për persona me aftësi të kufizuar."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesja e kërkesës nga Gjykata Kushtetuese kërkon që:

> *„Të vlerësohet kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. Nr. 1285/2011 të 30 dhjetorit 2011, lidhur me vendosjen për padinë e parashtruar nga znj. Remzije Arifi , nga Lipjani.“*

15. Parashtruesja e kërkesës konsideron se gjendja shëndetësore e parashtrueses së kërkesës me kalimin e kohës nuk është përmirësuar vetëm se është përkeqësuar dhe se komisionet mjekësore të shkallës së parë dhe të dytë nuk kanë vepruar objektivisht, andaj me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. Nr. 1285/2011, të 30 dhjetorit 2011, *„... janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore nga neni 24 (barazia para ligjit) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut Protokolli 1 neni 6.”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

17. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

> *„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.“*

18. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të të drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

19. Parashtruesja e kërkesës nuk ka ofruar ndonjë provë *prima facie* që do të tregonte në shkeljet e të drejtave kushtetuese të parashtrueses së kërkesës (shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës Nr. 53363/99, të 31 majit 2005). Parashtruesja e kërkesës nuk përmend se në çfarë mënyre neni 24 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ mbështesin kërkesën e saj, siç edhe parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

20. Në këtë rast, parashtrueses së kërkesës i janë ofruar mundësi të numërta për të paraqitur rastin dhe të kontestojë interpretimin e ligjit, që ajo konsideron të jetë i pasaktë, para komisioneve mjekësore të shkallës së parë dhe të dytë, MPMS-DAP dhe Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka arritur të vërtetojë se procedurat përkatëse në çfarëdo mënyre kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

21. Përfundimisht, kjo parashtresë nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë. Ajo nuk ka arritur të cekë dhe të mbështesë me prova pretendimin se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.

22. Rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, i cili parashikon që „faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese“.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 36 (2.b) të Rregullore së punës, në seancën e mbajtur më 7 maj 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. Ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Dr. Iliriana Islami Prof. Dr. Enver Hasan

KI 108/11 datë 10 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme PN. Nr. 372/2011, të 13 korrikut 2011

Rasti KI 108/11, aktvendimi i 4 majit 2012
Fjalët kyçe: rast penal, parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor, kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, shkelje të të drejtave dhe lirive individuale, qartazi e pabazuar, palë e paautorizuar

Parashtruesi ka parashtruar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pretenduar që të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E Drejta për Proces të Rregullt Gjyqësor] në lidhje me nenin 13 [E Drejta për Mjete Efektive Juridike] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe Protokolleve të saj, janë shkelur nga aktvendimet e Gjykatës Supreme, e cila ka vendosur që ankesa ndaj një vendimi gjyqësor për konfirmimin e aktakuzës do të lejohej vetëm nëse aktakuza do të hidhej poshtë, sipas nenit 317(2) të KPPK-së.
Gjykata vendosi që Kërkesa është e papranueshme, sepse Parashtruesi nuk ka arritur të paraqesë prova që procedurat përkatëse kanë qenë të padrejta apo të njollosura me arbitraritet në çfarëdo mënyre. Kështu, Gjykata theksoi që Kërkesa ishte qartazi e pabazuar, në bazë të Rregullit 36 (1.c) të Rregullores së Punës. Për më tepër, sa i përket përputhshmërisë së ligjeve, në këtë rast të KPPK-së, me Kushtetutën, Gjykata vëren që vetëm palët e autorizuara sipas nenit 113.2 të Kushtetutës kanë të drejtë të parashtrojë këtë pyetje. Pra, Parashtruesi nuk është palë e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës. Megjithatë, Parashtruesi mund të ngrejë çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën në gjykatat e rregullta, të cilat janë të autorizuara sipas nenit 113.8 të Kushtetutës t'i referojnë çështje Gjykatës Kushtetuese.

Prishtinë, më 22 maj 2012

Nr. ref.: RK244/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 108/11

Parashtruesi

Myrteza Dyla

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme PN. Nr. 372/2011, të 13 korrikut 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Myrteza Dyla, i përfaqësuar nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme PN. Nr. 372/2011, të 13 korrikut 2011, i cili i është dorëzuar më 22 korrik 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme PN. Nr. 372/2011, të 13 korrikut 2011, me të cilin gjoja i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E drejta për Mjete Juridike] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane

për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 8 gusht 2011.

6. Më 23 gusht 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI 108/11, e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Po të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI 108/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Gjyljeta Mushkolaj.

7. Më 24 janar 2011, Gjykata ua komunikoi kërkesën Gjykatës Supreme dhe Prokurorit publik të qarkut në Pejë. Gjykata nuk ka marrë asnjë përgjigje deri më tani.

8. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues më 4 maj 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 15 qershor 2011, një gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Pejë (në tekstin e mëtejmë: gjyqtari) e konfirmoi aktakuzën e Prokurorit

publik të Qarkut të paraqitur ndaj parashtruesit të kërkesës për kryerje të veprës penale nga neni 339.3 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal (në tekstin e mëtejmë: KPK) (Vendimi KA. nr. 90/11). Gjyqtari konfirmoi se kishte bazë të mjaftueshme për konfirmim të aktakuzës në mënyrë që të konstatohej fajësia ose pafajësia e parashtruesit në shqyrtimin kryesor. Parashtruesi ushtroi ankesë ndaj këtij vendimi në Kolegjin prej tre gjyqtarësh të Gjykatës së Qarkut në Pejë (në tekstin e mëtejmë: Kolegji).

10. Më 27 qershor 2011, Kolegji e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të papranueshme (Vendimi KA. nr. 90/11) dhe konkludoi që ankesa ndaj vendimit të gjyqtarit në lidhje me konfirmimin e aktakuzës do të mund të parashtrohej vetëm nga prokurori dhe pala e dëmtuar kur aktakuza hedhet poshtë sipas nenit 317.2 të KPK-së. Parashtruesi u ankua ndaj këtij vendimi në Gjykatën Supreme.

11. Më 13 korrik 2011, Gjykata Supreme e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe konkludoi, mbi të njëjtën bazë sikurse edhe Kolegji, që ankesa ndaj vendimit të gjyqtarit në lidhje me konfirmimin e aktakuzës do të mund të parashtrohej vetëm nga prokurori dhe pala e dëmtuar kur aktakuza hedhet poshtë sipas nenit 317.2 të KPK-së (Vendimi Pn. Nr. 372/2011).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se:

    a. Është shkelur e drejta për ankesë sepse parashtruesi nuk ka mundur të ankohej ndaj vendimit të gjyqtarit në lidhje me konfirmimin e Aktakuzës së 15 qershorit 2011;

    b. Është shkelur edhe e drejta e qasjes në gjykatë duke mos ia dhënë mundësinë parashtruesit që të ankohet;

c. Është shkelur parimi i barazisë së armëve në mes palëve në procedurë;

d. Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme gabimisht e kanë zbatuar dhe interpretuar KPK-në sepse, sipas parashtruesit, ekziston e drejta e ankesës sipas KPK-së.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E drejta për Mjete Juridike] dhe 102 [Parimet e përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.

14. Sa u përket ankesave të parashtruesit, Gjykata vëren se, për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, ajo së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

15. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese thekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

16. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin

Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

17. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë pasi nuk i është lejuar të ushtrojë ankesë ndaj vendimit të gjyqtarit për konfirmimin e aktakuzës.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 102.5 të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. "* Neni 317.2 i KPPK nuk parashikon të drejtën e parashtruesit që të ankohet ndaj konfirmimit të aktakuzës. Megjithatë, Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme e morën parasysh ankesën e parashtruesit, por vendosën që nuk mund të ushtrohej ankesë ndaj konfirmimit të aktakuzës sipas nenit 317.2 të KPPK-së, i cili përcakton:

> *"Ndaj aktvendimit të gjyqtarit për hudhjen e aktakuzës mund të ushtrohet ankesë nga prokurori dhe i dëmtuari në kolegjin prej **[tre]** gjyqtarësh."*

19. Përveç kësaj, Gjykata vëren që konfirmimi i aktakuzës nuk paragjykon gjykimin e çështjes gjatë shqyrtimit kryesor në përputhje me nenin 317.1 të KPPK-së, i cili përcakton:

> *"Të gjitha aktvendimet e marra nga gjyqtari lidhur me konfirmimin e aktakuzës duhet të arsyetohen në atë mënyrë që të mos prejudikohet gjykimi i çështjeve të cilat do të shqyrtohen në shqyrtimin gjyqësor."*

20. Në fakt, parashtruesi nuk e ka mbështetur kërkesën në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga ai organ publik. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub

kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

21. Prandaj, rezulton që kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhje me rregullin 36.1 (c) të Rregullores së punës, i cili thotë: *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar"*.

22. Nëse kjo Gjykatë merr parasysh faktin që parashtruesi i kërkesës e ngrit çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën, në këtë rast të KPPK-së, Gjykata vëren që vetëm palët e autorizuara sipas nenit 113.2 të Kushtetutës kanë të drejtë ta ngrenë këtë çështje. Prandaj, parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës. Megjithatë, parashtruesi mund ta ngrejë çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën në gjykata të rregullta, të cilat janë të autorizuara, sipas nenit 113.8 të Kushtetutës, t'i referojnë këto çështje në Gjykatën Kushtetuese.

23. Prandaj, kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës, rregullin 36.1 (c) dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 4 maj 2012, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 16/12 datë 25 qershor 2012- Vlerësim kushtetues i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. nr. 1415/2011, të datës 30 dhjetor 2011.

Rasti KI 16/12, vendimi i datës 7 maj 2012
Fjalët kyçe: procedura administrative, mbrojtja shëndetësore dhe sociale, zbulimi i identitetit, kërkesa individuale, shkelje të të drejtave dhe lirive individuale, qartazi e pabazuar

Parashtruesi ka parashtruar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pretenduar që të drejtat e tij sipas nenit 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] janë cenuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, e cila kishte vendosur që Departamenti i Administratës së Pensionit kishte marrë vendim më 22 mars 2011, derisa Parashtruesi ka kontestuar vendimin më 16 shtator 2011. Në këtë kuptim, Gjykata Supreme kishte theksuar që Komiteti për Ankesa, duke hedhur poshtë ankesën e Parashtruesit, kishte zbatuar të drejtën kur kishte vendosur që ankesa ishte parashtruar pas afatit të përcaktuar kohor. Parashtruesi më tutje kishte kërkuar nga Gjykata të mos zbulohej identiteti i tij.

Gjykata theksoi që Kërkesa ishte e papranueshme sepse Parashtruesi nuk kishte arritur të prezantonte prova që procedurat përkatëse kanë qenë të padrejta apo të njollosura me arbitraritet në çfarëdo mënyre. Kështu, Gjykata theksoi që Kërkesa ishte qartazi e pabazuar, në bazë të Rregullit 36 (1.c) të Rregullores së Punës. Sa i përket kërkesës së Parashtruesit për të mos zbuluar identitetin e tij, Gjykata e hodhi poshtë këtë kërkesë si të pabazuar, sepse nuk ishin prezantuar dokumente apo informata përcjellëse për arsyet e Parashtruesit për të mos zbuluar identitetin e tij.

Prishtinë, më 22 maj 2012

Nr. ref.: RK243/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 16/12

Parashtruesi

Gazmend Tahiraj

Vlerësim kushtetues i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. nr. 1415/2011, të datës 30 dhjetor 2011.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtrues i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Gazmend Tahiraj nga fshati Terdevc, Gllogovc.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr. 1415/2011, të 30 dhjetorit 2011, i cili nuk dihet se kur i ishte dorëzuar atij.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i lartpërmendur shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), më saktë neni 51 [Mbrojtja shëndetësore dhe sociale].

4. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të mos i zbulohet identiteti.

Baza Juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 23 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës e paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 1 mars 2012, Kryetari emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.

8. Më 5 mars 2012, Gjykata ua komunikoi kërkesën Gjykatës Supreme dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies sociale – Departamentit të Administratës Pensionale.

9. Më 7 maj 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 14 dhjetor 2004, Departamenti i Administratës Pensionale miratoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për pensionin e aftësisë së kufizuar në pajtim me Ligjin Nr. 2003/23 për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë. Kjo e drejtë për pension të aftësisë së kufizuar do të rishqyrtohej pas tri vjetësh nga data e fitimit të kësaj të drejte.

11. Më 16 shtator 2010, Komisioni mjekësor rivlerësoi situatën e parashtruesit të kërkesës dhe Departamentit të Administratës Pensionale, dhe konsideroi se parashtruesi i kërkesës i plotëson kërkesat e parapara me Ligjin Nr. 2003/23 Pensionet e personave me aftësi të kufizuar, dhe i vazhdoi të drejtën për pension të aftësisë së kufizuar.

12. Më 15 shkurt 2011, Komisioni mjekësor rivlerësoi përsëri situatën e parashtruesit të kërkesës dhe më 22 mars 2011, Departamenti i Administratës Pensionale konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kushtet e parapara me Ligjin Nr. 2003/23 për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar dhe rrjedhimisht refuzoi kërkesën për pension të aftësisë së kufizuar.

13. Më 16 shtator 2011, parashtruesi i kërkesës u ankua ndaj këtij vendimi tek Komisioni për ankesa në Departamentin e Administratës Pensionale.

14. Më 20 tetor 2011, Komisioni për ankesa refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, sepse parashtruesi i kërkesës nuk kishte respektuar afatin ligjor për parashtrim të ankesës. Në fakt, parashtruesi i kërkesës pranoi vendimin e kontestuar më 22 mars 2011, përderisa parashtroi ankesën më 16 shtator 2011, d.m.th. më shumë se 14 ditë nga dita e dorëzimit të vendimit në fjalë. Parashtruesi i kërkesës inicioi procedurën e konfliktit administrativ në Gjykatën Supreme kundër atij vendimi.

15. Më 30 dhjetor 2011, Gjykata Supreme (Aktgjykimi A. nr. 1415/2011) refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazë. Gjykata Supreme konkludoi se Departamenti i Administratës Pensionale mori vendimin më 22 mars 2011, përderisa parashtruesi i kërkesës kontestoi vendimin më 16 shtator 2011. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme vlerësoi se Komisioni i ankesave, duke hedhur poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ka zbatuar drejt ligjin kur ka konkluduar se ankesa ishte parashtruar pas afatit të paraparë kohor.

16. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dokumentacion mbështetës dhe as informacion që do të arsyetonte kërkesën e tij për moszbulim të identitetit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata Supreme *"në mënyrë të njëanshme po më mohon të drejtën për pension të aftësisë së kufizuar"*.

18. Prandaj, parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme ka shkelur nenin 51 [Mbrojtja shëndetësore dhe sociale] të Kushtetutës dhe nenet 1, 2, 3, 4 të Ligjit për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Gjykata vëren se për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese së pari duhet te shqyrtoje nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregulloren e punës.

20. Neni 113. paragrafi 1 dhe 7 i Kushtetutës parasheh:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. (...)*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

21. Në anën tjetër, rregulli 36 1 (c) i Rregullores së punës parasheh që *"Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar."*

22. Para së gjithash, parashtruesi i kërkesës nuk i parashtroi ankesë Komisionit të ankesave në Departamentin e Administratës Pensionale brenda afatit ligjor.

23. Në fakt, Gjykata Supreme konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk e ka parashtruar ankesën e tij brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 10.1 për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar.

24. Parimi i subsidiaritetit parasheh që parashtruesi i kërkesës të shter të gjitha mundësitë procedurale në procedurat e rregullta, në mënyrë që t'i parandalojë shkeljet e Kushtetutës, ose, nëse ka, të korrigjojë shkelje të tilla të të drejtave themelore. Kështu që, parashtruesi i kërkesës duke dështuar për të ndërmarrë veprime procedurale në gjykatat e rregullta në pajtim me afatet e parapara, faktikisht, mban përgjegjësinë pse rasti i tij deklarohet i papranueshëm, meqë do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për procedim të mëtejshëm për të kundërshtuar shkeljen.

25. Gjykata gjithashtu konsideron se dyshimi i thjeshtë mbi perspektivën e çështjes nuk është i mjaftueshëm për të ndaluar një parashtrues kërkese nga detyrimet e tij për t'u ankuar para organeve kompetente në kohën e duhur (shih Whiteside kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendimi i 7 marsit 1994, parashtresa nr. 20357/92, DR 76, fq.80).

26. Siç u tha më sipër, pretendimet e parashtruesit të kërkesës përmblidhen në një ankesë se procedurat ishin kryer në "*mënyrë të njëanshme*" dhe ishin të padrejta.

27. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të zëvendësojë vlerësimin vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta. Si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë dëshmitë para vetes. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të vërtetojë nëse procedurat në tërësi, përfshirë edhe se nëse mënyra se si janë marrë ato dëshmi, kanë qenë të drejta (shih, *mutatis mutandis*, Vidal kundër Belgjikës, Aktgjykimi i 22 prillit 1992, Seria A nr. 235-B, pp. 32-33, para. 33).

28. Në vazhdim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga ana e Gjykatës Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e

mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Kështu që, Gjykata nuk duhet vepruar si gjykatë e shkallës së katërt kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të të drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

29. Si përfundim, Gjykata vetëm mund të vlerësojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të ndershme, dhe nëse procedurat në përgjithësi, parë si tërësi, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesi i kërkesës ka pasur gjykim të ndershëm (shih mes tjerash, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

30. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thjeshtë konteston nëse Gjykata Supreme ka zbatuar plotësisht ligjin në fuqi dhe nuk pajtohet me gjetjet faktike të gjykatave lidhur me rastin e tij. Parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar se pse dhe si Gjykata Supreme vendosi *"në mënyrë të njëanshme",* duke mohuar të drejtën e tij për pension të personave me aftësi të kufizuar.

31. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tija në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga autoritetet publike. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të përfundojë se procedurat relevante në çfarëdo mënyre ishin të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, GJEDNJ Vendimi për Pranueshmëri Nr. 17064/06 i 30 qershorit 2009).

32. Nga e gjithë kjo, rrjedh se kërkesa është e papranueshme për arsye të mosshterjes së mjeteve ligjore të ofruara me ligj dhe, edhe po që se të shteruara, kërkesa është qartazi e pabazë në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës.

33. Sa i përket kërkesës së parashtruesit të kërkesës për moszbulim të identitetit, Gjykata e refuzon si të pabazë, sepse nuk ka ofruar dokumentacion dhe informata mbështetëse lidhur me arsyet se pse parashtruesi i kërkesës nuk dëshiron t'i zbulohet identiteti.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të rregullit 36 (1.c) dhe rregullit 56 (2) të Rregullore së punës, më 7 maj 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. Ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme;

II. Ta hedhë poshtë kërkesën e tij për moszbulim të identitetit;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Prof. Dr. Enver Hasani

KI 127/11 datë 11 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 219/2009, të 10 qershorit 2011

Rasti KI 127/2011, vendimi i datës 4 maj 2012
Fjalët kyçe: kontest administrativ, kontest pune, kërkesa individuale, mos shterje e mjeteve juridike, kërkesa qartazi e pabazuar.

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se me Aktgjykimin Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me Nenin 49.1, si dhe Nenin 23 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut në lidhje me Nenin 21.1 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, dhe Nenin 6 të KNDNj.

Gjykata, lidhur me këtë rast kishte vlerësuar që parashtruesi i kërkesës nuk e kishte mbështetur dhe argumentuar bindshëm pretendimin e tij se Gjykata Supreme në mënyrë arbitrare ia kishte shkelur të drejtat e tij. Gjykata Kushtetuese edhe ne këtë rast rikujtoj se është në juridiksionin e Gjykatës Supreme që të vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve të instancave më të ulëta, detyrë e të cilave është vërtetimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike dhe zbatimi së drejtës materiale në pajtim me rrethanat e krijuara të rastit, në mënyrë që të evitohen shkeljet e mundshme të të drejtave të garantuara me legjislacionin në fuqi dhe me Kushtetutë. Bazuar ne këto arsye, Gjykata kishte konstatuar se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbushte kërkesat e nenit 46 të Ligjit dhe rregullit 36.2 (b), prandaj, si e tillë është konsideruar si qartazi e pabazuar.

Gjykata, gjithashtu kishte vërejtur se parashtruesi kishte lidhur kontratë të re me Komunën e Gjilanit, pasi që Komuna ishte obliguar që ta kthente atë në punë në pajtim me Aktvendimin E. nr. 1/2009 të Gjykatës Komunale të Gjilanit, për përmbarimin e Aktgjykimit C. Nr. 540/07. Mirëpo parashtruesi përkitazi me këtë çështje nuk kishte provuar se i kishte shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion sa

i përket kontestimit të kontratës së re të lidhur me Komunën e Gjilanit, para se të parashtronte kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Si përfundim, Gjykata kishte konstatuar që kërkesa e parashtruesit nuk i kishte përmbushur kriteret e pranueshmërisë në përputhje me kërkesat e nenit 46, 47.2 të Ligjit, rregullit 36.1 (a) dhe 36.2 (b) të Rregullores së punës.

Prishtinë, më 24 maj 2012

Nr. ref.: RK246/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 127/11

Parashtruesi

Ardian Hasani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 219/2009, të 10 qershorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Ardian Hasani, me vendbanim në Gjilan.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi gjyqësor i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 219/2009, i 10 qershorit 2011, që parashtruesit i është dorëzuar më 18 korrik 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, lidhur me vendimin nr. 02/11 të Kryeshefit Ekzekutiv të Komunës së Gjilanit me të cilin është shuar vendi i punës së parashtruesit të kërkesës dhe i njëjti është larguar nga puna.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 3 tetor 2011, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

6. Më 7 tetor 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 127/11, caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, me Vendimin Nr. KSH. 127/11, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: 1. Robert Carolan (kryesues), 2. Almiro Rodriguez (anëtar) dhe 3. Prof. Dr. Enver Hasani (anëtar).

7. Më 18 janar 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Supreme dhe Komunën e Gjilanit për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 4 maj 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve në procedurë administrative

9. Parashtruesi i kërkesës, më 30 mars 2005 ka lidhur kontratë të punës me nr. 02/111/272 me Kuvendin Komunal të Gjilanit, me kohëzgjatje prej 1 janarit 2005 deri më 31 dhjetor 2006, në vendin e punës "Zyrtar për përcjellje" në kuadër të Ekzekutivit të Komunës.

10. Më 4 janar 2007, Komuna e Gjilanit, përkatësisht Kryeshefi Ekzekutiv nxori vendimin nr. 02/11 për mospërtëritje të kontratës së punës, bazuar në Vendimin nr. 02/7001, të 13 shtatorit 2006, sipas të cilit ishte shpërbërë Sektori i Inspeksionit dhe rrjedhimisht të punësuarit në atë shërbim ishin transferuar në drejtoritë përkatëse komunale. Vendi i punës "Zyrtar për përcjellje", siç thuhet në vendim ishte shuar për arsye se nuk "kishte kushte bazë për ekzistimin e këtij vendi të punës."

11. Më 10 prill 2007, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), pas ankesës se ushtruar nga parashtruesi, nxori Vendimin me nr. 02/77/2007, me të cilin e aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit, anuloi Vendimin Kryeshefit Ekzekutiv nr. 02/11, të 4 janarit 2007, si vendim i organit punëdhënës i cili nuk ishte kompetent për vendosje dhe e obligoi ushtruesin e detyrës të Kryeshefit Ekzekutiv, që në afat prej 10 ditësh ta shqyrtojë vendimin e lartshënuar dhe të bie vendim meritor lidhur me këtë çështje. Ky vendim ishte përfundimtar në procedurën administrative kundër të cilit nuk është e lejuar ankesa.

12. Më 22 qershor 2007, u.d i Kryeshefit Ekzekutiv në procedurë të përsëritur e ka shuar serish vendin e punës - Zyrtar për përcjellje, që ishte në kuadër të Departamentit të Ekzekutivit, ish-sektorit të Inspeksionit. Më 26 qershor 2007, Komuna e Gjilanit e njoftoi KPMSHC dhe parashtruesin lidhur me ketë vendim.

Përmbledhje e fakteve në procedurë gjyqësore

13. Parashtruesi i kërkesës, pasi që kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative, ka parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Komunale të Gjilanit kundër Komunës së Gjilanit, me të cilën e ka kontestuar vendimin e u.d. të Kryeshefit Ekzekutiv lidhur me shuarjen e vendit të punës dhe largimin e tij nga puna.

14. Më 14 korrik 2008, Gjykata Komunale në Gjilan nxori Aktgjykimin C. nr 540/07, aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit, anuloi Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv nr. 02/11 dhe 02/10, të 4 janarit 2007, si dhe e obligoi të padituren, Komunën e Gjilanit, që ta kthej në punë parashtruesin me të gjitha të drejtat që dalin nga marrëdhënia e punës, duke filluar nga 1 janari 2007.

15. Më 18 korrik 2008, Komuna e Gjilanit përmes përfaqësuesit të saj ushtroi të drejtën e ankesës kundër Aktgjykimit C. nr 540/07 të 14 korrikut 2008, të Gjykatës Komunale, në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, me propozimin për anulimin e këtij vendimi.

16. Më 26 nëntor 2008, Gjykata e Qarkut në Gjilan nxori Aktgjykimin Ac. nr 328/2008, refuzoi si të pa bazë ankesën e ushtruar nga përfaqësuesi i Komunës së Gjilanit dhe vërtetoi Aktgjykimin C. Nr. 540/07 të Gjykatës Komunale të Gjilanit, të 14 korrikut 2008. Komuna e Gjilanit, e pakënaqur me ketë aktgjykim, ka ushtruar revizion në Gjykate Supreme të Kosovës.

Faktet në procedurë përmbarimore

17. Më 5 janar 2009, parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e kreditorit, parashtroi kërkesë për ekzekutimin e Aktgjykimit C. Nr. 540/07 të 14 korrikut 2008, në Gjykatën Komunale të Gjilanit, pasi që Gjykata e Qarkut si shkallë e dytë e kishte refuzuar ankesën e ushtruar nga Komuna e Gjilanit.

18. Më 12 janar 2009, Gjykata Komunale në Gjilan nxori Aktvendimin E. nr. 1/2009, me të cilin e aprovoi propozimin e parashtruesit për lejimin e ekzekutimit të Aktgjykimit C. nr. 540/07 të 14 korrikut 2008, lidhur me kthimin e tij në vendin e punës.

19. Më 22 janar 2009, Komuna e Gjilanit parashtroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjilan për shtyrjen e ekzekutimit të aktvendimit E. nr. 1/2009, të 12 janarit 2009, për faktin se e njëjta kishte ushtruar revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe ishte në pritje të vendimit.

20. Më 26 shkurt 2009, Gjykata Komunale në Gjilan e hodhi poshtë kërkesën e Komunës së Gjilanit për shtyrjen e ekzekutimit të Aktvendimit E. nr. 1/2009, të 12 janarit 2009.

21. Komuna, e pakënaqur me vendimin e Gjykatës Komunale të Gjilanit, parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan me propozim për prishjen e Aktvendimit E. nr. 1/2009, të 12 janarit 2009 dhe shtyrjen e ekzekutimit derisa Gjykata Supreme të vendoste lidhur me revizionin.

22. Më 16 prill 2009, Gjykata e Qarkut në Gjilan, me aktvendimin Ac. nr. 107/09, e hodhi poshtë si të pabazë propozimin e Komunës së Gjilanit për shtyrjen e ekzekutimit të aktvendimit E. nr. 1/2009, të 12 janarit 2009, si dhe kërkesën për anulimin e këtij vendimi. Pasi që kjo gjykatë, si instancë përfundimtare në procedurë përmbarimore, kishte hedhur poshtë propozimin e Komunës për shtyrjen e ekzekutimit të Aktvendimit të shkalles së parë E. nr. 1/2009, të 12 janarit 2009, parashtruesi i kërkesës me pas bëri propozim në Gjykatën Komunale të Gjilanit për kompensimin e të ardhurave të humbura personale.

23. Më 28 korrik 2010, Gjykata Komunale e Gjilanit, sipas propozimit të parashtruesit për kompensimin e të ardhurave personale, nxori Aktgjykim C. nr. 278/07 lidhur me këtë çështje dhe e obligoi Komunën e Gjilanit që në emër të pagave t'ia bëj kompensimin e të ardhurave personale, sipas llogarisë së ekspertit financiar për periudhën kohore: 1 janar 2007 - 31 dhjetor 2007, për periudhën kohore 1 janar 2008 - 31 dhjetor 2008 dhe për periudhën kohore 1 janar 2009 - 13 maj 2009, dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

24. Kundër këtij aktvendimi të Gjykatës Komunale të Gjilanit, më 9 dhjetor 2010, Komuna e Gjilanit në afat ligjor parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan.

Faktet në procedurë kontestimore

25. Më 10 qershor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Rev. nr.219/2009, me të cilin e aprovoi revizionin e ushtruar nga Komuna e Gjilanit, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan Ac. nr 328/08, të 21 nëntorit 2011, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Gjilanit C. nr. 540/07, të 14 korrikut 2008, si dhe refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit për anulimin e Vendimit të Kryeshefit Ekzekutiv nr. 02/11 të 4 janarit 2007. Kjo Gjykatë e kishte arsyetuar vendimin e saj duke u mbështetur në faktin se, instancat më të ulëta kishin vërtetuar drejtë gjendjen faktike, por e kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale, kur kanë vlerësuar se kërkesëpadia e parashtruesit është e bazuar. Gjykata Supreme me tej pohon që, me vet faktin që parashtruesit nuk i është vazhduar kontrata e punës, nënkupton që atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës si shërbyes civil në pajtim me nenin 35.1 pika (b) të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të skadimin të kohëzgjatjes së punësimit, andaj rrjedhimisht, ndërprerja e marrëdhënies së punës së parashtruesit ka qenë e ligjshme.

Përmbledhje e fakteve në procedurë administrative, pas procedurave gjyqësore

26. Më 19 korrik 2011, KK në Gjilan, pasi që kishte pranuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme, e kishte njoftuar parashtruesin lidhur me të dhe bashkëngjitur me njoftimin ia kishte dorëzuar kopjen e Aktgjykimit Rev. nr. 219/2009, të 10 qershorit 2011.

27. Më 21 korrik 2011, Kryetari i Komunës, bazuar në aktgjykimin e lartshënuar, bie Rekomandim nr. 02/16-20291, në të cilin thuhet: *"Rekomandohet zyra e personelit që të bëjë ç'kyçje nga puna të z. Ardian Hasani i caktuar në detyrë punuese: Mirëmbajtës i Stadiumit të Qytetit, në kuadër të DKRS sipas*

Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr.219/2009 të dt. 10.06.2011".

28. Më 25 korrik 2011, Komuna e Gjilanit ia ndërpreu parashtruesit të kërkesës kontratat e punës konform Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr.219/2009 të 10 qershorit 2011, me të cilin është miratuar revizioni i ushtruar nga kjo Komunë dhe janë ndryshuar aktgjykimet e instancave me të ulëta sipas të cilave ishte obliguar Komuna që ta kthej në punë parashtruesin me të gjitha të drejtat e plota që dalin nga marrëdhënia e punës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare, si më poshtë:

a. Neni 49.1 i Kushtetutës;
b. Neni 23 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut në lidhje me nenin 21.1 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës; dhe
c. Nenin 6 i Konventës.

30. Parashtruesi pohon se, Gjykata Supreme, vendosi njëanshëm nga shkaku se nuk mori parasysh faktin që Kryeshefi Ekzekutiv i Komunës së Gjilanit kishte marrë vendim për shuarjen e vendit të punës dhe largimin e tij nga puna, përderisa atij i kishte skaduar kontrata më 31 dhjetor 2006 dhe se ai vendim, sipas parashtruesit, është i paligjshëm dhe në kundërshtim me nenin 11.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës.

32. Gjykata Kushtetuese, nga shkresat e lëndës ka vërejtur që parashtruesi nuk i ka përmbushur kërkesat për pranueshmëri, në mënyre që gjykata të lëshohet në themelësinë e kërkesës, nga arsyet të cilat do t'i përmendim në paragrafët që do të pasojnë në vijim.

33. Gjykata, vëren se, me Vendimin nr. 02/11 të 4 janarit 2007, të Kryeshefit Ekzekutiv të Komunës së Gjilanit, parashtruesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të shuarjes se vendit të punës. Duke qenë i pakënaqur me vendimin e sipërpërmendur, parashtruesi ka ndjekur realizimin e të drejtave të tij përmes procedurave administrative, e më pas ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Komunale të Gjilanit, e cila kishte vendosur për kthimin e tij në vendin e punës. Pasi që edhe shkalla e dytë e kishte vërtetuar si të drejtë Aktgjykimin të shkallës së parë C. Nr. 540/07, të 14 korrikut 2008, parashtruesi ka bërë propozim për përmbarimin e aktgjykimit në fjalë. Komuna e Gjilanit, siç shihet nga shkresat, kishte kundërshtuar përmbarimin por kundërshtimi i së njëjtës ishte refuzuar nga Gjykata Komunale e Gjilanit. Aktvendimi ishte bërë i formës së prerë sipas Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe më pas, Komuna kishte respektuar dhe zbatuar Aktgjykimin C. Nr. 540/07 të 14 korrikut 2008, dhe Aktvendimin E. nr. 1/2009 të Gjykatës Komunale sipas propozimit të parashtruesit për përmbarimin e Aktgjykimit C. Nr. 540/07, sipas të cilit Komuna është obliguar që ta kthej parashtruesin në punë, gjë të cilën dhe e ka bërë. Por, më pas, vendimi i shkallës së parë dhe vendimi i shkallës së dytë, janë ndryshuar me Aktgjykimin Rev. nr 219/2009 të Gjykatës Supreme, të 10 qershorit 2011**.**

34. Gjykata Kushtetuese, vëren se parashtruesi pretendon që Gjykata Supreme ka bërë shkelje të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventa ndërkombëtare, kur ka vendosur për anulimin e kontratës së tij me nr. 02/111/272 duke e vlerësuar si të ligjshëm

vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv për ndërprerjen e kontratës së punës dhe mos vazhdimin e saj. Duket qartë që, Gjykata Supreme kishte vendosur sipas revizionit të ushtruar nga Komuna e Gjilanit dhe është lëshuar në vlerësimin e Vendimit të Kryeshefit ekzekutiv nr. 02/11 dhe vendimit të u. d. të Kryeshefit ekzekutiv, lidhur me shuarjen e vendit të punës - Zyrtar për përcjellje, që ishte në kuadër të Ekzekutivit të Komunës.

35. Gjykata, lidhur me këtë, vlerëson që, parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur dhe argumentuar bindshëm pretendimin e tij se Gjykata Supreme në mënyrë arbitrare ka shkelur të drejtat e tij. Gjykata, rikujton se është në juridiksionin e Gjykatës Supreme që të vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve të instancave më të ulëta, detyrë e të cilave është vërtetimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike dhe zbatimi së drejtës materiale në pajtim me rrethanat e krijuara të rastit, në mënyrë që të evitohen shkeljet e mundshme të të drejtave të garantuara me legjislacionin në fuqi dhe me Kushtetutë.

36. Në vazhdim, Gjykata thekson se, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga ana e Gjykatës Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë. Kështu që, Gjykata nuk duhet vepruar si gjykatë e shkallës së katërt kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë dhe obligim i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

37. Gjykata mund vetëm të vlerësojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, parë si tërësi, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesi i kërkesës ka pasur gjykim të ndershëm (shih mes tjerash, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

38. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar ndonjë

provë se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga autoritetet publike. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të vijë në përfundim se procedurat relevante në çfarëdo mënyre ishin të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, GJEDNJ Vendimi për Pranueshmëri Nr. 17064/06 i 30 qershorit 2009).

39. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kërkesat e nenit 46 të Ligjit dhe rregullit 36.2 (b), prandaj, si e tillë është qartazi e pabazuar.

40. Mirëpo, Gjykata, në rastin e parashtruesit ka vërejtur një realitet të ri, i cili është krijuar mes parashtruesit dhe Komunës së Gjilanit, pasi që Komuna është obliguar që ta kthej parashtruesin në punë në pajtim me Aktvendimin E. nr. 1/2009 të Gjykatës Komunale të Gjilanit, për përmbarimin e Aktgjykimit C. Nr. 540/07, të 14 korrikut 2008.

41. Duke qenë se parashtruesi ka lidhur kontratë të re të punës me nr. 02 nr. 1029, më 29 dhjetor 2009, i ngarkuar me pozitë - Mirëmbajtës i stadiumit të qytetit të Gjilanit, me kohëzgjatje të marrëdhënies së punës nga 1 janari 2010 deri më 31 dhjetor 2012, i njëjti është dashur që ta kontestoj vendimin e Komunës së Gjilanit lidhur me anulimin e kontratës së re të punës 02 nr. 1029, duke iniciuar kontest punë në gjykatën kompetente kundër Komunës së Gjilanit.

42. Nisur nga ky fakt, del se parashtruesi nuk ka provuar që i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sa i përket kontestimit të kontratës së re të lidhur me Komunën e Gjilanit.

43. Parimi i subsidiaritetit parasheh që parashtruesi i kërkesës duhet t'i shterë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat e rregullta, në mënyrë që t'i parandalojë shkeljet e Kushtetutës, ose, nëse ka, të korrigjojë shkelje të tilla të të drejtave themelore. Kështu që, parashtruesi i kërkesës duke dështuar që të ndërmarrë veprime procedurale në gjykatat e rregullta në pajtim me afatet e parapara, faktikisht, mban përgjegjësinë pse rasti i tij deklarohet i papranueshëm.

44. Si përfundim, Gjykata konstaton që kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë në përputhje me kërkesat e

nenit 46, 47.2 të Ligjit, rregullit 36.1 (a) dhe 36.2 (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 46, nenin 47.2 të Ligjit, rregullin 36.1 (a), rregullin 36.3 (h) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 4 maj 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Dr. Gjyljeta Mushkolaj Prof. Dr. Enver Hasani

KI 90/11 datë 18 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 368/2008, të 8 prillit 2011

Rasti KI 90/11, vendimi i datës 4 maj 2012
Fjalët kyçe: gjykim në bazë të kushtetutës dhe ligjit, kërkesë individuale, masa e përkohshme, të drejtat pronësore, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkelje të të drejtave dhe lirive individuale, qartazi e pabazuar, parimet universale.

Parashtruesja ka parashtruar kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pretenduar që të drejtat dhe liritë e saj individuale të garantuara me Kushtetutë janë cenuar nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 368/2008, me të cilin hidhet poshtë kërkesa për revizion si e pabazuar, si dhe ka theksuar që ka ekzistuar një marrëveshje gojore që shtëpia të ndërtohet, për arsye që edhe vëllai i burrit të Parashtrueses do të jetonte aty. Për më tepër, Parashtruesja i kishte kërkuar Gjykatës të vendoste masë të përkohshme.

Gjykata vendosi që Kërkesa ishte e papranueshme, sepse Parashtruesja nuk kishte arritur të prezantonte prova që procedurat përkatëse kanë qenë të padrejta apo të njollosura me arbitraritet në çfarëdo mënyre. Kështu, Gjykata theksoi që Kërkesa ishte qartazi e pabazuar, në bazë të Rregullit 36 (1.c) të Rregullores së Punës. Për më tepër, sa i përket kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata theksoi që duke marrë parasysh që Kërkesa ishte vendosur si e papranueshme, Parashtruesja nuk ka të drejtë të kërkojë masë të përkohshme, sipas Rregullit 54 (1) të Rregullores së Punës.

Prishtinë, 24 maj 2012

Nr. ref.: RK245/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 90/11

Parashtruesi

Xhemile Gashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 368/2008, të 8 prillit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues është znj. Xhemile Gashi, me banim në Prishtinë, e përfaqësuar nga z. Gani Tigani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme rev. nr. 368/2008, të 8 prillit 2011, që parashtrueses iu dorëzua më 25 maj 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme rev. nr. 368/2008, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e saj të garantuara sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

4. Parashtruesja ankohet në veçanti se:

a. Është shkelur parimi i përgjithshëm i sigurisë ligjore;
b. Është shkelur e drejta e saj në pronë;
c. Është zbatuar ligji në mënyrë retroaktive;
d. Është shkelur parimi i përgjithshëm që gjykatat duhet të gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe të Ligjit; dhe
e. Është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

5. Më tutje, parashtruesja kërkon që Gjykata të lejojë masat e përkohshme për të ndaluar ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale C. nr. 1593/07, të 29 nëntorit 2007, pa ofruar ndonjë arsye të mëtutjeshme.

Baza ligjore

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

7. Më 1 korrik 2011, parashtruesi parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

8. Më 17 gusht 2011, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI 90/11, emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin nr. K.SH.KI 90/11, emëroi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Almiro Rodriguez (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.

9. Më 28 shkurt 2012, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme.

10. Më 4 maj 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Më 12 shkurt 1986, Gjykata Komunale në Prishtinë vlerësoi se parashtruesja në pajtim me Ligjin për Trashëgiminë do të jetë trashëguesja e të gjithë trashëgimisë së lënë nga i ndjeri, Z. B. G. (bashkëshorti i parashtrueses), (Vendimi T. nr. 6/86).

12. Në vitin 1986, vëllai dhe nëna e bashkëshortit të parashtrueses paraqitën një padi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, si gjykatë e shkallës së parë duke kërkuar vërtetimin e së drejtës në gjysmën (1/2) e pronës së parashtrueses, sepse bashkëshorti i parashtrueses me marrëveshje gojore ua kishte dhënë gjysmën (1/2) e pronës atyre.

13. Më 30 mars 1989, Gjykata e Qarkut në Prishtinë miratoi ankesën dhe arriti në përfundim se ata (nëna dhe vëllai) janë pronarë të gjysmës (1/2) së pronës dhe obligoi parashtruesen që ta njohë këtë të drejtë (Vendimi C. nr. 763/86).

14. Më 5 shtator 1989, Gjykata Supreme anuloi vendimin e Gjykatës së Qarkut dhe ktheu rastin për rigjykim në Gjykatën Komunale të Prishtinës, sepse as vendimi i kontestuar e as faktet nuk janë vendosur plotësisht dhe bindshëm, prandaj ishte e nevojshme të përsëritet procedura për të vendosur pronësinë e pronës së kontestuar (Vendimi Gz. Nr. 616/89).

15. Më 7 tetor 1991, Gjykata Komunale në Prishtinë refuzoi padinë e nënës dhe vëllait të bashkëshortit të ndjerë të parashtrueses që kishte ndërtuar pronën me mjetet e tija financiare (Aktgjykimi C. nr. 2810/89).

16. Më 11 maj 1993, Gjykata e Qarkut në Prishtinë anuloi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe të njëjtën e ktheu në Gjykatën e Qarkut për rigjykim. Gjykata e Qarkut vlerësoi se Gjykata Komunale

kishte vendosur në rastin duke u bazuar në faktet të cilat nuk kishin rëndësi relevante për këtë rast, dhe për këtë arsye Gjykata Komunale "*duhet që mbi të gjitha të vendosë nëse pasuria e patundshme ishte arritur në një bashkësi familjare. Nëse pasuria ishte ngritur në bashkësi familjare, atëherë marrëveshja e kontestuar mes palëve duhet të qartësohet duke zbatuar dispozitat e Ligjit për Martesë dhe Marrëdhënie Familjare, që do të thotë se duhet të vlerësohet nëse kishte pasur marrëveshje në mes të anëtarëve të bashkësisë familjare sa i përket ndarjes së bashkë-pronësisë pavarësisht madhësisë së kontributit".*

17. Më 26 shtator 1995, Gjykata Komunale miratoi padinë e nënës dhe vëllait të bashkëshortit të ndjerë të parashtrueses dhe konfirmoi që secili prej tyre ishte pronar i ¼ së pasurisë. Gjykata vlerësoi se "kur një ndërtesë është ndërtuar në bazë të një marrëveshjeje të arritur gojarisht, bëhet njohja ligjore e bashkë-pronësisë përmes marrëveshjes gojore" (Aktgjykimi P. nr. 1105/93).

18. Më 14 shtator 1998, Gjykata e Qarkut në Prishtinë anuloi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe e ktheu në Gjykatën Komunale për të rigjykuar çështjen. Gjykata e Qarkut vlerësoi se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale nuk përmbante "arsyetime për faktet decidive as nuk kishte përmendur cilat fakte ishin vlerësuar, cilat fakte duket të kenë qenë të vërteta dhe cila ishte baza për vlerësimin e deklaratave të dhëna nga dëshmitarët dhe palët në procedurë" (Vendimi Gz. Nr. 402/98).

19. Më 16 korrik 2004, Gjykata Komunale gjykoi se "sa i përket ndërtimit të shtëpisë së kontestuar ekzistonte një marrëveshje gojore në mes të" burrit të parashtrueses dhe vëllait të tij që shtëpia duhej të ndërtohej për nevojat e dy vëllezërve, pa marrë parasysh kontributin. Gjykata Komunale konkludoi se vëllai i bashkëshortit të parashtrueses zotëronte gjysmën (½) e pasurisë dhe parashtruesja zotëron gjysmën tjetër (1/2) (Aktgjykimi C. nr. 280/00).

20. Më 11 maj 2005, Gjykata e Qarkut vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale (Aktgjykimi AC. Nr. 489/04).

21. Më 15 dhjetor 2005, Gjykata Supreme anuloi dy aktgjykimet e gjykatave më të ulëta dhe ktheu rastin në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Gjykata Supreme gjeti një numër të shkeljeve esenciale procedurale (Vendimi nr. rev. 153/2005).

22. Më 18 shtator 2006, Gjykata Komunale vendosi që ¼ e pasurisë i takonte vëllait të bashkëshortit të parashtrueses (Aktgjykimi C. nr. 111/06).

23. Më 28 qershor 2007, Gjykata e Qarkut anuloi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe e dërgoi çështjen për rigjykim sepse Gjykata e Qarkut gjeti se ka pasur shkelje esenciale procedurale dhe zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale (Vendimi AC. nr. 1037/ 06).

24. Më 29 nëntor 2007, Gjykata Komunale vendosi se gjysma (½) e pasurisë i takonte vëllait të bashkëshortit të parashtrueses bazuar në marrëveshjen gojore (Aktgjykimi C. nr. 1593/2007).

25. Më 5 qershor 2008, Gjykata e Qarkut mbështeti aktgjykimin e Gjykatës Komunale (Aktgjykimi AC. nr. 133/08).

26. Më 8 prill 2011, Gjykata Supreme hodhi poshtë kërkesën për revizion si të pabazuar. Gjykata Supreme vlerësoi se ka ekzistuar një marrëveshje gojore që shtëpia të ndërtohej me arsyen që vëllai i bashkëshortit të parashtrueses të mund të jetonte po ashtu në atë shtëpi (Aktgjykimi nr. rev. 368/2008).

Pretendimet e parashtruesit

27. Sa i përket parimit të sigurisë juridike, parashtruesja pohon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme rev. 368/2008, i 8 prillit 2011, cenon këtë parim universal për shkak se krijoi pasiguri sa i përket pyetjes se në çfarë baze juridike do të mbështetet e drejta e saj, përveç se në ligj.

28. Sa i përket shkeljes së pretenduar të së drejtës së saj në pronë, parashtruesja ankohet se gjykatat nuk kanë marrë parasysh pjesën e pasurisë së fituar gjatë jetës së saj martesore.

29. Sa i përket shkeljes së pretenduar se Gjykata Supreme nuk ka gjykuar çështjen në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve sepse, parashtruesja pohon që, ligji nuk njeh marrëveshjet verbale si bazë për të marrë pasurinë.

30. Sa i përket shkeljes së pretenduar për të drejtën në gjykim të drejtë, parashtruesja ankohet që Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar aktgjykimin e vet dhe nuk ka marrë parasysh dokumentet që ajo kishte dorëzuar në Gjykatë.

31. Më tutje parashtruesja ankohet që Gjykatat kanë zbatuar ligjet në mënyrë retroaktive.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Sa i përket ankesës që aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka shkelur:

a. parimin universal të sigurisë juridike;
b. të drejtat e saj pronësore;
c. parimet universale se gjykatat duhet të gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit; dhe
d. të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm,

Gjykata Kushtetuese thekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

33. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera,

Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).

34. Në rastin konkret, parashtruesja vetëm konteston nëse Gjykata Supreme ka zbatuar në mënyrë të drejtë ligjin e zbatueshëm dhe nuk pajtohet me gjetjet faktike të gjykatës sa i përket rastit të saj.

35. Në të vërtetë parashtruesja nuk e ka mbështetur një pretendim në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova se të drejtat dhe liritë e saja janë shkelur nga ai autoritet publik. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë se procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta ose të njollosura nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis*, Shub v. Lithuania, Vendimi i GJEDNJ për papranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).

36. Prandaj, parashtruesja nuk ka treguar si dhe pse Gjykata Supreme ka shkelur:

a. parimin universal të sigurisë juridike;
b. të drejtat e saj pronësore;
c. parimet universale se gjykatat duhet të gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit; dhe
d. të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

37. Rregulli 36 (2) d) i Rregullores së punës parasheh që "Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartas të pabazuar nëse bindet se (...) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

38. Duke marrë parasysh ato që u përmendën më lart, del se kërkesa në tërësi duhet të refuzohet si qartas e pabazuar.

Vlerësimi i kërkesës për masa të përkohshme

39. Neni 27 i Ligjit, në veçanti rregulli 54(1) i Rregullores së punës, parasheh se "përderisa një kërkesë është e pazgjidhur në Gjykatë

dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme...Megjithatë, duke marrë parasysh që kërkesa është gjetur e papranueshme, parashtruesja nuk ka të drejtë të kërkojë lejimin e masës së përkohshme sipas rregullit 54(1) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (2) (d), rregullin 54 (1) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 4 maj 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masa të përkohshme;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 95/11 datë 27 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 1230/2010, të 15 shkurtit 2011

Rasti KI 95/11, vendim i 29 majit 2012.

Fjalët kyçe: departamenti për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe viktimave civile, të drejtat dhe liritë kushtetuese, kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, prima facie.

Parashtrueset paraqitën kërkesën e tyre bazuar në Nein 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tyre kushtetuese janë cenuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, me ç'rast u vërtetua vendimi i departamentit për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe viktimave civile lidhur me të drejtën e parashtrueseve në pension për familjet e viktimave civile të luftës. Parashtrueset pohuan se Gjykata Supreme ka cenuar të drejtat e tyre të garantuara me nenet 21, 22, 24, 31, 37 (paragrafi 3), dhe 50, 51 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrueseve ishte e papranuehsme bazuar në Nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese për shkak se kërkesa ishte parashtruar jashtë afatit kohor të paraparë me dispozitën në fjalë. Duke cituar vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, Gjykata më tutje arsyetoi se edhe sikur hipotetikisht kërkesa të ishte parashtruar në pajtim me afatet ligjore, parashtrueset nuk kanë dorëzuar ndonjë prove *prima facie* që tregon cenimin e të drejtave të tyre garantuara me Kushtetutë. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtrueseve si të papranueshme.

Prishtinë, më 29 maj 2012

Nr. ref.: RK247/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 95/11

Parashtrues

Hajrije Behrami dhe e bija e saj (e mitur)

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 1230/2010, të 15 shkurtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtrues të kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë Hajrije Behrami dhe e bija e saj, e cila është e mitur, nga fshati Damanek i Komunës së Drenasit.

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës është kërkesa nga ish e veja e një viktime civile të luftës në emër të saj dhe të fëmijës së vet të mitur, për pension sipas Ligjit për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, Ligji Nr. 02/L-2.

3. Parashtrueset pretendojnë se ka pasur shkelje të neneve 21, 22, 24, 31, 37 (paragrafi 3), 50, 51 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Vendimi i kontestuar

5. Parashtrueset i kontestojnë vendimet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Kosovës në Prishtinë – Departamentit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile (në tekstin e mëtejmë: DFDILVC), nr. 01-03/6954, të 20 tetorit 2010, dhe nr. 01-03/6954, të 11 nëntorit 2010, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 1230/10, të 15 dhjetorit 2010.

Procedura në Gjykatë

6. Parashtrueset e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 13 korrik 2011.

7. Më 17 gusht 2011, Kryetari e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan, Snezhana Botusharova dhe Iliriana Islami.

8. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtares raportuese më 7 mars 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 20 tetor 2010, DFDILVC, në Vendimin e vet nr. 01-03/6954, e refuzoi kërkesën e parashtrueseve për pension për familjet e viktimave civile të luftës. DFDILVC theksoi se kërkesa ishte refuzuar për shkak se parashtruesja e parë kishte lidhur martesë të re, e cila, sipas nenit 11, paragrafit 3, të Ligjit për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, Ligji Nr. 02/L-2 (në tekstin e mëtejmë: Ligji Nr. 02/L-2), ia mohon të drejtën për pensionin e sipërpërmendur. Parashtrueset u njoftuan se mund të paraqitnin ankesë kundër këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit.

10. Më 11 nëntor 2010, sektori për ankesa i DFDILVC-së nxori vendimin e vet me të cilin e refuzonte ankesën e paraqitur nga parashtrueset. Ai gjithashtu konstatoi që parashtrueset nuk kishin të drejtë në pension pasi parashtruesja e parë kishte lidhur martesë të re.

11. Më 20 dhjetor 2010, parashtrueset parashtruan kërkesë në Gjykatën Supreme për anulimin e vendimit të 11 nëntorit 2010. Parashtrueset pohuan se vendimi i kontestuar ishte i padrejtë dhe i paligjshëm për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Parashtrueset theksuan se organi i shkallës së parë gabimisht e kishte vërtetuar gjendjen faktike me arsyetim të pabazuar se parashtruesja e parë nuk e gëzon statusin e anëtarit të familjes së viktimës civile të luftës pasi ka lidhur martesë të re.

12. Më 15 shkurt 2011, Gjykata Supreme e Kosovës, nëpërmjet Aktgjykimit A. nr. 1230/2010, e refuzoi kërkesën e parashtrueseve. Gjykata Supreme konstatoi që sektori për ankesa i DFDILVC-së e kishte vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë me rastin e refuzimit të ankesës së parashtrueseve. Gjykata Supreme u pajtua me arsyetimin në seancën e parë dhe të dytë dëgjimore se parashtruesja e parë nuk e gëzonte statusin e anëtarit të familjes pasi kishte lidhur martesë të re.

Pretendimet e parashtrueseve

13. Parashtrueset pretendojnë se u ishte mohuar njëra prej të drejtave të tyre themelore të garantuara dhe të mbrojtura me dispozitat e nenit 21 të Kushtetutës, dhe të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare ligjore në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës.

14. Parashtrueset pretendojnë që u ishte mohuar e drejta e barazisë para ligjit sipas nenit 24 dhe u ishte mohuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës.

15. Parashtrueset pohojnë që kishte shkelje të nenit 37 të Kushtetutës për shkak se shteti ua kishte mohuar mbrojtjen e posaçme që e gëzojnë familjet.

16. Parashtrueset pohojnë që u ishin mohuar të drejtat e garantuara me dispozitat e nenit 50 [E Drejta e Fëmijës] dhe nenit 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës.

17. Së fundi, parashtrueset pretendojnë që, duke ua shkelur të drejtat e tyre të garantuara juridike, atyre u ishte mohuar e drejta për mjete efektive juridike sipas nenit 54 të Kushtetutës.

Vlerësimi i pranueshmërisë

18. Sa i përket kërkesës së parashtrueseve, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili thotë:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi."*

19. Nga parashtresa mund të kuptohet që kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit kohor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

20. Vendimi i dytë është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 1230/2010, i 15 shkurtit 2011, të cilin parashtrueset pohojnë ta kenë marrë më 10 mars 2011 përmes avokatit të tyre Cenë Gashi. Parashtrueset e dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese më 13 korrik 2011. Kjo do të thotë se ato e dorëzuan kërkesën e tyre jashtë afatit kohor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

21. Prandaj, rezulton që kërkesa është e papranueshme në përputhje me rregullin 36 (1b) të Rregullores së punës, i cili thotë: *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi"*.

22. Edhe sikur raporti të mos ishte i papranueshëm për shkak të afatit kohor, Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*shih, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1*).

23. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (*shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të 23 qershorit 2010, të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, paragrafët 66 dhe 67*).

24. Pas shqyrtimit të procedurave të zhvilluara në gjykatat e rregullta si tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk gjen që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (*shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009*).

25. Përveç kësaj, parashtrueset nuk kanë dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tyre sipas Kushtetutës (*shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005*). Parashtrueseve u ishin ofruar mundësi të shumta për ta paraqitur rastin e tyre dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit të cilin e konsiderojnë jokorrekt në DFDILVC dhe në Gjykatën Supreme. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata nuk gjeti që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (*shih, mutatis*

mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

26. Sa i përket kërkesës së parashtrueses dytë, Gjykata gjen që kërkesa është e pabazuar. Gjykata arrin në përfundimin se parashtruesja e dytë nuk ka të drejtë në pension familjar sepse ajo është nën përkujdesje të parashtrueses së parë dhe neni 11, paragrafi 3, i Ligjit Nr. 02/L-2 u lejon pension familjar vetëm fëmijëve pa përkujdesje prindërore të viktimave civile të luftës.

27. Pasi parashtrueset thjesht kontestojnë nëse Gjykata Supreme e ka zbatuar ligjin përkatës dhe nëse ka nxjerrë konkluzione të mirëfillta faktike, duket që parashtrueset thjesht kërkojnë që Gjykata ta anulojë vendimin ligjor të Gjykatës Supreme. Prandaj, kjo kërkesë është qartazi e pabazuar sa i përket shkeljes së të drejtave të tyre kushtetuese apo të njeriut, dhe, si rrjedhojë, është e papranueshme.

28. Prandaj, kriteret për pranueshmëri nuk janë përmbushur në këtë kërkesë. Parashtrueset kanë dështuar ta mbështesin me prova pretendimin se vendimi i kontestuar ua ka shkelur të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese.

29. Rezulton që kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhje me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, i cili thotë: *"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese"*.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës e nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 7 mars 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'i komunikohet parashtrueses; dhe

III. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Dr.Gjyljeta Mushkolaj Prof. Dr. Enver Hasani

KI 30/10 datë 10 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 852/2009, të 24 marsit 2010

Rasti KI 30/10, vendim i 8 qershorit 2012

Fjalët kyçe: cenim i të drejtave dhe lirive individuale, departamenti i administratës pensionale të Kosovës, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, këshilli i ankesave, komisioni mjekësor, prima facie.

Parashtruesja paraqiti kërkesën bazuar në nein 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e saj kushtetuese janë cenuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, me ç'rast u vërtetua vendimi i komisionit mjekësor të departamentit të administrates pensionale lidhur me të drejtën e parashtrueses në pension për persona me aftësi të kufizuar. Parashtruesja pohoi se Gjykata Supreme ka cenuar të drejtat e saj të garantuara me nenet 3 dhe 51 të Kushtetutës së Kosovës.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrueses ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 36 të Rregullores së Punës për shkak se parashtruesja nuk kishte paraqitur fakte që *prima facie* arsyetonin shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese. Duke cituar vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Shub kundër Lituanisë* , Gjykata më tutje arsyetoi se nuk kishte vërejtur se procedurat në tërësi në Gjykatën Supreme ishin të padrejta apo arbitrare. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtrueses si të papranueshme.

Prishtinë, 08 qershor 2012

Nr. ref.: RK248/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti Nr. KI 30/10

Parashtruesi

Belkize Mustafa

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 852/2009, të 24 marsit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Belkize Mustafa nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 852/2009, të 24 marsit 2010.

Baza juridike

3. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Gjykatën Kushtetuese), dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Parashtruesja pretendon se ka pasur shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 51 [E Drejta për Mbrojtje Shëndetësore

dhe Sociale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 7 maj 2010.

6. Më 14 shtator 2010, Kryetari e caktoi prof. Dr. Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga Iliriana Islami, Gjyljeta Mushkolaj dhe Robert Carolan.

7. Më 11 dhjetor 2010 dhe më 14 janar 2011, Gjykata i dërgoi letra MPMS-së me të cilat kërkonte sqarim për disa pjesë të kërkesës.

8. Më 18 janar 2011, Gjykata mori një përgjigje nga MPMS-ja.

9. Më 16 maj 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 21 tetor 2005, Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: DAPK), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS), nxori një vendim me të cilin parashtrueses së kërkesës i njihej e drejta në pension të aftësisë së kufizuar në mënyrë retroaktive që nga 1 janari 2004, në shumë prej dyzet euro (40 €) në muaj. Në vendim gjithashtu theksohet se 3 vjet pas fitimit të kësaj të drejte, kjo Ministri do ta ftojë znj. Mustafa për qëllime të rishqyrtimit.

11. Më 12 korrik 2007, DAPK, MPMS, duke u bazuar në vlerësimin e komisionit mjekësor i cili ka vlerësuar se tek parashtruesja e kërkesës nuk ekziston aftësia e plotë dhe e përhershme e

kufizuar, ka nxjerrë një vendim me të cilin e refuzon kërkesën e znj. Mustafa për pension të aftësisë së kufizuar.

12. Më 11 dhjetor 2007, DAPK, MPMS, pas ekzaminimit të dokumentacionit, ankesave, dokumentacionit mjekësor dhe vlerësimeve të komisionit mjekësor të shkallës së parë dhe të dytë, konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që znj. Mustafa i plotëson kriteret ligjore për të qenë shfrytëzuese e pensionit të aftësisë së kufizuar dhe, si rrjedhojë, nxori vendim për ta refuzuar kërkesën e saj si të pabazuar.

13. Më 27 maj 2009, Gjykata Supreme e Kosovës, në mungesë të dokumenteve dhe si rezultat i mosveprimit të MPMS-së sipas kërkesës së Gjykatës Supreme, nxori Aktgjykim A. nr. 1287/2008, me të cilin miratohej padia e znj. Mustafa e parashtruar kundër aktvendimit të MPMS-së – Këshillit të Ankesave të 11 dhjetorit 2007, duke e anuluar atë.

14. Më 5 gusht 2009, Këshilli i Ankesave për Pensione të Aftësisë së Kufizuar i DAPK, MPMS, duke vepruar në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, A. nr. 1287/08, nxori një aktvendim me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e znj. Mustafa për njohjen e të drejtës në pension të aftësisë së kufizuar dhe e vërtetoi vendimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë si të bazuar plotësisht në Ligjin për pensionet e personave me aftësi të kufizuara 2003/23, (në tekstin e mëtejmë: LPPAK).

15. Më 24 mars 2010, Gjykata Supreme e Kosovës, në mbështetje të dokumentacionit përkatës, nxori Aktgjykim A. nr. 1287/08, me të cilin refuzohej padia e znj. Mustafa e parashtruar kundër aktvendimit të 5 gushtit 2009, të MPMS-së – Këshillit të Ankesave.

16. Në të njëjtin aktgjykim, Gjykata Supreme theksoi se komisionet mjekësore të themeluara nga MPMS-ja, në pajtim me nenin 3.2 të LPPAK-së, në përbërje të mjekëve specialistë të lëmenjve përkatës, pas vlerësimit të dokumentacionit mjekësor dhe

rezultateve të shikimit të drejtpërdrejtë, kanë gjetur se tek parashtruesja e kërkesës nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme. Prandaj, Gjykata konstatoi se DAPK, MPMS duke e refuzuar padinë e paditëses, kanë zbatuar drejtë të drejtën materiale kur kanë konstatuar se znj. Mustafa nuk i përmbush kriteret e parashikuara me nenin 3 të LPPAK-së për ta fituar të drejtën në pension të aftësisë së kufizuar.

Pretendimet e parashtrueses

17. Parashtruesja pohon që ka pasur shkelje të nenit 3 të Kushtetutës, i cili garanton barazi para ligjit.

18. Parashtruesja gjithashtu pohon që ka pasur shkelje të nenit 51 të Kushtetutës, i cili thekson se kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social do të rregullohen me ligj.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që në përputhje me rregullin 36.1 (c), *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse kërkesa është qartazi e bazuar"*.

21. Rregulli 36.2 i Rregullores së punës më tej përcakton që:

> *"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:*
>
> *a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

22. Parashtruesja e kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të saj sipas Kushtetutës (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

23. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

24. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

25. Në rastrin konkret, parashtrueses i ishin ofruar mundësi të shumta për ta paraqitur rastin e vet dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit, që e konsideronte të pasaktë, para MPMS-së dhe Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të procedurave administrative dhe të rastit të Gjykatës Supreme si tërësi, Gjykata nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë

mënyrë të padrejta, apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

26. Prandaj, Gjykata konkludon që kërkesa është qartazi e pabazuar në kuptim të rregullit 36 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 46/10 datë 19 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit P. nr. 162/03, të 7 prillit 2005, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan; Aktgjykimit P.nr.628/04, të 8 marsit 2007, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë; Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap. nr. 393/2006, të 21 majit 2008; Aktgjykimit API. Nr. 04/2009, të 16 shtatorit 2009, të Kolegjit të Veçantë Penal të Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap. nr. 84/09, të 3 dhjetorit 2009

Rasti KI 46/10, vendim i 11 qershorit 2012.

Fjalët kyçe: actio popularis, cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese, kërkesë individuale, këshilli organizativ, kërkesë e papranueshme, locus standi, vepra penale e vrasjes.

Parashtruesja paraqiti kërkesën në emër të Këshillit Organizativ "Drejtësi për rastin Kiqina", bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë kushtetuese të individëve që parashtruesja pohonte se i përfaqësonte në emër të Këshillit në fjalë janë cenuar me aktgjykimet e gjykatave të rregullta, me ç'rast ata individë ishin dënuar me burg për shkak se ishin shpallur fajtor *ndër të tjera* për kryerje të veprës penale të vrasjes. Parashtrusja pohoi se gjykatat e rregullta individëve në fjalë u kanë cenuar të drejtat dhe liritë të garantuara me nenet 21, 22, 29, 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut.

Gjykata konstaoti se kërkesa e parashtrueses ishte e papranueshme bazuar në Nenin 113.1 të Kushtetutës për shkak se parashtruesja nuk ishte palë e autorizuar. Gjykata vendimin e saj e arsyetoi duke theksuar se palët që parashtrojnë kërkesat në Gjykatë duhet të jenë pale të autorizuara dhe se duhet të provojnë se janë të prekura drejtpërdrejtë nga akti normative apo vendimi i kontestuar. Duke cituar praktikën e saj gjyqësore në rastin *nr. KI51/10, Živić Ljubiša, vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Kryetarit të Republikës*

së Kosovës për emërimin e z. Zdravković Goran anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përfaqësim të komunitetit serb, Gjykata më tutje arsyetoi se aktet normative dhe vendimet nuk mund të kontestohen në mënyrë abstrakte pasi që Kushtetuta nuk parasheh *actio popularis*. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtrueses si të papranueshme.

Prishtinë, më 11 qershor 2012

Nr. ref.: RK250/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 46/10

Parashtruesi

Sebahate Shala, në emër të Këshillit Organizativ

"Drejtësi për rastin Kiqina"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit P. nr. 162/03, të 7 prillit 2005, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan; Aktgjykimit P.nr.628/04, të 8 marsit 2007, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë; Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap. nr. 393/2006, të 21 majit 2008; Aktgjykimit API. Nr. 04/2009, të 16 shtatorit 2009, të Kolegjit të Veçantë Penal të Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap. nr. 84/09, të 3 dhjetorit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Sebahate Shala nga Krajkova e Gllogovcit, e cila e parashtron kërkesën në bazë të autorizimit të Këshillit Organizativ "Drejtësi për rastin Kiqina". Parashtruesja e kërkesës ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) një peticion me nënshkrimet e afërsisht pesëdhjetë mijë (50.000) qytetarëve të Republikës së Kosovës në mbështetje të kërkesës së saj në Gjykatë.

2. Këshilli Organizativ "Drejtësi për rastin Kiqina" përbëhet nga studentë të Universitetit të Prishtinës, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Luftëtarëve të UÇK-së, aktivistë nga shoqëria civile dhe të tjerë.

3. Në kërkesë thuhet se parashtruesja e kërkesës përfaqësohet nga Visar Zogaj, student nga Malisheva. Sidoqoftë, formularin e kërkesës e ka nënshkruar ajo vetë.

Vendimet e kontestuara

4. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin P. nr. 162/03, të 7 prillit 2005, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan; Aktgjykimin P. nr. 628/04, të 8 marsit 2007, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë; Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap. nr. 393/2006, të 21 majit 2008; Aktgjykimin API. Nr. 04/2009, të 16 shtatorit 2009, të Kolegjit të Veçantë Penal të Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap. nr. 84/09, të 3 dhjetorit 2009.

Objekti i çështjes

5. Objekti i çështjes, sipas parashtrueses së kërkesës, është dënimi i padrejtë i pretenduar i Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës për vepra të rënda penale, përfshirë vrasjen. Parashtruesja e kërkesës pohon se ajo e përfaqëson një organizatë e cila pretendon se dënimi për vrasje

dhe vepra tjera të rënda ndaj disa personave të caktuar në "rastet Kiqina", përbënte shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56(2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 25 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

8. Më 29 qershor 2010, Arben Kiqina parashtroi një kërkesë në Gjykatë që është regjistruar të njëjtën datë me numër nr. KI 52/10.

9. Më 29 mars 2011, Jeton Sefer Kiqina parashtroi një kërkesë në Gjykatë që është regjistruar në Gjykatë në të njëjtën datë me nr. KI 43/11.

10. Më 7 qershor 2011, Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina dhe Blerim Kiqina dorëzuan në Gjykatë një kërkesë me nr. KI 78/11.

11. Më 13 qershor 2011, Burim Ramadani dhe Arsim Ramadani dorëzuan në Gjykatë një kërkesë të regjistruar me nr. KI 81/11.

12. Më 11 nëntor 2010, Kryetari e emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese në kërkesën KI46/10. Të njëjtën ditë, Kryetari e emëroi Kolegjin shqyrtues të përbërë

nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

13. Më 19 korrik 2011, Kryetari, me Urdhër BK-46/10, i bashkoi të gjitha këto kërkesa të ndara KI46/10, KI52/10, KI43/11, KI78/11 dhe KI81/11, për shkak të lidhshmërisë në mes tyre për nga objekti i çështjes dhe sa i përket personave që kanë bërë kërkesat. Gjyqtari raportues dhe Kolegji shqyrtues mbeten po të njëjtit që u emëruan për këtë kërkesë.

14. Më 14 maj 2012, për shkak të mungesës së përkohshme të gjyqtarit Ivan Čukalović, Kryetari caktoi veten, Enver Hasani, si gjyqtar zëvendësues në Kolegjin shqyrtues.

15. Më 15 maj 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi Raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve në bazë të dokumenteve të parashtrueses së kërkesës të parashtruara në Gjykatë

16. Nga kërkesa dhe dokumentet e dorëzuara me të, përmbledhja e shkurtër e fakteve mund të konstatohet si në vijim.

17. Në mbrëmjen e 20 gushtit 2001, H. H., së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët ishin në një dasmë në fshatin Baicë. Pasi u larguan nga dasma, më vonë gjatë asaj nate, vetura e tij u sulmua nga pusia, ku ai, bashkëshortja e tij, djali dhe dy vajzat e tij u qëlluan për vdekje. Vetëm një vajzë e re shpëtoi.

18. Më 4 korrik 2002, Blerim Kiqina u mor në pyetje si dëshmitar nga Policia e Kosovës dhe ajo ndërkombëtare, me ç'rast ai dha deklaratë inkriminuese ndaj vetes dhe të tjerëve që pretendohet të ishin përfshirë në vrasje. Deklarata inkriminuese e Blerim Kiqinës ishte incizuar me kamerë.

19. Më 7 korrik 2002, Blerim Kiqina e përsëriti deklaratën inkriminuese të cilën e kishte dhënë më 4 korrik 2002 para Gjyqtarit hetues.

20. Procedura hetimore çoi deri te aktakuza dhe gjykimi i Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës, Jeton Kiqinës dhe të tjerëve.

21. Më 7 prill 2005, Gjykata e Qarkut në Gjilan me Aktgjykimin P. nr. 162/03, i shpalli Burim Ramadanin, Arsim Ramadanin, Arben Kiqinën dhe disa persona të tjerë të akuzuar fajtor për vrasje, vrasje në tentativë dhe bashkëpunim në kryerje të veprës penale të vrasjes së H. H. dhe familjes së tij. Burim Ramadani, Arsim Ramadani dhe Arben Kiqina të gjithë u dënuan veç e veç me burgim prej 30 vitesh. Disa nga akuzat u hodhën poshtë në atë proces gjyqësor.

22. Të akuzuarit u ankuan ndaj këtij dënimi dhe më 20 maj 2008, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin e saj Ap. nr. 393/2006, e hodhi poshtë ankesën e Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit dhe Arben Kiqinës si të pabazuar dhe e vërtetoi dënimin e shpallur nga Gjykata e Qarkut në Gjilan, ndërsa të akuzuarit e tjerë Gjykata Supreme i liroi nga akuza sepse nuk mund të vërtetohej se i kishin kryer veprat penale për të cilat ngarkoheshin.

23. Më 16 shtator 2009, Kolegji i Veçantë Penal i Gjykatës Supreme me anë të Aktgjykimit API. Nr. 04/2009, hodhi poshtë një ankesë tjetër të ushtruar nga Burim Ramadani, Arsim Ramadani dhe Arben Kiqina ndaj aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme si të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me Jeton Kiqinën në bazë të dokumenteve të parashtrueses së kërkesës të parashtruara në Gjykatë

24. Më 8 mars 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me anë të Aktgjykimit P.nr.628/04, e shpalli Jeton Kiqinën fajtor për disa pika të aktakuzës përfshirë vrasjen, vrasjen në tentativë dhe bashkëpunim në kryerje të veprës penale të vrasjes së H. H. dhe familjes së tij të ngushtë. Jeton Kiqina u dënua me 15 vjet burgim.

25. Më 3 dhjetor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Ap. nr. 84/09, pjesërisht e miratoi ankesën e të akuzuarit Jeton Kiqina ku gjeti se ai ishte fajtor për pikat e aktakuzës vrasje dhe vrasje në tentativë, por e shfajësoi për pikën bashkëpunim në kryerje të veprës penale të vrasjes së H. H. dhe familjes së tij të ngushtë.

Kërkesa e parashtrueses dhe pretendimet e saj

26. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që:

a) Të shqyrtojë, analizojë dhe rivlerësojë shkeljen e të drejtave të njeriut ndaj personave të dënuar;

b) Të japë një mendim dhe të bëjë interpretimin e shkeljes së drejtave të njeriut që rezultoi nga këto dënime;

c) Të japë një mendim për shkeljen e të drejtave të njeriut të personave të dënuar; dhe

d) Të marrë vendim në bazë të kompetencave të Gjykatës nëse konkludon se janë provuar shkeljet e bëra ndaj personave të dënuar.

27. Parashtruesja e kërkesës pohon se janë shkelur këto nene të Kushtetutës: neni 21 [Të drejtat dhe liritë themelore], neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe mekanizmave ndërkombëtare], neni 29 [E drejta e lirisë dhe sigurisë], neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

28. Parashtruesja e kërkesës pretendon se asnjëra nga tri shkallët e gjykimit nuk e ka vërtetuar në mënyrë ligjore fajësinë e Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës.

29. Parashtruesja e kërkesës pretendon se në aktgjykimin e fundit të nxjerrë në vitin 2009, Kolegji i Veçantë Penal i Gjykatës Supreme nuk i miratoi ankesat e mbrojtjes. Kolegji i Veçantë Penal nxori aktgjykim me të cilën e vërtetoi dënimin por jo edhe akuzat. Parashtruesja e kërkesës pretendon se aktgjykimi në fjalë ishte në kundërshtim me dy shkallët më të ulëta të gjykimit dhe se arsyetimi i Kolegjit të Veçantë Penal të Gjykatës Supreme ishte në kundërshtim me vetveten.

30. Parashtruesja e kërkesës pretendon se i bashkakuzuari kryesor, Skënder Halilaj, së bashku me Florim Kiqinën dhe Zeqir Kiqinën u liruan më 12 korrik 2008, personat në fjalë ishin të akuzuar për të njëjtën vepër: planifikim, organizim dhe pjesëmarrje në vrasjen e H. H. dhe familjes së tij.

31. Parashtruesja e kërkesës pretendon se provat materiale dhe rezultatet e provave të ekzaminuara që e provonin pafajësinë e Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës, ishin humbur dhe kurrë nuk u gjetën.

32. Parashtruesja e kërkesës pretendon se akuzat ndaj Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës ishin fabrikuar dhe në tërësi të përgatitura paraprakisht nga ana e Ekipit ndërkombëtar hetues të UNMIK-ut.

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Jeton Kiqina u dënua me 16 vjet burgim nën akuzën se ka furnizuar me armë Florim Kiqinën, i cili më vonë pretendohet të ketë marrë pjesë në vrasjen e H. H. Mirëpo, Florim Kiqina u shpall i pafajshëm nga Gjykata Supreme e Kosovës në korrik të vitit 2008, ndërsa "furnizuesi" me armë, Jeton Kiqina, është ende burg. Gjykata e Qarkut në Gjilan e dënoi F. K. me 21 vjet burgim,

nën akuzën e planifikimit, organizimit dhe pjesëmarrjes në vrasjen e H. H. dhe familjes së tij.

34. Parashtruesja e kërkesës pretendon se në kohën kur kishte ndodhur vrasja e H. H., më 20 gusht 2001, në ora 23:17, sipas regjistrimit të KFOR-it, ky grup i djelmoshave po festonte ditëlindjen Burim Ramadanit në një kafiteri në Gllogoc. Aty ishin të pranishëm edhe tre policë, të cilët dëgjuan në radio lidhje lajmin e vrasjes së tmerrshme që kishte ndodhur në fshatin Tërstenik në Gllogovc. Këtë lajm pretendohet ta kenë dëgjuar të gjithë ata që po festonin.

35. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës iu mohua e drejta për gjykim të drejtë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës.

36. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata të japë një mendim dhe interpretim në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut dhe padrejtësinë që u është shkaktuar Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

37. Në mënyrë që të vendosë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

38. Kriteri i parë dhe kryesor i pranueshmërisë, të cilin Gjykata e shqyrton në lidhje me këtë dhe në të vërtetë me çdo kërkesë që i parashtrohet, është që të konstatohet se a e ka parashtruar parashtruesi kërkesën në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës që përcakton:

"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."

39. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës e ka parashtruar kërkesën në Gjykatë në emër të Këshillit Organizativ "Drejtësi për rastin Kiqina" në lidhje me dënimet e Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës, megjithatë nuk ka dorëzuar dokumentacion nga personat në fjalë me të cilin do të duhej që parashtruesja e kërkesës të autorizohej qartazi për t'i përfaqësuar ata në Gjykatë.

40. Gjykata vëren që, në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës nuk ka *locus standi* pranë Gjykatës, pasi që parashtruesja e kërkesës nuk i ka plotësuar kushtet procedurale të nenit 113.1 të Kushtetutës, në kuptimin që kërkesa nuk është ngritur në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

41. Sa i përket peticionit të nënshkruar nga afërsisht pesëdhjetë mijë (50.000) qytetarë të Republikës së Kosovës që është parashtruar në Gjykatë nga ana parashtrueses së kërkesës, për të mbështetur kërkesën, Gjykata vëren se nuk ka juridiksion të merret me kërkesa që janë *actio popularis,* që do të thotë aktet normative dhe vendimet nuk mund të kontestohen në abstrakt dhe se palët në këtë Gjykatë duhet të demonstrojnë që ato preken drejtpërdrejt nga akti normativ dhe/ose vendimi i kontestuar dhe në të vërtetë duhet të jenë palë e autorizuar pranë kësaj Gjykate në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës që e rregullon juridiksionin e Gjykatës dhe ofron bazën juridike për parashtrimin e kërkesave nga ana e parashtruesve të kërkesë në këtë Gjykatë.

42. Kjo Gjykatë në rastin e kërkesës Rasti nr. KI51/10, Zivic Ljubisa, vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Kryetarit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Zdravkovic Goran anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përfaqësim të komunitetit serb, i datës 2 mars 2012, theksoi si në vijim:

"Personi i cili nuk është prekur në këtë mënyrë, nuk e ka statusin e viktimës pasi që Kushtetuta nuk parasheh actio popularis. Me fjalë të tjera, një parashtrues i kërkesës nuk mund të ankohet në abstrakt ndaj masave të autoriteteve publike të cilat nuk janë zbatuar personalisht ndaj tij, siç është ky rast në këtë Gjykatë."

43. Sikurse në atë rast, parashtruesja e kërkesës në këtë rast nuk preket nga dënimet e shpallura nga gjykatat e Kosovës dhe rrjedhimisht nuk është palë e autorizuar dhe kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, pas shqyrtimeve më 15 maj 2012, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'i komunikohet palës; dhe

III. Ky Vendim do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Dr. Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

KI 52/10 datë 19 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P. nr. 162/2003, të 7 prillit 2005, dhe të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. nr. 393/2006, të 20 majit 2008, Nr. 4/09, të 16 shtatorit 2009, dhe PKL-KZI nr. 30/2010, të 1 shkurtit 2011

Rasti KI 52/10, vendim i 11 qershorit 2012.

Fjalët kyçe: cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, ligji i procedurës penale, vepra penale e vrasjes.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese janë cenuar me aktgjykimet e gjykatave të rregullta të të gjitha shkallëve, me ç'rast parashtruesi ishte dënuar me burg lidhur me akuzat *mes tjerash* për kryerje të veprës penale të vrasjes. Parashtruesi pohoi se gjykatat e rregullta të të gjitha shkallëve kanë cenuar të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 36 të Rregullores së Punës për shkak se ishte qartazi e pabazuar. Gjykata vendimin e saj e arsyetoi duke theksuar se gjykatat e rregullta i kanë marrë parasysh dhe iu kanë përgjigjur ankesave të parashtruesit në çështje ligjore që kanë të bëjnë me pranimin e provave dhe vërtetësinë e tyre, vërtetimin e gjendjes faktike dhe zhvillimin e procedurës penale. Gjykata poashtu përsëriti se nuk është gjykatë e apelit apo gjykatë e shkallës së katërt dhe se vërtetimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike është juridiksion i gjykatave të rregullta. Duke cituar vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* Gjykata më tutje arsyetoi se fakti që parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese. Për shkak të arsyeve të

përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

Prishtinë, më 11 qershor 2012

Nr. ref.: RK251/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 52/10

Parashtruesi

Arben KIQINA

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P. nr. 162/2003, të 7 prillit 2005, dhe të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. nr. 393/2006, të 20 majit 2008, Nr. 4/09, të 16 shtatorit 2009, dhe PKL-KZI nr. 30/2010, të 1 shkurtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Arben Kiqina nga fshati Baicë, Komuna e Gllogocit, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, Ibrahim Z. Dobruna, avokat nga Drenasi. Kërkesa ka mbi 300 faqe.

2. Faktet dhe pretendimet e kësaj kërkese, të regjistruar nën numrin KI52/10 janë në thelb të ngjashme me faktet dhe

pretendimet e paraqitura në kërkesat KI46/10, KI43/11, KI78/11 dhe KI81/11.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Parashtruesi e ka parashtruar kërkesën mbi bazën që Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan P. Nr. 162/2003, i 7 prillit 2005, dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. nr. 393/2006, i 20 majit 2008, Nr. 4/09, i 16 shtatorit 2009, dhe PKL-KZI nr. 30/2010, i 1 shkurtit, 2011 kanë rezultuar në shkeljen e drejtës së tij kushtetuese për gjykim të drejtë sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 29 qershor 2010, e cila u regjistrua po të njëjtën ditë nën Nr. KI52/10. Më 1 qershor 2011, parashtruesi paraqiti dokumente shtesë në Gjykatë.

6. Para kësaj, më 25 qershor 2010, znj. Sebahate Shala, nga Krajkova e Drenasit, kishte parashtruar kërkesë sipas autorizimit të Këshillit Organizativ "Drejtësi për Rastin Kiqina", e cila u regjistrua nën Nr. KI46/10.

7. Më 29 mars 2011, Jeton Sefer Kiqina parashtroi kërkesë në Gjykatë, e cila u regjistrua po të njëjtën ditë nën Nr. KI46/10.

8. Më 7 qershor 2011, Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina dhe Blerim Kiqina dorëzuan një kërkesë në Gjykatë, e cila u regjistrua nën Nr. KI78/11.

9. Më 13 qershor 2011, Burim Ramadani dhe Arsim Ramadani dorëzuan një kërkesë në Gjykatë, e cila u regjistrua nën Nr. KI81/11.

10. Më 11 nëntor 2010, Kryetari e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese në kërkesën KI 46/10. Të njëjtën ditë, Kryetari e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

11. Më 19 korrik 2011, Kryetari, me Urdhrin BK46/10, i bashkoi të gjitha këto kërkesa të ndara KI46/10, KI52/10, KI43/11, KI78/11 dhe KI81/11 për shkak të lidhshmërisë me njëra-tjetrën sa i përket objektit të çështjes dhe personave që i parashtrojnë kërkesat. Gjyqtarja raportuese dhe Kolegji shqyrtues mbetën të njëjtit për të gjitha kërkesat.

12. Më 14 maj 2012, për shkak të mungesës së përkohshme të gjyqtarit Ivan Čukalović, Kryetari, Enver Hasani, e caktoi veten si gjyqtar zëvendësues në Kolegj shqyrtues.

13. Më 15 maj 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve sipas dokumenteve që parashtruesi i kishte parashtruar në Gjykatë

14. Në mbrëmjen e 20 gushtit 2001, H. H., bashkë me bashkëshorten dhe fëmijët e vet, kishin qenë në një dasmë në fshatin Baicë. Pasi u larguan nga dasma, më vonë atë natë, vetura e tij hasi në pusi dhe ai, bashkëshortja e tij, djali i tij dhe dy vajzat e tij vdiqën nga të shtënat. Një vajzë e re mbijetoi.

15. Të nesërmen, Blerim Kiqina dhe Jeton Kiqina u takuan me Burim Ramadanin, Arsim Ramadanin, Arben Kiqinën dhe një tjetër jashtë restorantit Era në Gllogoc. Burim Ramadani i tha që aksioni kishte shkuar shumë mirë dhe që S.H. ia kishte dhënë ose do t'ia jepte paratë. Biseduan si t'i ndanin paratë.

16. Më 4 korrik 2002, Blerim Kiqina u paraqit në stacion të policisë. Me këtë rast u arrestua, iu komunikuan të drejtat dhe më pas u mor në pyetje. Blerim Kiqina hoqi dorë nga e drejta për të heshtur dhe për ndihmë juridike dhe vazhdoi me dhënien e deklaratës. Blerim Kiqina i pranoi vrasjet dhe i implikoi pjesëmarrësit e tjerë në krim. Personat që i implikoi ishin: Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina, Jeton Kiqina dhe të tjerët.

17. Më 7 korrik 2002, kur Berim Kiqina u paraqit para Gjyqtarit hetues, ai përsëriti pothuaj fjalë për fjalë atë që ia kishte thënë policisë gjatë marrjes në pyetje më 4 korrik 2002.

18. Pavarësisht deklaratave që i kishte dhënë në polici më 4 dhe 7 korrik 2002, më 11 tetor 2002, Blerim Kiqina e tërhoqi deklaratën mbi bazën se e kishte trilluar tregimin.

19. Pas ngritjes së aktakuzës dhe gjykimit pasues në Gjykatën e Qarkut në Gjilan (Aktgjykimi P. nr. 162/03, i 7 prillit 2005), Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Ramadani, Blerim Kiqina dhe të tjerët u dënuan për vrasjen e pesë anëtarëve të familjes H.

20. Të gjithë të pandehurit parashtruan ankesë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan Nr. 162/2003, të 7 prillit 2005. Pas seancës së mbajtur më 20 maj 2008, Gjykata Supreme e Kosovës, në shkallë të dytë, e shpalli Aktgjykimin e vet (AP - KZ 393/2006) me të cilin i refuzoi ankesat e Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Blerim Kiqinës në bazë të palejueshmërisë. Gjykata Supreme e konfirmoi aktgjykimin e shkallës së parë në lidhje me këta katër të pandehur. Megjithatë, të pandehurit e tjerë u liruan për shkak të mungesës së provave që ata e kishin kryer veprën penale për të cilën ishin akuzuar.

21. Me ankesat e parashtruara në lidhje me Burim Ramadanin, Arsim Ramadanin dhe Arben Kiqinën kontestohej aktgjykimi i nxjerrë nga Gjykata Supreme në shkallë të dytë mbi bazën se kishte: shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale (duke përfshirë zëvendësimin e një gjyqtari në Trupin gjykues); vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; shkelje të ligjit penal dhe vendimit të padrejtë lidhur me dënimin. Gjykata

Supreme i shqyrtoi aspektet procedurale dhe materiale të përfshira në ankesë.

22. Të pakënaqur më rezultatin e ankesës, parashtruesit parashtruan edhe një ankesë ndaj aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Gjykata Supreme, në Kolegjin e shkallës së tretë, i refuzoi ankesat si të papranueshme (Aktgjykimi API. nr. 04/2009, i 16 shtatorit 2009).

23. Një nga çështjet e para të ngritura në këtë ankesë kishte të bënte me përbërjen e Trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut (gjykata e shkallës së parë). Gjatë gjykimit, një gjyqtar ndërkombëtar në Kolegj u zëvendësua me një gjyqtar tjetër ndërkombëtar. Parashtruesi pretendonte që kjo u kishte mundësuar gjyqtarëve tjerë të ndikonin në gjyqtarin e ri dhe që gjykimi do të duhej të rifillonte nga fillimi. Ai pretendoi që Gjykata Supreme, në shkallë të dytë, kishte refuzuar që kishte shkelje të Kodit të Procedurës Penale.

24. Gjykata Supreme, në shkallë të tretë, e hodhi poshtë këtë pikë të ankesës si të pathemeltë duke u bazuar në nenin 305 të Ligjit të Procedurës Penale dhe theksoi: *"Në atë kohë Kolegji zbatoi nenin 305 të Ligjit të Procedurës Penale i cili, në rast të zëvendësimit të një gjyqtari tjetër, përveç kryetarit të Kolegjit, ofron mundësinë që Kolegji ose të rifillojë shqyrtimin gjyqësor prej fillimit ose të vendosë ta vazhdojë atë dhe të lexojë procesverbalet e shqyrtimeve të mëparshme. Gjyqtari i ri ka marrë të gjitha procesverbalet e gjykimit dhe palët pranuan dhe kështu të gjitha shënimet u lexuan".*

25. Përveç kësaj, zëvendësimi i një gjyqtari ndërkombëtar në trupin gjykues ishte i lejuar me ligj dhe kushtet për këtë zëvendësim ishin plotësuar. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese i referohet rastit P.K. kundër Finlandës, Kërkesa Nr. 37442/97, në të cilin Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në seancën e 9 korrikut 2002, vendosi që pavarësisht zëvendësimit të një gjyqtari gjatë rrjedhës së gjykimit të P.K.-së "*Detyra e Gjykatës është të konstatojë nëse procedurat në tërësi, duke përfshirë mënyrën e marrjes së provave, ishin të drejta. ... Megjithatë, Gjykata konsideron që, në rrethanat specifike të këtij rasti, kjo e metë më vete nuk përbën shkelje të nenit 6. Së pari, edhe pse kryetari i trupit gjykues ishte*

ndërruar, tre gjyqtarët e tjerë porotë mbetën të njëjtit gjatë tërë procedurës. Së dyti, kredibiliteti i dëshmitarit në fjalë nuk është kontestuar në asnjë fazë, e as që ka ndonjë indikacion në shkresa të lëndës që i justifikojnë dyshimet për kredibilitetin e saj. Në këto rrethana, fakti që kryetari i ri i trupit gjykues kishte në dispozicion procesverbalin e seancës në të cilën dëshmitari ishte dëgjuar (khs. Karjalainen kundër Finlandës, Kërkesa Nr. 30519/96, Vendimi i Komisionit i 16 prillit 1998, i paraportuar) e kompenson në masë të madhe mungesën e tij të drejtpërdrejtë në procedurë. Së treti, dënimi i parashtruesit nuk ishte i bazuar vetëm në dëshminë e dëshmitarit H. Së fundi, nuk ka asgjë që sugjeron se kryetari i trupit gjykues ishte ndërruar për të ndikuar në përfundimin e rastit apo për ndonjë motiv tjetër të pavend. ... Konkluzionet e nxjerra nga gjykatat vendëse në këtë rast nuk duken të jenë arbitrare për të ngritur çështje sipas nenit 6...” Edhe një rast tjetër i GJEDNJ-së tregon se fakti i thjeshtë i zëvendësimit të një gjyqtari gjatë rrjedhës së gjykimit nuk përbën, vetvetiu, shkelje të nenit 6 të Konventës (*shih Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës, Kërkesa Nr. 10590/83, e 6 dhjetorit 1988, Moiseyev kundër Rusisë (Kërkesa Nr. 62936/00), e 9 tetorit 2008, dhe Ocalan kundër Turqisë (Kërkesa Nr. 46221/99), e 15 majit 2005*). Duke pasur tërë këtë parasysh, kjo Gjykatë është e mendimit që Gjykata Supreme kishte të drejtë kur konstatoi që nuk kishte shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm me rastin e zëvendësimit të gjyqtarit ndërkombëtar.

26. Një pjesë tjetër thelbësore e ankesës të cilën parashtruesit ia kishin parashtruar Gjykatës Supreme, si shkallë e tretë, kishte të bënte me pranueshmërinë e provave të përdorura nga gjykata më të ulëta. Që të dy aktgjykimet, ai i Gjykatës së Qarkut dhe i Gjykatës Supreme, në shkallë të dytë, janë kryesisht të bazuara në deklaratat e dhëna nga: Blerim Kiqina në fazën hetimore, dëshmitari “MB” dhe vajza që u mbijetoi të shtënave. Të gjitha këto burime të dëshmive u kundërshtuan me ankesë (dhe u përsëritën në këtë kërkesë). Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Ap. nr. 04/2009, të 16 shtatorit 2009, e refuzoi ankesën dhe konkludoi si vijon:

    a. Pas ekzaminimit të videoincizimit të dhënies së dëshmisë nga Blerim Kiqina, doli që rrëfimi i tij ishte i vërtetë dhe

nuk kishte arsye të besohej që i kishte trilluar dëshmitë. Shpjegimi i hollësishëm i vrasjeve do të mund të bëhej vetëm nga dikush që kishte njohuri të drejtpërdrejtë të ngjarjes;

b. Pas shqyrtimit të hollësishëm të deklaratave të Blerim Kiqinës të 4 korrikut 2002, 7 korrikut 2002 dhe 11 tetorit 2002, janë identifikuar disa mospërputhje, posaçërisht në lidhje me lëvizjet e Blerim Kiqinës më 20 gusht 2001. U konstatua që e gjithë dëshmia e tij nuk duhet dhe nuk mund të hidhet tej vetëm pasi nuk është pjesërisht e besueshme. Pas shqyrtimit të pjesëve të pranueshme të dëshmisë së tij, ishte më se e qartë që Blerim Kiqina ndodhej në vend të ngjarjes në kohën e caktuar dhe që i kishte kryer veprat penale të cilat pranoi t'i kishte kryer. Besueshmëria e deklaratës së dhënë nga Blerim Kiqina para Gjyqtarit hetues më 7 korrik 2002 ishte vërtetuar nga motivet e rrëfimit të tij, saktësia dhe përputhshmëria e deklaratave të tij, mungesa e mospërputhjeve të mëdha dhe mospërputhja e alibisë së të pandehurve;

c. Aktgjykimet morën parasysh edhe provat mbështetëse të rrëfimit, si përshkrimi i saktë, nga Blerim Kiqina, i të akuzuarve të tjerë, ekzistenca e vendit prej nga janë marrë armët, koha e largimit të familjes H. nga dasma, kronologjia e ngjarjeve në urë dhe pozita e makinës tek ura. Ato u mbështetën me dëshminë e vajzës që u mbijetoi të shtënave, dëshmitë e "MB-së", R. K., S. K., E. K., S. K., G. K., Y. K. dhe B. K., regjistrimet e thirrjeve telefonike, si dhe ekzaminimet balistike të plumbave që vërtetuan deklarimin e Blerim Kiqinës për llojin e armës së përdorur për kryerjen e krimit;

d. Pretendimi se dëshmia e "MB-së" ishte e papranueshme ishte refuzuar mbi bazën se ishte i pabazuar. "MB" ofroi dëshmi se Burim Ramadani i kishte treguar asaj se ai i kishte kryer vrasjet. Në ankesë u tha që: 1) "MB" nuk ishte këshilluar lidhur me të drejtën për të mos dëshmuar pasi ajo kishte bashkëjetuar me Burim Ramadanin; 2) Publiku ishte përjashtuar në mënyrë të paligjshme nga dëshmia e saj gojore gjatë seancës, dhe Kolegji nuk kishte lëshuar vendim me shkrim lidhur me masat mbrojtëse që

i janë dhënë “MB-së”; dhe 3) Burim Ramadanit i ishte mohuar e drejta për t’i bërë pyetje “MB-së”, gjë që rezultoi në shkelje të nenit 314 të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale;

e. Si përgjigje ndaj këtyre pretendimeve, Gjykata Supreme theksoi se lirimi nga dëshmia vlente vetëm për bashkëshortët dhe se “MB” nuk ishte liruar pasi nuk ishte bashkëshortja e Burim Ramadanit. Në pajtim me nenet 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/20, Trupi gjykues zbatoi masat mbrojtëse ndaj “MB-së” pasi ajo ishte një dëshmitare të cilën i pandehuri e njihte mirë dhe kishte lidhje intime me të. Vendimi gjyqësor përmbante vendimin për përjashtimin e publikut nga seanca kur “MB-ja” duhej të jepte dëshminë me gojë. Së fundi, Burim Ramadanit nuk i ishte mohuar mundësia për t’i bërë pyetje “MB-së” gjatë dëshmisë së saj. Në përgjithësi, dëshmia e “MB-së” u konsiderua e besueshme, posaçërisht duke marrë parasysh faktin se ishte thirrur nga policia të dëshmonte, ishte e arsyeshme në përshkrimin e ngjarjeve dhe e vazhdoi dëshminë e saj përkundër kërcënimeve nga anëtarët e familjes së të pandehurve;

f. Ankesa përmbante një argument se Gjykata e kishte shkelur procedurën penale me mënyrën se si kishte dëshmuar vajza që u mbijetoi të shtënave. Gjykata konstatoi që nuk ka pasur shkelje të procedurës penale me rastin e përjashtimit të publikut gjatë dëshmisë së vajzës që u mbijetoi të shtënave për shkak se ajo kishte dëshmuar përmes video lidhjes. Avokati mbrojtës pati mundësi ta merrte atë në pyetje edhe në gjykimin kryesor; dhe

g. Gjykata e hodhi poshtë pretendimin se ka pasur vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike për shkak të zhdukjes së provave të rëndësishme materiale mbi bazën se kjo nuk e ka penguar përcaktimin e drejtë të gjendjes faktike. Ankesat u referoheshin gjurmëve në parafinë të marra nga F. K. dhe Arben Kiqina më 21 gusht 2001 dhe ekzaminimit të disa eksponateve të mbledhura në vendet

e hetuara, që duhej të ekzaminoheshin për t'i gjetur gjurmët e gishtave ose mostrat ADN-së.

27. Gjykata Supreme, në shkallë të tretë, e konfirmoi aktgjykimin e shkallës së dytë në tërësi.

28. Parashtruesi e konsideroi aktgjykimin e sipërpërmendur si "jashtëzakonisht të padrejtë dhe të pabazuar në prova të besueshme dhe bindëse". Prandaj, ata paraqitën kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Megjithatë, me Aktgjykimin PKL. nr. 30/10, të 1 shkurtit 2011, Gjykata Supreme edhe një herë e hodhi poshtë kërkesën.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Ankesa e përgjithshme në kërkesë është se gjykatat e rregullta kishin kryer vetëm gjetje, vlerësime dhe konkluzione të përgjithshme duke shkelur dispozitat procedurale, të cilat kërkojnë nga gjykatat vlerësim të sinqertë të secilës provë veç e veç dhe në lidhje me provat tjera. Prandaj, në bazë të kësaj parashtruesi pretendon se aktgjykimet janë të paqëndrueshme.

30. Në përgjithësi, parashtruesi i kërkesës e konteston besueshmërinë e provave të përdorura nga gjykatat e rregullta në formulimin e aktgjykimeve dhe pretendon se shqyrtimi i këtyre provave nuk ishte i duhur. Parashtruesi i kërkesës pohon më sa vijon:

    a. Gjykatat nuk i kanë vërtetuar pohimet e dëshmitarëve kryesorë me prova të mjaftueshme, si materiali mjekoligjor (nga të cilat disa mungojnë);

    b. Të bashkëpandehurit në lidhje gjaku do të duhej të liroheshin nga dëshmimi kundër të afërmve të tyre;

    c. Prova e dëshmitarit "MB" nuk është dashur të shqyrtohej nga gjykatat për shkak se ajo kishte qenë në lidhje me Burim Ramadanin deri në kohën e arrestimit të tij dhe kërkonte t'i hakmerrej Burim Ramadanit pasi nuk u martua me të;

d. Dëshmia e Blerim Kiqinës, të cilës gjykatat i kishin dhënë prioritet të lartë, ishte kundërthënëse dhe me të meta sepse ai ishte i mitur në kohën kur vrasja kishte ndodhur, ishte mashtruar nga hetuesit me mundësinë për t'u larguar nga vendi dhe ishte kërcënuar nga policia për ta ndërruar dëshminë e tij;

e. Dëshmia e vajzës që u mbijetoi të shtënave nuk do të duhej të merrej parasysh për shkak të mospërputhjes me provat e tjera;

f. Në bazë të nenit 157 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, gjykatat nuk do të duhej t'i shpallnin të pandehurit fajtorë duke u mbështetur vetëm në një dëshmi; dhe

g. Gjykata e Qarkut e shkeli procedurën penale (nenet 354-359 dhe 403 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës) sepse pas caktimit të një gjyqtari të ri në Trup gjykues gjatë procedurës, gjykimi nuk kishte rifilluar nga fillimi.

Vlerësimi i pranueshmërisë

36. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

38. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është Gjykatë e verifikimit të fakteve, Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se vërtetimi i drejtë dhe i plotë gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që

garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt", (*shih, mutatis mutandis, ndër të tjera, Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65; shih, gjithashtu, Aktvendimin për Papranueshmëri në Rastin Nr. KI-86/11 – Parashtrues i kërkesës Milaim Berisha – Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 20/09, të 1 marsit 2011 – të nxjerrë nga Gjykata më 5 prill 2012*).

39. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën shihet që parashtruesi i kërkesës i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe që gjykatat e rregullta i kanë marrë parasysh dhe iu kanë përgjigjur ankesave të tij në çështje ligjore që kanë të bëjnë me pranimin e provave dhe vërtetësinë e tyre, vërtetimin e gjendjes faktike dhe zhvillimin e procedurës penale. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se gjykatave, gjatë dëgjimit të rastit, u mungonte paanshmëria apo që procedura ishte e padrejtë.

40. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pohimin e tij për të sqaruar si dhe pse është bërë shkelja, apo nuk ka ofruar prova për të dëshmuar se është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë.

41. Përveç kësaj, kërkesa nuk tregon që Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat që i kanë përpara. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (*shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 13071/87, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, para. 34, e 10 korrikut 1991*).

42. Vetë fakti që parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (*shih, mutatis mutandis, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-*

Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

43. Në këto rrethana, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë që gjykatat e rregullta, të të tri shkallëve, ia kanë mohuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e papranueshme në përputhje me rregullin 36 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 15 maj 2012, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'i komunikohet parashtruesit; dhe

III. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

INDEKSI I TERMAVË

TERMAT	NUMRI I FAQËS
A	
Agjensia Kosovare e Privatizimit	-161
Ansambleja Komunale e Komunës Shtime	-427
Agjensia Kosovare e Anti-Korrupsionit	-198
GJ	
Gjykata Supreme e Kosovës	-90, 135, 143, 173, 189, 230, 238, 264, 290, 300, 328, 366, 448, 461, 477, 552, 562, 632, 643, 665, 707, 734, 767, 775, 822
Gjykata e Regjionit Prishtinë	-359, 489, 806, 846
Gjykata e Regjionit Gjilan	-90, 503, 612, 833, 846
Gjykata e Regjionit Prizren	-215

Gjykata e Regjionit Pejë -320, 403

Gjykata Komunale e Vushtrisë -244

Gjykata Komunale e Gjilanit -336

Gjykata Komunale e Prishtinës -51, 415

Gjykata Komunale e Vitisë -612

K

Korporata Energjitike e Kosovës -24, 173, 230

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve -311

Këshilli Gjyqësor i Kosovës -381

-734

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës.

Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit -71

Komisioni i Kërkesave Banesore dhe Pronësore -108

M

Misionit Evropian për Drejtësi dhe Sundim të Ligjit -207

Ministria e Punëve të Mbrendshme -207

Marrëveshjet Ndërkombëtare -347

O

Organizata për Demokraci, Anti-Korruption and Dinjitet "Çohu" -198

Ombudspersoni i Republikës së Kosovës -427

P

Presidenca e Republikës së Kosovës -311, 439

Parlamenti i Republikës së Kosovës -347

Q

Qeveria e Kosovës -651, 672

R

ratione temporis -62, 238

U

Universiteti i Prishtinës -151

Ushtria Çlirimtare e Kosovës -497, 643

UNMIK -715

Z

Zyra e Prokurorit të Shtetit -198

INDEKSI I NENËVE TË KUSHTETUTËS

Neni/Titulli **Vendimi/ Numri i Faqës**

KAPITULLI I

DISPOZITAT THEMELORE

3	Barazia para ligjit	-71, 244, 461
5	Gjuhët	-381

KAPITULLI II

TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE

21	Parimet e përgjithshme	-51, 116, 415, 448, 497, 552, 793
22	Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare	-51,143, 552, 767, 833
23	Dinjiteti i njeriut	-51, 116, 290, 651
24	Barazia para ligjit	-24,135, 143, 189, 244, 290, 389, 461, 477, 497, 816
26	E drejta e integritetit personal	-651
29	E drejta e lirisë dhe sigurisë	-116, 198, 833

31	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	-14, 24, 116, 135, 143, 244, 290, 300, 336, 366, 325, 403, 461,742, 775
32	E drejta për mjete juridike	-244, 328, 381,389, 403, 775
36	E drejta e privatësisë	-244, 427
37	E drejta e martesës dhe familjes	-816
46	Mbrojtja e pronës	-24, 100, 161, 244, 328, 366, 448, 489
49	E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	-62, 151, 173, 215, 230, 238, 290, 477, 602
50	Të drejtat e fëmijës	-816
51	Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	-583, 784, 816
53	Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut	-403, 530, 552
54	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	-173, 366, 489, 816

KAPITULLI IV

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

65	Kompetencat e kuvendit	-207

KAPITULLI V
PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

84	Kompetencat e presidentit	-530

KAPITULLI VI
QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

93	Kompetencat e qeverisë	-590

KAPITULLI VII
SISTEMI I DREJTËSISË

102	Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor	-403, 477, 530, 571, 775
103	Organizimi dhe jurisdiksioni i gjykatave	-530
104	Emërimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve	-381, 530
108	Këshilli gjyqësor i kosovës	-381

KAPITULLI IX

MARRËDHËNIET EKONOMIKE

119	Parimet e përgjithshme	-530

KAPITULLI XIV
DISPOZITAT KALIMTARE

146	Përfaqësuesi ndërkombëtarë civil	-672
147	Autoriteti përfundimtarë i përfaqësuesit ndërkombëtarë civil	-672